

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

**Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore
Vlorë**

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

MBI

“AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË”

Tiranë, gusht 2024

Nr.	PËRMBAJTJA	Faqe
I	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	3
1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	8
II	HYRJA	9
1	Objektivat dhe qëllimi	9
2	Identifikimi çështjes	10
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	10
4	Përgjegjësitë e audituesve	11
5	Kriteret e vlerësimit	11
6	Standardet e auditimit	12
7	Metodat e auditimit	12
8	Dokumentimi i auditimit	13
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	13
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	13
2	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit	14
2.1	Programimi i të ardhurave tatimore dhe jo tatimore, realizimi i tyre, ndarë sipas strukturës së të ardhuravë tatimore dhe analiza e tyre referuar kuadrit rregullator fiskal në fuqi.	14
2.2	Vlerësimi i përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor	33
2.2.1	<i>-Sektori i Kontrollit në Vend</i>	33
2.2.2	<i>-Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit</i>	173
2.3	Vlerësimi i përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë së Shërbimeve të Tatimpaguesve	192
IV	REKOMANDIME	200

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit

Drejtoria Rajonale Tatimore (DRT) Vlorë është një institucion buxhetor në varësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, e ngarkuar për administrimin e taksave, tatimeve dhe kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe përgjegjëse për përgatitjen e planeve dhe objektivave institucionale, në funksion të promovimit të transparencës së duhur në marrëdhëniet me tatimpaguesin, duke siguruar sisteme të kontrollit të brendshëm që minimizojnë riskun e korrupsionit, dhe trajtimin e pandashëm për të gjithë tatimpaguesit. Misioni i Administratës Tatimore është mbledhja e të ardhurave tatimore përmes procedurave të thjeshta dhe me kosto minimale, duke zbatuar njëtrajtësisht legjislacionin tatimor, për financimin e buxhetit të shtetit shqiptar. Financimi i institucionit kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) sipas programit buxhetor “Menaxhimi i të ardhurave tatimore”, pjesë e programeve buxhetore të administruara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 1111/1 prot., datë 26.12.2023, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, u ushtrua auditim në këtë drejtori lidhur me programimin dhe realizimin e të ardhurave tatimore, vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor dhe Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve për periudhën 01.01.2021-31.12.2023.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij

DRT Vlorë është një njësi administrative e krijuar në mbështetje të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 90/2012, datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”. Organigrama e Drejtorisë Rajonale Tatimore është miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr. 79, datë 27.03.2020 “Për miratimin e organigramës së administratës tatimore qendrore”, në mbështetje të urdhrit nr. 33, të Kryeministrit datë 12.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore”, e ngarkuara për administrimin e tatimeve, taksave dhe kontributeve. Auditimi i këtij institucioni lidhur me realizimin e të ardhurave kundrejt planit, buxhetit, dhe vlerësimin të përputhshmërisë së veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor dhe Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, ka një rëndësi të veçantë, lidhur me transparencën e veprimtarisë në këtë fushë, impaktin financiar në buxhetin e shtetit. DRT Vlorë paraqitet në rangun e drejtorive rajonale tatimore kryesore, referuar nivelit të mbledhjes së të ardhurave kundrejt totalit të sistemit tatimor.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2023, nëpërmjet evidentimit të devijimeve nga standardet e pranuar, të shkeljeve të parimeve e të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar, me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga ana e subjektit të audituar.

Nëpërmjet kryerjes së këtij auditimi KLSH synon të promovojë:

- Transparencën, duke ofruar raport të besueshëm për fondet nëse janë mbledhur dhe administruar sipas një procesi të rregullt dhe është respektuar kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi;
- Përgjegjshmërinë ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor e rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korigjuese dhe personat përkatës të përgjigjen për veprimet e tyre;
- Qeverisjen e mirë, duke identifikuar dobësitë dhe duke vlerësuar rregullshmërinë aty ku kuadri ligjor rregullator rezulton i pamjaftueshëm dhe/ose i papërshtatshëm, si dhe duke marrë parasysh riskun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë.

Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësimin me synim marrjen e masave dhe veprimeve korigjuese nga subjekti i audituar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Programimi i të ardhurave tatimore dhe jo tatimore, realizimi i tyre, ndarë sipas strukturës së të ardhuravë tatimore dhe analiza e tyre referuar kuadrit rregullator fiskal në fuqi.
- Vlerësimi i përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor:
 - *Spektori i Kontrollit në Vend*
 - *Spektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit*
- Vlerësimi i përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë së Shërbimeve të Tatimpaguesve.
- Çështje të tjera që dalin gjatë auditimit.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Metodatat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera, me qëllim arritjen e objektivave të auditimit në bazë të vlerësimit të riskut.

Në këtë auditim janë përzgjedhur metoda, metodologji apo teknika auditimi dhe shtrirje të procedurave të auditimit, për të dhënë siguri të arsyeshme për arritjen e konkluzioneve të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat e mëposhtme:

- Intervistimi - duke komunikuar dhe marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;
- Raporte dhe informacione - shfrytëzimi i raporteve, informacioneve relevante dhe që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtmet e auditimit;
- Verifikimi në sistemet DRT Vlorë (C@TS)- me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
- Teknikat me ndihmën e kompjuterit - për procedura të programuara, për të bërë testimet ose për nxjerrjen të dhënave për testim të mëtejshëm;
- Verifikime transaksionesh – me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
- Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën objekt auditimi paraqet problematika dhe mangësi në disa drejtime të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 37 gjetje dhe ka dhënë 39 rekomandime, nga të cilat 14 masa organizative dhe 25 masa të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore

- Nga auditimi u konstatua mosrealizim i planit të të ardhurave sipas zërave kryesore, mungesa e kryerjes së analizave periodike mbi progresin e realizimit të të ardhurave sipas fushave kryesore, vonesa dhe mangësi në përcjelljen e planeve të të ardhurave për Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

- Nga auditimi u konstatua se, gjatë zhvillimit të aktivitetit të tyre, shoqëritë “E” SHPK, “K”, “K.R” SHPK, “T” SHPK, në periudha të ndryshme kohore kanë kryer transaksione huamarrje dhe huadhënie me ortakun (kreditime dhe debitime nga llogaria e ortakut), për llogari të shoqërive përkatëse, me qëllim mbarëvajtjen normale të aktivitetit tregtar të shoqërive, sipas përshkrimeve në raportet e kontroleve të inspektorëve tatimor. Nga ana e inspektorit nuk është bërë informacioni RAD (Raportim i Aktivitetit të Dyshimtë) në lidhje me shumat e parave të cilat kanë kaluar si hua ortakut ndaj shoqërisë, veprime këto jo në përputhje me dispozitat e ligjit Nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit” i ndryshuar, neni 18.1 si dhe UMF Nr.16, datë 16.2.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, neni 5, pika 1 dhe 2 . Këto pagesa nuk konfirmohen me saktësi në raportet e kontrollit tatimor, si pagesa të kryera nëpërmjet sistemit bankar dhe të pasqyruara me prova në aktet e mbajtura nga inspektorët e kontrollit.

- Në 4 raste nga auditimi i raportit të kontrollit të ushtruar në tatimpaguesit “S”, “F”, R, “A”, për zbatimin e kërkesave të ligjit Nr. 9136, datë 11.02.2003 “Për mbledhjen e detyrueshme të kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore”, kanë rezultuar mangësi pasi nuk janë analizuar kontratat individuale të punës midis shoqërisë dhe punonjësve, në lidhje me përputhshmërinë e tyre me përcaktimet e dispozitave të Kodit të Punës në R.SH; nuk janë analizuar regjistrat që duhet të mbajë tatimpaguesi; nuk ka një analizë të llogaritjes së pagës dhe elementëve përbërës të saj sipas përcaktimeve të dispozitave të nenit 119 të të Kreut XI të Kodit të Punës në R.SH; janë konstatuar parregullësi në llogaritjen e ditëve dhe orëve të punës dhe pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore.

- Në 3 raste nga auditimi i raporteve të kontrollit të ushtruar në tatimpaguesin “S” me NIPT KM, kanë rezultuar mangësi pasi nuk është bërë analiza e kartës teknologjike për të rakorduar sasinë e prodhuar për produktet Bitum natyral, Bitum i pastruar bllok, Bitum i fraksionuar, Bitum RAË (natyral), Qymyr nga karriera; karta teknologjike e paraqitur, nuk është e miratuar nga organet shtetërore përkatëse; nuk është analizuar çfarë përfaqësojnë “autofaturime punime zbulimit sipas 3 mujoreve”, nuk ka të dhëna si kanë dalë këto vlera, zërat e punimeve që janë kryer, çfarë dokumentacioni shoqërues dhe justifikues është kontrolluar nga Inspektori për të saktësuar vlerën e këtyre punimeve, mungon analiza për situacionet në lidhje me hyrjet dhe sasinë e

situacionuar në dalje, nuk ka të dhëna nëse kanë qenë objekt kontrolli nga institucione të tjera kompetente si AKBN etj, dhe a janë administruar këto raporte kontrolli nga Inspektori; nuk rezulton të jetë kryer një analizë në lidhje me licencat e kërkimit apo zbulimit të tatimpaguesit; mungon analiza e kostos së mallrave të raportuara nga tatimpaguesi.

- Nga auditimi mbi kontrollin e ushtruar në tatimpaguesin “M” me NIPT KE janë konstatuar mangësi pasi nuk rezulton të jetë kryer një kontroll i situacioneve në mënyrë analitike se çfarë kanë pasur të përfshirë, në elementët e materialeve të para, kostos së punës direkteve dhe shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit; nuk rezulton të jetë kryer një analizë në lidhje me licencat e kërkimit apo zbulimit të tatimpaguesit; nuk janë analizuar se çfarë përfaqësojnë autofaturat, si është arritur në këto vlera, zërat e punimeve të kryera, cilit dokumentacion justifikues dhe shoqërues i është referuar inspektori apo ka kontrolluar për të saktësuar vlerën e punimeve të këtyre punimeve, nuk ka të dhëna nëse subjekti ka qenë objekt kontrolli nga AKBN, dhe nëse inspektori i kontrollit i ka administruar këto raporte.

- Nga auditimi i DRT Vlorë u konstatua se Sektori i Kontrollit dhe Monitorimit nga Zyra, nuk ka përmbushur detyrimin për saktësimin e qarkullimit sipas kasës dhe të ardhurave të deklaruara në deklaratat e TTHF dhe TF për tatimpaguesit, nëpërmjet kontrollit tatimor apo vlerësimit nga zyra, në kundërshtim me ligjin nr.9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, “Për procedurat tatimore në RSH”, neni 71, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 70,317,876 lekë, nga të cilat 35,158,938 lekë detyrime tatimore dhe 35,158,938 lekë gjobë tatimore.

- Në 4 raste nga auditimi i dosjeve mbi kontrollin e ushtruar në tatimpaguesin “H” SHPK me NIPT LT, janë konstatuar mangësi në lidhje me kreditimin e TVSH-së për punimet e ndërtimit, shpenzimet e karburantit dhe blerjet e automjeteve, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 60,306,689 lekë nga të cilat 20% janë gjobë.

- Në 4 raste nga auditimi mbi kontrollin e ushtruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë janë konstatuar mangësi mbi shitjet e tatuashme me shkallë të reduktuar të TVSH-së me 6%, nga tatimpaguesit që ushtrojnë veprimtari në aktivitetin e hotelierisë, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit evidentuar paraprakisht në vlerën **23,267,129** lekë, sipas subjekteve “E” SHPK, me NIPT LJ detyrime për 13,499,980 lekë; “H” SHPK, me NIPT: KO detyrime për 8,899,342 lekë, “P” SHPK, me NIPT MF, detyrime për 867,807 lekë.

- Nga auditimi i raportit të kontrollit të ushtruar në “S” SHA, NIPT KM, nga analiza e Pasqyrave Financiare të periudhës ushtrimore 2021, ka rezultuar se ka vlerë të shtuar të aktivitetit “Ndërtesa” në shumën 92,407,223 lekë, për të cilën Inspektori tatimor nuk ka kryer verifikimet e subjektit sipas legjislacionit, ku diferenca e përmendur sjell efekte financiare në të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën totale 16,896,661 lekë, nga të cilat detyrimi për tatim fitimin në masën 15% ose në vlerën 13,861,084 lekë dhe penalteti për tatim fitimin në masën 21.9% ose në vlerën 3,035,577 lekë.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore

Me qëllim zgjidhjen e problematikave dhe përmirësimin e situatës janë dhënë rekomandime si vijon:

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masa për dërgimin të planit vjetor drejt Drejtorive Rajonale Tatimore dhe brenda afateve në mënyrë që të ndërmerren veprimet operacionale në kohë për mbedhjen e të ardhurave. Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë, të kryejë analiza mbi faktorët që ndikojnë në realizimin ose mosrealizimin të të ardhurave tatimore sipas zërave dhe t'i përcjell këto të dhëna në mënyrë të dokumentuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, me qëllim hartimin e programeve sa më

të drejtë dhe reale, si dhe të kryhen analiza periodike mbi progresin e realizimit të të ardhurave, me qëllim që të evidentohen përgjegjësitë e zbatimit të detyrave të strukturave përkatëse.

- Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të hartojnë një metodologji të qartë dhe të saktë nënligjore, ose një manual udhëzues për analizimin e llogarisë së ortakut, kur konstatohen se jepen hua ose shuma nga llogaria e ortakut në favor të llogarisë së shoqërisë, ku ata janë ortakë ose anasjelltas, apo nga individë të tjerë, për mënyrën e kryerjes së pagesës nëpërmjet sistemit bankar apo cash si dhe për raste kur këto hua jepen pa interes, nisur edhe nga përcaktimet ligjore që parashikon Kodi Civil.

- Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë pasi të ketë analizuar situatën e kontrollit të kryer në subjektet “E” SHPK, “K”, “K” SHPK, “T” SHPK, referuar gjetjeve nga auditimi i KLSH-së, të marrë masat e nevojshme që në bashkëpunim me Administratën Tatimore, të identifikojë burimin e detyrimeve që kanë shoqërit dhe transaksionet e kryera midis palëve, duke bërë informacioni RAD (Raportim i Aktivitetit të Dyshimtë) në lidhje me shumatat e parave të cilat kanë kaluar si hua ortakut ndaj shoqërisë.

- Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë për tatimpaguesin “S” me NIPT KM, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

-Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë për tatimpaguesin “M” me NIPT KE, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, Sektori i Kontrollit nga Zyra të kryejë verifikimet përkatëse dhe të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor, për vlerësimin e detyrimeve tatimore të munguara, duke kryer vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse, me qëllim arkëtimin e të ardhurave tatimore të evidentuara paraprakisht të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën gjithsej prej 70,317,876 lekë, nga të cilat 35,158,938 lekë detyrime tatimore dhe 35,158,938 lekë gjobë tatimore për kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore.

-Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë për tatimpaguesin “H” SHPK, NIPT LT, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit të munguar në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën prej **60,306,689 lekë**.

-Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, referuar mangësive dhe parregullsive të konstatuara, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të marrë masa të menjëhershme për vlerësimin e detyrimeve tatimore të munguara, duke kryer vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse, për arkëtimin e vlerës totale **23,267,129 lekë** të cilat përbëjnë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit, të përfituar padrejtësisht nga aplikimi i gabuar i shkallës së reduktuar të TVSH 6%, nga tatimpaguesit që ushtrojnë veprimtari në fushën e strukturave akomoduese, konkretisht: “E” SHPK, me NIPT LJ detyrime për **13,499,980 lekë**; “H” SHPK, me NIPT KO detyrime për **8,899,342 lekë**, “P” SHPK, me NIPT MF, detyrime për **867,807 lekë**.

-DRT Vlorë për tatimpaguesin “S” SHA, NIPT KM, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të bëjë

propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit të munguar në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën **16,896,661 lekë**.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion i auditimit të përrputhshmërisë.

Ne kemi audituar zbatueshmërinë e akteve ligjore nën ligjore dhe rregullative (burimi i kriterëve të paracaktuara të vlerësimit), për veprimtarinë e Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2023, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve në lidhje me mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe jo tatimore, zbatimin e procedurave gjatë veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor dhe Drejtorisë së Shërbimeve të Tatimpaguesve etj.

Auditimi, ka përfshirë ekzaminimin në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin kryerjen e procedurave tatimore, referuar dosjeve përkatëse, si dhe të dhënave, informacionit, evidencave dhe çdo dokumenti të ndodhur në sistemin C@ts, mbështetur në analizë risku, duke përzgjedhur kampionin përfaqësues mbi të cilin u kryen testet analitike.

Opinion i modifikuar/kualifikuar¹

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të cilësuar në paragrafin e “Baza për opinionin e modifikuar/kualifikuar” subjekti i audituar, DRT Vlorë ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit (Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligj nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligj nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, etj.), gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj.

Baza për opinionin e modifikuar/kualifikuar:

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për përrputhshmërinë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për dhënien e këtij opinionit.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, subjekti i audituar DRT Vlorë, në disa raste nuk ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit. Shkeljet e evidentuara në disa çështje të audituara, janë materiale por jo të përhapura, referuar popullatave, nën popullatave të kampionuara dhe kampioneve të testuara, sipas përshkrimit të më poshtëm:

Përshkrimi i çështjeve kryesore:

Si rezultat i veprimeve të kryera dhe mosveprimeve në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; ligjin nr. 92/2014, datë 24.7.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për

¹ Opinioni i modifikuar, i cilësuar/kualifikuar: Audituesi duhet të shprehë një opinion të cilësuar, kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalië apo rastet e mospërrputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura.

procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; UMF nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar etj., janë konstatuar efekte negative në grumbullimin e të ardhurave buxhetore gjatë auditimit të raporteve të kontrolleve të inspektorëve tatimorë, duke shkaktuar mungesën e evidentimit dhe të kërkimit për arkëtim të shumës së evidentuar paraprakisht në vlerën prej rreth **223,665,116 lekë**, konkretisht si pasojë e kreditimit të pa drejtë të TVSH-së për situacione të punimeve ndërtimore të cilat janë faturuar jashtë afatit të lejes së ndërtimit, mangësive në inventar, shitjeve pa faturë tatimore, kreditim i gabuar i TVSH-së së karburantit, zbatimit të gabuar të koeficientit të rregullimit të TVSH-së; si dhe përfitimin e uljes e TVSH-së 6% për subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën e strukturave akomoduese etj. Gjithashtu në raportet e kontrollit në vend kanë rezultuar pasaktësi në transaksionet me ortakun të kryera në kundërshtim me parimet dhe kushtet e tregut duke mos aplikuar norma interesi.

Problematika të tjera të konstatuara lidhen me masat e ndërmarra në procesin e monitorimit të të ardhurave tatimore, dobësi në procedurat e ndjekura për përzgjedhjen e subjekteve objekt kontrolli në vend, mos realizim i propozimeve për kontroll nga DTR Vlorë, etj.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1111/1 prot, datë 26.12.2023, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 26.12.2023 deri më datë 26.04.2024, në subjektin DTR Vlorë, është kryer auditim për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri më datë 31.12.2023, me objekt “Mbi përputhshmërinë”, nga grupi i auditimit:

1. R. G, Përgjegjës Grupi
2. B. P, Anëtar
3. E. B, Anëtar
4. G. T, Anëtar
5. B. H, Anëtar

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit.

Dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë nëpërmjet një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, gjatë veprimtarisë së tij. Në funksion të përmbushjes së misionit/angazhimit, objektivat kryesore të veprimtarisë audituese janë: Evidentimi i shmangieve të veprimtarisë së DRT Vlorë me kriteret e vlerësimit në bazë të kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi për periudhën objekt i auditimit; Evidentimi i të metave dhe mangësive në lidhje me rregullshmërinë e proceseve sipas legjislacionit dhe rregullave të funksionimit të miratuara nga DPT; Vlerësimi i veprimeve, zbulimi i mospërputhjeve me pasojë të ardhura të pa llogaritura, mungesë të ardhurash dhe ato të evazionit tatimor; Vlerësimi i përmbushjes së misionit të DRT Vlorë për realizimin e të ardhurave tatimore dhe jo tatimore; Ballafaqimi dhe diskutimi i rezultateve të auditimit me personat përgjegjës; Përcaktimi i rekomandimeve në bazë të gjetjeve nga auditimi, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen,

shlyerjen e dëmeve të mundshme ekonomike dhe parandalimin e mospërputhjeve në të ardhmen; etj. Qëllimi i auditimit është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuar të shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar, me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga ana e subjektit të audituar, ku KLSH synon të promovojë transparencën, përgjegjshmërinë, qeverisjen e mirë etj.

2. Identifikimi i çështjes.

Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2021 deri më 31.12.2023, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni. Përputhshmëria dhe rregullshmëria në procedurat e ndjekura nga ana e drejtorive përbërëse në DRT Vlorë të cilat monitorojnë ecurinë e realizimit të të ardhurave tatimore, ecurinë e vetëdeklarimit të tatimpagueseve, saktësinë e këtyre deklaratave, monitorimin e mos deklaruesve në të gjitha llojet e tatimeve, përputhshmëria ligjore në veprimtarinë e Drejtorisë së Kontrollit, Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave, Drejtorisë së Shërbimeve të Tatimpaguesve, si dhe çështje të tjera të cilat kanë rezultuar gjatë auditimit etj. Referuar analizës së riskut, në fazën e planifikimit dhe auditimit në terren, u identifikuan fushat me risk më të lartë. Gjithashtu, sigurojmë që vlerësimi fillestar i riskut në fazën e planifikimit si dhe ai i aplikuar gjatë fazës së auditimit në terren, vijon të mbetet i vlefshëm. Sa më sipër, fushat me risk më të lartë u përcaktuan si drejtimet e auditimit të miratuara me Programin e Auditimit dhe të trajtuara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Strukturat drejtuese të DRT Vlorë, janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, për përdorimin e burimeve financiare me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet, në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), për fushat e veprimtarisë në drejtim të mirë administrimit të fondeve buxhetore. Strukturat drejtuese të DRT Vlorë, janë përgjegjëse për realizimin e të ardhurave tatimore, në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullator në fushën e kontrollit dhe vlerësimit të subjekteve tatimpaguese, shërbimin ndaj tatimpaguesve, nxjerrjen e vendimeve etj. Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë sipas përcaktimeve në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe Rregullores së Brendshme, miratuar sipas Urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 19, datë 22.02.2017. Drejtori përfaqëson DRT Vlorë dhe vepron si pikë e parë e kontaktit midis DPT dhe institucionin. Është përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore për të maksimizuar mbledhjen e të ardhurave tatimore, si dhe zbatimin e detyrave të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi. Drejtori i Kontrollit mban përgjegjësi në menaxhimin e sektorëve të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, në zbatimin e planeve mujore dhe vjetore të kësaj drejtorie, dhe merr raporte lidhur me zbatimin e tyre nga përgjegjësit e sektorëve. Përgatit raport për realizimin e detyrave dhe harton plane kontrolli apo vizita fiskale për inspektorët në varësi. Strukturat drejtuese të DRT Vlorë kanë përgjegjësi që t’i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si

dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

4. Përgjegjësitë e audituesve.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, ne kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese. Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë. Audituesit në të gjithë llojet e auditimit, kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik", paragrafi 44-51. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar nëpërmjet auditimit të realizuar.

5. Kriteret e vlerësimit.

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- Ligji Nr. 8438, Datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;
- Ligji me Nr. 92.2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH" i ndryshuar ;
- Ligji Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar;
- Ligji Nr.9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë" dhe udhëzimeve në zbatim të tij;
- Ligji Nr.8977, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave kombëtare";
- Ligji Nr.25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe PF", i ndryshuar;
- VKM Nr.953, datë 29.12.2014 "Për dispozitat zbatuese të Ligjit Nr.92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH", i ndryshuar;
- Rregullore e brendshme me nr. 19, datë 22.02.2017 "Për miratimin e rregullores së brendshme për funksionimin e administratës tatimore";
- Rregullore nr. 2 "Mbi procedurat e përzgjedhjes për kontroll të tatimpaguesve";
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 26, datë 27.12.2007 "Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006";
- Udhëzimi Nr.24, datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në R.SH", i ndryshuar;
- Udhëzimi Nr.6 , datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH", i ndryshuar;
- Udhëzimi Nr.5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar;
- Manuali i Kontrollit nga Zyra dhe Kontrollit në vend;

- Të tjera akte ligjore, nënligjore dhe rregullative.

6. Standardet e auditimit.

Auditimi është kryer, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), përkatësisht në: Nivelin e parë “Parimet INTOSAI-t” ku përfshihet: ISSAI-P-1 “Deklarata e Limës”, ISSAI-P-10 “Deklarata e Meksikos”; Nivelin e dytë “Standardet e INTOSAI-t” ku përfshihen: ISSAI 100 - Parimet bazë në auditimin e sektorit publik, ISSAI 400-499 “Parimet bazë të auditimit të përputhshmërisë”, ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; ISSAI 4200; ISSAI-140 “Sigurimin e cilësisë”, ISSAI 130 “Kodin Etik”, ISSAI 2315 “Risku”, ISSAI 2320-2450 “Materialiteti”, ISSAI 2500 “Dokumentimi”; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.

7. Metodat e auditimit.

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera, me qëllim arritjen e objektivave të auditimit në bazë të vlerësimit të riskut. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

- a. Intervistimi - duke komunikuar dhe marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;
- b. Raporte dhe informacione - shfrytëzimi i raporteve, informacioneve relevante dhe që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimit e auditimit;
- c. Verifikimi në sistemet e DRT Vlorë- me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
- d. Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm relevant në entitetin DRT Vlorë, në mënyrë që të programoheshin procedurat e auditimit, që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit ka konsistuar në auditimin e të dhënave të siguruar nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm u administrua dhe nga procedurat e

ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar vlerësimin përmes skepticizmit profesional nga ana e audituesve.

8. Dokumentimi i auditimit.

Dokumentimi i auditimit është mbështetur në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë dhe në Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH, me ndryshime.

Gjithashtu, është mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”, i mjaftueshëm për të mundur dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundur dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionin dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, Akteve të Konstatimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky Raport Përfundimtar Auditimit.

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm

Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë është një njësi administrative në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe është përgjegjëse për mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, përmes procedurave të thjeshta me kosto minimale, në zbatim të Legjislacionit tatimor, për financimin e buxhetit të shtetit shqiptar.

Objektivat e punës së DRT Vlorë fokusohen në disa drejtime, të tilla si:

- Mbledhja e të ardhurave tatimore përmes procedurave të thjeshta dhe me kosto minimale, duke zbatuar njëtrajtësisht legjislacionin tatimor;
- Informimi, ndërgjegjësimi, edukimi i tatimpaguesve;
- Nxitja e vetëdeklarimit sipas parametrave fiskale, rritje të koeficientit të pagesës së TVSH-së;
- Rritja e cilësisë së kontrolleve;
- Ulje të borxhit tatimor, mbajtjen nën kontroll të borxhit të ri të krijuar;
- Vlerësimi i punës së inspektorëve;
- Vlerësimi i rezultateve të kontrolleve;
- Informimi dhe këshillimi i vazhdueshëm i tatimpaguesve në zbatim të procesit të fiskalizimit etj.

III.2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

III.2.1. Programimi i të ardhurave tatimore dhe jo tatimore, realizimi i tyre, ndarë sipas strukturës së të ardhuravë tatimore dhe analiza e tyre referuar kuadrit rregullator fiskal në fuqi.


Në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë janë përcjellë shkresa nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve mbi planet e rishikuar vjetore të të ardhurave të miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ku janë konstatuar mungesa në përcjelljen e planeve fillestare të të ardhurave dhe të ndryshimeve të aplikuara gjatë viti. Nga auditimi konstatohet se DRT Vlorë nuk disponon të gjitha shkresat me ndryshimet e planit të të ardhurave përgjatë periudhës së audituar pasi referuar të dhënave në shkresat përcjellëse nga DPT drejtuar DRT Vlorë rezulton se ka patur ndryshime të planit të të ardhurave me Akteve Normative. Për vitin 2023, konstatohet se plani i përcjellë nga DPT është hartuar duke e planifikuar realizimin e të ardhurave në nivel mujor dhe jo për të gjithë vitin, sikundër është vepruar në vitet paraardhëse 2021 dhe 2022. Si rrjedhojë, për vitin 2023 janë vendosur në dispozicion vetëm shkresat për miratimin e planit në nivel muaji ku konstatohet se mungon shkresa përcjellëse e planit të të ardhurave për muajin janar 2023 si dhe nga ana e DRT Vlorë nuk disponoheshin informacione mbi këtë vendimarrje. Rezulton se plani i të ardhurave nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve përcillet për zbatim në DRT Vlorë dhe nuk ka projekt plane, analiza mbi parashikimn e arkëtimeve, apo raporte të kryera nga Sektori i Analizës dhe Statistikës dhe Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit. Gjithashtu, nuk rezulton të jenë kryer analiza mbi mos realizimin apo realizimin krahasuar me planin për të ardhurat tatimore dhe jo tatimore për periudhën 2021-2023. DRT Vlorë ka kryer analiza statistikore vetëm mbi nivelin e realizimit të TVSH për periudhën tatimore dhjetor 2021/2020, dhjetor 2022/2021, dhjetor 2023/2022.

Referuar të dhënave të DRT Vlorë, të ardhurat tatimore të realizuara sipas zërave kryesor, rezultojnë me rritje për periudhën 2021-2023, pasqyruar në grafikun e mëposhtëm:

Grafik 1.1 – Realizimi i të ardhurave të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë për periudhën 2021-2023

000/Lekë

Realizimi i të Ardhurave DRT Vlorë 2021-2023



Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Sa më sipër, zërat kryesor të të ardhurat tatimore dhe të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore rezultojnë me rritje nga viti 2021-2023, me përjashtim të të ardhurave nga taksat nacionale që kanë rënie në 2023 krahasuar me vitet paraardhëse, si dhe rimbursimi i kryer në vitin 2022 ka patur rënie në krahasim me të njejtën periudhën të një viti më parë, megjithëse në vitin 2023 rezulton me rritje.

▪ **Shqyrtimi i të dhënave të planit dhe faktit të të ardhurave në DRT Vlorë për vitin 2021:**
-Planifikimi i të ardhurave tatimore

Nga auditimi konstatohet se përgjatë vitit 2021 ka pasur ndryshime në planin e të ardhurave vjetore. Referuar shkresës nr. 5249 prot., datë 18.03.2021, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë është dërguar ndryshimi i planit të të ardhurave vjetore sipas Aktit Normativ nr.4, datë 05.02.2021 dhe me shkresë nr. 8446 prot., datë 12.05.2021; është dërguar nga MFE ndryshimi i planit të të ardhurave vjetore sipas Aktit Normativ Nr. 18, datë 14.04.2021 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 137/2020 datë 16.12.2020 “Për buxhetin e vitit 2021” të ndryshuar, drejtuar Sektorit të Statistikës dhe Analizës në Drejtorinë Rajonale Vlorë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve bashkëlidhur ndryshimet sipas tatimit mujor dhe progresiv, si dhe grupit të punës ngritur me Urdhin nr. 847/1 prot., datë 05.02.2021, për detajimin e planit të të ardhurave të vitit 2021. Mungon shkresa e dërgimit të planit fillestar të të ardhurave për vitin 2021.

Me shkresë nr. 2189 prot., datë 22.02.2022, nga Sektori i Kontabilitetit dhe Analizës, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë, është dërguar informacion në kuadër të mbylljes së aktivitetit financiar për vitin ushtrimor 2021, si dhe janë dërguar pasqyrat e rakorduara me degën e Thesarit të Tatim Fitimit të Thjeshtuar (Llogaria 4481100) dhe me shkresë nr. 1389 prot., datë 21.02.2022 janë dërguar evidencat e të ardhurave dytësore janar-dhjetor 2021 si dhe dhe akt-rakodrimet me Degën e Thesarit.

Sipas të dhënave mbi Aktet Normative të vendosura në dispozicion rezulton se janë miratuar ndryshime në planin vjetor të të ardhurave si më poshtë:

Tabela 1.1 Plani i të ardhurave fillestare dhe me ndryshimet progresive gjatë vitit 2021

000/lekë

Rd.	EMERTIMI	Akt Normativ Nr. 4, datë 05.02.2021 2021	Akt Normativ Nr. 18, Datë 12.03.2021 2021
	D.P.TATIMEVE TOTAL (Bruto)	5,401,000	5,433,000
	(Tatimet + Rimbursime + Kontributet)		
A	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (bruto)	2,211,000	2,218,000
1	Tatimi Vleres se Shtuar (bruto)	881,000	881,000
	- Tatimi Vlerës së Shtuar (neto)	521,000	521,000
	- Rimbursimi TVSH-se	360,000	360,000
2	Tatim mbi Fitimin	530,000	533,500
3	Ardhura Personale	725,000	728,500
4	Taksat Nacionale	75,000	75,000
5	Taksa Qarkullimit Rrugor	0	0
6	Kazinot dhe Lodrat	0	0
B	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)	1,851,000	1,858,000
C	Kontributet e Sigurimeve gjithsej	3,190,000	3,215,000
	D.P.TATIMEVE TOTAL (Neto)	5,041,000	5,073,000

Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë (Sektori i Analizës dhe Statistikës), të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

-Realizimi i të ardhurave tatimore

Referuar të dhënave të planit dhe faktit të të ardhurave sipas raportimit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë për vitin 2021, të ardhurat tatimore bruto janë programuar 5,433,000 mijë lekë dhe janë realizuar 5,607,485 mijë lekë, me një tejkalim në vlerën 174,485 lekë ose 3.21% më shumë se plani i rishikuar. Megjithëse të ardhurat tatimore total (bruto) për vitin 2021, rezultojnë me nivel realizimi 103% në krahasim me planin e të ardhurave, të ardhurat tatimore gjithsej (arkëtim), tatimbi i vlerës së shtuar (bruto), rivlerësimi i kryer, tatimi mbi fitimin dhe taksa e qarkullimit rrugor dhe karburantit rezultojnë me mos realizim, ku nga auditimi konstatohet se nuk është kryer asnjë analizë nga DRT Vlorë mbi arsyet që kanë ndikuar në mosrealizim të

zërave të të ardhurave tatimore. Në krahasim me vitin paraardhës 2020, ka rritje të të ardhurave tatimore me 569,438 mijë lekë ose 11.30% lekë më shumë. Të ardhurat tatimore total (bruto) për vitin 2021, rezultojnë me nivel realizimi 103% në krahasim me planin e të ardhurave ose tejkalim me 174,485 mijë lekë. Sipas të dhënave statistikore të realizimit të ardhurave për vitin 2021 nga DRT Vlorë, rezulton sipas tabelës në vijim.

Tabela nr. 1.2 Realizimi i të ardhurave tatimore të DRT Vlorë për vitin 2021

000/Lekë

Emërtimi	Periudha: Janar – Dhjetor 2021						
	Faktet		Plani	Diferenca Fakt-Plan		Diferenca 2020 - 2021	
	2020	2021	2021	+ ose -	Përqindje	+ ose -	Përqindje
DRT Vlorë TOTAL (Bruto)	5,038,047	5,607,485	5,433,000	174,485	3.21%	569,438	11.30%
(Tatimet + Rimbursime + Kontribute)	0	0	0	0	0	0	0
A Të Ardhurat Tatimore gjithsej (arkëtim)	1,956,541	2,102,377	2,218,000	-115,623	-5.21%	145,836	7.45%
<i>Nga të cilat:</i>							
1 Tatimi Vlerës së Shtuar (Bruto)	763,947	771,455	881,000	-109,545	-12.43%	7,508	0.98%
- Tatimi Vlerës së Shtuar (neto)	430,045	331,270	521,000	-189,730	-36.42%	(98,775)	-22.97%
- Rimbursimi i kryer (gjithsej)	333,902	440,185	360,000	80,185	22.27%	106,283	31.83%
2 Tatim mbi Fitimin	484,638	508,140	533,500	-25,360	-4.75%	23,502	4.85%
3 Ardhura Personale	650,102	768,020	728,500	39,520	5.42%	117,918	18.14%
4 Taksat Nacionale	44,605	48,464	75,000	-26,536	-35.38%	3,859	8.65%
5 Taksa Qarkullimit Rrugor dhe Karburantit							
6 Lojrat e Fatit							
7 Dënimet Administrative	13,249	6,298	0	6,298		(6,951)	-52.46%
8 Të Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)	1,622,639	1,662,192	1,858,000	-195,808	-10.54%	39,553	2.44%
9 Kontributet e Sigurimeve gjithsej	3,081,506	3,505,108	3,215,000	290,108	9.02%	423,602	13.75%
- Tarifa jo Tatimore							
10 DRT Vlorë TOTAL (Neto)	4,704,145	5,167,300	5,073,000	94,300	1.86%	463,155	9.85%
(Tatimet neto + Kontributet)	0	0	0	0	0	0	0

Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH


A. Të Ardhurat Tatimore

Të ardhurat tatimore, sipas raportimit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, për vitin 2021 janë planifikuar në vlerën 2,218,000 mijë lekë dhe janë realizuar 2,102,377 mijë lekë, me një mosrealizim prej 115,623 mijë lekë ose 5.21% më pak. Rezulton se të ardhurat tatimore për vitin 2021, janë në rritje me 145,836 mijë lekë ose 7.45% më shumë, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, në të cilën të ardhurat u realizuan në vlerën 1,956,541 mijë lekë. Në analizimin e kryer sipas llojit të tatimeve, me përjashtim të ardhurave personale, në përgjithësi vihet re mos realizim i zërave në krahasim me planin e programuar për vitin 2021, por në veçanti taksat nacionale përbëjnë përqindjen më të lartë të mosrealizimit.

Referuar realizimit të të ardhurave sipas planit për vitin 2021, në grafikun më poshtë është paraqitur sitautua për zërat më kryesorë të të ardhurave:

Grafik 1.2 Ecuria e planit sipas zërave të të ardhurat tatimore për vitin 2021

në 000/lekë



Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Grafik 1.3 Realizimi i të ardhurave sipas strukturës



Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Sa më sipër, mbi realizimin e të ardhurat tatimore sipas strukturës, rezulton se kontribuesit kryesor janë të ardhurat personale dhe tatimi mbi vlerën e shtuar (bruto) me 36.53% dhe 36.69% respektivisht të të ardhurave kryesore, ndërkohë tatimi mbi fitimin përbën 24% të të ardhurave tatimore, taksat nacionale zë 2.31% dhe dënimet administrative 0.3%

Realizimi i të ardhurave tatimore të analizuar sipas zërave për vitin 2021 paraqitet si më poshtë vijon:

A.1. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

Të ardhurat nga Tatimi Vlerës së Shtuar (Bruto), për vitin 2021 sipas planit 12 mujor, ishin programuar në vlerën 881,000 mijë lekë dhe janë realizuar në 771,455 mijë lekë, me një mosrealizim në vlerën 109,545 ose 12.43% më pak. Krahasuar me realizimin e të ardhurave nga Tatimi Vlerës së Shtuar (Bruto), me të njejtën periudhë të një viti më parë, ka një rritje në vlerën 7,508 mijë lekë, ose 0.98% më shumë. Të ardhurat nga TVSH (Bruto) për vitin 2021, në vlerësim krahasues me planin duke konsideruar TVSH (Neto) dhe rimbursimin për TVSH, vihet re se të ardhurat nga TVSH (neto) ka një mosrealizim në vlerën 189,730 mijë lekë ose 36.42% më pak ndërsa rimbursimi është realizuar në vlerën 80,185 mijë lekë më shumë se plani. Në tabelën e paraqitur më poshtë po pasqyrojmë Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në raport me të njejtën

periudhë të një vitit 2020, në krahasim me plan-fakt.

000/Lekë

Lloji i të ardhurave	Fakti 2020	Fakti 2021	Plani 2021	Diferenca Plan –Fakt	% Diferencës Plan-Fakt	Diferenca në Vlerë, '21 –'20	Diferenca në %, '21 –'20
TVSH (Bruto)	763,947	771,455	881,000	-109,545	-12.43%	7,508	0,98%
▪ Tvsh (Neto)	430,045	331,270	521,000	-189,730	-36,42%	-98 775	-22,97%
- Rimbursimi i kryer	333,902	440,185	360,000	80,185	22,27%	106,283	31,83%

Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Referuar planit 12 mujor për vitin 2021 rimbursimi për TVSH-në ishte projektuar në vlerën 360,000 mijë lekë dhe ka një realizim në vlerën 440,185 mijë lekë, me një rritje prej 22.27%. Në krahasim me vitin e kaluar, 2020, vihet re një rritje në vlerën e rimbursuar prej 106,283 mijë lekë ose 31.83% më shumë. Nga shqyrtimi i informacionit, konstatohet se në terma neto, të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar paraqiten me mosrealizim në vlerën 189,730 mijë lekë, ndërkohë efekti i rimbursimit të kryer ka tejkaluar planin e miratuar.

A.2. Të ardhura tatimore nga Tatimi mbi Fitimin

Sipas të dhënave të raportuara nga DRT Vlorë të ardhurat tatimore nga Tatimi mbi Fitimin janë planifikuar 533,500 lekë dhe janë arkëtuar 508,140 mijë lekë me një mos realizim në vlerën 25,360 mijë lekë ose 4.75% më pak. Në krahasim me vitin 2020, në të cilin u arkëtuan 484,638 lekë, ka një rritje prej 4.85%, por një mosrealizim të të ardhurave nga ky lloj tatimi në vlerën 25,360 mijë lekë ose 4,75% më pak krahasuar me planin e vitit 2021.

000/Lekë

Lloji i të ardhurave	Fakti 2020	Fakti 2021	Plani 2021	Diferenca Plan –Fakt	% Diferencës Plan-Fakt	Diferenca në Vlerë, '21 –'20	Diferenca në %, '21 –'20
Tatimi mbi fitimin	484 638	508 140	533 500	-25 360	4,75%	23 502	4,85%

Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

A.3. Tatimi mbi Të Ardhura Personale

Të ardhurat personale për vitin 2021 janë planifikuar në vlerën 728,500 mijë lekë, sipas raportimit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, me një realizim prej 768,020 mijë lekë, me një realizim prej 39,520 mijë ose 5.42% më shumë. Në krahasim me të njejtën periudhë të vitit 2020, në të cilin janë janë arkëtuar 650,102 mijë lekë rezulton se në vitin aktual, 2021 të ardhurat nga ky lloj tatimi janë realizuar 117,918 mijë lekë më shumë ose 18.14% më shumë.

000/Lekë

Lloji i të ardhurave	Fakti 2020	Fakti 2021	Plani 2021	Diferenca Plan –Fakt	% Diferencës Plan-Fakt	Diferenca në Vlerë, '21 –'20	Diferenca në %, '21 –'20
Të ardhura Personale	650,102	768,020	728,500	39,520	5,42%	117,918	18,14%

Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

A.4. Taksa Nacionale

Të ardhurat nga Taksat Nacionale për vitin 2021 sipas planit të rishikuar janë projektuar në vlerën 75,000 mijë lekë dhe janë arkëtuar 48,464 mijë lekë, me një mosrealizim në vlerën 26,536 mijë lekë, ose 35.38% më pak. Krahasuar me të njejtën periudhë të vitit 2020, vjelja e taksave është në rritje në vlerën prej 3,859 mijë lekë ose 8.65% më shumë se viti paraardhës.

000/Lekë

Lloji i të ardhurave	Fakti 2020	Fakti 2021	Plani 2021	Diferenca Plan –Fakt	% Diferencës Plan-Fakt	Diferenca në Vlerë, '21 –'20	Diferenca në %, '21 –'20
Taksat Nacionale	44 605	48 464	75 000	-26 536	-35,38%	3 859	8,65%

Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

A.5. Taksa e Qarkullimit Rrugor

A.6. Të Ardhurat nga Lojrat e Fatit

A.7. Dënimet Administrative

Për vitin 2021, nuk janë programuar të ardhura nga dënimet administrative, ndërkohë janë arkëtuar 6,298 mijë lekë. Në krahasim me vitin 2020, në të cilin u arkëtuan 13,249 mijë lekë, rezultojnë me një mosrealizim në vlerën 6,951 mijë lekë ose 52.46% më pak.

000/Lekë

Lloji i të ardhurave	Fakti 2020	Fakti 2021	Plani 2021	Diferenca Plan –Fakt	% Diferencës Plan-Fakt	Diferenca në Vlerë, '21-'20	Diferenca në %, '21-'20
Dënimet Administrative	13,249	6,298	0	6,298		(6,951)	-52.46%

Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Të Ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore

Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore rezultojnë të jenë realizuar në vlerën 3,505,108 mijë lekë, 290,108 mijë lekë më shumë se plani i rishikuar. Tejkalimi i realizimit të kontributeve dhe sigurimeve krahasuar me planin e rishikuar në 9.02% më shumë rezultojnë të jetë faktori kryesor që ka ndikuar në realizimin me efekt pozitiv të të ardhurave tatimore totale bruto, në masën 5,607,485 mijë lekë, pra 174,485 mijë lekë më shumë se plani i rishikuar, pasi Tatimi i Vlerës së Shtuar, rezultojnë se nuk është realizuar duke patur një efekt negativ në të ardhurat tatimore totale bruto, me një mosrealizim në vlerën 109,545 mijë lekë më pak ose 12.43% më pak se plani i rishikuar.

000/Lekë

Lloji i të ardhurave	Fakti 2020	Fakti 2021	Plani 2021	Diferenca Plan –Fakt	% Diferencës Plan-Fakt	Diferenca në Vlerë, '21-'20	Diferenca në %, '21-'20
Kontributet e Sigurimeve gjithsej	3,081,506	3,505,108	3,215,000	290,108	9.02%	423,602	13.75%

Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Sipas të dhënave të vendosura në dispozicion nga DRT Vlorë, rezultojnë se pjesa më e madhe e kontributeve buxhetore me 1.62 miliard lekë, i ndjekur nga sektori privat me rreth 1.49 miliard lekë dhe më pas nga ai shtetëror në afërsisht 144 milion lekë. Sigurimet shoqërore raportohen të jenë realizuar rreth 2.94 miliard lekë, sigurimet shëndetësore rreth 467 milion lekë dhe kontributet suplementare rreth 58.9 milion lekë.

Nga analizimi i të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, rezultojnë se janë 1,881 subjekte deklarues për vitin 2021 që kanë plotësuar deklaratën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, sipas Ligj Nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 106. Në tabelën më poshtë janë pasqyruar të ndarë sipas sektorëve të ekonomisë, sipas të cilës sektori i tregtisë dhe sektori i shërbimit përbërjnë numrin më të lartë të subjekteve deklaruese.

Tabela nr.1 Subjekte deklarues të TVSH për vitin 2021

Lekë

Sektori i Ekonomisë	Nr. Deklaruesish 2021	Deklarimi i TVSH 2021	TVSH e detyrueshme për t'u paguar 2021	Debitor TVSH 2021
Sektori i Ndërtimit	272	8,197,007,558	314,642,291	4,234,660
Sektori i Prodhimit	284	8,261,770,516	234,430,044	10,905,701
Sektori i Shërbimit	601	8,273,590,983	370,438,406	17,705,716
Sektori i Transportit	70	1,745,354,789	20,729,184	4,399,160
Sektori i Tregisë	654	21,940,031,104	602,152,709	23,881,572
Total	1,881	48,417,754,950	1,542,392,734	61,126,809

Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Në vijim, në analizimin e nivelit të kredisë së papërdorur, rezultojnë se sektori i prodhimit me 253,275,119 lekë ka gjendjen më të lartë të kredisë së papërdorur, në dispozicion për të shlyer detyrimet e lindura gjatë periudhës. Ndërkohë edhe nga analiza e detyrimit në total, i përbërë nga “Detyrimi +Gjoha+Interesa” sektori i ndërtimit ka balancën dhe detyrimin më të lartë në fund të periudhës me 2,445,310 lekë.

Tabela nr. 2, Gjendja e kredisë së papërdorur për vitin 2021

Lekë

Sektori i Ekonomisë	Gjendja 2021				
	Kredi e Papërdorur	Detyrimi	Gjoha	Interesa	Balanca
Sektori i Ndërtimit	72,425,446	2,445,310	0	0	2,445,310
Sektori i Prodhimit	253,275,119	548,928	0	0	548,928
Sektori i Shërbimit	159,348,491	1,279,843	0	0	1,279,843
Sektori i Transportit	55,657,705	73,033	0	0	73,033
Sektori i Tregisë	157,040,155	1,803,686	0	0	1,803,686
Total	697,746,916	6,150,800	0	0	6,150,800

Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga analiza e FDP përmbledhëse të TVSH, bazuar në deklaratimet të vitit 2021, rezulton se në krahasim me vitin paraardhës, ka ndryshime në rubrikat e kryesore si më poshtë vijon:

- Janë rritur (9) “Shitje e përjashtuar” me 11%
- Janë rritur (10) “Shitje pa TVSH” me 17.37%
- Janë rritur (13) “Shitjet të tatueshme me shkallë tatimore 20%” me 11.59%
- Janë ulur (15) “Shitje të tatueshme me shkallë tatimore 10%” me 0.90%
- Janë rritur (17) “Shitje të tatueshme me shkallë tatimore 6%” me 75.72%
- Janë rritur (27) “Blerje investime brenda vendit pa TVSH” me 101.04%
- Janë rritur (44) “Blerje të investimeve me TVSH” me 13.37%
- Janë rritur (56) “TVSH e detyrueshme për t’u paguar” me 9.55%

• Shqyrtimi i të dhënave të planit dhe faktit të të ardhurave në DRT Vlorë për vitin 2022:

Me anë të shkresës nr. 21811/4, datë 16.01.2023 është dërguar plani i të ardhurave për vitin 2022, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve drejtuar Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Statistikës, sektorit të statistikës dhe analizës në DRT Vlorë sipas Aktit-Normativ nr. 17 datë 1.12.2022. Në shkresën nr. 771 prot., datë 09.02.2022 nga sektori i kontabilitetit dhe analizës DRT Vlorë i është dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës pasqyrat e rakorduara me degën e Thesarit të Tatim Fitimit të Thjeshtuar, si dhe me shkresën nr. 1769 prot., datë 17.03.2023, nga DRT Vlore janë dërguar DPT-së, Akt-Rakordimet e mbajtura me degën e Thesarit për Tatim Fitimin e Thjeshtuar, në kuadër të mbylljes së aktivitetit financiar për vitin ushtrimor 2022.

- Planifikimi i të ardhurave tatimore

Rezultoni se nga auditimi konstatohet se përgjatë vitit 2022 ka pasur ndryshime në planin e të ardhurave vjetore. Akti Normativ nr. 17, datë 01.12.2022 për disa ndryshime në Ligjin nr. 115/2022 datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”. Me anë të Akteve Normative janë miratuar ndryshime për të ardhurat nga TVSH (Bruto) nga 830,000 në 838,000 , Tatim i Vlerës së Shtuar, nga 310,000 në 318,000 si dhe të ardhurat nga kontributet shoqërore nga 3,700,000 mijë lekë në 3,750,000 mijë lekë. Nga kryezimi i dhënave me raportin e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për vitin 2022, rezulton se për Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë, ka patur ndryshime në planin fillestar të të ardhurave miratuar të Ligj nr. 115/2021, me Akt Normativ nr. 3, datë 12.03.2022. Megjithatë, dokumentacioni i nevojshëm për të verifikuar këto ndryshime mungon në DRT Vlorë. Mangësitë në dokumentacion kufizojnë grupin e auditimi për të siguruar një pamje të plotë dhe të saktë të ndryshimeve që kanë ndodhur në planin fillestar të të ardhurave që mund të sjellë mospërputhje midis të dhënave reale dhe atyre të raportuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë.

Tabela nr. 3-Plani i të ardhurave fillestare dhe me ndryshimet gjatë vitit 2022

000/Lekë

Rd.	E M E R T I M I	Plani fillestar	Plani i ndryshuar
		2022	2022
	D.P.TATIMEVE TOTAL (Bruto)	6,122,000	6,180,000
	(Tatimet + Rimbursime + Kontributet)		
A	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (bruto)	2,422,000	2,430,000
1	Tatimi Vleres se Shtuar (bruto)	830,000	838,000
	- Tatimi Vlerës së Shtuar (neto)	310,000	318,000
	- Rimbursimi TVSH-se	520,000	520,000
2	Tatim mbi Fitimin	690,000	690,000
3	Ardhura Personale	840,000	840,000
4	Taksat Nacionale	62,000	62,000
5	Taksa Qarkullimit Rrugor	0	0
6	Kazinot dhe Lodrat	0	0
B	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)	1,902,000	1,910,000
C	Kontributet e Sigurimeve gjithsej	3,700,000	3,750,000
	D.P.TATIMEVE TOTAL (Neto)	5,602,000	5,660,000

Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë (Sektori i Analizës dhe Statistikës), të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

- Realizimi i të ardhurave tatimore

Nga analiza e të ardhurave tatimore bruto gjithsej sipas raportimit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, për vitin 2022, nga 6,180,000 mijë lekë të programuara në planin e këtij viti, ka pasur një realizim në vlerën 6,531,621 mijë lekë, pra 351,621 mijë lekë më shumë ose një rritje prej 5.69% se plani i rishikuar. Në krahasim me vitin paraardhës, 2021, vërehet se të ardhurat tatimore bruto kanë një rritje në vlerën 924,136 ose 16.48% më shumë se një vit më parë si rezultat i rritjes së të ardhurave kryesisht nga Tatimi Vlerës së Shtuar (bruto), 38.28% më shumë, nga të ardhurat nga Tatimi mbi Fitimin, 37.31% më shumë, të ardhura tatimore, 27.17% si dhe të ardhurat nga dënimet administrative, 47.67% më shumë se viti 2021. Të ardhurat tatimore total (bruto) rezultojnë me realizim në masën 105%, ndërkohë të ardhurat nga taksa nacionale dhe rimbursimi i kryer paraqiten me mosrealizim në vlerën 10,090 mijë lekë dhe 99,643 mijë lekë respektivisht për të cilat nuk është kryer një analizë mbi arsyet që mund të kenë ndikuar në mosrealizim.

Tabela 1.4 Realizimi i të ardhurave tatimore të DRT Vlorë për vitin 2022

000/Lekë

Emërtimi	Periudha: Janar – Dhjetor 2022							
	Faktet		Plani	Diferenca Fakt-Plan		Diferenca 2021 - 2022		
	2021	2022	2022	+ ose -	Përqindje	+ ose -	Përqindje	
DRT Vlorë TOTAL (Bruto)	5,607,485	6,531,621	6,180,000	351,621	5.69%	924,136	16.48%	
(Tatimet + Rimbursime + Kontribute)	0	0	0	0	0	0	0	
Të Ardhurat Tatimore gjithsej (arkëtim)	2,102,377	2,673,529	2,430,000	243,529	10.02%	571,152	27.17%	
<i>Nga të cilat:</i>								
Tatimi Vlerës së Shtuar	771,455	1,066,767	838,000	228,767	27.30%	295,312	38.28%	
- Tatimi Vlerës së Shtuar (neto)	331,270	646,410	318,000	328,410	103.27%	315,140	95.13%	
- Rimbursimi i kryer (gjithsej)	440,185	420,357	520,000	(99,643)	-19.16%	(19,828)	-4.50%	
Tatim mbi Fitimin	508,140	697,721	690,000	7,721	1.12%	189,581	37.31%	
Ardhura Personale	768,020	847,831	840,000	7,831	0.93%	79,811	10.39%	
Taksat Nacionale	48,464	51,910	62,000	(10,090)	-16.27%	3,446	7.11%	
Taksa Qarkullimit Rrugor dhe Karburantit								
Lojrat e Fatit								
Dënimet Administrative	6,298	9,300		9,300		3,002	47.67%	
Të Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)	1,662,192	2,253,172	1,910,000	343,172	17.97%	590,980	35.55%	

Kontributet e Sigurimeve gjithsej	3,505,108	3,858,092	3,750,000	108,092	2.88%	352,984	10.07%
- Tarifa jo Tatimore							
DRT Vlorë TOTAL (Neto)	5,167,300	6,111,264	5,660,000	451,264	7.97%	943,964	18.27%
(Tatimet neto + Kontributet)							


Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

A. Të Ardhurat Tatimore

Sipas raportimit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, për vitin 2022 planifikimi i të ardhurave tatimor është 6,180,000 mijë lekë me një realizim në vlerën 6,531,621 mijë lekë ose 5.69% më shumë se plani për vitin 2022. Në krahasim me vitin paraardhës, të ardhurat tatimore rezultojnë me rritje me 924,136 mijë lekë më shumë ose 16.48%. Me përjashtim të të ardhurave nga taksat nacionale dhe rimbursimit të kryer që rezultojnë me mosrealizim në krahasim me plan-fakt në përgjithësi vihet re realizim i zërave të të ardhurave bazuar në planin e programuar për vitin 2022 pasqyruar si më poshtë:


Grafik 1.4 Ecuria e planit sipas zërave të të ardhurave tatimore për vitin 2022

në 000/lekë



Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Grafik1.5 : Realizimi i të ardhurave sipas strukturës për vitin 2022



Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Për sa i përket, realizimit të të ardhurave tatimore sipas strukturës, tatimi mbi të ardhurat personale dhe tatimi mbi vlerën e shtuar (bruto) rezultojnë me 31.71% dhe 39.90% respektivisht dhe

vijojnë të mbeten kontribuesit kryesor të të ardhurave tatimore, ndërkohë tatimi mbi fitimin përbën 26.10% të të ardhurave tatimore, taksa nacionale zë 1.94% dhe dënimet administrative 0.35%

Realizimi i të ardhurave tatimore të analizuara sipas zërave për vitin 2022 detajuar si më poshtë vijon:

A.1. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

Të ardhurat nga Tatimi Vlerës së Shtuar (Bruto), për vitin 2022 sipas planit 12 mujor, janë programuar në vlerën 838,000 mijë lekë dhe janë realizuar në 1,066,767 mijë lekë, me një rritje në vlerën 228,767 mijë lekë ose 27.30% më shumë se plani i rishikuar. Krahasuar me realizimin e të ardhurave nga Tatimi Vlerës së Shtuar (Bruto), me të njejtën periudhë të një viti më parë, ka realizim në vlerën 295,312 mijë lekë, ose 38.28% më shumë. Të ardhurat nga TVSH (neto) për vitin 2022, në krahasim me planin e rishikuar, ka një realizim në vlerën 646,410 ose 103.27% më shumë ndërsa rimbursimi i TVSH me një mosrealizim në vlerën 99,643 mijë lekë ose 19.16% më pak se plani i rishikuar, ndërkohë në krahasim me vitin 2021 vihet re një mosrealizim në vitin 2022 në vlerën prej 19,828 mijë lekë ose 4.50% më pak. Në tabelën e paraqitur më poshtë po pasqyrojmë Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në raport me të njejtën periudhë të një viti më parë, në krahasim me plan-fakt.

000/Lekë

Lloji i të ardhurave	Fakti 2021	Fakti 2022	Plani 2022	Diferenca Plan -Fakt	% Diferencës Plan-Fakt	Diferenca në Vlerë, '22 -'21	Diferenca në %, '22 -'21
TVSH (Bruto)	771,455	1,066,767	838,000	228,767	27.30%	295,312	38.28%
▪ Tvsh (Neto)	331,270	646,410	318,000	328,410	103.27%	315,140	95.13%
▪ Rimbursimi i kryer	440,185	420,357	520,000	(99,643)	-19.16%	(19,828)	-4.50%

Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga shqyrtimi i të dhënave të vendosura në dispozicion nga DRT Vlorë, konstatohet se rimbursimi i kryer rezulton me një mosrealizim ndërkohë TVSH në terma neto, ka tejkaluar planin e miratuar në 103.27%. Realizimi i TVSH (neto) në fund të vitit 2021 është 331,270 mijë lekë ndërkohë në buxhetin e vitit 2022 ky zë miratohet në vlerën 318,000 mijë lekë ose 13,270 mijë lekë më pak se realizimi i një viti më parë.

A.2. Të ardhura tatimore nga Tatimi mbi Fitimin

Nga shqyrtimi i të dhënave të raportuara, është konstatuar se nga të ardhurat nga Tatimi mbi Fitimin, në krahasim me vitin e 2021 kanë një rritje prej 37.31 % dhe një realizim në vlerën 697,721 mijë lekë ose 1.12% më shumë krahasuar me planin e vitit 2022.

000/Lekë

Lloji i të ardhurave	Fakti 2021	Fakti 2022	Plani 2022	Diferenca Plan -Fakt	% Diferencës Plan-Fakt	Diferenca në Vlerë, '22 -'21	Diferenca në %, '22 -'21
Tatimi mbi fitimin	508,140	697,721	690,000	7,721	1.12%	189,581	37.31%

Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

A.3. Tatimi mbi Të Ardhura Personale

Për vitin 2022 bazuar në raportimin e DRT Vlorë, të ardhurat personale të programuara janë 840,000 mijë lekë, me një realizim 847,831 mijë lekë. Diferenca plan-fakt rezulton me një realizim në vlerën 7,831 mijë lekë ose 0.95% më shumë të ardhura personale janë arkëtuar në krahasim me planin e rishikuar. Në analizimin e realizimit të këtyre të ardhurave për vitin 2022, duke e krahasuar me të njejtën periudhë të një viti më parë, vihet re një rritje prej 10.39% ose 79,811 mijë lekë më shumë.

000/Lekë

Lloji i të ardhurave	Fakti 2021	Fakti 2022	Plani 2022	Diferenca Plan -Fakt	% Diferencës Plan-Fakt	Diferenca në Vlerë, '21 -'22	Diferenca në %, '21 -'22
Të ardhura Personale	768,020	847,831	840,000	7,831	0.93%	79,811	10.39%

Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Tatimi mbi të ardhurat personale për vitin 2021 janë planifikuar në vlerën 728,500 mijë lekë, sipas raportimit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, me një realizim prej 768,020 mijë lekë, me një realizim prej 39,520 mijë ose 5.42% më shumë. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2020, në të cilin janë arkëtuar 650,102 mijë lekë rezulton se në vitin aktual, 2021 të ardhurat nga ky lloj tatimi janë realizuar 117,918 mijë lekë më shumë ose 18.14% më shumë.

A.4. Taksa Nacionale

Të ardhurat nga taksat nacionale, rezultojnë me një mosrealizim në krahasim me planin sipas vitit 2022 në vlerën prej 10,090,000 mijë lekë ose 16.27% më pak se plani i rishikuar. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2021, vihet re një rritje në 7.11% të realizimit ose 3,446,000 mijë lekë se viti paraardhës.

000/Lekë

Lloji i të ardhurave	Fakti 2021	Fakti 2022	Plani 2022	Diferenca Plan -Fakt	% Diferencës Plan-Fakt	Diferenca në Vlerë, '22 -'21	Diferenca në %, '22 -'21
Taksat Nacionale	48,464	51,910	62,000	(10,090)	-16.27%	3,446	7.11%

Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

A.5. Taksa e Qarkullimit Rrugor

A.6. Lojrat e Fatit

A.7. Dënimet Administrative

Sipas planit të rishikuar për vitin 2022 nuk janë programuar të ardhura nga dënimet administrative. Referuar të dhënave të pasqyruar më poshtë rezulton se janë arkëtuar 9,300 mijë lekë. Në krahasim me vitin 2021, në të cilin u arkëtuan 6,298 mijë lekë, rezulton me një realizim në vlerën 3,002 mijë lekë ose 47.67% më shumë.

000/Lekë

Lloji i të ardhurave	Fakti 2021	Fakti 2022	Plani 2022	Diferenca Plan -Fakt	% Diferencës Plan-Fakt	Diferenca në Vlerë, '21 -'22	Diferenca në %, '21 -'22
Dënimet Administrative	6,298	9,300	0	9,300		3,002	47.67%

Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Të Ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore

Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore janë realizuar në vlerën prej 3,858,092 mijë lekë ose 2.88% më shumë se plani 12 mujor i vitit 2022. Rezulton se është tejkaluar plani i rishikuar me 108,092 mijë lekë më shumë. Në krahasim me vitin paraardhës rezulton se ka rritje të realizimit të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 352,984 mijë lekë më shumë ose një rritje në 10.07%.

000/Lekë

Lloji i të ardhurave	Fakti 2021	Fakti 2022	Plani 2022	Diferenca Plan -Fakt	% Diferencës Plan-Fakt	Diferenca në Vlerë, '21 -'22	Diferenca në %, '21 -'22
Kontributet e Sigurimeve gjithsej	3,505,108	3,858,092	3,750,000	108,092	2.88%	352,984	10.07%

Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Të dhënat e vendosura në dispozicion nga Sektori i Kontabilitetit dhe Ekonomisë në DRT Vlorë, rezulton se për vitin 2022 janë 2016 subjekte deklaruese që kanë plotësuar deklaratën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar sipas përcaktime ligjore për TVSH në Republikën e Shqipërisë. Numri i subjekteve deklaruese është rritur në krahasim me vitin 2021, me 135 subjekte më shumë. Sipas sektorëve të ekonomisë rezulton se sektori i shërbimit dhe sektori i tregtisë përbëjnë numrin më të lartë të subjekteve deklaruese.

Tabela nr.6- Subjekte deklarues të TVSH për vitin 2022

Lekë

Sektori i Ekonomisë	Nr. Deklaruesish	Deklarimi TVSH 2022	TVSH e detyrueshme për t'u	Debitor TVSH
---------------------	------------------	---------------------	----------------------------	--------------

	2022		paguar 2022	2022
Sektori i Ndërtimit	290	15,914,490,837	619,431,503	4,965,663
Sektori i Prodhimit	316	9,758,078,407	302,831,993	34,934,209
Sektori i Shërbimit	653	10,465,506,007	511,852,556	14,506,978
Sektori i Transportit	75	2,244,566,336	20,855,549	93,521
Sektori i Tregisë	682	26,113,733,448	759,969,622	5,103,376
Total	2,016	64,496,375,035	2,214,941,223	59,603,747

Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Në analizimin e nivelit të kredisë së papërdorur, sektori i prodhimit rezulton me gjendjen më të lartë të kredisë së papërdorur, në dispozicion për të shlyer detyrimet e lindura gjatë periudhës. Në total të detyrimit të përbërë nga “Detyrimi+Gjoha+Interesa” sektori i prodhimit ka balancën dhe detyrimin më të lartë në fund të periudhës me 2,742,532 lekë.

Tabela nr. 7- Gjendja e kredisë së papërdorur për vitin 2022

Lekë

Sektori i Ekonomisë	Gjendja 2022				
	Kredi e Papërdorur	Detyrimi	Gjoha	Interesa	Balanca
Sektori i Ndërtimit	127,637,847	2,742,532	0	0	2,742,532
Sektori i Prodhimit	336,446,389	556,020	0	0	556,020
Sektori i Shërbimit	256,064,899	1,378,991	0	0	1,378,991
Sektori i Transportit	61,793,191	73,150	0	0	73,150
Sektori i Tregisë	238,550,109	2,031,398	0	0	2,031,398
Total	1,020,492,435	6,782,091	0	0	6,782,091

Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Sipas analizës së FDP përmbledhëse të TVSH, bazuar në deklaratimet të vitit 2022, rezulton se në krahasim me vitin paraardhës, ka ndryshime në rubrikat e kryesore ku përgjithësisht rezultojnë me rritje, si më poshtë vijon:

- Janë rritur (9) “Shitje e përjashtuar” me 15%
- Janë rritur (10) “Shitje pa TVSH” me 12%
- Janë rritur (13) “Shitjet të tatueshme me shkallë tatimore 20%” me 38%
- Janë rritur (17) “Shitje të tatueshme me shkallë tatimore 6%” me 18%
- Janë ulur (27) “Blerje investime brenda vendit pa TVSH” me 30%
- Janë rritur (44) “Blerje të investimeve me TVSH” me 3%
- Janë rritur (56) “TVSH e detyrueshme për t’u paguar” me 44%

▪ Shqyrtimi i të dhënave të planit dhe faktit të të ardhurave në DRT Vlorë për vitin 2023:

Me anë të shkresës nr. 749/1 datë 01.02.2024, është dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, evidenca e rimbursimeve përmbledhëse dhe analitike të shoqëruar me rakordinin e marrë nga Dega e Thesarit, si dhe me anë të shkresës 749/2 prot., datë 02.02.2024 janë dërguar nga DRT Vlorë drejtuar DPT, Akt-Rakordimet me degën e Thesarit për Tatim Fitimin e Thjeshtuar, evidencën e të ardhurave dytësore për vitin 2023 dhe akt-rakordimet nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë SIFQ.

Për vitin 2023, referuar shkresës nr. 17884 prot., datë 09.11.2023 drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është dërguar plani i të ardhurave për muajin nëntor 2023 dhe nëpërmjet shkresës 20258 prot., datë 14.12.2023 nga DPT është dërguar plani i të ardhurave për muajin dhjetor 2023, si dhe deri në momentin e ushtrimit të auditimit në DRT Vlorë nuk ka ardhur shkresa përcjellëse për planin vjetor të të ardhurave për vitin 2023 nga DPT. Në këto dy shkresa është cituar “... mbi ndryshimin e planit të të ardhurave vjetore sipas Aktit Normativ nr.5 datë 18.10.2023” ku rezulton se ka patur ndryshim të planit të të ardhurave vjetore me Akt Normativ nr. 5, datë 18.10.2023, por nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se përgjatë vitit 2023, DRT Vlorë nuk disponon Akt Normativ

nr. 5 si dhe nuk ka të dhëna nëse ka patur të tjera ndryshime në planin e të ardhurave vjetore. Mangësi në përcjelljen e shkresave mbi planet e të ardhurave dhe ndryshime të planit të të ardhurave kufizojnë grupin e auditimit për të siguruar një pamje të plotë dhe të saktë të ndryshimeve që kanë ndodhur në planin fillestar të të ardhurave që mund të sjellë mospërputhje midis të dhënave reale dhe atyre të raportuara nga DRT Vlorë. Mungesa e informacionit të plotë dhe të qartë mbi planet e të ardhurave dhe ndryshimeve e tyre krijon paqartësi në procesin e mbledhjes së të ardhurave pasi kjo mund të rezultojnë në mosrealizimin e objektivave të mbledhjes së të ardhurave për shkak të mungesës së udhëzimeve të qarta. Gjithashtu, sjell vështirësi në monitorimin dhe analizimin e performancës së DRT-ve, si rezultat të informacionit jo të plotë dhe të azhornuar, vështirësi në menaxhimin e të ardhurave kjo për pasojë ndikon në aftësinë e DRT-ve për të implementuar ndryshimet e nevojshme në strategjinë e tyre dhe për të marrë masa e nevojshme në rastet e devijimeve nga plani. Mungesa planeve të të ardhurave vjetore të përditësuara mund të ndikojë në mungesën e fokusit për zërat e të ardhurave që kanë nevojë për më shumë vëmendje. Mungesa e komunikimit të qartë dhe të rregullt midis DPT dhe DRT-ve mbi planet dhe ndryshimet e të ardhurave mund të ndikojë në përgjegjësinë dhe bashkëpunimin e strukturave pasi kjo mund të rezultojnë në një shkallë të ulët të koordinimit dhe bashkëpunimit midis tyre duke penguar arritjen e objektivave të përbashkëta.

- Planifikimi i të ardhurave tatimore

Nga DPT janë dërguar planet e të ardhurave sipas muajve me shkresat respektive; nr. 2078 prot., datë 10.02.2023 për muajin shkurt, nr. 3090/1 prot., datë 16.03.2023 për muajin mars; nr. 6660 prot., datë 14.04.2023 për muajin prill; nr.8822 prot., datë 19.05.2023 për muajin maj; nr. 10610 prot., datë 16.06.2023 për muajin qershor; nr. 12318 prot., datë 19.08.2023 për muajin korrik; nr. 13504 prot., datë 11.08.2023 për muajin gusht; nr. 14898 prot., datë 13.09.2023 për muajin shtator; nr. 16177 prot., datë 10.10.2023 për muajin tetor; nr. 17884 prot., datë 9.11.2023 për muajin nëntor; nr. 20258 prot., datë 14.12.2023 për muajin dhjetor. Referuar të dhënave të vendosura në dispozicion nga Sektori i Analizës dhe Statistikës, për vitin 2023 paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.5- *Plani i të ardhurave fillestare dhe me ndryshimet gjatë vitit 2023*

000/Lekë

Rd.	EMERTIMI	Plani 2023
	D.P.TATIMEVE TOTAL (Bruto)	8,157,027
	(Tatimet + Rimbursime + Kontributet)	
A	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (bruto)	3,572,228
1	Tatimi Vleres se Shtuar (bruto)	1,397,425
	- Tatimi Vlerës së Shtuar (neto)	
	- Rimbursimi TVSH-se	
2	Tatim mbi Fitimin	1,025,901
3	Ardhura Personale	1,083,835
4	Taksat Nacionale	65,067
5	Taksa Qarkullimit Rrugor	0
6	Kazinot dhe Lodrat	0
B	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)	2,174,803
C	Kontributet e Sigurimeve gjithsej	4,584,799
	D.P.TATIMEVE TOTAL (Neto)	6,759,602

Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë (Sektori i Analizës dhe Statistikës), të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

- **Realizimi i të ardhurave tatimore**

Referuar të dhënave të të ardhurave tatimore bruto gjithsej të raportuara nga DRT Vlorë dhe shqyrtimit të këtyre të dhënave, për vitin 2023 ka një realizim në vlerën prej 8,166,109 mijë lekë ose 0.11% më shumë se plani për vitin 2023. Në krahasim me vitin paraardhës, rezulton se të ardhurat tatimore totale bruto kanë një rritje në vlerën 1,634,488 mijë lekë ose 25.02% më shumë se një vit më parë si rezultat i rritjes së të ardhurave kryesisht nga Tatimi Vlerës së Shtuar (bruto), 36.40% më shumë, nga të ardhurat nga Tatimi mbi Fitimin, 49.94% më shumë, të ardhura tatimore gjithsej (neto), 41.79% si dhe të ardhurat nga dënimet administrative, 53.74% më shumë se viti 2021.

Nga auditimi konstatohet se megjithëse të ardhurat tatimore total (bruto) për vitin 2023, rezultojnë me nivel realizimi 100.1% në krahasim me planin e të ardhurave, tatimbi i vlerës së shtuar (neto) dhe të ardhurat nga taksat nacionale me mos realizim për të cilat nuk është kryer asnjë analizë nga DRT Vlorë mbi arsyet që kanë ndikuar në mosrealizim të zërave të të ardhurave tatimore.

Sipas të dhënave statistikore të realizimit të ardhurave për vitin 2023 nga DRT Vlorë, rezulton sipas tabelës në vijim.

Tabela nr.6- Realizimi i të ardhurave tatimore të DRT Vlorë për vitin 2023

000/Lekë


Emërtimi	Periudha: Janar – Dhjetor 2023						
	Faktet		Plani	Diferenca Fakt-Plan		Diferenca 2022 - 2023	
	2022	2023	2023	+ ose -	Përqindje	+ ose -	Përqindje
DRT Vlorë TOTAL (Bruto)	6,531,621	8,166,109	8,157,027	9,082	0.11%	1,634,488	25.02%
(Tatimet + Rimbursime + Kontribute)	0	0	0	0	0	0	0
Të Ardhurat Tatimore gjithsej (arkëtim)	2,673,529	3,663,888	3,572,228	91,660	2.57%	990,359	37.04%
<i>Nga të cilat:</i>							
Tatimi Vlerës së Shtuar (bruto)	1,066,767	1,455,081	1,397,425	57,656	4.13%	388,314	36.40%
- Tatimi Vlerës së Shtuar (neto)	646,410	985,899	1,397,425	-411,526	-29.45%	339,489	52.52%
- Rimbursimi i kryer (gjithsej)	420,357	469,182		469,182		48,825	11.62%
Tatim mbi Fitimin	697,721	1,046,130	1,025,901	20,229	1.97%	348,409	49.94%
Ardhura Personale	847,831	1,105,808	1,083,835	21,973	2.03%	257,977	30.43%
Taksat Nacionale	51,910	42,571	65,067	-22,496	-34.57%	(9,339)	-17.99%
Taksa Qarkullimit Rrugor dhe Karburantit							
Lojrat e Fatit							
Dënimet Administrative	9,300	14,298	0	14,298		4,998	53.74%
Të Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)	2,253,172	3,194,706	3,572,228	-377,522	-10.57%	941,534	41.79%
Kontributet e Sigurimeve gjithsej	3,858,092	4,502,221	4,584,799	-82,578	-1.80%	644,129	16.70%
- Tarifa jo Tatimore							
DRT Vlorë TOTAL (Neto)	6,111,264	7,696,927	8,157,027	460,100	-5.64%	1,585,663	25.95%
(Tatimet neto + Kontributet)		0	0	0	0	0	0

Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

A. Të Ardhurat Tatimore


Referuar të dhënave të të ardhurave tatimore gjithsej (arkëtim) të raportuara nga DRT Vlorë për vitin 2023 janë programuar 3,572,228 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën prej 3,663,888 mijë lekë, pra 91,660 mijë lekë ose 2.57.11% më shumë se plani për vitin 2023. Në krahasim me vitin paraardhës, rezulton se të ardhurat tatimore gjithsej (arkëtim) kanë një rritje në vlerën 990,359 mijë lekë ose 37.04% më shumë se viti paraardhës. Rezulton se në zërat kryesor të të ardhurave tatimore ka patur realizim krahasuar me planin e të ardhurave për vitin 2023, të pasqyruar në grafikun më poshtë:

Grafik 1.6 Ecuria e planit sipas zërave të të ardhurat tatimore për vitin 2023



Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Grafik 1.7 Realizimi i të ardhurave sipas strukturës për vitin 2023



Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Sa më sipër, mbi realizimin e të ardhurat tatimore sipas strukturës, edhe për vitin 2023 tatimi mbi vlerën e shtuar (bruto) vijon të jetë kontribuesi kryesorë me 39.71% të të ardhurave tatimore, tatimi mbi të ardhurat tatiore përbën 30.18% të të ardhurave tatimore dhe tatimi mbi fitimin zë 28.55%, taksa nacionale zë 1.16% dhe dënimet administrative 0.39%

Realizimi i të ardhurave tatimore të analizuar sipas zërave për vitin 2023 detajuar si më poshtë vijon:

A.1. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

Për vitin 2023, të ardhurat nga Tatimi Vlerës së Shtuar (Bruto), janë programuar në vlerën 1,397,425 mijë lekë dhe janë realizuar në 1,455,081 mijë lekë, me një tejkalim në vlerën 57,656 mijë lekë ose 4.13% më shumë se plani i këtij viti. Krahasuar me me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ka një rritje në vlerën 388,314 mijë lekë, ose 36.40% më shumë.

Të ardhurat nga TVSH (neto) për vitin 2023 në krahasim me planin e rishikuar, ka një mosrealizim në vlerën prej 411,526 mijë lekë ose 29.45% më pak, ndërsa rimbursimi i kryer është në vlerën 469,182 mijë lekë, ndërkohë në krahasim me vitin 2022, ka 11.62% më shumë.

000/Lekë

Lloji i të ardhurave	Fakti 2022	Fakti 2023	Plani 2023	Diferenca Plan –Fakt	% Diferencës Plan-Fakt	Diferenca në Vlerë, '23 –'22	Diferenca në %, '23 –'22
TVSH (Bruto)	1,066,767	1,455,081	1,397,425	57,656	4.13%	388,314	36.40%
▪ Tvsh (Neto)	646,410	985,899	1,397,425	(411,526)	-29.45%	339,489	52.52%
▪ Rimbursimi i kryer	420,357	469,182		469,182		48,825	11.62%

Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Për vitin 2023, të ardhurat nga Tatimi Vlerës së Shtuar (Bruto), janë programuar në vlerën 1,397,425 mijë lekë dhe janë realizuar në 1,455,081 mijë lekë, me një realizim në vlerën 57,656 mijë lekë ose 4.13% më shumë. Krahasuar me realizimin e një viti më parë, ka një rritje në vlerën 388,314 mijë lekë, ose 36.40% më shumë. Sipas të dhënave të vendosura në dispozicion nga Sektori i Statistikës dhe Analizës, rezulton se nuk janë planifikuar të ardhura nga rimbursimi i kryer si dhe nuk rezulton të jenë kryer analiza mbi mos planifikimin e të ardhurave nga ky zë.

Të ardhurat nga TVSH (neto) për vitin 2022 në krahasim me planin, ka një mosrealizim në vlerën prej 411,526 mijë lekë ose 29.45% më pak. Rimbursimi i kryer është realizuar në vlerën 469,182 mijë lekë, dhe në krahasim me vitin 2022, janë realizuar më shumë në vlerën prej 48,825 mijë lekë ose 11.62% më shumë.

A.2. Të ardhura tatimore nga Tatimi mbi Fitimin

Nga shqyrtimi i të dhënave të raportuara, është konstatuar se nga të ardhurat nga tatimi mbi fitimin, janë programuar në vlerën 1,025,901 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 1,046,130 mijë lekë ose me një realizim 1.97% krahasuar me planin e të ardhurave për vitin 2023. Në krahasim me të njejtën periudhë të një viti më parë, të ardhurat tatimore nga tatimi mbi fitimin kanë një rritje prej 49.94% dhe një realizim në vlerën 1,046,130 mijë lekë ose 1.97% më shumë.

000/Lekë

Lloji i të ardhurave	Fakti 2022	Fakti 2023	Plani 2023	Diferenca Plan –Fakt	% Diferencës Plan-Fakt	Diferenca në Vlerë, '23 –'22	Diferenca në %, '23 –'22
Tatimi mbi fitimin	697,721	1,046,130	1,025,901	20,229	1.97%	348,409	49.94%

Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

A.3. Tatimi mbi Të Ardhura Personale

Për vitin 2023, Tatimi mbi të Ardhurat Personale sipas planit të rishikuar në DRT Vlorë janë planifikuar në vlerën 1,083,835 mijë lekë dhe janë realizuar 1,105,808 mijë lekë, pra me një tejkalim në 21,973 mijë lekë ose 2.03% më shumë.

Në vitin 2022, vit në të cilin janë arkëtuar 847,831 mijë lekë, rezulton se viti aktual ka një realizim 257,977 mijë lekë më shumë ose një rritje prej 30.43%

000/Lekë

Lloji i të ardhurave	Fakti 2022	Fakti 2023	Plani 2023	Diferenca Plan –Fakt	% Diferencës Plan-Fakt	Diferenca në Vlerë, '22 –'23	Diferenca në %, '22 –'23
Të ardhura Personale	847,831	1,105,808	1,083,835	21,973	2.03%	257,977	30.43%

Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

A.4. Taksa Nacionale

Të ardhurat nga taksat nacionale, rezultojnë me një mosrealizim në krahasim me planin e vitit 2023 në vlerën prej 22,496 mijë lekë ose 34.57% më pak. Në krahasim me të njejtën periudhë të vitit 2022, vihet re një mosrealizim në vlerën prej 9,339 mijë lekë ose 17.99% më pak se viti paraardhës.

000/Lekë

Lloji i të ardhurave	Fakti 2022	Fakti 2023	Plani 2023	Diferenca Plan –Fakt	% Diferencës Plan-Fakt	Diferenca në Vlerë, '23 –'22	Diferenca në %, '23 –'22
Taksat Nacionale	51,910	42,571	65,067	(22,496)	-34.57%	(9,339)	-17.99%

Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

A.7. Dënimet Administrative

Referuar të dhënave të faktit për vitin 2023 rezulton se janë arkëtuar 14,298 mijë lekë. Në krahasim me vitin 2022, në të cilin u arkëtuar 9,300 mijë lekë, rezulton me një realizim në vlerën 4,998 mijë lekë ose 53.74% më shumë. Megjithëse, nga viti 2021 në vitin 2023 ka patur rritje në arkëtimin e të ardhurave nga dënimet administrative, për tre vite rradhazi planifikimi për të ardhurat nga ky zë janë 0 lekë, kjo tregon në mangësi në planifikim pasi nuk rezulton të jenë kryer analiza mbi planifikimin e të ardhurave.

000/Lekë

Lloji i të ardhurave	Fakti 2022	Fakti 2023	Plani 2023	Diferenca Plan –Fakt	% Diferencës Plan-Fakt	Diferenca në Vlerë, '21 –'23	Diferenca në %, '22 –'23
Dënimet Administrative	9,300	14,298	0	14,298		4,998	53.74%

Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Të Ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore

Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas planit të të ardhurave për Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë janë programuar në vlerën 4,584,799 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 4,502,221 lekë, ku rezulton se në vitin 2023 ka një mosrealizim në vlerën 82,578 mijë lekë ose -1.80% më pak se plani. Në krahasim me vitin 2022 në të cilin janë arkëtuar 3,858,092 mijë lekë, ka një realizim 16.70% më shumë.

000/Lekë

Lloji i të ardhurave	Fakti 2022	Fakti 2023	Plani 2023	Diferenca Plan –Fakt	% Diferencës Plan-Fakt	Diferenca në Vlerë, '22 – '23	Diferenca në %, '22 –'23
Kontributet e Sigurimeve gjithsej	3,858,092	4,502,221	4,584,799	(82,578)	-1.80%	644,129	16.70%

Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Të ardhurat tatimore gjithsej (neto) dhe të ardhurat tatimore total (neto) rezultojnë me një mosrealizim në vlerën prej 377,522 mijë lekë dhe 460,100 mijë lekë respektivisht më pak se plani i programuar për vitin 2023.

Në krahasim me vitin paraardhës, për këto dy zëra rezulton se ka në rritje në 41.79% ose në vlerën prej 941,534 mijë lekë nga të ardhurat tatimore gjithsej (neto) dhe 25.95% ose në vlerën 1,585,663 mijë lekë nga të ardhurat tatimore total (neto).

Në analizimin e dhënave sipas Sektorit të Kontabilitetit dhe Analizës në DRT Vlorë, në vitin 2023 janë 2,047 subjekte deklaruese që kanë plotësuar deklaratën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar sipas përcaktimeve të Ligj Nr. 92/2013 “Për tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 103. Në krahasim me vitin 2022, ka rritje në numrin e subjekteve që kanë plotësuar deklaratën e TVSH me 31 subjekte më shumë. Rezulton se sektori i shërbimit dhe sektori i tregtisë përbën numrin më të lartë të subjekteve deklaruese.

Tabela nr.8- Subjekte deklarues të TVSH për vitin 2023

Lekë

Sektori i Ekonomisë	Nr. Deklaruesish 2023	Deklarimi TVSH 2023	TVSH e detyrueshme për t'u paguar 2023	Debitor TVSH 2023
Sektori i Ndërtimit	313	21,205,542,673	844,240,743	47,076,817
Sektori i Prodhimit	307	11,216,693,660	386,462,404	41,126,366
Sektori i Shërbimit	659	11,667,949,707	594,612,322	48,957,558
Sektori i Transportit	77	2,536,107,433	31,239,410	54,743

Sektori i Tregisë	691	27,772,224,560	840,997,220	18,318,325
Total	2,047	74,398,518,033	2,697,552,139	155,533,809

Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Në vijim të analizimit të nivelit të kredisë së papërdorur, rezulton se sektori i prodhimit dhe sektori i shërbimit kanë gjendjen më të lartë të kredisë së papërdorur në dispozicion për të shlyer detyrimet e lindura gjatë periudhës.

Referuar analizimit të detyrimit në total që përfshin “Detyrimi+Gjoha+Inetresa sektori i tregtisë dhe sektori i ndërtimit kanë balancat më të larta në fund të periudhës me 5,979,112 lekë dhe 2,788,100 lekë respektivisht.

Tabela nr. 9- Gjendja e kredisë së papërdorur për vitin 2023

Lekë

Sektori i Ekonomisë	Gjendja 2023				
	Kredi e Papërdorur	Detyrimi	Gjoha	Interesa	Balanca
Sektori i Ndërtimit	284,746,092	2,788,100	0	0	2,788,100
Sektori i Prodhimit	589,979,776	1,046,782	0	0	1,046,782
Sektori i Shërbimit	582,592,790	2,367,395	0	0	2,367,395
Sektori i Transportit	107,634,404	123,052	0	0	123,052
Sektori i Tregisë	485,287,320	5,979,112	0	0	5,979,112
Total	2,050,240,382	12,304,441	0	0	12,304,441

Burimi: Të dhëna të DRT Vlorë të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga analiza e FDP përmbledhëse të TVSH, bazuar në deklaratimet të vitit 2023, rezulton se në krahasim me vitin paraardhës, ka ndryshime në rubrikat e kryesore ku kryesisht vihet re rritje si më poshtë vijon:

- Janë rritur (9) “Shitje e përjashtuar” me 28%
- Janë rritur (10) “Shitje pa TVSH” me 35%
- Janë rritur (13) “Shitjet të tatueshme me shkallë tatimore 20%” me 11%
- Janë ulur (15) “Shitje të tatueshme me shkallë tatimore 10%” me 0.48%
- Janë rritur (17) “Shitje të tatueshme me shkallë tatimore 6%” me 38%
- Janë ulur (27) “Blerje investime brenda vendit pa TVSH” me 20%
- Janë rritur (44) “Blerje të investimeve me TVSH” me 4%
- Janë rritur (56) “TVSH e detyrueshme për t’u paguar” me 22%

-Auditimi i të ardhurave dytësore tatimore, evidentimi dhe regjistrimi:

Nga auditimi rezulton se të ardhurat tatimore në bazë deklarate, nëpërmjet sistemeve informatike fiskale, arkëtohen një llogari të vetme në DPT, ku regjistron dhe përpilon pasqyrat financiare të të ardhurave tatimore për të gjitha DRT, nëpërmjet strukturës përkatëse të Drejtorisë së Analizës dhe të Kontabilitetit të të Ardhurave. Për të ardhurat që realizohen nga Sektori i Analizës dhe i Kontabilitetit të të Ardhurave në DRT Vlorë regjistron shumat e arkëtuara në kredi të llogarisë 4481100 “Agjent shërbimesh të vitit në vazhdim”, me kartela analitike për çdo Bashki dhe Njësi Administrative, për administrimin e tatim të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, dhe për këtë qëllim mbahen gjithashtu akt-rakordime për të ardhurat e realizuara dhe të derdhura për llogari të DPT për në buxhetin e shtetit me degën e thesarit në fund të çdo vitit.

Më konkretisht:

-Të ardhurat nga Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin (TTHF)

Sipas Udhëzimit nr.32, datë 31.12.2013 të MF “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”, neni 10 dhe neni 11, përcaktohet se për shërbimin e kryer administrata tatimore rajonale përfiton të ardhura në masën 1% të shumës së arkëtimit për llogari të qeverisjes vendore të të ardhurave tatimore nga TTHF për biznesin e vogël, të arkëtuara nga DRT Shuma (1% i TTHF) derdhet për llogari të DPT, në buxhetin e shtetit nga të ardhurat e grumbulluara si agjent tatimor

DRT nga pushteti vendor. Nga auditimi i dokumentacionit dhe evidencave me të dhëna për periudhën kohore 2021-2023, nga situata e llogarive sipas të dhënave nga Raporti i të Ardhurave, shuma e të ardhurave që i takon DRT (1% e totalit) masën 1% të TTHF mbi biznesin e vogël si agjent taksash është realizuar një e ardhur për vitin 2021 është 152,588 lekë, 2022 është 26,057 lekë, 2023 është 16,420.

- Të ardhurat nga shitja e shtypshkrimeve.

Mbi shitjet e shtypshkrimeve si fatura tatimore, fatura shoqërimi, dëftesë tatimore si dhe bileta transporti rrugor, etj, nga auditimi i evidencave dhe dokumentacionit janë realizuar të ardhura në shumën prej 8,064 mijë lekë për vitin 2021; 5,880 mijë lekë për vitin 2022 dhe 3,360 mijë lekë për vitin 2023.

Për sa më sipër, bazuar në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore, dalë me Urdhri Nr. 192, datë 12.08.2020 të Ministrisë të Financave, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. S. K, në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë për periudhën 2021-202, znj. L P në detyrën inspektorë i dytë, znj. O. S në detyrën inspektorë i dytë, znj. L. M në detyrën inspektorë i dytë.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 1111/28 prot., datë 13.06.2024 nga subjekti i audituar DRT Vlorë janë paraqitur observacionet me shkresë nr. 2991/25 prot., datë 10.07.2024, protokolluar në KLSH me nr. 1111/37, datë 15.07.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Referuar Projekt Raportit të Auditimit me Nr 1111/28 Prot datë 13.06.2024 të dërguar në DRT Vlorë me Nr 2991/17 prot datë 14.06.2024, tërhequr nga zyra e protokoll/arkivës në dt.01.07.2024 ku për sa cituar në raport dhe bazuar në Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore, Urdhri Nr.192 datë 12.08.2020 ju sqarohet si më poshtë :

-Për sa përmendur në Projekt Raportin e Auditimit mbi mosrealizimin e Rimbursimit (fq 211), ju bejmë me dije se Rimbursimet e TVSH-së nuk kryhen nga DRT Vlorë por nga Drejtoria e Rimbursimit në DPT dhe detyra funksionale e sektorit të Kontabilitetit dhe Analizës është vetëm raportimi i vlerës së rimbursuar në analizat e mbylljes së muajit.

-Sektori i Kontabilitetit dhe Analizës përpilon evidencat mbi të ardhurat tatimore sipas pagesave të kryera nga bankat nëpërmjet raporteve të shfaqura në C@TS.

Me mbylljen e të gjitha pagesave në fund të çdo muaji përpilohet Analiza sipas të gjithë zërave tatimore në vlera mujore/progresive në nivel sektorësh duke pasqyruar realizimin dhe mosrealizimin në shifra dhe vlera statistikore, e cila përcillet te drejtori rajonal dhe më pas në rrugë elektronike në DPT.

-Për sa i përket zërit tatimor të Tvsh-së, është kryer analiza e mirëfilltë e saj referuar formatit të miratuar nga DPT (format Poëer Point) me arsyet e realizimit dhe mosrealizimit sipas modelit të kërkuar duke e përcjell elektronikisht brenda afateve të përcaktuara.

-Referuar arsyeve të realizimit dhe mosrealizimit të zërave të tjerë tatimor nuk është kërkuar të bëhet analizë e mirëfilltë e faktorëve që kanë ndikuar në mosrealizimin e të ardhurave tatimore sikurse bëjmë për zërin e Tvsh-së.

Për sa më sipër bashkëlidhur ju përcjellim Analizat vjetore 2021-2022-2023 të cilat janë mbyllur prej nesh dhe janë përcjell elektronikisht në Drejtorinë e Kontabilitetit dhe Analizës në DPT.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: *Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar DRT Vlorë për Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr.1111/4, datë 13.06.2023 grupi i auditimit gjykon se: Në lidhje me observimin tuaj nuk janë sjellë argumente të të qenësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.*

III.2.2. Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor

Drejtorja e Kontrollit Tatimor menaxhon procesin e kontrollit dhe verifikimit të deklaratave tatimore dhe veprimtarisë së tatimpaguesve që mbulon Drejtorja Rajonale Tatimore. Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit është menaxheri i këtij procesi.

Në veprimtarinë e tyre, strukturat e Kontrollit Tatimor zbatojnë procedurat e përshkruara në Manualin e Kontrollit Tatimor, Rregulloret e tjera të nxjerrë për kontrollin e degëve dhe industrive të caktuara si dhe Udhëzimeve dhe Qarkoreve, të nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

II. Struktura e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor

Nga auditimi u konstatua se, DRT Vlorë për periudhën 01.01.2021-25.05.2023, ka funksionuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 33, datë 12.02.2020, “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore” dhe më pas, me Urdhrin e Kryeministrit nr. 69, datë 26.05.2023, “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të ATQ”, ku DRT Vlorë nuk ka pësuar ndryshime, me 47 punonjës në total.

Drejtorja e Kontrollit Tatimor është e ndarë në dy sektorë:

- Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit
- Sektori i Kontrollit në Vend

Tabela: “Struktura e Dejtorisë së Kontrollit për vitet 2021-2023”

	Viti 2021		Viti 2022		Viti 2023	
	Struktura	Fakti	Struktura	Fakti	Struktura	Fakti
Drejtor Kontrolli	1	1	1	1	1	1
Sektori i Kontrollit në Vend	8	7	8	7	8	7
Përgjegjës Sektori	1	1	1	1	1	1
Inspektor Total	7	7	7	7	7	6
Inspektor i pare	3	3	3	3	3	3
Inspektor i dyte	4	4	4	4	4	3
Sektori i Konntrollit nga Zyra dhe Monitorimit	10	10	10	10	10	9
Përgjegjës Sektori	1	1	1	1	1	1
Inspektor Total	9	9	9	9	9	8
Inspektor i pare	4	4	4	4	4	3
Inspektor i dyte	5	5	5	5	5	5

Burimi i të dhënave: DRT Vlorë; Punoi: KLSH

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT, gjatë vitit janë kryer 4 emërimë: drejtori i drejtorisë, përgjegjësi i sektorit, 1 inspektor i parë dhe 1 inspektor i dytë, si dhe është kryer 1 transferim, nga ky sektor në Sektorin e Kontrollit në Vend. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezultoi se këto emërimë janë kryer me procedurë përmes DAP-it, si dhe transferimi, pas shqyrtimeve të propozimeve të Komisionit të Ristrukturimit në DPT dhe DAP-it.

a) Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit

Sektori i Kontrollit Tatimor nga Zyra dhe Monitorimit ushtron veprimtarinë e tij bazuar në “Rregulloren e funksionimit të administratës rajonale tatimore” miratuar me Urdhër nr. 192, datë

12.08.2020, Manualin për Kontrollin Tatimor si dhe udhëzimet dhe qarkoret e nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm.

Objekt i punës të Kontrollit Tatimor nga Zyra dhe Monitorimit:

Analizon nëpërmjet raporteve të implementuar në sistem, nxjerr konkluzione përkatëse për situata të parregullta të deklaratave të ndryshme tatimore, tatimpaguesit me gjëndje të lartë e të vazhdueshme kreditore TVSH, tatimfitimi, mosdeklarues për lloje të ndryshme tatimi, deklaruesit pa veprimtari apo tatimpaguesit që kanë ndërprerë deklarinimin, analizon dhe nxjerr konkluzione nëpërmjet kryqëzimit të librave të shitjes dhe të blerjes për deklarinimin e faturave tatimore të shitjes apo blerjes, ndjek procedurat e përthithjes, ndarjes së tatimpaguesve, për transferimin e kredive të tatimeve të ndryshme nga një tatimpagues tek tjetri, kryen rimbursimin e tatimeve të ndryshme tatimore sipas këkesave të tatimpaguesve përveç TVSH-së, etj.

-Nga auditimi u konstatua se në vitin 2021, në Sektorin e Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit janë miratuar 10 punonjës :1 përgjegjës sektori dhe 9 inspektorë.

Përgjatë vitit 2022, në Sektorin e Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, nga totali i strukturës së miratuar prej 10 punonjësish rezulton se 1 punonjës është dorëhequr nga detyra dhe në vendin e tij ka kaluar 1 punonjës tjetër sipas Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve me emërtimin “Transferim të përhershëm”, pas shqyrtimeve të propozimeve të Komisionit të Ristrukturimit në DPT.

Ndërkohë, në vitin 2023, DPT ka kryer përsëri ristrukturim me Urdhrin nr. 69, datë 26.05.2023, dhe në Sektorin e Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, nga totali i strukturës së miratuar prej 10 punonjësish (1 përgjegjës sektori dhe 9 inspektorë), punonjësit kanë marrë urdhrat e transferimeve përkatëse për shkak të ristrukturimit, në të njëjtin vend. Gjatë vitit rezultoi 1 punonjës i dorëhequr nga puna me pezullim statusi nëpunësi. Në fund të vitit 2023, struktura e Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, ka pasur një vend inspektori vakant, fakt cili ka ndikuar dhe në performancën e këtij sektori apo mbingarkesën e inspektorëve të tjerë në këtë Sektor.

b)Sektori i Kontrollit në Vend

Sektori i Kontrollit Tatimor në Vend ushtron veprimtarinë e tij bazuar në “Rregulloren e funksionimit të administratës rajonale tatimore” miratuar me Urdhër nr. 192, datë 12.08.2020, Manualin për Kontrollin Tatimor si dhe udhëzimet dhe qarkoret e nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm.

Objekt i punës të Kontrollit Tatimor në Vend është:

-Menaxhon procesin e kontrollit dhe verifikimin e deklaratave tatimore dhe veprimtarisë së tatimpaguesve, kryen kontrole të tatimpaguesve sipas programeve të kontrollit të miratuara, zbaton me korrektësi dhe brenda afateve detyrat e ngarkuara nga eprorët dhe raporton për problematikat që kanë dalë gjatë procesit të kontrollit, përcakton prirjet lidhur me përmbushjen vullnetare apo fshehjen, qoftë në nivel vendor dhe kombëtar dhe referon rastet potenciale në lidhje me shmangiet tatimore dhe evazionin tatimor për Drejtorinë e Hetimit Tatimor duke përdorur formularët përkatës, kryerjen e kontrollit të zbatimit të rregulloreve të fiskalizimit , raporton dhe mban evidencë për punën e kryer për çdo kontroll, situatën e paraqitur nga tatimpaguesi, detyrimet e nxjerra dhe të paguara, ndjek çështjet e kontrollit dhe evidenton aktin e kontrollit në sistemin C@ts, etj.

Nga auditimi i strukturës së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, për periudhën 2021-2023, u konstatuan transferime të përhershme dhe të përkohshme, brenda drejtorisë por edhe jashtë saj.

Disa punonjës janë transferuar përkohësisht edhe jashtë profilit të tyre të punës. Këto lëvizje kanë sjell risk në mirëfunksionimin e punës dhe në performancën e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor.

Sektori i Kontrollit në Vend, në strukturën organizative është e përbërë nga 8 pozicione pune: një përgjegjës sektori dhe shtatë inspektor, ku nga auditimi rezulton se një pozicion pune (inspektor i dytë), është vakant.

Nga auditimi konstatohet se përgjatë vitit 2021, në Sektorin e Kontrollit në Vend nga totali i strukturës së miratuar prej 8 punonjësish, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT në bashkëpunim me DAP, 6 punonjës janë transferuar në mënyrë të përhershme për shkak të ristrukturimit në vitin 2020.

Ndërkohë përgjatë vitit 2022 në Sektorin e kontrollit në vend rezulton se nuk ka pasur largime emërimi apo transferime.

Me Urdhër nr. 69, datë 26.05.2023, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të ATQ”, DPT ka kryer përsëri ristrukturim. Në bashkëpunim me DAP-in, në cilësisë e Njësisë Përgjegjëse, në Sektorin e Kontrollit në Vend punonjësit kanë marrë transferimet përkatëse për shkak të ristrukturimit në të njëjtin vend. Rezulton se 1 punonjës është larguar nga puna dhe është komanduar një punonjëse tjetër në atë pozicion sipas Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, i cili në të njëjtën kohë është i emëruar dhe Specialisti i Zyrës së Burimeve Njerëzore, në DRT Vlorë.

Në fund të vitit 2023, struktura e Sektorit të Kontrollit në Vend, ka pasur një vend vakant, pozicioni Inspektor i dytë dhe për këtë pozicion është komanduar një punonjëse tjetër sipas Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, i cili në të njëjtën kohë është i emëruar dhe Inspektori i dytë i Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, në DRT Vlorë, fakt cili ka ndikuar dhe në performancën e këtij sektori apo mbingarkesën e inspektorëve të tjerë në këtë Sektor në realizimin e kontrollove në terren dhe mbartjen e kontrolleve në vitet pasardhëse.

Nga auditimi u kostatua se gjatë vitit 2023, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT, janë kryer edhe 3 “Ngarkime të përkohshme në detyrë” për nevoja dhe në interes të institucionit.

Sektori i Kontrollit në Vend ushtron veprimtarinë sipas planeve mujore të punës sipas përcaktimeve të Manualit për Kontrollin Tatimor në Vend.

Plani mujor i kontrollit për secilën Drejtori Rajonale Tatimore hartohet si bashkëpunim ndërmjet tyre dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe miratohet e dërgohet për zbatim nga kjo e fundit për secilën DRT.

Zgjedhja e tatimpaguesve, që do të kontrollohen:

- 30% e tatimpaguesve që do përfshihen në planin e kontrollit të çdo muaji, seleksionohen bazuar në propozimet e dërguara nga çdo DRT në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor në DPT.
- 70% e tatimpaguesve që do të përfshihen në planin e kontrolleve të çdo muaji seleksionohen në bazë të analizës së riskut nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut në DPT.

Kriter bazë për përgatitjen e 70% të planit të kontrolleve është vlerësimi i analizës së riskut të kryer në mënyrë automatike nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut në DPT. Drejtoria e Menaxhimit të Riskut pasi ka bërë seleksionimin e tatimpaguesve për kontroll dhe ka marrë propozimet e DRT-ve të tatimpaguesve të pjesës 30% nga Drejtoria e Kontrollit në DPT përgatit listat përmbledhese (30% +70%) dhe ia dërgon ato DRT përkatëse dhe një kopje Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DPT.

Nga dokumentacioni i kërkuar në DRT Vlorë mbi hartimin dhe raportimin e planeve mujore, grupit të auditimit janë vënë në dispozicion planet mujore dhe vjetore të punës për këtë sektor. Në këto plane përcaktohen objektivat, ndarjet e detyrave për inspektorët për të monitoruar subjektet në mënyrë të vazhdueshme.

Planifikimi kontrollive, realizimi i tyre dhe rezultatet në vlerë paraqiten sipas tabelës më poshtë:

Tabela: “Planifikimi dhe realizimi i kontrollove, rezultatet për periudhën 2021-2023”

VITET	PLANI-Formulari 4 DPT						Kontrolle te mbyllura Fakti			
	Zgj automa.sist. (1+ Rimb)		Propozim DRT (2)		Burime te tjera	Totali i Planit	Te perfunduara		Nr. kontroll te mbyllara	Rezultati (000leke)
	Te plota	V.Fiskale	Te plota	V.Fiskale	Te plota		Te plota	V.Fiskale		
Te prapamb 2020	21	3	6	1		31				
2021	34	32	10	2	1	79	46	38	84	94,722
2022	86	31	20	4	1	142	94	34	128	170,296
2023	92	37	17		9	155	129	32	161	284,896
Totali	233	103	53	7	11	407	269	104	373	549,914

Shënim: Burimi i të dhënave: DRT Vlorë; Punoi: KLSH

Kontrollet e mësipërme janë paraqitur sipas formularit nr.4 të DPT:

-Numri 1 përfaqëson kontrolle nga zgjedhje automatike nga sistemi dhe kontrolle për rimbursim nga DPT

-Nurmi 2 përfaqëson propozimet për kontrolle nga DRT

-Nurmi 3 Burime të tjera (Prokurori, hetim)

Sa më sipër rezulton se për periudhën 2021-2023, për Sektorin e Kontrollit në vend janë planifikuar të realizohen 407 kontrolle në subjekte tatimore, nga të cilat 297 kontrolle të plota dhe 110 vizita fiskale. Nga 407 kontrolle të planifikuara kanë përfunduar 373 kontrolle, ndërkohë që 34 kontrolle janë në proces nga viti 2023, që do të trashëgohen në vitin 2024. Ky vlerësim përfshin realizim në terma tatimpaguesish dhe jo në orë kontrolli në dispozicion për kryerjen e kontrolleve. Nga kontrollet e përfunduara rezultati në vlerë paraqitet 549,914,000 lekë vlerë e cila përfaqëson detyrime për TVSH, Tatim Fitimi, Sigurime Shoqërore e shëndetësore, TAP, TABV, Tatim burimi, kamat vonesa, gjoba etj.

- Në vitin 2021 janë trashëguar 31 kontrolle nga viti 2020, në vitin 2022 janë trashëguar 26 kontrolle nga viti 2021 dhe në vitin 2023 janë trashëguar 40 kontrolle nga viti 2022. Theksojmë se kontrollet e prapambetura janë kontrolle të cilat janë planifikuar për periudhën Nëntor-Dhjetor të vitit paraardhës dhe evadohen në vitin aktual për shkak të zbatimit të afateve procedurale të kontrollit.

- Në vitin 2021, nga 79 kontrolle të planifikuara, janë kontrolle janë propozuar nga DRT apo 15% e totalit, në vitin 2022 nga 142 kontrolle të planifikuara, 25 kontrolle janë propozuar nga DRT apo 17.6 % e totalit, në vitin 2023 nga 155 kontrolle të planifikuara, 17 kontrolle janë propozuar nga DRT apo 10.9 % e totalit.

- Në vitin 2021, nga 79 kontrolle të planifikuara dhe 31 kontrolle të prapambetura, janë përfunduar 84 kontrolle, nga të cilat 38 vizita fiskale, në vitin 2022, nga 142 kontrolle të planifikuara, janë përfunduar 128 kontrolle, nga të cilat 34 vizita fiskale, në vitin 2023, nga 155 kontrolle të planifikuara, janë përfunduar 161 kontrolle duke përfshirë dhe kontrollet e prapambetura, nga të cilat 32 vizita fiskale.

IV-Auditimi i dosjeve të kontrollit në subjektet tatimore

Në zbatim të kësaj pike u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Planet mujore të punës;
3. Dosjet e kontrollit të ushtruar në tatimpagues
4. Deklarimet në sistemin C@ts;
6. Dokumentacione dhe informacione shtesë të kërkuara dhe të vendosura në dispozicion sipas rastit nga ana e inspektorëve tatimorë etj;

Nga auditimi i dosjeve të kontrollit ka rezultuar si më poshtë:

Tatimpaguesi: “E” Sh.p.k.

Nipti: KO

Adresa kryesore: Lagja Pavarësia, Bulevardi Ismail Qemali, Pallati Nr. 458, Hyrja Nr. 11, Kati I, Vlorë.

Aktiviteti: *“Tregti me pakic e veshjeve. Aktivitet në fushën e ndërtimit. Tregti me pakice dhe shumicë e materialeve të ndërtimit, vegla pune, elektrike, hidraulike, elektroshtepiake, elektronike,(vazhdon edhe më tepër sipas përshkrimit të QKB-së).”*

Inspektori: B Z

Përgjegjës Sektori: I K

Drejtor Kontroll: B P

Drejtori Rajonal: S K

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH-periodha tatimore nga 02/2020-01/2022
- Për Tatim-Fitim periodha tatimore: 2019-2020
- Për Sigurimet Shoqërore e shëndetësore-periodha tatimore nga 02/2020-01/2022
- Të tjera periodha tatimore: deri në 2022/01
- Orë pune: 114 orë

Nga auditimi ka rezultuar se:

- Njoftimi i kontrollit është bërë në datë 31.03.2022, ndërkohë që kontrolli në subjekt ka filluar në datë 21.04.2022, pra nuk është respektuar afati 30 ditor në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 81, pika 1.1 dhe përcaktimet në programin e kontrollit nr. 2961/2 prot, datë 31.03.2022, ku është vendosur afati i fillimit të kontrollit në subjekt data 03.05.2022.
- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit, ndërkohë procesverbalet mbi kontrollin e kryer nuk janë hedhur brenda ditës së nesërme të punës nga momenti që janë mbajtur, jo në përputhje me përcaktimet e Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.
- Formulari 3- dokumenti që evidenton levizjen e dokumentacionit të kontrollit nga Inspektori deri tek Drejtori i Drejtorise Rajonale, nuk është hedhur në sistemin C@TS, nuk ka nënshkrim nga Inspektori i Kontrollit, jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2.
- Raporti nuk ka të bashkangjitur si pjesë përbërëse të tij “Formulari-pyetësor i vetë deklarimit para kontrollit”, gjë e cila nuk është në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6.

- Kontrolli është kryer në tejkalim të afatit të parashikuar në programin e kontrollit, me afat 114 orë pune, pasi kontrolli ka filluar me datë 21.04.2022 dhe ka përfunduar në datë 27.05.2022, 204orë/27 ditë pune, duke hequr ditët e festave, 188 orë pune, pra 74 orë pune më shumë, në kundërshtim me përcaktimet e Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.3 ku citohet: *“Kohëzgjatja e nevojshme e kontrollit përcaktohet nga të dhënat e analizës së riskut. Kohëzgjatja e kontrollit përcaktohet në baze të orëve të punës të parashikuara në Programin e Kontrollit. Kjo periudhë kohe merr parasysh kohën e kontrollit, pa përfshirë kohën për përgatitjen e raportit të kontrollit, i cili duhet të përgatitet brenda shtatë ditëve kalendarike nga data e përfundimit të tij tek tatimpaguesi”*.

- Raporti i Kontrollit është hartuar dhe hedhur në sistemin C@TS në datë 27.05.2022, dërguar në subjekt me shkresën nr. 2961/6 prot., datë 17.06.2022, ndërkohë Raporti Përfundimtar i Kontrollit mbajtur në 12.07.2022, hedhur në sistemin C@TS në datë 12.07.2022, përcjellë në subjekt me shkresën nr. 2961/8 prot., datë 12.07.2022. Sa sipër nuk janë respektuar afatet për hartimin e Raport Kontrollit, të përcaktuara në Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.5.

- Nuk është bërë analiza e detajuar e shitjeve si dhe analiza e kostos së mallrave për një grup artikujsh, në kundërshtim me përcaktimet e Programit të kontrollit nr. 2961/2 prot, datë 31.03.2022.

- Në Raport Kontrolli, janë përmendur dy adresa të ushtrimit të aktivitetit *1- Lagjja: “Pavarsia”, Bulevardi: “Ismail Qemali “Pallati Nr.458 Hyrja nr 11, kati I. Vlore; 2-Adrese sekondare , Rruga nacionale Tirane-Elbasan,* ndërkohë nga verifikimi i Ekstraktit Historik të gjeneruar nga QKB, rezulton se sipas çështjes CN-181703-04-19, datë 02.05.2019, është shtuar Adresa: *Tiranë; Rruga Abdyl Frasheri, Pallati 393, kati I.* Gjithashtu edhe nga verifikimi i librave të shitjes për çdo muaj përgjatë periudhës objekt kontrolli, rezultojnë shitje me kasë në 3 vende të ushtrimit të aktivitetit, pra kemi 3 vende të ushtrimit të aktivitetit, për pasojë nga Inspektori i kontrollit nuk janë respektuar përcaktimet e Programit të kontrollit dhe Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.5 dhe Kapitulli VIII, pika 8.

- Nuk është bërë inventari material për veshjet dhe materialet e ndërtimit në kundërshtim me përcaktimet e programit të kontrollit dhe Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.5, Kapitulli VIII, pika 8.

- Nga kontrolli i TVSH për tregtinë (veshjet), përkatësisht TVSH së zbritshme dhe shitjeve të tatueshme për periudhat tatimore 2021/01-2021/12 dhe 2022/01, të dhënat e trajtuara nga Inspektori i Kontrollit në Raportin Përfundimtar të Kontrollit janë kontradikore, pasi të dhënat për situatën financiare janë për periudhat 2021/01-2021/12 dhe 2022/01, ndërkohë që analiza e bërë në mënyrë narrative i referohet periudhave të mëparshme, një viti më parë. Gjithashtu nga kontrolli i tatim fitimit për vitin 2020, rezulton se të dhënat e paraqitura në Raport Kontrolli për pasqyrat e pozicionit financiar i përkasin vitit 2019 dhe jo vitit 2020.

-Nga analiza e pasqyrave financiare të deklaruara nga subjekti për vitin 2020, rezulton mospërputhje e zërit shpenzime në total të deklaruara në PF në vlerën 30,951,907 lekë dhe asaj çfarë është deklaruar në Fdp e tatim fitimit për vitin 2020, në vlerën 31,183,035 lekë, pra rezulton një diferencë 231,128 lekë, e cila sipas shpjegime të dhëna nga inspektori i kontrollit dhe dokumentacioni i vendosur në dispozicion, kjo diferencë ka të bëjë me shpenzimet fianciare, nga ta cilat 264,535 lekë janë shpenzime interesi dhe 33,407 lekë janë shpenzime nga kursi këmbimit.

- Nga verifikimi i pasqyrave financiare të vitit 2019 dhe 2020, rezulton se subjekti në pasiv të bilancit (Detyrime Afatshkurtra), zëri *“Huat dhe parapagimet/Të drejta dhe detyrime ndaj*

ortakëve” në vitin 2019 është pasqyruar në shumën 728,669 lekë, ndërkohë në mbyllje të vitit 2020 ky zë është pasqyruar në shumën 12,223,743 lekë, duke u rritur me *11,495,074 lekë*. Nga ana e inspektorit të kontrollit nuk është bërë analizë në raport kontrollit për ndryshimin në këtë zë, nuk është dhënë asnjë shpjegim në lidhje me krijimin e këtyre të ardhurave, nuk ka informacion nëse ka kontrata të lidhura midis palëve, afatet e huadhënies, mënyra e kryerjes së transaksioneve (me Banke apo Cash), etj. Nga ana e inspektori nuk është bërë informacioni RAD (Raportim i Aktivitetit të Dyshimtë) në lidhje me shumatat e parave të cilat kanë kaluar si hua ortakut ndaj shoqërisë, veprime këto jo në përputhje me dispozitat e ligjit Nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit” i ndryshuar, neni 18.1 si dhe UMF Nr.16, datë 16.2.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, neni 5, pika 1 dhe 2.

- Në lidhje me transaksionet kur ortaku i jep shoqërisë hua ose e anasjellta, pa aplikuar interesa, grupi i audituesve vlerëson se këto veprime janë pa thelb ekonomik dhe jo në përputhje me parimin e vlerës së tregut. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e germave “b”, “c”, “dh” të nenit 71, gerrat “a”, “b”, “c”, “ç” të nenit 71/2 dhe germa “ç” të neni 72 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 24, datë 02.09.2008, i ndryshuar. Nuk është kryer vlerësim alternativ i situatës financiare së shpenzimeve të interesit të pallogaritura në PASH, si rikarakterizim të ardhurash duke sjellë si pasojë detyrime tatimore. Referuar kuadrit legjislativ tatimor, rezulton se ortaku dhe shoqëria me përgjegjësi të kufizuara janë entitete të ndryshme dhe me personalitet juridik të ndarë, sipas përcaktimeve në Ligjin Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Sipas legjislacionit tatimor, si shoqëria dhe ortaku konsiderohen si “Palë të lidhura”, meqenëse ortaku ka ndikim në vendimmarrjen e shoqërisë për shkak të zotërimit të kuotave/aksioneve të saj sipas përcaktimeve në Ligjin Nr.42/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe Udhëzimin Nr.16, datë 18.6.2014 “Për transferimin e çmimit”, gjë që sjell se çdo marrëdhënie apo transaksion midis tyre duhet t’u përmbahet kushteve dhe parimeve të tregut (Arm’s Length). Megjithatë nuk ka të përcaktuar saktë dhe qartë mënyrën e procedimit në legjislacionin tatimor të fushës së llogaritjes së interesave dhe detyrimeve tatimore të rillogaritura në rastet e huadhënies nga llogaria e ortakut drejt llogarisë së shoqërisë ose e anasjelltas, referuar Kodit Civil i miratuar me Ligjin Nr.7850 datë 29.07.1994, i ndryshuar, nenet 1050-1055, Kreu XIX “Huaja”, cilësohet se huamarrësi duhet t’i paguajë huadhënësit një interes në rastet kur ekziston një marrëveshjeve ndërmjet palëve.

▪ Nga verifikimi i pasqyrave financiare të vitit 2019, zëri “*Shpenzime*”/Të tjera/Qera Ambjenti është deklaruar në vlerën totale 7,308,889 lekë, nga ta cilat 2,664,225 lekë qera për tregtinë dhe 4,666,664 lekë qera për ndërtimin, ndërkohë në bilancin e vitit 2020 ky zë është deklaruar në vlerën 7,479,996 leke, por pa përcaktuar se për çfarë është paguar qeraja për tregtinë apo ndërtimin. Nga ana e Inspektorit të Kontrollit nuk është bërë analiza e zërit qera ambjenti, nuk ka shpjegim çfarë përfaqëson qeraja për ndërtim, gjithashtu nuk është bërë analizë e detajuar në lidhje me pagesën e tatim burimit, shqyrtimin e kontratave të qerasë për vendet ku ushtrohet aktivitetit, si dhe nëse është respektuar niveli i referencës së qerasë minimale për qëllime fiskale sipas përcaktimeve ligjore përkatëse.

Nga grupi i auditimit në lidhje me zërin qera ambjenti janë verifikuar librat e blerjes për vitin 2019 dhe 2020, ku sipas faturave të blerjeve të deklaruara nga subjekti kundrejt shitësit “T” me NIPT KH, për vitin 2019 rezulton në total vlera 3,980,611 lekë ndërkohë në bilancin e vitit 2019 ky zë është deklaruar në vlerën 7,308,889 lekë, pra ka një diferencë 3,328,187 lekë, ndërkohë për

vitin 2020 rezulton në total vlera 3,459,839 lekë ndërkohë në bilancin e vitit 2020 ky zë është deklaruar në vlerën 7,479,996 lekë, pra ka një diferencë 4,020,158 lekë, diferenca për të cilat nuk është bërë analizë dhe shpjegime nga Inspektori i Kontrollit në Raport Kontrolli.

Sa sipër subjekti ka deklaruar shpenzime të paargumentuara 3,328,187 lekë për vitin 2019, dhe 4,020,158 lekë për vitin 2020, në total 7,348,345 lekë, për të cilat nga inspektori i kontrollit nuk u vu në dispozicion dokumentacion shtesë që argumenton këto shpenzime, për rrjedhojë shpenzimet e zbritshme janë mbivlerësuar në shumën 3,328,187 lekë për vitin 2019, dhe 4,020,158 lekë për vitin 2020, në total 7,348,345 lekë dhe fitimi i tatueshëm është ulur në po të njëjtën shumë. Në zbatim të përcaktimeve të Ligjit 9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 68 “Vleresimi tatimor” pika 4 dhe 5/b, subjektit i linden detyrime si më poshtë:

Detyrim për TF (15%) - 1,102,251 lekë (7,348,345 *15%).

Penalitet 100% - 1,102,251 lekë

Totali detyrimi= 2,204,503 lekë

▪ Nga kontrolli në librat e blerjes për periudhën objekt kontrolli konstatohet se në vitin 2020 janë bërë blerje në vlerën totale 2,040,132 lekë me TVSH nga subjekti GTS SHPK me NIPT J6.....5B, i cili ka objekt veprimtarie “*Prodhimin, shitjen dhe tregtimin e gazrave teknike, terapeutike, farmaceutike, ushqimore dhe gazrave te tjere ne pergjithesi, si dhe prodhimin e produkteve dhe apraturave qe kane te bejne me to; Projektimin, realizimin, instalimin dhe mirembajtjen e impjanteve te lidhura me gazet e siperpermendur dhe pajisjet mjekesore;.....*”. Nga Inspektori i Kontrollit nuk janë analizuar blerjet nga ky subjekt, nëse i shërbejnë veprimtarisë së subjektit që po kontrollohet tregti veshjesh dhe ndërtim.

▪ Nga kontrolli në librat e shitjes për periudhën objekt kontrolli, në lidhje me shitjet e deklaruar nga subjekti për ndërtimin e 2 objekteve si më poshtë:

1- A. N- *Objekt individual banimi 2 Kat+ 1 kat nëntokë Tragjas, Vlorë, Leje ndërtimi nr. 575, datë 13.12.2017, afati 18 Muaj, shtyrje leje ndërtimi nr. 548, datë 11.09.2019, Leje për ndryshime në projekt gjatë zbatimit datë 15.01.2021 me afat deri 11.03.2022.*

2- L. P -*Objekt individual banimi 1 Kat+1 kat nëntokë Lagja Lirim, Vlorë, sipas lejes së ndërtimi nr. 111, datë 28.02.2020, afati 12 muaj.*

Shitjet për secilin objekt sipas deklarimeve të subjektit paraqiten sipas tabelës poshtë:

VITI	Altin Nervaj			Pyze		
	2020	2021	2022	2020	2021	2022
Janar	-	-	360,000	-	-	-
Shkurt	-	-	-	-	-	-
Mars	-	-	-	-	-	-
Prill	-	-	-	-	-	-
Maj	1,784,100	-	-	-	-	-
Qershor	1,825,800	-	-	-	-	-
Korrik	883,620	-	-	2,888,400	-	-
Gusht	-	1,469,940	-	-	-	-
Shtator	548,418	-	-	230,760	-	-
Tetor	-	-	-	-	-	-
Nentor	1,262,160	-	-	-	-	-
Dhjetor	4,662,480	1,297,615	-	-	-	-
	10,966,578	2,767,555	360,000	3,119,160	-	-

- Sipas Raport Ekspertimit Teknik me nr. 12, Prill 2022, të Ing. Zeliha Ferati, situacionet progresive për periudhën Janar 2020-Dhjetor 2021, për secilin objekt janë si më poshtë:

a-Objekt individual banimi 2 Kat+ 1 kat nëntokë Tragjas, Vlorë

- Investitor A N

- Situacionet progresive janë në vlerën 10,393,311 lekë pa strukturat dhe TVSH.

- Realizuar afërsisht 80% e punimeve.
- Shitjet e deklaruara sipas librave të shitjeve për periudhën Janar 2020-Dhjetor 2021 janë në vlerën 13,734,133 lekë me TVSH.

Diferenca ndërmjet shitjeve të deklaruara sipas librave të shitjes dhe situacioneve progresive është 3,340,822 lekë me TVSH, diferencë kjo që vjen nga mosllogaritja e shpenzimeve plotësuese dhe fitimit të shoqërisë si dhe TVSH.

b-Objekt individual banimi 1 Kat+1 kat nëntokë, Lagja Lirim Vlorë

- Investitor L P
- Situacionet progresive janë në vlerën 3,651,100 lekë (pa strukturat dhe TVSH)
- Realizuar 100% e punimeve
- Shitjet e deklaruara sipas librave të shitjeve për periudhën Janar 2020-Dhjetor 2021 janë në vlerën 3,119,160 lekë me TVSH.

Diferenca ndërmjet shitjeve të deklaruara sipas librave të shitjes dhe situacioneve progresive është 531,940 lekë, ndërkohë duke marrë në konsideratë shpenzimet plotësuese dhe fitimin e shoqërisë në masën maksimale 10% ose 365,110 lekë ($10\% * 3,651,100$), vlera totale e situacioneve duke përfshirë strukturat dhe TVSH është 4,746,320 lekë, si rrjedhim diferenca llogaritet në vlerën 1,627,160 lekë, vlerë kjo e cila përbën shitje pa deklaruar, në kundërshtim me përcaktimet e Nenit 124 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mos lëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i mos lëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore”.

Nga ana e Inspektorit nuk është bërë rivlerësimi i të ardhurave në bazë të përcaktimeve të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 68 “Vlerësimi tatimor” pika 4 dhe 5/b, duke llogaritur detyrimet si më poshtë:

Detyrimi TVSH $1,627,160 * 20\%$ = 325,432 lekë.

Gjobë TVSH (100 % detyrimit) = 325,432 lekë.

Detyrimi **650,864 lekë**

Detyrim TF $1,627,160 * 15\%$ = 244,074 lekë

Gjobë TF (100% e detyrimit) = 244,074 lekë

Detyrimi **488,148 lekë**

- Në dosje mungon dokumentacioni justifikues për të 2 lejet e ndërtimit, si leje ndërtimi, preventiv, situacion punimesh, projekt zbatimi, kontrata sipërmarrje me subjektin Investitor, si dhe vendimi për shtyrjen e lejes së ndërtimit.

- Nga analiza e shitjeve të deklaruara nga subjekti në sistemin C@ts për periudhën Shkurt 2020-Dhjetor 2020, për ndërtim, referuar 3 subjekteve blerës që zënë peshën më të madhe AN, L P dhe A P me Nipt-LS, është deklaruar vlera totale 18,527,378 lekë me TVSH, pa përfshirë shitjet për subjekte të tjera që mund të jenë bërë për ndërtim, ndërkohë në Raport Kontrolli, në analizën e situatës financiare të subjektit të kryer nga Inspektori i Kontrollit, shitjet e tatueshme me shkallë 20 %, për ndërtim janë në vlerën 16,297,250 lekë me TVSH, mospërputhje këto të cilat nuk janë analizuar nga inspektori i kontrollit. Për periudhën Janar 2021-Dhjetor 2021, shitjet të deklaruara nga subjekti vlera totale 11,524,306 lekë me TVSH, ndërkohë në Raport Kontrolli, shitjet e tatueshme me shkallë 20 %, për ndërtim janë në vlerën 12,695,183 lekë me TVSH, mospërputhje këto të cilat nuk janë analizuar nga inspektori i kontrollit.

▪ Nga analiza e librit të shitjeve rezulton se gjatë periudhës së kontrollit janë bërë shitje drejt tatimpaguesit A P me Nipt-LS, në vlerën totale 13,198,391 lekë (4,441,640 lekë për vitin 2020 dhe 8,756,751 lekë për vitin 2021). Tatimpaguesi A P, sipas ekstraktit të QKB-së ka objekt të veprimtarisë së tij “Ndertim i te gjitha llojeve si banesa qytetare, ndertime industriale dhe tregtare, komplekse turistike, autostrada, kanalizime, vepra te tjera te energjise se rinovueshme. Punime hekuri, ndertime armaturash, shtrim pllakash, berje mur tulle dhe beton arme, instalime elektrike e hidrailike.Import-eksport, tregti me shumice e pakice e artikujve te ndryshem ushqimore industriale, materiale ndertimi, pjese kembimi etj. Transport mallrash e pasagjeresh brenda e jashte vendit. Sherbime ne fushen e turizmit si: hoteleri, agjensi turistike, bar, restaurante, akomodim ne çadra plazhi, shezllona etj”.

Këto shitje janë klasifikuar si “Shitje të tatueshme me shkallë 20%”, për ndërtim, ndërkohë që edhe pse në vlera të konsiderueshme nga ana e Inspektorit të Kontrollit nuk është bërë analizë e detajuar mbi këto shitje, nëse janë shitje të materialeve të ndërtimit për tregti apo janë shitje në funksion të veprimtarisë së ndërtimit.

- Në përfundim për tatimpaguesin “E” Sh.p.k., ka rezultuar detyrim në vlerën totale 3,343,515 lekë (nga të cilat 1,346,325 lekë detyrim për TF, 325,432 lekë detyrim për TVSH detyrim tatim fitimi + 1,671,757 lekë gjobë).

Tatimpaguesi: “I” Sh.p.k.

Nipti: KM

Adresa kryesore: Vlorë, Himarë, Dhërmi, Lgj.Kondraq, Hotel D Kati 1

Aktiviteti:“Zhvillim i aktiviteteve te ndryshme ne fushen e ndertimit si dhe te pasurive te paluajtshme etj.,(vazhdon edhe më tepër sipas përshkrimit të QKB-së).”

Inspektori: A A

Përgjegjës Sektori: I K

Drejtor Kontroll: B P

Drejtori Rajonal: S K

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH-periodha tatimore nga 06/2021-05/2022

- Për Tatim-Fitimin periodha tatimore: 2021

- Për Sigurimet Shoqërore e shëndetësore-periodha tatimore nga 06/2021-05/2022

- Të tjera periodha tatimore: deri në 2022/05

- Orë pune: 24 orë

Nga auditimi ka rezultuar se:

- Formulari 3-nuk është hedhur në sistemin C@TS, nuk ka nënshkrim nga Drejtori i Kontrollit, jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2.

- Raporti nuk ka të bashkangjitur si pjesë përbërëse të tij “Formulari-pyetësor i vetë deklarimit para kontrollit”, jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6.

- Raporti i Kontrollit është hartuar në datë 23.09.2022, hedhur në sistemin C@TS në datë 09.10.2022, dërguar në subjekt me shkresën nr. 6303/5 prot., datë 23.10.2022, ndërkohë Raporti Përfundimtar i Kontrollit mbajtur në 05.12.2022, gati 2 muaj me vonë, hedhur në sistemin C@TS në datë 05.12.2022, përcjellë në subjekt me shkresën nr. 6303/8 prot., datë 06.12.2022. Sa sipër nuk janë respektuar afatet nga përgatitja dhe dërgimi i Projekt Raporti deri në përgatitjen

dhe dërgimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit në subjekt, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1 dhe 4, Neni 84, pika 1 dhe Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.5.

Dokumentacioni Teknik administruar në dosje:

- Leje ndërtimit miratuar me Vendimin KRRT nr. 22, datë 15.05.2009, për objektin: 4(katër) Banesa 2+1KT për z. S. D dhe Investitor “I” Sh.p.k., me afat deri në datë 15.05.2012.
- Vendim nr. 76, prot 1191/1, datë 28.07.2020 “Për miratimin e shtyrjes së afatit të lejes së ndërtimit, është miratuar leja me emërtimin “Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit për projektin “Godinë banimi 2 Kate plus papafingo” Gjilek, Dhërmi, me pronë të z. S. D, zhvillues “I” Sh.p.k, afati i përfundimit të zbatimit lejes së ndërtimit shtyhet deri në datë 27.07.2023.
- Kontratë Sipërmarrje Nr. 3124 Rep, Nr. 591 Kol, datë 17.06.2009, pala pronare e tokës S. D., pala sipërmarrëse “I” Sh.p.k. dhe pala ndërtuese “Gj” Sh.p.k. Në këtë kontratë, ndër të tjera është përcaktuar që shoqëria Gj Sh.p.k merr përsipër ndërtimin e objektit me një çmim prej 28,000 lekë për m2, ndërkohë sipërfaqja e ndërtimit që do të përfitojnë pronarët e truallit mbi të cilën do të ndërtohet godina do të jetë 30% e sipërfaqes totale të ndërtimit.
- Kontratë Sipërmarrje datë 28.09.2020, është përcaktuar pala Investitore “I” Sh.p.k. me Administrator S. D., pala sipërmarrëse “Gj” Sh.p.k.
- Akt-Ekspertimit nr. 14 prot, datë 18.10.2022, hartuar nga Shoqëria “I” Sh.p.k, ku janë analizuar punimet e kryera për periudhën tatimore Qershor 2021-Maj 2022, për objektin me emërtimin: “Objekt 4 Kate banesa 2+1 kat, Dhërmi”. Në përfundim të Akt-Ekspertimit cilësohet se realizimi i punimeve për ndërtimin e 2 objekteve (vilave) është në vlerën 48,210,072 lekë me TVSH, ku TVSH është në vlerën 8,035,012 lekë dhe objekti konsiderohet i përfunduar.
- Subjekti “I” Sh.p.k, ka bërë kërkesë për ndryshimin e përgjegjësisë tatimore në datë 17.10.2022 dhe ka kaluar në përgjegjësi tatimore me TVSH në datë 18.10.2022.
- Me shkresën nr. 6303/12 prot, datë 14.12.2022, Drejtuar Sektorit të Regjistrimit DRT Vlorë, Drejtoria e Kontrollit në Vend ka kërkuar aktivizimin e përgjegjësisë tatimore TVSH, në vijim të kontrollit në vend të realizuar për këtë subjekt.

Nga sa më sipër konstatohet se:

1- Në dosjen e kontrollit nuk administrohet dokumentacioni i plotë, pasi mungon projekti i zbatimit, planimetria e sheshit të ndërtimit, preventivi i projektit të zbatimit, nuk ka të dhëna të mjaftueshme për lejen e ndërtimit, sipërfaqen e parcelës ndërtimore dhe volumin total të ndërtimit.

2- Në lejen fillestare miratuar me Vendimin nr. 22, datë 15.05.2009, është cilësuar “4 (katër) Banesa 2+1KT”, në shtyrjen e lejes miratuar me Vendimin nr. 76, prot 1191/1, datë 28.07.2020 cilësohet “Godinë banimi 2 Kate plus papafingo”, ndërkohë në Akt-Ekspertimi cilësohet “Objekt 4 kate banesa 2+1 kat, Dhërmi”, në të tre aktet e mësipërme të dhënat e lejes së ndërtimit nuk janë të njëjta, është e paqartë nëse janë 4 objekte 2+1KT, apo godinë banimi 4 kate, gjithashtu nga Akt-Ekspertimi konstatohet se ka përfunduar ndërtimi për 2 objekte(vila).

- Ndryshim të palës investitore, sipërmarrëse dhe ndërtuese nga leja fillestare e ndërtimit në aktet e tjera administrative pasuese, si më poshtë:

- Leja fillestare miratuar me Vendimin nr. 22, datë 15.05.2009
 - Pala pronare e tokës është z. S. D.
 - Investitor “I” Sh.p.k.
 - Pala ndërtuese “Gj” Sh.p.k
- Kontrata e sipërmarrjes me Nr. 3124 Rep, Nr. 591 Kol, datë 17.06.2009
 - Pala pronare e tokës S. D.

- Pala sipërmarrëse “I” Sh.p.k.
- Pala ndërtuese “Gj” Sh.p.k
- Leje Ndërtimi nr. 76, prot 1191/1, datë 28.07.2020
 - Pala Zhvilluese “I” Sh.p.k. me Administrator S. D.
 - Pala ndërtuese “Gj” Sh.p.k.
- Kontrata e sipërmarrjes datë 28.09.2020, e panoterizuar.
 - Pala Investitore “I” Sh.p.k. me Adminstrator S. D.
 - Pala sipërmarrëse “Gj” Sh.p.k.

Veprime këto që bien në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit Nr. 6, atë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, Neni 20- “Punimet e ndërtimit, kryerja e procesit të ndërtimit, si dhe të mirëmbajtjes”, ku ndër të tjera përcaktohet se “.....Për qëllime të zbatimit të dispozitave të ligjit dhe përcaktimeve të këtij neni për veprimtarinë në ndërtim duhet që: Në çdo rast të përcaktohet qartë në lejet përkatëse përveç të dhënave që lidhen me ndërtuesin dhe investitorin, të dhënat për llojin e objektit, natyrën dhe qëllimin e përdorimit të tyre. Kur qëllimi i përdorimit të objektit është i përzier të jetë përcaktuar qartë në përputhje me planimetrinë e objektit pjesa përkatëse dhe qëllimi i përdorimit.

4- Nga kontrolli i deklarimeve të subjektit në sistemin C@ts për TVSH, rezulton se për periudhën e analizuar, ka realizuar 0 leke të ardhura (shitje mallra/sherbime apo të tjera), dhe ka realizuar vetëm një blerje në periudhën Shkurt 2022 në shumën 12.255.960 lekë (bashkë me TVSH). Kjo blerje është bërë nga subjekti “E” me Nipt LC e cila nga verifikimi në platformen qeveritare të faturave online, rezulton të jetë “Shitje punimesh dhe shërbimesh”.

Nga kontrolli i tatim fitimit 2021, rezulton se subjekti ende nuk ka gjeneruar të ardhura apo dhe shpenzime referuar Pasqyrës së të Ardhurave dhe Shpenzimeve të vitit 2021.

Nga Akt-Ekspertimit nr. 14 prot, datë 18.10.2022, hartuar nga Shoqëria “I” Sh.p.k, deri në datë 23.09.2022, realizimi i punimeve për ndërtimin e 2 objekteve (vilave) është ***në vlerën 48,210,072 lekë me TVSH***, dhe objekti konsiderohet i përfunduar, ndërkohë që për periudhën objekt kontrolli nga pala investitore “I” Sh.p.k **nuk është deklaruar asnjë blerje në sistemin C@ts, gjithashtu për llogari të palës investitore “I” Sh.p.k nuk është lëshuar asnjë faturë shitje situacion punimesh nga subjekti i ndërtimit “Gj” Sh.p.k.**

Sa sipër konstatohet se moslëshimi faturave si nga shitësi dhe mospranimi faturave nga blerësi për ti regjistruar në librat e blerjes për efekt të deklarimit të formularëve të tatimit mbi vlerën e shtuar, gjatë periudhës objekt kontrolli, bie në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit Nr. 6, datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, Neni 20- “Punimet e ndërtimit, kryerja e procesit të ndërtimit, si dhe të mirëmbajtjes” ku ndër të tjera përcaktohet se “.....Në rastin kur ndërtohet një objekt ose kryhen punime ndërtimi prej një personi të tatueshëm, i cili ka marrë përsipër të ndërtojë sipas porosisë së investitorit një objekt, i cili do të ketë apartamente banimi dhe ambiente për qëllime tregtare, të cilat investitori do ti shesë veprohet si më poshtë: Personi i tatueshëm ndërtues situacionon dhe i lëshon faturën tatimore investitorit të objektit, për punimet e kryera për çdo muaj duke llogaritur dhe paguar TVSH, pasi ka zbritur TVSH-në që ka rënduar blerjet e kryera prej tij për këtë qëllim. Nga ana tjetër, investitorit të objektit, i cili do të furnizojë apartamentet dhe ambientet e ndryshme, bazuar në dispozitat përkatëse që kanë të bëjnë me zbritshmërinë e TVSH-së, kapitulli X i ligjit, nuk i lind e drejta të zbresë TVSH-në e paguar personit të tatueshëm ndërtues për punimet e ndërtimit pasi ky investim do të përdoret për një veprimtari të përjashtuar nga TVSH-ja siç është furnizimi i ndërtesave, pra nuk i shërben furnizimeve të tatueshme për TVSH-në. Faturat e

blerjeve të punimeve të kryera nga investitori regjistruar si blerje të përjashtuara në librin e blerjes dhe në deklaratën e TVSH-së... ”.

- Me shkresën nr. 6303/10 prot, datë 14.12.2022, dërgimi informacioni, Drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve/Drejtorisë së Hetimit Tatimor, nga DRT Vlorë në vijim të problematikave të konstatuara nga kontrolli në vend, ku ka rezultuar se deri në momentin e kontrollit për ndërtimin e objektit në fjalë nuk është prerë asnjë situacion dhe asnjë faturë tatimore, materiali është kaluar për procedurë të mëtejshme në DPT me qëllim verifikimin e deklarimeve të subjektit ndërtues “Gj” Sh.p.k me Nipt JH.

- Me shkresën nr. 6303/11 prot, datë 14.12.2022, dërgimi informacioni, Drejtuar Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenjë, nga DRT Vlorë në vijim të problematikave të konstatuara nga kontrolli në vend, materiali është kaluar për procedurë të mëtejshme në DTM me qëllim verifikimin e deklarimeve të subjektit ndërtues “Gj” Sh.p.k me Nipt JH.

- DRT Vlorë nuk administron shkresë kthim përgjigje nga DPT dhe DTM, në lidhje me ecurinë e mëtejshme të kësaj praktike.

Tatimpaguesi: “H” SHPK

Nipti: L87215201T

Adresa kryesore: Radhimë, Rruga Vlorë-Orikum, Km.12, Lagja Plazh, Objekt Nr. 1, Radhimë, Vlorë.

Aktiviteti: *“Aktivitet në fushën e ndërtimit, hoteleri, restorante, barkafe, agjensi turistike, menaxhim turizmi, etj. Ndertime civile industriale-turistike-bujqesore. Aktivitet në fushën e transportit. Import-Eksport. Tregti me shumice dhe pakice të mallrave të ndryshëm industrial ushqimor dhe karburante., (vazhdon edhe më tepër sipas përshkrimit të QKB-së).”*

Inspektori: E H

Përgjegjës Sektori: I K

Drejtor Kontroll: B P

Drejtori Rajonal: S K

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH-periodha tatimore nga 05/2020-04/2022

- Për Tatim-Fitimin periodha tatimore: -2020-2021

- Për Sigurimet Shoqërore e shëndetësore-periodha tatimore nga 05/2021-04/2022

- Të tjera periodha tatimore: deri në 2022/04

- Orë pune: 132 orë

Nga auditimi ka rezultuar se:

▪ Njoftimi i kontrollit është bërë në datë 29.06.2022, ndërkohë që kontrolli në subjekt ka filluar në datë 22.07.2022, pra nuk është repsektuar afati 30 ditor në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 81, pika 1.1 dhe përcaktimet në programin e kontrollit nr. 5633/2 prot, datë 29.06.2022, ku është vendosur afati i fillimit të kontrollit në subjekt data 01.08.2022.

- Në sistemin C@TS mungon Raporti i Kontrollit dhe procesverbalet, gjithashtu Njoftimi i Kontrollit nuk është hedhur brenda ditës së nesërme të punës nga momenti që janë mbajtur, jo në përputhje me përcaktimet e Manualin të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.

- Formulari 3-nuk është hedhur në sistemin C@TS, nuk ka nënshkrim nga Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori Rajonal, jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2.

- Raporti nuk ka të bashkangjitur si pjesë përbërëse të tij “Formulari-pyetësor i vetë deklarimit para kontrollit”, jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6.

- Kontrolli është kryer në tejkalim të afatit të parashikuar në programin e kontrollit, me afat 132 orë pune, pasi kontrolli ka filluar me datë 22.07.2022 dhe ka përfunduar në datë 06.09.2022, në total 256 orë / 34 ditë pune, apo më shumë 124 orë pune, jo në përputhje me përcaktimet e Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.3.

- Nuk është bërë bilanci material për materialet e ndërtimit në kundërshtim me përcaktimet e programit të kontrollit dhe Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.5, Kapitulli VIII, pika 8.

- Nuk është bërë analizimi i detajuar i shitjeve për të gjithë periudhën e kontrollit, sa nga këto “shitje për materiale ndërtimi”, nuk është analizuar zëri “shitje për restorantin” në kundërshtim me përcaktimet e programit të kontrollit dhe Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.5, Kapitulli VIII, pika 8.

- Nga kontrolli i blerjeve të deklaruara nga subjekti në sistemin C@ts sipas librave të shitjeve dhe krahasimi me të dhënat e paraqitura në Raport Kontrolli rezultojnë diferenca sipas viteve si më poshtë:

-Ka mospërputhje ndërmjet blerjeve të deklaruara në sistemin C@ts sipas formularëve të FDP-ve dhe të dhënave të paraqitura në Raport Kontrolli, konkretisht si më poshtë:

- Kreditimi i TVSH për karburantin **Korrik-Dhjetor 2020**

Nipti	Emri shitësit	Vendi	Pershkrimi	Blerje nga furnitor vendas me TVSH 20%	TVSH
KV	S G	Vlorë	Nafte	6,407,523	1,281,504
JT	A Sh.p.k	Vlorë	Nafte	1,233,333	246,667
			Totali	7,640,856	1,528,171

Sipas deklarimeve të subjektit qarkullimi për këtë periudhë është në vlerën 67,726,646 lekë, shitjet kryesisht përfaqësojnë shitjen e materialeve të ndërtimit tek shoqëria “H Sh.p.k”, gjithashtu shoqëria ka realizuar të ardhura dhe nga shërbimi bar-restorant. Shitjet e deklaruara nga subjekti lidhen me veprimtarinë ekonomike tregti dhe sipas përcaktimeve të Ligjit 92/2014, datë 24.07.2014 “Për TVSH-në” i ndryshuar, kreu IX, seksioni 3, neni 74/a/ii, Udhëzim Nr. 6, Datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 55- Kufizime të zbritjes së TVSH për disa furnizime, për tregtin normative e zbritjes së TVSH-së është 3 % e qarkullimit 2,031,799 lekë (3% *67,726,646 lekë), për pasojë për vlerën e tatueshme 5,609,057 lekë (7,640,856 -2,031,799), nuk i njihet e drejta e kreditimit të TVSH-së në vlerën 1,121,811 lekë.

Për sa më sipër dhe në zbatim të Ligjit 9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar , neni 68 “Vleresimi tatimor” pika 4 dhe 5/b dhe nenit 115, subjektit i linden detyrime si më poshtë:

Detyrim për TVSH - 1,121,811 lekë

Penalitet 20% - 224,362 lekë

Totali detyrimi= 1,346,173 lekë

- Kreditimi karburantit **Janar-Dhjetor 2021**

Nipti	Emri shitësit	Vendi	Pershkrimi	Blerje nga furnitor vendas me TVSH 20%	TVSH
KV	S	Vlorë	Nafte	1,886,249	377,251
JT	A Sh.p.k	Vlorë	Nafte	1,441,760	288,353

JT	A Sh.p.k	Vlorë	Naftë	282,915	56,583
			Totali	3,610,924	722,187

Sipas deklarimeve të subjektit qarkullimi për këtë periudhë është në vlerën 97,489,781 lekë, shitjet kryesisht përfaqësojnë shitjen e materialeve të ndërtimit tek shoqëria “H”, gjithashtu shoqëria ka realizuar të ardhura dhe nga shërbimi bar-restorant. Shitjet e deklaruara nga subjekti lidhen me veprimtarinë ekonomike tregti dhe sipas përcaktimeve të Ligjit 92/2014, datë 24.07.2014 “Për TVSH-në” i ndryshuar, kreu IX, seksioni 3, neni 74/a/ii, Udhëzim Nr. 6, Datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 55-Kufizime të zbritjes së TVSH për disa furnizime, për tregtin normative e zbritjes së TVSH-së është 3 % e qarkullimit 2,924,693 lekë (3% *97,489,781 lekë), për pasojë për vlerën e tatueshme 686,231 lekë (3,610,924 -2,924,693), nuk i njihet e drejta e kreditimit të TVSH-së në vlerën 137,246 lekë.

Për sa më sipër dhe në zbatim të Ligjit 9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republikën e Shqiperise” i ndryshuar, neni 68 “Vleresimi tatimor” pika 4 dhe 5/b dhe nenit 115, subjektit i linden detyrime si më poshtë:

Detyrim për TVSH - 137,246 lekë

Penalitet 20% - 27,449 lekë

Totali detyrimi= 164,695 lekë

- Nga kontrolli i blerjeve dhe shitjeve të deklaruara nga subjekti janë konstatuar si më poshtë :
-Në zërin “Blerje te përjashtuara” është deklaruar:

Viti	Nipti	Tatimpagues	Rrethi Shitësit	Blerje te perjashtuara	Përshkrimi
Korrik-Dhjetor 2020	ME	E	Vlorë	2,570,000	Ndertim puntori, vendosje pllaka, ndertim etj
2021	ME	E	Vlorë	2,125,040	Puntori shtrim pllakash etj
		TOTAL		4,695,040	

Për këtë blerje në Raport Kontrolli nuk është analizuar se për cilin objekt janë kryer punimet si dhe nëse administrohet situacion punimesh, mbi bazën e të cilave do të hartohen faturat tatimore.

Ndërtimi i hotelit dhe situacionimi i punimeve të ndërtimit

Dokumentacioni Teknik-ligjor administruar në dosje:

- **Leje zhvillimore nr.1, datë 04.02.2015, me afat deri në 20.09.2018**, për ndërtimin e objektit Strukturë shërbimi “Kompleks hotelerie 4 kat me 1 kat parkim nën tokë (3 objekte)” në Nisi, Radhimë, lëshuar nga Bashkia Orikum.

-Palë pronare të pasurisë truall nr. 515/11/1 V dhe F H,

-Palë zhvilluese shoqëria “H” Sh.p.k

-Sipërfaqe trualli 11100 m²

-Sipërfaqe e zënë nga struktura 2226 m²

-Volum total i ndërtimit 33266 m²

Në dosje nuk administrohen aktet administrative si vijon:

a- “Shtyrje afati leje ndërtimi nr.1146, datë 24.10.2018, me afat deri në datë 24.10.2020” lëshuar nga Bashkia Vlorë,

b- “Shtyrje afati leje ndërtimi nr.188, datë 17.03.2021, me afat deri në datë 17.03.2023”, lëshuar nga Bashkia Vlorë.

c-Aplikimi pranë Bashkisë Vlorë datë 20.10.2021, për pasqyrimin e efekteve ligjore të “Kontratës noteriale kalim të drejtash” në lejen e ndërtimit me AN 200420220015, për ndryshimin e subjektit zhvillues.

▪ **Kontratë noteriale kalim të drejtash me Nr. 3687 prot, Nr. 2951 Kol, datë 27.11.2018,**

Pala subjekt ish-investitore: Subjekti “H” Sh.p.k me Nipt- JI

Pala Investitore she sipërmarrëse: Subjekti “H Group” Sh.p.k me Nipt- LT

Pala pronare e truallit: A. H.

Objekti i kësaj kontrate është kalimi i të gjithë të drejtave reale nga shoqëria “H” Sh.p.k tek shoqëria “H Group” Sh.p.k, të lejes zhvillimore të ndërtimit me nr. 1, datë 04.02.2015, sipas kushteve më poshtë:

- Shoqëria “H Group” Sh.p.k merr pjesë në investim në masën 100 %

- Shoqëria “H Group” Sh.p.k merr përsipër të detyrimin për të përmbushur të gjitha detyrimet kontraktuale të bashkëpunimit sipas vlerave të përcaktuara nga ajo vetë.

- Shoqëria “H Group” Sh.p.k dhe shoqëria “H” Sh.p.k, kanë rëndë dakort që të gjitha të drejtat dhe detyrimet ti kalojnë shoqërisë “H Group” Sh.p.k.

▪ **Raport Ekspertimi Teknik nr. 18 prot, datë 05.08.2022,** hartuar nga Inxh. Z. F., referuar Kontratë Shërbimi me nr. 5633/4 prot, datë 26.07.2022 me DRT Vlorë. Sipas konkluzioneve të akt-ekspertimit kontrolli është kryer për punimet e realizuara në periudhën Korrik 2020-Gusht 2021, niveli i punimeve në datën e inspektimit 05.08.2022 është 70% e punimeve.

Në raport ekspertimi gjithashtu citohet se “*Analiza për kryerjen e punimeve dhe inventarin fizik të objektit është kryer për periudhën për muaj Korrik 2020-Gusht 2021..... Sipas subjektit zhvillues, situacionet progresive për periudhën e analizës janë në vlerën 105,705,725 lekë pa strukturat, fitimin dhe TVSH, marrë nga situacionet progresive të deklaruara nga investitori.*

Referuar kësaj analize situacioni progresiv për periudhën Maj 2021-Maj 2022, vetëm në volum punimesh sipas faturave tatimore është 105,705,725 lekë pa strukturat, fitimin dhe TVSH.”.

Në trajtimin e Raport Ekspertimit të dhënat për periudhën për të cilën është kryer analiza e punimeve dhe situacionet progresive, janë kontradiktore.

-Në Raport Kontrolli Tatimor datë 06.09.2022, nisur me shkresën nr. 5633/6 prot, datë 08.09.2022, tatimpaguesit “H Group” Sh.p.k, nuk i është njohur e drejta e kreditimit të TVSH-së për situacionet e punimeve në ndërtim, pasi realizimi i punimeve është në kundërshtim me lejen e ndërtimit referuar përcaktimeve të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar, Neni 2, pika 8, Neni 13, pika 1, 2 dhe 3, neni 14, pika 1. Në përfundim subjektit i janë nxjerrë detyrime për TVSH në vlerën 25,556,084 lekë, nga të cilat 21,296,737 lekë ulje e tepricës kreditore dhe 4,259,347 lekë penalitet.

- Në Raportin Përfundimtar të Kontrollit datë 28.09.2022, nisur me shkresën nr. 5633/8 prot, datë 30.09.2022, DRT Vlorë ka ndryshuar qëndrim bazuar në observacionet e paraqitura nga tatimpaguesit “H Group” Sh.p.k datë 19.09.2022, administruar në DRT Vlorë me nr.5633/7 prot, datë 20.09.2022, duke marrë në konsideratë pjesërisht pretendimet e tatimpaguesit referuar përcaktimeve të Ligjit nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IX, neni 69, pika 2, duke njohur të drejtën e zbritjes së TVSH-së për ato furnizime që lidhen direkt me pasurinë e paluajtshme që përdoret për qëllime të veprimtarisë së tij ekonomike.

-Sqarojmë se në lidhje me të drejtën e kreditimit të TVSH-së për këtë subjekt, nga DRT Vlorë është mbajtur më herët qëndrim, referuar Raport Kontrolli nr. 6370/6 prot, datë 21.07.2021 dhe komunikimit shkresor me DPT, si më poshtë:

Me shkresën nr. 3790 prot, datë 25.06.2021, kërkesë për interpretim, drejtuar DPT\Drejtorisë Teknike dhe Ligjore, nga DRT Vlorë është kërkuar interpretim nëse kontrata noteriale “Kalim të drejtash” me Nr. 3687 prot, Nr. 2951 Kol, datë 27.11.2018, i jep të drejtë të kreditimit të TVSH në procesin e ndërtimit tatimpaguesit “H Group” Sh.p.k sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 69 dhe Udhëzimit Nr. 6, datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, Neni 20, pika 4.

-Me shkresën nr. 12017/1 prot, datë 09.07.2021, administruar në DRT Vlorë me nr. 3790/1 prot, datë 12.07.2021, kthim përgjigje, DPT\Drejtoria Teknike dhe Ligjore, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe përmbajtjen e shkresës “Kërkesë për interpretim” të DRT Vlorë, nuk i ka njohur TVSH-n e zbritshme për ndërtimin e hotelit tatimpaguesit “H Group” Sh.p.k, duke argumentuar në shkresë ndër të tjera “...Për këtë, është kusht i domosdoshëm që lloji, natyra dhe qëllimi i përdorimit të objektit të shpallet dhe aprovohet në lejen e ndërtimit të dhënë sipas legjislacionit të fushës në fuqi.....Domosdoshmërisht të përcaktohet në leje qartësisht lloji i objektit dhe përdorimi i tij, në mënyrë që të jete i mundur të vërtetohet qëllimi i përdorimit në lidhje me veprimtarinë ekonomike.... Leje ndërtimi është akti i miratimit të kërkesës për leje ndërtimi dhe lejimit të punimeve përkatëse..... Referuar përmbajtjes së shkresës suaj konstatojmë se shoqëria “H Group”, ka kryer punime ndërtimi (operacion, transaksion, furnizim) dhe këto të fundit nuk janë kryer në përputhje me legjislacionin e fushës dhe legjislacionin fiskal duke përdorur lejen e ndërtimit të shoqërisë “H” Sh.p.k.

Bazuar në referencat ligjore të sipërpërmendura, duke qenë se tatimpaguesi “H Group” Sh.p.k, nuk ka zbatuar kërkesat e ligjit si ato në fushën e ndërtimit dhe legjislacionin fiskal, nuk njihet TVSH e zbritshme për ndërtimin e hotelit.”.

Deklarimet e subjektit në librat e shitjes dhe blerjes

▪ Periudha Korrik-Dhjetor 2020

-Në zërin “Blerje nga furnitor vendas me TVSH 20%”, janë deklaruar punimet e ndërtimit si më poshtë:

Nipti	Tatimpagues	Rrethi Shitësit	Furnitorë vendas 20%	TVSH 20 %	Përshkrimi
KB	I	Tiranë	15,456,240	3,091,250	Ndërtim hekuri
KR	Z	Vlorë	6,407,523	1,281,504	Cimento
KV	P	Durrës	5,077,938	1,015,589	Fv Durale
KC	A	Vlorë	1,685,833	337,167	Fv armature ndërtim
LA	A	Fier	1,142,040	228,408	Fv material hidraulik
JF	K	Tirane	1,002,584	200,516	Profile celiku
KF	E	Tirane	974,020	194,804	Materiale izolimi
KH	B	Vlorë	917,349	183,470	Pllake material+për shtrim
K	K	Vlorë	835,835	167,167	Fv mure tulle, grafiato, suva etj
KD	V	Berat	666,840	133,368	Fv vetrate alumil
LS	M	Vlorë	633,333	126,667	Mermer
K	D	Vlorë	600,833	120,167	Materiale lyerje
KK	A	Vlorë	496,250	99,250	Materiale per pllaka
TOTAL			35,896,618	7,179,327	

-Në zërin “Blerje të investimeve vendase me TVSH 20%” është deklaruar si më poshtë:

Nipti	Tatimpagues	Rrethi Shitësit	Furnitorë vendas 20%	TVSH 20 %	Përshkrimi
JI	H Sh.p.k	Vlorë	52,960,893	10,592,178	Situacion ndërtimi kompleksi hotelieri

TOTAL	52,960,893	10,592,178	
--------------	-------------------	-------------------	--

- **Periudha Janar-Dhejtor 2021**, janë konstatuar si më poshtë :

-Në zërin “Blerje nga furnitor vendas me TVSH 20%” janë deklaruar punimet e ndërtimit:

Nipti	Tatimpagues	Rrethi Shitësit	Furnitorë vendas 20%	TVSH 20 %	Përshkrimi
LQ	S	Tiranë	6,156,610	1,231,322	Ashensor
LB	H	Fier	3,648,849	729,771	Materiale hidro-izolimi
K	K	Vlorë	3,335,700	667,140	Fv Grafiato
KR	Z	Vlorë	3,213,749	642,751	Cimento
KH	B	Vlorë	1,859,184	371,837	Material drusore
KD	A	Vlorë	1,002,584	200,516	Profile celiku
MM	F	Vlorë	1,768,666	353,734	Materiale elektrike, spote ndricimi
KH	A	Vlorë	1,625,775	325,155	Ashensor ndërtim
KC	A	Vlorë	1,304,167	260,833	Fv armature ndërtim
KH	G	Vlorë	808,052		Punime gipsi
LV	M	Tiranë	718,695	143,740	Materiale Hidraulike
LS	M	Vlorë	416,667	83,333	Mermer
KA	U	Vlorë	314,833	62,967	Materiale lyerje
KE	F	Vlorë	308,565	61,713	Cimento
TOTAL			26,482,096	5,134,812	

-Në zërin “Blerje të investimeve vendase me TVSH 20%” është deklaruar si më poshtë:

Nipti	Tatimpagues	Rrethi Shitësit	Furnitorë vendas 20%	TVSH 20 %	Përshkrimi
Ji	H Sh.p.k	Vlorë	42,931,863	8,586,374	Situacion ndërtimi kompleksi hoteleri
Ji	H Sh.p.k	Vlorë	12,982,972	2,596,594	Situacion ndërtimi kompleksi hoteleri
TOTAL			55,914,835	11,182,968	

Sa sipër rezulton si më poshtë:

1-Nga Inspektori Kontrollit në analizën që i ka bërë zërit “Blerje nga furnitor vendas me TVSH 20%”, për periudhën Korrik-Dhejtor 2020, nuk ka njohur TVSH e zbritshme për vetëfaturimin në vlerë të tatueshme 3,886,732 dhe TVSH të zbritshme 777.347 leke, shitës H Sh.p.k, Nipt- JI, ndërkohë në zërin “Blerje të investimeve vendase me TVSH 20%” sa sipër, ka njohur të drejtën e kreditimit të TVSH-së në vlerën 10,592,178 lekë, po i njëjti shitës H Sh.p.k.

2-Nga verifikimi i listë pagesave të deklaruara në sistemin C@ts nga tatimpaguesi H Sh.p.k, Nipt- JI, në cilësinë e subjektit ndërtues, që ka lëshuar dhe situacionet e punimit kundrejt subjektit “H Group” Sh.p.k, gjatë periudhës së kontrollit Korrik 2020-Prill 2022, rezulton se ka 3 punonjës të deklaruar në listëpagesa si më poshtë:

-Sipërmarrës

-Ekonomist

-Inxhinier Zbatimi

3-Kontrata noteriale kalim të drejtash me Nr. 3687 prot, Nr. 2951 Kol, datë 27.11.2018, nuk plotëson kushtet e nenit 746 të Kodit Civil, siç pretendon tatimpaguesi në observacionet mbi Raport Kontrolli nr. 5633/6 prot, datë 08.09.2022, pasi sipas përcaktimeve të nenit 746- Shitja me rezervë e pronës, “Kur çmimi i shitjes paguhet me këste, blerësi e fiton pronësinë e sendit me pagimin e kështit të fundit të çmimit, duke marrë përsipër rreziqet që në çastin e dorëzimit. Kalimi me rezervë i pronësisë me kushtin e sipërm duhet të pasqyrohet në kontratë.”, ndërkohë që në kontratën e lidhur ndërmjet palëve, “H Group” Sh.p.k merr pjesë në investim në masën 100 % dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet ti kalojnë shoqërisë “H Group” Sh.p.k.

4- Leje zhvillimore nr.1, datë 04.02.2015, me afat deri në 20.09.2018, për ndërtimin e objektit Strukturë shërbimi “Kompleks hotelerie 4 kat me 1 kat parkim nën tokë (3 objekte)” në Nisi, Radhimë, lëshuar nga Bashkia Orikum, është lëshuar në emrin e sipërmarrësit H Shpk me Nipt: JI.

Të dy shtyrjet e lejeve nr.1146, datë 24.10.2018 dhe nr.188, datë 17.03.2021 janë bërë në emrin e shoqërisë H. Shpk me Nipt: JI. Ndryshimi i subjektit zhvillues është miratuar nga Bashkia Vlorë me Vendimin nr. 168, datë 22.03.2023, pra pas periudhës për të cilën kërkohet të kreditohet TVSH më sipër.

Si përfundim shoqëria “H Group” Sh.p.k, ka kryer punime ndërtimi (operacion, transaksion, furnizim) dhe këto të fundit nuk janë kryer në përputhje me legjislacionin e fushës dhe legjislacionin fiskal duke përdorur lejen e ndërtimit të shoqërisë “H” Sh.p.k me Nipt: JI, në kundërshtim me kërkesat ligjore të fushës së ndërtimit dhe ato fiskale, VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të territorit“, Neni 2, pika 8, neni 13, pika 1, 2 dhe 3, neni 14, pika 1. Për pasojë tatimpaguesit “H Group” Sh.p.k nuk i njihet TVSH-ja e zbriteshme për ndërtimin e hotelit.

Sa sipër referuar situacioneve të ndërtimit të deklaruar nga shoqëria si më poshtë:

Periudha/Natyra e blerjes	Vlera me TVSH	TVSH 20 %	Përshkrimi
Korrik-Dhjetor 2020			
Blerje të investimeve vendase me TVSH 20%	52,960,893	10,592,178	Situacion ndërtimi kompleksi hoteleri
Viti 2021			
Blerje të investimeve vendase me TVSH 20%	55,914,835	11,182,968	Situacion ndërtimi kompleksi hoteleri
TOTAL	108,875,728	21,775,146	

Për sa më sipër dhe në zbatim të Ligjit 9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar, neni 68 “Vleresimi tatimor” pika 4 dhe 5/b dhe nenit 115, subjektit i linden detyrime si më poshtë:

Detyrim për TVSH- 21,775,146 lekë

Penalitet 20% -..... 4,355,029 lekë

Totali detyrimi=..... 26,110,175 lekë

Në përfundim për tatimpaguesin “H Group” Sh.p.k., ka rezultuar detyrim në vlerën totale 27,641,043 lekë (nga të cilat 23,034,203 lekë detyrim për TVSH + 4,606,840 lekë gjobë).

Tatimpaguesi: “E” SHPK

Nipti: LJ

Adresa kryesore: Rruga e Kampit, Lagja Kamp, pranë Kampit të Punëtorëve, Objekt 2-katësh, Nr. 1 Dhërmi, Vlorë.

Aktiviteti: “Aktivitet në fushën e ndërtimit, hoteleri, restorante, barkafe, agjensi turistike, menaxhim turizmi, etj. Nderime civile industriale-turistike-bujqesore. Aktivitet në fushën e transportit. Import-Eksport. Tregti me shumice dhe pakice te mallrave te ndryshem industrial ushqimore dhe karburante., (vazhdon edhe më tepër sipas përshkrimit të QKB-së).”

Inspektori: F S

Përgjegjës Sektori: I K

Drejtor Kontroll: B P

Drejtori Rajonal: S K

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për Rimbursimin e TVSH-periodha tatimore nga 03/2021-07/2021
- Orë pune: 26 orë

Nga auditimi ka rezultuar se:

▪ Formulari 3-nuk është hedhur në sistemin C@TS, nuk ka nënshkrim nga Inspektori, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori Rajonal, jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2.

- Raporti nuk ka të bashkangjitur si pjesë përbërëse të tij “Formulari-pyetësor i vetë deklarimit para kontrollit”, jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6.

▪ Subjekti “E” *Sh.p.k.* me NIPT L67207205J ka paraqitur pranë Drejtorisë së rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, kërkesën datë 16.02.2022 për rimbursim TVSH-je, që i përket periudhës Mars-Korrik 2021.

Sipas shkresës së DPT-së nr. 2789/2 prot, datë 03.03.2022 protokolluar në DRT Vlorë me nr.2447 prot, datë 07.03.2022, është miratuar kontrolli për rimbursimit të TVSH-se që përfshin periudhën 01.03.2021 deri 31.07.2021, sipas kërkesës së subjektit “Për rimbursim TVSH-je në shumën 16,600,287 lekë.

▪ Raport Ekspertimi Teknik datë 25.03.2022, hartuar nga Inxh. Z F, referuar Kontratë Shërbimi me nr. 2629/3 prot, datë 16.03.2022 me DRT Vlorë. Sipas konkluzioneve të akt-ekspertimit:

- Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 2, Prot 126, datë 15.01.2018 “Objekt 2 kat mbi tokë dhe 1 kat nëntokë Hotel, Restorant, Pishinë”, me afat 30 muaj nga dita e fillimit të punimeve, Investitor E Sh.p.k.

- Kontrolli është kryer për punimet e realizuara në periudhën Mars-Korrik 2021, punimet kanë përfunduar në datën e inspektimit 25.03.2022 dhe është bërë kolaudimi i objektit.

- Realizimi i punimeve për periudhën Mars-Korrik 2022 është jashtë afatit të lejes së ndërtimit referuar shkresës nr. 1561/1 prot, datë 30.03.2022 të Bashkisë Himarë. Sipas kësaj shkrese afati i përfundimit të punimeve sipas pikës 2 të lejes së ndërtimit është 30 muaj nga data e fillimit të punimeve dhe rezulton të jetë e vlefshme deri me datë 06.08.2020.

- Situacionet progresive të punimeve të kryera për periudhën Mars-Korrik 2021 sipas faturave tatimore janë në vlerën 43,910,000 lekë.

▪ Nuk është bërë përcaktimi i kostos së blerjeve dhe kostos së plotë për çdo artikull dhe krahasimi me çmimet e shitjes së deklaruar nga subjekti, nuk është bërë bilanci material për lëvizjet e mallit në sasi dhe në vlerë jo sipas përcaktimeve të programit të kontrollit pika 1/5 dhe Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.5, Kapitulli VIII, pika 8.

▪ Nga analiza e blerjeve dhe shitjeve të deklaruar nga subjekti rezulton se për periudhën Mars-Korrik 2021, ka deklaruar shitje me shkallë të tatueshme 6 % vlerën 14,638,347 lekë me TVSH.

-Subjektit ka aplikuar pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për pajisjen me certifikatën e kategorizimit si strukturë akomoduese, aplikim me nr. 4147 prot, datë 15.06.2020, administruar në DRT Vlorë me nr. 3037 prot, datë 26.05.2023.

-Certifikata është lëshuar në datë 10.08.2023.

Referuar përcaktimeve të Ligjit 92/2014, datë 24.07.2014 “Për TVSH-në” i ndryshuar, Neni 49, pika 3 “*Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese, sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin e fushës së turizmit, është 6 për qind. Kushtet, kriteret dhe procedurat për zbatimin e kësaj pike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave*”.

Vendim Nr. 953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”, Neni 11/1: *Në zbatim të pikës 3, të nenit 49, të ligjit, shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese, sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin e fushës së turizmit, është 6 për qind.*

-Personat e tatueshëm, që aplikojnë shkallën e reduktuar të TVSH-së sipas këtij neni, janë personat që ushtrojnë vetëm veprimtari ekonomike në fushën e strukturave akomoduese, sipas legjislacionit të fushës për turizmin. Nëse personi i tatueshëm ushtron edhe veprimtari të tjera, përveç asaj në fushën e strukturave akomoduese, atëherë duhet të jetë i regjistruar si person i tatueshëm më vete, për qëllime të veprimtarisë në fushën e strukturave akomoduese.

- Urdhër nr.41, datë 18.02.2020 “Për një ndryshim në Urdhrin nr. 267, datë 24.07.2019 “Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese”, ka shtyrë afatin e aplikimit për marrjen e çertifikatës së kategorizimit të strukturave akomoduese duke përcaktuar datën 31.03.2020 si afatin përfundimtar për aplikim.

Sa sipër tatimpaguesi “E” Sh.p.k, nuk plotëson kushtet për aplikimin shkallës së reduktuar TVSH-së 6 % dhe në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 68 “Vleresimi tatimor” pika 4 dhe 5/b, Neni 115, pika 3, subjektit i linden detyrime si më poshtë:

TVSH 20% - 2,586,108 lekë (15,516,648/6*5)

TVSH e papaguar diferencë - 1,707,807 lekë (2,586,108 -878,301 TVSH e paguar me 6%)

Penalitet 20% - 341,561 lekë

Totali detyrimi= - 2,049,368 lekë

▪ Nga Inspektori i Kontrollit në përfundim të kontrollit subjektit i është njohur e drejta për kreditimin e TVSH-së vetëm për vlerën 7,584,835 lekë nga 16,600,287 lekë të kërkuara në total. Për diferencën që nuk i është njohur janë llogaritur detyrimet dhe penalitetet përkatëse si dhe është bërë njoftimi vlerësimi.

- Në përfundim për tatimpaguesin “E” Sh.p.k, ka rezultuar detyrim në vlerën totale 2,049,368 lekë (nga të cilat 1,707,807 lekë detyrim për TVSH detyrim tatim fitimi + 341,561 gjobë).

Tatimpaguesi: “I” SHPK.

Nipti: MR

Adresa kryesore: Himarë, Dhërmi, Rruga Perivolo Km.12, Lagja Drimadhes, Objekti nr. 1, Dhërmi, Vlorë.

Aktiviteti: “Veprimtari ne fushen e ndertimit, zbatimit dhe projektimit. Ndertime civile, industrial, turistike, investitor ne sektorin e turizmit. Tregeti me shumice e pakice, import-eksport te mallrave te ndryshem industrial, bujqesore dhe blegtorale, etj. Bar, kafe, turizem hoteleri. Pastrim, urbanizim te plazheve ne bregdet. Gjueti, rritje trajtim e import i peshkut etj., (vazhdon edhe më tepër sipas përshkrimit të QKB-së).”

Inspektori: E H

Përgjegjës Sektori: I K

Drejtor Kontroll: B P

Drejtori Rajonal: S K

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për rimbursimin e TVSH-periodha tatimore nga 06/2021-09/2021

- Orë pune: 32 orë

Nga auditimi ka rezultuar se:

▪ Njoftimi i kontrollit është bërë në datë 15.03.2022, ndërkohë që kontrolli në subjekt ka filluar në datë 24.03.2022, pra nuk është respektuar afati 30 ditor në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 81, pika 1.1 dhe përcaktimet në programin e kontrollit nr. 2258/2 prot, datë 15.03.2022, ku është vendosur afati i fillimit të kontrollit në subjekt data 21.03.2022.

- Formulari 3-nuk është hedhur në sistemin C@TS, nënshkrim nga Përgjegjësi i Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori Rajonal nuk ka datë, jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2.

- Raporti nuk ka të bashkangjitur si pjesë përbërëse të tij “Formulari-pyetësor i vetë deklarimit para kontrollit”, jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6.

▪ Subjekti “I” Sh.p.k, me NIPT MR ka paraqitur pranë Drejtorisë së rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, kërkesën datë 23.12.2022 për rimbursim TVSH-je, që i përket periudhës Qershor-Shtator 2021.

Sipas shkresës së DPT-së nr. 2274/2 prot, datë 24.02.2022 protokolluar në DRT Vlorë me nr.22588 prot, datë 28.02.2022, është miratuar kontrolli për rimbursim të TVSH-së për periudhën 01.06.2021 deri 31.09.2021, sipas kërkesës së subjektit “Për rimbursim TVSH-je në shumën 27,849,923 lekë.

▪ Raport Ekspertimi Teknik datë 24.03.2022, hartuar nga Inxh. Z F, referuar Kontratë Shërbimi me nr. 2258/4 prot, datë 17.03.2022 me DRT Vlorë. Sipas konkluzioneve të akt-ekspertimit:

-Leje zhvillimi, Vendim nr. 10, datë 28.02.2020.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 104, Prot 3810/1, datë 14.12.2020 “Kompleks Hotelerie 2 dhe 3 kat me 1 kat nëntokë dhe pishinë”, Gjilekë, Bashkia Himarë, Rrethi Vlorë.

Zhvilluesi: I

Ndertues: “T” Sh.p.k

-Punimet kanë filluar në datë 14.12.2020, me afat 36 muaj deri në datë 14.12.2023.

-Zbatimi i projektit nuk ka përfunduar dhe është akoma në fazë punimesh, janë realizuar 95 % të punimeve.

-Nuk është respektuar plotësisht projekti i miratuar pasi është shtuar një kat nëntokë.

-Nga inspektimi në objekt u konstatua që objekti ka një kat nëntokë.

Sipërfaqet për ndërtimin paraqiten si më poshtë:

- Sipërfaqe totale nëntokë - 4709.9 m²

- Sipërfaqe totale mbi tokë - 3364.6 m²

- Sipërfaqe pishine - 226 m²

- Sipërfaqe totale objekti - 8074.5 m²

-Analiza për kryerjen e punimeve dhe inventarin fizik të raportimeve të objektit është kryer për periudhën Korrik-Gusht 2021.

-Sipas subjektit ndërtues dhe investitor, Situacionet progresive për periudhën e analizës janë në vlerën 78,052,008 lekë pa strukturat, fitimin dhe TVSH.

Sa sipër janë konstatuar mangësi si vijon:

- Nga analiza e Raport Ekspertimit Teknik datë 24.03.2022, konstatohet se konkluzionet e nxjerra janë kontradiktore, pasi në të njëjtin material është cituar se “...Nuk është respektuar

plotësisht projekti i miratuar pasi është shtuar një kat nëntokë...., ndërkohë më poshtë citohet “....Nga inspektimi në objekt u konstatua që objekti ka një kat nëntokë....”.

- Në dosje mungojnë planimetritë e kateve të objektit të miratuar sipas lejes së ndërtimit dhe analiza e detajuar e situacioneve sipas zërave të punimeve të kryera krahasuar me faturat tatimore të lëshuara në subjektin ndërtues.

- Në Raport Kontrolli nuk është sqaruar nga Inspektori nëse ka shkelje të lejes së ndërtimit, referuar citimeve në Raport Ekspertimi.

- Kërkesa për rimbursim të TVSH-së nga tatimpaguesi është bërë për vlerën 27,849,923 lekë, në analizën e situatës financiare në Raport Kontrolli TVSH e zbritshme është në vlerën 27,598,807 lekë, i ka njohur në fund 27,570,723 lekë (27,849,923 lekë-279,200 lekë zbritja e TVSH-së), ndërkohë sipas FDP-ve të TVSH-së korrik-shtator 2021, të deklaruara në sistemin C@ts, TVSH e zbritshme është në vlerën 27,523,242 lekë, ka një diferencë më shumë 326,681 lekë, e cila nuk është analizuar nga Inspektori i Kontrollit, se si është krijuar.

- Nuk është bërë përcaktimi i kostos së blerjeve dhe kostos së plotë për çdo artikull dhe krahasimi me çmimet e shitjes së deklaruara nga subjekti, nuk është bërë bilanci material për lëvizjet e mallit në sasi dhe në vlerë në kundërshtim me përcaktimet e programit të kontrollit pika 1/5 dhe Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.5, Kapitulli VIII, pika 8.

- Sipas Raport Ekspertimit Teknik situacionet progresive për ndërtimin e hotelit për periudhën Korrik-Gusht 2021, janë në vlerën 78,052,008 lekë pa strukturat, fitimin dhe TVSH. Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit në librat e blerjes për të njëjtën periudhë, rezulton se janë bërë blerje situacione punimesh nga subjekti ndërtues “T” SHPK me NIPT KC, sipas tabelës më poshtë:

	KORRIK			GUSHT		
	Vlera me TVSH	Vlerë e tatueshme	TVSH	Vlera me TVSH	Vlerë e tatueshme	TVSH
	44,572,542	37,143,785	7,428,757	86,644,530	72,203,775	14,440,755
				15,161,398	12,634,498	2,526,900
Total	44,572,542	37,143,785	7,428,757	101,805,928	84,838,273	16,967,655
Total vlera me TVSH	146,378,470					
Total Vlerë e tatueshme	121,982,058					
Total TVSH	24,396,412					

Nga kryqëzimi i të dhënave rezulton se subjekti investitor “T” Sh.p.k, ka deklaruar blerje situacione punimesh ndërtimi nga subjekti ndërtues “T. T” Sh.p.k, për peiudhën korrik-shtator 2021, në vlerë të tatueshme 121,982,058 lekë, ndërkohë që nga Raport Ekspertimi sipas inxhinierit vlera faktike e volumit të punimeve të kryera për peiudhën korrik-shtator 2021 është 78,052,008 lekë.

Duke marrë në konsideratë shpenzimet plotësuese dhe fitimin e shoqërisë në masën maksimale 10% apo 7,805,200 lekë (10%*78,052,008), vlera totale e situacioneve duke përfshirë shstrukturat, pa TVSH, është 85,857,208 lekë, si rrjedhim diferenca ndërmjet blerje situacione punimesh ndërtimi të deklaruara nga subjekti dhe vlerës faktike të volumit të punimeve të kryera në Raport Ekspertimi sipas inxhinierit është **36,124,850 lekë** (121,982,058 lekë- 85,857,208 lekë).

Sa sipër konstatohet se është mbivlerësuar zëri “Investime brenda vendit me TVSH 20%”, në vlerën **36,124,850 lekë**, duke rritur në mënyrë të padrejtë tepricën kreditore të TVSH-së në vlerën 7,224,970 lekë (36,124,850 lekë * 20%), për peiudhën korrik-shtator 2021. Në zbatim të përcaktimeve të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e

Shqipërisë” i ndryshuar , neni 68 “Vleresimi tatimor” pika 4 dhe 5/b dhe neni 124, subjektit i lundin detyrime si më poshtë:

Detyrim për TVSH- 7,224,970 lekë

Penalitet 100% -..... 7,224,970 lekë

Totali detyrimi=.....14,449,940 lekë

-Në përfundim për tatimpaguesin “I. D.” Sh.p.k., ka rezultuar detyrim në vlerën totale **14,449,940 lekë** (nga të cilat 7,224,970 lekë detyrim për TVSH detyrim tatim fitimi + 7,224,970 gjobë).

Tatimpaguesi: “SH”

Nipti: LJ

Adresa kryesore: Rruga Nacionale, Vlorë-Fier, Lagja Novosolë, Objekt nr. 42/18-ND, Novoselë, Vlorë

Aktiviteti: “Tregti me pakice e shumice e karburantit. Tregeti me pakice e shumice mallra ushqimore. Bar-Kafe.”

Inspektori: E H

Përgjegjës Sektori: I K

Drejtor Kontroll: B P

Drejtori Rajonal: S K

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH-periodha tatimore nga 10/2020-09/2022

- Për Tatim-Fitimin periodha tatimore: -2020-2021

- Për Sigurimet Shoqërore e shëndetësore-periodha tatimore nga 05/2021-04/2022

- Të tjera periodha tatimore: deri në 2022/04

- Orë pune: 44 orë

▪ Njoftimi i kontrollit është bërë në datë 27.12.2022, ndërkohë që kontrolli në subjekt ka filluar në datë 16.01.2023, pra nuk është repsektuar afati 30 ditor në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 81, pika 1.1 dhe përcaktimet në programin e kontrollit nr. 5633/2 prot, datë 29.06.2022, ku është vendosur afati i fillimit të kontrollit në subjekt data 01.08.2022.

- Në sistemin C@TS mungon Raporti Përfundimtar i Kontrollit, gjithashtu Njoftimi i Kontrollit nuk është hedhur brenda ditës së nesërme të punës nga momenti që janë mbajtur, jo në përputhje me përcaktimet e Manualin të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.

- Formulari 3-nuk është hedhur në sistemin C@TS, nënshkrim nga Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori Rajonal nuk ka datë, jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2.

- Raporti nuk ka të bashkangjitur si pjesë përbërëse të tij “Formulari-pyetësor i vetë deklarimit para kontrollit”, jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6.

▪ Është bërë kontrolli i TVSH për periudhën objekt kontrolli dhe krahasimi ndërmjet treguesve sipas FDP-ve dhe të dhënave të Sistemit Informatik, Librave të Blerje, Shitjeve dhe faturave përkatëse.

▪ Është bërë evidentimi i blerjeve sipas origjinës, blerje brenda vendit dhe i blerjeve që i shërbejnë shitjeve të përjashtuara, por nuk është bërë trajtimi i detajuar me sasi dhe vlerë sipas blerjeve për çdo furnitor.

- Për periudhën Tetor 2020-Shtator 2022, është bërë bilanci material vetem për artikujt benzin dhe naftë dhe jo për artikujt ushqimor. Për artikujt naftë dhe beznin në Raport Kontrolli nuk evidentohet se nga janë marrë të dhënat për sasit në fillimi të periudhës 30.09.2020, sipas sqarimeve nga inspektori i kontrollit të dhënat për gjëndjen e dy artikujve janë marrë bazuar në të dhëna të paraqitura nga vetë tatimpaguesi, gjithashtu nuk administrohen të dhëna për sasit në shitje dhe në blerje të produkteve naftë dhe beznin sipas furnitorëve por vetëm në vlera, fakt që e bën të vështirë nxjerrjen e konkluzioni për saktësinë dhe vërtetësinë e bilancit material të deklaruar nga tatimpaguesi. Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e programit të kontrollit pika 1/5 dhe Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.5, Kapitulli VIII, pika 8.

- Nga analiza e blerjeve për periudhën Janar-Shtator 2022, konstatohet se shoqëria ka kryer blerje të materialeve të ndërtimit “pllaka”, por nuk provohet që këto materiale të jenë përdorur për mirëmbajtjen e aktiveve të shoqërisë nga të cilat gjenerohen të ardhura të tatueshme apo të jenë tregtuar.

Ligji 92/2014 “Per TVSH-ne” i ndryshuar, kreu IX, seksioni I, percakton lindjen dhe aplikimin e të drejtës së zbritjes së TVSH-së, ku konkretisht në nenin 69, pika 1 sanksionohet se: *“Personi i tatueshëm gëzon të drejtën që të zbresë nga TVSH-ja e llogaritur për transaksionet e tatueshme shumat e mëposhtme të TVSH-së, në masën që furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të marra përdoren nga personi i tatueshëm në funksion të këtyre transaksioneve të tatueshme”*.

Në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 68 “Vleresimi tatimor” pika 4 dhe 5/b dhe nenit 115, subjektit i linden detyrimet për mosnjohjen e TVSH-së së zbritshme për materialet e ndërtimit në vlerë të tatueshme 121,325 lekë dhe TVSH të zbritshme 24,261 lekë. Konkretisht si më poshtë:

Detyrim për TVSH-24,261 lekë

Penalitet 20% -.....4,852 lekë

Totali detyrimi=.....29,113 lekë

- Nga kontrolli për zbatimin e kërkesave të ligjit Nr. 9136 datë 11.02.2003 “Për mbledhjen e detyrueshme të kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore”, kanë rezultuar problematikat si më poshtë:

- Nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor nuk janë analizuar kontratat individuale të punës midis shoqërisë dhe punonjësve, në lidhje me përputhshmërinë e tyre me përcaktimet e dispozitave të Kodit të Punës në R.SH.

- Nuk janë analizuar regjistrat që duhet të mbajë tatimpaguesi sipas përcaktimeve të nenit 15 “Mbajtja e regjistrimeve” të Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Nuk ka një analizë të llogaritjes së pagës dhe elementëve përbërës të saj sipas përcaktimeve të dispozitave të nenit 119 të Kreut XI të Kodit të Punës në R.SH.

- Janë konstatuar parregullësi në llogaritjen e ditëve dhe orëve të punës dhe pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore.

- Nga kontrolli i listë pagesave të subjektit të deklaruar në sistemin C@ts për periudhën 11/2020-03/2022, ka rezultuar se shoqëria ka deklaruar për punonjësit 26 ditë pune që është në tejkalim të kohëzgjatjes normale të punës prej 174 orë në muaj ose 22 ditë pune, pa ndryshuar pagën minimale dhe pagesa për ditët shtesë duhet të kryhet me një shtesë jo më pak se 25% të pagesës të ditës normale sipas përcaktimeve të Kreut IX të Kodit të Punës në R.SH.

- Gjithashtu referuar natyrës së aktivitetit që ushtron ky tatimpagues *“Tregti me pakice e shumice e karburantit”* dhe orarve të ushtrimit të aktivitet ta pandërprerë gjatë një ditë 24 orë, si dhe gjatë

ditëve të pushimi e shtunë dhe e djelë, konstatohet se nuk është bërë një analizë për deklarimin e pagave reale me qëllim llogaritjen dhe pagesën detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Theksojmë se fenomeni i mosdeklarimit të pagave reale shoqërohet me pasoja sociale për të punësuarit, ndikimin në zhvillimin ekonomik të vendit si dhe pasoja të drejtëpërdrejta në skemën e pensioneve, duke sjellë uljen e ndjeshme të nivelit të pensionit në raport me pagën mesatare që ka vendi.

-Në mungesë të të dhënave për regjistrat që duhet të mbajë tatimpaguesi, për efekt të llogaritjes së ditëve dhe orëve të punës për pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe natyrës së aktivitetit që ushtron ky tatimpagues, kontatohen diferencat si më poshtë:

a) Rasti 1

Fasha orare 19⁰⁰-22⁰⁰, shtesë mbi pagë 20% sipas përcaktimeve të Kodit të Punës, i ndryshuar, Kreu IX, Nenit 81, pika 1.

Diferenca në pagë bruto për 1 muaj është: $(3 \text{ orë} * 22 \text{ ditë} * 172.4 \text{ lekë/paga orare} * 0.2 \text{ shtesë page}) = 2275 \text{ lekë.}$

b) Rasti 2

Fasha orare 22⁰⁰-06⁰⁰, shtesë mbi pagë 50% sipas përcaktimeve të Kodit të Punës, i ndryshuar, Kreu IX, Nenit 81, pika 1.

Diferenca në pagë bruto për 1 muaj është: $(8 \text{ orë} * 22 \text{ ditë} * 172.4 \text{ lekë/paga orare} * 0.5 \text{ shtesë page}) = 15,171 \text{ lekë}$

c) Rasti 3

Dita e djelë, shtesë mbi pagë 25%, sipas përcaktimeve të Kodit të Punës, i ndryshuar, Kreu IX, Nenit 87, pika 1.

Diferenca në pagë bruto për 1 muaj është: $(96 \text{ orë} (4 \text{ ditë punë}) * 172.4 \text{ lekë/paga orare} * 0.25 \text{ shtesë page}) = 4137 \text{ lekë.}$

Në lidhje me situatën e trajtuar më sipër grupi i audituesve gjykon se janë arsye themelore për të kryer rivlerësimin e pagave, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, për punonjësit me paga të deklaruara jo konform përcaktimeve të legjislacionit, në lidhje me këtë tatimpaguesi i cili ka plotësuar deklarata tatimore që përmbajnë të dhëna të pasakta ose të falsifikuara dhe nuk mban dhe ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve, veprime të cilat janë në kundërshtim me *germën b, c të nenit 71, gërma a e nenit 72 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.24 date 02.09.2008, i ndryshuar në zbatim të tij, ku përcaktohet se:*

Neni 71 “E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi” i Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, konkretisht pika:

b) deklarata tatimore përmban të dhëna të pasakta ose të falsifikuara;

c) tatimpaguesi nuk mban ose ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve;

Neni 72 “Baza e mënyrave alternative të vlerësimit”:

1. Mënyrat alternative të vlerësimit nuk kufizohen, por bazohen në:

a) të dhëna të drejtëpërdrejta, që gjenden në deklaratat tatimore ose në dokumentet apo në një informacion tjetër, dhënë nga tatimpaguesi;

Penalizmi i subjektit duhet të ishte bërë sipas llogaritjeve të mëposhtme në bazë të pikës 3 të nenit 119 “Mosdeklarimi i punonjësve dhe fshehja e pagës” të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008

“Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, ku përcaktohet qartë se: “Nëse nga verifikimi dhe kontrolli rezulton se tatimpaguesi ka fshehur dhe nuk ka deklaruar pagën e saktë të përfituar nga punëmarrësi, si rezultat i marrëdhënies së punësimit, tatimpaguesi-punëdhënës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimit tatimor dhe kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të llogaritur për gjithë periudhën që provohet se është kryer shkelja, dënohet me gjobë në masën 100 për qind të detyrimit dhe kontributit të llogaritur”.

Muaj	Diferenca Rasti 1	Diferenca Rasti 2	Diferenca Rasti 3	Total Diferenca pagë bruto
Tetor 2020- Shtator 2022	54,600	364,104	99,288	517,992
Total				

Nr	Emërtimi	Vlera
1	Efekti shtese ne page bruto rivleresuar	517,992
2	Diferenca Sig Shoq Punëmarrësi (9.5%)	49,209
3	Diferenca Sig Shënd Punëmarrësi (1.7%)	8,805
4	Diferenca Sig Shoq Punëdhënësi (15%)	77,698
5	Diferenca Sig Shënd Punëdhënësi (1.7%)	8,805
6	Detyrimi per sigurimet shoqerore dhe shendetesore [(2)+(3)+(4)+(5)]	144,517
7	Gjobë Sig Shoq dhe shendetesore (100%)	144,517
8	Total detyrimi	289,034

-Në përfundim për tatimpaguesin “SH”, ka rezultuar detyrim në vlerën totale 318,167 lekë (nga të cilat 144,517 lekë detyrim për Sig.Shoqërore dhe Shëndetsore, 24,261 lekë detyrim për TVSH dhe 149,369 gjobë).

Tatimpaguesi: “S”

Nipti: KM

Adresa kryesore: Vlore, Selenice

Aktiviteti: “Nxjerrja, perpunimi dhe tregtimi i qymyrit bituminoz, bitumit te paster, dolmitit kokerr. Transportimi, qe perfshin transportimin kombetar dhe nderkombetar te mallrave per vet shoqerine dhe per llogari te te treteve, per import dhe per eksport. Veprimtari eksportuese dhe importuese, ku futen eksporti i lendeve te para dhe i mallrave e materialeve te te gjitha llojeve. Veprimtari tregtare, ku perfshihet tregtimi me shumice dhe pakice i mallrave, i pasurive te luajtshme e te paluajtshme, etj., (vazhdon edhe më tepër sipas përshkrimit të QKB-së).”

Inspektori: D B

Përgjegjës Sektori: I K

Drejtor Kontroll: B P

Drejtori Rajonal: S K

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për rimbursimin e TVSH-periudha tatimore nga 01/2020-05/2021

- Orë pune: 16 orë

Nga auditimi ka rezultuar se:

▪ Subjekti “S” Sh.p.k. me NIPT KM ka paraqitur pranë Drejtorisë së rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, kërkesën datë 22.11.2021 për rimbursim TVSH-je, që i përket periudhës Janar 2020-Maj 2021.

Sipas shkresës së DPT-së nr. 21188/2 prot, datë 13.02.2021 protokolluar në DRT Vlorë me nr.8995 prot, datë 15.12.2021, është miratuar kontrolli për rimbursimit të TVSH-së që përfshin periudhën 01.01.2020 deri 31.05.2021, sipas kërkesës së subjektit “Për rimbursim TVSH-je në shumën 13,819,786 lekë.

- Njoftimi i Kontrollit nuk është hedhur brenda ditës së nesërme të punës nga momenti që janë mbajtur, Formulari 3-nuk është hedhur në sistemin C@TS, nuk ka nënshkrim nga Përgjegjësi i Sektorit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori Rajonal, Raporti i Kontrollit nuk ka të bashkangjitur si pjesë përbërëse të tij “Formulari-pyetësor i vetë deklarimit para kontrollit”, veprime këto jo në përputhje me përcaktimet e Manualin të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6, pika 2.2.

- Është kryer kontrolli i TVSH-së, analiza e shitjeve, librat e shitjeve, analiza e blerjeve, librat e blerjeve, deklarimi në sistem, janë analizuar klientët dhe furnitorët kryesorë.

- Është bërë analiza e kostos së çmimit të shitjes për periudhën objekt kontrolli, nga ku rezultojnë se çmimet e shitjes si brenda vendit si dhe në eksport janë më të larta se kosto e prodhimit të tyre.

- Është bërë kontrolli i eksporteve dhe importeve, janë sqaruar në mënyre analitike diferencat ndërmjet të dhënave të deklaruara nga shoqëria dhe atyre të deklaruara nga dogana, për periudhën objekt kontrolli.

- Janë analizuar treguesit e pagesës apo tepricës kreditore të TVSH-së, është kryer zbërthimi e analiza e komponentëve të TVSH-së, është përcaktuar prejardhja e tepricës së TVSH-së kreditore në fund të periudhës.

- Është bërë bilanci material nga data 01.01.2020 deri në datën 31.07.2021, ku sipas të dhënave të paraqitura në Raport Kontrolli dhe deklarimeve të tatimpaguesit në sistemin C@ts nuk kanë rezultuar diferenca.

- Bilanci material është bërë për periudhën 01.01.2020-31.07.2021, ndërkohë që kërkesa për rimbursimin e TVSH sipas njoftimit për kontroll dhe programit të kontrollit është për periudhën Janar 2020-Maj 2021. Sa sipër rezulton se janë 2 muaj Qershor-Korrik 2021 për të cilat është bërë kontrolli i bilancit material por që nuk është përcaktuar në program kontrolli, në kundërshtim me përcaktimet e Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1, germa a, ku citohet “*Njoftimi i kontrollit tatimor përmban periudhën ose periudhat tatimore, për të cilat kryhet kontrolli tatimor*”.

- Në Raport Kontrolli nuk është bërë analiza e kartës teknologjike për të rakorduar për sasinë e prodhuar për produktet Bitum Natyral, Bitum i pastruar bllok, Bitum fraksionuar, Bitum Raë(natyral), Qymyr nga karriera si dhe sasinë në dalje për prodhim bitumi/dhe/ose djegje, gjithashtu nuk administrohen të dhëna për sasinë në shitje dhe në blerje të produkteve por vetëm në vlera, çka e bën të paqartë metodologjinë e kontrollit të aplikuar në këtë rast nga Inspektori i Kontrollit në kundërshtim me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli VIII, pika 8.

Gjithashtu karta teknologjike e paraqitur nga inspektori tatimor nuk është e miratuar nga organet shtetërore përkatëse në kundërshtim me përcaktimet e bëra në VKM nr. 434, datë 20.05.2015 “Për përcaktimin e normativave për humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë prodhimit, magazinimit, transportimit etj., të njohura për qëllime fiskale”, neni 4, 7, 8 dhe 9.

- Nga subjekti janë deklaruar si “*autofaturime punime zbulimit sipas 3 mujoreve*”, për vitin 2020 në vlerë të tatueshme 17,935,369 lekë dhe TVSH 3,587,074 lekë dhe për vitin 2021 në vlerë të tatueshme 9,142,948 lekë dhe TVSH 1,828,590 lekë. Në Raportin Përfundimtar të Kontrollit nuk është analizuar çfarë përfaqësojnë “*autofaturime punime zbulimit sipas 3 mujoreve*”, nuk ka të dhëna si kanë dalë këto vlera, zërat e punimeve që janë kryer, çfarë dokumentacioni shoqëruar

dhe justifikues është kontrolluar nga Inspektori për të saktësuar vlerën e këtyre punimeve, mungon analiza për situacionet në lidhje me hyrjet dhe sasinë e situacionuar në dalje, nuk ka të dhëna nëse kanë qenë objekt kontrolli nga institucione të tjera kompetente si AKBN etj, dhe a janë administruar këto raporte kontrolli nga Inspektori. Këto autofatura të hartuara nga ana e tatimpaguesit nuk rezultojnë të jenë të detajuara në raportin e kontrollit tatimor. Sipas shpjegimit të inspektorit tatimor ato përfshijnë situacione për punime të realizuara për nxjerrjen e mineralit, “*për zbulime në karrierë*”, të cilat janë trajtuar si investime.

Nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor nuk rezulton të jetë kryer një kontroll i këtyre situacioneve në mënyrë analitike se çfarë kanë pasur të përfshirë, në elementët e materialeve të para, koston së punës direkteve dhe shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit (ku përfshihen material indirekte, puna indirekte dhe shpenzime të tjera), për të gjykuar me komponentët e secilit situacion dhe krahasimin me blerjet e tatueshme.

Nga ana tjetër, nga inspektori tatimor, konstatohet se nuk është kryer një analizë në lidhje me plotësimin e kushteve për klasifikimin e këtyre operacioneve të realizuara nga tatimpaguesi si investime apo jo referuar kërkesave të legjislacionit fiskal dhe standarteve të raportimit financiar. Mungesa e analizës dhe trajtimi i gabuar nuk janë në përputhje me përkesat ligjit për kontabilitetin dhe standarteve në zbatim të tij, konkretisht SKK 5 “*Aktivitet afatgjatë materiale dhe jomateriale*” ku përcaktohet: Njësia ekonomike njih koston e një zëri të AAM-ve si një aktiv nëse dhe vetëm nëse:

(a) aktiviteti kontrollohet nga njësia ekonomike;

(b) është e mundur që nga përdorimi i aktivitetit do të hyjnë në njësinë ekonomike përfitime të ardhshme ekonomike;

(c) kostoja e aktivitetit mund të matet me besueshmëri.

Regjistrimi fillestar i AAM-së bëhet zakonisht në momentin e përfundimit të tij nga blerja apo prodhimi.

Kjo pasi nga ana Inspektorit në Raport Kontrolli nuk është detajuar lloji i investimit për punime në karrierë dhe nëse këto punime do të kontribuojnë në sjelljen e përfitimeve të ardhshme ekonomike në mënyrë që të plotësohen kushtet për njohjen e tyre si aktiv në kontroll të njësive ekonomike.

Nuk rezulton të jetë kryer një analizë në lidhje me licencat e kërkimit apo zbulimit të tatimpaguesit dhe klasifikimi i tyre si shpenzime kërkimore të cilat nuk plotësojnë kushtet për njohjen si aktiv (investim) apo shpenzime zhvillimi (të cilat kapitalizohen në aktiv të pasqyrave financiare dhe plotësojnë kushtet për njohjen si investim). Për më tepër, referuar dispozitave të Udhëzimit nr.6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, situacionet, referohen të përdoren në fushën e punimeve të ndërtimit, sipas përcaktimeve të nenit 20 “Punimet e ndërtimit”, ndërkohë që tatimpaguesi nuk është i licencuar për punime ndërtimore dhe ushtron veprimtarinë sipas objektit të tij në fushën e nxjerrjes së mineraleve. Për rrjedhojë, trajtimi i autofaturimeve me anë të situacioneve, për operacionet e paraqitura të nxjerrjes së mineralit paraqitet i gabuar sipas kuadrit të raportimit financiar dhe atij fiskal. Grupit të auditimit, këto situacione nuk iu vendosën në dispozicion në mënyrë që të gjykohej në lidhje me komponentët e përfshirë në të, si përfshirja e koston së punës në situacion dhe shpenzimet e tjera të përgjithshme të prodhimit.

-Nga problematikat e evidentuara në raportin e kontrollit përfshihen gjithashtu mungesa e analizimit të koston së mallrave të raportuara nga tatimpaguesi, e cila rezulton të jetë marrë e mirëqenë nga ana e inspektorit tatimor, pasi nuk rezulton të jetë kryer një analizë në lidhje me

komponentët e koston së paraqitur në raport kontrolli referuar koston së materialeve të para si dhe procesi të prodhimit.

Mungesa e analizës dhe trajtimi i gabuar nuk janë në përputhje me përkesat ligjit për kontabilitetin dhe standarteve në zbatim të tij, konkretisht SKK 4 “Inventarët” ku përcaktohet “...15. Njësitë ekonomike që merren me prodhim produktesh duhet të përcaktojnë koston e inventarit të tyre. Kostoja e inventarit duhet të përfshijë të gjitha kostot e blerjes, kostot e shndërrimit/prodhimit dhe kostot që lidhen me sjelljen e inventarit në kushtet dhe vendndodhjen ekzistuese. Metoda të bazuara në koston direkte ku të gjitha shpenzimet indirekte futen në shpenzimet e periudhës nuk lejohen. Kostot indirekte duhet t’i ngarkohen inventarit pavarësisht se si klasifikohen ato nga njësia ekonomike.

....16. Shembuj të shpenzimeve që nuk mund të përfshihen në koston e inventarit janë dhënë më poshtë: (a) shpenzimet e punëve kërkimore (b) shumat mbi normalen nga dëmtimet, firot, kostot e prodhimit dhe të punës, penaltete dhe të tjera të ngjashme; (c) shpenzimet e shitjes (d) shpenzimet e përgjithshme të administrimit që nuk kontribuojnë në sjelljen e inventarëve në vendndodhjen dhe kushtet aktuale.”

Nga auditimi konstatohet se nga ana e inspektorit tatimor nuk është shkëmbyer informacion apo të jenë marrë konfirmime nga AKBN në lidhje me treguesit e inventarit të raportuar të nxjerrë apo investimet e realizuara përgjatë periudhës objekt kontrolli, por janë marrë të mirëqena deklaratimet e tatimpaguesit. Në këtë mënyrë nuk është arritur siguri në lidhje me sasinë e nxjerra/përpunuara dhe shitura drejt palëve të treta apo investimet e pretenduara me anë të vetëfaturimeve, të cilat vazhdimisht kanë krijuar një tepriçë kreditore të tvsh-së.

▪ Në Raportin Përfundimtar të Kontrollit nuk është bërë analiza për blerjet e tatueshme në lidhje me kredine apo leasing, për vitin 2020 në vlerën 2,698,139 lekë dhe periudhën Janar-Korrik 2021 në vlerën 1,540,486 lekë, çfarë përfaqësojnë këto blerje. Sipas shpjegimeve të Inspektorit të Kontrollit marrja e kredive është bërë me qëllim investimin për blerje pajisje dhe makinerie, por nuk u paraqit dokumentacion justifikues në dispozicion të Grupit të Auditimit, si kontrata, faturë blerje, dokumente zhdoganimi etj, se çfarë pajisjes apo makinerie janë blerë me kredit e marra.

Tatimpaguesi: “F”

Nipti: KH

Adresa kryesore: Rruga Hasan Kushta, Lagja Pavarësia, Kompleksi “G. T.”, Kati pare Vlorë
Aktiviteti: “Tregti me shumice e artikujve farmaceutik”

Inspektori: J F

Përgjegjës Sektori: I K

Drejtor Kontroll: B P

Drejtori Rajonal: S K

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH-në, periudha Korrik 2020-Maj 2022.
- Për Tatim Fitimin, vitet 2020-2021.
- Për Sigurimet shoqerore dhe shendetsore periudha Korrik 2020-Maj 2022.
- Të tjera: deri 2022/05
- Orë pune: 134 orë

▪ Formulari 3 nuk është nënshkruar nga Inspektori, Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori Rajonal, jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2.

- Është bërë kontrolli i TVSH për periudhën objekt kontrolli dhe krahasimi ndërmjet treguesve sipas FDP-ve dhe të dhënave të Sistemit Informatik, Librave të Blerje, Shitjeve dhe faturave përkatëse, ku nuk kanë rezultuar diferenca.
- Është bërë evidentimi i blerjeve sipas origjinës, importe, blerje brenda vendit dhe i blerjeve që i shërbejnë shitjeve të përjashtuara. Në Raport Përfundimtar Kontrolli nuk ka asnjë të dhënë për klientët dhe furnitorët, nuk është bërë analiza e detajuar për blerjet, duke analizuar furnitorët për secilin zë të blerjeve, nuk përcaktohet se çfarë përfaqësojnë këto blerje dhe nëse janë në funksion të aktivitetit ekonomik që ushtron tatimpaguesi në kundërshtim me përcaktimet e programit të kontrollit nr. 6147/2 prot, datë 03.08.2022.
- Është bërë analiza e kostos së çmimit të shitjes për periudhën objekt kontrolli, nga ku rezultojnë se çmimet e shitjes së medikamenteve janë më të larta se kosto e blerjes së tyre.
- Është kryer kontrolli për tatimin në burim ku bazuar në kontratat noteriale të qerave janë zbatuar kërkesat e çmimeve të referencës dhe për rrjedhojë zbatimi i VKM nr.469, datë 03.06.2015 “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”.
- Për periudhën Korrik 2020-Maj 2022, është bërë bilanci material vetëm për 10 medikamente, ndërkohë sipas inventarit të deklaruar nga tatimpaguesi në datë 31.12.2020, numri i medikamente është 3887 dhe në datë 31.12.2021 numri i medikamente është 2932. Nga inspektori i kontrollit nuk është përcaktuar se si është përzgjedhur kampioni për realizimin e bilancit material, nuk ka të dhëna se nga është marrë gjëndja fizike e medikamenteve në datën 01.07.2020, sipas sqarimeve nga inspektori i kontrollit të dhënat për gjëndjen e medikamenteve janë marrë bazuar në të dhënat të paraqitura nga vetë tatimpaguesi. Gjithashtu në raport kontrolli nuk ka të dhëna për sasinë në hyrje dhe dalje për çdo medikament gjatë periudhës objekt kontrolli, fakt që e bën të pamundur nxjerrjen e konkluzionit për saktësinë dhe vërtetësinë e bilancit material të deklaruar nga tatimpaguesi. Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e programit të kontrollit nr. 6147/2 prot, datë 03.08.2022, pika 1/5 dhe Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.5, Kapitulli VIII, pika 8.
- Nga kontrolli për zbatimin e kërkesave të ligjit Nr. 9136 datë 11.02.2003 “Për mbledhjen e detyrueshme të kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore”, kanë rezultuar problematikat si më poshtë:
 - Nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor nuk janë analizuar kontratat individuale të punës midis shoqërisë dhe punonjësve, në lidhje me përputhshmërinë e tyre me përcaktimet e dispozitave të Kodit të Punës në R.SH.
 - Nuk janë analizuar regjistrat që duhet të mbajë tatimpaguesi sipas përcaktimeve të nenit 15 “Mbajtja e regjistrimeve” të Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
 - Nuk ka një analizë të llogaritjes së pagës dhe elementëve përbërës të saj sipas përcaktimeve të dispozitave të nenit 119 të të Kreut XI të Kodit të Punës në R.SH.
 - Janë konstatuar parregullësi në llogaritjen e ditëve dhe orëve të punës dhe pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore.
 - Nga kontrolli i listë pagesave të subjektit të deklaruar në sistemin C@ts për periudhën 11/2020-03/2022, ka rezultuar se shoqëria ka deklaruar paga të ndryshme për të njëjtën kategori punonjësish *Kategoria 2262.01-Farmacist*, për të cilët procesi i punës është i njëjtë, gjithashtu referuar natyrës së aktivitetit që ushtron ky tatimpagues “*Farmaci*” dhe orareve të ushtrimit të aktivitetit gjatë një dite pune si dhe gjatë ditëve të pushimit e shtunë dhe e djelë, konstatohet se nuk është bërë një analizë për deklarimin e pagave reale me qëllim llogaritjen dhe pagesën

detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Theksojmë se fenomeni i mosdeklarimit të pagave reale shoqërohet me pasoja sociale për të punësuarit, ndikimin në zhvillimin ekonomik të vendit si dhe pasoja të drejtëpërdrejta në skemën e pensioneve, duke sjellë uljen e ndjeshme të nivelit të pensionit në raport me pagën mesatare që ka vendi.

-Në lidhje konstatimin e parë për deklarimin e gabuar të pagave për të njëjtën kategori punonjësish *Kategoria 2262.01-Farmacist*, nga inspektori janë bërë rivlerësimet përkatëse në Raportin Përfundimtar të Kontrollit duke nxjerrë dhe njoftim vlerësimet për detytrimet e konstatuara.

Ndërkohë në lidhje me konstatimin për llogaritjen e shtesës mbi pagë, në mungesë të të dhënave për regjistrat që duhet të mbajë tatimpaguesi, për efekt të llogaritjes së ditëve dhe orëve të punës për pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe referuar natyrës së aktivitetit që ushtron ky tatimpagues, konstatohen diferencat si më poshtë:

a) Rasti 1

Fasha orare 19⁰⁰-22⁰⁰, shtesë mbi pagë 20% sipas përcaktimeve të Kodit të Punës, i ndryshuar, Kreu IX, Nenit 81, pika 1.

Diferenca në pagë bruto për 1 muaj është: $(3 \text{ orë} * 22 \text{ ditë} * 172.4 \text{ lekë/paga orare} * 0.2 \text{ shtesë page}) = 2275 \text{ lekë}$.

b) Rasti 2

Dita e djelë, shtesë mbi pagë 25%, sipas përcaktimeve të Kodit të Punës, i ndryshuar, Kreu IX, Nenit 87, pika 1.

Diferenca në pagë bruto për 1 muaj është: $(96 \text{ orë} (4 \text{ ditë punë}) * 172.4 \text{ lekë/paga orare} * 0.25 \text{ shtesë page}) = 4137 \text{ lekë}$.

Në lidhje me situatën e trajtuar më sipër grupi i audituesve gjykon se janë arsye themelore për të kryer rivlerësimin e pagave, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, për punonjësit me paga të deklaruara jo konform përcaktimeve të legjislacionit, në lidhje me këtë tatimpaguesi i cili ka plotësuar deklarata tatimore që përmbajnë të dhëna të pasakta ose të falsifikuara dhe nuk mban dhe ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve, veprime të cilat janë në kundërshtim me *germën b, c të nenit 71, gërma a e nenit 72 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.24 date 02.09.2008, i ndryshuar në zbatim të tij,*

Penalizmi i subjektit duhet të ishte bërë sipas llogaritjeve të mëposhtme në bazë të pikës 3 të nenit 119 “Mosdeklarimi i punonjësve dhe fshehja e pagës” të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar.

Muaj	Diferenca Rasti 1	Diferenca Rasti 2	Total Diferenca pagë bruto
Korrik 2020-Maj 2022	47,775	86,877	134,652
Total	134,652		

Nr	Emërtimi	Vlera
1	Efekti shtese ne page bruto rivleresuar	134,652
2	Diferenca Sig Shoq dhe Shende (27.9%)	37,566
6	Detyrimi per sigurimet shoqerore dhe shendetesore	37,566
7	Gjobë Sig Shoq dhe shendetesore (100%)	37,566
8	Total detyrimi	75,132

-Në përfundim për tatimpaguesin “F. V.” Sh.p.k., ka rezultuar detyrim në vlerën totale 75,132 lekë (nga të cilat 37,566 lekë detyrim për Sig.Shoqërore dhe Shëndetsore dhe 37,566 gjobë).

Tatimpaguesi: “T”

Nipti: KË

Adresa kryesore: Lagja 11 Janari, Pusi Mezinit, Vlorë

Aktiviteti: “*Prodhim dhe përpunim i mishit*”

Inspektori: R K

Përgjegjës Sektori: I K

Drejtor Kontroll: B P

Drejtori Rajonal: S K

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH-në, periudha 09/2015-08/2020
- Për Tatim Fitimin, vitet 2015-2019
- Për Sigurimet shoqërore dhe shendetësore periudha 09/2015-08/2020
- Të tjera: deri 2022/05
- Orë pune: 260 orë

- Raporti nuk ka të bashkangjitur si pjesë përbërëse të tij “Formulari-pyetësor i vetë deklarimit para kontrollit”, jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6.
- Formulari 3- nuk administrohet në dosjen e kontrollit, jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2.
- Nuk është bërë analiza e detajuar e shitjeve për një grup artikujsh, në kundërshtim me përcaktimet e programit të kontrollit nr. 2961/2 prot, datë 31.03.2022.
- Është bërë kontrolli i TVSH për periudhën objekt kontrolli dhe krahasimi ndërmjet treguesve sipas FDP-ve dhe të dhënave të Sistemit Informatik, Librave të Blerje, Shitjeve dhe faturave përkatëse, ku nuk kanë rezultuar diferenca.
- Është kryer analiza e zërave të bilancit kontabël si aktivet, detyrimet dhe kapitali i vet për periudhën objekt kontrolli, sipas përcaktimit të programit të kontrollit.
- Është kryer analiza e rezultatit financiar dhe analiza e zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas përcaktimit të programit të kontrollit.
- Është kryer kontrolli për sigurimet shoqërore dhe shendetësore për periudhën objekt kontrolli, nga ku rezulton se përgjithësisht janë zbatuar përcaktime ligjore.
- Është bërë evidentimi i blerjeve sipas origjinës, importe, blerje brenda vendit dhe i blerjeve që i shërbejnë shitjeve të përjashtuara. Në Raport Përfundimtar Kontrolli nuk ka asnjë të dhënë për klientët dhe furnitorët, nuk është bërë analiza e detajuar për blerjet, duke analizuar furnitorët për secilin zë të blerjeve, nuk përcaktohet se çfarë përfaqësojnë këto blerje dhe nëse janë në funksion të aktivitetit ekonomik që ushtron tatimpaguesi në kundërshtim me përcaktimet e programit të kontrollit nr. 2961/2 prot, datë 31.03.2022.
- Për periudhën objekt kontrolli, është bërë bilanci material vetëm për 10 artikuj, ndërkohë që sipas inventarit të deklaruar nga subjekti për periudhën objekt kontrolli, vetëm në vitin 2015 janë deklaruar 136 artikuj. Gjithashtu nga inspektori i kontrollit nuk është përcaktuar se si është përzgjedhur kampioni për realizimin e bilancit material, pasi në bilanc nuk janë përfshirë disa artikuj që kanë vlera më përfaqësuese si *pite exelent, mish i grire, pula, paketa, niseshte, kima* etj.

- Në Raport Përfundimtar Kontrolli nuk ka të dhëna për sasitë në hyrje dhe dalje për *çdo artikull* gjatë periudhës objekt kontrolli, fakt që e bën të vështirë nxjerrjen e konkluzionit për saktësinë dhe vërtetësinë e bilancit material të deklaruar nga tatimpaguesi.

- Në Bilancin e vitit 2017, në Inventarin e deklaruar në sistemin C@ts, nuk ka të dhëna për sasitë e artikujve gjëndje në datë 31.12.2017, por është paraqitur vetëm në vlerë totale.

▪ Në Raport Përfundimtar Kontrolli nuk ka asnjë të dhënë për procesin e prodhimit, nga Inspektori i Kontrollit nuk është bërë analiza dhe bilanc material për produktet që përdoren si lëndë e parë për procesin e prodhimit, mungon analiza për kartën teknologjike për të rakorduar për sasinë e prodhuar për produktet *sallam, salcice, proshut*, gjithashtu nuk administrohen të dhëna për sasitë në shitje dhe në blerje të produkteve por vetëm në vlera, çka e bën të paqartë metodologjinë e kontrollit të aplikuar në këtë rast nga Inspektori i Kontrollit në kundërshtim me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli VIII, pika 8.

- Në Raport Përfundimtar Kontrolli nuk evidentohet nëse tatimpaguesi ka kartë teknologjike të miratuar nga organet shtetërore përkatëse në kundërshtim me përcaktimet e bëra në VKM nr. 434, datë 20.05.2015 “Për përcaktimin e normativave për humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë prodhimit, magazinimit, transportimit etj., të njohura për qëllime fiskale”, neni 4 dhe 7.

- Nga analiza e bilancit material për vitin 2016 të paraqitur nga vetë inspektori i kontrollit, për 10 artikuj, duke e kryqëzuar me të dhënat e inventarit të deklaruar nga subjekti në sistemin C@ts, kanë rezultuar diferenca në disa artikuj.

Referuar përcaktimeve të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 68 pika 4 dhe 5/b, neni 124, Ligji Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 97, 101 dhe Udhëzimin Nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, pika 57.1, subjektit i linden detyrimet si më poshtë:

Nr	Emërtim	Njësi	Gjendje 01.01.2016 sipas R.K	Gjendje 01.01.2016 sipas deklarimit C@ts	Hyrje	Dalje	Gjendje kontabel 31.12.2016 sipas C@ts	Gjendje fizike	Diferenca	Kosto	Vlerë
1	Mish Derri	kg	35,780	35,780	24,700	35,800	24,677	24,680	3	315.11	945
2	Mish Pule	kg	5,047	5,047	7,202	7,105	5,141	5,144	3	184.96	554
3	Zogj	kg	955	955	10,847	9,365	2,437	2,437	0	218.61	0
4	Ardo bizele	copë	912	912	10	814	108	108	0	94.49	0
5	Pite	copë	4,478	4,478	270	3,790	0	958	958	9	8,622
6	Djath për pica	kg	49	49	9,800	9,838	10	11	1	349.26	349
7	Qumësht	copë	38	38	470	505	3	3	0	81.77	0
8	Fruta pylli	copë	91	29	480	562	9	-53	62	195.85	12,142
9	Amita	copë	23	23	437	448	12	12	0	60.04	0
10	Kofsha pule	kg	16,777	5,659	5,117	17,290	4,598	-6,514	11,112	142.26	1,580,793
TOTAL DIFERENCA NE VLERE TE TATUESHME											1,601,557
DETYRIM TVSH											320,311
GJOBE 100%											320,311
DETYRIM TF											240,233
GJOBE 100%											240,233
TOTAL DETYRIMI											1,121,088

▪ Nga analiza e blerjeve të realizuara nga subjekti për periudhën objekt kontrolli në zërin “Blerje të investimeve vendase me 20%” është deklaruar “Blerje punime riparimi”, si më poshtë:

Viti	EMËRTIM	VLERË TATUESHME
2018	Blerje punimesh riparimi	1,608,887
TOTAL		1,608,887

Nga ana inspektorit të kontrollit nuk është analizuar se çfarë investimesh janë bërë, çfarë përfaqësojnë këto punime, nëse janë punime ndërtimi dhe nëse është pajisur me leje ndërtimi për këto punime/deklaratë paraprake punimesh, i shërbejnë ose jo natyrës së aktivitetit që kryen

tatimpaguesi. Sa sipër subjekti ka deklaruar blerje investime vendase me TVSH 20% në vlerën totale 1,608,887 lekë, për të cilat nga administrohet dokumentacion shtesë (*fatura tatimore, situacione, preventiv punimesh etj*) që argumenton se këto investime i shërbejnë natyrës së aktivitetit që kryen tatimpaguesi si dhe mungon leja e ndërtimit për kryerjen e punimeve (*Deklarata paraprake punimesh*) sipas përcaktimeve të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të territorit“, Neni 7. Në zbatim të përcaktimeve të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 68 “Vleresimi tatimor” pika 4 dhe 5/b, neni 115, subjektit i linden detyrime si më poshtë:

Detyrim për TVSH (20%) - 321,777 lekë (1,608,887 *20%)

Penalitet 100% - 321,777 lekë

Totali **643,554 lekë**

Tatimpaguesi: “K”

Nipti: KS

Adresa kryesore: Lagja Pavaresia, Rruga “Sadik Zotaj”, Vlorë

Aktiviteti: “*Pregatitja e specialistëve të lartë dhe kryerja e kualifikimeve shkencore*”

Inspektori: E H

Përgjegjës Sektori: I K

Drejtor Kontroll: B P

Drejtori Rajonal: S K

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH-në, periudha 01/2018-12/2022

- Për Tatim Fitimin, vitet 2018-2021

- Për Sigurimet shoqërore dhe shendetësore periudha 01/2018-12/2022

- Të tjera: deri 12/2022

- Orë pune: 220 orë

Nga auditimi ka rezultuar se:

▪ Formulari 3-nuk është hedhur në sistemin C@TS, nuk ka nënshkrim nga Drejtori Rajonal i Kontrollit, jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2.

- Raporti nuk ka të bashkangjitur si pjesë përbërëse të tij “Formulari-pyetësor i vetë deklarimit para kontrollit”, jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6.

- Projekti Kontrolli është përfunduar në subjekt në datë 02.06.2023, ndërkohë Raporti Përfundimtar i Kontrollit është përfunduar në datë 04.07.2023, duke tejkaluar afatet nga përgatitja dhe dërgimi i Projekt Raporti deri në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit në subjekt, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1 dhe 4, Neni 84, pika 1.

▪ Nga kontrolli i faturave tatimore të shitjes për periudhën objekt kontrolli rezulton se qarkullimi i regjistruar i shoqërisë përfaqëson furnizimi i shërbimeve mësimdhënies universitare dhe kryerjen e kualifikimeve shkencore pasuniversitare. Në zbatim të ligjit 92/2014 “Për TVSH-në” i ndryshuar, nenit 51 germa (g), furnizimi i shërbimeve mësimdhënies shkollore apo universitare është furnizim i perjashtuar nga TVSH.

- Është bërë evidentimi i blerjeve sipas origjinës, blerje brenda vendit dhe i blerjeve që i shërbejnë shitjeve të përjashtuara.
- Është bërë kontrolli i TVSH për periudhën objekt kontrolli dhe krahasimi ndërmjet treguesve sipas FDP-ve dhe të dhënave të Sistemit Informatik, Librave të Blerje, Shitjeve dhe faturave përkatëse, ku ka rezultuar diferenca për vitin 2018 në vlerën 325,631 leke, për të cilat është bërë sistemimi i situatës nga Inspektori, duke zbritur vlerën e deklaruar nga shoqëria.
- Nga inspektori i kontrollit nuk është analizuar nëse është miratuar nga organet drejtuese tarifa e studimit për çdo program studimi, por është nxjerrë një vlerë mesatare për çdo vit si raport i numrit të përgjithshëm të studentëve me pagesat e kryera, gjithashtu është analizuar numri i studenteve bazuar vetëm tek të dhënat e vëna në dispozicion nga subjekti, duke mos kryqëzuar të dhënat e paraqitura nga subjekti me të dhënat zyrtare të raportuara çdo vit në MAS, si detyrim ligjor që ka çdo institucion i Arsimit të Lartë në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit Nr. 5, datë 19.2.2018 “Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për Raportim të Institucioneve të Arsimit të Lartë”, i ndryshuar.

Pika 1. *Për çdo vit akademik, institucionet e arsimit të lartë (IAL) paraqesin pranë Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, raportet vjetore për veprimtarinë e kryer.*

Pika 2. *Raportimi synon:*

a) *të paraqesë informacione të qarta dhe transparente të veprimtarisë së IAL-së në zbatim të misionit të tyre, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;*

b) *të ofrojë informacion për ministrinë mbi gjendjen financiare të institucionit, parashikimin për angazhimin e personelit akademik, tarifat e shkollimit për vitin në vijim, për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për secilin program studimi që ato ofrojnë, si dhe elemente të tjera që lidhen me shërbimet që IAL-ja ofron;*

Pika 4/A:

j) *Të dhëna mbi studentët si:*

i) *numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit;*

ii) *numrin e studentëve që ndjekin programe që përbëjnë prioritet kombëtar, të përcaktuar në dokumentin e prioriteteve të miratuar dhe të publikuar çdo vit nga ministria sipas drejtimeve kryesore.*

iv) *numrin e studentëve të çregjistruar ose të transferuar të shoqëruar me informacion mbi institucionin dhe programin e studimit të parë dhe programin e studimit ku transferohen;*

v) *numrin e studentëve që kanë përfutuar bursa dhe numrin e atyre që kanë përfutuar nga përjashtimi apo reduktimi i tarifave të shkollimit;*

Pika 4/B:

c) *Realizimin faktik të planit buxhetor të vitit paraardhës buxhetor sipas zërave të buxhetit, planin buxhetor të vitit pasardhës akademik, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik në vijim.*

d) *Dokumentacionin e shlyerjes së detyrimeve tatimore, si dhe të sigurimeve shoqërore e shëndetësore;*

Pika 5. *Në rastet kur IAL-ja nuk e dorëzon raportin vjetor, brenda afatit kohor të caktuar në këtë udhëzim, pa arsye të përlligjura, Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë kërkon marrjen e masave administrative nga organi kompetent, sipas legjislacionit në fuqi.*

Pika 6. *Në rastet kur Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë konstaton pavërtetësi në të dhënat e paraqitura të raportit vjetor nga IAL-të, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, vendos kushte*

ndaj IAL-së dhe/ose pezullon veprimtarinë e IAL-së, në rast se veprimi apo mosveprimi nuk përbën vepër penale.

Sa sipër mungesa e të dhënave zyrtare për tarifatat e miratuara dhe numrin e studentëve, paraqet pasiguri për vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave financiare të raportuara nga subjekti.

▪ Nga analiza e pasqyrave financiare të vitit 2018 në Aktivitet/Të drejta të arkëtueshme, zëri “Instrumenta të tjera borxhi” është deklaruar në vlerën 12,787,566 lekë, ndërkohë në pasqyrat financiare të vitit 2019, ky zë është deklaruar me vlerë 0. Nga ana inspektorit të kontrollit nuk është analizuar se çfarë përfaqëson ky zë, nuk është dhënë asnjë shpjegim në lidhje me krijimin e këtyre të ardhurave, nuk ka informacion nëse ka kontrata të lidhura midis palëve, afatet e huadhënies, mënyra e kryerjes së transaksioneve (me Banke apo Cash), etj. Gjithashtu nuk është bërë informacioni RAD (Raportim i Aktivitetit të Dyshimtë) në lidhje me shumatat e parave të cilat kanë kaluar si hua ortakut/apo individëve ndaj shoqërisë, veprime këto jo në përputhje me dispozitat e ligjit Nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit” i ndryshuar, neni 18.1 si dhe UMF Nr.16, datë 16.2.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, neni 5, pika 1 dhe 2.

▪ Vlera e aktiveve afatgjata materiale për vitin 2018 të paraqitura në Raport Përfundimtar Kontrolli është në vlerën 4,296,848 lekë, nuk përputhet me deklaratimet e subjektit sipas pozicionit financiar për vitin 2018, në të cilën është pasqyruar në vlerën 5,955,225 lekë. Nga ana inspektorit të kontrollit nuk është bërë analizë në Raport Kontrolli për këtë mospërputhje.

▪ Nga analiza e pasqyrave financiare për vitin 2018, rezulton se subjekti ka deklaruar në zërin “Shpenzime të tjera shfrytëzimi”, shpenzime për qira në vlerën 563,433 lekë, të cilat në mungesë të dokumentacionit që vërteton njohjen e këtyre shpenzimeve janë shpenzime të panjohura për efekte fiskale, për pasojë nuk do duhet ti njihen si shpenzim i zbritshëm. Referuar përcaktimeve të Ligjit nr. 8438, date 28.12.1998 “Per Tatimin mbi te Ardhurat” i ndryshuar, neni 21, Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni nr 115, subjektit i linden detyrimet si më poshtë:

Detyrim për TF (15%) - 84,514 lekë (563,433 *15%)

Penalitet 21.9% - 18,508 lekë

Totali 103,022 lekë

-Nga analiza e shpenzimeve të deklaruara nga subjekti për vitin 2018 dhe 2021 rezulton se subjekti ka deklaruar në zërin “Shpenzime të tjera shfrytëzimi”, shpenzime të tjera në vlerën 1,717,923 lekë për vitin 2018 dhe 7,500,000 lekë për vitin 2021, të cilat nuk janë analizuar nga inspektori i kontrollit, se çfarë përfaqësojnë këto shpenzime dhe nëse janë në funksion të veprimtarisë ekonomike të subjektit dhe pse në vlera të konsiderueshme. Shpenzimet më sipër në mungesë të dokumentacionit justifikues, fatura tatimore, situacione etj, që vërteton njohjen e këtyre shpenzimeve, klasifikohen si shpenzime të panjohura për efekte fiskale, dhe në referencë të përcaktimeve të Ligjit nr. 8438, date 28.12.1998 “Per Tatimin mbi te Ardhurat” i ndryshuar, neni 21, Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni nr 115, mund të sjellin efekte tatimore të cilat llogariten 1,382,688 lekë (9,217,923*15%) si detyrim për TF dhe penalitetet 302,808 lekë (21.9%*1,382,688 lekë).

▪ Në përfundim të kontrollit inspektori i ka nxjerrë detyrime në vlerë totale 28,604,642 lekë (18,509,598 lekë TF dhe 10,094,642 lekë penalitet), të cilat kanë ardhur nga mos njohja e shpenzimeve për qira ambjente dhe shpenzimet për pagat pasi nuk janë kaluar nëpërmjet sistemit bankar por janë bërë cash, për pasojë janë shpenzime të panjohura për efekte fiskale referuar përcaktimeve të gërmes “nj”, pika 1, neni 21 e ligjit 8438 datë 28.12.1998 “Per Tatimin mbi

Fitimin” i ndryshuar. Në sistemin C@ts, detyrimet e mbartura aktuale të tatimpaguesit janë në vlerën 96,825,731 lekë (detyrime për sigurime shoqërore, shëndetësore, TAP, etj).

Tatimpaguesi: “K.” SHPK

Nipti: KU

Adresa kryesore: Lagja 1 Maji, Plazhi i vjetër, Godinë banimi 6-katëshe, Vlorë.

Aktiviteti: *“Prodhimi, tregtimi i materialeve të ndertimit, inerte-gure, sherbime ndertimore, import, eksport te materialeve te ndertimit, punime dheu sistemime, tarracime terrenesh, ndertime civile, industriale turistike, bujqesore, deri ne 5 kate dhe rikonstruksione te tyre. Aktivitete në fushën e ndërtimit dhe hotelerisë”*(vazhdon edhe më tepër sipas përshkrimit të QKB-së).”

Inspektori: L K

Përgjegjës Sektori: S B

Drejtor Kontroll: B P

Drejtori Rajonal: S K

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH-periodha tatimore nga 01/2021-11/2022
- Për Tatim-Fitimin periodha tatimore: 2020-2021
- Për Sigurimet Shoqërore e shëndetësore-periodha tatimore nga 01/2021-11/2022
- Të tjera periodha tatimore: deri në 2022/11
- Orë pune: 32 orë

Nga auditimi ka rezultuar se:

▪ Raporti nuk ka të bashkangjitur si pjesë përbërëse të tij “Formulari-pyetësor i vetë deklarimit para kontrollit”, gjithashtu mungon formularin Nr. 3, jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6, pika 2.2.

▪ **Leje ndërtimi**

1-Me Vendim nr. 3/102, datë 07.06.2010, është miratuar leja e ndërtimit për objektin “Kompleks banimi dhe shërbimi 5,6 dhe 7 kat me 1 kat parkimi nëntokë” në lagjen 1 Maj Vlorë.

Subjekt Ndërtues: Shoqëria “E” me Nr. License 5215 dhe Shoqëria K. me License Nr. 6181.

Afati lejes: 31.12.2013

2- Me Vendim nr. 57, datë 29.04.2014, është miratuar zgjatja e afatit për lejen e ndërtimit të miratuar me Vendimin nr. 3/102, datë 07.06.2010, duke shtyrë afatin e lejes deri në datë 28.05.2017.

3- Me Vendim nr. 602, datë 04.01.2018, është miratuar leja për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit për objektin “Kompleks banimi dhe shërbimi 5, 6 dhe 7 kat me 1 kat parkimi nëntokë” në lagjen 1 Maj Vlorë.

4- Me Vendim nr. 331, datë 30.06.2017, është miratuar zgjatja e afatit për lejen e ndërtimit të miratuar me Vendimin nr. 3/102, datë 07.06.2010, duke shtyrë afatin e lejes deri në datë 01.12.2018.

5- Me Vendim nr. 1240, datë 05.12.2017, është miratuar zgjatja e afatit për lejen e ndërtimit të miratuar me Vendimin nr. 3/102, datë 07.06.2010, duke shtyrë afatin e lejes deri në datë 01.05.2020.

6- Me Vendim nr. 442, datë 22.07.2020, është miratuar zgjatja e afatit për lejen e ndërtimit të miratuar me Vendimin nr. 3/102, datë 07.06.2010, duke shtyrë afatin e lejes deri në datë 22.01.2022.

7- Me Vendim nr. 543, datë 25.09.2020, është miratuar leja për ndryshim funksioni për objektin “Kompleks banimi dhe shërbimi 5, 6 dhe 7 kat me 1 kat parkimi nëntokë” në lagjen 1 Maj Vlorë, ku Seksioni “E” ndryshon destinacion nga banim në funksion të turizimit dhe hoteleri.

8- Referuar kërkesës së subjektit me nr. 1420 prot, datë 06.10.2020, nga Bashkia Vlorë është marrë Vendimi për lëshimin e Certifikatës së përdorimit nr. 594, datë 19.10.2020, për objektin “Kompleks banimi dhe shërbimi 5, 6 dhe 7 kat me 1 kat parkimi nëntokë” në lagjen 1 Maj Vlorë, Seksioni-D (Banim); Seksioni E(Hotel).

Mangësi të konstatuara:

▪ Nga analiza e shitjeve dhe blerjeve të deklaruara nga subjekti për periudhën objekt kontrolli, nga Inspektori i Kontrollit nuk është bërë analiza e detajuar e blerjeve dhe shitjeve duke përcaktuar se cilat janë në funksion të veprimtarisë së furnizimit të banesave/apartamenteve si veprimtari e përjashtuar nga TVSH-ja dhe cilat janë në funksion të hotelerisë, duke krahasuar deklaratimet e bëra nga subjekti me destinacionin e përdorimit dhe planimetrit sipas projektit të miratuar për secilën nga godinat A, B, C, D dhe E, në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit Nr. 6, atë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, Neni 20, pika 3.2, 3.4, 3.6, pika 8, germa c dhe Neni 53, pika 1.

-Në Raport Kontrollit nuk është bërë analiza e shitjeve të deklaruara nga subjekti për banesat/apartamentet, pasi subjekti nuk ka patur aktivitet lidhur me shitjet dhe blerjet për banesa (ka qenë në pritje të daljes së certifikates, aktit të pronësisë përfundimtare) të objekteve dhe për banesat ka deklaruar shitje të përjashtuara vetëm për efekte fiskale.

▪ Nuk është bërë përcaktimi i kostos së blerjeve dhe kostos së plotë për çdo artikull dhe krahasimi me çmimet e shitjes së deklaruara nga subjekti, nuk është bërë bilanci material për lëvizjet e mallit në sasi dhe në vlerë jo sipas përcaktimeve të programit të kontrollit pika 1/5,6 dhe Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.5, Kapitulli VIII, pika 8.

▪ Nga analiza e blerjeve të deklaruara nga subjekti në zërin “Blerje brenda vendit me TVSH 20%” dhe “Blerjet e Investimeve brenda vendit me TVSH 20%”, janë deklaruar si blerje të realizuara në funksion të aktivitetit të subjektit, punime ndërtimi dhe blerje situacione ndërtimi/vetefaturime, më hollësisht sipas zërave si më poshtë:

Viti 2021

a-“Blerje brenda vendit me TVSH 20%”

Subjekt	Rrethi	Nipti	Vlere tateshme	Tvsh	Pershkrimi
A	TIRANE	LI	121,115	24,223	elektrike
A	VLORE	LO	449,213	89,843	pllake gipsi
A	VLORE	KE	4,828,433	965,687	fv pjese ashensori
B	VLORE	KH	463,071	92,614	pllake
C	FIER	LF	124,520	24,904	hidraulike
D	VLORE	KG	755,855	151,171	boje
D	FIER	KA	72,314	14,463	boje
D	VLORE	LQ	291,667	58,333	patinim ,lyerje
D	VLORE	LJ	44,916	8,983	boje
K	VLORE	KH	228,865	45,773	tubo,rakorderi
K	VLORE	KI	229,970	45,994	boje
N	TIRANE	LA	1,919,048	383,810	arket avance
S	VLORE	KP	763,785	152,757	elektrike
S	VLORE	LO	67,833	13,567	elektrike
S	VLORE	KC	252,750	50,550	gur
V	VLORE	KS	417,000	83,400	fv dyer,dritare
TOTAL			11,030,355	2,206,072	

b- “Blerjet e Investimeve brenda vendit me TVSH 20%”

Subjekt	Rrethi	Nipt	Vlere e tatueshme	Tvsh	Pershkrimi/ Situacione vetefaturime
K.	VLORE	K.U	273,352	54,670	mat izolimi, boje, elektrike
K.	VLORE	K.U	392,549	78,510	mat izolimi, elektrike
K.	VLORE	K.U	409,584	81,917	elektrike, pllaka kol
K.	VLORE	K.U	475,746	95,149	mat izolimi, boje, elektrike
K.	VLORE	K.U	815,249	163,050	elektrike, fv ashensor, boje, pllaka
K.	VLORE	K.U	845,570	169,114	elektrike, fv ashensor, boje
K.	VLORE	K.U	1,200,231	240,046	mat izolimi, boje, elektrike, pllaka
K.	VLORE	K.U	1,538,342	307,668	elektrike, fv ashensor, hidraulike, lyerje
K.	VLORE	K.U	1,539,274	307,855	elektrike, kole pllak, fv ashensor, hidraulike
K.	VLORE	K.U	1,841,193	368,239	parket, fv dyer dritare, hidraulike, elektrike
K.	VLORE	K.U	2,894,911	578,982	lyerje, hidraulike, elektrike, fv ashensor
K.	VLORE	K.U	2,922,400	584,480	lyerje, hidraulike, elektrike, fv ashensor
			15,148,401	3,029,680	

Sa sipër rezulton se nga inspektori i kontrollit nuk është bërë analiza në raport kontrolli se për cilën godinë janë kryer punimet e ndërtimit, ndërkohë për situacionet/vetëfaturimet të deklaruara në zërin “Blerjet e Investimeve brenda vendit me TVSH 20%”, në Raport Kontrolli citohet se këto punime janë kryer për objektin Resort Turistik Hotel, ndërkohë që Hoteli që përkon me Seksionin “E” është pajisur me certifikatë përdorimi nr. 594, datë 19.10.2020, miratuar nga Bashkia Vlorë, për pasojë situacionet/vetëfaturimet për punimet e ndërtimit të deklaruara nga subjekti nuk i shërbejnë veprimtarisë së tatueshme dhe nuk do ti njihet e drejta e zbritshmërisë së TVSH-së.

Në zbatim të përcaktimeve të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar, neni 68 “Vleresimi tatimor” pika 4 dhe 5/b dhe nenit 115, pika 3 subjektit i linden detyrime si më poshtë:

Detyrim për TVSH- 3,029,680 lekë

Penalitet 20% -..... 605,936 lekë

Totali detyrimi=..... 3,635,616 lekë

■ Nga verifikimi i pasqyrave financiare të vitit 2019, 2020 dhe 2021, rezulton se subjekti në pasiv të bilancit (Detyrime Afatgjata), zëri “Titujt e huamarrjes” në vitin 2019 është pasqyruar në shumën 26,318,848 lekë, ndërkohë në mbyllje të vitit 2020 ky zë është pasqyruar në shumën 50,311,271 lekë, duke u rritur me 23,992,423 lekë. Në Bilancin e vitit 2021 është pasqyruar në shumën 105,612,152 lekë, duke u rritur me 55,300,881 lekë. Nga viti 2019 në vitin 2021, zëri “Titujt e huamarrjes” është rritur total me 79,293,304 lekë.

Nga ana e inspektorit të kontrollit nuk është bërë analizë në raport kontrolli për ndryshimin në këtë zë, nuk është dhënë asnjë shpjegim në lidhje me krijimin e këtyre të ardhurave, nuk ka informacion nëse ka kontrata të lidhura midis palëve, afatet e huadhënies, mënyra e kryerjes se transaksioneve (me Banke apo Cash), etj, nuk është analizuar dhe saktësuar burimi i të ardhurave, në bashkëpunim me strukturat përkatëse në DPT, veprime këto jo në përputhje me dispozitat e ligjit Nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit” i ndryshuar, neni 18.1 si dhe UMF Nr.16, datë 16.2.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, neni 5, pika 1 dhe 2.

Nga shpjegimet e dhëna dhe dokumentacioni i paraqitur me observacione rezulton se nga shoqëria “K” SHPK administrohen 3 vendime të Asamblese së Ortakëve, Vendim dt.14.01.2020, Vendim dt.10.01.2021 dhe Vendim dt.20.06.2021, për huadhenien nga subjekte ku eshte vetë

administrator dhe familjarja e tij (Bashkeshortja) znj. R C. Në këto vendime janë përcaktuar shumat e huadhënies që do të kalojnë për llogari të ortakut, si dhe detyrimi për pagesën e interesit 0.1 % të principalit. Gjithashtu janë paraqitur dhe esktraktet bankare në Bankën Credins dhe BKT, ku evidentohen transaksionet e kryera nga Rajmonda Ceno për shoqërinë K nga viti 2015 deri në vitin 2022, të cilat duhet të jenë objekt analize nga DRT Vlorë në bashkëpunim me DPT, në lidhje me saktësimin e burimit të të ardhurave sipas transaksioneve të kryera.

-Në përfundim për tatimpaguesin “K.” SHPK, ka rezultuar detyrim në vlerën totale 3,635,616 lekë (nga të cilat 3,029,680 lekë detyrim për TVSH + 605,936 lekë gjobë).

Tatimpaguesi: “T” SHPK

Nipti: KE

Adresa kryesore: Lagja “Kushtrimi”, Rruga “Dëshmorët”, Objekt Nr.5, Vlorë.

Aktiviteti: *“Prodhim tregtim i artikujve zdrucktarie, druri, dyer etj. Import eksport, tregti me shumice e pakice te lendeve te para dhe aksesoreve te ndryshem per punime zdrucktari, mobileri, dyer etj.” (vazhdon edhe më tepër sipas përshkrimit të QKB-së).”*

Inspektori: Bd K

Përgjegjës Sektori: I K

Drejtor Kontroll: B P

Drejtori Rajonal: S K

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH-periodha tatimore nga 10/2019-09/2021
- Për Tatim-Fitimin periodha tatimore: 2019-2020
- Për Sigurimet Shoqërore e shëndetësore-periodha tatimore nga 10/2019-09/2021
- Të tjera periodha tatimore: deri në 09/2021
- Orë pune: 174 orë

▪ Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit, Projekt Raport Kontrolli dhe Raport Kontrolli Përfundimtar ndërkohë procesverbalet mbi kontrollin e kryer nuk janë hedhur brenda ditës së nesërme të punës nga momenti që janë mbajtur, jo në përputhje me përcaktimet e Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.

- Formulari 3-nuk është hedhur në sistemin C@TS, nënshkrimi nga Inspektori i Kontrollit dhe Drejtori i Kontrollit nuk ka datë, nuk ka nënshkrim nga Drejtori Rajonal jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2.

▪ Është bërë evidentimi i blerjeve sipas origjinës, importe, blerje brenda vendit dhe i blerjeve që i shërbejnë shitjeve të përjashtuara.

▪ Për periudhën objekt kontrolli është bërë analiza e eksporteve dhe importeve të deklaruara nga shoqëria, ku janë sqaruar në mënyre analitike diferencat ndërmjet atyre të deklaruara nga shoqëria dhe atyre të deklaruara nga dogana.

▪ Është kryer kontrolli i zërit shpenzime “Amortizime”, ku përgjithësisht kanë të bëjnë me amortizimet e llogaritura për ndërtesa (zyra), impiante dhe makineri, mjete transporti dhe pajisje zyrash e kompjuterike, për të cilat nga ana e shoqërisë janë zbatuar normat e amortizimit sipas grupeve përkatëse.

▪ Është kryer kontrolli për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për periudhën objekt kontrolli.

▪ Është kryer kontrolli për tatimin në burim ku bazuar në kontratat noteriale të qerave janë zbatuar kërkesat e çmimeve të referencës dhe për rrjedhojë zbatimi i VKM nr.469, date

03.06.2015 “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”.

- Në Raport Përfundimtar Kontrolli nuk është bërë analiza e detajuar për shitjet dhe blerjet duke i ndarë ato sipas secilit vend të ushtrimit të akvitetit, kur subjekti ka deklaruar 3 vende të ushtrimit të aktivitetit, nuk ka asnjë të dhënë për klientët dhe furnitorët.

- Për periudhën objekt kontrolli, është bërë bilanci material vetëm për 10 artikuj, ndërkohë që sipas inventarit të deklaruar nga subjekti për periudhën objekt kontrolli, vetëm në vitin 2019 janë deklaruar 1113 artikuj. Gjithashtu nga inspektori i kontrollit nuk është përcaktuar se si është përzgjedhur kampioni për realizimin e bilancit material, pasi në bilanc nuk janë përfshirë disa artikuj që kanë vlera më përfaqësuese si *Dyer Eksl, xokla, Tenie 08*22, Tenie 08/*40, Shine grass 50 cm, Panel Melamine shq16, Panel Melamine shq. 18, Pllaka Mdf, Panel Mdf 16.18, Parket Laminat K etj, Pllaka Mdf të rimesuara, Panel Mdf 16 etj*. Në Raport Përfundimtar Kontrolli nuk ka të dhëna për sasitë në hyrje dhe dalje për çdo artikull, sipas furnitorëve, gjatë periudhës objekt kontrolli, fakt që e bën të vështirë nxjerrjen e konkluzionit për saktësinë dhe vërtetësinë e bilancit material të deklaruar nga tatimpaguesi.

- Në Raport Përfundimtar Kontrolli nuk ka asnjë të dhënë për procesin e prodhimit, mungon analiza për kartën teknologjike, gjithashtu nuk administrohen të dhëna për sasitë në shitje dhe në blerje të produkteve por vetëm në vlera totale, çka e bën të paqartë metodologjin e kontrollit të aplikuar në këtë rast nga Inspektori i Kontrollit në kundërshtim me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli VIII, pika 8.

- Nga verifikimi i pasqyrave financiare rezulton se subjekti në pasiv të bilancit (Detyrime Afatgjata), zëri “*Titujt e huamarrjes*” në vitin 2018 është pasqyruar në shumën 44,158,412 lekë, ndërkohë në mbyllje të vitit 2019 ky zë është pasqyruar në shumën 25,242,500 lekë, duke u zvogeluar me *18,915,912 lekë*. Në Bilancin e vitit 2020 është pasqyruar në shumën 0 lekë, duke u pakësuar me *25,242,500 lekë*. Sipas shpjegimeve në Raport Kontrolli Përfundimtar, titujt e huamarrjes afatgjatë kanë të bëjnë me hua sipas kontratës noteriale me nr.rep.524, datë 06.07.2015, me subjektin “A.” shpk, e cila është amortizuar për periudhën ushtrimore.

-Sipas kontratës noteriale Nr. 524 Rep, Nr. 181 Kol, datë 06.07.2015, Palë Huadhënëse “A” Sh.p.k dhe palë huamarrëse “T” Sh.p.k, vlera e huasë është 225120 Euro, ndërkohë që vlera e huasë së deklaruar në bilancin e vitit 2018 është 44,158,412 lekë, për diferencën nuk ka asnjë shpjegim për burimin e të ardhurave.

- Gjithashtu nga analiza e bilancit të vitit 2019 të deklaruar nga shoqëria, në pasivin e Bilancit, zëri “*Detyrime Afatshkurta*”/“*Të tjera detyrime afatshkurta*” është deklaruar vlera 71,902,218 lekë, e cila sipas shpjegimeve në Raport Kontrolli Përfundimtar, janë detyrime ndaj ortakëve për likuiditete të derdhura në llogari nga ortaku, ku për periudhën 2019 llogaria është shtuar në vlerën prej 5,871,280 lekësh nga viti 2018, shtesa për periudhën ushtrimore, e cila përputhet me derdhjet analitike. Në vitin 2020 ky zë është deklaruar në vlerën 70,785,045 lekë, ku për periudhën llogaria është pakësuar në vlerën prej 1,117,173 lekësh.

-Thekojmë se në bilancin e vitit 2018 të deklaruar nga shoqëria, periudhë e cila nuk është pjesë e programit të kontrollit sipas këtij Raport Kontrolli, ky detyrim është pasqyruar në zërin “*Detyrime Afatshkurta*”, por jo tek titujt e huamarrjes por tek “*Të tjera të pagueshme*”, gjithashtu sipas Ekstraktit Historik të shoqërisë, rezulton me një ortak të vetëm që zotëron 100% të aksioneve, pra nuk kemi të bjmë me detyrime ndaj ortakëve për likuiditete të derdhura në llogari nga ortaku.

Nga ana e inspektorit të kontrollit nuk është bërë analizë në lidhje me krijimin e këtyre të ardhurave, nuk ka informacion nëse ka kontrata të lidhura midis palëve, afatet e huadhënies,

mënyra e kryerjes se transaksioneve (me Banke apo Cash), etj. Gjithashtu nuk është bërë informacioni RAD (Raportim i Aktivitetit të Dyshimtë) në lidhje me shumat e parave të cilat kanë kaluar si hua ortakut/apo individëve ndaj shoqërisë, veprime këto jo në përputhje me dispozitat e ligjit Nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit” i ndryshuar, neni 18.1 si dhe UMF Nr.16, datë 16.2.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, neni 5, pika 1 dhe 2.

- Në lidhje me transaksionet kur ortaku i jep shoqërisë hua ose e anasjellta, pa aplikuar interesa, grupi i audituesve vlerëson se këto veprime janë pa thelb ekonomik dhe jo në përputhje me parimin e vlerës së tregut. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e germave “b”, “c”, “dh” të nenit 71, gerrat “a”, “b”, “c”, “ç” të nenit 71/2 dhe germa “ç” të neni 72 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 24, datë 02.09.2008, i ndryshuar. Nuk është kryer vlerësim alternativ i situatës financiare së shpenzimeve të interesit të pallogaritura në PASH, si rikarakterizim të ardhurash duke sjellë si pasojë detyrime tatimore. Referuar kuadrit legjislativ tatimor, rezulton se ortaku dhe shoqëria me përgjegjësi të kufizuara janë entitete të ndryshme dhe me personalitet juridik të ndarë, sipas përcaktimeve në Ligjin Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Sipas legjislacionit tatimor si shoqëria dhe ortaku konsiderohen si “Palë të lidhura”, meqenëse ortaku ka ndikim në vendimmarrjen e shoqërisë për shkak të zotërimit të kuotave/aksioneve të saj sipas përcaktimeve në Ligjin Nr.42/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe Udhëzimin Nr.16, datë 18.6.2014 “Për transferimin e çmimit”, gjë që sjell se çdo marrëdhënie apo transaksion midis tyre duhet t’u përmbahet kushteve dhe parimeve të tregut (Arm’s Length). Megjithëse nuk ka të përcaktuar saktë dhe qartë mënyrën e procedimit në legjislacionin tatimor të fushës së llogaritjes së interesave dhe detyrimeve tatimore të rillogaritura në rastet e huadhënies nga llogaria e ortakut drejt llogarisë së shoqërisë ose e anasjelltas, referuar Kodit Civil i miratuar me Ligjin Nr.7850 datë 29.07.1994, i ndryshuar, nenet 1050-1055, Kreu XIX “Huaja”, cilësohet se huamarrësi duhet t’i paguajë huadhënësit një interes në rastet kur ekziston një marrëveshjeve ndërmjet palëve.

Tatimpaguesi: “D” SHPK

Nipti: KL

Adresa kryesore: *Selenicë, Sheshi Minatori, Godina nr.27. Selenicë, Vlorë.*

Aktiviteti: *“Ndërtimi i veprave të tubacioneve e kanalizimeve”*

Inspektori: M K

Përgjegjës Sektori: I K

Drejtor Kontroll: B P

Drejtori Rajonal: S K

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH-periodha tatimore nga Qershor 2020 deri Shtator 2021

Kontrolli në këtë tatimpagues është ushtruar në vijim të kërkesës nr. 20116/2 datë 01.12.2021 për rimbursimin e TVSH në shumën 12,337,702 lekë. Tatimpaguesi e ushtron veprimtrinë kryesore në punime të specializuara ndërtimi dhe përgjatë periudhës objekt auditimi ka kryer punime në ndërtimin e objektit me të dhënat e mëposhtme:

- Godina hotelerie 3 kate me nje kate nentoke, Rradhime – Vlore, me Leje ndertimi Nr 1129 date 16.10.2018 me afat 36 mujore.

Në këtë fushë veprimtarie që përshin ndërtimin, sipas nenit 20 të UMF nr.6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, subjekti referuar lejes së ndërtimit sipas përshkrimit të bërë në akt ekspertizën e inxhinierit nr.8865/4 datë 28.12.2021 (I. shpk) dhe kontratës noteriale nr. 47 datë 18.01.2017 është në rolin:

-Palë investitore dhe sipërmarrëse shoqëria “D.” shpk dhe palë pronare e truallit Z.N.M. dhe Z. A M. Pala sipërmarrëse dhe financuese do bëjë ndërtimin sipas kushteve me 67% të sipërfaqes ndërtimore dhe me përfundimin e ndërtimit pronari i truallit do të marrë 33% të sipërfaqes ndërtimore. D. shpk do investoj dhe ndërtojë kullat A dhe C ndërsa investimi në kullën B ipërket pronarit të truallit.

-Projekti filestar ka ndryshuar sipas kërkesës së “D.” shpk dhe është miratuar me lejen nr. 229 datë 26.03.2021 pa ndryshuar afatin e përfundimit. Sipas raportit të inxhinierit, ndryshimi ka konsistuar se ka ndryshuar tipologjia në dhoma njësi për kullat A dhe B ndërsa në kullën C është ndryshuar tipologjia apartament njësi dhe në kullën B është ndryshuar nga restorant në apartament njësi.

Në raport kontrolli është kundërshtuar pjesa prej 33% e kërkesës për rimbursim për shkak të përfitimit të një pjese të investimit prej pronarëve të truallit, për të cilën sipërmarrësin nuk e ka trajtuar si shitje drejt tyre si investitorë referuar kontratës noteriale ndërmjet palëve. Për këtë detyrim tatimor për TVSH janë llogaritur edhe gjoba në masën 20% për deklarim të pasaktë të deklaratës tatimore.

Nga auditimi konstatohet:

-Sipas lejes fillestare nr. 1129 datë 16.10.2018, ndërtimi është dhënë për objektin “godinë hoteleri 3 kate me një kat nëntokë Rradhimë-Vlorë” me sipërfaqe parcele zënë nga ndërtimi 756.9 m, sipërfaqe totale ndërtimi 2600 m dhe me përdorim të lejuar të objektit “funksioni”, hoteleri. Kontrata nr. 47 datë 18.01.2017 ndërmjet palës investitore dhe sipërmarrëse “D” dhe palës pronare “N. M dhe A. M”, nenit 6, 7 “*lejen e ndërtimit godinave hoteleri, shërbime dhe banim*”, neni 1 “*pronarët vënë në dispozicion pronën e mësipërme për ndërtimin e një kompleksi prej tre kullash*”. Pra konstatohen ndryshime ndërmjet objektit të ndërtimit që në leje referohet si një godinë hotelerie ndërkohë që në kontratën noteriale ndërmjet palëve si dhe aktin e inxhinierit konstatohen tre kulla me funksione/përdorime të ndryshme nga ato të përcaktuara në lejen e ndërtimit. Në dosje nuk administrohet ndryshimi i lejes së ndërtimit.

-Rivlerësimi nga ana e inspektorit tatimor është kryer për pjesën blerjeve të tatueshme duke e ulur tepricën e kreditueshme, ndërkohë që problematike me pronarët e truallit krijon detyrime tatimore që lindin nga mos trajtimi i pjesës së pronarëve të truallit si palë investitore që duhej të shoqërohej me faturë tatimore shitje drejt këtyre të fundit. Nga auditimi konstatohet se trajtimi i shitjes si vetëfurnizim me 20% për vlerën 100% të investimit si përfitues D duhej të ishte trajtuar duke korigjuar edhe shitjet e tatueshme si procedurë dhe jo vetëm blerjet nga investimi.

-Në raport kontrolli nuk janë analizuar blerjet e tjera që nuk i takojnë vetëfurnizimit për ndërtimin dhe financimin e hotelit, që përfshijnë inventar, AAM dhe blerje të përjashtuara. Për këto inventare dhe blerje të aktiveve afatgjata material nuk ka një analizë të detajuar sipas natyrës në mënyrë që të gjykohet mbi përputhshmërinë e kreditimit të TVSH për këto blerje.

-Në raport kontrolli nuk është paraqitur bilanci material për artikujt e përzgjedhur për kontroll sipas konsumit kryesor në ndërtimin e objektit që ka akumuluar pjesën më të madhe të rimbursimit të tvsh-së, por ndërkohë është mbështetur vetëm në analizën e pohimin e inxhinierit

për mungesën e diferencave. Inxhinieri nuk është shprehur për diferenca dhe as ka bërë lëvizje materiale. Edhe situacionet e paraqitura në vlerë totale nuk janë paraqitur analitike referuar materialeve kryesore të përdorura për ndërtimin e hotelit në mënyrë që të gjykohet mbi lëvizjen e materialeve dhe rrejedhimisht edhe kreditimin e TVSH për këto furnizime të bëra në rubrikën e blerjeve të tatueshme.

-Në raport kontrolli nuk është kryer procesi i inventarizimit fizik si kërkesë e Manualit të Kontrollit Tatimor.

Tatimpaguesi: “H. Grup” SHPK

Nipti: LT

Adresa kryesore: Radhimë, Rruga Vlorë-Orikum, Km.12, Lagja Plazh, Objekt Nr. 1, Radhimë, Vlorë.

Aktiviteti:“Aktivitet në fushën e ndërtimit, hoteleri, restorante, barkafe, agjensi turistike, menaxhim turizmi, etj. Ndertime civile industriale-turistike-bujqesore. Aktivitet në fushën e transportit. Import-Eksport. Tregti me shumice dhe pakice te mallrave te ndryshem industrial ushqimore dhe karburante (vazhdon edhe më tepër sipas përshkrimit të QKB-së).”

Inspektori: M P me autorizim shtesë AM

Përgjegjës Sektori: I K

Drejtor Kontroll: B P

Drejtori Rajonal: S K

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH-periudha tatimore nga 10/2018-06/2020

- Për Tatim-Fitimin periudha tatimore: 2018/2019

- Për Sigurimet Shoqërore e shëndetësore-periudha tatimore nga 10/2018-06/2020

- Orë pune: 110 orë ose 14 ditë pune

Nga auditimi rezultoi se:

-Në analizën e blerjeve të tatueshme për të cilën është kredituar TVSH, janë paraqitur blerjet nga furnitorë vendas analitike sipas furnitorëve, por nuk janë analizuar sipas natyrës së blerjes për të gjykuar në lidhje me përmbushjen e kushteve për kreditimin e tvsh në lidhje me këto blerje. I njejtë konstatim vlen edhe për blerjet e investimeve Brenda vendit me tvsh.

-Nga auditimi konstatohet se tatimpaguesi ka raportuar shitje sipas natyrës për shërbimin e bar restorantit dhe nuk rezulton të ketë në pronësi ambjente apo të ketë blerje të deklaruara për qeradhënie për ushtrimin e aktivitetit dhe kjo analizë nuk është kryer në raportin e kontrollit tatimor.

-Nga auditimi konstatohet se në raportin e kontrollit tatimor nuk është kryer analiza e bilancit material, si një element kryesor mbi kreditueshmërinë e tvsh, duke qenë se gjatë peridhës së kontrollit konstatohet se është ushtruar aktiviteti i ndërtimit që përfshin lëvizjeve të lëndëve të para për procesin e prodhimit. Nuk rezulton të jetë kryer krahasimi ndërmjet materialeve në blerje të tatueshme brenda vendit me situacionet e paraqitura nga raporti i inxhinierit.

-Nga auditimi mbi krijimin e tepricës së kreditueshme të TVSH-së përgjatë periudhës objekt kontrolli nga ana e inspektorit tatimor është kryer analiza e krijimit të saj për shkak të angazhimit në ndërtimin e një hoteli, ku tatimpaguesi ka kryer deklarime në rolin e ndërtuesit dhe investitorit në të njëjtën kohë, gjë që ka sjellë edhe autofaturimin në blerje të investimeve të brendshme nga furnitorë vendas. Konkretisht leja filletare me ndryshime të afateve paraqitet si në vijim:

▪ **Leje zhvillimore nr.1, datë 04.02.2015, me afat deri në 20.09.2018**, për ndërtimin e objektit Strukturë shërbimi “Kompleks hotelerie 4 kat me 1 kat parkim nën tokë (3 objekte)” në Nisi, Radhimë, lëshuar nga Bashkia Orikum.

-Palë pronare të pasurisë truall nr. 515/11/1 V. dhe F. H,

-Palë zhvilluese shoqëria “H” Sh.p.k,

Në dosjen e kontrollit administrohet edhe një kontratë kalimit të drejtasht për objektin e investimit sipas lejes së mësipërme, si në vijim:

▪ **Kontratë noteriale kalim të drejtash me Nr. 3687 prot, Nr. 2951 Kol, datë 27.11.2018,**

Pala subjekt ish-investitore: Subjekti “H” Sh.p.k me Nipt- JI

Pala Investitore she sipërmarrëse: Subjekti “H Group” Sh.p.k me Nipt- LT

Pala pronare e truallit: A H

Objekti i kësaj kontrate është kalimi i të gjithë të drejtave reale nga shoqëria “H” Sh.p.k tek shoqëria “H Group” Sh.p.k, të lejes zhvillimore të ndërtimit me nr. 1, datë 04.02.2015, sipas kushteve më poshtë:

- Shoqëria “H Group” Sh.p.k merr pjesë në investim në masën 100 %

- Shoqëria “H Group” Sh.p.k merr përsipër të detyrimin për të përmbushur të gjitha detyrimet kontraktuale të bashkëpunimit sipas vlerave të përcaktuara nga ajo vetë.

- Shoqëria “H Group” Sh.p.k dhe shoqëria “H” Sh.p.k, kanë rëndë dakort që të gjitha të drejtat dhe detyrimet ti kalojnë shoqërisë “H Group” Sh.p.k.

-Në Raport Kontrolli Tatimor, tatimpaguesit “H Group” Sh.p.k, nuk i është njohur e drejta e kreditimit të TVSH-së për situacionet e punimeve në ndërtim, pasi realizimi i punimeve është në kundërshtim me lejen e ndërtimit referuar përcaktimeve të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar, Neni 2, pika 8, Neni 13, pika 1, 2 dhe 3, neni 14, pika 1. Në përfundim subjektit i janë nxjerrë detyrime për TVSH pasi për këtë çështje nga ana e inspektorit tatimor ka pasur korespondencë me DPT si më poshtë:

Me shkresën nr. 3790 prot, datë 25.06.2021, kërkesë për interpretim, drejtuar DPT\Drejtorisë Teknike dhe Ligjore, nga DRT Vlorë është kërkuar interpretim nëse kontrata noteriale “Kalim të drejtash” me Nr. 3687 prot, Nr. 2951 Kol, datë 27.11.2018, i jep të drejtë të kreditimit të TVSH në procesin e ndërtimit tatimpaguesit “H Group” Sh.p.k sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 69 dhe Udhëzimit Nr. 6, datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, Neni 20, pika 4.

-Me shkresën nr. 12017/1 prot, datë 09.07.2021, administruar në DRT Vlorë me nr. 3790/1 prot, datë 12.07.2021, kthim përgjigje, DPT\Drejtoria Teknike dhe Ligjore, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe përmbajtjen e shkresës “Kërkesë për interpretim” të DRT Vlorë, nuk i ka njohur TVSH-n e zbritshme për ndërtimin e hotelit tatimpaguesit “H. Group” SHPK, duke argumentuar në shkresë ndër të tjera “....Për këtë, është kusht i domosdoshëm që lloji, natyra dhe qëllimi i përdorimit të objektit të shpallet dhe aprovohet në lejen e ndërtimit të dhënë sipas legjislacionit të fushës në fuqi....Domosdoshmërisht të përcaktohet në leje qartësisht lloji i objektit dhe përdorimi i tij, në mënyrë që të jete i mundur të vërtetohet qëllimi i përdorimit në lidhje me veprimtarinë ekonomike.... Leje ndërtimi është akti i miratimit të kërkesës për leje ndërtimi dhe lejimit të punimeve përkatëse..... Referuar përmbajtjes së shkresës suaj konstatojmë se shoqëria “H Group”, ka kryer punime ndërtimi (operacion, transaksion, furnizim) dhe këto të fundit nuk janë kryer në përputhje me legjislacionin e fushës dhe legjislacionin fiskal duke përdorur lejen e ndërtimit të shoqërisë “H” SHPK.

Bazuar në referencat ligjore të sipërpërmendura, duke qenë se tatimpaguesi “H. Group” SHPK, nuk ka zbatuar kërkesat e ligjit si ato në fushën e ndërtimit dhe legjislacionin fiskal, nuk njihet TVSH e zbritshme për ndërtimin e hotelit.”

Nga ana e inspektorit me të drejtë nuk janë njohur situacionet e punimeve të vetëfaturuara pasi tatimpaguesi në lidhje me ndërtimin e hotelit nuk ka statusin e investitorit dhe as zhvilluesit pasi leja e ndërtimit për të cilën janë pretenduar punimet janë në emër të H. SHPK me NIPT JI. Bazuar ne referencat ligjore te siperpermendura, duke qene se tatimpaguesi “H. Group” SHPK nuk ka zbatuar kerkesat e ligjit si ato ne fushen e ndertimit dhe legjislacionin fiskal, nuk njihet TVSH-ja e zbriteshme per ndertimin e hotelit”. Për rrjedhojë nga ana e inspektorit tatimor janë paraqitur në raport kontroll detyrime për tvsh në lidhje me vetëfaturimet në shumën **18,503,670 lekë**.

Nga auditimi konstatohet se këto detyrime nuk janë përlllogaritur saktë nga ana e inspektorit tatimor pasi i atribuohen një pjese të ndërtimit dhe nuk përputhen me analizën sipas aktit të inspektimit të inxhinierit të ndërtimit për realizimin e punimeve në objekt.

Periudha	Vlera me tvsh	TVSH	Vlera pa TVSH
Janar - Dhjetor 2019 (Subjekti“ H “ sh.p.k)	52,846,313	8,807,719	44,038,594.17
Janar - Dhjetor 2019 (Vetfaturime“ H Group “ sh.p.k)	45,515,976	7,585,996	37,929,980.00
Janar - Qershor 2020 (Subjekti“ H “ sh.p.k)	15,946,354	2,657,726	13,288,628.33
Janar - Qershor 2020 (Vetfaturime“ H Group “ sh.p.k)	65,503,820	10,917,303	54,586,516.67
Shumaleke me tvsh	179,812,463	29,968,744	149,843,719.17

Referuar tabelës së mësipërme, për ndërtimin e hotelit janë realizuar punimet e mësipërme të cilat sipas rastit janë vetëfaturuar apo janë faturuar nga subjekti ndërtues H. SHPK, të cilat kanë krijuar një tepricë të TVSH së kreditueshme në shumën 29,968,744 lekë, e cila referuar interpretimit në lidhje me mos aplikueshmërinë e të drejtës së zbritjes si pasojë e mos qenies në rolin e investitorit të shoqërisë H. Group nuk duhet të ishte raportuar në blerjet e investimit me tvsh të zbritshme të H. SHPK. Në raport kontrolli janë njohur detyrime vetëm për **18,503,670 lekë, ndërkohë që duhet të ishin nxjerrë njoftim vlerësime në shumën 29,968,744 lekë, për pasojë diferenca prej 11,465,074 lekë përbën kreditim të padrejtë të TVSH-së. Mbi këtë detyrim aplikohet gjoba për deklarata të pasaktë në shumën 2,476,456 lekë dhe në total detyrimi në shumën 13,941,530 lekë.**

-Nga auditimi mbi blerjet e tatueshme të raportuara nga tatimpaguesi, në kryqëzim me analizën e bërë për tatim fitimin në vitin 2019, konstatohet se janë blerë mjete transporti me vlerën 10,987,500 lekë sipas shtesës së aktiveve afatgjata të pashitura dhe mjete transporti në shumën 6,453,083 lekë të cilat janë shitur në 2019, në pasqyrat financiare të dorëzuara në cats për vitin 2019 e cila përbëhet nga si më poshtë:

AUTOVETURE	E SHITUR 2019	5,337,500
AUTOVETURE	E SHITUR 2019	1,115,583
AUTOVETURE	INVENTAR	3,862,500
Mjet transport blere mars 2019		7,125,000

Nga auditimi konstatohet se tre blerjet e para të mësipërme janë kryer për autovetura dhe për këto është kredituar TVSH pasi shuma e tyre përkon me faturën e regjistruar në blerje të brendshme investimi nga furnitori T me NIPT LU në shumën 10,315,583 lekë dhe tvsh në shumën 2,063,117 lekë, e cila rezulton të jetë kredituar padrejtësisht për autovetura, referuar edhe formatit për pasuri të luajtshme të dorëzuar në cats ku rezultojnë të regjistruara autoveturat e mëposhtme që nuk janë ATP:

Marka	Modeli
AUDI	SQ7

CHEVROLET	ORLANDO
BMË	530D

Për këto arsye linden detyrimet e në shumën 2,063,117 lekë për tvsh dhe gjobë për deklarim të pasaktë në shumën 445,633 lekë, në total detyrime në shumën 2,508,750 lekë.

-Në përfundim për tatimpaguesin H. G Sh.p.k, ka rezultuar detyrim në vlerën totale 16,450,280 lekë (nga të cilat 13,528,191 lekë detyrim për TVSH dhe 2,922,089 lekë gjobë).

Tatimpaguesi: “P H”

Nipti: MF

Adresa kryesore: Lagjja Pavarësia, Rruga Pelivan Leskaj, Zona Kadastrale Nr. 8602, Hotel Partner, kati i parë, Vlorë.

Aktiviteti: “Hotele dhe struktura të ngjashme”

Inspektori: Mirela Bejo

Përgjegjës Sektori: S B

Drejtor Kontroll: B P

Drejtori Rajonal: S K

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për periudhën Shtator 2022-Nëntor 2022 për TVSH-në, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, TAP e të tjera.

Nga auditimi konstatohet se tatimpaguesi ka deklaruar shitje të tatueshme me 6% për aktivitetin e hotelarisë në deklaratat e TVSH-së. Nga verifikimi në sistemin cats konstatohet se tatimpaguesi ka marrë certifikatën e kategorizimit në datë 24.03.2023 për strukturë akomoduese “hotel”.

Për periudhën e kontrolluar shtator – nëntor 2022 shitjet e deklaruara me 6% janë shumën 5,097,557 lekë dhe TVSH është 305,854 lekë. Mbi këto shitje duhet të ishte deklaruar TVSH 20% ose në shumën 1,019,511 lekë dhe për rrjedhojë **detyrimi për TVSH vlerësohet në shumën 713,657 lekë, për diferencën në normën e TVSH së aplikuar. Gjoha për deklarim të pasaktë për tatimin mbi vlerën e shtuar vlerësohet në shumën 154,150 lekë. Në total detyrimi tatimor për tvsh për këtë tatimpagues paraqitet në shumën 867,807 lekë.**

Këto konstatime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 49, pika 3 e ligjit për TVSH ku përcaktohet që “Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese, sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin e fushës së turizmit, është 6 për qind. Kushtet, kriteret dhe procedurat për zbatimin e kësaj pike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave” dhe nenin 11/1 të VKM nr. 953 datë 29.12.2014 ku përcaktohen kushtet dhe kriteret për aplikimin e shkallës së reduktuar të TVSH-së. Duke qenë se tatimpaguesi nuk është i pajisur me certifikatën e kategorizimit në momentin që ka kryer shitjet dhe nuk janë përmbushur kushtet ligjore për përfitimin e aplikimit të normës së reduktuar të TVSH-së, nga ana e kontrollit tatimor duhet të ishte aplikuar shkalla tatimore standarte e TVSH dhe jo të njëjhej aplikimi i 6% pa u verifikuar përmbushja e kriterëve për përfitimin e tij nga strukturat përkatëse në fushën e turizmit sipas përcaktimit në legjislacionin e TVSH-së.

Gjithashtu referuar edhe faktit që tatimpaguesi nuk e ka hotelin në pronësi/apo me marrëdhënie tjetër qeraje, nuk vërtetohet e drejta e tij për ofrimin e shërbimit të hotelarisë për aplikimin e normës së 6% si shkallë e reduktuar.

-Në përfundim për tatimpaguesin “P” SHPK, ka rezultuar detyrim në vlerën totale 867,807 lekë (nga të cilat 713,657 lekë detyrim për TVSH dhe 154,150 lekë gjobë).

Tatimpaguesi: “S”

Nipti: LN

Adresa kryesore: Lagjja Uji i Ftohte, Godine dy kateshe nr.5, Jonufer, Vlore.

Aktiviteti: “Projektimi dhe zbatimi, ndertime civile, turistike, bujqesore, ujesjellës kanalizime, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike Punime karpenterie, hekuri, murature e suvatime, kalluposje, shtrim me pllaka e nivelime, si dhe nivelime, punime hidraulike dhe elektrike.Sherbime hotelerie, bar-restorante”

Inspektori: E H

Përgjegjës Sektori: I K

Drejtor Kontroll: B P

Drejtori Rajonal: S K

Periodha e kontrolluar: Tetor 2019–Mars 2021

Kontrolli në këtë tatimpagues është zhvilluar në vijim të kërkesës për rimbursimin e TVSH-së të paraqitur në Drejtorinë e Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Tatimpaguesi përgjatë periudhës object kontrolli që përfshin Tetor 2019 – Mars 2021, për tatimin mbi vlerën e shtuar ka akumuluar teprice kreditore të TVSH-së si pasojë e rolit të tij si investitor në ndërtimin e një hoteli, pra praktikisht ka deklaruar në blerjet situacionet për investime në funksion të një aktiviteti të tatueshëm siç është hoteleria.

Sipas dokumentacionit të paraqitur në dosjen e kontrollit për këtë rast, janë administruar lejet e ndërtimit fillestare si dhe ndryshimet që kanë pësuar në drejtim të shtyrjes së afateve, ndryshimit të destinacionit të lejes apo edhe zhvilluesit. Sipas Vendimit nr. 581 datë 24.09.2019 të Bashkisë Vlorë është miratuar kërkesa për shtyrjen e afatit të përfundimit të lejes fillestare deri në datën 24.12.2020. Ndërkohë për perudhën e kontrollit deri në Mars 2021 konstatohen që janë kryer punime përtej periudhës së lejes së ndërtimit.

Për periudhën objekt kontrolli, nga shqyrtimi i librave të blerjes së tatimpaguesit konstatohet se janë deklaruar situacionet në shitje dhe në blerje e mëposhtme:

Muaji	Vlera e tatueshme	TVSH
Janar	3,137,407	627,481
Shkurt	4,334,053	866,810
Mars	2,483,044	496,609
TOTALI	9,954,504	1,990,900

Për rrjedhojë, duke qenë se janë kryer punime në shkelje të lejes së ndërtimit pas ka përfunduar afati i lejes, linden detyrime në shumën 1,990,900 lekë për tvsh dhe 430,034 lekë gjobë për deklarim të pasaktë, në total detyrime në shumën 2,420,934 lekë.

Këto detyrime linden si pasojë e përcaktimeve të nenit 20 të Udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se “Për çdo punim në ndërtim të kryer në shkelje të lejes përkatëse të ndërtimit të lëshuar nga autoritetet e fushës, ose çdo punim të kryer përpara se leja përkatëse e kërkuar nga legjislacioni i fushës, të jetë lëshuar, personi i tatueshëm ndërtues është i detyruar të paguajë TVSH për pjesën e punimeve të kryera, por ndërkohë atij nuk i lejohet të zbresë TVSH-në për blerjet e kryera që i korrespondojnë situacioneve (pjesës së punimeve) në fjalë, përsa për kryerjen e punimeve nuk janë respektuar kërkesat dhe dispozitat ligjore të fushës përkatëse. Nga ana tjetër investitorit të objektit, nëse e ka zbritur TVSH-në e punimeve të kryera prej personit të tatueshëm ndërtues, nuk i lejohet të zbresë TVSH-në përkatëse të punimeve të ndërtimit të kryera në kushtet e shkeljes.”. Gjithashtu nga auditimi konstatohet se për periudhën objekt vlerësimi të detyrimeve, Janar – Mars 2023, në listëpagesat e tatimpaguesit nuk ka të paraqitur inxhinier zbatimi të punimeve të ndërtimit në

mënyrë që situacionet të jenë të hartuara dhe miratuara nga profesionistët e licensuar përkatës për vërtetësinë e punimeve të ndërtimit për të cilat është pretenduar teprica kreditore e tvsh-së.

-Në përfundim për tatimpaguesin "S" Sh.p.k, ka rezultuar detyrim në vlerën totale **2,420,934 lekë** (nga të cilat **1,990,900 lekë** detyrim për TVSH dhe **430,034 lekë** gjobë).

Tatimpaguesi: "S"

Nipti: KM

Adresa kryesore: Selenicë, Vlorë.

Aktiviteti: *"Nxjerrja, përpunimi dhe tregtimi i qymyrit bituminoz, bitumit të paster, dolmitit kokerr. Transportimi, që përfshin transportimin kombëtar dhe nderkombëtar të mallrave për vet shoqëri dhe për llogari të tregëteve, për import dhe për eksport. Veprimtari eksportuese dhe importuese, ku futen eksporti i lendeve të para dhe i mallrave e materialeve të të gjitha llojeve. Veprimtari tregëtar, ku përfshihet tregtimi me shumicë dhe pakicë i mallrave, i pasurive të luajtshme e të paluajtshme, etj.,...*

Inspektori: D B

Përgjegjës Sektori: I K

Drejtor Kontroll: B P

Drejtori Rajonal: S K

Periudha e kontrolluar: TVSh për periudhën Gusht 2019- Korrik 2021, tatim fitimi 2019-2020 dhe kontributet e të tjera gusht 2019 – korrik 2021.

Ky raport kontrolli është realizuar përpara kontrollit të mëpasshëm të përzgjedhur që lidhet me të njëjtën periudhë për kontrollin e tvsh-së si dhe që është kryer në vijim të kërkesës së tatimpaguesit për rimbursimin e TVSH-së.

-Është bërë analiza e kostos së çmimit të shitjes për periudhën objekt kontrolli, nga ku rezultojnë se çmimet e shitjes si brenda vendit si dhe në eksport janë më të larta se kosto e prodhimit të tyre.

-Është bërë kontrolli i eksporteve dhe importeve, janë sqaruar në mënyrë analitike diferencat ndërmjet të dhënave të deklaruara nga shoqëria dhe atyre të deklaruara nga dogana, për periudhën objekt kontrolli.

-Janë analizuar treguesit e pagesës apo tepricës kreditore të TVSH-së, është kryer zbërthimi e analiza e komponentëve të TVSH-së, është përcaktuar prejardhja e tepricës së TVSH-së kreditore në fund të periudhës.

-Është bërë bilanci material nga data 01.01.2020 deri në datën 31.07.2021, ku sipas të dhënave të paraqitura në Raport Kontrolli dhe deklarimeve të tatimpaguesit në sistemin C@ts nuk kanë rezultuar diferenca.

-Tatimpaguesi, sipas shpjegimit të dhënë në raportin e kontrollit ushtron aktivitetin në nxjerrjen dhe përpunimin e mineralit të bitumit në zonën e Selenicës dhe rezulton të jetë palë e lidhur me tatimpaguesin tjetër të përzgjedhur për kontroll M me NIPT KE, pasi kontrollohen nga të njëjtët persona të ngarkuar me qeverisjen e këtyre entiteteve. Kjo rezulton edhe nga marrëdhëniet e analizuar në shitje dhe në blerje ndërmjet tyre. Nga auditimi konstatohet se, një analizë mbi transaksionet e kontrolluara ndërmjet palëve të lidhura sipas përcaktimeve të ligjit për tatimin mbi të ardhurat nuk rezulton të jetë realizuar nga inspektori tatimor në raportin e kontrollit tatimor.

-Këto subjekte veprojnë në fushë të rregulluar nga legjislacioni specifik në sektorin e nxjerrjes dhe përpunimit nga mineraleve, konkretisht nga institucione të tjera si AKBN. Nga auditimi konstatohet se nga ana e inspektorit tatimor nuk është shkëmbyer informacion apo të jenë marrë

konfirmime nga AKBN në lidhje me treguesit e inventarit të raportuar të nxjerrë apo investimet e realizuara përgjatë periudhës objekt kontrolli, por janë marrë të mirëqena deklaratimet e tatimpaguesit. Në këtë mënyrë nuk është arritur siguri në lidhje me sasinë e nxjerra/përpunuara dhe shitura drejt palëve të treta apo investimet e pretenduara me anë të vetëfaturimeve, të cilat vazhdimisht kanë krijuar një tepricë kreditore të tvsh-së.

-Nga ana e inspektorit rezultojnë të jetë kryer bilanci material për periudhën objekt kontrolli në bazë të vetëdeklarimeve të subjektit, por nuk rezultojnë të jetë kryqëzuar me të dhënat zyrtare të AKBN në lidhje me sasinë e prodhuar. Në mënyrë të përmbledhur diferenca ndërmjet vlerave të paraqitura nga inspektori me ato të paraqitura në raportin e AKBN për vitin 2020 paraqiten si më poshtë:

Raporti i kontrollit:

Nr	Emertimi	Njesia	Gjendja 01/01/2020 Kontrolli	Prodhuar 01/01/2020-31/12/2020	Shitur 01/01/2020-31/12/2020	Dalje per prodhim bitumi/dhe /ose djegje	Gjendja 31/12/2020 Fizike
1	Bitum Natyral	Ton	557	2867	162	2640	622
2	Bitum i pastruar bllok	Ton	1 887	1756	-	2974	669
3	Bitum fraksionuar	Ton	95	2916	2 462	0	549
4	Qymyr nga karriera	Ton	3 340	24154	20 856	482	6 156

Raporti i AKBN

(chromeextension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/http://www.akbn.gov.al/wpcontent/uploads/2021/03/Raport-per-treguesit-minerar-te-realizuar-n-v2020-ne-Shqiperi-1.pdf)

Minerali	Sasia ne ton 2020
2.13 Bitum	4,000
2.14 Qymyr Bituminoz (Zhavorr bituminoz)	23,558

Për rrjedhojë, sasinë e deklaruar të mineralit të prodhuar paraqiten me diferenca kryesisht në drejtim të sasisë së prodhur që vendos në dyshim saktësinë e bilancit material e shitjeve e gjendjes përfundimtare të raportuar nga tatimpaguesi e të kontrolluar nga inspektori tatimor.

-Gjithashtu, duke qenë se kemi të bëjmë me proces përpunimi, konstatohet se është aplikuar karta teknologjike e paraqitur nga inspektori tatimor e cila rezultojnë të mos jetë e miratuar nga organet shtetërore përkatëse dhe nuk është analizuar nga inspektori tatimor. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në VKM nr. 434 datë 20.05.2015 “Për përcaktimin e normativave për humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë prodhimit, magazinimit, transportimit etj., të njohura për qëllime fiskale”, ku në nenet 4, 7, 8 dhe 9 përcaktohen:

4.Për humbjet dhe firot në procesin e prodhimit, për të cilat nuk ka akte të veçanta ligjore dhe nënligjore, sasia dhe vlera e lejuar e tyre do të llogariten duke u bazuar në kartat apo skemat teknologjike të procesit të prodhimit. Autoritetet tatimore, gjatë kontrollit të ushtruar në vend pranë tatimpaguesit, analizojnë kartat apo skemat teknologjike të procesit të prodhimit, që shoqërojnë makineritë apo linjat përkatëse nga prodhuesi i tyre dhe kryejnë verifikimet lidhur me nivelin e humbjeve të pësuar gjatë procesit të prodhimit/përpunimit. Për matjen e nivelit të humbjeve gjatë prodhimit, inspektorët tatimorë mbajnë procesverbalin përkatës, të firmosur edhe nga drejtuesi teknik apo administratori, të cilin ia bashkëlidhin aktit të kontrollit.

7.Brenda 45 ditëve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, çdo tatimpagues duhet të paraqesë në DrejtorinëRajonale Tatimore dokumentacionin për miratimin e firove, ku të përfshihen: a)karta teknologjike; b)përshkrimi i detajuar i procesit të prodhimit; c)planimetria e objektit; ç)normativat e konsumit të lëndës së pare dhe të orëve të punës për një si produkti të gatshëm (karta teknologjike), shoqëruar edhe me të dhënat për: -llojin e lëndës së parë, të përdorur në

procesin e prodhimit; -fazat, në procesin teknologjik, ku përdoret lënda e parë. Karta teknologjike, duhet të jetë e konfirmuar/certifikuar nga një institucion i njohur, që ka aftësinë teknike të konfirmimit të kartave teknologjike, si: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), Instituti i Materialeve të Ndërtimit, Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve, Drejtoria e Patentave dhe Markave, Inspektorati Shtetëror, përgjegjës dhe Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, institucione që miratojnë karta të ndryshme teknologjike apo çdo institucion tjetër që ka aftësitë dhe lidhet me proceset teknologjike përkatëse.

8. Firot e miratuara nga drejtoritë rajonale tatimore (DRT), në përputhje me këtë vendim, do të njihen për efekte fiskale për periudha jo më të hershme se data e miratimit zyrtar në DRT, sipas pikës 7, më lart.

9. Ngarkohen drejtoritë rajonale tatimore për zbatimin e këtij vendimi.

- Në Raportin Përfundimtar të Kontrollit nuk është analizuar çfarë përfaqësojnë “autofaturime punime zbulimit sipas 3 mujoreve”, nuk të dhëna si kanë dalë këto vlera, zërat e punimeve që janë kryer, çfarë dokumentacioni shoqërues dhe justifikues është kontrolluar nga inspektori për të saktësuar vlerën e këtyre punimeve, mungon analiza për situacionet në lidhje me hyrjet dhe sasinë e situacionuar në dalje, nuk ka të dhëna nëse kanë qenë objekt kontrolli nga institucione të tjera kompetente si AKBN etj, dhe a janë administruar këto raporte kontrolli nga inspektori. Këto autofatura të hartuara nga ana e tatimpaguesit nuk rezultojnë të jenë të detajuara në raportin e kontrollit tatimor. Sipas shpjegimit të inspektorit tatimor ato përfshijnë situacione për punime të realizuara për nxjerrjen e mineralit, “për zbulime në karrierë”, të cilat janë trajtuar si investime.

Nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor nuk rezulton të jetë kryer një kontroll i këtyre situacioneve në mënyrë analitike se çfarë kanë pasur të përfshirë, në elementët e materialeve të para, kostos së punës direkteve dhe shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit (ku përfshihen material indirekte, puna indirekte dhe shpenzime të tjera), për të gjykuar me komponentët e secilit situacion dhe krahasimin me blerjet e tatueshme.

Nga ana tjetër, nga inspektori tatimor, konstatohet se nuk është kryer një analizë në lidhje me plotësimin e kushteve për klasifikimin e këtyre operacioneve të realizuara nga tatimpaguesi si investime apo jo referuar kërkesave të legjislacionit fiskal dhe standarteve të raportimit financiar. Mungesa e analizës dhe trajtimi i gabuar nuk janë në përputhje me përkesat ligjit për kontabilitetin dhe standarteve në zbatim të tij, konkretisht SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale” ku përcaktohet: Njësia ekonomike njihet koston e një zëri të AAM-ve si një aktiv nëse dhe vetëm nëse:

(a) aktivi kontrollohet nga njësia ekonomike;

(b) është e mundur që nga përdorimi i aktivitetit do të hyjnë në njësinë ekonomike përfitime të ardhshme ekonomike;

(c) kostoja e aktivitetit mund të matet me besueshmëri.

Regjistrimi fillestar i AAM-së bëhet zakonisht në momentin e përftimit të tij nga blerja apo prodhimi.

Kjo pasi nga ana Inspektorit në Raport Kontrolli nuk është detajuar lloji i investimit për punime në karrierë dhe nëse këto punime do të kontribuojnë në sjelljen e përfitimeve të ardhshme ekonomike në mënyrë që të plotësohen kushtet për njohjen e tyre si aktiv në kontroll të njësisë ekonomike.

Nuk rezulton të jetë kryer një analizë në lidhje me lishencat e kërkimit apo zbulimit të tatimpaguesit dhe klasifikimi i tyre si shpenzime kërkimore të cilat nuk plotësojnë kushtet për njohjen si aktiv (investim) apo shpenzime zhvillimi (të cilat kapitalizohen në aktiv të pasqyrave

fiannciare dhe plotësojnë kushtet për njohjen si investim). Për më tepër, referuar dipozitive të udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, situacionet, referohen të përdoren në fushën e punimeve të ndërtimit, sipas përcaktimeve të nenit 20 “Punimet e ndërtimit”, ndërkohë që tatimpaguesi nuk është i licencuar për punime ndërtimore dhe ushtron veprimtarinë sipas objektit të tij në fushën e nxjerrjes së mineraleve. Për rrjedhojë, trajtimi i autofaturimeve me anë të situacioneve, për operacionet e paraqitura të nxjerrjes së mineralit paraqitet i gabuar sipas kuadrit të raportimit financiar dhe atij fiskal. Grupit të auditimit, këto situacione nuk iu vendosën në dispozicion në mënyrë që të gjykohet në lidhje me komponentët e përfshirë në të, si përfshirja e kostos së punës në situacion dhe shpenzimet e tjera të përgjithshme të prodhimit.

-Nga problematikat e evidentuara në raportin e kontrollit përfshihen gjithashtu mungesa e analizimit të kostos së mallrave të raportuara nga tatimpaguesi, e cila rezulton të jetë marrë e mirëqenë nga ana e inspektorit tatimor, pasi nuk rezulton të jetë kryer një analizë në lidhje me komponentët e kostos së paraqitur në raport kontrolli referuar kostos së materialeve të para si dhe procesi të prodhimit.

Mungesa e analizës dhe trajtimi i gabuar nuk janë në përputhje me përkesat ligjit për kontabilitetin dhe standarteve në zbatim të tij, konkretisht SKK 4.

Tatimpaguesi: “V”

Nipti: LT

Adresa kryesore: Rruga nacionale Vlore-Himare, fushe Dukat, objekt 2-katesh nr 1.

Aktiviteti: *Tregti me shumice e peshkut, krustaceve dhe molusqeve.*

Inspektori: E H

Përgjegjës Sektori: I K

Drejtor Kontroll: B P

Drejtori Rajonal: S K

Periudha e kontrolluar: TVSh për periudhën Tetor 2020- Shtator 2022, tatim fitimi 2020-2021 dhe kontributet e të tjera Tetor 2020- Shtator 2022.

Tatimpaguesi ushtron veprimtarinë në shitjen tregtinë e peshkut dhe blerjet kryesore i ka për energji elektrike dhe blerje arkash ndërkohë që shitjet i ka me përshkrimin shërbim paketim peshku për subjekte të ndryshme. Nga analiza e deklarimeve në shitje dhe blerje konstatohet se ka vlerë të shtuar dhe janë kryer analiza nga ana e inspektorit si dhe nuk ka inventar që qarkullon në subjekt dhe nuk ka bilanc material. Sipas shpjegimit të inspektorit tatimor, tatimpaguesi ofron shërbimin e paketimit dhe ruajtjes së peshkut në linjat e ndërtuara për llogari të të tretëve, megjithatë nga auditimi konstatohet se nuk është kryer një analizë në lidhje me inventarin e përpunuar nga tatimpaguesi si dhe arsyen e mos dokumentimit të qarkullimit të këtij inventari të ky tatimpagues për aq kohë sa është në ruajtje. Këto mangësi, rezultojnë që të kenë ndikuar edhe në mos kryerjen e analizës për të ardhurat e realizuara nga tatimpaguesi në lidhje me natyrën e faturimit të tyre, për kg apo orë pune. Gjithashtu sipas informacionit të vendosur në dispozicion në lidhje me këto mangësi për dokumentimin e qarkullimit të inventarit referuar objektit të aktivitetit, konstatohet se ai është kryer duke përdorur faturë shoqërimi. Kjo praktikë konstatohet e gabuar duke qenë se ajo përdoret për lëvizjet ndërmjet vendndodhjeve të të njëjtit tatimpagues, ndërkohë që në këtë rast duhet të ishte përdorur faturë shitje. Për rrjedhojë nga ana e inspektorit tatimor duhet të ishte kryer analiza e qarkullimit të inventarit.

Nga auditimi mbi blerjet e investimit të raportuara nga tatimpaguesi dhe të pasqyruara në raport kontroll konstatohen punime ndërtimi për mirëmbajtjen e godinave në vlerën 4,129,550 lekë dhe tvsh në shumën 825,910 lekë të cilat nuk janë trajtuar në raport kontrolli që të jenë pajisur me lejen përkatëse të ndërtimit për kryerjen e tyre si dhe faktit që të jenë kryer në formën e autofaturimit sipas paraqitjes në raport kontrolli dhe deklarimeve në cats. Tatimpaguesi referuar objektit të veprimtarisë nuk rezulton të jetë i licensuar për kryerjen e veprimeve ndërtimore dhe nuk rezulton të ketë të punësuar punonjës të specializuar për kryerjen e këtyre punimeve të specializuara në lsitëpagesat e raportuara për periudhën objekt kontrolli. Për rrjedhojë, blerjet për të cilat është lejuar kreditimi i tvsh për këto punime rezutojnë të jenë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 20 të Udhëzimit nr. 6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Detyrimet që lindin për TVSH janë në shumën 825,910 lekë dhe gjobë për deklarim të pasaktë në shumën 178,396 lekë.
-Në përfundim për tatimpaguesin “V” Sh.p.k, ka rezultuar detyrim në vlerën totale **1,004,306 lekë** (nga të cilat **825,910 lekë** detyrim për TVSH dhe **178,396 lekë** gjobë).

Tatimpaguesi: “T”

Nipti: KN

Adresa kryesore: Lagjja Uji i Ftohtë, Rruga Nacionale Vlorë-Orikum km 2, objekt 6-katesh, Orikum

Aktiviteti: *Studim projektim dhe ndertim i veprave civile, industriale restaurime, punime dheu, betoni, armature, ujesjelles, kanalizime.*

Inspektori: F S

Përgjegjës Sektori: I K

Drejtor Kontroll: B P

Drejtori Rajonal: S K

Periudha e kontrolluar: Korrik 2021

Kontrolli në këtë tatimpagues është kryer si pasojë e verifikimit dhe qëndrimit fiskal ndaj kërkesës së shoqërisë Nr. Çështje E0000969677 date 27.07.2022, nga Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-se, me objekt: Rimbursim i tepicës kreditore të TVSH-së, në shumën 6,693,076 leke, për periudhën tatimore Korrik 2021.

-Nga auditimi konstatohet se tatimpaguesi ka kryer blerje të investimeve përgjatë periudhës objekt kontrolli për të cilat ka akumuluar pjesën më të madhe të tvsh të kreditueshme përgjatë periudhës objekt kontrolli. Konkretisht akumulimi i tepicës është kryer për shkak të blerjes së një investimi në proces së bashku me lejen e ndërtimit, për shkak të të cilit nga ana e inspektorit tatimor është cilësuar e padrejtë kreditimi i tvsh pasi kontrata është lidhur ndërmjet individëve dhe shoqërisë Turi MZB. Për këtë arsye vlera prej 5,600,852 lekë e tvsh është cilësuar e padrejtë për kreditim dhe mbi këtë shumë janë aplikuar edhe gjoba përkatëse.

-Pavarësisht pjesës së analizës mbi transferimin e lejes së ndërtimit si dhe lindjen e detyrimeve të tvsh për këtë pjesë, nuk rezulton të jetë realizuar bilanci material në lidhje me materialet e ndërtimit dhe situacionet e raportuara në shitje për ti kryqëzuar me sasinë e mallrave në fillim dhe në fund nga ana e inspektorit tatimor. Gjatë analizës së blerjeve të tatueshme të tatimpaguesit janë paraqitur sipas natyrës blerjet nga furnitorë vendas të llojit materiale ndërtimi për të cilat nuk është rakorduar në lidhje me faturimin e tyre në situacione. Gjithashtu edhe shitja e raportuar nga tatimpaguesi si situacion punimesh ndërtimi nuk rezulton të jetë analizuar se në cilin objekt ndërtimor është realizuar, duke qenë jo në përputhje me përcaktimet e bëra në nenin 20 të udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar.

Tatimpaguesi: “A”

Nipti: KE

Adresa kryesore: Bulevardi Ismail Qemali, Lagja Pavarsia, prane statiumit Flamurtari.

Aktiviteti: *Aktivitete te rendit publik dhe sigurimit.*

Inspektori: M K

Përgjegjës Sektori: I K

Drejtor Kontroll: B P

Drejtori Rajonal: S K

Periudha e kontrolluar: T.V.SH periudhat Qershor 2021 – Maj 2023, Tatim fitimi 2021/2022 dhe të tjera për Qershor 2021 – Maj 2023.

Nga auditimi në lidhje me këtë praktikë kontrolli janë konstatuar problematika në raportin e kontrollit tatimor si më poshtë:

-Në blerjet brenda vendit, nuk është kryer analiza e kreditimit të tvsh për karburantin në raport me qarkullimin e realizuar duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e blerjeve referuar llojit të aktivitetit të tatimpaguesit referohet drejt kësaj natyre për ofrimin e shërbimit të sigurimit. Nga librat e blerjeve dhe informacionit të vendosur në dipozicion nga inspektorit taimtor për kartelën e blerjes së karburantit konstatohet se tatimpaguesi për vitin 2022 ka kryer blerje për karburant në shumën 19,471,731 lekë. Në raport me qarkullimin e realizuar gjatë vitit 2022 prej 181,585,388 lekë gjatë vitit 2022 konstatohet se nuk janë respektuar përcaktimet e bëra nenin 55 të UMF nr.6 datë 30.01.2015 ku përcaktohet që “Me kushtin që gazoili i blerë të përdoret vetëm për nevoja të veprimtarisë ekonomike të tatueshme, e drejta për të zbritur TVSH-në ushtrohet deri në normativat e përcaktuara më poshtë sipas veprimtarive. Shpenzimet faktike për gazoilin për çdo veprimtari ekonomike duhet të justifikohen me volumin e punës së kryer, rrugët e realizuara nga mjeti/et, normativat e konsumit të gazoilit për rrugë ose proces të kryer, etj. Në çdo rast, këto shpenzime duhet të jenë të kryera realisht dhe të justifikuara sipas veprimeve të realizuara për nevoja të veprimtarisë ekonomike, të provuara me dokumentacionin përkatës, por jo më shumë se normativat e përcaktuara në këtë udhëzim.”

Duke qenë se tatimpaguesi ushtron veprimtarinë e sigurimit sipas objektit të veprimtarisë, klasifikohet në grupin “V. Të tjera (veprimtari të tjera jo të listuara) deri në 2% dhe për rrjedhojë blerjet e karburantit të lejuara për tu kredituar paraqiten si më poshtë:

Vlera e karburantit e lejuar për tu kredituar në raport me qarkullimin 2% * 181,585,388 = 3,631,708 lekë

Blerje për karburant për vitin 2022 = 19,471,731 lekë

Diferenca karburant i kredituar përtej normativës = 15,840,023 lekë

Detyrim për tvsh nga kreditimi përtej normës 3,168,005 lekë.

Gjobë për tvsh 684,289 lekë

-Në raport kontrolli nuk janë analizuar shitjet drejt tatimpaguesve të realizuara.

-Në raportin e kontrollit tatimor nuk është realizuar bilanci material në sasi dhe në vlerë për të gjykuar në lidhje me inventarin dhe qarkullimin e tij përgjatë periudhës apo atë në mbyllje të periudhës në pasqyrën e pozicionit financiar.

-Në analizën e realizuar për efekt të deklarimit dhe mbledhjes së kontributeve të sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore konstatohet se nga ana e inspektorit është paraqitur vetëm një përmbledhëse në lidhje me rubrikat e listëpagesës sipas periudhave tatimore. Konstatohet se nuk është realizuar një analizë e detajuar e kontratave përkatëse për punonjës, nuk janë analizuar listëprezencat dhe kohëshënuesit me qëllim që të konkludohet në lidhje orët dhe ditët e punuara

ng punonjësit për ofrimin e shërbimit që në shumicën e rasteve për shkak të natyrës së aktivitetit përfshin shërbim të pandërprerë prej 24 orësh. Sipas analizës së listëpagesave në sistemin cats, konstatohet se pjesa më e madhe e punonjësve paraqiten me 22 ditë pune dhe pagë në nivelin e pagës minimale për punonjësit e sigurisë e cila ka një shtesë të përhershme mbi pagën minimale në shkallë vendi. Sipas këtyre deklarimeve të realizuara nga tatimpaguesi, konstatohet se nuk rezultojnë të jenë raportuar aktivitet shërbimi në turne të dyta dhe të treta apo ditë pushimi, për të cilat, referuar Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë duhej të ishin llogaritur tarifa orare me shtesa mbi pagën orare normale prej 20%-50%. Për këto arsye, rezulton se deklaratimet për kontribute të sigurimeve rezultojnë të jenë të nënvlerësuara si pasojë e mos analizimit të kushteve të kontratave të punës, kohëshënuesve reale të ofrimit të shërbimit dhe deklaratimeve në sistemin informatik tatimor. Për këto mangësi, nga ana e inspektorit tatimor nuk janë analizuar siç duhet me efekt edhe në të ardhurat e deklaruara nga tatimpaguesi si pasojë e krahasimit të kostos së ofrimit të shërbimit me çmimin e ofruar për sigurimin e tij.

-Në përfundim për tatimpaguesin "A" SHPK, ka rezultuar detyrim në vlerën totale 3,852,294 lekë (nga të cilat 3,168,005 lekë detyrim për TVSH dhe 684,289 lekë gjobë).

Tatimpaguesi: "K"

Nipti: LL

Adresa kryesore: Lagjja "Kushtrimi", magazine te ish NTUS, Vlorë

Aktiviteti: *"Export – Import dhe shitblerje me shumice dhe pakice e mallrave industrial, ushqimore, blegtorale etj."*

Inspektori: A A

Përgjegjës Sektori: I K

Drejtor Kontroll: B P

Drejtori Rajonal: S K

Periudha e kontrolluar: T.V.SH periudhat Tetor 2019- Shtator 2021, tatim fitimi 2019-2020 dhe të tjera Tetor 2019- Shtator 2021.

-Nga auditimi i kësaj dosje të kontrollit konstatohet se është kryer bilanci material për tre artikuj të cilët për nga vlera e qarkullimit të realizuar dhe gjendjes përfundimtare nuk janë përfaqësues në zgjedhje si për nga vlera ashtu edhe për nga sasia në qarkullim.

Nga auditimi në lidhje me këtë praktikë kontrolli janë konstatuar problematika në raportin e kontrollit tatimor si më poshtë:

-Nga auditimi në lidhje me rakordimin e shpenzimeve sipas pasqyrës së performancës me blerjet e deklaruara në formularin e deklarimit dhe pagesës së tvsh-së konstatohet se nuk është kryer nga ana e inspektorit tatimor në raportin e kontrollit tatimor. Nga kryerja e këtyre e këtyre krahasimeve duke marrë në konsideratë edhe efektin e diferencave ndërmjet gjendjes së inventarit kanë rezultuar diferencat si më poshtë:

Shpenzim për mallra deklaruar në pasqyrën e performancës 2020 = 137,976,688 lekë

Gjendje e mallrave në fillim të periudhës 23,762,713 lekë

Blerjet e periudhës për mallra për rishitje nga importi 131,357,011 lekë

Blerjet e periudhës për mallra për rishitje nga furnitorët vendas 9,048,120 lekë

Gjendje e mallrave në fund të periudhës 27,592,287

KMSH Kosto e mallrave të shitur 136,575,557 lekë.

Diferenca ndërmjet shpenzimeve për mallra në PASH me KMSH llogaritur 137,976,688 – 136,575,557 = 1,401,131 lekë.

Për rrjedhojë, rezulon të jenë mbivlerësuar shpenzimet e periudhës pasi janë më të mëdha se ato të deklaruara në libra për 1,401,131 lekë që pasojnë në një detyrim për tatim fitimi në masën 15% ose 210,167 lekë dhe gjobë në masën 100% në masën 210,167 lekë.

-Në përfundim për tatimpaguesin “K” Sh.p.k, ka rezultuar detyrim në vlerën totale 420,334 lekë (nga të cilat 210,167 lekë detyrim për TF dhe 210,167 lekë gjobë).

Tatimpaguesi: “A”

Nipti: KR

Adresa kryesore: Bulevardi Vlore-Skele, Rruga "Sadik Zotaj", nr. 2/359, kati i dyte, Vlorë.

Aktiviteti: *“Import-eksport, tregetim me shumice e pakice artikuj te ndryshem shtëpiakë në dyqane të specializuara etj.”*

Inspektori: F S

Përgjegjës Sektori: I K

Drejtor Kontroll: B P

Drejtori Rajonal: S K

Periudha e kontrolluar: TVSH Korrik 2020 – Mars 2022, Tatim fitimi 2020, 2021, Të tjera Korrik 2020 – Mars 2022

Tatimpaguesi ushtron veprimtarinë në tregtimin e artikujve industrial si enë guzhine, të cilat kryesisht i merr nga importi dhe i tregton në vend. Në blerjet e përjashtuara ka raportuar kryesisht qera dhe transport. Blerjet nga importi janë blerjet përfaqësuese të taimpaguesit të cilat janë të natyrës mallra për rishitje dhe janë analizuar në raportin e kontrollit tatimor.

-Nga ana e inspektorit tatimor është kryer analiza e deklarimeve të importit në tvsh me ato të paraqitura nga doganat ku janë konstatuar diferenca të cilat janë trajtuar në raportin e kontrollit tatimor.

-Në raport kontrolli rezultojnë të jenë analizuar blerjet nga furnitorë vendas dhe është bërë analiza e kreditimit të karburantit.

-Janë analizuar eksportet e realizuara nga shoqëria për periudhën objekt kontrolli të realizuara drejt Kosovës dhe janë krahasuar me të dhënat e doganës në cats.

-Konstatohet se është kryer analiza e situatës së TVSH-së si dhe është kryer analiza e shitjes mbi kosto për një grup artikujsh dhe gjendjet e sasisë e lëvizjes së tyre për periudhën objekt kontrolli që përbëjnë gati 35% të inventarit të analizuar.

-Janë analizuar pasqyrat financiare dhe janë pasqyruar në raport kontrolli kryqëzimet me rubrikat e deklaratave të për ardhurat dhe shpenzimet.

Tatimpaguesi: “M B”

Nipti: KE

Adresa kryesore: Selenicë, Vlorë

Aktiviteti: Përfshin nxjerrjen dhe prodhimin e bitumit dhe zhavorit bituminoz, i cili realizoet sipas kartes teknologjike.

Inspektori: D B

Përgjegjës Sektori: I K

Drejtor Kontroll: B P

Drejtori Rajonal: S K

Periudha e kontrolluar: Shkurt 2020 – Shkurt 2021 për TVSH

Kontrolli në këtë tatimpagues është kryer në vijim të kërkesës së tatimpaguesit nr. Prot, 21178 date 24.11.2021 në Drejtorinë Përgjithshme të Tatimeve, ku ka bërë kërkesën për rimbursim. Përgjatë periudhës së kontrolluar subjekti ka një pjesë të aktivitetit të përqëndruar në eksporte si dhe gjendja e tepricës kreditore të tvsh ka ardhur edhe nga akumulimi i gjendjes së inventarit në rritje në mbyllje të periudhës në krahasim me çeljen e periudhës së kontrolluar. Gjithashtu, komponenti tjetër nga është akumuluar teprica kreditore e tvsh-së vjen si rrjedhojë e deklaramit të punimeve për nxjerrjen e mineralit si investime në formën e autofaturimeve duke i deklaruar në blerje dhe në shitje si autongarkesë në rubrikën e tvsh-së. Këto autofatura të hartuara nga ana e tatimpaguesit nuk rezultojnë të jenë të detajuara në raportin e kontrollit tatimor. Sipas shpjegimit të inspektorit tatimor ato përfshijnë situacione për punime të realizuara për nxjerrjen e mineralit, “për zbulime në karrierë”, të cilat janë trajtuar si investime.

Nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor nuk rezulton të jetë kryer një kontroll i këtyre situacioneve në mënyrë analitike se çfarë kanë pasur të përfshirë, në elementët e materialeve të para, kostos së punës direkteve dhe shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit (ku përfshihen material indirekte, puna indirekte dhe shpenzime të tjera), për të gjykuar me komponentët e secilit situacion dhe krahasimin me blerjet e tatueshme.

Nga ana tjetër, nga inspektori tatimor, konstatohet se nuk është kryer një analizë në lidhje me plotësimin e kushteve për klasifikimin e këtyre operacioneve të realizuara nga tatimpaguesi si investime apo jo referuar, kërkesave të legjislacionit fiskal dhe standarteve të raportimit financiar. Mungesa e analizës dhe trajtimi i gabuar nuk janë në përputhje me përkesat ligjit për kontabilitetin dhe standarteve në zbatim të tij, konkretisht SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale” ku përcaktohet: Njësia ekonomike njeh koston e një zëri të AAM-ve si një aktiv nëse dhe vetëm nëse:

(a) aktivi kontrollohet nga njësia ekonomike;

(b) është e mundur që nga përdorimi i aktivitetit do të hyjnë në njësinë ekonomike përfitime të ardhshme ekonomike;

(c) kostoja e aktivitetit mund të matet me besueshmëri.

Regjistrimi fillestar i AAM-së bëhet zakonisht në momentin e përfundimit të tij nga blerja apo prodhimi.

Kjo pasi nga ana në raport kontrolli nuk është detajuar lloji i investimit për punime në karrierë dhe nëse këto punime do të kontribuojnë në sjelljen e përfitimeve të ardhshme ekonomike në mënyrë që të plotësohen kushtet për njohjen e tyre si aktiv në kontroll të njësisë ekonomike.

Nuk rezulton të jetë kryer një analizë në lidhje me lishencat e kërkimit apo zbulimit të tatimpaguesit dhe klasifikimi i tyre si shpenzime kërkimore të cilat nuk plotësojnë kushtet për njohjen si aktiv (investim) apo shpenzime zhvillimi (të cilat kapitalizohen në aktiv të pasqyrave fiannciare dhe plotësojnë kushtet për njohjen si investim). Për më tepër, referuar dispozitave të udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, situacionet, referohen të përdoren në fushën e punimeve të ndërtimit, sipas përcaktimeve të nenit 20 “Punimet e ndërtimit”, ndërkohë që tatimpaguesi nuk është i licencuar për punime ndërtimore dhe ushtron veprimtarinë sipas objektit të tij në fushën e nxjerrjes së mineraleve. Për rrjedhojë, trajtimi i autofaturimeve me anë të situacioneve, për operacionet e paraqitura të nxjerrjes së mineralit paraqitet i gabuar sipas kuadrit të raportimit financiar dhe atij fiskal. Grupit të auditimit, këto situacione nuk iu vendosën në dispozicion në mënyrë që të gjykohe në lidhje me komponentët e përfshirë në të, si përfshirja e kostos së punës në situacion dhe shpenzimet e tjera të përgjithshme të prodhimit.

-Nga problematikat e evidentuara në raportin e kontrollit përfshihen gjithashtu mungesa e analizimit të kostos së mallrave të raportuara nga tatimpaguesi, e cila rezulton të jetë marrë e mirëqenë nga ana e inspektorit tatimor, pasi nuk rezulton të jetë kryer një analizë në lidhje me komponentët e kostos së paraqitur në raport kontrolli referuar kostos së materialeve të para si dhe procesi të prodhimit.

Mungesa e analizës dhe trajtimi i gabuar nuk janë në përputhje me përkesat ligjit për kontabilitetin dhe standarteve në zbatim të tij, konkretisht SKK 4.

-Periudha e kontrolluar në raport kontrolli për vitin 2021, përfshin muajt Janar –Gusht 2021, ndërkohë që referuar programi të kontrollit periudha e kontrollit është deri në Shkurt 2021, sipas kërkesës për rimbursimin e TVSH së tatimpaguesit, duke mos përputhur analizën e kryer në raport kontrolli me kërkesën e tatimpaguesit, në kundërshtim me përcaktimet e manualit të kontrollit tatimor dhe duke certifikuar për rimbursim në mënyrë të epadrejtë tepricën kreditore të TVSH-së së miratuar.

Tatimpaguesi: “Ç”

Nipti: KT

Adresë Kryesore: Vlore, lagja Kushtrimi

Aktiviteti: *“Sherbime ne fushen e procesit te ndertimit, mirembajtjes dhe transportit”*

Inspektori: E H

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: 2020 Gusht – 2022 Korrik
- Për Tatim Fitimin periudha tatimore nga: 2020-2021
- Për Sigurimet Shoqërore e Shëndetsore - periudha tatimore nga: 2020 Gusht –2022 Korrik
- Të tjera periudha tatimore nga: 2020 Gusht – 2022 Korrik

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të tatimpaguesit “C”, i cili për periudhën e audituar ka kryer kryesisht punime germimi dhe hapje rruge konstatohet se:

- 1- Nga inspektori i kontrollit nuk janë analizuar mallrat e konsumuar për çdo periudhë.
- 2- Nuk është kryer ndarja e shitjeve të mallrave të cilat rezultojnë në blerje por ndërkohë në shitje subjekti ka deklaruar vetëm gërmime dhe jo shitje të tjera.
- 3- Nuk është analizuar veprimi financiar i blerjes së karburantit pasi rezulton se subjekti ka gjendje në fillim të periudhës së audituar sasi dhe vlera të larta, ndërkohë që vazhdon blerje gjatë periudhës, po kështu konstatohet në gjendje e lart në fund të periudhës, veprim i cili nuk është analizuar nga ana e inspektorit dhe si pasojë lë hapsira për abuzime nga ana e subjektit pasi vlera totale e karburantit gjendje e tejkalon atë të konsumit të periudhës.
- 4- Analiza e konsumit të karburantit nuk është llogaritur sipas nenit 74, pika 1 , shkronja a/ii e ligjit 92/2014 “Per TVSH-ne” i ndryshuar, për përcaktimin e normativave të zbritjes së TVSH-se të perdorur sipas veprimtarive dhe UMF Nr.6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 55, pika I/d me kushtin që gazoili i blerë të përdoret vetëm për nevoja të veprimtarisë ekonomike të tatueshme, e drejta për të zbritur TVSH-në ushtrohet deri në normativen 25 % të peshës specifike që blerjet për gazoil zënë në raport me qarkullimin e tatueshëm, të kryer në kuadër të veprimtarisë ekonomike.

Nga mos kryerja e analizës lidhur me veprimet financiare të sipërpermendura ka sjell diferencë të cilat në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

-Shitje të tatueshme për periudhën gusht 2020 -dhjetor 2021 janë në total 50,789,368 lekë, nga të cilat punimeve të kryera referuar situacioneve dhe raportit të inxhinierit ka kryer punime

gërmime në shumën 25,775,502 lekë, kreditimi i lejuar nga inspektori është në shumën 32% ose në vlerën 8,248,160 leke, kreditimi i lejuar për punimet e kryera duhet të ishte 6,443,875 leke. Diferenca në vlerë të tatueshme është (8,248,160 leke-6,443,875 leke)= 1,804,285 lekë.

-Diferenca 50,789,368 leke - 25,775,502 lekë = 25,013,866 leke e cila nga ana e inspektorit është llogaritur normativa e konsumit të karburantit me 32 % janë punime ndërtim banesash dhe objektesh të ndryshme ku normative e lejuar e konsumit të karburantit është 8% dhe jo 32% që subjektit i është llogaritur nga ana e inspektorit, kreditimi i lejuar nga inspektori është në shumën 32% ose në vlerën 8,004,437 leke, kreditimi i lejuar për punimet e kryera duhet të ishte 2,001,109 lekë (8%). Diferenca në vlerë të tatueshme është(8,004,437 leke- 2,001,109 leke)= 6,003,328 leke.

Për sa konstatohet me sipër subjektit duhet të lindin detyrimet :

<i>Periudha</i>	<i>Gusht 2020- dhjetor 2021</i>
<i>Diferenca në vlerë të tatueshme</i>	7,807,613
Detyrim Tvsh 20%	1,561,523
Gjobë për tvsh 21.6%	337,289
Total	1,898,811

Efkti financiar i shmangur është në shumën 1,898,811 lekë.

Tatimpaguesi: D

Nipti: JS

Adresë Kryesore: Lagjja Pavarësia, Rr.Nermin Vlora, Vlorë

Aktiviteti: *“Prodhim të materialeve të ndërtimit, ndërtime e shtrime rruges, punime dhe gërmime me makina të renda , pune rruges dhe digash etj”*

Inspektori: A A

1-Per **T.V.SH**-ne periudhat Janar 2019 -Maj 2022

2-Per **Tatim fitimin** vitin 2019-2021

3-Per **Sigurimet Shoqerore Shendetsore** Janar 2019 - Maj 2022

4-**Te tjera** Janar 2019 - Maj 2022.

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të tatimpaguesit “D”, konstatohet se:

1-Nga ana e inspektorit nuk është bërë llogaritja dhe ndërtimi i bilancit material të subjektit në raportin e kontrollit.

2-Nuk evidentohet blerja/natyra dhe shuma ne raport kontrolli, fakt ky që e bën të pamundur për grupin e auditimit të verifikojë nëse blerjet e kryera i shërbejnë veprimtarisë së subjektit apo jo dhe nëse për to lejohet kreditimi i TVSH-së sipas përcaktimeve ligjore.

3-Në vitin 2021 vihen re fatura shitje të prera me vlerë minus kundrejt bashkisë Vlorë, të cilat janë anulime faturash të lëshuara kundrejt bashkis. Në rastet e lëshimit të faturave me minus në raportin e kontrollit të mbajtur nga inspektori specifikohet që janë mbajtur procesverbale nga bashkia Vlorë ku pretendohet se volumet e punimeve nuk janë kryer plotësisht, por në dosjen e kontrollit këto procesverbale nuk janë gjendur. Inspektori tatimor specifikon në raportin e kontrollit se për këto pretendime ka mosmarrëveshje midis palëve të cilat janë në proces gjyqësor.

4-Subjekti është pajisur me leje ndërtimi nr. 2/32 date 28.09.2011, me shtyrje leje dy here sipas Vendimit nr. 289, datë 24.05.2019 dhe Vendimit nr. 186, datë 24.04.2020.

Nga raporti identifikohet se subjekti ka kryer Blerje të investimit brenda vendit (autofature) për ndërtimin e një strukture shërbimi pajisur me lejen e ndërtimit të sipërcituar.

Nga auditimi konstatohet se Autofatura me nr.363 e datës 31.01.2019 e shoqërisë D. Shpk me vlerë të tatueshme 700,567 lekë dhe me TVSH 140,113 lekë, autofatura me nr. 370 dhe nr. 371 e datës 28.02.2019, përkatësisht me vlerë të tatueshme 2,670,018 lekë dhe 4,796,881 lekë dhe me TVSH 534,004 lekë dhe 959,376 lekë, autofatura me nr.377 dhe nr. 378 e datës 31.03.2019 me vlerë të tatueshme 2,242,198 lekë dhe 8,893,229 lekë dhe me tvsh 448,440 lekë dhe 1,778,646 lekë, autofatura me nr.388 dhe nr. 389 e datës 30.04.2019 me vlerë të tatueshme 1,396,894 lekë dhe 4,157,814 lekë dhe me TVSH 279,379 lekë dhe 831,563 lekë për blerje investime brenda vendit për ndërtimin e strukturës së sipërcituar nuk i lejohet të zbresë TVSH për blerjet e kryera pasi konsiderohen punime të kryera në shkelje të lejes përkatëse (Për periudhën Janar-Prill 2019 subjekti nuk ka qënë i pajisur me leje ndërtimi). Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenit 69 pika 1 e Ligjit 92/2014 dt.24.07.2014 i ndryshuar si dhe nenit 20 pika 8/d të UMF Nr.6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Fakt ky i paidentifikuar nga Raporti i Kontrollit.

Për sa konstatohet me sipër subjektit duhet ti lindin detyrimet :

Periudha	Janar 2019- Maj 2019
Diferenca në vlerë të tatueshme	24,857,601
Detyrim Tvsh 20%	4,971,521
Gjobë për tvsh 21.6%	1,073,849
Total	6,045,370

Efekt i financiar i shmangur është në shumën 6,045,370 lekë.

Tatimpaguesi: “ T”

Nipti: KN

Adresë Kryesore: Lagjja Uji i Ftohtë, Rruga Nacionale Vlorë-Orikum km 2

Aktiviteti: “Studim projektim dhe ndertim i veprave civile, industriale restaurime, punime dheu, betoni, armature, ujesjelles, kanalizime”

Inspektori: O Sh

Përgjegjës Sektori: I K

Drejtor Kontroll: B P

Drejtori Rajonal: S K

Shqyrtimi i kërkesës për rimbursimin e TVSH-së sipas shkresës DPT, drejtorja e Rimbursimit me nr E00009531103, datë 31.05.2022, për shumën 8.541.624 lekë, periudha e kontrollit: 2019.12-2021.01. Nga auditimi i Raportit të Kontrollit, konstatohet se:

-Nuk është bërë analizë në lidhje me shitjet e tatueshme me shkallë 20%

-Nuk është kryer analiza e bilancit material.

-Nuk është bërë analiza e situacioneve nga fillimi i vitit me ndryshimet përkatëse dhe me mbylljen.

-Nuk është bërë zberthimi i bilancit material në mënyrë që të krahasohen situacionet me blerjet e tatueshme në funksion të veprimtarisë ndërtimore për hotelin e analizuar dhe nuk korrespondojnë me raportin e inxhinierit situacionet me një diferencë prej 1,986,175 lekë (34,140,000 Lekë sipas analizës së inspektorit në raportin e kontrollit dhe 32,618,825 lekë sipas raportit të inspektimit të inxhinierit).

-Subjekti është pajisur me leje ndërtimi Nr.1701, datë 15.01.2020 e cila ndryshon subjektin zhvillues nga “G” e cila ishte pajisur me leje ndërtimi Nr.339, datë 16.01.2018 nga Bashkia Kavajë në subjektin “T” si subjekt zhvillues. Nga raporti identifikohet se subjekti ka kryer

“Blerje te investimit brenda vendit” (autofature) për ndërtimin e një strukture shërbimi pajisur me lejen e ndërtimit të sipërcituar.

Nga auditimi konstatohet se Autofatura me nr.30, datë 31.12.2019 e shoqërisë T. Shpk me vlerë të tatueshme 4,400,000 lekë dhe TVSH 880,000 lekë për blerje investime brenda vendit për ndërtimin e strukturës së sipërcituar nuk i lejohet të zbrësë TVSH për blerjet e kryera pasi konsiderohet punime të kryera në shkelje të lejes përkatëse (*Për periudhën Dhjetor 2019 subjekti nuk ka qënë i pajisur me leje ndërtimi*). Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenit 69, pika 1 e Ligjit 92/2014, datë 24.07.2014 i ndryshuar si dhe nenit 20 pika 8/d të UMF Nr.6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Fakt ky i paidentifikuar nga Raporti i Kontrollit.

Për sa konstatohet me sipër subjektit duhet ti lindin detyrimet :

Periudha	Dhjetor 2019
Diferenca në vlerë të tatueshme	4,400,000
Detyrim Tvsh 20%	880,000
Gjobë për tvsh 21.6%	190,080
Total	1,070,080

Efekti financiar i shmangur është në shumën 1,070,080 lekë.

Tatimpaguesi: “A”

Nipti: LT

Adresë Kryesore: Rradhimë pranë Urës së Katorisë, Rradhimë Vlorë

Aktiviteti: *“Tregtia me pakicë e karburantit për automjete në dyqane të specializuara, Bar restorant ambiente pushimi etj”*

Inspektori: L K

Përgjegjës Sektori: I K

Drejtor Kontroll: B P

Drejtori Rajonal: S K

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH-në, periudha 01.01.2021- 31.08.2022
- Për Tatim Fitimin, vitet 2020-2021
- Për Sigurimet shoqerore dhe shendetësore periudha 01.01.2021– 31.08.2022
- Të tjera: deri 2022/08
- Orë pune: 34 orë

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të tatimpaguesit “A”, i cili për periudhën e audituar ka kryer kryesisht Tregti karburanti dhe Hotel bar restorant konstatohet se:

- Raporti nuk ka të bashkangjitur si pjesë përbërëse të tij “Formulari-pyetësor i vetë deklarimit para kontrollit”, jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6.
- Formulari 3-nuk është nënshkruar nga Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori Rajonal administrohet në dosjen e kontrollit, jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2.
- Është bërë kontrolli i TVSH për periudhën objekt kontrolli dhe krahasimi ndërmjet treguesve sipas FDP-ve dhe të dhënave të Sistemit Informatik, Librave të Blerje, Shitjeve dhe faturave përkatëse.

- Është bërë evidentimi i blerjeve sipas origjinës, blerje brenda vendit dhe i blerjeve që i shërbejnë shitjeve të përjashtuara, por nuk është bërë trajtimi i detajuar me sasi dhe vlerë sipas blerjeve për çdo furnitor.
- Për periudhën objekt kontrolli, është bërë bilanci material vetëm për artikujt gaz i lëngshëm, benzin dhe naftë dhe jo për artikujt ushqimor. Në Raport Kontrolli nuk evidentohen të dhëna për sasit në shitje dhe në blerje të produkteve gaz i lëngshëm, naftë dhe benzin sipas furnitorëve por vetëm në vlera, fakt që e bën të vështirë nxjerrjen e konkluzioni për saktësinë dhe vërtetësinë e bilancit material të deklaruar nga tatimpaguesi. Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e programit të kontrollit pika 1/5 dhe Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.5, Kapitulli VIII, pika 8.
- Nuk është bërë specifikimi për blerjet në vitin 2021 nga furnitori A në shumën me vlerë të tatueshme 1,525,957 dhe TVSH 305,191 lekë me përshkrim elektrike nëse janë blerje të klasifikuara si instalime elektrike apo aktive të tjera materiale. Nuk është bërë specifikimi për blerjet në vitin 2022 nga furnitori A në shumën me vlerë të tatueshme 2,120,184 dhe TVSH 424,037 lekë me përshkrim elektrike nëse janë blerje të klasifikuara si instalime elektrike apo aktive të tjera material. Kjo konstatohet edhe për blerjet e investimit për hidraulike. Nga sqarimet e dhëna nga Inspektori i Kontrollit dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion/fatura tatimore blerjet nga furnitori A kanë të bëjnë me blerje materiale elektrike për zëvendësim të llampave elektrike të hotelit, të prizave dhe të shërbime tjera elektrike.
- Egziston një diferencë përsa i përket blerjeve në analizën e KMSH-së ku përcaktohen blerjet në shumën 26,576,941 lekë ndërkohë që sipas analizës së Raportit të Kontrollit të blerjeve nga furnitorët vëndas rezulton në 26,982,774 lekë.
- Nuk është bërë identifikimi nga ana e inspektorit të kontrollit që subjekti tatimpagues i cili ushtron shkallën e reduktuar të TVSH-së në fushën e strukturave akomoduese duhet të jetë i regjistruar si person i tatueshëm më vete përsa i përket ushtrimit të veprimtarisë në fushën e strukturave akomoduese dhe në vete sa i përket veprimtarive të tjera, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e nenit 11/1 të VKM-së nr.953, datë 29.12.2014.
- Nga kontrolli për zbatimin e kërkesave të ligjit Nr. 9136 datë 11.02.2003 “Për mbledhjen e detyrueshme të kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore”, kanë rezultuar problematikat si më poshtë:
 - Nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor nuk janë analizuar kontratat individuale të punës midis shoqërisë dhe punonjësve, në lidhje me përputhshmërinë e tyre më përcaktimet e dispozitave të Kodit të Punës në R.SH.
 - Nuk janë analizuar regjistrat që duhet të mbajë tatimpaguesi sipas përcaktimeve të nenit 15 “Mbajtja e regjistrimeve” të Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
 - Nuk ka një analizë të llogaritjes së pagës dhe elementëve përbërës të saj sipas përcaktimeve të dispozitave të nenit 119 të të Kreut XI të Kodit të Punës në R.SH.
 - Janë konstatuar parregullësi në llogaritjen e ditëve dhe orëve të punës dhe pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore.
 - Nga kontrolli i listë pagesave të subjektit të deklaruar në sistemin C@ts për periudhën 11/2020-03/2022, ka rezultuar se shoqëria ka deklaruar për punonjësit 26 ditë pune që është në tejkallim të kohëzgjatjes normale të punës prej 174 orë në muaj ose 22 ditë pune, pa ndryshuar pagën minimale dhe pagesa për ditët shtesë duhet të kryhet me një shtesë jo më pak se 25% të pagesës të ditës normale sipas përcaktimeve të Kreut IX të Kodit të Punës në R.SH.

-Gjithashtu referuar natyrës së aktivitetit që ushtron ky tatimpagues “Tregti me pakice e shumice e karburantit” dhe orarve të ushtrimit të aktivitetit ta pandërprerë gjatë një ditë 24 orë, si dhe gjatë ditëve të pushimi e shtunë dhe e djelë, konstatohet se nuk është bërë një analizë për deklarimin e pagave reale me qëllim llogaritjen dhe pagesën detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Theksojmë se fenomeni i mosdeklarimit të pagave reale shoqërohet me pasoja sociale për të punësuarit, ndikimin në zhvillimin ekonomik të vendit si dhe pasoja të drejtëpërdrejta në skemën e pensioneve, duke sjellë uljen e ndjeshme të nivelit të pensionit në raport me pagën mesatare që ka vendi.

-Në mungesë të të dhënave për regjistrat që duhet të mbajë tatimpaguesi, për efekt të llogaritjes së ditëve dhe orëve të punës për pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe natyrës së aktivitetit që ushtron ky tatimpagues, kontatohen diferencat si më poshtë:

d) Rasti 1

Fasha orare 19⁰⁰-22⁰⁰, shtesë mbi pagë 20% sipas përcaktimeve të Kodit të Punës, i ndryshuar, Kreu IX, Nenit 81, pika 1.

Diferenca në pagë bruto për 1 muaj është: $(3 \text{ orë} * 22 \text{ ditë} * 172.4 \text{ lekë/paga orare} * 0.2 \text{ shtesë page}) = 2275 \text{ lekë}$.

e) Rasti 2

Fasha orare 22⁰⁰-06⁰⁰, shtesë mbi pagë 50% sipas përcaktimeve të Kodit të Punës, i ndryshuar, Kreu IX, Nenit 81, pika 1.

Diferenca në pagë bruto për 1 muaj është: $(8 \text{ orë} * 22 \text{ ditë} * 172.4 \text{ lekë/paga orare} * 0.5 \text{ shtesë page}) = 15,171 \text{ lekë}$

f) Rasti 3

Dita e djelë, shtesë mbi pagë 25%, sipas përcaktimeve të Kodit të Punës, i ndryshuar, Kreu IX, Nenit 87, pika 1.

Diferenca në pagë bruto për 1 muaj është: $(96 \text{ orë} (4 \text{ ditë punë}) * 172.4 \text{ lekë/paga orare} * 0.25 \text{ shtesë page}) = 4137 \text{ lekë}$.

Në lidhje me situatën e trajtuar më sipër grupi i audituesve gjykon se janë arsye themelore për të kryer rivlerësimin e pagave, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, për punonjësit me paga të deklaruara jo konform përcaktimeve të legjislacionit, në lidhje me këtë tatimpagues i cili ka plotësuar deklarata tatimore që përmbajnë të dhëna të pasakta ose të falsifikuara dhe nuk mban dhe ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve, veprime të cilat janë në kundërshtim me *germën b, c të nenit 71, gërma a e nenit 72 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.24 date 02.09.2008, i ndryshuar në zbatim të tij*, Penalizmi i subjektit duhet të ishte bërë sipas llogaritjeve të mëposhtme në bazë të pikës 3 të nenit 119 “Mosdeklarimi i punonjësve dhe fshehja e pagës” të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar.

Muaj	Diferenca Rasti 1	Diferenca Rasti 2	Diferenca Rasti 3	Total Diferenca pagë bruto
Janar 2022-Tetor 2022	18,205	121,368	33,096	172,669
Total				

Nr	Emërtimi	Vlera
1	Efekt i shtesë në pagë bruto rivlerësuar	172,669

2	Diferenca Sig Shoq dhe Shende (27.9%)	48,173
6	Detyrimi per sigurimet shoqerore dhe shendetesore	48,173
7	Gjobë Sig Shoq dhe shendetesore (100%)	48,173
8	Total detyrimi	96,346

-Në përfundim për tatimpaguesin A, ka rezultuar detyrim në vlerën totale 96,346 lekë (nga të cilat 48,173 lekë detyrim për Sig.Shoqërore dhe Shëndetsore, 48,173 lekë detyrim për gjobë).

Tatimpaguesi: “T” SHPK, NIPT: MR.

Adresa kryesore: Rruga Çamëria, Çobo Center, Vlorë.

Aktiviteti: Hotele dhe struktura të ngjashme. (Sipas përshkrimit të QKB-së: Aktivitet në fushën e hotelierisë, turizmit, bar-restorant, tregti dhe shërbime të tjera. Investitor e aktivitete në fushën e ndërtimit dhe restaurim objektsh civile, industrial, turistike etj).

Inspektor Kontrolli: J F

Përgjegjës Kontrolli: I K

Drejtor Kontrolli: B P

Drejtor Rajonal: S K

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- TVSH, periudha tatimore Korrik – Dhjetor 2021

Saktësimi i kërkesës për rimbursim është kërkuar në DPT nga tatimpaguesi “T”, me NIPT MR, e protokolluar me shkresën nr. 1322/1, datë 08.02.2022, në vlerën 7,090,738 lekë. Në përfundim të kontrollit subjektit i është njohur si TVSH e rimbursueshme vlera 6,967,538 lekë (pasi të jenë shlyer nga tatimpaguesi, detyrimet tatimore ekzistuese, si dhe t’i zbritet nga teprica kreditore, vlera e zbuluar nga kontrolli prej 123,200 lekë).

Nga ana e grupit të auditimit janë verifikuar të gjitha dokumentacionet e paraqitura në sistemin C@ts dhe në dosjen e kontrollit, ku ka rezultuar se:

Kontrolli në subjekt ka filluar me Program kontrollin nr. 2150/2 prot., datë 18.02.2022.

- Nga auditimi u konstatua se në dosje mungon dokumenti i pronësisë së “T” SHPK, e justifikuar me Certifikatë apo Vërtetim pronësie nga ASHK Vlorë.

- Më datë 22.07.2021, zhvilluesi “T” ka bërë kërkesën me nr. AN220720210052, në Bashkinë Vlorë, për pajisjen me deklaratë paraprake për kryerje punimesh për objektin “ndarje e ambjenteve të brendshme” në objektin “3-5-12 kate me 1 kat parkime nëntokë”, pasuria Njësi, kati i dytë, sipas Vërtetimit hipotekor të ZVRPP Vlorë nr. 226 datë 25.01.2013.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se, zhvilluesi “T”, i ka kryer punimet me Vendimin nr. 561, datë 27.07.2021, “Për miratimin e deklaratës për kryerje punimesh”, nënshkruar elektronikisht nga Drejtori i Drejtorisë së Urbanistikës z. J më datë 30.07.2021, Kontrolluesi z. R H. më datë 27.07.2021, por pa nënshkrimin dhe vulën e Kryetarit të Bashkisë Vlorë. Veprim ky në kundërshtim me kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë, me nenin 5, pika 1.3/b, “Autoritetet përgjegjëse”, të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”. Me pikën nr. 4, të nenit 99, dhe 109 “Kërkesat e formës së aktit administrativ të shkruar në letër ose elektronik” të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”. Me nenin 4 “Vlefshmëria ligjore e nënshkrimeve elektronike” të ligjit nr. 9880, datë 25.2.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, si dhe neni 7 dhe 8 i VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.

Për pasojë DRT Vlorë nuk duhet të vijonte me procedurën e rimbursimit për blerjet e kryera në vlerën e tatueshme 33,845,497 lekë dhe TVSH 6,769,099 lekë, pa saktësuar më parë vërtetësinë

e deklaratës paraprake të lëshuar nga Bashkia Vlorë, dokument mbi bazën e të cilit janë kryer punimet për objektin “Ndarje e ambjenteve të brendshme”.

Inspektori i kontrollit nuk ka kryer verifikimet përkatëse sipas legjislacionit tatimor, mungon korespondenca me institucionet vendore, për pasojë rimbursimi i kryer, në mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor, ka sjellë efekte financiare në të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit. Sa më sipër, subjektit i lindin detyrime në zbatim të pikës nr. 3, të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Nga grupi i auditimit janë llogaritur detyrimet përkatëse.

Detyrimi për TVSH: 6,769,099 lekë

Penaliteti 20%: 1,353,920 lekë

Detyrimi total: 8,123,019 lekë

Në total, detyrimet tatimore për këtë tatimpagues në këtë praktikë kontrolli, paraqiten për TVSH në shumën 8,123,019 lekë.

Tatimpaguesi: “T” SHPK, NIPT: LS

Adresa kryesore: Rrethi Skelë, Vlorë.

Aktiviteti: Tregtimi i aparaturave për sisteme të transmetimit dhe marrjes së valëve televizive. Prodhimi, transmetimi dhe shitja në mënyrë digitale të produkteve dhe shërbimeve audio dhe video. (Sipas përshkrimit të QKB-së: Shërbime radio-televizive).

Inspektor Kontrolli: F S

Përgjegjës Kontrolli: I K

Drejtor Kontrolli: B P

Drejtor Rajonal: S K

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- TVSH, periudha tatimore Tetor 2020 – Korrik 2022

- Tatim Fitimi, periudha tatimore 2020-2021

- Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore, periudha tatimore Tetor 2020 - Korrik 2022

- Të tjera, periudha tatimore Tetor 2020 - Korrik 2022

Nga ana e grupit të auditimit janë verifikuar të gjitha dokumentacionet e paraqitura në sistemin C@ts dhe në dosjen e kontrollit, ku ka rezultuar se:

Me Njoftimin e kontrollit nr. 7380 prot., datë 05.10.2022, dhe të Programit të kontrollit nr. 7380/2 prot., datë 05.10.2022, tatimpaguesi “T” SHPK, i është nënshtruar kontrollit të plotë tatimor.

- Në Pasqyrën e Aktiveve Afatshkurtra, periudha paraardhëse për viti 2020, në zërin «Inventar», «Mallra për rishitje», vlera 4,000,000 lekë i përket sasisë 1000 copë aparate, e dhënë kjo, nga inventari në fund të vitit 2020, deklaruar nga subjekti në sistemin C@ts. Ndërsa në periudhën raportuese për viti 2021, ky zë paraqitet në vlerën 17,929,727 lekë.

Nr.	Aktivet Afatshkurtra	Periudha Raportuese 2021	Periudha Paraardhëse 2020
3	Inventari		
	Mallra për rishitje	17,929,727	4,000,000

Nga inspektori i kontrollit na u komunikua se për vitin 2021, kjo rritje në vlerë, ka ardhur pasi subjekti ka mbajtur në të njëjtin zë «*Mallra për rishitje*», Aparatet/dekoder tokësor së bashku me Shërbimin e transmetimit kabllor, veprime këto në kundërshtim me nenin 15, “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve” i ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Nga të dhënat e inventarit të aparateve/dekoder në fund të vitit, i deklaruar nga subjekti në sistemin C@ts, sasia është 700 copë, me vlerë totale 2,800,000 lekë. Ndërsa sipas bilancit material të kryer nga inspektori, sasia e aparateve/dekoder në fund të vitit 2021, është 152 copë.

Aparate/Dekoder	Copë	Lekë/Njësi	Totali
Inventar fundviti 2020	1000	4,000	4,000,000
Inventar fundviti 2021	700	4,000	2,800,000
Bilanci material	152		

Konstatohet diferencë në aparate/dekoder në sasinë 548 copë, e cila llogaritet (548 copë * 4,000 lekë/copë = me vlerën 2,192,000 lekë). Inspektori i kontrollit nuk ka kryer verifikimet e subjektit sipas legjislacionit tatimor ku diferenca e përmenduar sjell efekte financiare. Veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, neni 124 “*Moslëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i moslëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore*”. Sa më sipër, tatimpaguesit i linden detyrime për vlerën 2,192,000 lekë:

TVSH 20% : 438,400 lekë

Penaliteti 100% i 438,400 : 438,400 lekë

Detyrimi për TF 15%: 328,800 lekë

Penaliteti 100% i 328,800 : 328,800 lekë

Detyrimi total: 1,534,400 lekë

Në total, detyrimet tatimore për këtë tatimpagues në këtë praktikë kontrolli, paraqiten në shumën 1,534,400 lekë.

Tatimpaguesi: “H” SHPK, NIPT: KO

Adresa kryesore: Pranë Kampit të Punëtorëve, Dhërmi, Vlorë.

Aktiviteti: “*Shërbime në fushën e turizmit: hoteleri, agjensi turistike, bar, restorante, akomodim në çadra plazhi, shezllona etj. Investime në fushën e ndërtimit, kryerja e ndërtimeve të të gjitha llojeve. Punimet e armaturave. Përpunimin e hekurit në ndërtim etj. (vazhdon edhe më tepër sipas përshkrimit të QKB-së)*”.

Inspektor Kontrolli: A A

Përgjegjës Sektori: I K

Drejtor Kontrolli: B P

Drejtor Rajonal: S K

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- TVSH, periudha tatimore Tetor 2021- Shtator 2022

Saktësimi i kërkesës për rimbursim është kërkuar në DPT nga tatimpaguesi “H” SHPK, me nr. çështje E0001041785, datë 28.12.2022, në shumën 18.298.506 lekë.

Në përfundim të kontrollit, i është njohur si TVSH e rimbursueshme vlera 17.551.689 lekë. (Nga kjo shumë do të kompesohen të gjitha detyrimet tatimore të papaguara që rezultojnë në sistemin C@ts në momentin e kryerjes së rimbursimit).

Nga ana e grupit të auditimit janë verifikuar të gjitha dokumentacionet e paraqitura në sistemin C@ts dhe në dosjen e kontrollit, ku ka rezultuar se:

- Programi i kontrollit nuk është hedhur në sistemin C@ts, veprim jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor, kapitulli II, pika 2.2 “Pasqyrimi i veprimeve të kontrollit në programin informatik të tatimeve C@ts”.

- Formulari nr. 3, i hedhur në sistemin C@ts nuk ka nënshkrimin e inspektorit të kontrollit, veprim ky jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor, kapitulli II, pika 2.2.

- Raporti nuk ka të bashkëngjitur si pjesë përbërëse të tij “Formulari-pyetësor i vetëdeklarimit para kontrollit”, që i vihet në dispozicion tatimpaguesit së bashku me njoftimin për kontroll dhe plotësohet prej tij në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 81/f, brenda 30 ditëve para fillimit të kontrollit në vend, të përcaktuar në Njoftimin për kontroll, sipas formatit të miratuar (shtojca 1) me Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar. Veprim jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6.

- Nga ana e inspektorit të kontrollit nuk është bërë analizë e detajuar e blerjeve të përjashtuara në vlerën 12,347,692 lekë, si dhe të blerjeve të investimeve nga furnitorë me shkallë tatimore 20 %, për të vërtetuar nëse këto blerje i shërbejnë subjektit në aktivitetin e tij. Por, nga ana e tij, janë paraqitur vetëm blerjet nga furnitorët më të mëdhenj me vlerë të tatueshme 99,632,160 lekë dhe TVSH e zbritshme në vlerën 19,926,432 lekë. Veprim ky në kundërshtim me nenin 80, “Kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, me nenin 59 “Përgjegjësitë dhe detyrat e inspektorit të sektorit të kontrollit në vend”, të “Rregullores së funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore”, i ndryshuar, miratuar nga Ministri i MFE me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, Programit të kontrollit nr. 195 prot, datë 11.01.2023, si dhe me Manualin e Kontrollit Tatimor.

- Për periudhën tetor 2021 – shtator 2022, është kryer bilanci i materialeve lëndë e parë dhe ndihmëse, ku është përfshirë edhe artikulli Beton M200, M370 dhe M371, detajuar si më poshtë:

Tabela: ”Bilanci material periudha tetor 2021 – shtator 2022”

Në lekë

Bilanc Material		Gjendje 01.10.2021		Hyrje		Dalje		Gjendje 30.09.2022	
Përshkrimi	Njësia	Sasi	Vlera	Sasi	Vlera	Sasi	Vlera	Sasi	Vlera
Beton M200	m3	0	0	1349	9,784,807	1234	8,911,528	115	873,280
Beton M370	m3	115	873,279	1600	12,623,949	1639	12,766,785	76	730,443
Beton M371	m3	77	735,250	484	5,206,909	560	5,937,352	0	0
Totali		192	1,608,529	3433	27,615,665	3433	27,615,665	191	1,603,723

Shënim: Burimi i të dhënave: DRT Vlorë; Punoi: KLSH

Nga të dhënat e tabelës rezulton se, me sasinë dhe vlerën e artikullit “Beton M370” gjëndje më datë 01.10.2021, paraqitet artikulli “Beton M200” më datë 30.09.2022, si dhe me sasinë dhe vlerën e artikullit “Beton M371”, gjëndje më datë 01.10.2021, paraqitet artikulli “Beton M370” gjëndje më datë 30.09.2022.

Nga kryqëzimi i librave të shitjeve me ato të blerjeve në sistemin c@ts, rezulton se nuk është deklaruar nga tatimpaguesi shitja e artikullit Beton M200, M370 dhe M371. Ky material nuk mund të magazinohet pasi i bashkëlidhet procesit të ndërtimit. Për diferencat të cilat kanë rezultuar “shitje pa faturë” do të kryhet penalizimi sipas ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 121 “Mallrat e pashoqëruara me dokumente tatimore” pika 1/b, si dhe neni 124, i këtij ligji. Rivlerësim i shitjeve për mallrat pa faturë në vlerën 1,603,723 lekë, është si më poshtë:

Detyrimi për TVSH 20%: 320,745 lekë
 Penaliteti i TVSH 100%: 320,745 lekë
 Detyrimi për TF 15%: 240,558 lekë
 Penaliteti i TF 100%: 240,558 lekë
Detyrimi total: 1,122,606 lekë

-Referuar dokumentacionit të ngarkuar në sistemin C@ts, subjekti “H” SHPK, me NIPT KO, për ushtrimin e veprimtarisë si strukturë akomoduese, kategoria: “Hotel” është pajisur me Certifikatë Kategorizimi nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në datë 19.02.2020, nr. Regj. 601/2020.

Në analizën e kontrollit të shitjeve të tatueshme, inspektori ka paraqitur në RPK në mënyrë të përmbledhur shitjet për periudhën Tetor 2021 - Shtator 2022, si dhe ka ndarë shitje të tatueshme me shkallë 20% nga shitjet e tatueshme me shkallë 6%, por nuk ka detajuar nëse shitjet e tatueshme me shkallë 6% janë aplikuar vetëm për strukturën akomoduese Hotel, pasi subjekti sipas regjistrimit në QKB, vepron edhe në aktivitete si: agjenci turistike, bar-restorant, akomodim në çadra plazhi, shezllona. Sipas FDP-ve të deklaruara nga subjekti, për periudhën e kontrollit Tetor 2021 - Shtator 2022, ka kryer shitje të tatueshme si më poshtë:

Tabela: ”Shitje të tatueshme me shkallë 20% dhe 6%”

Në lekë

Emërtimi i shitjeve	Tetor 2021 – Shtator 2022	
	Vlera e Tatueshme	TVSH
Shitje të tatueshme me shkallë 20%	127,241,176	25,448,237
Shitje të tatueshme me shkallë 6%	46,290,094	2,777,402

Burimi: Raporti i kontrollit tatimor DRT Vlorë, përpunuar nga grupi i auditimit i KLSH.

Referuar përcaktimeve të ligjit 92/2014, datë 24.07.2014 “Për TVSH-në” i ndryshuar, neni 49, pika 3. Vendimi nr. 953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”, neni 11/1, i cili citon: “Personat e tatueshëm, që aplikojnë shkallën e reduktuar të TVSH-së sipas këtij neni, janë personat që ushtrojnë vetëm veprimtari ekonomike në fushën e strukturave akomoduese, sipas legjislacionit të fushës për turizmin. Nëse personi i tatueshëm ushtron edhe veprimtari të tjera, përveç asaj në fushën e strukturave akomoduese, atëherë duhet të jetë i regjistruar si person i tatueshëm më vete, për qëllime të veprimtarisë në fushën e strukturave akomoduese”.

Inspektori i kontrollit nuk ka kryer verifikimet e subjektit sipas legjislacionit tatimor ku diferencat e përmendura sjellin efekte financiare. Sa më sipër, në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 68 “Vlerësimi tatimor” pika 4 dhe 5/b, si dhe neni 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, pika 3, tatimpaguesit “H” SHPK i linden detyrimet për vlerën 46,290,094 lekë:

Detyrimi për TVSH (20% - 6%): 6,480,613 lekë
 Penaliteti 20%: 1,296,123 lekë
Detyrimi total: 7,776,736 lekë

Në total, detyrimet tatimore për këtë tatimpagues në këtë praktikë kontrolli, paraqiten për TVSH në vlerën 8,899,342 lekë.

Tatimpaguesi: “H Group” SHPK, NIPT: LT

Adresa Kryesore: Rruga Vlorë – Orikum, km 12, objekti nr. 1.

Aktiviteti: “Aktivitet në fushën e ndërtimit, hoteleri, restorante, bar-kafe, agjensi turistike, menaxhim turizmi, etj. Ndërtime civile industriale-turistike-bujqësore. Aktivitet në fushën e transportit. Import-Eksport. Tregti me shumicë dhe pakicë të mallrave të ndryshëm industrial ushqimor dhe karburante. (vazhdon edhe më tepër sipas përshkrimit të QKB-së).”

Inspektor Kontrolli: E H

Përgjegjës Sektori: I K

Drejtor Kontrolli: B P

Drejtor Rajonal: S K

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- TVSH, periudha tatimore Gusht 2020 - Gusht 2022

Nga ana e grupit të auditimit janë verifikuar të gjitha dokumentacionet e paraqitura në sistemin C@ts dhe në dosjen e kontrollit, ku ka rezultuar se:

- Njoftimi i kontrollit është me nr. 8188 prot., datë 01.11.2022, ndërkohë kontrolli në subjekt ka filluar më datë 09.11.2022, me Program kontrolli nr. 8188/2 prot., datë 01.11.2022, për periudhën Gusht 2020 - Gusht 2022. Objekti i kontrollit është shqyrtimi i kërkesës për rimbursimin e TVSH, kërkuar në DPT me nr. çështje E0001000589, datë 25.10.2022, nga tatimpaguesi “H Group” me NIPT LT, për shumën 41,168,251 lekë.

Në Raport, inspektori i kontrollit është shprehur se, “nga shqyrtimi i dosjes së tatimpaguesit u konstatua se shoqëria, për periudhën Gusht 2020 - Prill 2022, është kontrolluar nga Drejtorja e Tatimeve sipas Njoftim kontrollit nr. 5633 prot., datë 29.06.2022. Përsa më sipër dhe në bazë të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, për periudhën e kontrolluar më parë, nuk do të kryhet kontroll, por do të merren në konsideratë rezultatet e saj për shqyrtimin e kërkesës për rimbursim të TVSH së zbritshme. Periudha e cila do të kontrollohet dhe do t’i bashkëngjitet analizës të kryer në kontrollin e mëparshëm, **do të jetë Maj – Gusht 2022**. Për periudhën Gusht 2020 – Prill 2022, do të pasqyrojmë analizën e kryer në Raport kontrollin e mëparshëm nr. 5633 prot., datë 29.06.2022”.

Kontrollit tatimor është kryer nga muaji Janar deri në Gusht 2022.

- Sipas analizës së bërë nga inspektori tatimor në Raport kontrolli, arsyet e krijimit të TVSH së zbritshme kreditore, janë se, “shoqëria “H Group” po ndërton një objekt të cilin do e përdorë për qëllime të aktivitetit të saj të tatueshëm. Në bazë të ligjit 92/2014 “Për TVSH-në” shoqëria përfiton të drejtën e zbritjes për punimet e ndërtimit të kryera në objekt dhe mallrat e blera po në funksion të veprimtarisë së tatueshme. Vlera e situacioneve të punimeve të ndërtimit, mallrave apo shërbimeve të kryera, përbën tepricën kreditore të TVSH të kërkuar për rimbursim. Nga shuma e kërkuar prej 41,168,251 lekë, shuma e cila do të miratohet dhe do vazhdojë procedurën për rimbursim është në vlerën 40,711,585 lekë”.

Sipas të dhënave në sistemin C@ts, në situatën financiare të tatimpaguesit, rezulton se teprica kreditore e TVSH, për periudhën janar–gusht 2022, është në vlerën 3,335,993 lekë.

Nga auditimi rezulton se subjekti “H Group” nuk disponon leje ndërtimi. Leja zhvillimore nr.1, datë 04.02.2015, me afat deri në 20.09.2018, për ndërtimin e objektit Strukturë shërbimi “Kompleks hotelerie 4 kate me 1 kat parkim nëntokë (3 objekte)” në Nisi, Radhimë, lëshuar nga Bashkia Orikum, është lëshuar në emrin e sipërmarrësit H. SHPK me NIPT JI. Të dy shtyrjet e afateve të lejes nr. 1146, datë 24.10.2018 dhe nr. 188, datë 17.03.2021, janë bërë në emrin e shoqërisë H. SHPK me NIPT JI.

Sa më sipër, tatimpaguesit nuk i kreditohet vlera e TVSH për blerjet e mëposhtme:

Tabela: “Blerje furnitorë vendas me 20 %”

NIPT	Emri i shitësit	Vlera e tatueshme 20%	TVSH 20 %	Në lekë Përshkrimi
KH	B	1,811,715	362,343	Llamarinë, panele
KH	B	5,032,210	1,006,442	Pllaka, mobilim hoteli
KP	S	622,440	124,488	Materiale elektrike
LP	M	616,525	123,305	Ndriçimi i hotelit

Totali		8,082,890	1,616,578
---------------	--	------------------	------------------

Burimi: Raporti i kontrollit tatimor DRT Vlorë, përpunuar nga grupi i auditimit i KLSH.

Nga ana e inspektorit nuk janë kryer verifikimet e subjektit sipas legjislacionit tatimor, ku vlera e TVSH e përmenduar në tabelën më sipër, sjell efekte financiare të shmangura me efekt të ardhura të mungura në buxhetin e shtetit. Subjektit “H Group” i linden detyrimet për vlerën e TVSH 1,616,578 lekë, sipas përcaktimeve të pikës nr. 3, të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Detyrimi për TVSH: 1,616,578 lekë

Penaliteti 20%: 323,316 lekë

Detyrimi total: 1,939,894 lekë

Në total, detyrimet tatimore për këtë tatimpagues në këtë praktikë kontrolli, paraqiten për TVSH në vlerën 1,939,894 lekë.

Tatimpaguesi: “F” SHPK, NIPT: LK

1. Adresa kryesore: Lagjja “Osman Haxhiu”, Rruga “Demokracia”, objekti nr. 1, Vlorë.

Adresa dytësore:

2. Autostrada “100 Vjetori i Pavarësisë”, Levan-Vlorë km 13, Autogrillë, hotel 4 kate, lavazh dhe pikë furnizimi. Zona kadastrale 2689 me SN-368293-10-15;

3. Autostrada “100 Vjetori i Pavarësisë”, Vlorë-Levan km 13, Autogrillë, hotel 4 kate, lavazh dhe pikë furnizimi. Zona kadastrale 2689 me SN-368300-10-15;

4. Lagjja “24 Maji”, Rruga “Enver Jaho”, pranë Stacionit të Trenit, godina nr.1 me SN-322510-08-15. Objekt shërbimesh 4 kate + shërbimi 2 kate (kati përdhe karburant, kati 1 lokal me konstrukcion të lehtë).

Aktiviteti: “Tregtim me pakicë të karburanteve dhe të gazit. Bar-Kafe, Restorante, Hoteleri, Lavazh, Servis, Pjesë këmbimi, Kalçeto, Tregti me shumicë e pakicë, import-eksport të mallrave të ndryshëm industrialë dhe ushqimorë dhe konfeksione. Ndërtim. Prodhim i materialeve, etj. (vazhdon sipas përshkrimit të QKB-së)”.

Inspektor Kontrolli: D F

Përgjegjës Sektori: I K

Drejtor Kontrolli: B P

Drejtor Rajonal: S K

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- TVSH, periudha tatimore Mars 2018 - Gusht 2020

- Tatim Fitimi, periudha tatimore 2017-2019

- Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore dhe Tap, periudha tatimore Mars 2018 - Gusht 2020

- Të tjera deri në Gusht 2020.

Nga ana e grupit të auditimit janë verifikuar të gjitha dokumentacionet e paraqitura në sistemin C@ts dhe në dosjen e kontrollit, ku ka rezultuar se:

- Autorizimi për kontroll tatimor, njoftimi i kontrollit, programi i kontrollit nr. 1756/2 prot., datë 08.04.2021, vetëdeklarimi për konfliktin e interesit, si dhe procesverbalet e plotësuara më datë 17.05.2021, ditën e fillimit të punës në subjekt, janë pasqyruar në sistemin C@ts më datë 23.07.2021, veprime në kundërshtim me Manualin e Kontrollit, pika 2.2 “Pasqyrimi i veprimeve të kontrollit në programin informatik të tatimeve C@ts”.

- Subjekti “F” në periudhën objekt kontrolli tatimor, ka investuar në dy objekte:

1. Autostrada “100 Vjetori i Pavarësisë”, Levan-Vlorë km 13, Autogrillë, hotel 4 kate, lavazh dhe pikë furnizimi. Zona kadastrale 2689 me SN-368293-10-15;

2. Autostrada “100 Vjetori i Pavarësisë”, Vlorë-Levan km 13, Autogrillë, hotel 4 kate, lavazh dhe pikë furnizimi. Zona kadastrale 2689 me SN-368300-10-15;

- Shoqëria “F.” disponon Licensën NZ. 7449, të regjistruar në Regjistrin themeltar që nga data 21.11.2016, për ushtrimin e veprimtarisë ndërtuese.

- Nga kryqëzimi i të dhënave në sistemin C@ts dhe dokumentave në dosje, rezulton se tatimpaguesi “F” SHPK, ka deklaruar situacione punimesh (autofatura) për periudhën shkurt 2017- shtator 2019, në total në vlerë të tatueshme 91,531,887 lekë dhe me TVSH 18,306,377 lekë, të cilat janë kryer sipas përcaktimeve të nenit 20, të Udhëzimit nr. 6, datë 30.01.2015, i ndryshuar.

Analiza e shitjeve të tatueshme me shkallë 6%.

Nga auditimi konstatohet se tatimpaguesi ka deklaruar shitje të tatueshme me 6%, për aktivitetin e hotelerisë, periudha tatimore mars – dhjetor 2018, në vlerën e tatueshme 1,039,279 lekë, si dhe për periudhën janar – dhjetor 2019, në vlerën e tatueshme 709,625 lekë. Nga verifikimi në sistemin c@ts konstatohet se tatimpaguesi ka marrë Certifikatë Kategorizimi më datë 15.04.2022 me nr. Regj.1413/2022, për ushtrimin e veprimtarisë si strukturë akomoduese kategoria “Hotel”.

Analiza e blerjeve të tatueshme me shkallë 20%.

Nga auditimi u konstatua se “Blerjet brenda vendit me 20%”, të paraqitura si më poshtë, nuk janë analizuar nga ana e inspektorit të kontrollit, se çfarë përfaqësojnë këto blerje dhe nëse i shërbejnë natyrës së aktivitetit që kryen tatimpaguesi.

Blerje brenda vendi 20% për periudhën mars – dhjetor 2018:

Emërtimi	Vlera në lekë
Blerje mallra dhe lëndë e parë	196,060,877
Blerje për situacion punimesh	22,992,871
Blerje shërbime të ndryshme	2,586,659
Totali	221,640,407

Blerje brenda vendi 20% për periudhën ushtrimore janar – dhjetor 2019:

Emërtimi	Vlera në lekë
Blerje mallra dhe lëndë e parë	276,574,026
Blerje për situacion punimesh	41,576,687
Blerje shërbime të ndryshme	2,692,549
Totali	320,843,262

Veprime këto në kundërshtim me nenin 80, “Kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, me nenin 59 “Përgjegjësitë dhe detyrat e inspektorit të sektorit të kontrollit në vend”, të “Rregullores së funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore”, i ndryshuar, miratuar nga Ministri i MFE me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, Programit të kontrollit nr. 2465/2 prot, datë 26.04.2023, si dhe me Manualin e Kontrollit Tatimor.

-Është kryer bilanci material për artikujt kryesorë (nafta, benzina dhe gaz i lëngshëm). Për periudhën janar – dhjetor 2019, rezultuan diferenca në llogaritje të gazit të lëngshëm të paraqitura në tabelën më poshtë:

Tabela: “Bilanci material për artikullin Gaz i lëngshëm“

Periudha		01.01.2019	01.01.2019-31.12.2019	31.12.2019	31.12.2019		
	Njësi			Gjëndje			

Emërtimi		Gjëndje fizike	Blerje	Shitje	kontabel	Gjëndje fizike	Diferenca	Kosto/litër (në lekë)
Gaz i lëngshëm	litër	1,515.21	227,864	223,174	6,205.21	6,205.21	0	45
Inventari më 31.12.2018	litër	5,708,96	227,864	223,174	10,398.96	10,398.96	4,193.75	45

Burimi: Raporti i kontrollit tatimor DRT Vlorë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Nga auditimi i inventarëve të kryer për artikujt (nafta, benzina dhe gaz i lëngshëm), në 4 magazinat që disponon tatimpaguesi, rezulton se magazina me adresë “Stacioni i trenit“, “Lagjja 24 Maji“ në fund të periudhës, më datë 31.12.2018, ka pasur gjëndje gaz të lëngshëm, sasinë prej 4,193.75 litër, e jo 1,515,21 litra siç është paraqitur në bilancin material. Sa më sipër, për këtë diferencë llogaritet detyrimi ndaj subjektit, për vlerën (4,193,75 litër * 45 lekë/litër = 188,719 lekë), sipas përcaktimeve të nenit 124, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

TVSH 20% : 37,744 lekë
 Penaliteti 100% i 37,744: 37,744 lekë
 Detyrimi për TF 15%: 28,308 lekë
 Penaliteti 100% i 28,308: 28,308 lekë
Detyrimi total: 132,104 lekë

Në total, detyrimet tatimore për këtë tatimpagues në këtë praktikë kontrolli, paraqiten në vlerën 132,104 lekë.

Tatimpaguesi: “S” SHPK, NIPT: LN

Adresa kryesore: Lagjja Uji i Ftohtë, Godinë dy katëshe nr. 5, Jonufer, Vlorë.

Aktiviteti: “Projektimi dhe zbatimi, ndërtime civile, turistike, bujqësore, ujësjellës kanalizime, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike. Punime karpenterie, hekuri, muraturë e suvatime, kalluposje, shtrim me pllaka e nivelime, punime hidraulike dhe elektrike. Shërbime hotelerie, bar-restorante, si dhe tregtim me shumicë e pakicë të karburanteve, etj”. (vazhdon edhe më tepër sipas përshkrimit të QKB-së)”.
 Inspektor Kontrolli: O Sh
 Përgjegjës Sektori: I K
 Drejtor Kontrolli: B P
 Drejtor Rajonal: S K

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:
 - TVSH, periudha tatimore Prill 2021- Nëntor 2021

Saktësimi i kërkesës për rimbursim është kërkuar nga tatimpaguesi “S”, me shkresën e datës 27.12.2021, protokolluar në DPT me nr. 23262, datë 30.12.2021, në shumën 8,535,399 lekë, për ndërtimin e objektit “Hoteleri 1, 2 dhe 3 kate me 2 kate nëntokë”. Në përfundim të kontrollit, subjektit i është njohur si TVSH e rimbursueshme vlera 7,237,252 lekë. (Nga kjo shumë do të kompesohen të gjitha detyrimet tatimore të papaguara që rezultojnë në sistemin e integruar tatimor C@ts në momentin e kryerjes së rimbursimit).

Nga ana e grupit të auditimit janë verifikuar të gjitha dokumentacionet e paraqitura në sistemin C@ts dhe në dosjen e kontrollit, ku ka rezultuar se:

Analiza e blerjeve nga furnitorë vendas me shkallë 20 %.

- Nga inspektori i kontrollit është bërë analizë e blerjeve nga furnitorë vendas me shkallë 20 %, të cilat përfaqësojnë blerje për procesin e ndërtimit, në vlerën e tatueshme 46,996,915 lekë, dhe

TVSH në vlerën 9,273,710 lekë. Në blerjet e deklaruara nga subjekti, janë përjashtuar nga rimbursimi i TVSH, situacioni nr. 16, për periudhën Prill 2021, me vlerë të tatueshme 3,171,968 lekë dhe TVSH 634,394 lekë, si dhe situacioni nr. 17, për periudhën Maj 2021, me vlerë të tatueshme 3,275,010 lekë dhe TVSH 655,002 lekë, pasi në librat e shitjes së subjektit mbikqyrës të kontraktuar nga “S”, nuk kanë rezultuar fatura të lëshuara për shërbimet e kryera.

- Gjatë auditimit u konstatua se fatura nr. 326073154, datë 07.03.2020, blerje me TVSH 35,839 lekë, nga furnitori “S E”, është deklaruar në muajin Maj 2021, për të cilën tatimpaguesi “S” ka kërkuar kreditimin e TVSH, në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 76 “Mënyra e ushtrimit të së drejtës së zbritjes”, pika 4, e cila citon: “Nëse personi i tatueshëm nuk kryen zbritjen e TVSH-së në periudhën tatimore në të cilën i lind e drejta e zbritjes, ai mund ta zbresë këtë shumë të TVSH-së së zbritshme pas kësaj periudhe tatimore, por jo më vonë se 12 periudha tatimore përfshirë periudhën në fjalë”. Udhëzimi nr. 6, datë 30.01.2015, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 54, pika 3, “Pas 12 periudhave kjo faturë regjistrohet si “blerje me TVSH jo të zbritshme”. Sa më sipër, subjekti i linden detyrime në zbatim të pikës nr. 3, të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Inspektori i kontrollit nuk ka kryer verifikimet e subjektit sipas legjislacionit tatimor dhe manualit të kontrollit, ku diferenca e përmenduar sjell efekte financiare. Nga grupi i auditimit është llogaritur detyrimi përkatës.

Detyrimi TVSH: 35,839 lekë

Penaliteti 20%: 7,168 lekë

Detyrimi total: 43,007 lekë

Në total, detyrimet tatimore për këtë tatimpagues në këtë praktikë kontrolli, paraqiten për TVSH në shumën 43,007 lekë.

Tatimpaguesi: “H” SHPK, NIPT: KH

Adresa kryesore: Lagjja Rahnoes, Rruga nacionale Vlorë-Sarandë, Zona Kadastrale Nr.1952, nr. pasurie 233/1.

Adresa dytësore: Lagjja “Shën Kostandini”, Rruga nacionale Vlorë-Sarandë, Zona Kadastrale 1481, nr. pasurie 283, ambjent i marrë me qira nga subjekti.

Autobot MITCUBISHI L200 targa VL1427D.

Aktiviteti: “Tregti me pakicë të karburanteve, vajrave të makinave, bateritë dhe pjesët e këmbimit për makina. Eksport-import, tregti me shumicë dhe pakicë e artikujve industrial dhe ushqimorë, hidrosanitare, elektrike, elektroshtëpiake, etj”. (vazhdon edhe më tepër sipas përshkrimit të QKB-së)”.
Inspektor Kontrolli: F S
Përgjegjës Sektori: I K
Drejtor Kontrolli: B P
Drejtor Rajonal: S K

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- TVSH, periudha tatimore Shkurt 2020-Janar 2022

- Tatim Fitimi, periudha tatimore 2019-2020

- Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore periudha tatimore Shkurt 2020-Janar 2022

- Për tatime të tjera deri Janar 2022

Nga ana e grupit të auditimit janë verifikuar të gjitha dokumentacionet e paraqitura në sistemin C@ts dhe në dosjen e kontrollit, ku ka rezultuar se:

- Kontrolli në subjekt ka filluar më datë 23.05.2022, pas darkotësisë së subjektit për kontroll tatimor dërguar me njoftimin nr. 2947 prot., datë 30.03.2022, si dhe Program kontrolli nr. 2947/2 prot., datë 30.03.2022.

- Raporti i kontrollit nuk ka të bashkëngjitur si pjesë përbërëse të tij “Formulari-pyetësor i vetëdeklarimit para kontrollit”, veprim jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6.

Analiza e TVSH për periudhën 01.01.2021-31.12.2021

- Subjekti ka kryer “Blerje të investimeve nga furnitorët vendas me shkallë 20%” në vlerën 5,545,040 lekë dhe TVSH 1,109,008 lekë. Nga kontrolli që i’u bë blerjeve për kreditimin e TVSH, shoqëria ka kryer blerje për investime punimesh “ndërtimin e depozitës së karburantit” në vlerën e tatueshme 3,724,941 lekë dhe TVSH 744,988 lekë, por nga auditimi rezulton se subjekti për këtë investim nuk është pajisur me “Deklaratë paraprake për kryerje punimesh”. Veprime këto në kundërshtim me nenin 39, pika 1, i ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, si dhe nenit 7, të VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar. Sa më sipër, subjektit i linden detyrime në zbatim të pikës nr. 3, të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Nga grupi i auditimit janë llogaritur detyrimet përkatëse.

Detyrimi: 744,988 lekë

Penaliteti 20%: 148,998 lekë

Detyrimi total: 893,986 lekë

-Nga kontrolli i listëpagesave të subjektit të deklaruar në sistemin C@ts për periudhën Shkurt 2020-Janar 2022, ka rezultuar se për llogaritjen e kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, janë respektuar kufijtë e pagës minimale. Nga ana e inspektorit të kontrollit nuk është bërë analizë për pagën e “shitësve në pikat e karburanteve”, nisur nga natyra e aktivitetit të tregtisë me pakicë. Subjekti ushtron aktivitet edhe ditë shtunë e të diel, ku sipas përcaktimeve të neni 87, të “Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, duhet që pagesa orare të jetë minimalisht 25% më e lartë se pagesa minimale orare, gjithashtu për çdo punë të kryer nga ora 19.00-22.00, jep të drejtën e shtesës mbi pagë jo më pak se 20%, sipas përcaktimeve të nenit 81 të “Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në total, detyrimet tatimore për këtë tatimpagues në këtë praktikë kontrolli, paraqiten në vlerën 893,986 lekë.

Tatimpaguesi: “H” SHPK, NIPT: KH

Adresa kryesore: Lagjja Rahnoes, Rruga nacionale Vlorë-Sarandë, Zona Kadastrale Nr.1952, nr. pasurie 233/1.

Adresa dytësore: Lagjja “Shën Kostandini”, Rruga nacionale Vlorë-Sarandë, Zona Kadastrale 1481, nr. pasurie 283, ambjent i marrë me qira nga subjekti.

Autobot MITCUBISHI L200 targa VL1427D.

Aktiviteti: “Tregti me pakicë të karburanteve, vajrave të makinave, bateritë dhe pjesët e këmbimit për makina. Eksport-import, tregti me shumicë dhe pakicë e artikujve industrial dhe ushqimorë, hidrosanitare, elektrike, elektroshtëpiake, etj”. (vazhdon edhe më tepër sipas përshkrimit të QKB-së)”.
Inspektor Kontrolli: O Sh
Përgjegjës Sektori: I K

Drejtor Kontrolli: B P
Drejtor Rajonal: S K

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- TVSH, periudha tatimore Shkurt 2022 – Qershor 2023
- Tatim Fitimi, periudha tatimore 2022
- Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore periudha tatimore Shkurt 2022 – Qershor 2023
- Të tjera Shkurt 2022 – Qershor 2023

Në përfundim të kontrollit, tatimpaguesit “H P” SHPK, i kanë lindur detyrime në vlerën 1,135,879 lekë.

Nga ana e grupit të auditimit janë verifikuar të gjitha dokumentacionet e paraqitura në sistemin C@ts dhe në dosjen e kontrollit, ku ka rezultuar se:

- Kontrolli tatimor është kryer në zbatim të njoftimit nr. 5386 prot., datë 23.08.2023 dhe Programit të kontrollit nr. 5386/2 prot., datë 23.08.2023.
- Raporti nuk ka të bashkëngjitur si pjesë përbërëse të tij “Formulari-pyetësor i vetëdeklarimit para kontrollit”, veprim jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6.

Analiza e blerjeve për periudhën ushtrimore 02.2022 – 12.2022

- Subjekti ka kryer “Blerje të investimeve nga furnitorët vendas me shkallë 20%” në vlerën e tatueshme 5,118,687 lekë, me TVSH 1,023,737 lekë. Nga kryqëzimi i faturave të blerjeve me FDP mujore në sistemin c@ts, rezultojnë blerje në subjektin “S” me NIPT KQ të cilat janë pajisje duralumini, si dhe në subjektin “A SHPK” me NIPT KF, aktiviteti i të cilit është “shitje inerte e beton”. Këto blerje paraqiten në vlerën e tatueshme 3,338,080 lekë dhe me TVSH 667,616 lekë. Nga auditimi rezulton se subjekti për investimin e punimeve të kryera nuk është pajisur me Deklaratë paraprake për kryerje punimesh, në kundërshtim me nenin 7, “Punime që kryhen me deklaratë paraprake punimesh”, i VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”. Sa më sipër, subjektit i lindin detyrime sipas përcaktimeve të pikës nr. 3, të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Nga grupi i auditimit janë llogaritur detyrimet përkatëse.

Detyrimi: 667,616 lekë

Penaliteti 20%: 133,523 lekë

Detyrimi total: 801,139 lekë

Analiza e blerjeve për periudhën ushtrimore 01.2023 – 06.2023

- Subjekti ka kryer “Blerje nga furnitorë brenda vendit me 20%”, në vlerën e tatueshme 60,538,763 lekë, me TVSH 12,107,753 lekë, të cilat janë blerje për gazoil, benzinë, gaz i lëngshëm, vaj e shpenzime të ndryshme. Gjithashtu, ka bërë blerje materiale për kryerje punimesh, të cilat sipas nenit 6, të rregullores të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, janë ndërhyrje të cilat kryhen pa pajisje me leje ndërtimi dhe pa paraqitur deklaratë paraprake.

- Është kryer bilanci material në sasi dhe në vlerë për artikujt e rishitur, gazoil dhe benzinë bazuar te gjendja në fillim, gjendja kontabile në fund, lëvizjet për periudhën, te kostoja e magazinës dhe çmimet e shitjes të tatimpaguesit.

- Nga ana e inspektorit të kontrollit nuk është bërë analizë për pagën e “shitësve në pikat e karburanteve”, nisur nga natyra e aktivitetit të tregtisë me pakicë. Nga kontrolli i listëpagesave të

deklaruara në sistemin C@ts për periudhën 02.2022-06.2023, tatimpaguesi ka deklaruar për punonjësit 22-24 ditë pune në muaj. Subjekti ushtron aktivitet edhe ditë shtunë e të diel, ku sipas përcaktimeve të neni 87, të “Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, duhet që pagesa orare të jetë minimalisht 25% më e lartë se pagesa minimale orare, gjithashtu për çdo punë të kryer nga ora 19.00-22.00, jep të drejtën e shtesës mbi pagë jo më pak se 20%, sipas përcaktimeve të nenit 81 të “Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në total, detyrimet tatimore për këtë tatimpagues në këtë praktikë kontrolli, paraqiten në vlerën 801,139 lekë.

Tatimpaguesi: “T”, NIPT: KË

Adresa: Lagjja “11 Janari”, te Pusi i Mezinit, Vlorë.

Aktiviteti: *“Prodhimi dhe përpunimi i mishit. Prodhim i sallameve të të gjitha llojeve dhe tregtimin e tyre, import-eksport artikuj të ndryshëm. Tregtim të të gjitha produkteve ushqimore etj. (vazhdon edhe më tepër sipas përshkrimit të QKB-së)”*.

Inspektor Kontrolli: B Z

Përgjegjës Sektori: I K

Drejtor Kontrolli: B P

Drejtor Rajonal: S K

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- TVSH, periudha tatimore Shtator 2020 –Maj 2022
- Tatim Fitimi, periudha tatimore 2020-2021
- Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore periudha tatimore Shtator 2020–Maj 2022
- Të tjera deri në Maj 2022

Nga ana e grupit të auditimit janë verifikuar të gjitha dokumentacionet e paraqitura në sistemin C@ts dhe në dosjen e kontrollit, ku ka rezultuar se:

- Kontrolli tatimor është kryer në zbatim të Programit të kontrollit nr. 6146/2 prot., datë 03.08.2022 me objekt “Kontroll i vetëdeklarimeve dhe llogaritjes e derdhjes së detyrimeve tatimore”, i cili ka filluar në datën 19.09.2022, pas dakordësisë së subjektit në njoftimin e kontrollit tatimor nr. 6146 prot., datë 03.08.2022.

- Raporti i Kontrollit nuk ka të bashkëngjitur si pjesë përbërëse të tij “Formularin-pyetësor i vetëdeklarimit para kontrollit”, veprim jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6.

- Nga ana e inspektorit të kontrollit nuk është kryer bilanci material për periudhën e kontrolluar për TVSH, megjithatë për vitin 2020, është bërë analizë për produktet të shitura nënkosto. E njëjta analizë në terma të sasive dhe krahasimit të marzhit çmim-kosto duhej të ishte realizuar për të gjithë periudhën objekt kontrolli. Nuk është kryer analizë për pjesën e përpunimit të mishit për prodhimin e sallamit, nuk është analizuar karta teknologjike, për të rakorduar për sasinë e produktit të gatshëm të deklaruar dhe të shitur, por janë shfaqur vetëm receipturat e prodhimit për 100 kg produkt. Nuk është bërë analizë e detajuar për secilin zë, të blerjeve të furnitorët, si dhe nuk është bërë analizë e detajuar për blerjet, por është bërë evidentim i përgjithshëm i blerjeve të përjashtuara dhe blerjeve brenda vendit me TVSH 20%. Inspektori i kontrollit nuk ka zbatuar të gjitha pikat e programit të kontrollit, duke mos dhënë një analizë të detajuar të veprimtarisë së tatimpaguesit, për periudhën objekt kontrolli. Veprime këto në kundërshtim me nenin 80, “Kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Me nenin 59 “Përgjegjësitë dhe detyrat e inspektorit të sektorit të kontrollit në vend”, të “Rregullores së funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore”, i

ndryshuar, miratuar nga Ministri i MFE me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, dhe Programit të kontrollit nr. 6146/2 prot., datë 03.08.2022 të DRTVlorë.

Tatimpaguesi: “M”, NIPT: LS

Adresa: Lagjja “11 Janari”, Rruga Jorgji Ceko, Vlorë.

Aktiviteti: “Prodhim dhe tregtim i mermerit dhe granitit. Punime mermeri dhe Punime guri. Shfrytëzim kavash minerale. Import-eksport, tregti me shumicë dhe pakicë të artikujve të ndryshëm industrial e ushqimorë (vazhdon edhe më tepër sipas përshkrimit të QKB-së)”.

Inspektor Kontrolli: F S

Përgjegjës Sektori: I K

Drejtor Kontrolli: B P

Drejtor Rajonal: S K

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- TVSH, periudha tatimore Tetor 2020 – Shtator 2022
- Tatim Fitimi, periudha tatimore 2020-2021
- Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore dhe TAP periudha tatimore Tetor 2020 – Shtator 2022
- Të tjera Tetor 2020 – Shtator 2022

Nga ana e grupit të auditimit janë verifikuar të gjitha dokumentacionet e paraqitura në sistemin C@ts dhe në dosjen e kontrollit, ku ka rezultuar se:

- Kontrolli tatimor është kryer në zbatim të Programit të kontrollit nr. 9214/2 prot., datë 27.12.2022, ka filluar në datën 08.02.2023, pas dakordësisë së subjektit në njoftimin e kontrollit tatimor nr. 9214 prot., datë 27.12.2022.
- Më datë 08.02.2023, sipas përcaktimeve të programit të kontrollit është bërë inventarizimi fizik për disa mallra.
- Është bërë analiza e kostos së çmimit të shitjes për periudhën objekt kontrolli, nga ku rezultojnë se çmimet e shitjes janë më të larta se kosto e prodhimit të tyre.
- Është bërë kontrolli i TVSH për periudhën objekt kontrolli dhe krahasimi ndërmjet treguesve sipas FDP-ve dhe të dhënave të sistemit C@ts, librave të blerjeve, shitjeve dhe faturave përkatëse, janë analizuar klientët dhe furnitorët kryesorë.
- Është bërë analizë e blerjeve të përjashtuara, të blerjeve nga importi me TVSH 20%, blerjeve brenda vendit me TVSH 20%.
- Është bërë krahasimi i deklarimeve të tatimpaguesit me të dhënat e doganës në sistemin C@ts, ku nuk kanë rezultuar diferenca.
- Është kryer analiza e zërave të bilancit kontabël si aktivet, detyrimet dhe kapitali i vet për periudhën objekt kontrolli, sipas përcaktimit të programit të kontrollit.
- Është kryer kontrolli i zërit “Amortizime” ku përgjithësisht amortizimet e llogaritura janë për ndërtesa, makineri e pajisje, mjete transporti, mobilje zyrë e të tjera, për të cilat janë zbatuar normat e amortizimit sipas grupeve përkatëse.
- Është kryer kontrolli për sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe tap për periudhën objekt kontrolli, nga ku rezulton se përgjithësisht janë zbatuar përcaktime ligjore.
- Është kryer bilanci material për artikujt që zënë peshën kryesore në aktivitetin e shoqërisë (mermer dhe granit), për periudhën tetor - dhjetor 2020, janar – dhjetor 2021, si dhe janar – shtator 2022.
- Nga auditimi rezulton se, për periudhën janar – shtator 2022, subjekti ka kryer blerje importi të lëndës së parë, bllok mermeri në sasinë 38.08 m3, në vlerën e tatueshme 1,301,452 lekë dhe TVSH

260,290 lekë. Mermeri është përpunuar në lastra dhe shitja kryhet në m², (38.08 m³ * 43.17 koeficienti i konvertimit në m² = 1,643.92 m²). Deri në datë 30.09.2022, është shitur sasia prej 3058 m² mermer dhe nga analiza rezulton se nuk ka diferencë gjendja kontabel me gjendjen fizike.

Tatimpaguesi: “S” SHA, NIPT KM

Adresa: Selenicë, Vlorë.

Aktiviteti: “Nxjerrja, përpunimi dhe tregtimi i qymyrit bituminoz, bitumit të pastër, dolmitit kokërr. (vazhdon edhe më tepër sipas përshkrimit të QKB-së)”.

Inspektor Kontrolli: E H

Përgjegjës Sektori: I K

Drejtor Kontrolli: B P

Drejtor Rajonal: S K

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- TVSH, periudha tatimore Qershor 2021 – Shkurt 2023

- Tatim Fitimi, periudha tatimore 2021-2022

- Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore periudha tatimore Mars 2021 – Shkurt 2023

- Të tjera deri në Shkurt 2023

Nga ana e grupit të auditimit janë verifikuar të gjitha dokumentacionet e paraqitura në sistemin C@ts dhe në dosjen e kontrollit, ku ka rezultuar se:

- Kontrolli tatimor është kryer në zbatim të Programit të kontrollit nr. 2465/2 prot., datë 26.04.2023. Ai ka filluar në datën 16.05.2023, pas dakordësisë së subjektit në njoftimin e kontrollit tatimor nr. 2465 prot., datë 26.04.2023.

- Në RPK nuk është bërë analiza e kartës teknologjike për të rakorduar sasinë e prodhuar për produktet Bitum natyral, Bitum i pastruar bllok, Bitum i fraksionuar, Bitum RAË (natyral), Qymyr nga karriera, si dhe sasinë në dalje për prodhim bitumi dhe/ose djegie, gjithashtu nuk administrohen të dhëna për sasi të në shitje dhe në blerje të produkteve por vetëm në vlera, çka e bën të paqartë metodologjinë e kontrollit të aplikuar në këtë rast nga inspektori i kontrollit, veprim në kundërshtim me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli VIII, pika 8.

- Gjithashtu karta teknologjike e paraqitur nga inspektori tatimor, nuk është e miratuar nga organet shtetërore përkatëse, veprim në kundërshtim me përcaktimet e bëra në VKM nr. 434, datë 20.05.2015 “Për përcaktimin e normativave për humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë prodhimit, magazinimit, transportimit etj... të njohura për qëllime fiskale”, neni 4, 7, 8 dhe 9.

- Nga subjekti janë deklaruar dy “Autongarkesa të TVSH” në blerje dhe në shitje:

1. për periudhën qershor-dhjetor 2021, në vlerë të tatueshme 20,891,665 lekë dhe me TVSH në vlerën 4,178,333 lekë;

2. për periudhën janar-dhjetor 2022, në vlerë të tatueshme 1,679,130 lekë dhe me TVSH në vlerën 335,826 lekë. Këto vlera janë regjistruar edhe në shitje duke anuluar efektin e TVSH.

Në RPK nuk është analizuar çfarë përfaqësojnë “autofaturime shitje e brendshme Selenicë-mineral” të hartuara nga ana e tatimpaguesit, nuk ka të dhëna si kanë dalë këto vlera, zërat e punimeve që janë kryer, çfarë dokumentacioni shoqërues dhe justifikues është kontrolluar nga inspektori, për të saktësuar vlerën e këtyre punimeve, mungon analiza për situacionet në lidhje me hyrjet dhe sasinë e situacionuar në dalje. Gjithashtu, nuk ka të dhëna nëse kanë qenë objekt kontrolli nga institucione të tjera kompetente si AKBN etj, dhe a janë administruar këto raporte kontrolli nga inspektori i kontrollit.

Nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor nuk rezulton të jetë kryer një kontroll i këtyre situacioneve në mënyrë analitike se çfarë kanë pasur të përfshirë, në elementët e materialeve të para, kostos së punës direkteve dhe shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit (ku përfshihen material indirekte, puna indirekte dhe shpenzime të tjera), për të gjykuar me komponentët e secilit situacion dhe krahasimin me blerjet e tatueshme.

Nga ana tjetër, nga inspektori tatimor, konstatohet se nuk është kryer një analizë në lidhje me plotësimin e kushteve për klasifikimin e këtyre operacioneve të realizuara nga tatimpaguesi si investime apo jo referuar kërkesave të legjislacionit fiskal dhe standarteve të raportimit financiar. Mungesa e analizës dhe trajtimi i gabuar nuk janë në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe standarteve në zbatim të tij”, konkretisht SKK 5 “*Aktivët afatgjatë materiale dhe jomateriale*”. Regjistrimi fillestar i AAM-së bëhet zakonisht në momentin e përfundimit të tij nga blerja apo prodhimi.

Kjo pasi, në RPK nuk është detajuar lloji i investimit dhe nëse këto punime do të kontribuojnë në sjelljen e përfitimeve të ardhshme ekonomike në mënyrë që të plotësohen kushtet për njohjen e tyre si aktiv në kontroll të njësisë ekonomike.

Nuk rezulton të jetë kryer një analizë në lidhje me licencat e kërkimit apo zbulimit të tatimpaguesit dhe klasifikimi i tyre si shpenzime kërkimore të cilat nuk plotësojnë kushtet për njohjen si aktiv (investim) apo shpenzime zhvillimi (të cilat kapitalizohen në aktiv të pasqyrave financiare dhe plotësojnë kushtet për njohjen si investim). Për më tepër, referuar dispozitave të Udhëzimit nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, situacionet, referohen të përdoren në fushën e punimeve të ndërtimit, sipas përcaktimeve të nenit 20 “Punimet e ndërtimit”, ndërkohë që tatimpaguesi nuk është i licensuar për punime ndërtimore dhe ushtron veprimtarinë sipas objektit të tij në fushën e nxjerrjes së mineraleve. Për rrjedhojë, trajtimi i autofaturimeve me anë të situacioneve, për operacionet e paraqitura të nxjerrjes së mineralit paraqitet i gabuar sipas kuadrit të raportimit financiar dhe atij fiskal.

-Nga problematikat e evidentuara në RPK, përfshihet gjithashtu mungesa e analizimit të kostos së mallrave të raportuara nga tatimpaguesi, e cila rezulton të jetë marrë e mirëqenë nga ana e inspektorit tatimor, pasi nuk rezulton të jetë kryer një analizë në lidhje me komponentët e kostos së paraqitur në raport kontrolli referuar kostos së materialeve të para si dhe procesit të prodhimit. Mungesa e analizës dhe trajtimi i gabuar nuk janë në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe standarteve në zbatim të tij”, konkretisht SKK 4 “*Inventarët*” pika 15 e 16.

Nga auditimi konstatohet se nga ana e inspektorit tatimor nuk është shkëmbyer informacion apo të jenë marrë konfirmime nga AKBN në lidhje me treguesit e inventarit të raportuar të nxjerrë apo investimet e realizuara përgjatë periudhës objekt kontrolli, por janë marrë të mirëqena deklaratimet e tatimpaguesit. Në këtë mënyrë nuk është arritur siguri në lidhje me sasinë e nxjerra/përpunuara dhe shitura drejt palëve të treta apo investimet e pretenduara me anë të vetëfaturimeve.

Në RPK nuk është bërë analizë për blerjet e tatueshme në lidhje me kredinë apo leasing, për periudhën Qershor – Dhjetor 2021, në vlerën 1,455,093 lekë, për vitin 2022 në vlerën 2,540,763 lekë, si dhe periudhën Janar- Shkurt 2023 në vlerën 419,656 lekë, se çfarë përfaqësojnë këto blerje. Sipas shpjegimeve në raport, marrja e kredive është bërë me qëllim investimin për blerje mjete transporti, por nuk u paraqit dokumentacion i justifikues në dispozicion të grupit të auditimit, si kontrata, faturë blerje, dokumente zhdoganimi etj.

Gjithashtu, nuk ka analizë për “Blerje të investimeve vendase me TVSH 20 %”, nga subjekti “B” me NIPT LA, në vlerë të tatueshme 9,774,500 lekë dhe TVSH e zbritshme në vlerën 1,954,900 lekë, periudha Janar - Dhjetor 2022, për të cilat tatimpaguesi ka deklaruar blerje të punimeve për

sistemim karriere, vegla pune dhe materiale ndihmëse. Veprime këto në kundërshtim me nenin 80, “Kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, me nenin 59 “Përgjegjësitë dhe detyrat e inspektorit të sektorit të kontrollit në vend”, të “Rregullores së funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore”, i ndryshuar, miratuar nga Ministri i MFE me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, Programit të kontrollit nr. 2465/2 prot, datë 26.04.2023, si dhe me Manualin e Kontrollit Tatimor.

Analiza e vlerës së aktivitet “Ndërtesa” për vitin 2021.

Nga auditimi rezulton se tatimpaguesi S. B., të gjitha AAM i ka njohur me kosto, në të cilat janë përfshirë kostoja e blerjes dhe kosto të tjera të drejtpërdrejta që lidhen me aktivin.

Nga analiza e Pasqyrave Financiare të periudhës ushtrimore 2021, u konstatua se nuk përputhen të dhënat e Pasqyrës së Amortizimit të AAM, me të dhënat në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, të detajuara në tabelën më poshtë:

Tabela: “Bilanci i vitit 2021”

		Në lekë	
Pasqyra e Pozicionit Financiar	Viti Raportues 2021	Pasqyra e Amortizimit të Aseteve	Gjendja në mbyllje të vitit ushtrimor
Aktivet Afatgjata Material	Vlera	Aktivet Afatgjata Material	Vlera
Toka	36,099,175.00	Toka	-
Ndërtesa	454,052,579.19	Ndërtesa	361,645,355.56
Makineri dhe Pajisje	115,849,337.68	Inst.tek.mak.paisje,vegla instr.	93,646,172.53
Aktive të tjera	6,295,869.49	Mjete transporti	83,001,430.64
		Pajisje zyre mobilje	1,281,329.00
		Pajisje informatike	1,450,000.00
		Të tjera	790,327.55
Total (pa aktivin “Toka”)	576,197,786.36		541,814,615.28
Vlera e mbivlerësuar e aktivitet “Ndërtesa”	92,407,223.63		

Burimi: Bilanci i deklaruar nga tatimpaguesi në C@ts, si dhe Raporti i kontrollit tatimor DRT Vlorë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Ne kemi marrë në analizë aktivin “Ndërtesa”, pasi siç evidentohet edhe në tabelë, AAM të tjera, nuk janë paraqitur në të njëjtën mënyrë, tek të dyja pasqyrat.

Në Pasqyrën e Amortizimit të AAM viti 2021, “Ndërtesa” paraqitet në vlerën 361,645,355.56 lekë. Ndërsa në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në periudhën raportuese paraqitet në vlerën 454,052,579.19 lekë. Kjo vlerë është raportuar edhe në analizën e inspektorit në Raportin Përfundimtar të Kontrollit. Për sa më sipër, kemi vlerë të shtuar me 92,407,223.63 lekë të aktivitet. Inspektori tatimor nuk ka kryer verifikimet e subjektit sipas legjislacionit, ku diferenca e përmenduar sjell efekte financiare në të ardhura të mungura në buxhetin e shtetit. Veprime këto në kundërshtim me nenin 80, “Kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, me nenin 59 “Përgjegjësitë dhe detyrat e inspektorit të sektorit të kontrollit në vend”, të “Rregullores së funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore”, i ndryshuar, miratuar nga Ministri i MFE me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, Programit të kontrollit nr. 2465/2 prot, datë 26.04.2023, si dhe me Manualin e Kontrollit Tatimor.

Për veprimet e mësipërme në lidhje me vlerën e mbivlerësuar prej 92,407,223.63 lekë të aktivitet “Ndërtesa”, në bazë të ligjit nr. 9920 datë 18.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 115 “Plotësimi i pasaktë i deklaratës tatimore”, subjektit S. B, i janë llogaritur detyrimet si më poshtë:

TF 15%: 13,861,084 lekë

Penaliteti TF (21.9%): 3,035,577 lekë

Detyrimi total: 16,896,661 lekë

Në total, detyrimet tatimore për këtë tatimpagues në këtë praktikë kontrolli, paraqiten në vlerën 16,896,661 lekë.

Tatimpaguesi: R

NIPT: LG

Aktiviteti: Hotele dhe struktura të ngjajshme

Aktivitetit sipas QKB: *“Hoteleri dhe veprimtari ndihmëse lidhur me këtë aktivitet. Ndërtimi i jahteve apo mjeteve të tjera lundruese. Të transportoje turistë dhe persona në këto mjete. Te marrë në përdorim, të tregtoje, të leshojë me qira të gjitha llojet e mjeteve lundruese detare qofshin ato motorrike apo jo. Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njëzë. Qiradhenie e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme. Rezervime online hoteleri. Operator turistik detar. Transport i udhetarëve Brenda dhe jashtë vendit.”*

Adresa: Rruga Murat Tërbaçi, Lagjia Uji Ftohtë, Kulla Nr. 2, kati 1-5-6-7-8 (9 nën)

Administrator: K B

Periudha e kontrolluar: Sigurime shoqërore dhe shëndetësore 2021 Janar – 2021 Dhjetor

Inspektorë kontrolli: D B dhe

Përgjegjës kontrolli: I K

Drejtor Kontrolli: B P

Drejtori Rajonal: S K

Njësia Speciale Antiinformalitet: G P (DKT), E K (DKT), A P (DKS), E M (DHT)

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore për periudhën tatimore 01/2021 – 12/2021

Afati i kontrollit: 100 orë pune

Data e periudhës së kontrollit: 14.06.2022 – 10.08.2022

-Bazuar në autorizimin për kryerjen e vizitës fiskale me nr. 4669 prot., datë 30.05.2022, dhe programit të kontrollit të programuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë është kryer kontrolli tatimore në subjektin R. G. Sipas Urdhër Pune nr. 4669/1 prot., datë 14.06.2021, inspektorët e kontrollit të DRT Vlorë janë shoqëruar në këtë program kontrolli edhe nga inspektorët e Njesisë Speciale Antiinformalitet.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes së kontrollit rezultoi se:

- Në sistemin C@TS, mungon dokumenti i Akt-Konstatimit të mbajtur në datë 14.06.2022, si dhe Formularët e Vetëdeklarimit të Individit Punëmarrës nuk janë ngarkuar në sistem, jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.
- Formulari 3, Raporti i vizitës së kontrollit i ngarkuar në sistemin C@TS nuk përban nënshkrimin e të dy inspektorëve në kundërshtim me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2,

Në subjektin R. G. është kryer vizitë fiskale në bazë të autorizimit nr. 4669 prot., datë 30.05.2022 dhe programit të kontrollit për periudhën Janar 2021-Dhjetor 2021, që ka rezultuar se detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore ka pasaktësi në llogaritje, për të cilën është llogaritur detyrimi dhe gjoha në bazë të Ligj Nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 119, “Mosdeklarimi i punonjësve dhe fshehja e pagës, pika 3 nga grupi i kontrollit si dhe është kontaktuar se ditët e punës të deklaruara nga subjekti nuk rakordojnë me ditët e punës të deklaruara nga punonjësit e intervistuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se, në krahasim me të dhënat e raportuara nga inspektorët e kontrollit të DRT Vlorë dhe inspektorët e Njesisë Speciale Antiinformalitet për vizitën fiskale të ushtruar në subjektin R. G. kanë konstatuar se për punonjësit e intervistuar raportojnë se punojnë 26 ditë dhe jo 22 ditë pune siç është deklaruar nga subjekti. Ndërkohë, në formularin e vetëdeklarimit të individit punëmarrës, disa nga punonjësit raportojnë se punojnë 28 ditë pune dhe jo 26 ditë pune.

Inspektorët e kontrollit u shprehën se është marrë mesatare e ditëve të punës, si rrjedhojë rezulton se për dy persona bazuar në vetë deklarimet të metodologjisë së përdorur nga inspektori i kontrollit nuk është kryer trajtimi edhe me dy ditë shtesë pune ose të jenë njoftuar organet përkatëse të Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Nga shqyrtimi i dosjes së kontrollit për zbatimin e kërkesave të Ligj Nr. 9136 datë 11.02.2003 “Për mbledhjen e detyrueshme të kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore” kanë rezultuar problematikat si më poshtë vijon:

-Nuk rezulton, referuar dokumentacionit në dosjen e kontrollit të jenë analizuar kontratat individuale të punës midis shoqërisë dhe punonjësve, në lidhje me përputhshmërinë e tyre me përcaktimet e dispozitave të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë.

-Janë konstatuar parregullësi në llogaritjen e ditëve të punës dhe orëve të punës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore.

Tatimpaguesi: E

NIPT: LJ

Aktiviteti: Hotel, bar-restorant

Objekti Veprimtarisë sipas QKB: “*Shërbime ne fushën e turizmit si: hoteleri, agjenci turistike, bar-restorante, akomodim ne çadra plazhi, shezllona etj.Import-Eksport, tregëtimin e artikujve te ndryshem etj. Tregti me shumice e produkteve shtazore per njerez.*”

Adresa: Lagja “Kamp”, rruga e kampit, objekt nr.2, Dhërmi, Vlorë

Inspektorë kontrolli: E H

Përgjegjës kontrolli: I K

Drejtor Kontrolli: B P

Drejtori Rajonal: S K

Periudha e kontrolluar:

1. Për TVSH-në: Gusht 2021 – Gusht 2022
2. Për tatim mbi fitimin: 2020-2021
3. Sigurimet shoqërore: Gusht 2021 – Gusht 2022
4. Të tjera: Gusht 2022

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes së kontrollit ka rezultuar se:

▪ Dokumenti Formulari 3 - Raporti i vizitës së kontrollit, nuk u gjet i ngarkuar në sistemin C@TS jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.

-Bazuar në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin C@TS, subjekti E. SHPK, me NIPT LJ, për ushtrimin e veprimtarisë si strukturë akomoduese, kategoria *Hotel* është pajisur me Certifikatë Kategorizimi nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) në datë 10.08.2023, Nr. Regj. 1544/2023. Nga shqyrtimit i dokumentacionit të tatimpaguesit, E. SHPK, rezulton se ka tejkaluar afatin e aplikimit për tu pajisur me Certifikatë Kategorizimi për të përfituar shkallën e reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar jo në përputhje me përcaktimet ligjore, pasi subjekti ka aplikuar për certifikatë kategorizimi në datë 15.06.2020 duke mos respektuar afatin e përcaktuar në Urdhër

Nr. 41 datë 18.02.2020 “Për një ndryshim në Urdhrin Nr. 267, datë 24.07.2019, “Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese”, i ndryshuar ku përcakton se, “...të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari si strukturë akomoduese se afati i aplikimit për marrjen e certifikatës së kategorizimit është deri në datë 31.03.2020”. Shoqëria E. SHPK për periudhën e kontrollit Gusht– Dhjetor 2021 dhe Janar-Gusht 2022, ka kryer shitje të tatueshme me shkallë të reduktuar të TVSH 6% megjithëse nuk disponon certifikatën e kategorizimit.

Në raportin përfundimtar të kontrollit, në analizimin e kontrollit të shitjeve të tatueshme inspektori ka paraqitur në mënyrë të përmbledhur shitjet për periudhën Gusht-Dhjetor 2021 dhe ka ndarë shitjet të tatueshme me shkallë 6% nga shitjet e tatueshme me shkallë 20%, por nuk është detajuar nëse në shitjet e tatueshme me shkallë 6% janë aplikuar vetëm për strukturën akomoduese *Hotel*, pasi subjekti vepron edhe në aktivitetin bar-restorant.

Për periudhën e kontrollit, gusht 2021-gusht 2022, tatimpaguesi ka kryer shitje të tatueshme me shkallën e reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar në vlerën si mëposhtë:

Emertimi i shitjeve	Shitje e tatueshme me shkallë 6%	
	Vlera e Tatueshme	TVSH
Gusht – Dhjetor 2021	30,326,429	1,819,586
Janar – Gusht 2022	37,831,978	2,269,919
Total	68,158,407	4,089,505

Referuar përcaktimeve ligjore si më poshtë:

-Ligjit Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për TVSH-në” i ndryshuar, Neni 49, pika 3

-Vendim Nr. 953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”, Neni 11/1

- Urdhër nr.41, datë 18.02.2020 “Për një ndryshim në Urdhrin nr. 267, datë 24.07.2019 “Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese”, ka shtyrë afatin e aplikimit për marrjen e certifikatës së kategorizimit të strukturave akomoduese duke përcaktuar datën 31.03.2020 si afatin përfundimtar për aplikim.

Sa sipër tatimpaguesi “E” SHPK, nuk plotëson kushtet për shitje të tatueshme me shkallë 6%, pasi u konstatuan të jenë aplikuar në mungesë të certifikatës së kategorizimit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe tejkalim i afatit të aplikimit për tu pajisur me certifikatë kategorizimi, si rezultat subjekti ka detyrimin si mëposhtë vijon:

Detyrim për TVSH 9,542,177 lekë (68,158,407* 14%)

Penaliteti për TVSH = 1,908,435 lekë (9,542,176 *20%)

Total i Detyrimit = 11,450,612 lekë

Totali i detyrimit të TVSH për subjektin, E për periudhën Gusht-Dhjetor 2021 dhe Janar – Gusht 2022 është 11,450,612 lekë.

Tatimpaguesi: H Group

NIPT: LT

Aktiviteti: Ndërtimi i ndërtesa rezidenciale e jo rezidenciale

Adresa: Radhime, Rruga Vlorë-Orikum Km. 12. Lagjia Plazh, Objekt nr. 1., Radhimë, Vlorë

Inspektorë kontrolli: O Sh

Përgjegjës kontrolli: I K

Drejtor Kontrolli: B P

Drejtori Rajonal: S K

Objekti i Kontrollit:

- Rimbursim i TVSH-së

Periudha e Kontrollit:

- TVSH 09.2022 – 01.2023
- Orë pune: 149 orë

Subjekti “H G” SHPK me NIPT LT sipas shkresës së DPT, numër çështje E0001072519 datë 15.03.2023 ka paraqitur pranë Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së kërkesën për rimbursim të TVSH-së me numër kërkesë RAE0000246141. Nga shuma e kërkuar 19,893,920 lekë është miratuar vlera 19,241,236 lekë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes së kontrollit ka rezultuar se:

-Në auditimin e dokumentacionit të vendosur në dispozicion dhe bazuar në të dhënat në sistemin C@TS, rezulton se nuk është bërë bilanci material si element kryesor mbi kreditueshmërinë e TVSH dhe inventari fizik në kontrollin e ushtruar për subjektin H. Group SHPK, jo në përputhje me përcaktimet e programit të kontrollit dhe Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.5, Kapitulli VIII, pika 8.

-Nuk është kryer analizimi i detajuar i shitjeve për të gjithë periudhën e kontrollit, sipas zërave të shitjeve për secilin nga objektet, për të përcaktuar vlerën e shitjeve për restorantin, për materialet e ndërtimit, në kundërshtim me përcaktimet e programit të kontrollit dhe Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.5, Kapitulli VIII, pika 8.

- Nga shqyrtimi i informacionit në sistemin C@TS, libri i blerjeve për muajin Janar 2023 nuk gjendet në sistem për të cilën inspektori i kontrollit është shprehur se ka kryer rakordimin, për blerje nga furnitorë vendas me TVSH, në një vlerë të tatueshme në shumën 80,635,427 lekë dhe tvsh në shumën 16,127,085 lekë për të cilën është kredituar TVSH sipas raportit përfundimtar të kontrollit.

-Referuar kontratës së shërbimit nr. 1839/3 prot., datë 27.03.2023 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë është kryer Raport Ekspertimi Teknik nr. 32 prot., datë 28.03.2023, në të cilin inxhinierë e ndërtimit nuk është shprehur për ndërtimin në Lungomare, Vlorë por vetëm për “Kompleks hotelerie 4 kate me 1 kat parkim nën tokë në Radhimë Vlorë”. Inxhinierin e ndërtimit, është shprehur se ka kryer raportin e ekspertimit teknik vetëm për rimbursimin e TVSH së objektit “Kompleks hotelerie 4 kate me 1 kat parkim nën tokë në Radhimë Vlorë”, pasi nuk është informuar për të kryer raport ekspertimi për objektin në Lungomare. Analiza për kryerjen e punimeve dhe inventarin fizik të raportimeve të objektit në Radhimë, Vlorë është kryer për periudhën Tetor 2022-Janar 2023. Për objektin në Lungomare, sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga inspektori i kontrollit, është lëshuar vetëm një situacion në Shtator 2022, periudhë për të cilën inspektore e kontrollit nuk është shprehur. Referuar raportit përfundimtar të kontrollit, rezulton se tatimpaguesit H Group, i është kredituar TVSH edhe për objektin polifunksional në Lungomare, në mungesë të raportit të ekspertimit të inxhinieres së ndërtimit.

-Sipas raportit përfundimtar të kontrollit, për periudhën e kontrollit Shtator 2022 – Janar 2023, vlera totale e rimbursuar është 19,241,236 lekë. Rezulton se në raportin përfundimtar të kontrollit nuk është analizuar nga inspektori i kontrollit, vlera e tepicës së mbartur nga periudhat e mëparshme si dhe nuk është e qartë vlera totale e rimbursuar e TVSH-së.

- Vlera e situacioneve progresive për ndërtimin e hotelit në Radhimë, Vlorë, në raportin e kontrollit nuk rakordon me vlerën e situacioneve në raportin e ekspertimi teknik dhe me situacionin analitik të shoqërisë H G SHPK, vendosur në dispozicion nga inspektori i kontrollit.

-Subjekti ka kryer veprimtari si bar restorant, shërbime akomodimi, nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se tatimpaguesi ka raportuar shitje sipas natyrës për shërbimin e bar restorantit dhe nuk rezultojnë të ketë në pronësi ambjente apo të ketë blerje të deklaruara për qeradhënie për ushtrimin e aktivitetit dhe kjo analizë nuk është kryer në raportin e kontrollit tatimor, si dhe nuk është vendosur në dispozicion certifikata e përdorimit për objektin në të cilën po zhvillohet veprimtaria si bar restorant, shërbime akomodimi që tregon se objekti është ndërtuar në përputhje me projektin dhe kushtet teknike në fuqi, që tregon se objekti ka kaluar të gjitha inspektimet dhe testet e nevojshme për të siguruar që është i sigurt dhe në përputhje me standardet dhe rregulloret përkatëse për të ushtruar aktivitetin. Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezultojnë se objekti vijon të jetë në proces ndërtimi.

-Shoqëria “H Group” SHPK dhe “E” subjekte zhvilluese po kryejnë punime në “Objektin polifunksional” në Lungomare, Bashkia Vlorë, me leje ndërtimi nga K.K.T Bashkia Vlorë, Vendim Nr. 21 datë 10.06.2021 për “Objekt banimi dhe shërbimi me 11 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë”. Referuar Udhëzim nr. 6, datë 30.01.2015, i ndryshuar neni 20 pika 6, “Kur një person i tatueshëm ndërtues, njëkohësisht edhe investitor ndërtton një objekt i cili pjesërisht është për t’u shitur, ndërsa pjesërisht për t’u shfrytëzuar nga vetë shoqëria për një veprimtari të tatueshme që shoqëria do të kryejë pasi të përfundojë investimi... është e rëndësishme dhe duhet të jetë e qartësisht e përcaktuar që në fillim të ndërtimit të objektit në planimetrinë e tij, pjesa që do të përdoret për shfrytëzim nga vetë personi i tatueshëm dhe pjesa që do të jetë ambiente për t’u shitur”. Në lejen e ndërtimit si dhe në raportin Përfundimtar të Kontrollit, nuk është përcaktuar pjesa që do të përdoret për shfrytëzim nga vetë personi i tatueshëm dhe pjesë që do të jetë për t’u shitur, jo në përputhje me përcaktimet e Udhëzim nr.6 neni 20, pika 6.

-Në raportin e kontrollit është konstatuar se në situacion punimesh për Hotelin në Radhimë, Vlorë është lëshuar nga H Group por subjekti që ka lejen e ndërtimit është subjekti H. SHPK e trajtuar si më poshtë:

Leje zhvillimore nr.1, datë 04.02.2015, me afat deri në 20.09.2018, për ndërtimin e objektit Strukturë shërbimi “Kompleks hotelerie 4 kat me 1 kat parkim nën tokë (3 objekte)” në Nisi, Radhimë, lëshuar nga Bashkia Orikum, është lëshuar në emrin e sipërmarrësit H Shpk me Nipt: J66915252I.

Të dy shtyrjet e lejeve nr.1146, datë 24.10.2018 dhe nr.188, datë 17.03.2021 janë bërë në emrin e shoqërisë H. Shpk me Nipt: JI. Ndryshimi i subjektit zhvillues është miratuar nga Bashkia Vlorë me Vendimin nr. 168, datë 22.03.2023, pra pas periudhës për të cilën kërkohet të kreditohet TVSH më sipër.

Si përfundim shoqëria “H Group” SHPK, ka kryer punime ndërtimi (situacione Hoteli Orikum) dhe këto të fundit nuk janë kryer në përputhje me legjislacionin e fushës dhe legjislacionin fiskal duke përdorur lejen e ndërtimit të shoqërisë “H” SHPK me Nipt: JI, në kundërshtim me kërkesat ligjore të fushës së ndërtimit dhe ato fiskale, VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të territorit“, Neni 2, pika 8, neni 13, pika 1, 2 dhe 3, neni 14, pika 1. Për pasojë tatimpaguesit “H Group” Sh.p. k nuk i njihet TVSH-ja e zbritshme për situacionet e ndërtimit të hotelit.

-Vlera jo e zbritshme për TVSH si rezultat i konstatimeve të sipërcituara është si më poshtë:

(Lekë)

Objekt	Vlera e Tatueshme	TVSH
Bar-restorant shërbime akomodimi	8,654,819	1,730,964

Hoteleri në Radhimë, Vlorë	44,395,786	8,879,157
Ndërtimi në Lungomare	16,883,654	3,376,731
Total	69,934,259	13,986,852

Detyrim për TVSH 13,986,852 lekë (69,883,654* 20%)

Penaliteti për TVSH = 2,797,370 lekë (13,986,852 *20%)

Total i Detyrimit = 16,784,222 lekë

Totali i detyrimit të TVSH për subjektin, H Group për periudhën Shtator 2022-Janar 2023 është 16,784,222 lekë.

Tatimpaguesi: “H”

NIPT: JG

Aktiviteti: Prodhimi i produkteve të tjera prej druri; prodhimin e artikujve prej xunkthi, shporte
Objekti Veprimtarisë sipas QKB: *“Prodhimi dhe tregtimi i artikujve artistike prej druri, metali, pëlhure e çdo lloj materiali tjetër. Prodhimi dhe tregtimi i konfeksioneve të të gjitha llojeve si dhe tregtimi i mallrave të tjerë industriale brenda dhe jashtë vendit për importin dhe eksportin e tyre. Ndërtimi, projektimi, ristrukturimi, mirëmbajtja dhe tregtim të pronave të pasurive të patundshme të çdo lloji. Prodhimi dhe tregtimi i mobiljeve dhe aksesoreve, si dhe kryerje e shërbimeve për konsulencë të çdo lloji. Kompanisë i lejohet të krijoj ndërmarrje të tjera, të bashkëpunoj ose të marr pjesë në të. Kryerje e veprimtarive të mësipërme Brenda dhe jashtë shtetit shqiptar.”*

Adresa: L. Bashkimi RR. Transballkanik, Vlorë, Vlorë

Inspektorë kontrolli: D B

Përgjegjës kontrolli: I K

Drejtor Kontrolli: B P

Drejtori Rajonal: S K

Shkresa nr. 2396 prot., datë 28.02.2023, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, ka kërkuar të dhëna nga Drejtoria Rajonale të Tatimeve Vlorë për subjektin H. SHPK me NIPT JG mbi kontrollin tatimor të ushtruar në këtë subjekt.

Periudha e Kontrollit

1. Për TVSH-në: 2019.06 – 2023.02
2. Për Tatim Fitimin: 2018 – 2022
3. Për Sigurimet Shoqërore: 2018.03 – 2023.02
4. Të tjera: deri 2023.02

Afati i kontrollit: 110 orë pune

Data e periudhës së kontrollit: 30.05.2023 – 29.06.2023

-Njoftim për kontroll tatimor është dërguar me shkresë 2634, datë 2.05.2023, dhe kontrolli ka filluar në datë 30.05.2023, rezulton të jetë jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor.

-Është bërë bilanci material për periudhën e kontrollit, ku sipas të dhënave të paraqitura në raportin e kontrollit nuk kanë rezultuar diferenca.

-Është kryer analiza e zërave të bilancit kontabël si aktivet, detyrimet dhe kapitali i vet për periudhën e kontrollit, sipas përcaktimeve të programit të kontrollit.

-Është kryer analiza e rezultatit financiar dhe analiza e zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën objekt kontrollit sipas përcaktimeve të programit të kontrollit.

-Është kryer kontrolli i zërit “Amortizime” ku përgjithësisht amortizimet e llogaritura janë për ndërtesa, makineri, pajisje, mjete transporti, zyrë, për të cilat janë zbatuar normat e amortizimit sipas grupeve përkatëse.

-Për vitin 2020 është bërë kontroll i blerjeve nga importi të deklarura nga shoqëria ku janë squarua në mënyrë analitike nga shoqëria

Sipas analizës së shpenzimeve për vitin 2022, rezulton se subjekti ka hyrje aktivesh gjatë vitit 2022 për mjete transporti në vlerën 3,994,202 lekë. Në raportin e kontrollit rezulton se është kryer blerje e mjetit të transportit, kamion, në datë 30.07.2022 nga Holanda, e klasifikuar si import investimesh me TVSH 20% që ka vlerën 2,686,322 lekë. Konstatohet një diferencë në vlerën 1,307,880 lekë si më poshtë vijon:

Në analizën e shpenzimeve për vitin 2022,

Emërtimi	Gjendja 01.01.2022	Vlera	Amortizimi	Gjendja 31.12.2022
Mjete Transporti	1,948,480	3,994,202	389,696	5,552,986
Kamion		2,686,322		
Diferenca		1,307,880		

Diferenca konstatohet të jetë si rezultat i klasifikimit jo të duhur nga inspektori i kontrollit të “Makinorisë për përkuljen e profileve të aluminit” në vlerën 1,307,880 lekë si mjet transporti.

-Karta teknologjike e ngarkuar në sistemin C@TS, rezulton të jetë e nënshkruar elektronikisht vetëm nga administratori i subjektit dhe jo e konfirmuar/certifikuar nga institucioni përgjegjës, që ka aftësinë teknike të konfirmimit të kartave teknologjike, kjo jo në përputhje me Vendim nr. 434, datë 20.05.2015, “Për përcaktimin e normativave për firot, humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë prodhimit, magazinimit, transportimit etj., të njohura për qëllime fiskale”, pika 7.

-Nuk janë vendosur në dispozicion faturat për zërin udhëtime, dieta, transporte.

Tatimpaguesi: D

NIPT: KV

Aktiviteti: Hotele dhe struktura të ngjashme

Adresa: Lagjja Uji i Ftohtë, Rruga Llambro Rexho, 200 m Tynelit. përballë me Rezidencën Qeveritare Vlorë. Nr., Vlorë

Inspektorë kontrolli: A A

Përgjegjës kontrolli: I K

Drejtor Kontrolli: B P

Drejtori Rajonal: S K

Në zbatim të njoftimit kontrolli dhe programit të kontrollit nr. 7335 prot., datë 01.10.2022 është kryer kontroll për tatimpaguesin D. H. & SPA, për periudhën e kontrollit:

Periudha e Kontrollit

5. Për TVSH-në: Gusht 2017 – Korrik 2022

6. Për Tatim Fitimin: 2017 – 2021

7. Për Sigurimet Shoqërore: Gusht 2017 – Korrik 2022

8. Të tjera: Gusht 2017 – Korrik 2022

Afati i kontrollit: 160 orë pune ose 20 ditë pune

Data e periudhës së kontrollit: 10.10.2022 – 07.11.2022

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes së kontrollit ka rezultuar se:

-Njoftimi i Kontrollit Tatimor është bërë me shkresë 7335, datë 30.09.2022, kontrolli ka filluar në datë 10.10.2022, si dhe subjekti ka deklaruar se ka marrë njoftimin në datë 10 Tetor 2022, duke

mos respektuar afatin 30 ditor të përcaktuar në Manualin e Kontrollit Tatimorë, Kapitulli II, pika 2.1, nënpika 2.

Në sistemin C@TS, Njoftim i Kontrollit Tatimor, nuk është i nënshkruar dhe nuk përmban nr. Prot., dhe datë.

-Formulari 3 - Raporti i vizitës së kontrollit nuk u gjet i ngarkuar në sistemin C@TS, jo në përputhje me përcaktimet në Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.

Referuar përcaktimeve të:

- Ligj Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për TVSH-në” i ndryshuar, Neni 49, pika 3.

- Vendim Nr. 953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”, Neni 11/1.

- Urdhër nr.41, datë 18.02.2020 “Për një ndryshim në Urdhrin nr. 267, datë 24.07.2019 “Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese”, ka shtyrë afatin e aplikimit për marrjen e çertifikatës së kategorizimit të strukturave akomoduese duke përcaktuar datën 31.03.2020 si afatin përfundimtar për aplikim.

Bazuar në përcaktimet ligjore të sipërcituara, rezultojnë parregullësi dhe mangësi në dokumentacionin e tatimpaguesit D për periudhën e kontrollit të ushtruar, Gusht 2017-Shkurt 2020, për të përfituar shkallën e reduktuar të TVSH me 6%.

Sipas të dhënave mbi objektin e veprimtarisë në QKB të subjektit D, rezulton se ka patur ndryshime ndër vite të pasqyruar më poshtë:

Data e ndryshimit të objektit të aktivitetit	Ndryshimi i objektit të aktivitetit
03.08.2016	<i>“Aktivitet ndërtimi në zbatim gërmime dheu muratur beton armë ndërtime banesa mbi 8 kate ndërtim rrugë, ura, ujsjellsa, kaskade mbi 10 metra, kanalizime, projektim objekte civile, industriale turistike dhe rrugë, import eksport dhe 15 shitberje me shumicë dhe pakicë mallra të ndryshme. veprimtari në fushën e turizmit, transport i mallrave për vete dhe të tretët, marketing. Bar restorant, dyqane. Dhënie me qera ambjente banimi, ambjente shërbimi dhe mjete transporti. Kënde lojrash për fëmijë. Organizim evenimentesh kulturore dhe sportive. Shitje konfeksionesh. Parkim, guida turistike dhe catering. Shërbime dhe mikpritje.”</i>
26.06.2019	<i>U shtua "...Transportin e udhëtarëve dhe bagazheve në linja të rregullta kombëtare dhe ndërkombetare, agjensi për transportin e udhëtarëve dhe bagazheve.”</i>
17.02.2020	<i>U shtua: “...Hotel, resort”</i>

Sipas pasqyrave të rakordimit të TVSH në Raportin Përfundimtar të Kontrollit dhe të dhënave në librat e shitjes në sistemin C@TS për periudhën Gusht-Dhjetor 2017 është aplikuar shkalla e reduktuar e TVSH-së, 6%. Në VKM Nr. 953, datë 29.12.2014, “Për dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Aplikimi i shkallës së reduktuar të TVSH me 6% është jo në përputhje me kushtet, kriteret dhe procedurat për të përfituar aplikimin e shkallës së reduktuar të TVSH pasi referuar objektit të aktivitetit të subjektit sipas QKB për këtë periudhë, D nuk ka si objekt veprimtarie Hotel apo Resort, për periudhën për të cilën është përfituar shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar. D, ka përfituar nga aplikimi me shkallë të reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar në mungesë të dokumentacionit dhe certifikimeve përkatëse situatë e cila nuk është trajtuar nga inspektori i kontrollit në raportin e kontrollit dhe nuk janë marrë masa për trajtimin e rastit të disponimit së

certifikatës përpara mbylljes së aplikimeve për tu pajisur me certifikatë. Në shkurt të vitit 2020, tatimpaguesi D. SHPK, NIPT KV është pajisur me Certifikatë Kategorizimi, për strukturën akomoduese kategoria RESORT, në datë 19.02.2020, Nr. Regj. 655/2020, por nuk ka të dhëna mbi datën e aplikimit të subjektit për tu pajisur me certifikatë kategorizimi. Nga auditimi mbi këtë praktikë konstatohet se megjithëse ndryshimet ligjore kanë dhënë mundësinë tatimpaguesve që të aplikojnë shkallën e reduktuar të tvsh-së për shërbimet e akomodimit në struktura akomoduese që në vitin 2016, procesi i paisjes me certifikata kategorizimi në bashkëpunim me MTM ka filluar vetëm pas vitit 2019. Për këtë arsye, kuadri rregullator, përveç ligjit për tvsh-në dhe VKM në zbatim të tij, ka qenë jo i plotë për administrimin e procesit dhe aplikimin e shkallës së reduktuar të tvsh-së, duke krijuar kushtet për aplikim të standartit të dyfishtë në trajtimin e tatimpaguesve. Për rrjedhojë, trajtimi i këtij rasti dhe të tjerëve të ngjashëm kërkon një qëndrim administrativ të unifikuar mbi ligjshmërinë e aplikimit të shkallës së reduktuar për këtë periudhë kohore.

Tatimpaguesi: “S” SHPK

NIPT: JT

Aktiviteti: Tregtia me shumicë e pjesëve dhe aksesorëve të automjeteve

Objekti Veprimtarisë sipas QKB:

Adresa: Lagjja Rilindja, Rruga Riza Salati, përballë zyrës së Punës, Vlorë

Inspektorë kontrolli: M K

Përgjegjës kontrolli: I K

Drejtor Kontrolli: B P

Drejtori Rajonal: S K

Në zbatim të njoftim kontrolli nr. 9218 datë 27.12.2022 dhe programit të kontrollit nr. 9218/2 prot., datë 27.12.2022 është kryer kontroll për tatimpaguesin, për periudhën e kontrollit:

Periudha e Kontrollit

1. Për TVSH-në: Tetor 2020 – Shtator 2022
2. Për Tatim Fitimin: 2020 – 2021
3. Për Sigurimet Shoqërore: Tetor 2020 – Shtator 2022
4. Të tjera

Afati i kontrollit: 44 orë pune ose 5.5 ditë pune

Data e periudhës së kontrollit: 14.02.2023 – 21.02.2023

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes së kontrollit ka rezultuar se:

-Njoftim i kontrollit tatimorm nr. 9218 prot., datë 27.12.2022, dhe kontrolli ka filluar në datë 14.02.2023. Subjekti ka deklaruar se ka marrë njoftimin për fillimin e kontrollit në 14.02.2023

-Referuar raportit të kontrollit, në analizën e rezultatit ekonomik financiar për vitin 2020-2021, nga rakordimi i të ardhurave në TVSH Pasqyra Financiare FDPTF sipas deklaramentit 2020-2021, kanë rezultuar diferenca dhe mospërputhje të të ardhurave në TVSH me të ardhurat e deklaruara në pasqyrat financiare dhe në FDP e tatim fitimit. Gjithashtu, nga analiza e rezultatit ekonomik financiar, bazuar në të dhënave në sistemin C@TS, rezulton se Tatimi mbi Vlerën e Shtuar sipas situatës financiare për vitin 2020 dhe 2021 konstatohet se tatimpaguesi ka deklaruar më shumë blerje të kreditueshme nga TVSH, për të cilën i është kredituar TVSH ndërkohë që për tatim fitim ka deklaruar më pak, si pasojë shuma e deklaruar për TVSH dhe tatim fitimin rezultojnë jo në përputhje, si dhe është konstatuar se nga verifikimi i faturave të blerjeve nuk ka përputhje në

vitin 2020 për vlerën 198,643 më shumë, diferencë për të cilën është konsideruar shpenzim i pa zbritshëm në rezultatit tatimorë. Për vitin 2021, diferenca e krijuar është në vlerën 94,188 më pak. Si rrjedhojë, tatimpaguesi i ka detyrimin si më poshtë vijon:

Viti 2020

Të dhëna nga sistemi C@TS për TVSH sipas situatës financiare

(Lekë)

Emërtimi	Viti 2020
TVSH e Zbritshme	
▪ Importe mallra me 20%	1,810,639
▪ Blerje vendit me TVSH 20%	19,198,748
Total	21,009,387
Të dhëna nga raporti i kontrollit të inspektori i kontrollit	Viti 2020
Lënda e parë dhe materiale të konsumit	18,690,000
Shpenzime të tjera	300,527
Total	18,990,527
Diferenca	21,009,387 – 18,990,527 = 2,018,860

Lënda e parë, materiale të konsumueshme përfaqësojnë koston e materialeve të shitura, në vlerën 18,690,000 lekë. Këto diferenca janë shpjeguar në observacion me ndryshimet e gjendjes së inventarit në fillim dhe në fund të periudhës kontabël, të cilat kanë dhënë efekt në llogaritjen e KMSH dhe për këtë arsye nuk gjenerohen detyrime tatimore.

Viti 2021

Të dhëna nga sistemi C@TS për TVSH sipas situatës financiare

Lekë

Emërtimi	Viti 2021
TVSH e Zbritshme	
Importe mallra me 20%	1,990,763
Blerje vendit me TVSH 20%	22,196,599
Total	24,187,362
Të dhëna nga raporti i kontrollit të inspektori i kontrollit	Viti 2021
Lënda e parë dhe materiale të konsumit	22,963,342
Shpenzime të tjera	281,115
Total	23,244,457
Diferenca	24,187,362 – 23,244,457 = 942,905

Këto diferenca janë shpjeguar në observacion me ndryshimet e gjendjes së inventarit në fillim dhe në fund të periudhës kontabël, të cilat kanë dhënë efekt në llogaritjen e KMSH dhe për këtë arsye nuk gjenerohen detyrime tatimore.

Tatimpaguesi:

NIPT: KE

Aktiviteti: Ndërtimi i ndërtesave rezidenciale e jo rezidenciale

Adresa: Lagja Uji i Ftohtë, në perëndim të rrugës Vlorë-Orikum, në kufi me Rezidencën Qeveritare, Vlorë

Inspektorë kontrolli: M K

Përgjegjës kontrolli: I K

Drejtor Kontrolli: B P

Drejtori Rajonal: S K

Në zbatim të njoftim kontrolli nr.1548 prot., datë 26.03.2021 dhe programit të kontrollit nr. 1568/2 prot., datë 26.03.2021 është kryer kontroll për tatimpaguesin, për periudhën e kontrollit: Periudha e Kontrollit

1. Për TVSH-në: Shkurt 2018 – Dhjetor 2020

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes së kontrollit ka rezultuar se:

-Tatimpaguesit, V, NIPT KE ka marrë leje ndërtimi për ndryshim funksioni nga Banim në Hotel, nr. 406, datë 29.08.2017. Në leje ndërtimi për ndryshim funksioni është miratuar për objektin H, pa ndryshuar volumet e miratuara në lejen e ndërtimit.

-Referuar aktit të konstatimit teknik, rezulton se inxhinieri i ndërtimit inspektimin në vend të objektit të subjektit V e ka kryer për, Hotel seksioni H-H1, pjesë e kompleksit rezidencial M. B, ku subjekti ndërtues është vetë shoqëria “V” SHPK. Në analizën e projektit dhe sipërfaqes ndërtimore rezulton se inxhinieri i ndërtimit i referohet objektit H-H1, 4 kat mbi tokë dhe dy kat nën tokë ka një sipërfaqe ndërtimore 6,600 m².

-Sipas raportit të inxhinierit të ndërtimit, situacioni progresiv i punimeve të vetëdeklaruar nga subjekti në fillim Shkurt 2018 – Dhjetor 2020 rezulton si më poshtë:

- Vlera e tatueshme: 364,311,239.2 lekë
- TVSH 20% e situacionuar është: 72,862,247.8 lekë
- Shuma Totale e situacionit progresiv: 43,717,487 lekë
- Kostoja mesatare pa TVSH për këtë objekt është: 55,199 lekë/m²
- Kostoja mesatare Totale me TVSH për këtë objekt është 66,238 lekë/m²

Bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion rezulton se në leje ndërtimit nr. 406, datë 29.06.2017 të miratuar për ndryshim funksioni nga Banim në Hotel është miratuar vetëm për objektin H and jo për objektin H1, për të cilën subjektit ndërtues i është rimbursuar TVSH referuar Akt Konstatimit Teknik në datë 10.05.2021.

-Në datë 05.05.2021 është lidhur kontratë shërbimit nr. 2345/3 prot., ndërmjet palëve, Altin Karalli, me profesion inxhinier ndërtimi dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë. Rezulton se inxhinier i ndërtimit që ka kryer Akt Konstatimit Teknik, në datë 10.05.2021, është njëkohësisht edhe drejtues teknik i kompanisë E. SHPK e cila është projektuese e projekt-arkitekturave për Hotelin në kompleksin M. B. L. and SPA, me drejtues ligjor A K. Nuk u gjet në dosjen e kontrollit, nënshkrimi i deklaratës së konfliktit të interesit.

-Në akt konstatimit teknik nuk janë të ndarë zërat e punimeve të situacionuara të ndara për objektin H. dhe objektin H1, si dhe nuk janë të përcaktuara se si është arritur në sipërfaqe ndërtimore 6600 m² për të cilën i është rimbursuar TVSH.

-Rezultojnë ndryshime në planimetritë e sheshit të ndërtimit sipas dokumentacionit në dosjen e kontrollit, ka mospërputhje të sipërfaqes së ndërtimit, me një diferencë 33 m², nga 5250 m² është ndryshuar në 5283 m², si dhe ka ndryshuar kati numri i kateve nëntokë, nga 1 kat në planimetrinë fillestare në 2 kate nën tokë. Në projektin-arkitekturorë objekti “Hotel 4 kat me një kat pjesërisht nën tokë” rezulton se është 1 kat pjesërisht nën tokë ndërkohë në leje ndërtimi me ndryshim funksioni, nr. 406, datë 29.08.2017.

-Rezultojnë mospërputhje dhe ndryshime nga leja fillestare e ndërtimit në lejet e trajtuara më vonë të cilat nuk janë analizuar në Akt Konstatimit Teknik në datë 10.05.2021 dhe Raport Kontrolli.

Tatimpaguesi: P

NIPT: JN

Aktiviteti: Dorëzimi i ngarkesës

Adresa: Lagja Pavaresia, Skele, Vlorë Nr. , Vlorë

Inspektorë kontrolli: E H

Përgjegjës kontrolli: I K

Drejtor Kontrolli: B P

Drejtori Rajonal: S K

Në zbatim të njoftim kontrolli nr.362 prot, datë 18.01.2021 dhe programit të kontrollit nr. 362/2 prot., datë 25.01.2019 është kryer kontroll për tatimpaguesin, për periudhën e kontrollit:

Periudha e Kontrollit

1. Për TVSH-në: 2019.10 – 2020.07
2. Për Tatim Fitimin: 2015 – 2019
3. Për sigurime shoqërore: 2019.10 – 2020.07

Data e fillimit të kontrollit: 03.03.2021 – 25.10.2021

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes së kontrollit ka rezultuar se:

-Në kontrollin e TVSH për periudha të ndryshme, Tetor- Dhjetor 2019 dhe Janar-Korrik 2020, blerje nga furnitorë si “Pjesë këmbimi auto” është klasifikuar si blerje e përjashtuar, ndërkohë në periudhën Janar-Korrik 2020, në kontrollin e TVSH-së së zbritshme, e njejtat blerje me përshkrim “Pjesë këmbimi auto” me vlerën 185,000 lekë dhe me TVSH 37,000 lekë në zërin “Blerje nga furnitor vendas me TVSH të zbritshme”, është klasifikuar për TVSH të zbritshme. Nuk analizuar nga ana e inspektorit, se përse i njejtat përshkrim i blerjes është klasifikuar në dy zëra të ndryshëm, një herë si blerje e përjashtuar dhe më pas si blerje nga furnitorë vendas me TVSH të zbritshme, si dhe për cilin automjet janë kryer këto shërbime.

-Në periudhën Janar-Korrik 2020, në kontrollin e TVSH të zbritshme, blerje nga tatimpaguesi, I Nipt KC, blerje nga furnitorë vendas me 20% në vlerën 25,000 lekë me TVSH 5,000 lekë, për azhurnim konfigurim F5, është klasifikuar në zërin “Blerje nga furnitorë vendas me TVSH të zbritshme” dhe jo si blerje të investimeve vendas me TVSH 20%.

-Nuk është analizuar nga inspektori i kontrollit, në raport se blerje nga furnitorë vendas me TVSH të zbritshme, nga tatimpaguesi, S, NIPT KV, Kolaudim mjete në vlerën 10,641 me TVSH 2,128 lekë se cilit automjet është kryer blerja e këtij shërbimi.

-Sipas raportit përfundimtar të kontrollit, rezulton se nuk është kryer një analizë mbi mjetet e klasifikuara si autovetura, të listuara mëposhtë që nuk janë ATP (automjet i transportit të përzier) si dhe çfarë funksioni kanë për subjektin, bazuar formatit për pasuri të luajtshme të ngarkuara në sistemin C@TS. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 21/i, “Shpenzimet e konsumit personal” të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe në kundërshtim me pikën 1/c, shpenzimet për autovetura dhe shërbimet në lidhje me to, i nenit 74 “Kufizimet e së drejtës së zbritjes” të ligjit nr. 92 /2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nr.	Lloji i mjetit	Tipi/Markë	Targë	Kapaciteti	Vlera kontabël
1	Autoveture	Volksëagen	AA 753 RJ	4+1	536,978
2	Autoveture	Hyundai	AA 912 SK	4+2	774,747
Total					1,311,725

Detyrim për TVSH: 262,345 lekë (1,311,725 *20%)

Gjobë: 56,666 lekë

Total i Detyrimit: 319,011 lekë

Tatimpaguesi: M

NIPT: KE

Aktiviteti: Industri të tjera nxjerrëse p.k.t

Adresa: Miniera në qendër të Qytezës, Selenicë, Vlorë

Inspektorë kontrolli: E H

Përgjegjës kontrolli: I K

Drejtor Kontrolli: B P

Drejtori Rajonal: S K

Në zbatim të njoftim kontrolli nr. 5375 datë 23.08.2023 dhe programit të kontrollit nr. 5375/2 prot., datë 23.08.2023 është kryer kontroll për tatimpaguesin, për periudhën e kontrollit:

Periudha e Kontrollit

1. Për TVSH-në: Shtator 2021 – Qershor 2023
2. Për Tatim Fitimin: 2021 – 2020
3. Për Sigurimet Shoqërore: Shtator 2021 – Qershor 2023

Afati i kontrollit: 72 orë pune ose 9 ditë pune

Data e periudhës së kontrollit: 10.10.2023 – 20.10.2023

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes së kontrollit ka rezultuar se:

-Janë evidentuar mangësi në rakordimin e të dhënave për periudhën Shtator-Dhjetor 2021, në blerjet brenda vendit sipas FDP janë më shumë, në vlerën 18,109,523 lekë ndërkohë referuar tabelës “Blerje nga furnitorë vendas me TVSH 20%” të analizuar sipas natyrës dhe furnitorëve nga inspektori i kontrollit paraqiten në shumën 18,702,663 lekë, pra me një diferencë në vlerën 593,140 lekë

- Subjekti është i pajisur me leje shfrytëzimi nr. 1371, në 22.06.2009, për nxjerrjen e mineralit të grupit 1-2-3, për të cilën është dhënë leja e shfrytëzimit për bitum natyral dhe zhavor bituminoz.

-Nuk është analizuar renta minerare nga inspektorit, jo në përputhje me program kontrolli nr. 5375 prot., datë 23.08.2023.

-Në vijim, referuar procesit të nxjerrjes së mineralit, proces përpunimi, tatimpaguesit duhet të aplikojë kartën teknologjike që nuk gjendet në sistemin C@TS dhe as në dosjen e kontrollit, si dhe nuk është analizuar nga inspektori i kontrollit apo të jetë është shprehur nëse tatimpaguesi përmban kartën teknologjike për proceset e punës dhe nëse e disponon kartën teknologjike, nëse është e miratuar nga organet përkatëse. Veprime të cilat rezultojnë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në VKM nr. 434 datë 20.05.2015 “Për përcaktimin e normativave për humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë prodhimit, magazinimit, transportimit etj., të njohura për qëllime fiskale, në nenet 4 dhe 7.

-Referuar përcaktimeve të udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, situacionet, referohen të përdoren në fushën e punimeve të ndërtimit, sipas përcaktimeve të nenit 20 “Punimet e ndërtimit”, ndërkohë që tatimpaguesi nuk është analizuar nga inspektori nëse subjektet që kryejnë punime në karrierë janë të licenuar për punime ndërtimore dhe ushtron veprimtarinë sipas objektit të tij në fushën e nxjerrjes së mineraleve. Për rrjedhojë, trajtimi i autofaturimeve me anë të situacioneve, për operacionet e paraqitura të nxjerrjes së mineralit paraqitet i gabuar sipas kuadrit të raportimit financiar dhe atij fiskal. Grupit të auditimit, nuk iu vendosën në dispozicion situacione në mënyrë që të gjykohej në lidhje me komponentët e

përfshirë në të, si përfshirja e kostos së punës në situacion dhe shpenzimet e tjera të përgjithshme të prodhimit.

-Kjo pasi nga ana në raport kontrolli nuk është detajuar lloji i investimit për punime në karrierë dhe nëse këto punime do të kontribuojnë në sjelljen e përfitimeve të ardhshme ekonomike në mënyrë që të plotësohen kushtet për njohjen e tyre si aktiv në kontroll të njësisë ekonomike.

- Mungesa e analizës dhe trajtimi i gabuar nuk janë në përputhje me përkesat ligjit për kontabilitetin dhe standarteve në zbatim të tij, konkretisht SKK 4 “Inventarët”

-Nuk rezultojnë të jetë marrë apo shkëmbyer informacion nga inspektori i kontrollit lidhur me sasinë e nxjerra apo të përpunuara të mineralit për të arritur në sigurinë për sasinë e nxjerra apo investimet e pretenduara me anë të vetëfaturimeve.

-Tatimpaguesi, M NIPT KE , referuar të dhënave në raportin e kontrollit ushtron aktivitetin në nxjerrjen dhe përpunimin e mineralit të bitumit në zonën e Selenicës dhe rezultojnë të jetë palë e lidhur me tatimpaguesin tjetër të përzgjedhur për kontroll, “S” me NIPT KM, pasi kontrollohen nga të njëjtët persona të ngarkuar me qeverisjen e këtyre subjekteve. Kjo rezultojnë edhe nga marrëdhëniet e analizuar në shitje dhe në blerje ndërmjet tyre. Nga auditimi konstatohet se, një analizë mbi transaksionet e kontrolluara ndërmjet palëve të lidhura sipas përcaktimeve të ligjit për tatimin mbi të ardhurat nuk rezultojnë të jetë realizuar nga inspektori tatimor në raportin e kontrollit tatimor. Nuk janë vendosur në dispozicion, situacione për punime në karrierë nga tatimpaguesi Selenicë Bitumi.

Periudha	Tatimpaguesi	Blerje	TVSH	Përshkrimi	Zëri
09.21-12.21	Selenicë bitumi	19,892,025	3,978,405	Punime sistemim karriere	Blerje të investimeve vendase me 20%
01.22-12.22	Selenicë bitumi	12,741,399	2,548,284	Mineral	Blerje nga furnitorë vendas me TVSH 20%

-Inspektori i kontrollit, në raportin përfundimtar të kontrollit, nuk ka analizuar se çfarë përfaqësojnë autofaturat, si është arritur në këto vlera, zërat e punimeve të kryera, cilit dokumentacion justifikues dhe shoqërues i është referuar inspektori apo ka kontrolluar për të saktësuar vlerën e punimeve të këtyre punimeve, nuk ka të dhëna nëse subjekti ka qënë objekt kontrolli nga inspektori si AKBN, dhe nëse inspektori i kontrollit i ka administruar këto raporte. Nuk rezultojnë të jenë detajuar në raportin e kontrollit, autofaturat e hartuara nga tatimpaguesi, nuk është analizuar nga inspektori se për çfarë është përdorur vetëfaturim që ka rritur TVSH e kreditueshme nga blerjet me 2,236,926 lekë për periudhën shtator-dhjetor 2021 dhe 1,805,679 lekë për periudhën Janar-Dhjetor 2022.

NIPT	Tatimpaguesi	Shtator-Dhjetor 2021			Janar-Dhjetor 2022		
		Vlera e tatueshme	TVSH	Përshkrimi	Vlera e tatueshme	TVSH	Përshkrimi
KE	M	11,184,629	2,236,926	Mineral	9,028,397	1,805,679	Punime në karrierë

-Nuk rezultojnë të jetë kryer analizë nga inspektori për “Blerje të investimeve vendase me TVSH 20 %”, nga subjekti “B” me NIPT LA, në vlerë të tatueshme 11,772,500 lekë dhe TVSH e zbritshme në vlerën 2,354,500 lekë, për periudhën Janar - Dhjetor 2022, për të cilat tatimpaguesi ka deklaruar blerje të investimeve vendase për punime në karriere. këto në kundërshtim me nenin 80, “Kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, me nenin 59 “Përgjegjësitë dhe detyrat e inspektorit të sektorit të kontrollit në vend”, të “Rregullores së funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore”, i ndryshuar, miratuar nga Ministri i MFE me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, Programit të kontrollit nr. 2465/2 prot, datë 26.04.2023, si dhe me Manualin e Kontrollit Tatimor. Nuk u

vendosën në dispozicion situacionet në mënyrë që të gjykohej në lidhje me komponentët e përfshirë në të, si përfshirja e kostos së punës në situacion.

NIPT	Tatimpaguesi	Blerje	TVSH	Përshkrimi
LA	B	11,772,500	2,354,500	Punime në Karrierë

-Nuk rezultojnë të jetë kryer kontroll i situacioneve në mënyrë analitike nga inspektori i kontrollit, se çfarë kanë përfshirë në elementët e materialeve të para, kostos së punës direkteve dhe shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit (ku përfshihen material indirekte, puna indirekte dhe shpenzime të tjera), për të gjykuar me komponentët e secilit situacion dhe krahasimin me blerjet e tatueshme.

-Referuar Pasqyrave Financiare dhe bilancit material për periudhën shtator-dhjetor 2021 në raportin e kontrollit rezultojnë diferenca në sasi, si më poshtë për të

Lloji i inventarit	Njësia	Sasia në PF 21	Koso për njësi	Vlera në PF	Sasi në B.M	Diferenca në sasi	Diferenca në Vlerë
Bitum Natyral	Ton	595.05	22,079	13,138,398	690	94.95	2,096,447.15
Qymyr Bituminoz	Ton	10,546.27	2,404	25,354,114	9,404	1,142.27	2,746,112.53
Total							4,842,559.68

Detyrim për TVSH: 968,512 lekë (4,842,559.68* 20%)

Penalitet për TVSH: 193,702 lekë

Total i Detyrimit: 1,162,214 lekë

-Nga analiza e bilancit material për periudhën janar-dhjetor 2022, në vlerë konstatohet se gjendja fillestare dhe hyrjes ka të dhëna të pamjaftueshme për të bërë dalje material me kosto 60,301,665 lekë, në të njetjën kohë sasi të shitura 24,000 janë të pamjaftueshme për tu bërë dalje ndërkohë që kemi patur 19,404 gjë që dëshmon në mosvërtetimin e sasisë së deklaruar si të nxjerrë të mineralit për aq kohë që vërtetohet shitje qymyri mbi sasi të gjendje dhe të blera, si në sasi dhe si në vlerë duke ju referuar bilancit material.

Përshkrimi	Njësi	Gjendja Fillestare dhe Hyrjet nga blerjet			Daljet				Gjendje në fund		
		Sasia	Kosto	Vlera	Sasia	Kosto	Vlera	Çmimi i Shitjes	Sasia	Kosto	Vlera
Qymyr Bituminoz	Ton	19,404	2,511	22,607,232	24,015	2,511	60,301,665	3,221	3,598	2,404	8,650,061
Bitum Natyral	Ton	690	22,507	15,235,949	203	22,507	4,568,921	28,994	487	22,079	10,753,813

Kontroll i TVSH, Janar – Qershor 2023

Blerje nga furnitorë vendas me TVSH 20%

NIPT	Tatimpaguesi	Blerje nga furnitorë vendas me 20%	TVSH nga furnitorë vendas me 20%	Përshkrimi
L	E	48,998,704	7,799,741	Gazoil

-Në analizën e normativave të zbritjes së TVSH-së për gazoilin, inspektori i kontrollit, të normativën e karburantit e ka 33% në raport kontrolli ndërkohë në koherencë edhe me raportin e mëparshëm tatimor për të njetjën subjekt që e ka licensuar si gjërmim/shpim si aktivitet, me normativën e karburantit me 25% jo në përputhje me Udhëzim nr. 6, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 55, “Kufizime të zbritjes së TVSH për disa furnizime”, normativat e përdorimit të gazoilit sipas veprimtarisë, deri më 33% është normativa që aplikohet për prodhim materiale inerte, ndërkohë për veprimtarinë gjërmime/shpime është deri më 25%.

Përshkrimi	Prodhim materiale inerte 2301-06 sipas raportit të kontrollit	Rivlerësim nga Grupi i Auditimit
% e lejuar e gazoilit	33%	25%
Qarkullimi	41,612,574	
Vlera e lejuar e kreditimit të gazoilit	13,732,149 (41,612,574*33%)	10,403,144 (41,612,574*25%)
Vlera e gazoilit të kredituar për periudhën	16,142,332	
Diferenca mbi normativën e lejuar	2,410,183 (16,142,332-13,732,149)	5,739,189 (16,142,332-10,403,144)
Diferenca	5,739,189 – 2,410,183	

Detyrimi i TVSH: 665,801 lekë (3,329,006*20%)

Penaliteti për TVSH: 133,160 lekë

Totali i Detyrimi: 798,961 lekë

-Në bilancin material të periudhës Janar-Qershor 2023, nuk rakordojnë sasi të mineralit, qymyr bituminoz të gjendjes fillestare dhe hyrjet me gjendjen në fund të periudhës së kaluar, Janar-Dhjetor 2022, si dhe nuk është bërë bilanci material për Bitum Natyral, ndërkohë që në fund të periudhës së vitit të kaluar ka gjendje në mbyllje të mineralit. Nuk është analizuar nga inspektori i kontrollit, mos përfshirja në bilancin material e mineralit, Bitum Natyral.

Periudha	Përshkrimi	Njësi	Gjendja Fillestare dhe Hyrjet nga blerjet			Daljet				Gjendje në fund		
			Sasia	Kosto	Vlera	Sasia	Kosto	Vlera	Çmimi Shitjes	Sasia	Kosto	Vlera
2022	Qymyr Bituminoz	Ton	19,404	2,511	22,607,232	24,015	2,511	60,301,665	3,221	3,598	2,404	8,650,061
2023	Qymyr Bituminoz	Ton	41,317	2,404	22,607,232	12,940	2,502	32,376,956	3,221	28,377	2,382	67,581,093

-Rezulton se nuk është kryer rakordimi i FDP-ve të TVSH, me tatim fitimin dhe me pasqyrat financiare nga ana e inspektorit për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2022. Mos kryerja e rakordimit, sipas Ligj Nr. 9920, datë 19.05.2009, për “Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 71, e drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi. Bazuar në blerje nga furnitorë vendas me 20%, të analizuar nga inspektori vlera rezulton:

Blerje nga furnitorë vendas me 20% për vitin 2022	21,051,293
KMSH	
T1 (inventar sipas bilancit 2021)	40,244,914
Blerje Neto	21,051,293
T2 (inventar sipas bilancit 2022)	30,244,914
Total	31,051,293
Diferencë	50,593,912-31,051,293 = 19,541,719

Detyrimi i TF: 2,931,257 lekë (19,541,719 lekë*15%)

Penaliteti për TF : 641,945 lekë (2,931,257 lekë*21.9%)

Totali i Detyrimi: 3,573,203 lekë

Totali i detyrimit të TVSH për subjektin MB është 5,534,378 lekë.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore si më poshtë:

Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71, neni 72, neni 115, neni 124;

Ligji nr.92/2014 datë 24.07.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, i ndryshuar, neni 74;

Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, ” Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 22, pika 3, pika 5.

Udhëzimi nr.5, datë 30.01.2006 për “Tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar pika 3.6;

Udhëzimin nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, neni 8, neni 55;

Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin nr.192, datë 12.08.2020;

-Neni 4 “Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore”, Pikat 3, 10, 11, 18.

-Neni 57 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Drejtoritë të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në Drejtoritë e tjera Rajonale”, Pikat 2, 7.

-Neni 58 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Përgjegjësitë të Sektorit të Kontrollit në Vend”, Pikat 1, 2, 3, 4, 5, 7,

Neni 59 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Inspektorit të Sektorit të Kontrollit në Vend”, Pika 1.

-Neni 60 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimi”,

-Neni 61 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Përgjegjësitë të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimi”,

Manuali i Kontrollit Tatimor.

Formulari i dokumentimit të lëvizjes së dokumentacionit të kontrollit nga Inspektori deri tek Drejtori i Drejtorisë Rajonale. (Inspektor, Përgjegjës Sektori, Drejtor Kontrolli, Drejtor Rajonal). Fakti që nënshkruajnë dhe ka të drejtën e komenteve Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori Rajonal i DRT-së, në aneksin e raportit paraprak dhe përfundimtar i bën përgjegjës, sepse manuali ju rezervon të drejtën e shprehjes dhe të komenteve për rezultatet e procedurës së kontrollit. Në rastin e Drejtorit Rajonal ky fakt që përbën përgjegjësi funksionale të nëpunësit/titullar si person që ka dijeni dhe nënshkruan aktin administrative të organit përkatës të administratës publike sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Për mangësitë e konstatuara ngarkohen me përgjegjësi, rast pas rasti, sipas subjekteve për kontroll, punonjësit si më poshtë:

1- z. E H, z. R K, z. MK, z. B Z, z. M P, znj. D F, znj. A A, zj. L K, z. D B, z. O Sh, z. J F, znj. M B, z. B K, z. A M, znj. F S, në cilësinë e inspektorit të Sektorit të Kontrollit në Vend dhe Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit pranë Drejtorisë Rajonale Tatime Vlorë.

2- zj. I K, në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit të Kontrollit Tatimor në Vend pranë Drejtorisë Rajonale Tatime Vlorë.

2- z. S B, në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit të Kontrollit Tatimor nga Zyra dhe Monitorimit pranë Drejtorisë Rajonale Tatime Vlorë.

3- z. B P, në cilësinë e Drejtorit të Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatime Vlorë.

4- z. S K, në cilësinë e ish-Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatime Vlorë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2991/25 prot, datë 10.07.2024 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", administruar në KLSH me nr. 1111/37 prot, datë 15.07.2024, nga DRT Vlorë, janë shprehur objeksionet si më poshtë:

-Nga z. E. H. me detyrë Inspektor i Kontrollit në Vend pranë DRT Vlorë, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Konstatoj qe te perzgjedhura per auditim ishin 40 praktika kontrolli nga te cilat 12 prej tyre ishin kontrolle te kryera prej meje, pra afersisht 30% ishin praktika te nje inspektori te vetem. Ne drejtorine e Vlores inspektor qe kryerjne kontrolle ne vend jane 10 te tille. Auditimi i nje numri praktikash kontrolli ne numer te larte te nje inspektori krahasuar me ato te inspektoreve te tjere mendoj se ndikon ne krijimin e nje pasqyre jo objektive te standartit punes se gjithsecilit prej nesh dhe drejtorise ne pergjithesi.

Sipas rasteve te audituara nga ana juaj:

Tatimpaguesi: H Group

NIPT: LT

Aktiviteti: Aktivitet ne fushen e ndertimit, Hoteleri-Bar-Restorant

- *Kreditimi i gazoilit per periudhen Korrik-Dhjetor 2020 dhe Janar-Dhjetor 2021.*

Sipas analizes suaj tatimpaguesi me nje qarkullim prej 67.726.646 leke ne zbatim te udhezimit nr 6, date 30.01.2015 "Per TVSH-ne" i ndryshuar duhet te kreditoj ne vlere te tatueshme 3% te qarkullimit te kryer pasi aktiviteti tij eshte vetem tregi.Mbi te njejtin arsyetim eshte kryer edhe analiza per periudhen Janar-Dhjetor 2021. Sipas analizes se kryer nga ana juaj ne total eshte kredituar 251.811 leke TVSH me shume nga cfare lejon ligji.

Sqarojme se:

Nga ana e grupit te kontrollit te DRT Vlore eshte analizuar aktiviteti i tatimpaguesit i cili nuk rezulton i nje natyre te vetme por i shumellojshem. Shoqeria kryen aktivitetet te ndertimit, bar dhe restorant. Pjese e ketyre sherbimeve te ofruara eshte edhe transporti i punonjesve ne vendin e punes, si pjese e mbajtjes se struktures funksionale ne raste te nderprerjes se energjise shoqeria perdor dhe nje gjenerator elektrik i cili funksionon me nafte. Shoqeria zoteron disa mjete teknike te ndertimit te cilat jane bere pjese e ofrimit te sherbimit te punimeve te ndertimit.

Nisur nga parimi i "Objektivitetit" i materializuar ne ligjin nr 9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar dhe ligjit nr 92/2014 "Per TVSH-ne" i ndryshuar, grupi i kontrollit me qellim gjykimin sa me drejte te aplikimit te zbritjes se TVSH-se per gazoilin mori ne konsiderate dy normativa zbritje te tij ate te tregtise dhe te tjera. Duke marre parasysh keto dy normativa dhe kryerjen e perlllogaritjeve si meposhte nuk u konstatuan efekte ekonomike per tu analizuar.

Gjitashtu sqarojme se nga te dy furnoret pershkrimi i blerjeve eshte "Gazoil" sepse kjo eshte natyra e shumices e furnizimit te kryer por pjese e ketyre furnizimeve jane edhe vajra lubrifikante, filtra dhe pjese kembimi.

Nisur nga faktet e mesiperme rezulton se per periudhen Korrik 2020-Dhjetor 2021 Blerjet e gazoilit jane ne vleren 7.988.500 leke vlere te tatueshme dhe blerjet per vajra lubrifikante dhe pjese kembimi jane 3.263.280 leke, vlere kjo e lejuar per kreditim sipas analizes se kryer nga kontrolli dhe udhezimit nr 6 "Per TVSH-ne" i ndryshuar.

- *Ndertimi i hotelit dhe situacionimi i punimeve te ndertimit.*

Sipas analizes te kryer nga audituesit shoqeria "H Group" operacionet e ndertimit nuk i ka kryer ne perputhje me legjislacionin e fushes dhe ate tatimor. Persa ky aktivitet eshte kryer ne kundershtrim me kerkesat ligjore tatimpaguesit nuk duhet ti njihet e drejta e zbritjes se TVSH-se per ndertimin e hotelit dhe keni perlllogaritur nje detyrim prej 23.034.203 leke.

Sqarojme se:

Grupi i kontrollit pasi konstatoi kompleksitetin e situates e shtriu analizen e tij ne kuptim te legjislacionit tatimor, atij te fushes se ndertimit, praktikave te meparshme te kontrollit dhe vendimeve gjyqesore te rasteve analoge te dhene nga gjykatat.

Shoqeria "H" me NIPT LT dhe "H" me NIPT JI ka lidhur nje kontrate kalim te drejtash mbi lejen e zhvillimore nr 1 date 04.05.2015. Ne zbatim te kesaj leje po ndertohet nje kompleks hotelier me 4 kate dhe 1 kat nen toke.

Shoqeria per pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ka kryer aplikimin perkatese prane Bashkise Vlore.

Ne zbatim te vendimit nr. 408, datë 13.5.2015 "Per Miratimin e Rregullores se Zhvillimit te Territorit", percakton se leja e ndertimit është e transferueshme, me ndryshimin e subjektit përfitues të lejes së ndertimit. Transferimi i lejes së ndertimit gjatë afatit të zbatimit të saj duhet t'i komunikohet sportelit të

shërbimit pranë autoritetit që ka lëshuar lejen, bashkërisht me aktet zyrtare që vërtetojnë kalimin e titullit mbi lejen e ndërtimit.

“Leje zhvillimi” është akti i përcaktimit të kushteve zhvillimore për një parcelë/pronë të caktuar, që shërben si bazë për pajisjen me leje ndërtimi.

“Leje ndërtimi” është akti i miratimit të kërkesës për leje ndërtimi dhe i lejimit të punimeve përkatëse.

Persa me sipër grupi i kontrollit gjykoj që leja e zhvillimit dhe ndërtimit në thelb të tyre janë të lidhura me zhvillimin e territorit dhe ngritjen e objektit brenda kriterëve të përcaktuara në këto leje. Në asnjë moment, siç është përcaktuar dhe nga raporti i inxhinjerit të ndërtimit, shoqëria tashmë zhvilluese “H Group” nuk ka shkelur asnjë nga kriteret e kësaj leje.

Një sqarim të tillë e jep dhe Gjykata Administrative e cila në vendimin nr 762 shprehet:

Sipas udhëzimit nr 6 datë 30.01.2015 “Per TVSH-ne” i ndryshuar dy janë situatat që nuk lejohet zbritja e TVSH-se:

1. Se pari, kur janë kryer blerje për punime në shkelje të lejes së ndërtimit. Në këtë rast behet fjale për punime ndërtimore të cilat janë në kundërshtim me projektin e miratuar në lejen e ndërtimit;

2. Se dyti, kur janë kryer blerje për punime të kryera përpara se të jetë miratuar leja përkatëse;

Në udhëzimin nr 6, datë 30.01.2015 “Per TVSH-ne” i ndryshuar, nëni 20, pikë 8, shkronja b, është përcaktuar se rregullat për qellime të TVSH-se, për të rregulluar dhe sqaruar zbatimin e tatimit bazohen në legjislativonin e fushës ku ushtrohet veprimtaria, ku në rastin konkret është ligji nr 107/2014 “Per Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Konsatohet se Bashkia Vlorë ka vlerësuar të ligjshëm kontratën e shoqërive dhe e ka reflektuar këtë ndryshim në lejen fillestare të ndërtimit duke vendosur zhvilluesin e ri si përgjegjës dhe përfitues të objektit.

Bashkangjitur këtij observacioni:

- Leja e ndryshuar e ndërtimit
- Vendimi i Gjykatës Administrative

Sjellim bashkangjitur këtij observacioni dhe një rast të njëjtit në të cilin është kërkuar interpretim nga drejtoria ligjore në DPT e cila e riadreson në DRT përkatëse me sqarimin:

-Persa kerkohet nga ana juaj, është objekt verifikimi dhe vlerësimi nga Drejtoria e Kontrollit në DRT e juridiksionit, në çilesinë e strukture kompetente.

Tatimpaguesi: I

NIPT: MR

Aktiviteti: Veprimtari në fushën e ndërtimit, zbatimit dhe projektimit. Ndërtime civile, industriale, turistike, investitor në sektorin e turizmit. Tregeti me shumicë e pakice, import-eksport të mallrave të ndryshëm industrial, bujqësore dhe blegtorale, etj. Bar, kafe, turizëm hotelier. Pastrim, urbanizim të plazheve në bregdet.

-Diferenca Raport Ekspertimi Teknik – Raport Kontrolli.

Sipas analizës të kryer nga audituesit citohet se sipas Raport Teknik të inxhinjerit të ndërtimit situacionet janë në vlerën 78.052.008 leke ndërsa situacionet të deklaruara në sistemin tatimor c@ts 121.982.058 leke. Për këtë diferencë nga ana juaj janë perlllogaritur detyrime tatimore duke e konsideruar si tepricë kreditore të TVSH-se të krijuar padrejtesisht.

Sqarojme se:

Shoqëria “I” është pajisur me leje ndërtimi nr 104, datë 14.12.2020 për ndërtimin e një kompleksi hotelier. Shoqëria ndërtuese është “T”.

Diferenca e cilesuar nga ana juaj përfaqëson situacionin nr 9 datë 30.06.2021. Ky situacion është deklaruar në periudhën Korrik 2021. Të njëjtin veprim shoqëria ka kryer dhe me dy situacionet e tjera Korrik dhe Gusht duke i deklaruar në periudhën pasardhëse. Gabimisht nga ana e inxhinjerit të ndërtimit nuk është përfshirë në raportin e saj fillestar periudha Qershor 2021 por është dorezuar shkresë nga ana e saj për sqarimin e këtij gabimi.

Bashkangjitu po ju dergojme situacionet e punimeve të ndërtimit për të cilat është kryer kreditimi i TVSH-se dhe është përfituar dhe rimbursimi përkatës.

Shoqeria ne deklarimet e saj ka zbatuar dispozitat e percaktuara ne udhezimin nr 6 date date 30.01.2015 "Per TVSH-ne" i ndryshuar mbi modalitetet e zbatimit te TVSH-ne ne ndertim.

Theksojme qe diferenca vjen vetem si pasoje e nje gabimi nga ana e ixhinjerit te ndertimit ne aktin e saj dhe ne asnje rast nuk konstohet diferenca ne vlera te situacionuara dhe fatuaruara. Gjithashtu nuk konstatohen diferenca midis punimeve te kryera dhe atyre te faturuara.

Tatimpaguesi: K

NIPT: KS

Aktiviteti: Pregatitja e specialisteve te larte ne fushen e shkencave juridike, ekonomike, inxhinierike Sipas analizes te kryer nga audituesit citohet se shoqeria per zerin shpenzime te tjera te deklaruara ne pasqyren e performances per vitin 2020 dhe 2021 duhet ti klasifikoj si shpenzime te pazbritshme pasi nuk zoteron dokumentacion e duhur.

Sqarojme se:

Shoqeria gjate aktivitetit te saj perdor burimet financiare per kryerjen e aktivitetit normal te saj. Disa prej ketyre shpenzimeve te kryera gjate nje periudhe rimerren ne pasqyren e performacen te vitit korrent dhe disa prej tyre kontabilizohen ne zerin shpenzime te periudhave te ardhshme pasi megjithese jane kryer ende nuk kane marre pjese ne gjenerimin e te ardhurave. Rregulli per klasifikimin e tyre si shpenzime te periudhave te ardhshme dhe momentin e rimarrjes ne pasqyren e performances percaktohen nga Standartet Kombetare te Kontabilitetit. Pikerisht rimarrjen e ketyre shpenzimeve ne periudhat 2020 dhe 2021 perfaqeson zerin -Shpenzime te tjera. Keto jane shpenzime te dokumentuara dhe perllogaritura ne zbatim te ligjit 8438, date 28.12.1998 "Per Tatimin mbi te Ardhurat" i ndryshuar dhe jane te njohura per efekte fiskale.

Tatimpaguesi: "C" Sh.p.k

Kreditimi i gazolit.

Sipas analizes se audituesve tatimpaguesi ne zbatim te udhezimit nr 6, date 30.01.2015 "Per TVSH-ne" i ndryshuar duhet te kreditoj ne vlere te tatueshme prej 25% te qarkullimit te kryer pasi aktiviteti tij eshte Germime / shpime. Sipas analizes se kryer nga ana e audituesve ne total eshte kredituar 7.807.613 leke TVSH me shume nga cfare lejon ligji. Sqarojme se shoqeria kryen aktivite te germimit, cpimeve, transport dheu, ndertim rruges dhe objektesh. Per periudhen e kontrollit shoqeria ka kryer punime te germimeve transport dheu dhe punime per ndertimin e rruges Palase - Dhermi. Kjo vertetuar dhe nga librat e shitjes ku klienti i saj kryesor eshte shoqeria "Gj" me NIPT JH.

Persa me siper dhe ne zbatim te udhezimit nr 6 date 31.05.2015, neni 55, pika 1/b normativa e perllogaritjes se vleres se tatueshme per efekt te zbritjes se TVSH-se eshte 32% aq sa eshte perllogaritur ne Raport Kontrolli.

Tatimpaguesi: S

Per kete shoqeri vendimarrja ka qene objekt i gjykimit ne Gjykatën Administrative ku dhe me vendimin nr 762 eshte vendosur:

Sipas udhezimit nr 6 date 30.01.2015 "Per TVSH-ne" i ndryshuar dy jane situatat qe nuk lejohet zbritja e TVSH-se:

1. *Se pari, kur jane kryer blerje per punime ne shkelje te lejes se ndertimit. Ne kete rast behet fjale per punime ndertimore te cilat jane ne kundershtrim me projektin e miratuar ne lejen e ndertimit;*

2. *Se dyti, kur jane kryer blerje per punime te kryera perpara se te jete miratuar leja perkatese; Ne udhezimin nr 6, date 30.01.2015 "Per TVSH-ne" i ndryshuar, neni 20, pika 8, shkronja b, eshte percaktuar se rregullat per qellime te TVSH-se, per te rregulluar dhe sqaruar zbatimin e tatimit bazohen ne legjislacionin e fushes ku ushtrohet veprimtaria, ku ne rastin konkret eshte ligji nr 107/2014 "Per Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" dhe aktet nenligjore te dala ne zbatim te tij.*

Konsatohet se Bashkia Vlore ka vleresuar te ligjshem punimet e kryera nga shoqeria dhe jo ne kundershtrim me lejen e ndertimit per kete arsye me vendimin nr 672 date 14.09.2021 ka vendosur miratimin e shtyrjes te afatit te lejes se ndertimit per nje periudhe 10 mujore.

Nisur nga fakti qe kjo vendimarrja eshte konfirmuar nga sistemi gjyqesor vleresojme qe nuk ka efekte ekonomike per tu analizuar.

Tatimpaguesi: V

NIPT: LN

Aktiviteti: Paketim dhe magazinim i peshkut

Sipas analizës të kryer nga audituesit citohet se shoqëria ka kryer punime ndërtimi duke kryer autofaturim por nuk është e pajisur me lishencë për kryerje punimesh dhe gjithashtu nuk është pajisur me leje ndërtimi dhe për këtë arsye në zbatim të ligjit 92/2014 "Për TVSH-në" i ndryshuar nuk duhet të kreditohet TVSH në vlerën 825.910 leke.

Sqarojme se:

Shoqëria në fjalë ka kryer punime brenda objektit pa ndryshuar strukturën e tij si shtrim parketi dhe vendosje paneli diellor. Theksojmë se në zbatim të vendimit nr. 408, datë 13.5.2015 "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" neni 6 "Ndërhyrje që nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi" citohet:

Pa përjashtuar detyrimin e respektimit të dispozitave të parashikuara nga kuadri ligjor në fuqi për veprimtarinë ndërtimore, përfshirë, në mënyrë të veçantë, sa i përket qëndrueshmërisë antisizmike, mbrojtjes kundër zjarrit, ruajtjes së sigurisë dhe higjienës shëndetësore, ndërhyrjet e mëposhtme kryhen pa pajisje me leje ndërtimi

ii) ndërhyrje të brendshme:

- riparimi dhe rinovimi i dyshemeve;

Përsa me sipër këto punime nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe nuk konstatohet asnjë shkelje me legjislacionin e fushës së ndërtimit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Në lidhje me pretendimet e paraqitura në observacion sqarojmë se janë të njëjta më ato të paraqitura për akt-konstatimet (të trajtuara hollësisht në pjesën takuese në Projekt Raport), nuk janë paraqitur argumente apo dokumente shtesë, për pasojë nuk merren në konsideratë.

-Nga znj. F S me detyrë Inspektori i Kontrollit në Vend pranë DRT Vlorë, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në projekt raportin e kontrollit grupit të auditit është konstatuar se në raportin e kontrollit mbajtur nga ana jone në subjektin "E" me nipt LJ ka rezultuar se subjekti ka shitje me 6% në vlerën 14,638,347 leke me TVSH dhe në periudhën Mars-Korrik 2021 nuk ishte paisur me certifikatë kategorizimi dhe subjektit i lindi detyrimet si më poshtë;

Tvsh 20% 2,049,368 leke

Gjore 409,873 leke

Për sa me sipër sqarojmë se; nga ana jone është marrë parasysh data e aplikimit të subjektit pranë Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit për pajisjen me certifikatën e kategorisë së struktura akomoduese, aplikimi me nr 4147 prot date 15.06.2020 administruar në DRT Vlorë me nr 3037 prot date 26.05.2023 dhe certifikata e pronësive është leshuar në datë 10.08.2023.

Periudha e kontrolluar prej nësh është 2021/03-2021/07 dhe në momentin e kontrollit është kërkuar prej subjektit certifikata e kategorizimit, subjekti na ka paraqitur vetëm aplikimin .

Bazuar në urdhrin 267, datë 24.07.2019, për kategorizimin e Strukturave akomoduese, me datë 31.12.2019, subjekti ka dërguar pranë Ministrisë së Turizimit, kërkesën bashkë me të dhënat për kategorizimin e strukturës, për përfitimin e TVSH së reduktuar në 6%, duke plotësuar kushtin e parë formal, që ky proces kërkon (Vertetuar me mandatin e postes, deklaruar dhe në SIT).

Urdhëri i parë i Ministrisë nr 267, datë 24.07.2019, kishte afat deri me 31.12.2019, dhe urdhëri i dytë të i Ministrisë nr 18, datë 17.01.2020, kishte afat deri me 31.12.2020.

Në kuptim të ligjit material të Procedurave Tatimore, bazuar dhe në Nenin 155 i Kushtetutës parashikon se taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj dhe se, në këto raste, ligji nuk mund t'i jepet fuqi prapavepruese.

Referuar ligjit, duke qënë se afati i aplikimit fillestar ishte deri me datë 31.12.2019, dhe afati i dytë i shtyre, ishte deri me datë 31.12.2020, në asnjërin rast ligji nuk jep të drejten e afektimit të shifrave të deklaruara nga subjekti, përpara konsumimit të afatit zyrtar për aplikim.

Duke gjykuar në aspektin e kundërt, nëse subjekti do kishte marrë çertifikaten e Kategorizimit në 2021, bazuar në aplikimin e datës 15.06.2020, cili do ishte argumentimi juridik i cili do i njihte të drejten e shkallës së reduktuar të TVSH-së, për vitin 2020, 2021?

Bazuar në nenin 49, të ligjit 92/2014, pika 3, Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese, sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin e fushës së turizmit, është 6 për qind. Kushtet, kriteret dhe procedurat për zbatimin e kësaj pike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Kriteret ligjore për përfitimin e këtij reduktimi, përcaktohen në urdhërin 267, datë 24.07.2019.

Urdhër Nr.267, Datë 24.07.2019 “Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese”, i ndryshuar.

Neni 4 Procedura e kategorizimit të strukturave akomoduese

Si konkluzion:

Bazuar në ligjin për Procedurat Tatimore, të cituar dhe më sipër, dhe në dy udhëzimet e Ministrisë së Turizmit, në lidhje me afatet e aplikimit për Kategorizimin e strukturave akomoduese, subjekti ka plotësuar kushtin formal të aplikimit brenda afatit ligjor dhe është në pritje të miratimit të saj.

Afatet ligjore, në kuptim të ligjit, nuk kanë fuqi prapavepruese.

Kategorizimi i Strukturave Akomoduese

Në zbatim të Urdhrit nr.267, datë 24.07.2019 “Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese”, i ndryshuar, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka filluar procesin e Kategorizimit të Strukturave Akomoduese.

Afati për Aplikim

Çdo subjekt, që ushtron veprimtarinë si strukturë akomoduese, është i detyruar të aplikojë pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për t’u pajisur me certifikatën e kategorizimit brenda datës 31.03.2020, për të përfituar shkallën e reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese. Për këtë aplikim subjekti duhet të parqesë dokumentacionin e detyrueshëm dhe shoqërues të përcaktuar në pikën 1 të nenit 6 të urdhrit nr. 267 datë 24.07.2019, të ndryshuar dhe në rast se nuk e ka depozituar dokumentacionin shoqërues në momentin e aplikimit, duhet ta dorëzojë atë brenda datës 31.12.2020 pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin.

Gjithashtu ne ëëbin e DPT është hedhur njoftimi përkatës për afatin e aplikimit.

Kështu, bazuar në ligjin nr.92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH”, të ndryshuar, Neni 49, pika 4, (Ligj nr. 107/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014, “Për TVSH në RSH”, të ndryshuar) shkalla e reduktuar e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar 6 % aplikohet për çdo furnizim shërbimi të ofruar brenda strukturave akomoduese, të cilat kanë aplikuar për marrjen e certifikatës së kategorizimit brenda datës 31.03.2020.

Ju bej me dije se afati i aplikimit deri ne daten 31.03.2020 është per subjektet te cilet kane aplikuar tvsh-ne e reduktuar para kesaj date. Subjekti qe une kontrolloj ka aplikuar para dates qe une kontrolloj dhe është marr parasysh momenti i aplikimit. Dhe ne ligj citohet vetem momenti i aplikimit .Gjithashtu është marr parasysh dhe vendimi i Drejtorise se Apelit prane Ministrise se Financave publikuar ne faqen zyrtare te DAT per nje rast te njejte per te cilen është marr parasysh data e aplikimit per marrjen e certifikates.

Duke gjykuar në aspektin e kundërt, nëse subjekti do kishte marrë çertifikaten e Kategorizimit në 2021, bazuar në aplikimin e datës 31.12.2020, cili do ishte argumentimi juridik i cili do i njihte të drejten e shkallës së reduktuar të TVSH-së, për vitin 2019?

Si konkluzion: Bazuar në ligjin për Procedurat Tatimore, të cituar dhe më sipër, dhe në dy udhëzimet e Ministrisë së Turizmit, në lidhje me afatet e aplikimit për Kategorizimin e strukturave akomoduese, subjekti ka plotësuar kushtin formal të aplikimit brenda afatit ligjor dhe ka qene në pritje të miratimit të saj.

Formulari 3- nuk eshte hedhur ne sistemin C@TS nuk ka nenshkrim nga inspektori sipas manualit te kontrollit Kapitulli II, pika 2.2

Formulari 3 eshte dokument qe tregon levizjen e praktikës se kontrollit midis hallkave te grupit te kontrollit. Ky formular i bashkalidhet kopjes se dosjes qe qendron ne arkive se bashku me raportin perfundimtar. Eshte e pamundur teknikisht te ngarkohet ne sistem sepse ceshija ne sistem perfundon me miratimin e saj nga DR Rajonal. Pas miratimit nga ky i fundit ne ceshije nuk mund te ngarkohen dokumenta. Gjithesesi cdo levizje e praktikës se kontrollit eshte e gjurmueshme ne sistemin C@ts.

Raporti i kontrollit nuk ka te bashkangjitur si pjese perberese te tij "Formularin Pyetesor i vetedeklarimit para kontrollit" jo ne perputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor Kapitulli II pika 2.1 paragrafi 6. Per sa me siper ju bejme me dije se eshte zbatuar Manuali i kontrollit Kapitulli II pika 2.1 paragrafi 8 ku thuhet "Nëse tatimpaguesi nuk deklaroi sipas pikës 3, të këtij neni, përpara fillimit të kontrollit prezumohet që nuk ka për të deklaruar dhe për çdo detyrim tatimor apo shkelje të konstatuar gjatë kontrollit aplikohen dënimet administrative sipas këtij ligji."

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Në lidhje me pretendimet e paraqitura në observacion sqarojmë se janë të njëjta më ato të paraqitura për akt-konstatimet (të trajtuara hollësisht në pjesën takuese në Projekt Raport), nuk janë paraqitur argumente apo dokumente shtesë, për pasojë nuk merren në konsideratë.

-Nga znj. M B me detyrë Inspektor i Kontrollit nga Zyra pranë DRT Vlorë, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Tatimpaguesi Partner me nipt MF me vendimin Nr1 te Ortakut të Vetëm të Shoqërisë, më datën 30.09.2022 ka vendosur miratimin e blerjes me transferim të një pjese të veprimtarisë së shoqërisë G.M shpk me nipt KR dhe konkretisht veprimtarinë ekonomike "Sherbim Hotelerie ,akomodim,bar-restorant, salla konferencash etj aktivtete te tjera te turizmit". Ky transferim eshte miratuar gjithashtu edhe nga shoqeria transferuese G.M shpk me nipt KR, me vendimin Nr 1 te Otakut te Vetem te shoqerise me date 30.09.2024 (bashkelidhur te dy vendimet).

Tatimpaguesi ka njoftuar per kryerjen e ketij transferimi me shkresen nr. 7854 dt 17.10.2022 (Bashkelidhur shkresa).

Me date 29.10.2022 shoqeria G.M shpk nepermjet fatures nr.2784 date 29.10.2022, i ben shitjen e aseteteve te lidhura me strukturen akomoduese , shoqerise P H. (bashkelidhur fatura).

Me date 31.10.2022 nenshkrhet Akt Marveshja e Transferimit te Veprimtarise Ekonomike ndermjet Shoqerise transferuese G.M shpk dhe Shoqerise perfituese P H (Bashkengjitur kopje e akt marveshjes).

Tatimpaguesi G.M shpk me nipt KR, i cili ne kete rast eshte ne kushtet e transferuesit te veprimtarise se struktures akomoduese ka qene i pajisur me certifikatene kategorizimit te struktures akomoduese Nr.regj 1234/2020 leshuar me 08.09.2021 pikerisht per te njejten godine, pra te njejten strukture Hotel "P" dhe per periudhen ne te cilen po kryhej transferimi tek tatimpagesi P shpk, ky subjekt (G.M shpk) nuk ka deklaruar me shifte 6 % edhe pse zoteronte certifikaten, por shitjet jane deklaruar nga subjekti perfitues Pshpk (Bashkelidhur certifikata).

Tatimpaguesi P duke qene se ishte ne proces blerje me transferim te struktures akomoduese,e gjendur ne kushte te filla (Perfituese te transferimit te veprimtarise), deri ne momentin qe do te perfundoj procesi i tranferimit Shoqeria P Hotel ka perdorur certifikaten e struktures akomoduese per Hotel P me Nr.1234/2020 Date 08.09.2021 te nxjerr nga shoqeria tranferuese.

Persa ju theksoni ne projekt raportin tuaj qe tatimpaguesi nuk e ka ne pronesi hotelin apo ne mardhenie tjeter qeraje, nuk duhej te gezonte te drejten e aplikimit te normes 6%, ju bej me dije se duke qene se tatimpaguesi ishte ne proces perfitimi me transferim te objektit Hotel P sic ju sqarova me lart, ndermjet tij dhe shoqerise GM shpk me nipt KR, me date 24.09.2022 eshte nenshkruar nje Kontrate Huaperdorje sipas te ciles Huadhenesi (Shoqeria GM) jep ne perdorim pa kundershperblim Huamarresit (Shoqerise P) hotelin dhe certifikaten e kategorizimit te struktures akomoduese leshuar me date 08.09.2021, Nr. Rregj 1234/2020, deri ne momentin e transferimit te veprimtarise ekonomike te hotelerise (bashkelidhur kopje e kontrates).

Shpresoj qe informacioni dhe sqarimet e vendosura nga ana ime ne kete observacion te sherbejne per nje qartesim te situates se tatimpaguesve te permendur ne materialin tuaj.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me pretendimet e paraqitura në observacion sqarojmë se janë të njëjta më ato të paraqitura për akt-konstatimet (të trajtuara hollësisht në pjesën takuese në Projekt Raport) dhe referuar faturës së shitjes së aseteve të lidhura me strukturën akomoduese apo vetë strukturën akomoduese, sqarojmë se këto nuk janë trajtuar në kuadrin e transferimit të veprimtarisë ekonomike në raportin e kontrollit tatimor. Për rrjedhojë, nuk janë paraqitur argumente apo dokumente shitesë dhe observacionet nuk merren në konsideratë.

-Nga z. M me detyrë Inspektor i Kontrollit në Vend pranë DRT Vlorë, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Për Tatimpaguesin "A" Nipti: KE, me përmbajtje si në vijim:

Normativat për kreditimin e karburantit aplikohen mbi bazen e treguesit të percaktuar sipas peshes specifike që blerjet për gazoil në vlerën 19.471.731 leke zene në raport me qarkullimin e tatueshem të kryer në kuader të veprimtarisë ekonomike të relizuar dhe deklaruar si më poshtë:

Shitje të tatueshme me shkallë tatimore 20% të deklaruar në TVSH nga tatimpaguesi nuk janë vetëm nga veprimtaria e sigurimit të objekteve të veprimtarisë ekonomike të marra nga ana juaj por edhe nga veprimtaria e TRANSPORTIT TË VLERAVE MONETARE, sipas faturave të shitjeve të fiskalizuara duke e plotësuar qartë përshkrimi e veprimtarisë ekonomike transport vlerash monetare sipas licenses perkates 1.3.B. që disponon tatimpaguesi, pra për veprimtari transporti vlera monetare që kanë krijuar dhe deklaruar të ardhurave me mjetet e shoqërisë sipas dokumentacionit baze për kreditimin e karburantit aplikohet norma 38 % dhe jo 2%.

Keni praktiken e mjeteve në pronësi të shoqërisë sipas inventarit fizik vecmas AUTOBLINDA NE PRONESI TË SHOQËRISË , një kopjo të licenses se vecante 1.3.B. që disponon tatimpaguesi, dhe një praktike fatura shitje të fiskalizuara me shkallë tatimore 20% me përshkrim të sakte TRASPOT VLERASH MONETARE ku janë realizuar dhe deklaruar të Ardhura të evidentura me vete në TVSH dhe në pasqyrat financiare si më poshtë:

a-Sipas faturave të fiskalizuara shitjet me shkallë tatimore 20% të deklaruar në TVSH me përshkrimin të sakte të realizuara nga veprimtaria e sigurimit të objekteve janë në vlerën 128.554.012 leke.

b-Sipas faturave të fiskalizuara shitjet me shkallë tatimore 20% të verifikueshme nga sistemi 100% të deklaruar në TVSH me përshkrim të sakte realizuar nga veprimtaria e transportit të vlerave monetare janë në vlerën 53.031.376 leke (pra janë të ardhura të deklaruar ku janë paguar detyrimet tatimore në TVSH dhe tatimfitimi).

Totali shitjeve gjithsej me shkallë tatimore 20% përputhet me shumën e deklarimit në vlerën 181.585.388 leke.

Sipas pikes a- Vlera e shitjeve të deklaruar në TVSH me shkallë tatimore 20% dhe në pasqyrat financiare prej 128.554.012 leke, klasifikohet si veprimtari të tjera dhe normativa e perdorimit të karburantit është 2% dhe vlera e karburantit të lejuar për tu kredituar është $128.554.012 \times 2\% = 2.571.080$ leke.

Sipas pikes b-Vlera e shitjeve sipas faturave të transportit që kanë krijuar të ardhura dhe janë të deklaruar në TVSH dhe në pasqyrat financiare janë 53.031.376 leke, dhe klasifikohet si veprimtari TRANSPORTI VLERASH MONETARE dhe normativa e perdorimit të karburantit është 38% , dhe vlera e karburantit të lejuar për tu kredituar sipas llogaritjeve është $53.031.376 \times 38\% = 20.151.922$ leke.

Totali vleres së karburantit në blerje të lejuar për kreditim në raport me qarkullimin sipas të ardhurave të veprimtarisë ekonomike të analizuar vecmas është 22.723.002 leke($2.571.080 + 20151.922$).

Meqëse tatimpaguesi disponon dokumentacionin baze fatura të fiskalizuara shitje me përshkrimin transport të vlerave monetare duke krijuar dhe deklaruar të ardhura në shumën 53.031.376 leke, nga ana juaj nuk mund të aplikohet norma e kreditimit të karburantit në masën 2% si tregeti por sipas faktit të realizimit të të ardhurave në normën 38% ,duke argumentuar se në tregeti transporti mallrave për shoqërinë me mjetet në pronësi të shoqërisë , atëherë kur nuk leshon fature shitje të fiskalizuara për realizim të ardhurash aplikohet norma 2%.

Sipas të dhenave të më sipërme kur janë krijuar dhe deklaruar të ardhura nga faturat e fiskalizuara të shitjes për transport vlerash monetare me mjetet shoqërisë të pasqyruara në kontabilitet dhe me licencën

perkatese 1.3.B. te vecante qe jepet per kete lloj transporti nuk keni te drejte te beni vlersim per ti llogaritur detyrimet tatimore dhe penalitete (shif praktiken e dokumentacionit te derguar ne observacionin e pare).

Nuk jane analizuar shitjet, jane analizur saktesisht referuar faturave te fiskalizuara dhe per mosperputhjet e shitjeve te deklaruar ne TVSH, krahasuar me shumate e pasqyrave mujore te fiskalizimit (*TE CILAT NE PROCESIN E FISKALIZIMIT NUK DUHET TE EKZISTOJNE*) jane bere vlersimet perkatese per detyrimet tatimore dhe penalitetet ne vitin 2022 per vleren 497.370 leke dhe per 5/mujorin 2023 ne vleren 1.153.370 leke.

Nuk eshte bere bilanci material, eshte bere bilanci material per artikujt kryesor te perzgjedhur nga inventari referuar proces verbalit fizik pasi nuk ka patur ndryshime (shif inventarin ne raport kontrolli dhe pasqyren e bilancit material bashkelidhur).

Per liste pagesat dhe kontributet ne daten e fillimit te kontrollit eshte mbajtur Proces verbali perkates ne te cilin verehen qarte , numeri i te punesuareve eshte 239 , ditet e punes, paga bruto dhe neto per efekt te llogaritjes se kontributeve dhe paga mesatare ne raport me ditet e punuara dhe rezulton ne vleren 62.290 leke (shif proces verbalet e bashkelidhur ne raport perfundimtar kontrollin), pra sipas liste pageses paga per cdo punonjes nuk eshte me e vogel se paga minimale shumezuar me 20 deri ne 50% (shif proces verbalin perkates).

Jane analizuar efektet per pagesen e detyrimeve tatimore ne TVSH, tatim fitimi, kontributet shoqerore, TAP,etjera rast pas rasti.

Ne analizen e tregueseve te TVSH-se Koficenti pageses se TVSH-se ne raport me shitjet e tatueshme me shkalile tatimore 20% pa mare parasysh efektet eshte jo me pak se 16 % ose me vlere te shtuar 80% (16*5), pra mbi perqindjet e krahasuara me subjektet analoge.

Ne perfundim te kontrollit eshte evidentuar pasqyra permbledhese per pagesat e detyrimeve tatimore ne raport me te ardhurat e deklaruar per periudhen e kontrollit te cilat jane ne vleren absolute 192.066.676 leke dhe ne perqindje me te ardhurat e deklaruar eshte jo me pak se +38%.

Në takimin e mirëkuptimit të zhilluar në ambjentet e KLSH-së në datë 31.07.2024 në prani të drejtuesve të KLSH, u paraqitën observacione shtesë që përfshijnë fatura tatimore që kategorizojnë shitjet në transport vlerash monetare dhe shërbime sigurie, licenca, certifikata dhe autorizime për ushtrimin e aktivitetit të transportit të vlerave monetare nga tatimpaguesi.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me pretendimet e paraqitura në observacion sqarojmë se janë të njëjta më ato të paraqitura për akt-konstatimet (të trajtuara hollësisht në pjesën takuese në Projekt Raport). Për rrjedhojë, nuk janë paraqitur argumente apo dokumente shtesë dhe observacionet nuk merren në konsideratë. Në përgjigje të observacioneve të paraqitura në takimin e mirëkuptimit në KLSH, marrim në konsideratë pjesërisht faktin që udhëzimi i TVSH-së nuk shprehet specifikisht për trajtimin e kreditimit të karburantit për rastin e shoqërive të transportit të vlerave monetare si një kategori e veçantë e transportit, por megjithatë, kjo nuk pasqyron të drejtën për ta klasifikuar këtë aktivitet si transport mallrash. Për rrjedhojë, reflektohet gjetje edhe në masat organizative për DPT për këtë sektor duke qenë se elementi kryesor i vlerës së tatueshme të kostove të furnizimit përfshin koston e punës direkte të përbërë nga pnonjësit e armatosur gjatë transportit të vlerave monetare.

Për Tatimpaguesin “D” Sh.p.k, Nipti: KL, me përmbajtje si në vijim:

Ne raport perfundimtar kontrollin jam shprehur se tatimpaguesi ka plotesuar dhe deklaruar gabim, faturat per vete furnizim ne masen 100% te situacioneve per te perfituar kreditimin e TVSH-se se materialeve dhe me pas rimbursimin e TVSH-se nga ky gabim ne vleren e tatueshme 19.569.323 leke dhe TVSH 3.913.865 leke , duke bere anullimin e ketyre vlerave ne periudhat perkatese.

Ne rastin konkret tatimpaguesi ka te drejte te kreditoje TVSH-ne ,e evidentuar me vete per pjesen e ndertimit qe do ti sherbeje veprimtarise tatueshme ne masen 67%(100%-33%) dhe jo 100% te cilat jane saktuar dhe anuluar nga KONTROLLI.

Ne raport kontrolli eshte cilesuar se faturat tatimore ne shitje te trajtuara si vete furnizim do te priteshin ne masen 67% te vleres se situacionineve mujore dhe do te deklaroheshin ne blerje dhe shitje per te

njejten vlere dhe vecmas faturat tatimore per pronarin e truallit do te priteshin ne masen 33% te vlere se situacionineve mujore dhe do te deklaroheshin vetem ne shitje .

Nuk jane konstatuar ndryshime ndermjet objektit te ndertimit krahesuar me lejen e ndertimit nuk qendron, por jane konsideruar te mirqena bazuar te projekti dhe planimetrite te verifikuara ne raportin teknik te inxhinjerit.

Nuk administrohet ndryshimi i lejes se ndertimit nuk qendron, te cilen po ju ve ne dispozicion me keto te dhena leje ndertimi numer 229 date date 26.03.2021.

Rivlersimi eshte kryer per pjesen e blerjeve sepse kemi plotesim te gabuar te faturave tatimore te shitjes ne masen 100% kur duheshin prere vecmas me 67% per ndertuesin dhe dhe 33% per pronarin e tokes vlere e cila nuk duhej te kreditohej si blerje prandaj eshte bere anulimi ketyre vlerave ne masen 33% .

Nuk mund ti sistemoj shitjet vecmas pasi vlera e shitjeve eshte ne funksion te prerjes se fatures tatimore shitje te cilat jane plotesuar dhe deklaruar gabim.

Nuk jane analizuar blerjet e tjera qe i takojne vete furnizimit qe perfshine inventar dhe A.A.M qe nuk jane pjese e situacionit, ne raport perfundimtar kontrolli jane te percaktuara vlefat perkatese te shoqeruara dhe me flete inventarit analitik te ketyre artikujve bashkelidhur kontrollit.

Per artikujt e mare ne analize sipas raportit teknik te inxhinjerit nuk jane konstatuar diferenca per tu trajtuar , duke theksuar se ky kontroll ne ndertim eshte per periudha te ndermjetme dhe eshte ne vazhdimesi te kontrollit paraardhes .

Sipas faturave tatimore te blerjes dhe zerave te punimeve ne situacione per periudhen e kontrollit nuk kemi blerje artikuj kryesor hekur, beton, tulla, per te bere bilancin material te ketyre artikujve si vijimesi e pericesit te ndertimit .

Nuk eshte bere inventari fizik ne daten e fillimit te kontrollit,

Eshte bere inventari fizik ne momentin e kontrollit dhe ne fund te cdo viti rezulton me gjendje materiale zero (shif flete inventaret ne fund te vitit dhe ne date e fillimit te kontrollit).

Qëndrimi i grupit të auditimit: Ne pergjigje të observacioneve të subjektit të audituar në lidhje me këtë praktikë sqarojmë se mangësitë e evidentuara në raportin e kontrollit në lidhje me mungesën e bilancit material, analizën e detajuar të blerjeve për inventar apo aktive të tjera afatagjata materiale çënojnë thelbësisht formën dhe thelbin e tij si dokumenti bazë referuar ligjit të procedurave tatimore dhe manualit të kontrollit tatimor mbi të cilin mbështeten rezultatet e kontrollit. Referuar dosjes fizike të kontrollit të arkivuar, materialet e pretenduara nuk janë pjesë shoqëruese e praktikës së kontrollit tatimor. Mungesa e analizës së bilancit material dhe krahasimit me raportin e inxhinierit për daljet dhe blerjet për hyrjet përbëjnë magësi thelbësore të përmbushjes së qëllimit të raportit të kontrollit që është certifikimi i shumës së pretenduar për rimbursim të tvsh-së. Për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

Nga ana tjetër, trajtimi i gabimit të deklarimeve të tatimpaguesit në lidhje me pjeën e pronarëve të truallit si korigjim i blerjeve të kreditueshme është i gabuar, pasi referuar gjendjes faktike dhe pasqyrimeve në raport kontrolli sikurse pasqyrohet edhe në observacione është trajtimi i gabuar në rolin e shitësit dhe jo në të blerësit, pasi shitja duhej të ishte realizuar në masën 33% të pronarët e truallit dhe jo të vetëfaturuave. Megjithatë efekti është i njejtë pasi për këtë pjesë është nxjerrë njëfitm vlerësimi në masën 33% dhe për këtë arsye nga auditimi nuk janë llogaritur të ardhura të munguara.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me pretendimet e paraqitura në observacion sqarojmë se janë të njëjta më ato të paraqitura për akt-konstatimet (të trajtuara hollësisht në pjesën takuese në Projekt Raport), nuk janë paraqitur argumente apo dokumente shtesë, për pasojë nuk merren në konsideratë.

-Nga z. O Sh me detyrë Inspektor i Kontrollit në Vend pranë DRT Vlorë, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Referuar konstatimit te mbajtur ne lidhje me subjektin T me nipt KN saqorjme se per perjudhen te ciles ju i referoheni, Dhjetor 2019 subjekti ka operuar i paisur me lejen e zhvillimit Nr 1610 Date 12.11.2019. Ky dokument ka qene bashkelidhur me materialet e tjera te raport kontrollit perfundimtar. Bashkelidhur ketij materjali nje kopje e leje zhvillimi Nr 1610 Date 12.11.2019. Analiz per bilancin e materjaleve te perdorura dhe situacioneve eshte ber ne raportin e inxhinierit, bashkelidhur raport kontrollit. Diferenca ndermjet raportit te inxhinierit dhe situacioneve ne shitje te nxjera nga ana jone konsiston ne faktin se

raporti inxhinierit mer ne analiz vetem vleren neto te materialeve te blera dhe situacionuara ndersa situacioni per efekt te faturimit ne shitje perfshin edhe element si fitim ne ndertim deri ne (7%) dhe shpenzime te pergjithshme deri ne (3%).

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Në lidhje me pretendimet e paraqitura në observacion sqarojmë se janë të njëjta më ato të paraqitura për akt-konstatimet (të trajtuara hollësisht në pjesën takuese në Projekt Raport), nuk janë paraqitur argumente apo dokumente shtesë, për pasojë nuk merren në konsideratë.

-Nga znj. L K me detyrë Inspektor i Kontrollit nga zyra pranë DRT Vlorë, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Tatimpaguesi “K.” me NIPT KU

Lidhur me blerjet per investime brenda vendit me 20% per te cilat eshte njohur tvsh-ja nga ana e kontrollit, sqarojme se, subjekti keto blerje i ka bere per punime te brendshme, janë punime të cilat përfshihen në nenin 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar me VKM-në nr. 457, datë 29.06.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të këshillit të ministrave, ‘Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit’, të ndryshuar”.

Te gjitha blerjet per investime brenda vendit me TVSH 20% me siper jane punime te brendshme, riparime te ndryshme ne funksion te Hotelerise ne objektin ekzistues, per te cilin ka marre certificate perdorimi ne Tetor 2020. Punimet jane kryesisht riparime, zvendesime te pajisjeve hidrosanitare, riparimin e sistemit elektrik (kjo ndërhyrje ka qenë pjesore, aty ku sistemi elektrik, celsa, priza nuk kanë qenë funksionale), rifreskim lysterje te ambjenteteve te brendshme te Hotelit, riparim ose ndrim te pjeseve per ashensor, restaurim te nje pjese te pllakave ,te gjitha këto kanë qenë ndërhyrje ‘zëvendësuese’ dhe asnjë volum i ri nuk i është shtuar objektit. Bashkelidhur faturat dhe situacionet perkatese.

-Lidhur me postin e Bilancit “Detyrimet Afatgjata” Titujt e Huamarrjes per vitin 2020,2021 ju sqarojme si me poshte:

-Duke qene se subjekti ka qene ne veshtiresi financiare ka pasur nevojte per burime te tjera financimi ne lidhje me vazhdimin e aktivitetit. Me Vendime te Asamblese se Ortakut te Vetem z.K C, ka te dokumentuar huadhenien nga subjekte ku eshte vete administrator dhe familjarja e tij (Bashkeshortja) znj. R C. Bashkelidhur ketij observacioni Vendimet . Te detajuara:f

1. Vendim dt.14.01.2020 kerkon financim nga R C shpk(bashkeshortja) me nipt LS si dhe C sha me nipt KT me ortak te vetem z.K C (ortaku dhe administratori i vetem i shoqerise K). Burimi i financimit do te jete 200,000 euro dhe kthimi i tyre do te jete deri ne dt.31.12.2025. Bashkelidhur dhe Vendimet e pranimit te kesaj huadhenie nga subjektet R C dhe C.

2.Vendim dt.10.01.2021 kerkon financim nga R C shpk (bashkeshortja) me nipt L07308203S si dhe C sha me nipt KT me ortak te vetem z.K C (ortaku dhe administratori i vetem i shoqerise K). Burimi i financimit do te jete 280,000 euro dhe kthimi i tyre do te jete deri ne dt.31.12.2025. Bashkelidhur dhe Vendimet e pranimit te kesaj huadhenie nga subjektet R C.

3. Vendim dt.20.06.2021 kerkon financim nga K HOTEL ME NIPT Ii me ortak te vetem z.KC (ortaku dhe administratori i vetem i shoqerise K). Burimi i financimit do te jete 280,000 euro dhe kthimi i tyre do te jete deri ne dt.31.12.2025. Bashkelidhur dhe Vendimet e pranimit te kesaj huadhenie nga subjektI K. Te tre keto vendime eshte vendosur ne fund te kthimit te huadhenies perfituesi duhet te ktheje dhe interes prej 0.1 % te principalit.

Ju bejme me dije se, nga ana jone eshte bere verifikimi i konfirmave bankare lidhur me llogarine titujt e huamarrjes dhe nuk rezultuan problematika per ta raportuar ne RAD (bashkelidhur kopje te ekstraktit te bankave).

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Në lidhje me observimin për kreditimin e TVSH-së për punimet e ndërtimit, sqarojmë se janë të njëjta më ato të paraqitura për akt-konstatimet (të trajtuara hollësisht në pjesën takuese në Projekt Raport), nuk janë paraqitur argumente apo dokumente shtesë, për pasojë nuk merren në konsideratë.

-Në lidhje me observimet tuaja, për konstatimet e Grupit të Auditimit për zërin “Titujt e huamarrjes”, do të merret në konsideratë obesrvimi juaj referuar dokumentacionit të paraqitur si vendime të Asamblesë ku

janë përcaktuar shumat që do të kalojnë për llogari të ortakut, si dhe detyrimi për pagesën e interesit 0.1 % të principalit, duke bërë reflektimet në pjesën takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit, ndërsa në lidhje me ekstraktet bankare në Bankën Credins dhe BKT, ku evidentohen transaksionet e kryera nga R C për shoqërinë K HOTEL nga viti 2015 deri në vitin 2022, duhet të jenë objekt analize nga DRT Vlorë në bashkëpunim me DPT, në lidhje me saktësimin e burimit të të ardhurave sipas transaksioneve të kryera.

-Nga z. A M me detyrë Inspektor i Kontrollit nga zyra pranë DRT Vlorë, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Ne lidhje me sa trajtohet ne Projekt Raport Kontrollin protokolluar ne DRT Vlore me nr.2991/17 protokoll date 14.06.2024 ju sqarojme se:

1.Ne lidhje me subjektin H. Group SHPK, sqarojme se nga grupi i kontrollit eshte trajtuar si e pazbriteshme Tvsh-ja e blerjeve per investime vendase qe lidhej me situacionet e punimeve ne objektin Hotel ne Rrugen Vlore – Orikum, fshati Radhime. Nga te dhenat e deklaruar nga subjekti ne momentin e kontrollit, shuma e situacioneve jashte lejes se ndertimit ishte 92.516.496 leke me Tvsh 18.503.299 leke. Per sa i perket kreditimit te mjeteve te transporti, sqarojme se keto jane regjistruar ne emer te kompanise H. Group Shpk, si mjete per perdorim ne sherbim te sherbimit te akomodimit. Per kete nuk u konsiderua si e pazbriteshme Tvsh ne blerje.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: *Në lidhje me pretendimet e paraqitura në observacion sqarojmë se janë të njëjta më ato të paraqitura për akt-konstatimet (të trajtuara hollësisht në pjesën takuese në Projekt Raport), nuk janë paraqitur argumente apo dokumente shtesë, për pasojë nuk merren në konsideratë.*

- Nga z. B P me detyrë Drejtor Kontrolli pranë DRT Vlorë, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

-Në lidhje me konstatimet tuaja se nuk është respektuar afati i fillimit të kontrollit, sqarojmë se:

Afati i kontrollit për çdo çështje kontrolli është llogaritur sipas nenit 81, pika 1.1 të Ligjit nr. 9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar ku është përcaktuar data e fillimit të kontrollit. Në kushtet kur nga administratori i subjektit është dhënë pëlqimi për fillimin e kontrollit përpara datës së përcaktuar sipas nenit 81, pika 1.1 të Ligjit nr. 9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, nga ana e DRT Vlore ka vijuar kontrolli në subjekt, duke mos cënuar ndonjë instrument ligjor dhe duke respektuar vullnetin e tatimpaguesit. Në rastin kur tatimpaguesi pranon fillimin e kontrollit përpara afatit 30 ditor, njëkohësisht pranon faktin që nuk ka për të kryer ndryshime sipas “Formular-pytesori i vetëdeklarimit para kontrollit” dhe administrata tatimore nuk ka detyrimin ligjor të administrimit të këtij formulari. Nga ana e DRT Vlorë, për cdo rast kontrolli, është nisur Formular - Pyetësori së bashku me njoftim kontrollin sipas pikës 2.1 të Manualit të kontrollit, ku citohet: “Me njoftimin e kontrollit tatimor, tatimpaguesit i jepet mundësia të deklarojë çdo të dhënë për transaksione të padeklaruar, për të cilat nuk është paguar tatim. Ky deklarim kryhet në Drejtorinë Rajonale Tatimore, nëpërmjet një formulari-pyetësor që i vihet në dispozicion së bashku me njoftimin për kontroll, brenda 30 ditëve kalendarike, por përpara fillimit të kontrollit tatimor. Tatimpaguesi deklaron dhe paguan menjëherë tatimin ose kontributin përkatës së bashku me kamatëvonesën, të llogaritur në përputhje me nenin 76 të këtij ligji. Për detyrimin tatimor të deklaruar përpara fillimit të kontrollit tatimor sipas pikës 3, të këtij neni, aplikohet dënim administrativ në masën 50 për qind të tatimit ose kontributit. Ky dënim administrativ vendoset nga inspektori/inspektorët e kontrollit dhe nuk llogaritet nga sistemi. Ai është pjesë e dokumentacionit të raportit përfundimtar të kontrollit”.

Për sa më sipër, konkluzioni juaj se, nuk është respektuar afati 30 ditor për fillimin e kontrollit dhe se mungon “Formular-pytesori i vetëdeklarimit para kontrollit”, nuk qëndron.

1. Në lidhje me konstatimet se në disa raste mungojnë dokumenta të ngarkuara në sistemin C@ts, sqarojmë se:

• *Referuar Manualit të kontrollit, pika 2.2, është cituar se, Inspektori i Kontrolli Tatimor është i detyruar të pasqyrojë në programin informatik të tatimeve C@TS, çdo hap të ndërmarrë gjatë çdo forme të kontrollit që nga dalja e Urdhërit për kontroll të nënshkruar, vulosur e protokolluar nga Drejtori i*

Drejtorisë Tatimore Rajonale (Programi i Kontrollit), Inspektori i kontrollit tatimor pasqyron (hedh) në sistemin informatik të tatimeve C@TS gjithçka sipas udhëzimeve të dhëna në Manualin e përdorimit të tij. Çdo dokument i cili përpilohet për qëllime të kontrollit tatimor (proçes-verbal, inventarë, akte konstatimi etj) hidhet në sistem jo më vonë se dita e nesërme e punës.

Për sa më sipër, mosrespektimi i pikës së më sipërme nuk më ngarkon me përgjegjësi.

2. Në lidhje me konstatimet tuaja për vonesa në proceset e kontrollit, sqarojmë se:

- Në asnjë rast nuk konstatohen vonesa në ecurinë e procesit të kontrollit në vend, me përjashtim të rasteve kur në kontroll është kontraktuar një specialist i fushës. Në raste të tilla, vonesa ka ardhur nga kompleksiteti i veprimeve të specialistit të fushës, por në cdo rast nga ana e DRT Vlorë, kontrolli në subjekt ka përfunduar sipas orëve për kontroll dhe projekt raporti është përgatitur brenda 7 ditëve nga dorëzimi i raportit të specialistit të fushës. Në kontratën e lidhur midis DRT Vlorë dhe specialistit të fushës për ofrimin e shërbimit, në nenin 2 të saj, DRT Vlore ka përcaktuar si afat për kryerjen e shërbimit, orët e punës sipas programit të kontrollit. Gjithashtu nga ana ime cdo raport kontrolli është miratuar në cdo rast jo më vonë se 2 ditë pune.

Për sa më sipër konkluzioni juaj se nuk janë respektuar afatet e kontrollit nuk më ngarkon me përgjegjësi.

4. Në lidhje me konstatimet tuaja se në disa raste mungon i ngarkuar në sistemin C@ts Formulari 3, sqarojmë se:

- Formulari 3 është dokumenti që tregon lëvizjen e praktikës së kontrollit midis hallkave të grupit të kontrollit. Ky formular i bashkëlidhet kopjes së dosjes që qëndron në arkivë së bashku me raportin përfundimtar. Është e pamundur teknikisht të ngarkohet në sistem Formulari 3 sepse çështja në sistem përfundon me miratimin e saj nga Drejtori Rajonal. Pas miratimit nga ky i fundit në çështje nuk mund të ngarkohen dokumenta. Gjithsesi, cdo lëvizje e praktikës së kontrollit është e gjurmueshme në sistemin C@ts.

5. Në lidhje me konstatimet tuaja për sa u përket rasteve me diferenca, mospërputhje vlerash, dokumentacione të ndryshme...etj, ju sqaroj se:

- Referuar kapitullit 4“ Menaxhimi i kontrollit tek tatimpaguesit dhe procedurat që ndiqen nga Drejtoria Tatimore Rajonale”, të Manualit të Kontrollit, ku është cituar se: “Inspektori i kontrollit, pasi ka mbyllur qëndrimin (kontrollin) e tij tek tatimpaguesi, fillon të hartojë raportin e kontrollit i cili nuk duhet të zgjasë më shumë se 7 ditë pune, sipas pikës 6, nenit 83, “Raporti i kontrollit Tatimor Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Inspektori i Kontrollit mban përgjegjësi të plotë mbi hartimin e raportit të kontrollit duke qënë se edhe fizikisht ka parë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm”.

Për sa më sipër, për cdo rast në të cilin vërtetohen mospërputhje të vlerave, të të dhënave apo dokumentacionit, nuk mund të ngarkohem me përgjegjësi pasi nga ana ime dokumentacioni nuk është parë fizikisht.

Në përfundim, në lidhje me konstatimin tuaj se, nga ana ime është vepruar në kundërshtim me nenin 58, pika 2, 7 e Rregullores së DRT-ve, e kundërshtoj atë me arsyetimin se nuk provohet që të jetë kërkuar mbështetje teknike apo drejtuese në lidhje me çështjet e kontrollit për sa i përket legjislacionit tatimor. Gjithashtu nga ana ime është bashkërenduar puna për përhapjen dhe zbatimin e interpretimeve ligjore për çështjet e kontrollit tatimor, nuk u provua në ndonjë rast ekzistenca e mosveprimeve të mësipërme.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Në lidhje me pretendimet e paraqitura në observacion sqarojmë se janë të njëjta më ato të paraqitura për akt-konstatimet (të trajtuara hollësisht në pjesën takuese në Projekt Raport), nuk janë paraqitur argumente apo dokumente shtesë, për pasojë nuk merren në konsideratë.

- Nga zj. I K me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit në Vend pranë DRT Vlorë, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. Përsa i takon konstatimeve se në sistemin C@ts në disa raste, nuk janë ngarkuar dokumenta justifikues të proçesit të kontrollit, bëj me dije se:

Bazuar në Manualit e kontrollit, pika 2.2, e theksuar edhe në programin e kontrollit -Te behet hedhja në sistemin informatik të tatimeve C@TS të gjithë dokumentave juridike të neneshkruara dhe të vulosura, proces-verbaleve dhe akt konstatimeve etj, inspektori i Kontrollit Tatimor është i detyruar të pasqyrojë në programin informatik të tatimeve C@TS, çdo hap të ndërmarrë gjatë çdo forme të kontrollit që nga dalja e Urdhërit për kontroll të nënshkruar, vulosur e protokolluar nga Drejtori i Drejtorisë Tatimore Rajonale (Programi i Kontrollit), Inspektori i kontrollit tatimor pasqyron (hedh) në sistemin informatik të tatimeve C@TS gjithçka sipas udhëzimeve të dhëna në Manualin e përdorimit të tij. Çdo dokument i cili përpilohet për qëllime të kontrollit tatimor (proces-verbal, inventarë, akte konstatimi etj) hidhet në sistem jo më vonë se dita e nesërme e punës. Vonesa në ngarkim mund të ketë ndonjë rast për arsye të ndonjë problemi me sistemin, por me rregullimin e sistemit ato janë ngarkuar në sistemin informatik të tatimeve.

2. Përsa i takon konstatimeve për respektimin e afateve për fillimin e kontrollit, bëj me dije se:

Bazuar në nenit 81, pika 1.1 shkronja f, të Ligjit nr. 9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, në programin e kontrollit është përcaktuar data dhe ora kur fillon dhe kur përfundon kontrolli tatimor, për tatimpaguesin që është objekt kontrolli. Bashkëlidhur programit të kontrollit në rastet kur kontrolli është i plotë (përfshin kontrollin për TVSH-në, Tatim Fitimin, Sig. Shoq, e të tjera), sipas pikës 2.1 të Manualit të kontrollit dërgohet me postë edhe “Formular-pytesori i vetëdeklarimit para kontrollit”. Në rastet kur perfaqesuesi i tatimpaguesit dorëzon para afati 30 ditor, “Formularin-pytesori të vetëdeklarimit para kontrollit”, nga ana e DRT Vlore ka filluar kontrolli në subjekt, duke respektuar vullnetin e tatimpaguesit. Në rastin kur tatimpaguesi nënshkruan për fillimin e kontrollit përpara afatit 30 ditor, njëkohesisht pranon faktin që nuk ka për të kryer ndryshime sipas “Formular-pytesori i vetëdeklarimit para kontrollit” dhe administrata tatimore nuk ka detyrimin ligjor të administrimit të këtij formulari.

3. Përsa i takon konstatimet tuaja se në disa raste mungon i ngarkuar në sistemin C@ts Formulari 3, bej me dije se:

Formulari 3 është dokumenti që tregon lëvizjen e praktikës së kontrollit midis hallkave të grupit të kontrollit. Ky formular i bashkëlidhet kopjes së dosjes që qëndron në arkivë së bashku me raportin përfundimtar i nënshkruar nga i gjithë grupi i kontrollit. Në sistemin informatik C@ts do ta ngarkojmë edhe kete si dokument i procesit të kontrollit.

4. Përsa i takon konstatimet tuaja për vonesa në proceset e kontrollit, bej me dije se:

Në asnjë rast nuk ka vonesa në ecurinë e procesit të kontrollit në vend nga inspektori i kontrollit. Vonesa ka ardhur kur nga aktiviteti i tatimpaguesit ka të domosdoshme specialistin e fushës. Në cdo rast kontrolli në subjekt ka përfunduar sipas orëve të përcaktuara në programin e kontrollit dhe projekt raporti është përgatitur brenda 7 ditëve nga dorëzimi i raportit të specialistit të fushës. Për çdo vonesë nga specialisti i fushës (inxh), ose kur administratori i subjektit nuk ndodhet për arsye të ndryshme në ambientet ku zhvillon veprimtarinë e tij, të gjithë inspektorët e kontrollit bëjnë shenimet përkatëse në sistemin informatik C@ts-komente. Dhe kur janë paraqitur keto raste të justifikuar, nga ana e inspektorit të kontrollit, Raporti Përfundimtar, është dorëzuar brenda afatit të përcaktuar në programin e kontrollit, përcaktohet qarte data e fillimit dhe e përfundimit të gjithë procesit të kontrollit:

- Kontrolli do të kryhet nga inspektori: Kontrolli do të fillojë nga data 0000000 per 00 orë pune në subjekt, dhe duhet të përfundojë Raporti Përfundimtar, brenda datës 000000.

Data përfundimtare është respektuar gjithmone nga grupi i kontrollit.

Raport kontrolli është miratuar në cdo rast jo më vonë se 2 ditë pune nga ana ime.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Në lidhje me pretendimet tuaja për respektimin e procedurave të kontrollit, nuk janë paraqitur argumente dhe dokumente të reja shtesë nga ato të trajtuara gjatë fazës së auditimit në terren, (të trajtuara hollësisht në pjesën takuese në Projekt Raport), për pasojë observacionet tuaja nuk merren në konsideratë.

-Me shkresat nr.2991/20 prot, datë 02.07.2024, administruar në KLSH me nr. 1111/30 prot, datë 05.07.2024 dhe nr. 2991/25 prot, datë 10.07.2024, administruar në KLSH me nr. 1111/37 prot, datë

15.07.2024, nga z. B Z me detyrë Inspektor i Kontrollit në Vend pranë DRT Vlorë, janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Tatimpaguesi: “E” Nipt KO

-Ne lidhje me afatet e kontrollit duhet te theksojme se dorzimi i materialit nga inxhinjria e ndertimit kas gene data 20.05.2022 vonesa e dorzimit te saj ka sjelle dhe vonesen e dorzimit te kontrollit. Pas kesaj date kontrolli eshte dorzuar ne daten 27.05.2022. Megjithate po te nisemi nga data e planifikuar per mbyllje qe eshte mesi muajit shtator, kontrolli eshte kryer shume kohe perpara.

- Ne lidhje me pretendimet per mos berjen e e analizes se detajuar te shitjeve theksojme se eshte bere analiza totale dhe analiza e kostones se mallrave sipas periudhave te kontrollit.

-Per vitin 2019 eshte bere lapsus nga tatimpaguesi, deklarimi “qera ndertimi” duhet te ishte qera ambjenti, gabim qe eshte regulluar ne pasqyrat financiare te vitit 2020 (bashkangjitur pasqyrat)

Ne faqen 6 eshte pretenduar se subjekti ka diferencë ne shpenzime per vitin 2020 ne vleren 231,128 leke. Sqarohet se shpenzimet ne vleren 231,128 leke, jane shpenzime financiare. (Bashkangjitur pasqyrat e te ardhurave dhe shpenzimeve) kemi: $30,951,907 + 231,128 = 31,183,035$ leke.

Për sa i përket shpenzimeve (të pa argumentuara, citimi juaj faqe 7) sqarohet se i perkasin qerave qe ka paguar tatimpaguesi (bashkangjitur kontratat) per te cilat eshte paguar tatimi ne burim.

Per sa i perket konstatimit tuaj se ne dosje mungojne lejet e ndertimit, ju bej me dije se ato jane dokumenta qe administrohen nga inxhinjeri qe harton raportin e ekspertizes.

Ne lidhje me gjobat eshte zbatuar neni 115 i Ligj Nr. 9920, datë 19.5.2008.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Në lidhje me pretendimet e paraqitura në observacion janë të njëjta më ato të paraqitura për akt-konstatimet (të trajtuara hollësisht në pjesën takuese në Projekt Raport), nuk janë paraqitur argumente apo dokumente shtesë, për pasojë nuk merren në konsideratë.

Me shkresat nr.2991/21 prot, datë 08.07.2024, administruar në KLSH me nr. 1111/32 prot, datë 10.07.2024, dhe nr. 2991/25 prot, datë 10.07.2024, administruar në KLSH me nr. 1111/37 prot, datë 15.07.2024, nga z. B K me detyrë Inspektor i Kontrollit në Vend pranë DRT Vlorë, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me konstatimet e pasqyruara nga ana juaj në faqen 39, 40, 41 dhe 42 ndaj Raport kontrollit të mbajtur nga DRT Vlorë për tatimpaguesin “T”:

Disa nga dokumentat si Raport kontrolli dhe Njoftimi per kontroll ka qene e pamundur te ngarkoheshin per shkak te volumit te materialit dhe te gjitha keto dokumenta per te cilat ju citoni qe nuk jane hedhur ne sistem ndodhen ne dosjen e tatimpaguesit ne zyren e Arkiv-protokollit.

1. Ju shpreheni se ne Raport Kontrollin e mbajtur nga DRT Vlore per tatimpaguesin “T” nuk eshte bere nje ndarje e te ardhurave sipas adresave dhe nuk ka asnje te dhene per klientet e furnitoret.

Per kete sqarohet se te ardhurat e ndara sipas adresave dhe llojit, lista e klienteve dhe furnitoreve ju jane vene ne dispozicion me emra dhe vlera, ku dhe nga kontrolli nga ana juaj nuk jane konstatuar diferencë.

1. Ju shpreheni se ne Raport Kontrollin e mbajtur nga DRT Vlore per tatimpaguesin “T” eshte bere bilanc material per 10 artikuj dhe nuk jane bere per me shume.

Per kete sqarohet se nisur nga gama e gjere e artikujve bilanc material eshte kryer me perzgjedhje per 10 artikuj te cilat nga pikepamja e vleresimit zene peshen kryesore te aktivitetit. Dua te theksoj qe nuk ka nje percaktim te qarte ne ligj ose udhezim mbi menyren e perzgjedhjes se artikujve ne kryerjen e bilancit material.

2. Ju shpreheni se nuk ka asnje te dhene per procesin e prodhimit, mungon karta teknologjike.

Per kete sqarohet se tatimpaguesi prodhon dyer, tavolina, krevate, kuzhina etj ne fushen e mobilimit sipas kerkesave specifike te klienteve dhe nuk eshte linje prodhimi format standard. Per cdo porosi te ndryshme te klienteve tatimpaguesi pervec fatures tatimore bashkelidh edhe situacionin per materialet e perdorura ne prodhimin e seciles mobilje. Situacionet dhe preventivet per prodhimin e mobiljeve ju jane vene dispozicion.

3. Ju shpreheni se tatimpaguesi ka marre hua nga Shoqeria A. shpk sipas kontrates N.524 date 06.07.2015 e cila eshte deklaruar ne bilancin e vitit 2018 ne vleren 44.158.412 leke, dhe nuk eshte dhene asnje sqarim per burimin e te ardhurave per diferencen ne vitin 2018.

Per kete sqarohet se treguesit e Pasqyrave Financiare te viti 2018 nuk kane qene objekt i ketij kontrolli. Programi i Kontrollit obligon kontrollin per vitet ushtrimore 2019-2020 dhe ne keto vite shoqeria nuk ka pasur transaksione ne shtesa te ketij posti. Per vitin 2015 qe ju citoni kontraten perkatese dhe ne vijim jane ushtruar kontrole tatimore parardhese te cilat vleresoj kane bere verifikimet e nevojshme.

4. Ju shpreheni se tatimpaguesi ne vitin 2019 ka pasur shtesat nga ortakut ne vleren 5.871.280 leke, per te cilat nuk ka analize per krijimin e ketyre te ardhurave, nuk ka informacion nese ka kontrata te lidhura midis paleve, afatet e huadhenies, raportim te RAD, nuk jane aplikuar interesa per te cilat ju gjykoni se jane veprime te cilat jane pa thelb ekonomik dhe jo ne perputhje me vleren e tregut dhe per kete duhet te ishte kryer vleresim alternative i situates financiare duke rikarakterizuar te ardhurat ne PASH.

Per shtesat ne kete llogari ne vitin 2019 ju kam vendosur ne dispozicion dhe Vetdeklarimin e Ortakut 100% te vetem te shoqerise si dhe ekstraktin e bankave per derdhjet bankare te kesaj vlere ku dhe ju vet jeni shprehur ne Akt Konstatimin, se perputhet shtesa 2019 me derdhjet ne banke.

Ne lidhje me plotesimin e Formulareve RAD per te cilat ju shpreheni pse nuk jane trajtuar, vlen tju sqarohet se tatimpaguesi ka filluar aktivitetin e tij ne vitin 2006 pra rreth 18 vite me pare. Per kete tatimpagues jane ushtruar kontrole parardhese te konsiderueshme dhe ne asnje rast nuk konstatohet te jete penalizuar per fshehje te ardhurave ose mos leshim faturash, si nga DRT Vlore, Hetimi Tatimor, Hetimi Doganor ose organet e tjera ligjzbatuese.

Per periudhen e kontrollit ne asnje rast nuk konstatohen derdhje/ose terheqje ne banke nga persona te tjere qe nuk jane te lidhur me shoqerine.

Ne keto kushte ku gjate veprimtarise objekt kontrolli nuk ka patur aktivitet te padokumentuara apo jashte percaktimeve te legjisalcionit tregetar dhe atij civil nuk eshte evidentuar shkak ligjor i arsyeshem te behet raportim per aktivitet te dyshimte.

Sa i perket trajtimit me interes te huase se ortakut ku nga ana juaj trajtohet se duhej bere rivleresim sqarohet se nuk jemi ne asnje prej kushteve te parashikuara ne piken b), c) dhe dh) te Nenit 71 te Ligjit nr. 9920 date 1905.2008, E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi, i ndryshuar, pasi:

b) vlere e detyrimit eshte paraqitur ne te njejten vlere sipas transaksioneve te ortakut ne banke.

c) tatimpaguesi ka paraqitur ekstraktin e bankes i cili eshte vene ne dispozicion te grupit te auditimit i cili evidenton qarte ortakun per keto shuma.

dh) nuk jemi ne kushtet e efekteve ekonomike thelbesore pasi nuk kemi te bejme me ulje apo nenvleresim te te ardhurave te shoqerise (pasqyrimi i ngjarjeve ne kontabilitet eshte bere sipas veprimit).

Ortakut eshte drejtperdrejt pergjegjes per mbarevajtjen e shoqerise dhe si i tille mund te financoj ne menyre te rregullt shoqerine per raste te nevojshme por smund dhe sduhet te vleresohet si nje marredhenie huamarrje me shperblim pasi ortakut nuk eshte institucion financiar i licensuar i cili ka si qellim fitimin. Nese do te shohim se cilat jane pasojat e keqfunksionimit te shoqerise ato lidhen drejtperdrejte me ortakun. Pikerisht edhe ne kontabilitet kjo eshte nje nga arsyet qe ka nje pozicion financiar te posacem. Nuk kemi hasur asnje rast kur ortakut jep hua shoqerise me shperblim pa qene institucion financiar.

Nuk gjendemi ne rastin e asnje prej kushteve te parashikuara ne piken a), b), c) dhe ç) te Nenit 71/2 Përdorimi i metodave alternative të vlerësimit në rastet e veprimeve për shmangien e tatimit dhe abuzimit me parimet e ligjit tatimor, i ndryshuar, pasi ky nen trajton vetem rastet e marreveshjeve midis dy tatimpaguesve dhe jo rastin e individit i cili eshte ortak me shoqerine tregtare. Per termin tatimpagues duhet ti referohemi percaktimeve ne neni 5 te ligjit pjesa "Perkufizime".

Referuar Kodit Civil ne Republiken e Shqiperise, i miratuar, nenet 1050-1055 "HUAJA", qe ju trajtoni keto dispozita pasqyrojne qartesisht marredhenien pa shperblim te huase mes paleve.

Si perfundim:

Lidhur me Qendrimin e Grupit te Auditimit ne faqen 144 te Projekt Raport te Auditimit Nr.1111/28 Prot date 13.06.2024 kundershtoj ne menyre absolute qendrimin nga ana juaj pasi argumentet dhe dokumentat

e vendosura ne dispozicion nga inspektori I DRT Vlore, gjate procesit se auditimit jane te mbeshtetura ne Ligjet me te cilat operon dhe funksionon Republika e Shqiperise

Duke shpresuar ne marrjen ne konsiderate dhe nje vleresim te drejte e objektiv nga ana juaj.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: *Në lidhje me pretendimet e paraqitura në observacion janë të njëjta më ato të paraqitura për akt-konstatimet (të trajtuara hollësisht në pjesën takuese në Projekt Raport), nuk janë paraqitur argumente apo dokumente shtesë, për pasojë nuk merren në konsideratë.*

Me shkresat nr.2991/18 prot, datë 21.06.2024, administruar në KLSH me nr. 1111/29 prot, datë 24.06.2024 dhe nr. 2991/25 prot, datë 10.07.2024, administruar në KLSH me nr. 1111/37 prot, datë 15.07.2024, nga z. R K me detyrë Inspektor i Kontrollit në Vend pranë DRT Vlorë, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në përgjigje të Projekt-Raport-Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, marë në dorëzim më datë 20.06.2024 me shkresën me nr.2991/17 protokoll, datë 14.06.2024, po ju sqarojmë për rekomandimet faqe 231 (dyqind e tridhjetë e një) e Projekt-Raport-Auditimit si mëposhtë:

Për tatimpaguesin “T.” me nipt-KË, me adresë: Lagjja “11 Janari”, tek Pusi i Mezinis, Vlorë. Me aktivitet: Prodhimi dhe përpunimi i mishit sipas kodit ekonomik naçe C1011, sqarimet për pretendimet tuaja, jepen sipas pikave në vijim.

1. Për pretendimin e mospasjes bashkëngjitur si pjesë përbërëse te raporti i kontrollit, të “Formularit pyetësor i vetëdeklarimit para kontrollit”, po ju sqaroj se ky formular plotësohet dhe dorëzohet nga tatimpaguesi në afatin prej 30 ditë kalendarike. Te ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Taimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 81 (Njoftimi i Kontrollit Tatimor), pika 3, citohet:

3. Me njoftimin e kontrollit tatimor, tatimpaguesit i jepet mundësia të deklarojë çdo të dhënë për transaksione të padeklaruara, për të cilat nuk është paguar tatim. Ky deklarim kryhet në Drejtorinë Rajonale Tatimore, nëpërmjet një formulari-pyetësor që i vihet në dispozicion së bashku me njoftimin për kontroll, brenda 30 ditëve kalendarike, por përpara fillimit të kontrollit tatimor.

Vërejmë, se formulari e shtrin efektin për 30 ditë kalendarike. Tatimpaguesi, brenda këtyre 30 ditëve, nuk ka dorëzuar formular pyetësor dhe si llogjikë, nuk kemi sesi të administrojmë një të tillë në dosjen e kontrollit.

Nga ana jonë dhe në respektim të nenit 81 (Njoftimi i Kontrollit Tatimor), pika 1, ku citohet:

1. Administrata tatimore i dërgon tatimpaguesit njoftimin, i cili përcakton tatimpaguesin si subjekt të kontrollit tatimor. 1/1. Njoftimi i kontrollit tatimor i dërgohet tatimpaguesit të paktën 30 ditë kalendarike përpara datës së fillimit të kontrollit tatimor të shkruar në njoftim, përveç kur kontrolli kryhet si rezultat i kërkesës së tatimpaguesit për rimbursim tatimor,

Është respektuar afati ligjor i përcaktuar nga ligji në mënyrë rigoroze, ku brenda afatit tatimpaguesi nuk ka paraqitur asnjë formular pyetësor.

Gjithashtu, citimi ligjor nga ana juaj për Manualin e Kontrollit, ndoshta i referohet Manualit të vjetër, pasi Manuali i ri i Kontrollit Tatimor me ndryshimet e fundit proçeduriale është që nga viti 2017 dhe aty nuk gjenden referencat ligjore të cituara nga ana juaj.

Si rrjedhojë, ky pretendim është sqaruar.

2. Për pretendimin e mospasjes në dosjen e kontrollit të Formularit 3, sërish po sqaroj se:

citimi ligjor nga ana juaj për Manualin e Kontrollit, ndoshta i referohet Manualit të vjetër, pasi Manuali i ri i Kontrollit Tatimor me ndryshimet e fundit proçeduriale është që nga viti 2017 dhe aty nuk gjenden referencat ligjore të cituara nga ana juaj. Pra, nuk citohet detyrimi ligjor i administrimit të Formularit 3. Bashkëngjitur, do ju vendos një kopje të printuar të pikës përkatëse të Manualit.

Si rrjedhojë, ky pretendim është sqaruar.

3. Për pretendimin e mosbërjes së analizës së detajuar të shitjeve për një grup artikujsh, po ju sqaroj se kjo analizë është kryer si për bilancin material, po ashtu edhe për raportin kosto/çmim shitje për çdo periudhë kontrolli më vete, për çdo periudhë kontrolli më vete faqet 7,8 për vitin 2015, faqet 7,8 për vitin 2015, faqet 11,12 për vitin 2016, ku nga ana jonë janë kryer edhe vlerësime përkatëse në vlera të

konsiderueshme, faqet 15,16 për vitin 2017, faqet 19,20 për vitin 2018, faqet 23,24 për vitin 2019 dhe faqet 27,28 për vitin 2020 të raport kontrollit.

Si rrjedhojë, ky pretendim është sqaruar.

4. *Për pikën e katërt, ku citoni se është kryer kontroll i TVSH dhe ku nuk kanë rezultuar diferenca, jam dakord me ju.*

5. *Për pikën e pestë, ku citoni se është kryer analizë e zërave të bilancit sipas përcaktimit të programit të kontrollit, jam dakord me ju.*

6. *Për pikën e gjashtë, ku citoni se është kryer analizë e rezultatit financiar dhe analiza e zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve sipas përcaktimit të programit të kontrollit, jam dakord me ju.*

7. *Për pikën e shtatë, ku citoni se është kryer kontroll për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për periudhën objekt kontrolli, nga ku rezulton se përgjithësisht janë zbatuar përcaktimet ligjore, jam dakord me ju.*

8. *Për pretendimin e moskryerjes së evidentimit të blerjeve, mospërcaktimin analitik të klientëve dhe furnitorëve dhe mospërcaktimin nëse këto blerje janë në funksion të aktivitetit apo jo, po ju sqaroj si mëposhtë:*

Evidentimi i blerjeve është kryer për çdo periudhë kontrolli më vete, përkatësisht në faqen 6 për vitin 2015, në faqen 10 për vitin 2016, në faqen 14 për vitin 2017, në faqen 18 për vitin 2018, në faqen 22 për vitin 2019 dhe në faqen 26 për vitin 2020 të raport kontrollit. Aty janë përcaktuar në mënyrë të përmbledhur blerjet, të ndara në blerje për lëndë të parë, blerje për gazoil, cigare, energji, makineri e pajisje, mjete transporti, shërbime të ndryshme, etj. Nuk mund të pasqyrohet çdo blerje analitike, pasi kërkon volum pune, mijëra faqe të printuara.

Përsa u përket klientëve dhe furnitorëve, ata janë të pasqyruar në mënyrë analitike te bilancet e dorëuara nga tatimpaguesi dhe nuk është e nevojshme të pasqyrohen në raport kontrolli, pasi sërish do të zinin dhjetëra faqe në raport kontroll. Nga ana jonë, gjatë periudhës së kontrollit, janë analizuar klientët dhe furnitorët e tatimpaguesit dhe duke qenë se nuk kanë rezultuar problematika, nuk janë pasqyruar në raport në mënyrë analitike, por jemi shprehur në mënyrë sintetike.

Përsa i përket faktit, se nëse blerjet janë në funksion të aktivitetit apo jo, nga ana jonë, përkatësisht në faqen 6 për vitin 2015, në faqen 10 për vitin 2016, në faqen 14 për vitin 2017, në faqen 18 për vitin 2018, në faqen 22 për vitin 2019 dhe në faqen 26 për vitin 2020 të raport kontrollit, citohet:

Nga verifikimi i materialeve të blera, rezultoi se ato janë mallra dhe shërbime që i shërbejnë plotësisht aktivitetit të tatimpaguesit, në përputhje kjo me përcaktimet e ligjit nr.92/2014.

Përkatësisht neneve: neni 57, neni 58, neni 59. Janë respektuar nenet 68-73 të ligjit, ku nenet 71, 72 dhe 73 shprehen për kreditim të pjesshëm, por ne nuk jemi në këtë rast. Janë respektuar nenet 98 dhe 101 të ligjit nr.92/2014, datë 24.07.2014, i ndryshuar.

Blerjet mbi vlerën 150.000 lekë me tvsh përfshirë janë kryer nga sistemi bankar, sipas përcaktimeve të nenit 59, ligji nr.9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar.

Si rrjedhojë, ky pretendim është sqaruar.

9. *Për pretendimin e kryerjes së bilancit material vetëm për 10 artikuj dhe jo për më shumë artikuj, po ju sqarojmë se bilanci material është kryer me përzgjedhje për artikujt që zënë peshën më të madhe specifike, ku nga na jonë, përkatësisht në faqen 7 për vitin 2015, në faqen 11 për vitin 2016, në faqen 15 për vitin 2017, në faqen 19 për vitin 2018, në faqen 23 për vitin 2019 dhe në faqen 27 për vitin 2020 të raport kontrollit, citohet:*

U krye regjistrimi i artikujve për bilancin e mallrave në sasi për disa artikuj me përzgjedhje. Kjo, në varësi të faktit të shumëllojshmërisë së artikujve dhe pamundësisë për kryerjen e bilancit për mijëra copë artikujsh. U hartua në këtë mënyrë kartela blerje-shitje për periudhën, bazuar te gjendja kontabile në fillim, gjendja kontabile në fund, hyrjet dhe daljet për periudhën e kontrollit. U ndërtaua kështu bilanci material në sasi për disa artikuj me përzgjedhje. Rezultati jepet si mëposhtë:

Kampioni është përzgjedhur në bazë të peshës specifike që zënë artikujt. Psh.në vitin 2015, vetëm produkti "Mish derri" zë gati 53% të inventarit në fund, gati 41% të inventarit në fund të vitit 2016, gati 13% të inventarit në fund të vitit 2017, gati 14% të inventarit në fund të vitit 2018.

Po ju sqaroj, se kryerja e bilancit material është një punë shumë voluminoze, sidomos përkatësisht me këtë lloj aktiviteti, pasi që në faturat e blerjes ndodh që një faturë ka mbi 40 artikuj. Kur shkojmë te faturat e shitjes, ka akoma më shumë fatura në sasi. Llogarit dhe faktin, që për kryerjen e bilancit material, duhet të kryesh llogaritjet sipas normativave të harxhimit të lëndës së parë, sesa sasi janë konsumuar. Pra, është punë që kërkon muaj të tërë.

Përsa u përket produkteve të cituara nga ana juaj, nuk rezulton të kenë peshë specifike të lartë.

Si rrjedhojë, ky pretendim është sqaruar.

10. Për pretendimin se në raportin përfundimtar nuk ka të dhëna për sasi të hyrje dhe dalje për çdo artikull gjatë periudhës së kontrollit, po ju sqarojmë se me llojin e veprimtarisë, është e pamundur kryerja e bilancit material të plotë. Ky bilanc material, me hyrjet dhe daljet për zërat e përzgjedhur, është kryer nga ana jonë, përkatësisht në faqen 7 për vitin 2015, në faqen 11 për vitin 2016, në faqen 15 për vitin 2017, në faqen 19 për vitin 2018, në faqen 23 për vitin 2019 dhe në faqen 27 për vitin 2020 të raport kontrollit.

Si rrjedhojë, ky pretendim është sqaruar.

11. Për pretendimin se në bilancin e vitit 2017 të deklaruar në sistemin c@ts, nuk ka të dhëna për sasi të artikujve, po ju sqaroj se gjatë periudhës së ushtrimit të kontrollit, në ambientet e tatimpaguesit, është vendosur në dispozicion të kontrollit inventari me sasi të përkatëse të artikujve.

Si rrjedhojë, ky pretendim është sqaruar.

12. Për pretendimin se në raportin e kontrollit nuk ka asnjë të dhënë për procesin e prodhimit dhe se nuk ka analizë për kartën teknologjike, po ju sqarojmë si mëposhtë:

Përsa i përket procesit të prodhimit, tatimpaguesi ka dorëzuar recepturat e prodhimit (recetat për 100 kg produkt) të paraqitura hollësisht me tabelë në observacion. Kjo recepturë është bërë edhe pjesë e dosjes së tatimpaguesit. Nga ana jonë është kryer bilanci material ku janë përfshirë gjithë hyrjet dhe daljet bazuar edhe te kjo recepturë prodhimi.

Proçesi i prodhimit realizohet pa humbje dhe pa mbetje. Te UMF nr.6, datë 30.01.2015, neni 60 (Trajtimi fiskal i firove /humbjeve gjate procesit të prodhimit, magazinimit, transportit), percaktohet detyrim i tatimpaguesit për dorëzim të kartës teknologjike, lind kur tatimpaguesi në procesin e prodhimit, realizon firo/humbje. Në rastin tonë, nuk jemi në këto kushte.

Gjithashtu, citimi ligjor nga ana juaj për Manualin e Kontrollit, ndoshta i referohet Manualit të vjetër, pasi Manuali i ri i Kontrollit Tatimor me ndryshimet e fundit proceduriale është që nga viti 2017 dhe aty nuk gjenden referencat e cituara nga ju. Pra, nuk citohet fakti se duhet ndjekur një metodologji e caktuar. Bashkëngjitur, do ju vendos një kopje të printuar të pikës përkatëse të Manualit.

Si rrjedhojë, ky pretendim është sqaruar.

13. Për pretendimin se në raportin e kontrollit nuk evidentohet nëse tatimpaguesi ka kartë teknologjike të miratuar nga organet shtetërore përkatëse në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr.434, datë 20.05.2015 “Për përcaktimin e normativave për humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë prodhimit...”, po ju sqaroj se:

Te pika 4 e VKM nr.434, datë 20.05.2015, ku citohet:

4.Për humbjet dhe firot në procesin e prodhimit, për të cilat nuk ka akte të veçanta ligjore dhe nënligjore, sasia dhe vlera e lejuar e tyre do të llogariten duke u bazuar në kartat apo skemat teknologjike të procesit të prodhimit. Autoritetet tatimore, gjatë kontrollit të ushtruar në vend pranë tatimpaguesit, analizojnë kartat apo skemat teknologjike të procesit të prodhimit, që shoqërojnë makineritë apo linjat përkatëse nga prodhuesi i tyre dhe kryejnë verifikimet lidhur me nivelin e humbjeve të pësuar gjatë procesit të prodhimit/përpunimit. Për matjen e nivelit të humbjeve gjatë prodhimit, inspektorët tatimorë mbajnë procesverbalin përkatës, të firmosur edhe nga drejtuesi teknik apo administratori, të cilin ia bashkëlidhin aktit të kontrollit.

Konstatohet se kjo referencë ligjore flet për nivelin e humbjeve gjatë prodhimit.

Po ashtu te pika 7 e VKM nr.434, datë 20.05.2015, ku citohet:

7.Brenda 45 ditëve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, çdo tatimpagues duhet të paraqesë në Drejtorinë Rajonale Tatimore dokumentacionin për miratimin e firove...

Konstatohet sërish se referenca ligjore flet për firot.

Si përfundim, tatimpaguesi realizon një proces prodhimi pa humbje dhe nuk është i detyruar të dorëzojë paraprakisht kartë teknologjike dhe dokumentacione plotësuese.

Si rrjedhojë, ky pretendim është sqaruar.

14. Për pretendimin se nga analiza e bilancit material kanë rezultuar diferenca në disa artikuj, ju sqaroj se:

Konstatohet se inventari në datë 31.12.2016 për kofsha pule i bilancit material të kontrollit, përputhet plotësisht me inventarin analitik të datës 31.12.2016 të ngarkuar elektronikisht nga tatimpaguesi.

Përsa i përket inventarit të datës 31.12.2015, po jap sqarimin si mëposhtë:

Duke punuar me tabelat në eksel, pasi bilanci material është një punë voluminoze dhe kërkon shumë kohë dhe përqëndrim, pasi analizohet çdo faturë dhe nxirren të dhënat po ashtu për secilën faturë, të dhëna këto që pasqyrohen me formula përkatëse në eksel, duke qenë se kam ndërtuar edhe bilanc material për vitin e plotë 2015 për produktet e përzgjedhura, për të pasur një pasqyrë më të plotë studimore, formulat në eksel për produktin “Kofsha pule” kanë pësuar çrregullim dhe për pasojë ka sjellur situatën e bilancit material jo të saktë. Gjithashtu, ndikim ka pasur te çrregullimi edhe mospasqyrimi te bilanci material i vitit 2015 (vit i plotë) i daljeve dhe për pasojë gjendja inventariale e datës 31.12.2015 për bilancin material te viti i plotë 2015 dhe te 2015 (periudha 201509 deri më 201512) ka ngelur sa janë blerjet e vitit për 2015 për këtë produkt, pasi gjendja në fillim ka qenë zero. Kjo ka ndodhur, pasi në eksel kam pasur vendosur formulën e barazimit të qelizave gjendje fundviti të dy bilanceve material. Ndikim ka pasur edhe gjendja në datë 01.09.2015 e produktit “Kofsha pule”, pasi në eksel nga 898.5 kg, ajo është shfaqur 8.985 kg te bilanci material i periudhës 201509-201512. Kjo mund të ketë ndodhur për shkak se mund të jetë marë me formulë gabim.

Kalohet te viti 2016 për të sqaruar situatën si më poshtë:

Inventari në fillim, gjendje e datës 01.01.2016 është me formulë barazimi dhe është po aq sa ishte në fundperiudhe. Inventari në fund përputhet me inventarin e ngarkuar elektronikisht nga tatimpaguesi. Problem formule këtu ka ndodhur te hyrjet gjatë vitit.

Për të pasur një pasqyrë të saktë të bilancit material pa problemin e tabelave në eksel, po ju jap bilancet material të saktë sipas tabelave në observacion. Si përfundim, konstatohet se nuk ka diferenca për produktin “Kofsha pule”. Po ashtu edhe për produktin “Pite” dhe “Fruta pylli”.

Konstatohet se treguesi i vlerës së shtuar është në parametra të krahasueshëm me tregun. Në vitin 2016, sipas të dhënave të shqyrtuara, del se vlera e shtuar është me tregues prej 5,66%. Pra, vetëm kjo periudhë është me tregues të ulët. Nga ana jonë, te raport-kontrolli është kryer vlerësim përkatës për këtë periudhë.

Vlera e vlerësuar është prej 2.215.961 lekësh. Ndërtojmë një pasqyrë të re të treguesit të tvsh-së për periudhën 2016, përfshirë vlerësimin sipas tabelës në observacion.

Pra, me vlerësimet e kryera, treguesi shkon në norma të krahasueshme me tregun dhe vetë periudhat e tjera të tatimpaguesit.

Gjithashtu, duhet të theksoj, se gjatë asaj periudhe kam pasur probleme me kompjuterin dhe programet, fakt i cili ka krijuar anomalitë e sqaruara. Për këtë fakt, kam edhe korrespondencat me sektorin përkatës, ku vazhdimisht kam kërkuar zgjidhje të problematikës me njësinë kompjuterike të tejkonsumuar.

Bashkëngjitur, gjenden shkresa me nr.616 protokoll, datë 03.02.2021, shkresa me nr.6662/2 protokoll, datë 12.10.2021, të cilat besoj se janë prova të mjaftueshme për faktin se pajisja kompjuterike ka qenë pothuajse jofunksionale.

Sqaroj, se programet donin edhe orë të hapeshin dhe gjithmonë krijonin probleme. Psh, formatet eksel krijonin problematika duke mosruajtur punë të bëra, duke ndryshuar formula, etj. Për ta besuar këtë fakt, mund ta verifikoni pajisjen me një ekspert të fushës përkatëse.

Si rrjedhojë, ky pretendim është sqaruar, detyrim nuk ka.

15. Për pretendimin se nga analiza e blerjeve të realizuara nga subjekti për periudhën objekt kontrolli në zërin “Blerje të investimeve vendase me 20%”, është deklaruar “Blerje punime riparimi”, e cila sipas VKM nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, neni 7, nuk njihet si e zbritshme,

po ju sqaroj se është pikërisht kjo VKM nr.408, datë 13.05.2015, KREU I, neni 6, (Ndërhyrje që nuk kërkojnë pajisjen me një leje ndërtimi dhe pa nevojën e deklaratës paraprake të punimeve), pika a), paragrafi ii), ku citohet:

Pa përjashtuar detyrimin e respektimit të dispozitave të parashikuara nga kuadri ligjor në fuqi për veprimtarinë ndërtimore përfshirë, në mënyrë të veçantë, sa i përket qëndrueshmërisë antisizmike, mbrojtës kundër zjarrit, ruajtjes së sigurisë dhe higjienës shëndetësore, ndërhyrjet e mëposhtme kryhen pa pajisje me leje ndërtimi dhe pa paraqitur deklaratë paraprake punimesh:

- Riparimi dhe rinovimi i dyshemeve;
- Riparimi dhe restaurimi i suvasë, veshjeve dhe ngjyrave.

E cila i jep të drejtën e zbritshmërisë së tvsh-së, pasi sipas referencave ligjore të sipërcituara, tatimpaguesi ka kryer punime riparim dhe rinovim dyshemeje të magazinës, suvasë në përputhje me ligjin, në vlerën totale prej 1.085.505 lekë.

Diferenca prej 1.608.887 lekë - 1.085.505 lekë = 523.382 lekësh në zërin “Blerje punimesh riparimi”, ka të bëjë me blerje mobiljesh, banakë, etj. për aktivitetin në vlerën 362.000 lekë dhe blerje të ndryshme për pajisje prerëse, paketuese, DPM, etj. në vlerën totale 161.382 lekë.

Për zërin “Blerje punimesh riparimi”, kryesisht tatimpaguesi ka riparuar dhe rinovuar dyshemenë e magazinës, suvanë, pasi sipas intervistës me atë, dyshemeja dhe suvaja ishin në gjendje të atillë, e cila nuk lejonte zhvillimin normal të aktivitetit. Duhet theksuar, se aty kryhet procesi i prodhimit dhe kushtet duhet të jenë të mira.

Nga verifikimi i materialeve të blera, rezultoi se ato ishin punime, që i shërbenin plotësisht aktivitetit që ushtrohej nga tatimpaguesi, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.92/2014.

Gjithashtu, punimet janë në vlerën 1.085.505 lekë dhe jo 1.608.887 lekë. Po ashtu, gjoba prej 100% bie, pasi mosnjohja e blerjeve sipas nenit 115, pika 3, ligji nr.9920, datë 19.05.2008 llogaritet prej 20%.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Në lidhje me pretendimet e paraqitura në observacion sqarojmë se janë të njëjta më ato të paraqitura për akt-konstatimet (të trajtuara hollësisht në pjesën takuese në Projekt Raport), nuk janë paraqitur argumente apo dokumente shtesë, për pasojë nuk merren në konsideratë.

-Me shkresë nr. 4672/33 prot, datë 09.07.2024, administruar në KLSH me nr. 1111/21 prot, datë 11.07.2024, nga z. D B me detyrë Inspektor i Kontrollit në Vend pranë DRT Vlorë, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

I. Selenice “B” sha , me N.I.P.T. KM

Per te dy akt konstatimet per subjektin Selenice “Bitumi” sha , me n.i.p.t. KM po paraqes te njejten pergjigje meqense jane te te njejtit subjekt dhe te njejtes periudhe. Akt konstatim per subjektin S” sha , me n.i.p.t. KM ne faqe 26 dhe Akt konstatim per subjektin Selenice Bitumi” sha , me n.i.p.t. KM ne faqe 48

Per periudhen per kete subject kemi dy kontroll te kryera nga ana ime:

Lajmërim kontrollin Nr. Prot. 6735/1 date 04.10.2021 (kontroll i plote tvsh, tatim fitimi)

Lajmërim kontrollin Nr. Prot. 2267/1 date 28.02.2022 rimbursim i tvsh-se

Kontrollet kane kaluar ne apelim tatimor

Kontrollet jane ne proces gjyqesor (me sa informacion kam)

Per kontrollin me Lajmërim kontrollin Nr. Prot. 6735/1 date 04.10.2021. vlera e zbulimit eshte

- Tatim fitimi ulje humbje 2019	8.583.050 leke
- Tatim fitimi ulje humbje 2020	<u>5.891.400 leke</u>
Totali	14.474.450 leke
- Detyrim Tatim ne burim 2019	546.518 leke
- Penalitet Tatim ne burim 2019	119.687 leke
- Penalitet mosmbajtje dokumentacioni 2019	50.000 leke
- Detyrim Tatim ne burim 2020	1.219.116 leke
- Penalitet Tatim ne burim 2020	266.986 leke

- Penalitet mosmbajtje dokumentacioni 2020	50.000 leke
- Detyrim Tatim ne burim 2021	241.495 leke
- Penalitet Tatim ne burim 2021	26.081 leke
- Detyrim Tvsh 2021	816.590 leke
- Penalitet Tvsh 2021	<u>88.192 leke</u>
Totali i zbulimit	3.424.665 leke

Per kontrollin me Lajmërim kontrollin Nr. Prot. 2267/1 date 28.02.2022
vlera e zbulimit eshte: (kerkese per rimbursim)

Bazuar ne analizen e kryer me siper Kërkesa për rimbursimin e TVSH-se nga subjekti eshte ne vleren 13.819.786 leke, Kerkese e rregullt e Teprices kreditore te Tvsh-se qe meret ne shqyrtim eshte 11.811.176 leke. Pra kemi kerkese te gabuar ne vleren 13.819.786 - 11.811.176 = 2.008.610 leke

Bazuar ne analizen e kryer ne akt kontrolli pikat 1 dhe 2 me siper shuma që miratohet subjektit per rimbursim është 6.843.602 leke (6.412.783 +430.819) leke .

- Penalitet mosmbajtje dokumentacioni 2021	50.000 leke
- Kerkese e pa sakte per rimbursim	<u>2.008.610 leke</u>
Totali i zbulimit	2.058.610 leke

- Ne lidhje me akt konstatimin te subjektin "S" sha , me n.i.p.t. KM dhe me administrator z. P P ,faqe 25 te shkresen nr 7986/4 date 26.04.2024 te Klsh-se.

Kerkesa per rimbursim periudha Tvsh nga muaji janar 2020 deri ne maj 2021 Lajmërim kontrollin Nr. Prot. 2267/1 date 28.02.2022.

Kerkesa per rimbursim Me nr.Prot, 21188 date 22.11.2021 protokolluar ne Drejtorine Pergjithshme te Tatimeve subjekti ka bere kerkesen per rimbursim. periudha Tvsh nga muaji janar 2020 deri ne maj 2021.

- Eshte kryer analiza e kartes teknologjike sepse ne baze te analizes te kartes teknologjike eshte bere rakordimi i inventarit fizik me ate kontabel,levizja e artikujve kryesore. Disa prej te cilave jane paraqitur me poshte, psh vitin 2020 ne faqe 23 te raportit perfundimtar te kontrollit. Po keshtu per periudhen (janar-korrik) 2021 ne faqe 23 te Raportit Perfundimtar te Kontrollit

Per marjen e kartes teknologjike duhet ti drejtoheni subjektit.

- Ne lidhje me autofaturimet (Autongarkesë e Tvsh-së në shitje, Autongarkesë e Tvsh-së në blerje) te cilat jane punime zbulimi te kryera nga subjekti, te cilat jane punime per hapje kariere per te bere te mundur zhvillimin e veprimtaris te tij per nxjerjen e mineralit, sepse sic e dime per nxjerren e mineralit punohet ne siperfaqe dhe jo ne thellesi ,pra nuk kemi veprime ne miniere nentokesore. Sigurisht qe eshte kryer kontrolli i ketyre situacioneve. Dhe si element kryesor eshte diezeli i perdorur nga makinerit e renda te subjektit per hapur karieren e cila shfrytezohet nga subjekti per veprimtarin e tij ekonomike.

Te kontrolli i rimbursimit te tvsh-se te certifikimi i teprices kreditore flisni per regjistrim aktivesh

Per kete po kaloi te Kontrolli Nr. Prot. 6735/1 date qe ka dhe bilancin ne analize.

Analiza per aktivet eshte kryer per shembull per vitin 2019 ne faqen 21 pika 2 te Raportit te Kontrollit

2. Nga analiza e amortizimit kemi zerin Instalime Makineri e Paisje i cili ka vleren e mbetur (161.941.902 gjendja ne fillim 2019), e cila perbehet nga Instalime Makineri e Pajisje. Vlera filllestare e investimit per kete grup ka vleren 294.370.902 leke.

Zeri Instalime Makineri e pajisje midis te tjereve ka dy nen zera me vlera filllestare e investimit totale 184.427.326 leke si me poshte:

a - Punime minerale me vlera filllestare e investimit 137,289,523 leke

b - Punime zbulimi me vlera filllestare e investimit 47,137,803 leke

Ne perqindje ze 62.65 % (184.427.326/294.370.902) te Zerit Instalime Makineri e Paisje

Per te cilen subjekti llogarit amortizim

Ky ze perfaqson 62.65 % te shpenzimeve te amortizimit te ketij grupi qe kane vleren 13,700,000 leke per vitin 2019

$13,700,000 * 62.65 \% = 8.583.050 leke$

Per punimet qe ka kryer ne karrier subjekti ka bere autofaturim dhe kete vlere e ka shtuar te aktivet qfategjata materiale (zeri Instalime Makineri e Pajisje) dhe ka llogaritur amortizim ne vleren 13,700,000 leke. Ne rastin tone punimet e karrieres jane punime qe kryen ne siperfaqe te tokes per te nxjere bitum dhe zhavor bituminoz pra nuk jane punime te kryera ne thellesi te tokes ne galerit e minieres . Pra do te trajtohen si punime ne siperfaqe te tokes . Per token nuk llogaritet amortizim

Ligji Nr. 8438, Datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i Ndryshuar ,Neni 22 Amortizimi pika 2. Toka, trualli, veprat e artit, sendet antike, bizhuteritë, metalet dhe gurët e çmuar, nuk amortizohen.

Per rrjedhoje do te kemi Ulje humbje ne vleren 8.583.050 leke

- Aktivit (Per punimet qe ka kryer ne karrier subjekti)

- Aktivit kontrollohet nga subjekti

- Subjekti e perdor per veprintarin e tij ekonomike per realizimin e te ardhurave ne periudhat ne vazhdim

- Kostua e aktivitetit matet me besushmeri

(po persa i takon mosnjohjes si shpenzim te zhpenzimit te amortizimit si me siper ,Apelimi Tatimor ka mendim te kundert , njifet si aktiv dhe njifet dhe shpenzimi i amortizimit)

Per sa i takon lincencave minerale, te kerkimit etj. subjekti eshte i paisur po keto duhet ti kerkohen subjektit. Duhet te kemi parasysh qe kemi te bejme me nje ndermarje ish shteterore te privatizuar para rreth 30 vjeteve nga investitor te huaj.

- Ne rastet e autofaturimeve per punimet e zbulimit nuk kemi te bejme me punime ndertimi por me punime zbulimi per mineral me mjetet e renda te saj dhe jo me ndertim ne kuptimin klasik. Sic e kam thene dhe me siper komponenti kryesor eshte diezeli i perdorur nga makinerit. Per situacionet duhet ti drejtohem subjektit.

Ne raportin e kontroll eshte kryer analiza e kostove te mallrave e raportuar nga tatim paguesi. Po ashtu dhe kostot e inventareve te produkteve te tregetuar nga subjekti psh(kontrolli per rimbursimin) faqe 24 te Raportit te Kontroll Perfundimtar.

- U verifikuan cmimet e blerjes u be analiza e kostos dhe cmimet e shitjes te artikujve.

Po keshtu dhe per periudhat e tjera qe jane kontrolluar.

Po ashtu dhe per vlerat e paraqitura ne pasqyrat financiare te zeri i inventareve eshte mare parasysh sasia dhe kostua e tyre.

Per sa i takon shkembimit te informacionit me AKBN , i takon ketij institucioni te dergoi informacionin qe ka te DPT Tirane (si ben DP Doganave ,etj).sepse nuk eshte vetem ky subjekt objekt i AKBN-se si ne Vlore po ashtu dhe ne rang vendi.

- Per sai takon blerje me Leasing eshte bere analiza e tyre mjafton te shikosh per cdo periudhe kontrolli kemi vlerat e blerje me Leasing keshtu psh te Raport i Kontroll rimbursimi per vitin 2020 e kemi ne faqe 13.

Blerjet me Leasing jane mjete trasporti per veprintarin e subjektit.

Si konkluzion per fiskalitetin:

Autofaturat subjekti i ka te paraqitura si ne blerje dhe ne shitje, pra nuk kane efekt te tvsh-ja.

Per tatim fitimi :amortizimi i shtesave te aktivitetit qe vjen nga autofaturat nuk eshte njohur prej meje.

Autofaturat jane sic eshte pasqyruar me siper.

Certifikimi i tvsh per arsye rimbursimi sipas periudhes eshte bere sipas kerkeses te ardhur nga subjekti nepermjet shkresave me DPT.

Certifikatat , autorizimet dhe cdo dokument shoqerues duhet tia kerkoime subjektit

Kontrollet kane kaluar ne apelimit tatimor

2. “M” sha, me n.i.p.t. KE

Akt konstatim per subjektin M” sha, me n.i.p.t. KE ne faqe 56 per kontroll me Lajmërim kontrollin Nr. 3563/1 date 13.04.2022 rimbursim i tvsh-se

Per periudhen per kete subject kemi dy kontroll te kryera nga ana ime :

Lajmërim kontrollin Nr. Prot. 8508/1 date 19.11.2021(kontroll i thelluar tvsh,tatim fitimi)

Lajmërim kontrollin Nr. 3563/1 date 13.04.2022 rimbursim i tvsh-se

- Kontrollet kane kaluar dhe proceduren e Apelimit Tatimor

Per kontrollin me Lajmërim kontrollin Nr. Prot. 8508/1 date 19.11.2021 (kontroll i thelluar tvsh,tatim fitimi) vlera e zbulimit eshte:

- Tatim fitimi ulje humbje 2020	<u>10.000.000 leke</u>
Totali	10.000.000 leke
- Detyrim Tatim fitimi 2019	3.018.636 leke
- Penalitet Tatim fitimi 2019	661.081 leke
- Penalitet mosmbajtje dokumentacioni 2020	50.000 leke
- Detyrim Tatim ne burim 2021	18,000 leke
- Penalitet Tatim ne burim 2021	<u>3.942 leke</u>
Totali i zbulimit	3.751.659 leke

Per kontrollin me Lajmërim kontrollin Nr. Prot. 3563/1 date 13.04.2022

vlera e zbulimit eshte : (kerkese per rimbursim)

Bazuar ne analizen e kryer ne kontroll shuma që miratohet subjektit per rimbursim është 210.538 leke

- Penalitet mosmbajtje dokumentacioni 2021	50.000 leke
- Kerkese e pa sakte per rimbursim	<u>1.267.596 leke</u>
Totali i zbulimit	1.317.596 leke

Ne lidhje me subjektin “Mineral Bitumi” sha, me n.i.p.t. K87021202E dhe me administrator z. M. P., faqe 56 te akt konstatimet.

Kerkesa per rimbursim periudha Tvsh nga muaji shkurt 2020 - shkurt 2021 Lajmërim kontrollin Nr. Prot. 3563/1 date 13.04.2022,

Koha e kryerjes se kontrollit : 60 ore pune

Kerkesa per rimbursim Me nr.Prot, Prot, 21178 date 24.11.2021 protokolluar ne Drejtorine Pergjithshme te Tatimeve subjekti ka bere kerkesen per rimbursim. periudha Tvsh nga muaji muaji shkurt 2020 - shkurt 2021

- Ne lidhje me autofaturimet (Autongarkesë e Tvsh-së në shitje, Autongarkesë e Tvsh-së në blerje) te cilat jane punime zbulimi te kryera nga subjekti, te cilat jane punime per hapje kariere per te bere te mundur zhvillimin e veprimtaris te tij per nxjerjen e mineralit , sepe sic e dime per nxjerjen e mineralit punohet ne siperfaqe dhe jo ne thellesi ,pra nuk kemi veprime ne miniere nentokesore. Sigurisht qe eshte kryer kontrolli i ketyre situacioneve. Dhe si element kryesor eshte diezeli i perdorur nga makinerit e renda te subjektit per hapur karieren e cila shfytezohet nga subjekti per veprimtarin e tij ekonomike.

Te kontrolli i rimbursimit te tvsh-se te certifikimi i teprices kreditore flisni per regjistrim aktivesh.

Per kete po kaloi te kontrolli Nr. Prot. 8508/1 date 19.11.2021,qe ka dhe bilancin ne analize.

Analiza per aktivet eshte kryer per shembull po ju paraqes analizen e kryer per vitin 2019 ne faqen 13 pika 2 te Raportit te Kontrollit nr Nr. Prot. 8508.

2. Nga analiza e amortizimit kemi zerin (Te tjera ne shfrytezim) (Aktive te tjera afgj) i cili ka vleren e mbetur 127,457,745 leke (gjendja ne fillim 2019), te cilat jane punime zbulimi per mineral. Vlera filllestare e investimit per punime zbulimi per mineral ka vleren 164,339,357 leke, te cilat jane punimet qe ka kryer ne karrier subjekti per zbulimi per minerali.

Per punimet qe ka kryer ne karrier subjekti ka bere autofaturim dhe kete vlere e ka shtuar te aktivet afategjata materiale zeri (Te tjera ne shfrytezim) (Active te tjera afgj) dhe ka llogaritur amortizim ne vleren 16,960,000 leke. Ne rastin tone punimet e karrieres jane punime qe kryen ne siperfaqe te tokes per te nxjere bitum dhe zhavor bituminoz pra nuk jane punime te kryera ne thellesi te tokes ne galerit e minieres. Pra do te trajtohen si punime ne siperfaqe te tokes .Per token nuk llogaritet amortizim

Ligji Nr. 8438, Datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i Ndryshuar ,Neni 22 Amortizimi pika 2. Toka, trualli, veprat e artit, sendet antike, bizhuteritë, metalet dhe gurët e çmuar, nuk amortizohen.

Gjobat jane ne baze të Ligjit 9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 115 pika 1. Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Per kete subjektit i dalin detyrimet e meposhteme :

Per tatimi fitimi do te kemi :

Detyrimi $16,960,000 \times 15 \% = 2.535.000$ leke

Gjobe 21.9 % 555.165 leke

Totali 3.090.165 leke

- Aktivi (Per punimet qe ka kryer ne karrier subjekti)

- Aktivi kontrollohet nga subjekti

- Subjekti e perdor per veprimtarin e tij ekonomike per realizimin e te ardhurave ne periudhat ne vazhdim

- Kostua e aktivitet matet me besushmeri

(po persa i takon mosnjohjes si shpenzim te zhpenzimit te amortizimit si me siper ,Apelimi Tatimor ka mendim te kundert , njifet si aktiv dhe njifet dhe shpenzimi i amortizimit

- Per sa i takon lincencave minerale, te kerkimit etj subjekti eshte i paisur po keto duhet ti kerkohen subjektit .

- Ne rastet e autofaturimeve per punimet e zbulimit nuk kemi te bejme me punime ndertimi por me punime zbulimi per mineral me mjetet e renda te saj dhe jo me ndertim ne kuptimin klasik. Sic e kam thene dhe me siper komponenti kryesor eshte diezeli i perdorur nga makinerit. Per situacionet duhet ti drejtohem subjektit.

Ne raportin e kontroll eshte kryer analiza e kostove te mallrave e raportuar nga tatim paguesi. Po ashtu dhe kostot e inventareve te produkteve te tregetuar nga subjekti psh (kontrolli per rimbursimin) faqe 10 te Raportit te Kontroll perfundimtar per vitin 2020

- U verifikuan cmimet e blerjes u be analiza e kostos dhe cmimet e shitjes te artikujve.

Po keshtu dhe per periudhat e tjera qe jane kontrolluar.

Po ashtu dhe per vlerat e paraqitura ne pasqyrat financiare te zeri i inventareve eshte mare parasysh sasia dhe kostua e tyre.

Ne raport kontroll perfundimtar eshte kryer kryer analiza per certifikimin e teprices kreditore sipas periudhe te cilen e keni ne faqe nr 18 te Raportit te Kontroll Perfundimtar te cilen po jua riparaqes :

- Teprica kreditore eshte krijuar nga blerjet e tatueshme brenda vendit me tvsh 20 % dhe importet me tvsh 20 % te cilat jane lende e pare dhe material ndimese qe i sherbejne aktivitetit. Subjekti ka kerkuar rimbursimin e t.v.sh - se per vleren 2.930.045 leke.

Bazuar ne analizen e kryer me siper Kërkesa për rimbursimin e Tvsh-se nga subjekti eshte ne vleren 2.930.045 leke, Kerkese e rregullt e Teprices kreditore te Tvsh-se qe meret ne shqyrtim eshte 1.662.449 leke. Pra kemi kerkese te gabuar ne vleren $2.930.045 - 1.662.449 = 1.267.596$ leke

Faqe 21

Bazuar ne analizen e kryer ne akt kontrolli pikat 1 dhe 2 shuma që miratohet subjektit per rimbursim është 210.538 leke (210538 +0) leke .

Pra analiza e certifikimit te teprices kreditore eshte kryer

Si konkluzion per fiskalitetin :

Autofaturat subjekti i ka te paraqitura si ne blerje dhe ne shitje , pra nuk kane efekt te tvsh-ja.

Per tatim fitimi :amortizimi i shtesave te aktivitet qe vjen nga autofaturat nuk eshte njohur prej meje.

Autofaturat jane aam sic eshte pasqyruar me siper.

Certifikimi i tvsh per arsye rimbursimi sipas periudhes eshte bere sipas kerkeses te ardhur nga subjekti nepermjet shkresave me DPT.

Certifikatat , autorizimet dhe cdo dokument shoqerues duhet tia kerkoime subjektit

Kontrollet kane kaluar ne apelim tatimor

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Në lidhje me pretendimet e paraqitura në observacion sqarojmë se janë të njëjta më ato të paraqitura për akt-konstatimet (të trajtuara hollësisht në pjesën takuese në Projekt Raport), nuk janë paraqitur argumente apo dokumente shtesë, për pasojë nuk merren në konsideratë.

-Me shkresat nr. 2991/25 prot, datë 10.07.2024, administruar në KLSH me nr. 1111/37 prot, datë 15.07.2024 dhe nr. 4672/1 prot, datë 10.07.2024, administruar në KLSH me nr. 1111/36 prot, datë 15.07.2024, nga znj. A. A. me detyrë Inspektor i Kontrollit në Vend pranë DRT Vlorë, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

-Ne lidhje me subejktin "D Sh.p.k", për periudhën Janar-Prill 2019, periudhë para shtyrjes së lejes së mëparshme, subjekti ka bërë blerje me qëllim arredim të brendshëm, si vendosje pllaka gipsi, shtrim pllakash, cemento, kol, suva, etj të cilat për nga natyra nuk kanë nevojë për leje ndërtimi. Këto pretendime janë paraqitur edhe në takimin e mirëkuptimit të zhvilluar në ambjentet e KLSH-së në datë 31.07.2024 në prani të drejtuesve, ku janë referuar si punime elektrike.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Në lidhje me pretendimet e paraqitura në observacion sqarojmë se janë të njëjta më ato të paraqitura për akt-konstatimet (të trajtuara hollësisht në pjesën takuese në Projekt Raport), nuk janë paraqitur argumente apo dokumente shtesë, për pasojë nuk merren në konsideratë. Gjithashtu sqarojmë se këto punime lidhen me procesin e ndërtimit të një objekti që është paraqitur në tejkalim të lejes sipas treajtimit në raport kontrolli tatimor të shqyrtuar nga grupi i auditimit.

-Ne lidhje me subjektin "K" Shpk Nipt LL

"Nga auditimi ne lidhje me rakordimin e shenzimeve sipas pasqyres se performances me blerjet e deklaruar ne formularin e deklarimit dhe pageses se tvsh-se konstatohet se nuk eshte kryer nga ana e inspektorit tatimor ne raportin e kontrollit tatimor. Nga kryerja e ketyre krahasimeve duke marre ne konsiderate edhe efektin e diferencave ndermjet gjendjes se inventarit, kane rezultuar diferenca ne KMSH-ne e llogaritur."

Vlen te theksoj se, kjo problematike eshte trajtuar ne raport kontrollin e mbajtur nga ana ime, ne seksionin e diferencave Tatime – Dogana per vitin 2020. Diferenca qe rezulton ne muajin Prill 2020 prej 400,000 leke Tvsh, qendron pasi importet e deklaruar nga subjekti jane me pak se importet e deklaruar nga Dogana. Por, subjekti e ka deklaruar me pak ne fdp e tvsh-se ndersa ne librin e blerjeve e ka te deklaruar. Gjithashtu, ne koston e mallrave te shitur eshte perfshire vlera e sakte e importeve (shiko shenimet ne bilanc), qe do te thote qe rakordimi i hyrjes dhe gjendjes se mallrave eshte bere ne baze te fatures reale te importit. Ne keto kushte bejme sistemimin e situates se tvsh-se ne muajin Prill 2020 duke shtuar blerjet e perjashtuar me vleren e deklarates se importit + tvsh (ka humbur te drejten e kreditimit 12 muaj).

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Në lidhje me pretendimet e paraqitura në observacion sqarojmë se diferenca e paraqitur si pasojë e mos deklarimit të importit në fdp e tvsh në vlerën e tatueshme 1,931,991 dhe tvsh 400,00 lekë (2,331,991 në total pas kalimit si blerje e përjashtuar) është më e madhe se diferenca e paraqitur nga grupi i auditimit në vlerën 1,401,131 lekë dhe kjo diferencë nuk rezulton të jetë rakorduar në raport kontrolli duke kryer procedurën e rakordimit të fdp të tvsh me shpenzimet e deklaruar në pasqyrën e performancës financiare dhe deklaratën e tatim fitimit. Për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

Për sa është trajtuar në Projekt raportin e auditimit nr. prot.,1111/28 datë 13.06.2024, nga subjekti i audituar DRT Vlorë, janë paraqitur observacionet me shkresën nr. 2991/25 prot., datë 10.07.2024, protokolluar në KLSH me nr. 1111/37, datë 15.07.2024 dhe është zhvilluar takimi i mirëkuptimit në ambjentet e KLSH-së në datë 31.07.2024 në prani të drejtuesve, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit për "T"

Me Vendimin nr. 561 datë 27/07/2021, për Miratim Punimesh, duam tju bëjmë me dije se shoqëria The Central Vieë Boutique Hotel është pajisur nga Bashkia Vlorë me një VENDIM për Deklaratë paraprake punimesh e cila ka koncept tjetër ligjor nga Leja dhe pasqyrohet saktë në legjislacionin e fushës, ku që në nenin 3, si dhe te neni 41 të ligjit 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" sqaron se deklarata paraprake aplikohet për punime që nuk kërkohet leje ndërtimi. Vendimi nr. 561 datë 27/07/2021, Për miratimin e deklaratës paraprake është i bashkëlidhur me 1-Grafikun e punimeve, 2- Preventivin, 3- Projektin. Që në rreshtat e parë të vendimit e pasqyron qartë Bashkia Vlorë, e cila citon se ky vendim referuar është në mbështetje të Ligjit nr. 107/2014, datë 31/07/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, dhe nenit 20, të VKM nr. 408, datë 13/05/2015 "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" i ndryshuar.

Në vijim po ju vendosim korespondencën me bashkinë Vlorë, me shkresën e DRT Vlorë nr. 4057 prot., datë 11.06.2024, lënda “Kërkesë për interpretim” drejtuar Bashkisë Vlorë në lidhje objekt ndërtimi si: Dhënia e lejeve të fillimit të punimeve, dhënia e lejeve për deklaratën paraprake, Vendim “Për miratimin e deklaratës paraprake për kryerje punimesh” të cilat janë të pa sigluara dhe pa vulë digjitale nga ana e titullarit të insitucionit, ku kërkohet nëse kjo procedurë është bazuar në rregullore. Bashkia Vlorë, Drejtoria e Urbanistikës kthen përgjigje me shkresën nr.4057 prot., datë 11.06.2024, te DRT Vlorë me nr. 9305 prot., datë 09.07.2024 ku citon qartë se: Në bazë të ligjit nr.44/2015 të Kodit të procedurave Administrative R SH, ju orientojmë ti referoheni dispozitave ligjore të nent 98 e vijues, 104 e vijues të këtij ligji i cili shprehet për veprimtarinë administrative të aktit Administrativ, gjithashtu shkresa citon dhe ligjin nr. 9880 datë 25.02.2008 për nënshkrimin elektronik i ndryshuar, për sa i përket “Vlefshmërisë ligjore e nënshkrimeve elektronike dhe përjashtimet”. Pra kemi të bëjmë me një Vendim të bazuar në kritere ligjore. (bashkëngjitur keni dhe shkresën që e konfirmon).

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me komentet e bëra nga DRT Vlorë mbi auditimin e praktikës së kontrollit tatimor të kryer tatimpaguesit “T”, grupi i auditimit gjykon se:

Bashkia Vlorë në kthimin e përgjigjes suaj me shkresën nr. 9305/1, datë 09.07.2024, citon se mund t’i referohemi ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Për sa më sipër, në pikën nr. 4, të nenit 99, “Kërkesat e formës së aktit administrativ të shkruar në letër ose elektronik” të këtij ligji, citohet “Akti administrativ elektronik nënshkruhet në mënyrë elektronike në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në neni 109, “Paligjshmëria e aktit administrativ” citohet: Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: a) organi publik që e ka nxjerrë ka vepruar në mungesë të kompetencës.

Si dhe të ligjit nr. 9880, datë 25.2.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, ku në nenin 4 “Vlefshmëria ligjore e nënshkrimeve elektronike” të tij, citohet: Dokumenti elektronik, i cili mban emrin e nënshkruesit dhe nënshkrimin e tij të kualifikuar, ka të njëjtën vlefshmëri ligjore dhe fuqi provuese me formën shkresore.

Pra, në gjykimin e grupit të auditimit, Deklarata për kryerje punimesh, dalë me Vendimin nr. 561, datë 27.07.2021, nga Bashkia Vlorë edhe pas shkresës së Bashkisë Vlorë rezulton e pakonfirmuar nga ky organ publik.

1. në formulim të saj shkruhet, e citojmë: ... Kryetari i Bashkisë, pasi mori në shqyrtim kërkesën e zhvilluesit...Vendosi...”, pra ky është një dokument i cili del me miratimin dhe nënshkrimin e Kryetarit të Bashkisë, e jo të vartësve të tij.

2. sipas neneve të cituara më sipër, një akt administrativ elektronik duhet të ketë emrin dhe nënshkrimin. Veprime këto në kundërshtim me kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë, si dhe me nenin 5 “Autoritetet përgjegjëse”, pika 1.3, Në nivel bashkie, gërma “b” kryetari i bashkisë, i ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

Objeksionet tuaja nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit për konfirmim të mëtejshëm në rikontroll në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, si rast përgjithësues për vlefshërinë e kreditimit të tvsh-së në ndërtim kur aktit administrativ të dalë nga organi publik (deklaratë apo leje) i mungon nënshkrimi i personit të autorizuar si një kompetencë për vlefshërinë e tij.

Pretendimet e subjektit për “T”.

Për sa është trajtuar në Projekt raportin e auditimit nr. prot.,1111/28 datë 13.06.2024, nga subjekti i audituar DRT Vlorë, janë paraqitur observacionet me shkresën nr. 2991/25 prot., datë 10.07.2024, protokolluar në KLSH me nr. 1111/37, datë 15.07.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

- Kontrolli ka konstatuar diferencë ndërmjet inventarit në fund të vitit dhe inventarit material në artikullin dekoder në sasinë 548 copë, marrë nga inventari në fund të vitit i subjektit i cili është dorëzuar në sistemin C@ts. Sqarojmë se inventari i datës 31.12.2021, i dorëzuar nga subjekti për kontrollin është: 152 dekodera të saktë për t’u shitur, 548 dekodera të dëmtuar në pritje nga kompania për ti kthyer. Pjesa tjetër e inventarit analitik është e detajuar dhe bashkalidhur këtij dokumenti. D.m.th. sipas deklaratimit të subjektit 548 dekodera janë më shumë në inventarin e deklaruar nga subjekti pra të kthyer mbrapsht nga

klientët, për arsye se janë të dëmtuar në pritje të riparohen dhe të kthehen përsëri te klientët (ose të dëmtuar të cilët nuk mund të riparohen më, por janë shitur njëherë nga shoqëria).

Dekoderat e kthyer nga klientët janë të dëmtuar brenda periudhës së garancisë nga shkaqe natyrore dhe merren nga kompania rregullohen pjesët dhe dekoderat që nuk arrihet të rregullohen nxirren jashtë përdorimi. Këto dekodera janë shitur një herë dhe nuk mund të bëhet rivlerësim për diferencë. Dekoderat janë më tepër gjendje inventari në fund të vitit dhe jo më pak që ti konsiderojmë të shitur. Bashkalidhur gjendja e inventarit të detajuar të subjektit në datë 31.12.2021.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Për sa më sipër, nga subjekti i audituar nuk janë sjellë dokumente të rinj justifikues për të kundërshtuar konstatimet e grupit të auditimit në projekt raportin e auditimit, prandaj observacioni nuk merret në konsideratë.

Pretendimet e subjektit për “H”.

Për sa është trajtuar në Akt Konstatimin nr. 1, datë 26.04.2024 nga subjekti i audituar DRT Vlorë janë paraqitur observacionet me shkresën nr. 2991/25 prot., datë 10.07.2024, protokolluar në KLSH me nr. 1111/37, datë 15.07.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

-Në lidhje me bilancin material i mbajtur për periudhën tatimore Tetor 2021 – Shtator 2022, rezulton artikulli “Beton” gjëndje në sasinë 191 m3. Sipas analizës Tuaj, duhej që ky beton ose të ishte shitur ose të ishte situacionuar. Duke qenë se sektori i ndërtimit, ndryshe nga sektorët e tjerë, për çdo artikull që blen apo çdo punim, e kthen në një produkt që nuk mundet kurrësesi të mos e deklarojë deri në përfundim të punimeve, por duke qenë se në një situacion ndërtimi, zërat e punimeve lidhen me njëra tjetrën, për të krijuar produktin, atëherë edhe ky zë do të situacionohet bashkë me zërat e tjera që ndoshta nuk janë realizuar akoma deri në këtë fazë të inventarizimit.

- Në lidhje me faktin që subjekti ushtron edhe aktivitete të tjera përveç strukturave akomoduese për të cilat aplikon shkallën e reduktuar të TVSH 6% dhe për këtë arsye, nuk duhet të aplikojë shkallën e reduktuar të TVSH, pasi nuk i ka të ndara aktivitetet. Sqaroj se, ashtu sikurse e keni cituar dhe ju në akt konstatimi, aktiviteti i shoqërisë është “hoteleri, agjensi turistike, bar, restorante, akomodim në çadra plazhi, shezllona etj”. Duke qenë se aktiviteti primar i shoqërisë është “Struktura akomoduese”, sqarojmë se ashtu sikurse e përcakton dhe Ligji 92/2014 “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar në R.Sh”, i ndryshuar, neni 49 i tij, si dhe Ligji 71/2017 “Për një shtesë në Ligjin 92/2014 “Për TVSH”, i ndryshuar ku citohet: “Në nenin 49, të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje: “3. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese, sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin e fushës së turizmit, është 6 për qind. Kushtet, kriteret dhe procedurat për zbatimin e kësaj pike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Vendimi 730, datë 20.10.2016 “Për Miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, neni 3, gërma f) “Strukturë akomoduese”, struktura që vë në dispozicion të turistëve, vendas apo të huaj, individë ose të organizuar në grupe, për një periudhë kohe të pacaktuar, por jo më shumë se 1 vit, shërbimet e akomodimit (fjetje, ushqim, pije dhe shërbime të tjera), në përputhje me standardet e përcaktuara sipas klasifikimit dhe kategorizimit të saj;

Certifikatë Kategorizimi nga Ministria e Turizimit dhe Mjedisit nr. Regj 601/2020 datë 19.02.2020. Sa më sipër, në përputhje me legjislacionin në fuqi, aktivitetet e tjera janë në funksion të mbarëvajtjes së aktivitetit primar “Strukturë akomoduese” për të cilat ashtu siç e kërkon dhe ligji i TVSH, është bërë aplikimi i diferencuar i shkallës së TVSH me 6% për hotelerinë dhe 20% për aktivitetet e tjera.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga DRT Vlorë mbi auditimin e praktikës së kontrollit tatimor të kryer tatimpaguesit “H” grupi i auditimit gjykon se:

-Në lidhje me bilancin material të mbajtur për periudhën tatimore Tetor 2021 – Shtator 2022, duke marrë në konsideratë se bëhet fjalë për artikullin “beton”, i cili nuk magazinohet, subjekti duhet ta kishte situacionuar çdo muaj për efekt rakordimi dhe jo ta linte si gjendje inventari.

- Në lidhje me komentet e juaja mbi aplikimin e reduktuar të TVSH 6% nga subjekti, grupi i auditimit i është referuar pikës nr.1, neni 11/1, të VKM nr. 953, datë 29.12.2014, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, e ndryshuar. Për sa më sipër objeksioni juaj nuk merret në konsideratë.

Pretendimet e subjektit për “F”:

Për sa është trajtuar në Projekt raportin e auditimit nr. prot.,1111/28 datë 13.06.2024, nga subjekti i audituar DRT Vlorë, janë paraqitur observacionet me shkresën nr. 2991/25 prot., datë 10.07.2024, protokolluar në KLSH me nr. 1111/37, datë 15.07.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

-Në lidhje me auditimin e bilancit material për diferencën në artikullin gaz i lëngshëm në 4193 ju bëj me dije se: Gjendja e Inventarit në fund për periudhën Janar - Dhjetor 2019, për gazin në litra është 6205 litra për të gjitha pikat që disponon shoqëria. Përsa i përket shoqërisë, punon me dy njësi lidhur me artikullin Gaz. Pra, kemi gaz në litra për Autostradën dhe gaz në kg, për Lagjia 24 Maji. Në raport kontroll është marrë në analizë gazi në litra dhe lëvizja inventariale për gazin në litra është e njëjtë me atë të paraqitur në raport kontrolli.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

-Në lidhje me konstatimin e bilancit material për gjendjen e gazit të lëngshëm në magazinë, nga subjekti i audituar nuk janë sjellë dokumente të rinj justifikues për të kundërshtuar konstatimet e grupit të auditimit në projekt raportin e auditimit, prandaj observacioni nuk merret në konsideratë.

Pretendimet e subjektit për “S”:

Për sa është trajtuar në Projekt raportin e auditimit nr. prot.,1111/28 datë 13.06.2024, nga subjekti i audituar DRT Vlorë, janë paraqitur observacionet me shkresën nr. 2991/25 prot., datë 10.07.2024, protokolluar në KLSH me nr. 1111/37, datë 15.07.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

-Referuar konstatimit të mbajtur në lidhje me subjektin S. H. R., diferenca prej 1,092,556 lekë që rezulton si e kredituar tepër nuk ekziston pasi nga ana e grupit të kontrollit janë kontrolluar librat e blerjes dhe pasqyrimi i tyre në FDP përkatëse mujore. Diferenca në vlerë vjen si rezultat i filtrimit të gabuar gjatë përpunimit të excel-it dhe nuk ndikon në ngarkesën reale të TVSH. Bashkëlidhur FDP për periudhën prill – nëntor 2021.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga DRT Vlorë mbi auditimin e praktikës së kontrollit tatimor, vërejmë se subjekti ka paraqitur të njëjtat objeksione që ka paraqitur mbi Akt Konstatimin nr. 1, datë 26.04.2024, për të cilat grupi i auditimit ka mbajtur qëndrimin e tij dhe i ka reflektuar ato në projekt raportin e auditimit.

Pretendimet e subjektit për “H P”:

Për sa është trajtuar në Projekt raportin e auditimit nr. prot.,1111/28 datë 13.06.2024, nga subjekti i audituar DRT Vlorë, janë paraqitur observacionet me shkresën nr. 2991/25 prot., datë 10.07.2024, protokolluar në KLSH me nr. 1111/37, datë 15.07.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Në lidhje me konstatimin tuaj se subjekti “H P”, me NIPT KH, nuk është pajisur me deklaratë paraprake punimesh për “Blerje të investimeve nga furnitorët vendas me shkallë 20%” në vlerën 5,545,040 lekë dhe TVSH 1,109,008 lekë, shprehem se, pas ri-verifikimit të situatës referuar konstatimit tuaj dhe duke marrë në konsideratë bazën ligjore dhe rregullatore në lidhje me tipologjitë e ndryshme të aplikimeve për leje punimesh:

Punimet e kryera nga subjekti “H P” janë punime të cilat përfshihen në nenin 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar me VKM-në nr. 457, datë 29.06.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar”. Referuar kësaj dispozite rregullatore, citojmë se:

“Pa përjashtuar detyrimin e respektimit të dispozitave të parashikuara nga kuadri ligjor në fuqi për veprimtaritë ndërtimore, përfshirë, në mënyrë të veçantë, sa u përket qëndrueshmërisë antisizmike, mbrojtjes kundër zjarrit, ruajtjes së sigurisë dhe higjienës shëndetësore, ndërhyrjet e

mëposhtme kryhen pa u pajisur me leje ndërtimi dhe pa paraqitur deklaratë paraprake punimesh:

1. Ndërhyrje të mirëmbajtjes së zakonshme, sipas nenit 2, të kësaj rregulloreje, që përfshijnë:

1.1 ndërhyrje të jashtme për riparimin dhe zëvendësimin e rifiniturave të jashtme të ndërtesave, me kusht që të ruhen karakteristikat origjinale të tyre, si:

ii. ndërhyrjet me qëllim ruajtjen apo rritjen e eficiencës energjetike dhe akustike në një strukturë ekzistuese, që nuk prekin sistemin konstruktiv të ndërtesës (p.sh. ndërhyrje në themele, mure mbajtëse, tra-kolonë etj.);

v. zëvendësimi, riparimi i pjesshëm i mbulesës së çatisë, pa ndonjë ndryshim të formës, të pjerrësisë dhe të karakteristikave të veshjes;

1.3 Ndërhyrje në impiante higjieno-sanitare dhe elektrike, si:

ii. veprat e riparimit dhe të zëvendësimit të pajisjeve elektrike dhe riparimet e sistemeve elektrike.

Punimet që subjekti ka kryer kanë të bëjnë me zëvendësimin e paneleve “sandëich” të mbulesës së sipërme, me rikonstrukcionin e tualetit, me riparimin e depozitave të karburantit (saldime), si dhe me riparimin e sistemit elektrik (kjo ndërhyrje ka qenë pjesore, aty ku sistemi elektrik, celsa, priza për shkak të amortizimit), të gjitha këto kanë qenë ndërhyrje ‘zëvendësuese’ dhe asnjë volum i ri nuk i është shtuar objektit.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga DRT Vlorë mbi auditimin e praktikës së kontrollit tatimor të kryer tatimpaguesit “H P”, grupi i auditimit gjykon se:

-Inspektori në observacionin e tij i është referuar VKM nr. 457, datë 29.06.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar”, VKM e cila është ndryshuar pas periudhës objekt kontrolli të subjektit dhe pas periudhës së kontrollit nga administrata tatimore.

Nga subjekti i audituar nuk janë sjellë dokumente të rinj justifikues për të kundërshtuar konstatimet e grupit të auditimit në projekt raportin e auditimit, prandaj observacioni nuk merret në konsideratë.

Pretendimet e subjektit për “H P”:

Për sa është trajtuar në Projekt raportin e auditimit nr. prot.,1111/28 datë 13.06.2024, nga subjekti i audituar DRT Vlorë, janë paraqitur observacionet me shkresën nr. 2991/25 prot., datë 10.07.2024, protokolluar në KLSH me nr. 1111/37, datë 15.07.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Referuar konstatimit të mbajtur në lidhje me subjektin H P, sqarojmë se subjekti për punimet e kryera nuk ka patur detyrim për tu pajisur me leje paraprake punimesh, kjo gjë vërtetohet në dokumentin kthim-përgjigje nga Bashkia Himarë me nr. 1656/1 prot., datë 07.04.2023. Dokument që ju është vendosur në dispozicion në kontaktet e mëparshme.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me konstatimin mbi punimet e kryera nga subjekti pa u pajisur me Deklaratë paraprake, nga subjekti i audituar nuk janë sjellë dokumente të rinj justifikues për të kundërshtuar konstatimet e grupit të auditimit në projekt raportin e auditimit, prandaj observacioni nuk merret në konsideratë.

Pretendimet e subjektit për “S”:

Për sa është trajtuar në Projekt raportin e auditimit nr. prot.,1111/28 datë 13.06.2024, nga subjekti i audituar DRT Vlorë, janë paraqitur observacionet me shkresën nr. 2991/19 prot., datë 02.07.2024, protokolluar në KLSH me nr. 1111/31, datë 05.07.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Sqarojmë se: Shoqëria në zbatim të SKK nr. 5 dhe udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, tatimpaguesi të gjitha AAM-të i ka njohur me kosto. Në kosto ka përfshirë: koston e blerjes dhe kosto të tjera të drejtpërdrejta që lidhen me sjelljen e aktivitetit në vendndodhjen dhe kushtet e nevojshme për funksionimin e tij, sipas qëllimeve të njësisë.

Gjatë periudhës ushtrimore të gjitha kostot e blerjes, krijimit, përmirësimit, rinovimit dhe rikonstrukcionit të aktiveve të qëndrueshme që kanë pasur për qëllim përmirësimin e kapacitetit përfitues të ardhshëm të aktiveve dhe vlera e të cilave është më e madhe se 15 përqind e vlerës kontabel të mbetur të aktiveve, nuk

janë njohur si shpenzime periudhe, por janë shtuar vlerës së aktivitetit. Kjo shpjegon dhe rritjen e vlerës së aktivitetit ndërtesë me vlerë 20,000,000 lekë gjatë periudhës 2021.

Në pasqyrën e “Pozicionit financiar”, në zërin “Ndërtesa” është paraqitur e grupuar dy zëra të cilët janë dhënë analitik në pasqyrën “Amortizimi i AAM”, ai i “Ndërtesa” në vlerën 361,645,355 lekë dhe ai i “Ndërtesa + instalime” në vlerën 93,646,172 lekë.

Oëndrimi i grupit të auditimit:

- Në lidhje me komentet e bëra nga DRT Vlorë mbi auditimin e praktikës së kontrollit tatimor të kryer tatimpaguesit “S”, vërejmë se subjekti ka paraqitur të njëjtin objeksion që ka paraqitur mbi Akt Konstatimin nr. 1, datë 26.04.2024, ku të gjitha Aktivitet Afatgjata Materiale, subjekti i ka njohur me kosto, si dhe vlera prej 20,000,000 lekë është rritje e vlerës së aktivitetit “Ndërtesë” gjatë periudhës ushtrimore 2021. Objeksion për të cilin grupi i auditimit ka mbajtur qëndrimin e tij dhe i ka reflektuar ato në projekt raportin e auditimit.

- Ndërsa për objeksionin se në pasqyrën e “Pozicionit financiar”, në zërin “Ndërtesa” është paraqitur e grupuar dy zëra të cilët janë dhënë analitik në pasqyrën “Amortizimi i AAM”, ai i “Ndërtesa” në vlerën 361,645,355 lekë dhe ai i “Ndërtesa + instalime” në vlerën 93,646,172 lekë, nga subjekti i audituar nuk janë sjellë dokumente të rinj justifikues për të kundërshtuar konstatimet e grupit të auditimit në projekt raportin e auditimit, prandaj observacioni nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit mbi R:

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 1111/28 prot., datë 13.06.2024 nga subjekti i audituar DRT Vlorë janë paraqitur observacionet me shkresë nr. 2991/25 prot., datë 10.07.2024, protokolluar në KLSH me nr. 1111/37, datë 15.07.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit nga punonjesis e Kontrollit te larte te Shtetit jane konstatuar llogaritje jo te sakta te rivleresimit te diteve te punes per 2 punonjes te cilet kane plotesuar formualarin e vetdeklarimit per ditet e punuara.Konkretisht per punemarresit Id me ID HO dhe punemarresen tjeter J B me ID IU te cilet kane vetdeklaruar te formualri qe kane punuar 28 dite pune, dhe nga analiza e kryer nga Inspektori i KLSH-se jane konstatuar parregullsi ne llogaritjen e diteve te punes dhe oreve te punes per efekt te kontributeve te Sigurimeve Shoqerore dhe Shendetesore, Per keta 2 (dy) persona dalin detyrimet 14.151 leke.

- Për pretendimin që kanë konstatuar nuk qendrojnë pasi po ben nje analize per te 2 punemarresit simeposhte:

-Nga analiza e mesiperme shihet se per te 2 (dy) punemarresit jane siguruar me shume sesa i takon te sigurohen. Per punemarresen I P kemi 24 dite dhe per punemarresen J B me ID I kemi 35 dite, duhet te kemi parasysh se punemarresit e mesiperme kane filluar pune ne muajin Korrik 2021 dhe per 6 - mujorin e pare nuk ka pasur arsye rivleresimi.

Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar DRT Vlorë për Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 1111/4, datë 13.06.2023 grupi i auditimit gjykon se:

Në dokumentacionin e shqyrtuar në dosjet e kontrollit ka rezultuar se nuk rakordojnë me deklarinimin që të punësuarit janë shprehur, si dhe referuar informacionit të përcjell nga inspektorët e kontrollit është deklaruar se është marrë mesatarja e ditëve të punës. Nuk janë sjellë argumente të reja nga sa është trajtuar në Projekt Raport dhe si rrjedhojë gjykojmë se nga DRT Vlorë nuk janë sjellë argumente të qenësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit mbi “E” SHPK:

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 1111/28 prot., datë 13.06.2024 nga subjekti i audituar DRT Vlorë janë paraqitur observacionet me shkresë nr. 2991/25 prot., datë 10.07.2024, protokolluar në KLSH me nr. 1111/37, datë 15.07.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

-Grupi i kontrollit mori në analizë jo vetëm situatën financiare të tatimpaguesit por edhe plotësimin e kriterëve ligjore për aplikimin e shkallës së reduktuar të TVSH-së prej 6%.

-Për analizimin e kësaj situatë ju referuam jo vetëm legjislacionit tatimor por edhe atij për fushën e turizmit.

Në hulumtimin e dispozitave ligjore u konstatua se Me Urdhërin nr. 18, datë 17.01.2020, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit ka ndryshuar Rregulloren e miratuar me Urdhërin e mësipërm, duke shtuar pikën 4 në nenin 6, e cila përcakton se “Dokumentacioni shoqërues, në rast se nuk është depozituar nga subjekti në momentin e aplikimit, duhet të dorëzohet brenda datës 31.12.2020, pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin”.

Me urdhërin nr.41, datë 18.02.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr.267,datë 24.07.2019 “Mbi miratimin e rregulles për mënyrën,kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese” Ministria e Turizmit dhe Mjedisit,ka përcaktuar se afati i aplikimit përmarrjen e certifikatës së kategorizimit është shtyrë deri në datë 31.03.2020.

Kështu, bazuar në Ligjin nr.92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH”, të ndryshuar, Neni 49, pika 4, (Ligj nr. 107/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014, “Për TVSH në RSH”, të ndryshuar), shkalla e reduktuar e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar 6 % aplikohet për çdo furnizim shërbimi të ofruar brenda strukturave akomoduese, të cilat kanë aplikuar për marrjen e certifikatës së kategorizimit brenda datës 31.03.2020”.

Deri në hyrjen në fuqi të akteve të mësipërme nënligjore, tatimpaguesi nuk ka patur detyrimin për t’u pajisur me certifikatë kategorizimi për ushtrimin e aktivitetit si strukturë akomoduese, por vetëm certifikatë klasifikimi. Ligji 92/2014 shkallën e reduktuar të TVSH-së për furnizimin e shërbimeve të akomodimit e lejon për kategoritë e përcaktuara në legjislacionin për turizmin, për të cilat nuk ka patur nevojë për certifikim nga ministria përkatëse, për t’u trajtuar si të tilla, deri në ndryshimet e mësipërme ligjore.

Aktet e mësipërme ligjore, të cilat detyrojnë tatimpaguesit të pajisen me certifikatë kategorizimi për ushtrimin e veprimtarisë si strukturë akomoduese nuk mund t’i shtrijnë efektet për periudha përpara datës së përcaktuar në Urdhërin nr. 267, datë 24.07.2019, pra përpara datës 31.03.2020.

Tatimpaguesi ka aplikuar ne datën 15.06.2020 për pajisje me “Certifikate Kategorizimi” dhe periudha për të cilën ai është kontrolluar është mbas datës së aplikimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar DRT Vlorë për Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr.1111/4, datë 13.06.2023 grupi i auditimit gjykon se:

Tatimpaguesi ka aplikuar për pajisje me “Certifikatë Kategorizimi” në datë 15.06.2020 duke tejkuluar afatin e vendosur në datë 31.03.2020, si dhe periudha për të cilën është ushtruar kontrolli është Gusht 2021- Gusht 2022, periudhë për të cilën subjekti nuk disponon dokumentacionin e nevojshëm për të përfutuar aplikimin e reduktuar të shkallës së TVSH me 6%. Nuk janë sjellë argumente të reja nga sa është trajtuar në Projekt Raport dhe si rrjedhojë, gjykojmë se nga DRT Vlorë nuk janë sjellë argumente të qenësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit mbi H Group:

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 1111/28 prot., datë 13.06.2024 nga subjekti i audituar DRT Vlorë janë paraqitur observacionet me shkresë nr. 2991/25 prot., datë 10.07.2024, protokolluar në KLSH me nr. 1111/37, datë 15.07.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

-Referuar konstatimit të mbajtur në lidhje me subjektin H Group me Nipt L87215201T sqarojmë se, bilanci material është konsideruar i ezauruar pasi analiza e blerjeve është bërë fatur më fatur për çdo artikull të blerë. Analizimi i shitjeve për periudhën e kontrolluar është kryer sipas tabelës në faqen 15-16 të materialit të kontrollit. Subjekti nuk ka dorezuar libër blerje për periudhën janar 2023 për këtë arsye për efekt analize janë marrë faturat fizike. Inxhinieri nuk është shprehur për punimet në objektin lungomare pasi faza e investimit ishte në fillime (katllavan hedhje betoni për themel) për efekt kreditimi u

analizuan zërat e blerjeve dhe analiza është pasqyruar në materialin e kontrollit. Nuk është bërë analizë e tepicës kreditore e mbartur nga periudhat e mëparshme pasi ka qenë periudhe e kontrolluar. Shitjet e natyrës bar restorant i perkasin njerës nga strukturat e hotelerisë së përfunduar dhe vendosur në funksion në adresën radhim Vlorë. Në përfundim në plotësim të dokumentacionit të vëna në dispozicion në komunikimet e mëparshme, po ju bashkëlidhim, lejen e ndërtimit të ndryshuar nxjerr nga Bashkia Vlorë në Datë 05.10.2022 e cila merr efekte edhe për lejen e ndërtimit nr. 1 datë 04.02.2015.

Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar DRT Vlorë për Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr.1111/4, datë 13.06.2023 grupi i auditimit gjykon se:

-Tatimpaguesit H. Group i është kredituar TVSH për veprimtarinë për bar-restorant, shërbime akomodimi, por nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se nuk ka në pronësi ambiente apo të ketë blerje të deklaruar për qeradhënie për ushtrimin e aktivitetit, si dhe kjo analizë nuk është kryer në raportin e kontrollit tatimor. Gjithashtu, nuk është vendosur në dispozicion certifikata e përdorimit për objektin në të cilën po zhvillohet veprimtaria si bar restorant, shërbime akomodimi që tregon se objekti është ndërtuar në përputhje me projektin dhe kushtet teknike në fuqi, që tregon se objekti ka kaluar të gjitha inspektimet dhe testet e nevojshme për të siguruar që është i sigurt dhe në përputhje me standardet dhe rregulloret përkatëse për të ushtruar aktivitetin. Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se objekti vijon të jetë në proces ndërtimi.

-Lidhur me ndërtimin e objektit Hoteleri në Radhimë, Vlorë, rezulton se situacion punimesh është lëshuar nga H. Group por subjekti që ka lejen e ndërtimit është subjekti H. SHPK, si dhe vlera e situacioneve progresive për ndërtimin e hotelit në Radhimë, Vlorë, në raportin e kontrollit nuk rakordon me vlerën e situacioneve në raportin e ekspertimi teknik dhe me situacionin analitik të shoqërisë H. Group SHPK, vendosur në dispozicion nga inspektori i kontrollit.

-Për ndërtimin në Lungomare, me subjekt ndërtimi H. Group dhe E. B., nuk rezulton të jetë kryer raport ekspertimi për vlerën e punimeve të kryera ndërkohë është rimbursuar TVSH.

Nuk janë sjellë argumente të reja nga sa është trajtuar në Projekt Raport si rrjedhje, gjykojmë se nga DRT Vlorë nuk janë sjellë argumente të qenësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit mbi H:

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 1111/28 prot., datë 13.06.2024 nga subjekti i audituar DRT Vlorë janë paraqitur observacionet me shkresë nr. 2991/25 prot., datë 10.07.2024, protokolluar në KLSH me nr. 1111/37, datë 15.07.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

-Te tabela e amortizimit për vitin 2022 është bërë një lapsus ku makineria e blerë për përkuljen e profileve të aluminit në vend që të vihej te zëri makineri dhe paisje është vendosur te zëri i mjeteve të transportit.

Për sa i takon faturave për zërin udhëtime dhe dieta, transporte këto duhet tia kerkojml subjektit. Po duhet te kemi parasysh se subjekti e kryen vete me mjetet e tij trasportin ndërkombetar me destinacion Italinë e veriut.

Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar DRT Vlorë për Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr.1111/4, datë 13.06.2023 grupi i auditimit gjykon se:

-Për të verifikuar raportimin e subjektit mbi shpenzime të tjera të shfrytëzimit për periudhën e raportit të kontrollit për zërin e udhëtime, dieta, transporte u kërkua të na viheshin në dispozicion fatuarat për këtë zë, por nuk është sjellë dokumentacion justifikues. Nuk janë sjellë argumenta të reja nga sa është trajtuar në Projekt Raport, si rrjedhje gjykojmë se nga DRT Vlorë nuk janë sjellë argumente të qenësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit mbi D:

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 1111/28 prot., datë 13.06.2024 nga subjekti i audituar DRT Vlorë janë paraqitur observacionet me shkresë nr. 2991/25 prot., datë 10.07.2024, protokolluar në KLSH me nr. 1111/37, datë 15.07.2024 dhe janë paraqitur pretendime të tjera në takimin përmblylës të zhvilluar në datë 31.07.2024 në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ku në mënyrë të përmbledhur janë shprehur objeksionet si më poshtë:

I-Subjekti D për periudhën e kontrolluar nuk ka patur në objekt të aktivitetit Hotel-Resort dhe pavarësisht kësaj ka aplikuar shkallën e reduktuar të TVSh me 6%. Kompleksi D aktivitetin kryesor të tij ka veprimtari në fushën e turizmit objekt i cilit është cilësuar që në krijimin e firmës "D". Me vendim të asamblesë së ortakëve nr. 1 datë 29.07.2016 është bërë shtim të aktivitetit të veprimtarisë: bar restorant, dyqane, shërbimi dhe mjete transporti, kënde lojrash për fëmijë, organizim evenimentesh kulturore dhe sportive, shitje konfeksionesh, parkim, guida turistike dhe catering, shërbime dhe mikpritje.

Me vendimin e asamblesë nr. 3 datë 25.06.2019 për të përmirësuar cilësinë e shërbimit është shtuar: Transport i udhëtarëve dhe bagazhe në linja të rregullta kombëtare dhe ndërkombëtare, agjensi për transportin e udhëtarëve, i cili u vjen në ndihmë turistëve të akomoduar në kompleksin D. H..

Me datë 05.05.2014, nga Drejtoria e Përgjithshme e patentave dhe markave shoqëria është pajisur me Certifikatë Marke nr. 15314 ku cilësohet qartazi lista e mallrave dhe shërbimeve (sipas klasifikimit ndërkombëtar të (Nice-s) Shërbime për sigurimin e ushqimeve dhe pijeve, strehim i përkohshëm) dhe me datë 05.04.2024 është bërë rinovimi I Certifikatës së Markës nr.24739 ku përfshihen lista e mallrave dhe shërbimeve (sipas klasifikimit ndërkombëtar të (Nice-s) e cila e specifikon "Strehim të përkohshëm". Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese sipas kategorive të përcaktuara në ligjslacionin e fushës së turizmit është 6 përqind miratuar në datën 27.04.2017. Botuar në Fletoren zyrtare nr. 113/2017 datë 22.05.2017.

Menjëhere Drejtoria e Përgjithshme e tatimeve ka nxjerr njoftim:

Në Fletoren Zyrtare Nr. 113, datë 22 Maj 2017, është publikuar Ligji Nr. 71/2017 datë 27.04.2017 "Për një shtesë në Ligjin Nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar. Sipas këtij ndryshimi, në Nenin 49, të Ligjit nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"3. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese, sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin e fushës së turizmit, është 6 përqind. Kushtet, kriteret dhe procedurat për zbatimin e kësaj pike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave."

Ky ndryshim ligjor, hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të ligjit në Fletoren Zyrtare, përkatësisht nga data 05.06.2017.

Datë 19.02.2020, Kompleksi D, është pajisur me Certifikatën e Kategorizimit Struktura Akomoduese kategoria Resort me nr. 655/2020, datë 19.02.2020.

VKM730, datë 20.10.2016 neni 3 thotë:

"Resort" Kompleks ndërtesash për pushim dhe argëtim të grupuara e të administruara së bashku si hotel, apartamente, vila, studio që ofron klientëve akomodim, ushqim, pije, veprimtari sportive dhe argëtuese dhe shërbime ndihmëse nëpërmjet një stafi të kualifikuar.

Sipas vendimit nr.730 datë 20.10.2016, për klasifikimin e strukturave akomoduese Kompleksi "D. H." plotësonte plotësisht të gjitha kushtet dhe kriteret për kategorinë Resort.

Nga Kërkimet që kemi bërë në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit pajisja me certifikatë ka filluar në vitin 2020 ku është e gjithë lista e strukturave akomoduese pajisur me certifikatë.

Nuk ka asnjë subjekt që të jetë pajisur me certifikatë më herët se viti 2020. Sipas kësaj llogjike është i pavend rivlerësimi i TVSH nga 6% në 20%.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 1111/28 prot., datë 13.06.2024 nga tatimpaguesi, D janë paraqitur observacionet me shkresë nr. 251 prot., datë 25.07.2024, protokolluar në KLSH me nr. 728/1 prot, datë 26.07.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

2. Detyrimet e vendosura në ngarkim të shoqërisë paraqesin si argumenta:

-Për periudhën Gusht 2017-Janar 2020 shoqëria “D” SHPK nuk është pajisur me certifikatë kategorizimi nga MTM.

-Për periudhën Gusht 2017-Janar 2020 shoqëria “D” SHPK nuk ka si objekt veprimtarie Hotel Resort. Sa më sipër rezulton se:

Në interpretim të procedurave të marrjes së autorizimit në raport përshkruhet që me urdhër nr. 41 datë 18.02.2020 “Për një ndryshim të Urdhërit nr. 267 datë 24.07.2019”, “Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese” ka shtyrë afatin e aplikimi për marrjen e certifikatës së kategorizimit të strukturave akomoduese duke përcaktuar afatën 31.03.2020 si afatin përfundimtar për aplikim. Me datë 19.02.2020 Kompleksi “D” SHPK është pajisur me Certifikatë Kategorizimi Strukturë Akomoduese kategoria Resort me nr. 655/2020 datë 19.02.2020. Çka tregon se vetë ministria nuk ka dhënë autorizime para kësaj periudhe.

2.2 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 953 datë 29.12.2014 Neni 11/1 përcakton Kushtet, kriteret dhe procedurat për zbatimin e shkallës së reduktuar për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese.

1. Në zbatim të pikës 3, të nenit 49, të ligjit, shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të akomodimit në stukturat akomoduese, sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin e fushes së turizmit, është 6% (gjashtë per qind). Për qëllime të zbatimit të shkallës së reduktuar të TVSH-së, me termin “Furnizim i shërbimit të akomodimit” nënkuptohet furnizimi i shërbimit të fjetjes në strukturat akomoduese, sipas legjislacionit për turizmin, pa përfshirë furnizimin e ushqimit apo çdo furnizimin tjetër të ofruar nga këto struktura. Përrjashtimisht, “furnizimi i shërbimit të akomodimit” nënkupton, përveç shërbimit të fjetjes, dhe furnizimin e ushqimit (mëngjesit) në rastet kur struktura akomoduese e ofron mëngjesin brenda çmimit të furnizimit të shërbimit të fjetjes.

Në objektin e veprimtarisë së shoqërisë, shprehet, akomodimi në ambjenteve të banimit, shërbim të turizmit, shërbime mikpritje, nënkupton furnizimin e shërbimeve të akomodimit të strukturave akomoduese. Shërbime akomodimi paraqitet në ligje dhe nuk shprehet hotel e resort. Fakti që faturat e deklaruarat me 6% në të gjithë rastet, janë shërbime fjetje, vërteton se janë në zbatim të ligjit të TVSH-së.

Vetëm shërbime turizëm i pastër janë deklarimet e të ardhurave të faturuara dhe nga këto: “D” SHPK është regjistruar në booking platformën e rezervimeve Prill 2016. Për periudhën 2017-2019 janë deklaruar këto shitje nga booking. Viti 2017 shuma 10,392 Euro; Viti 2018 shuma 45,900 Euro; Viti 2019 shuma 57,100 Euro. Objekti i shoqërisë ka qenë “Aktivitet ndërtimi në zbatim, gërmime dheu, muratur, beton-armë, ndërtime, banesa 8 kate ndërtim rrugë, ura ujësjellës, kaskadë mbi 10 m kanalizime, projekte objekte civile, veprimtari në fushën e turizmit. Me datë 07.01.2014 nga Drejtoria e Përgjithshme e patentave dhe markave jemi pajisur me Certifikatë Marke nr. 15173 ku cilësohet qartazi lista e mallrave dhe shërbimeve sipas klasifikimit ndërkombëtar të (Nice-s. Shërbime për sigurimin e ushqimeve dhe pijeve, strehim i përkohshëm. Me datë 05.04.2024 është bërë rinovimi i Certifikatës së Markës nr. 24739 ku përfshihen lista e mallrave dhe shërbimeve (sipas klasifikimit ndërkombëtar të (Nice -s). Në vitin 2016 në momentin e mbarimit të objektit ndërtimor vendosi që shumë ambjente mos ti shesi dhe ti përdori me destinacion aktivitet në fushën e turizmit, duke krijuar një resort të kompletuar prestigjioz me shumë aktivitete. Ky resort do ti shërbejë kryesisht klientëve të huaj duke i siguruar fillimisht fjetjen, kateringun dhe ambjente të tjera argëtuese. U investua në ambjentet akomoduese duke mobiluar 25 ambjente akomodimi, me dhoma gjumi, sisteme kondicionimi, tavolina karrige dhe të gjitha paisjet e tjera në shërbim të klientit. Paralelisht është investuar dhe në aktivitet e bar-restorantit, këndit të lojrave për fëmijë, parkimi dhe aktivitete argëtuese ndihmëse si evenimente kulturore dhe sportive, guida turistike shërbime dhe mikëpritje etj. Këto aktivitete janë pasqyruar në vazhdimësi nëpërmjet vendimeve të ortakëve të pasqyruara dhe në QKB. Me vendim të asamblesë së ortakëve nr. 1 datë 29.07.2016 është bërë shtim të aktivitetit të veprimtarisë, sigurime i ambjenteve akomoduese për fjetje; bar restorant, dëqyqane; shërbimi dhe mjete transporti; kënde lojrash për fëmijë; organizim evenimeshte kulturore dhe sportive; shitje konfeksionesh; parkim, guida turistike dhe catering; shërbime dhe mikëpritje. Kompleksi “D” SHPK aktivitetin kryesor të tij ka veprimtari në fushën e turizmit përcaktuar me vendim asambleje në krijimin e shoqërisë “D. Investimi i bërë në “D” SHPK është investim për suitat, bar, restorant, kënd lojrash, të gjitha aktivitetet të cilat janë në funksion të suitave (aktivitet në fushën e turizmit). Ky investim i bërë në

ambjente akomodimi (dhoma të mobiluara për fjetje) është lehtësisht i identifikueshëm edhe në inventarët e AAM dorëzuar përgjatë viteve 2015-2023 në portalin e-tatime dhe në QKB. Në vendimin e asamblesë nr.3 datë 25.06.2019 për të përmirësuar cilësinë e shërbimit është shtuar në aktivitetin e shoqërisë depozituar në QKB: Transport i udhëtarëve dhe bagazheve në linja të rregullat kombëtare dhe ndërkombëtare, agjensi për transportin e udhëtarëve, i cili u vjen në ndihmë turistëve të akomoduar në kompleksin tonë. Sipas Ligjit 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” të ndryshuar pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar e cila aplikohet për furnizimime shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin e fushës së turizmit është 6 per qind, miratuar në datën 27.04.2017. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 113/2017 datë 22.05.2017. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka nxjerrë njoftim: Në Fletoren Zyrtare Nr. 113, datë 22 Maj 2017 është publikuar Ligji nr. 71/2017 datë 27.04.2017 “Për një shtesë në Ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” të ndryshuar. Sipas këtij ndryshimi në nenin 49, të Ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje. 3. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese, sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin e fushës së turizmit, është 6 per qind. Kushtet, kriteret dhe procedurat për zbatimin e kësaj pike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.” Ky ndryshim ligjor, hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të ligjit në Fletoren Zyrtare, përkatësisht nga data 05.06.2017. Për sa më sipër ju bëjmë të ditur, që formulari i Deklarimit të Pagesës së TVSH-së (FDP) i ndryshuar, do të përfshijë periudhën tatimore Qershor 2017, e cila duhet të deklarohet deri në datën 14.07.2017. Në rakordim me Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier, bazuar në kërkesat e ligjit ne jemi klasifikuar në aktivitetet që përfitojnë të drejtën e zbatimit 6% të TVSH në shitje gjithmonë vetëm për shërbimin e fjetjes. Me miratimin e mësipërm ne filluam aplikimin sipas ligjit të mësipërm. Ligji 71/2017 neni 3, sipas këtij neni, Kompleksi “D. H & Spa” SHPK automatikisht u klasifikuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier si strukturë akomoduese me 6% dhe në korrik 2017 ka filluar aplikim e TVSH 6% për ambjentet akomoduese të turistëve ardhur në kompleks. Sipas Vendimit nr. 730 datë 20.10.2016 për klasifikimin e strukturave akomoduese kompleksi “D” SHPK plotësonte plotësisht të gjitha kushtet dhe kriteret për kategorinë Resort. Tregues që kompleksi “D” SHPK ka funksionuar si strukturë akomoduese (resort). Me datë 31.12.2019 kemi bërë aplikim me dokumentacionin e plotë pranë Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit për certifikatën e strukturës akomoduese. Nga kërkimet që kemi bërë në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit pajisja me certifikatë ka filluar në vitin 2020 ku është e gjitha lista e strukturave akomoduese pajisur me certifikatë. Nuk ka asnjë subjekt që të jetë pajisur me certifikatë më herët se viti 2020. Kompleksi “D” SHPK i cili është pajisur me certifikatë kategorizimi RESORT ushtron aktivitetin si Hotel, bar restorant. Aktivitetet bar, restorant janë të gjitha në funksion të Hotelit. Të gjitha aktivitetet janë të pajisura me program fiskalizimi ku çdo shitje deklarohet online 6% në strukturën akomoduese dhe 20% në bar, restorant, gjë e cila është lehtësisht verifikueshme në programet e instaluar online me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar DRT Vlorë në shkresën e dërguar dhe takimit përmbyllës në ambjentet e KLSH-së me drejtimin e KLSH-së dhe observacionet e tatimpaguesit për Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr.1111/4, datë 13.06.2023 grupi i auditimit gjykon se:

- Subjekti ka kryer shitje të tatueshme me 6% por nuk është pasqyruar në QKB objekti i veprimtarisë së aktiviteti hotel, resort si dhe për periudhën 2017- janar 2020 subjekti “D.” SHPK është i vetmi i cili është rivlerësuar për periudhën para vitit 2020, kur ka filluar shpërndarja e certifikatave të kategorizimit. Për këtë arsye, duke qenë se kuadri rregullator nga ana e institucioneve publike ka pamundësuar aplikimin e shkallës së reduktuar të tvsh-së para 2020 dhe rasti është përfaqësues për një interpretim të nevojshëm të këtij fenomeni nga struktura eprore, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, observacioni merret në konsideratë pjesërisht dhe reflektohet në kërkesën për interpretim të situatës së krijuar.

Pretendimi i subjektit mbi V:

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 1111/28 prot., datë 13.06.2024 nga subjekti i audituar DRT Vlorë janë paraqitur observacionet me shkresë nr. 2991/25 prot., datë 10.07.2024, protokolluar në KLSH me nr. 1111/37, datë 15.07.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

-Per tatimpaguesin "V" me Nipt KE sipas akt konstatimt keni konstatuar:

Sipas raport përfundimtar kontrollit jam shprehur qartë për: Të dhënat e lejes së ndërtimit per ndryshim funksioni, nr. 406 datë, 29.08.2017 në fillimin e kontrollit. Leje ndërtimi nga Bashkia Vlorë numër 406 datë 29.08.2017 me përshkrimin: VENDOSA: Lëshimin e kësaj Leje Ndërtimi për zhvilluesin "V" me Nipt KE të cilit i lejohet ndryshimi i funksionit nga Banim në Hotel të objektit H-H1, pa ndryshuar volumet e miratuara në lejen e ndërtimit me të dhënat; Adresa e realizimit të punimeve, Lagja Uji Ftohet Vlorë; Afati kohor i kësaj leje është 22 muaj nga data e fillimit të punimeve; Subjekti Ndërtues: "Sh"; Investitor: "Shoqëria V"

Si dhe kushti për rimbursimin e tvsh-së në ndërtim:

1.Të dhënat për ndërtuesin dhe investitorin, të dhënat për llojin e objektit, natyrën dhe qëllimin e përdorimit të tyre, referuar lejes së ndërtimit, kusht ky i domosdoshëm lidhur me zbritjen e TVSH-së në ndërtim.

2.Kur përdorimi i objektit është furnizimi i përzier të përcaktohet qartë bazuar në planimetrin e objektit, pjesët përkatëse dhe qëllimi përdorimit të tyre. (nuk kemi furnizim të përzier)

3.Që në fillimin e kontrollit duhet të përcaktohen sipërfaqet për të cilat përfitohet kreditimi TVSH-së e cila është e përcaktuar saktë në raportin teknik të inxhinierit bazuar ne të dhënat e pa ndryshuara të projektit dhe planimetrisë përkatëse.

4.Për rimbursimin e TVSH-se bazohemi te Leja e Ndërtimit numër 406 datë 29.08.2017 për zhvilluesin (Investitorin)"V" me Nipt KE, të cilit i lejohet ndryshimi i funksionit nga Banim në Hotel të objektit H,(verifiko projektin dhe planimetrinë) pa ndryshuar volumet e miratuara në lejen e ndërtimit.

5.Për rimbursimin e TVSH-së bazohemi dhe te blerjet e investimeve me TVSH 20% (kontabilizuar si inventar ekonomik për mobilimi e Hotelit) në vlerën e tatueshme 81.881.283 që nuk jane futur në situacionet e punimeve progresive të Hotelit, prej deklarimeve (446.192.522 -364.311.239)

Për perputhjen e të dhënave të më sipërme jemi bazuar dhe te Akt konstatimit inxhinierit mbajtur datë 10.05.2021 për zbërthimin e zërave të punimeve për ndërtimin e Hotel të objektit H –H1, krahasuar me situacionet progresive për objektin të vëna në dispozicion nga shoqëria "V" dhe faturave të blerjeve të trajtuara gjatë kontrollit nuk rezultojnë diferenca në sasi dhe vlerë trajtuar nga inxhinieri si dhe janë sakteësuar të dhënat sipas lejes së ndërtimit me ndryshimet e ndodhura në kohë të bazuara te projekti dhe planimetritë përkatëse me të dhënat si më poshtë:

1.Sipërfaqe totale ndërtimi për Hotelin H-H1 është 6.600 m2

2.Situacioni progresiv i punimeve të vete deklaruar nga subjekti Shkurt 2018-Dhjetor 2020 është në vlerën e tatueshme..... 364.311.239 leke

3.TVSH-ja e situacionuar është (364.311.239 x20%).....72.862.248 lekë

4.Shuma totale e situacionit progresiv me TVSH është437.173.487 lekë

5.Kosto mesatare pa TVSH për ndërtimin e hotelit për këtë objekt është 55.199leke/m2

6.Kosto /M/ totale me TVSH për ndërtimin e hotelit për këtë objekt është 66.238 leke/m2

Cilësoni se rezultojnë mospërputhje dhe ndryshime nga leje fillestare e ndërtimit, në lejet e trajtuar më vonë të cilat nuk janë analizuar në akt konstatimin teknik te inxhinierit datë 10.05.2021 dhe ne raport kontrolli.

Gjatë kontrollit nuk kam konstatuar mospërputhje, pasi jam bazuar te versionin fundit i lejeve të ndërtimit të lëshuar nga autoriteti fushës përkatëse bazuar në dokumentacionin ligjor të zyrës së urbanistikës, projekti dhe planimetritë të kontrolluara dhe nga eksperti inxhinier i jashtëm vënë në dispozicion gjatë kontrollit.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar DRT Vlorë për Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr.1111/4, datë 13.06.2023 grupi i auditimit gjykon se:

- Në leje ndërtimi të miratuar nga Bashkia Vlorë, Leje nr. 406, datë 29.08.2017, në dokumentacionin e vendosur në dispozicion, të Leje Ndërtimi për ndryshim funksioni për zhvilluesin “V” me Nipt KE i lejohet ndryshimi i funksionit nga Banim në Hotel vetëm për objektin H, pa ndryshuar volumet e miratuara në lejen e ndërtimit dhe nuk është përcaktuar ndryshimi i funksionit për objektin H1 në lejen e ndërtimit për ndryshim funksioni.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit nuk është gjetur në dosjen e kontrollit nënshkrimi i deklaratës së konfliktit të interesit pasi rezultoi se inxhinier i ndërtimit që ka kryer Akt Kontaktimin Teknik, në datë 10.05.2021, është njëkohësisht edhe drejtues teknik i kompanisë E. SHPK e cila është projektuese e projekt-arkitekturave për Hotelin në kompleksin M. B. L. and SPA, me drejtues ligjor A K. Inxhinieri i ndërtimit ka deklaruar se ka kryer aktin e kontaktimit teknik, sipas lejes së ndërtimit për objektin Hotel seksioni H-H1, 4 kat mbi tokë dhe dy kat nën tokë ndërkohë, leje e ndërtimit me ndryshim funksioni nr. 406, datë 29.08.2017 është dhënë vetëm për objektin H. Nga planimetria fillestare e ndërtimit të objektit me 1 kat nën tokë është dhënë rimbursimi i TVSH për 2 kate nën tokë. Kanë rezultuar mospërputhjeve dhe ndryshimeve nga leja fillestare e ndërtimit në lejet e trajtuara më vonë të cilat nuk janë analizuar në akt konstatimin teknik në datë 10.05.2021 dhe raport kontrolli.

Nuk janë sjellë argumente të reja nga sa është trajtuar në Projekt Raport dhe si rrjedhojë, gjykojmë se nga DRT Vlorë nuk janë sjellë argumente të qenësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit mbi P:

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 1111/28 prot., datë 13.06.2024 nga subjekti i audituar DRT Vlorë janë paraqitur observacionet me shkresë nr. 2991/25 prot., datë 10.07.2024, protokolluar në KLSH me nr. 1111/37, datë 15.07.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

- Automjetet perdoren nga njesia drejtuese e tatimpaguesit. Ne momentin e bleres se tyre ato jane deklaruar si blerje te perjashtuara ne zbatim te ligjit 92/2014 date 27.04.2014 “Per TVSH-ne” i ndryshuar dhe gjithashtu cdo furnizim i mepasshem i lidhur me to si sherbime riparimi apo pjese kembimi. Ky fakt eshte konstatuar nga audituesi ku cileson qe blerje per pjese kembimi jane deklaruar si blerje te perjashtuara. Shoqeria zoteron disa mjete, disa prej tyre autovetura dhe disa te tjera mejte teknike pune. Kjo eshte arsyeja qe ne situaten financiare te analizuar nga kontrolli dhe konstatuar nga audituesi disa nga blerjet per pjese kembimi jane deklaruar te perjashtuara (ato te lidhura me autoveturat) dhe disa prej tyre me TVSH-te zbritshme 20% (ato te lidhura me mjetet teknike).

Lloji i mjetit	Tipi/Markë	Targë	Pronësia
Autoveture	Volkswagen	AA 753 RJ	Porti Detar Vlorë Sha
Autoveture	Hyundai	AA 912 SK	Porti Detar Vlorë Sha
ATP	Volkswagen	VL 7953 C	Porti Detar Vlorë Sha
ATP	Volkswagen	VL 7957 C	Porti Detar Vlorë Sha
APV	KAMA	VL 8192 C	Porti Detar Vlorë Sha
APV	FAUN	VL 9277 B	Porti Detar Vlorë Sha
Motkarro	SHIFENG	VL 046 A	Porti Detar Vlorë Sha

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar DRT Vlorë për Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr.1111/4, datë 13.06.2023 grupi i auditimit gjykon se:

- Në raportin e kontrollit nuk është përcaktuar dhe analizuar nëse shitje e përjashtuara i referohen automjete të klasifikuara si ATP, si dhe nga inspektori i kontrollit, mbi automjetet nuk është vendosur në dispozicion faturat e blerjes për llojin e mjetit autoveturë e klasifikuar si blerje e përjashtur apo dokumentacion justifikues për autoveturat që rezultojnë si pasuri të luajtshme referuar formatit të ngarkuar në C@TS, si dhe nuk janë sjellë argumente të reja nga sa është trajtuar në Projekt Raport. Gjykojmë se nga DRT Vlorë nuk janë sjellë argumente të qenësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit mbi "S." SHPK:

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 1111/28 prot., datë 13.06.2024 nga subjekti i audituar DRT Vlorë janë paraqitur observacionet me shkresë nr. 2991/25 prot., datë 10.07.2024, protokolluar në KLSH me nr. 1111/37, datë 15.07.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

- Per tatimpaguesin "S" me Nipt JT sipas akt konstatimit keni shkruar:

Për vitin 2020 diferencë në vlerën 2.018.860 leke si mospërputhje e vlerave të blerjeve me shkallë tatimore 20% të deklaruara në TVSH, krahasuar me vlerën e lëndëve të para dhe materialeve të pasqyruara në pasqyrat financiare 2020 duke mos ju përmbajtur Veprimi Kontabël të KOSTOS SË MALLRAVE TË SHITUR, por në mënyrë mekanike përputhni vlerat e deklarimit në TVSH me vlerat e hedhura në llogarinë e blerjeve të lëndëve të para dhe materiale të tjera për vitin duke krijuar diferencë statistikore për vlerësim dhe jo diferenca kontabël (reale). Ju risqaroj dhe një herë se vlera e blerjeve me shkallë tatimore 20% e deklaruara në TVSH nuk përputhet asnjëherë me vlerën e lëndëve të para dhe materialeve të tjera të hedhura në pasqyrat financiare të të njëjtit vit ushtrimor të llogaritur, pa marrë parasysh dhe gjendjet e inventarit në fillim dhe në fund të vitit në pasqyrat financiare të cilat sjellin ndryshimin në vlerat e blerjeve në plus ose minus me përjashtim të rasteve kur këto vlera inventariale si në fillim dhe në fund të periudhës nuk kanë ndryshime janë zero ose të barabarta, atëherë qëndron vlerësimi i shkruar nga ana juaj (pra në rastin konkret kemi rritje të inventarit në fund të periudhës). Për të saktësuar gabimin e mësipërm për diferencën për vlerësimin e nënshkruar nga ana juaj une i jam përmbajtur veprimi kontabël (Ekuacionit bazë) për llogaritjen e Kostos së Mallrave të shitura në vlerë me përshkrimin (Gjendja e mallrave dhe materialeve në fillim të periudhës, plus Blerjet e mallrave dhe materialeve të periudhës, Pakësuar me gjendjen e mallrave dhe materialeve në fund të periudhës rezulton K.M.SH) ku në rastin e kontrollit nga ana ime përputhen vlerat e deklarimit në TVSH me vlerat e hedhura në llogarit e shpenzimeve të pasqyrave financiare në total dhe veçmas për lëndën e parë dhe veçmas për shpenzime të tjera duke marrë parasysh gjendjet e inventareve në fillim dhe në fund të periudhës të verifikueshëm në pasqyrat financiare nga ana juaj nuk janë marrë parasysh. Duke mos marrë parasysh gjendjet e inventareve në fillim dhe në fund të vitit që sjellin ndryshimin e gjendjes të kostua e mallrave të shitura midis deklarimit të blerjeve në TVSH, krahasuar me vlerat e blerjeve të hedhura në pasqyrat financiare po ju paraqes të dhenat e inventareve të cilat nuk janë marrë parasysh nga ana juaj:

1. Gjendja e inventarit e lëndëve të para në fillim të vitit është në shumën 15.510.758 lekë

2. Gjendja e inventarit e lëndëve të para në fund të vitit është në shumën 17.360.235 lekë

3. Ndryshim gjendjes së inventareve është (15.510.758-17.360.235) minus (-)1.849.477 lekë

Pra vetëm nga të dhënat e më sipërme vlerësimi juaj statistikor në vlerën 2.018.860 leke rrëzohet dhe mbetet vetëm vlera për vlerësim për diferencën pozitive prej 169.383 lekë (2.018.860 -1.849.477) sipas metodës tuaj.

Në raport kontrolli faqe 10 ju mund të lexoni se për këtë mos përputhje të të dhënave sipas faturave të deklaruara në TVSH, krahasuar me të dhënat e hedhura në pasqyrat financiare nga kontrolli ka rezultuar diferencë në shumën plus 198.643 lekë e cila është më e madhe se diferenca mekanike për të cilën janë llogaritur detyrimet tatimore së bashku me penalitetet perkatëse.

Për vitin 2021 sipas akt konstatimit tuaj keni llogaritur diferencë në vlerën 942.905 lekë si mospërputhje e vlerave të blerjeve me shkallë tatimore 20% të deklaruara në TVSH, krahasuar me vlerën e lëndëve të para dhe materialeve të tjera të hedhura në pasqyrat financiare 2021, duke mos ju përmbajtur Veprimi Kontabël të KOSTOS SË MALLRAVE TË SHITUR, por në mënyrë mekanike përputhni vlerat e deklarimit në TVSH me vlerat e hedhura në llogarinë e blerjeve të lëndëve të para dhe materiale të tjera për vitin duke krijuar diferencë statistikore për vlerësim dhe jo diferenca kontabël (reale)

Ju risqaroj dhe një herë se vlera e blerjeve me shkallë tatimore 20% e deklaruara në TVSH nuk përputhet asnjëherë me vlerën e lëndëve të para dhe materialeve të tjera të hedhura në pasqyrat financiare të të njëjtit vit ushtrimor të llogaritur, pa marrë parasysh dhe gjendjet e inventarit në fillim dhe në fund të vitit në pasqyrat financiare të cilat sjellin ndryshimin në vlerat e blerjeve në plus ose minus me përjashtim të rasteve kur këto vlera inventariale si në fillim dhe në fund të periudhës nuk kanë

ndryshime janë zero ose të barabarta, atëherë qëndron vlerësimi i shkruar nga ana juaj (pra ne rastin konkret kemi rritje te inventarit ne fund te periudhes).

Për të saktësuar gabimin e mësipërm për diferencën për vlerësimin e nënshkruar nga ana juaj unë i jam përmbajtur veprimet kontabël (Ekuacionit bazë) për llogaritjen e Kostos së Mallrave të shitura në vlerë me përshkrimin (Gjendja e mallrave dhe materialeve në fillim të periudhës, plus Blerjet e mallrave dhe materialeve të periudhës, Pakësuar me gjendjen e mallrave dhe materialeve në fund të periudhës rezulton K.M.SH) ku në rastin e kontrollit nga ana ime përputhen vlerat e deklarimit në TVSH me vlerat e hedhura në llogarit e shpenzimeve të pasqyrave financiare në total dhe veçmas për lëndën e parë dhe veçmas për shpenzime të tjera duke marrë parasysh gjendjet e inventarëve në fillim dhe në fund të periudhës të verifikueshëm në pasqyrat financiare nga ana juaj nuk janë marrë parasysh.

Duke mos marrë parasysh gjendjet e inventarëve në fillim dhe në fund të vitit që sjellin ndryshimin e gjendjes të kostua e mallrave të shitura midis deklarimit të blerjeve në TVSH, krahasuar me vlerat e blerjeve të hedhura në pasqyrat financiare po ju paraqes të dhënat e inventarëve të cilat nuk janë marre parasysh nga ana juaj:

- 1.Gjendja e inventarit e lendëve të para në fillim të vitit është në shumën 17.360.235 lekë
- 2.Gjendja e inventarit e lendëve të para në fund të vitit është në shumën 18.482.956 lekë
- 3.Ndryshim gjendjes së inventarëve është (15.510.758-17.360.235) minus (-)1.122.721lekë

Pra vetëm nga të dhënat e më sipërme vlerësimi juaj statistikor në vlerën 942.905 lekë rrezohet 100% dhe mbetet vetëm vlera për vlerësim për diferencën negative prej minus 179.816 lekë (942.905 - 1.122.721) sipas metodës tuaj.

Në raport kontrolli faqe 10 ju mund të lexoni se për këtë mos përputhje të të dhënave sipas faturave të deklaruara në TVSH, krahasuar me të dhënat e hedhura në pasqyrat financiare nga kontrolli ka rezultuar diferenca në shumën minus -94.188 lekë e cila është më e vogël se diferenca mekanike për të cilën janë llogaritur detyrimet tatimore së bashku me penalitetet përkatëse.

Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar DRT Vlorë për Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr.1111/4, datë 13.06.2023 grupi i auditimit gjykon se:

-Në përgjigje të këtyre observacioneve sqarojmë se merren në konsideratë ndryshimet e gjendjes së inventarit në fillim dhe në fund të periudhës për efekt të rakordimit të blerjeve sipas fdp të tvsh dhe shpenzimeve të deklaruara në bilanc dhe fdp e tatim fitimit.

Pretendimi i subjektit mbi M:

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 1111/28 prot., datë 13.06.2024 nga subjekti i audituar DRT Vlorë janë paraqitur observacionet me shkresë nr. 2991/25 prot., datë 10.07.2024, protokolluar në KLSH me nr. 1111/37, datë 15.07.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

-Sipas analizes se audituesve referuar bilancit material per periudhen Shtator – Dhjetor 2021 rezultojne diferenca ne sasi krahasuar me PF. Sqarojme se: Bilanci material per periudhen Shtator-Dhjetor 2021 eshte ndertuar duke marre parasysh sasite kontabël te deklaruara nga tatimpaguesi ne daten 30.06.2021 dhe 31.12.2021. Ai paraqitet si me poshte:

Përshkrimi	Njësi	Gjendja fillestare dhe Hyrjet nga blerjet			Daljet			Cmimi i shitjes	Gjendje ne fund			Vlera e situar	Gjendje kontrolli	Diferenca
		Sasia	kosto	Vlera	Sasia	kosto	Vlera		Sasia	kosto	Vlera			
QYMYR BITUMINOZ	TON	19,404	2,511	22,607,232	24,015	2,511	60,301,665	3,221	3,598	2,404	8,650,061	28%	3,598	-
BITUM NATYRAL	TON	690	22,507	15,235,949	203	22,507	4,568,921	28,994	487	22,079	10,753,813	29%	487	-

Sipas analizes se audituesve referuar bilancit material per periudhen Janar-Dhjetor 2022 gjendja fillestare shtuar dhe hyrjet ka sasi te pamjaftueshme per te shitur mallrat. Sqarojme se:Konstatimi i audituesve eshte i sakte ne gjykimin mbi vlerat te cilat jane paraqitur. Mbasi u analizua situata nga kontrolli konstatohet se ka ndodhur nje gabim ne hedhjen e vlerave invers. Situata duhet te ishte paraqitur si meposhte:

Përshkrimi	Njësi	Gjendja fillesatare dhe Hyrjet nga blerjet			Dalljet			Cmimi i shitjes	Gjendje ne fund			Vlera e shtuar	Gjendje kontrolli	Diferenca
		Sasia	kosto	Vlera	Sasia	kosto	Vlera		Sasia	kosto	Vlera			
QYMYR BITUMINOZ	TON	24,015	2,511	60,301,665	19,404	2,511	22,607,232	3,221	4,611	2,404	11,085,999	28%	3,598	-
BITUM NATYRAL	TON	690	22,507	15,235,949	203	22,507	4,568,921	28,994	487	22,079	10,753,813	29%	487	-

Per post gabimit te mesiperem ne paraqitje nuk ka gabime materiale te cilat ndikojne ne gjenerimin e detyrimeve tatimore shtese apo ne perlllogaritje gabim te tyre. Sipas analizes se audituesve norma e zbritjes se gazoilit nuk duhet te jete 33% por 25% ne koherence me kontrollin e meparshem. Nga ana e audituesit eshte perlllogaritur detyrim tatimor ne vleren 665.801 leke. Sqarojme se: Grupi i kontrollit ka analizuar aktivitetin e tatimpaguesit. Ai ka te beje me germim/shpim, perpunim i materialet inert dhe transport i tij. Ne zbatim të udhezimit nr 6 date 30.01.2015 “Per TVSH-ne” i ndryshuar, grupi i kontrollit per te qene sa me objektiv me aktivitetin e tatimpaguesit e ka klasifikuar si “Prodhim inertesh” me normative kreditimi 33% te vleres se qarkullimit te tatueshem te deklaruar. Përsa pretendohet per koherence me raportin e meparshem te kontrollit sqarojme se keto qendrime i ka sqaruar Drejtoria e Apelimt Tatimor e cila ka zhvleresuar rivleresim e kryera ne ate raport si jo objektive dhe te pabazuara ne legjislacionin tatimor. Persa me siper sqarojme se nuk ka efekte ekonomike per tu analizuar.

Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar DRT Vlorë për Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr.1111/4, datë 13.06.2023 grupi i auditimit gjykon se:

-Bilanci material shërben si element kryesor mbi kreditushmërinë e TVSH, pasi gjatë periudhës së kontrollit konstatohet se është ushtruar aktivitetit i nxjerrës së mineralit.

-Mbi normën e kreditimit të vlerës së qarkullimit të tatueshëm të deklaruar, deri më 33% është normativa që aplikohet për prodhim materiale inerte, ndërkohë për veprimtarinë gërmime/shpime është deri më 25%. Nuk janë sjell argumente të reja nga sa është trajtuar në Projekt Raport dhe si rrjedhojë gjykojmë se nga DRT Vlorë nuk janë sjellë argumente të qenësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

III.2.2.2-Sektori i Kontrollit nga Zyra

Mbi auditimin e ushtruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë, në bazë të programit të auditimit financiar nr. 1111/1 prot, datë 26.12.2023, mbajtur në datë 26.04.2024.

Në zbatim të pikës 2 të Programit të Auditimit “Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor/Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Në zbatim të kësaj çështje të auditimit u shqyrtua dokumentacioni, informacioni dhe të dhënat si më poshtë:

2. Organika e Sektorit të kontrollit nga Zyra dhe monitorimit;
3. Plane mujore të punës;
4. Ndarjet e Nipt-ve sipas inspektorëve;
5. Kasat Fiskale;
6. Deklaratat vjetore në nivel subjekti të TVSH;
7. Tepricat kreditore TVSH-TF-TTHF;
8. Deklaratat e TF-TTHF;
9. Rivlerësimet e kësteve të TF etj.
10. Dokumentacion, shkresa etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

I.a-Objekt i punës të kontrollit tatimor nga Zyra dhe Monitorimit

Sektori i Kontrollit Tatimor nga Zyra dhe Monitorimit ushtron veprimtarinë e tij bazuar në “Rregulloren e funksionimit të administratës rajonale tatimore” miratuar me Urdhër nr. 192, datë

12.08.2020, Manualin për Kontrollin Tatimor si dhe udhëzimet dhe qarkoret e nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm.

Objekt i punës të Kontrollit Tatimor nga Zyra dhe Monitorimit:

Analizon nëpërmjet raporteve të implementuar në sistem, nxjerr konkluzione përkatëse për situata të parregullta të deklaratave të ndryshme tatimore, tatimpaguesit me gjëndje të lartë e të vazhdueshme kreditore TVSH, tatimfitimi, mosdeklarues për lloje të ndryshme tatimi, deklaruesit pa veprimtari apo tatimpaguesit që kanë ndërprerë deklarimin, analizon dhe nxjerr konkluzione nëpërmjet kryqëzimit të librave të shitjes dhe të blerjes për deklarimin e faturave tatimore të shitjes apo blerjes, ndjek procedurat e përthithjes, ndarjes së tatimpaguesve, për transferimin e kredive të tatimeve të ndryshme nga një tatimpagues tek tjetri, kryen rimbursimin e tatimeve të ndryshme tatimore sipas këkesave të tatimpaguesve përveç TVSH-së, etj.

-Nga auditimi u konstatua se në vitin 2021, në Sektorin e Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit janë miratuar 10 punonjës :1 përgjegjës sektori dhe 9 inspektorë.

Përgjatë vitit 2022, në Sektorin e Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, nga totali i strukturës së miratuar prej 10 punonjësish rezulton se 1 punonjës është dorëhequr nga detyra dhe në vendin e tij ka kaluar 1 punonjës tjetër sipas Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve me emërtimin “Transferim të përhershëm”, pas shqyrtimeve të propozimeve të Komisionit të Ristrukturimit në DPT.

II.b-Struktura e Sektorit Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit

Struktura e miratuar me Urdhrin Nr. 33, datë 12.02.2020 “Për Miratimin e Strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore” ka përfunduar në datën 03.08.2020.

Sektori Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, në strukturën organizative është e përbërë nga 10 pozicione pune, ku nga auditimi rezulton se një pozicion pune (inspektor i dytë), është vakant.

Tabela nr. 1: “Struktura e Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit”

Drejtoria e Kontrollit (SKZM)	Struktura	Vakanca
Përgjegjës Sektori	1	0
Inspektor	9	1
Total	9	1

Burimi i të dhënave: DRT Vlorë; Punoi: KLSH

Nga auditimi u konstatua se Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit për periudhën e auditimit disponon plane mujore dhe vjetore. Në këto plane përcaktohen objektivat, ndarjet e detyrave për inspektorët për të monitoruar subjektet në mënyrë të vazhdueshme.

III.c- Veprimtaria e Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit

Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit ushtron veprimtarinë sipas planeve mujore dhe vjetore të punës sipas përcaktimeve të Manualit për Kontrollin Tatimor nga Zyra dhe Monitorimit. Për periudhën e auditimit disponon plane mujore dhe vjetore ku përcaktohen objektivat, ndarjet e detyrave për inspektorët për të monitoruar subjektet në mënyrë të vazhdueshme.

II. Ndarja e NIPT-eve sipas Inspektorëve

Grupit të auditimit i janë vënë në dispozicion 5 shkresa dhe email në lidhje me ndarjen e subjekteve si në vijim:

- Shkresa nr. 7290 prot, datë 06.08.2020, drejtuar Inspektorëve të Kontrollit nga Zyra
- Shkresa nr. 1674 prot, datë 16.04.2021, drejtuar Inspektorëve të Kontrollit nga Zyra
- Shkresa nr. 3397 prot, datë 15.06.2021, drejtuar Inspektorëve të Kontrollit nga Zyra
- Shkresa nr. 30 prot, datë 06.01.2022, drejtuar Inspektorëve të Kontrollit nga Zyra
- Me email datë 21.11.2022, për shpërndarjen e nipteve për inspektorët Mirela Bejo dhe Arditë Rushitaj
- Shkresa nr. 641 prot, datë 01.02.2023, drejtuar Inspektorëve të Kontrollit nga Zyra

Memot janë të përgatitura nga Përgjegjësi i Sektorit, aprovuar nga Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit dhe miratuar nga Drejtori Rajonal, në përputhje me Manualin e Kontrollit.

Në një rast ndarja e nipteve është bërë me email dhe je mo shkresë, si më sipër, në kundërshtim me përcaktimet e Manualit për Kontrollin Tatimor nga Zyra dhe Monitorimit, pika 4.

IV.d- Kasat Fiskale

Nga auditimi u kryqëzuan të dhënat e marra nga D.R.T. Vlorë në lidhje me kasat fiskale dhe gabimet e kasave. Grupi i auditimit përpunoi të dhënat për të nxjerrë xhiron e korrektuar të subjekteve dhe konstatoj sa më poshtë:

Tabela nr. 2- Kasat fiskale

(në lekë)

Vitet	Totali i Xhiros nga Kasa	Gabime Kasa	Xhiro e korrektuar
2021	16,637,329,944	(7,514,259,113)	24,151,589,057
2022	64,342,985,261,128,900	64,342,900,283,902,000	84,977,226,905
2023	102,935,587,194	(1,203,646,329)	104,139,233,523

Burimi i të dhënave: DRT Vlorë; Punoi: KLSH

Të dhënat për diferencat e sipërcituara nuk gjenerojnë detyrime tatimore, pasi evidentohen që janë rastësore në vlera shumë të larta referuar statusit dhe përgjegjësive tatimore të tatimpaguesve që kanë raportuar gabimet për të gjithë periudhën objekt auditimi sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 3- Xhiro me gabime dhe xhiro e korrektuar

NIPT	Xhiro me gabime	Xhiro e korrektuar	Viti
LN	(7,514,259,113)	0	2021
KI	(1,197,794,534)	256,392,538	2022
LB	(8,233,992,709)	90,031,656	2022
KH	1,571,786,507	93,983,658	2022
LU	(1,363,356,539,401)	-	2022
LQ	64,344,271,940,850,100	-	2022
LK	-1157267746	46378583	2023

Burimi i të dhënave: DRT Vlorë; Punoi: KLSH

Në vijim nga grupi i auditimit u bën testet përkatëse, ku u kryqëzua qarkullimi sipas kasës (zbritur gabimet e kasës) dhe të ardhurat në deklaratën e TTHF ku u konstatuan diferenca si në vijim klasifikuar sipas llojit të përgjegjësive si më poshtë:

Tabela nr. 4 “Qarkullimi sipas kasës dhe të ardhurat në deklaratën e TTHF- 2021” (në Lekë)

Tatimapaguesi	Të ardhurat Tatimore totale	Shitje total sipas kasës	Diferenca total	Rastet e Diferencave
BM	2,986,449,615	1,747,680,200	1,238,769,415	477
BV me TVSH	1,102,692,191	319,580,253	783,111,938	617
BV pa TVSH	5,310,428,578	850,116,548	4,460,312,030	4,901
Të tjera	210,927,915	23,924,629	187,003,286	176

Total	9,610,498,299	2,941,301,630	6,669,196,669	6,171
--------------	----------------------	----------------------	----------------------	--------------

Burimi i të dhënave: DRT Vlorë; Punoi: KLSH

Tabela nr. 5 “Qarkullimi sipas kasës dhe të ardhurat në deklaratën e TTHF- 2022” (në Lekë)

Tatimapaguesi	Të ardhurat Tatimore totale	Shitje total sipas kasës	Diferenca total	Rastet e Diferencave
BM	2,381,610,589	5,232,496,500	(2,850,885,911)	415
BV me TVSH	1,339,667,335	1,400,758,202	(61,090,867)	636
BV pa TVSH	7,119,278,821	8,208,470,500	(1,089,191,679)	5025
Të tjera	135,876,223	102,664,133	33,212,090	95
Grand Total	10,976,432,968	14,944,389,335	(3,967,956,367)	6171

Burimi i të dhënave: DRT Vlorë; Punoi: KLSH

Për subjektet e kategorizuara si biznes i vogël pa TVSH në diferencat e konstatuara ndërmjet TTHF dhe xhiros sipas kasës, e ardhura maksimale nuk e kalon kufirin e qarkullimit prej 14 milion lekë ku fillon shkalla tatimore prej 15%, për këtë arsye nuk janë konstatuar detyrime tatimore si pasojë e këtyre diferencave.

4.1. Diferencat e kasave për biznesin e vogël me TVSH

Për bizneset e vogla me TVSH u kryqëzua qarkullimi sipas kasës së saktësuar nga gabimet dhe të ardhurat në deklaratën e TTFH ku u konstatuan diferenca për vitin 2021 në 617 tatimpagues në shumën 783,111,938 lekë dhe për vitin 2022 në 636 tatimpagues në shumën negative (61,090,867) lekë (pra shitjet sipas kasës janë më të larta se ato të raportuara në deklaratën e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin). Nga këto diferenca, u përzgjedhën sipas vlerës më lartë dhe me efektin më të madh në tatimin mbi vlerën e shtuar dhe tatim mbi fitim të mundshëm disa raste përgjatë viteve 2021 dhe 2022, nga ku rezultuan me problematikat diferencat e mëposhtme:

Tabela nr. 6 “Diferencat e kasave për biznesin e vogël me TVSH 2021- 2022” (në Lekë)

Viti	NIPT	Të ardhurat Tatimore	Shitje CPCMC(kasa)	Xhiro sipas FDP TVSH	TR sipas DTF	Diferenca per TVSH	Diferenca per TF
2022	LT	17,260,350	18,410,699	17,260,350	0		4,410,699
2022	LM	5,760,215	5,760,215	-	0		
2022	MN	-	3,647,580	-	0	3,647,580	
2022	LO	-	1,650,265	643,339	0	731,882	
2021	MN	-	4,889,688	-	0	4,889,688	
2021	MF	-	1,101,024	178,693	0	1,101,024	
TOTALI						10,370,174	4,410,699

Burimi i të dhënave: DRT Vlorë; Punoi: KLSH

Për subjektet e mësipërm nuk është vepruar me sistemimin dhe saktësimin e këtyre diferencave sipas kasës dhe të ardhurave në deklaratën e TTHF për secilin vit dhe sipas subjekteve dhe do të vlerësohen paraprakisht efektet financiare duke llogaritur të ardhurat e munguara si dhe vlerën e gjobave.

Efektet financiar:

- TVSH për tu paguar detyrim $10,370,174 * 20\% = 2,146,034$ lekë.

Gjobë 100% TVSH = 2,146,034 për shitje të padeklaruara në deklaratën e fdp.

-Tatim fitimi për tu paguar detyrim $4,410,699 * 15\% = 661,604$ lekë.

Gjobë 100% Tatim fitimi = 661,604 lekë për mos plotësim deklarate të tatim fitimit pavarësisht kalimit të pragut të xhiros prej 14,000,000 lekësh për vitin përkatës.

Nga sa më sipër vlerësohet paraprakisht se diferenca sipas kasës dhe të ardhurave në deklaratën e TTHF- në për 4 subjekte në vitin 2021 dhe 2022 ka sjellë një total të ardhura të munguara për

TVSH gjithsej 4,292,068 lekë, nga të cilat 50% janë vlerat e gjobave dhe për 1 tatimpagues të ardhura të munguara për tatim fitimin në shumë 1,323,209 lekë nga të cilat 50% janë vlerat e gjobave.

Total detyrim i konstatuar në shumën 5,615,277 lekë.

4.2. Diferencat e kasave biznesi i madh.

Për periudhën objekt auditimi, bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga DRT Vlorë janë kryer kryqëzimet e të ardhurave të raportuara në kasa fiskale me të ardhurat e deklaruara në FDP të TVSH si dhe FDP të tatim fitimit për periudhën që ato janë dorëzuar. **Në vijim për bizneset e mëdha u kryqëzua qarkullimi sipas kasës dhe shitjet sipas deklaratës së TVSH-së.** (Shumatore e plotë e kategorive: shitje të përjashtuara nga TVSH, shitje pa TVSH, eksporte mallrash, furnizime me shkallë 0%, shitje të tatueshme me shkallë 20%, TVSH e llogaritur shitje të tatueshme me shkallë 20%, shitje të tatueshme me shkallë 10%, TVSH e llogaritur shitje të tatueshme me shkallë 10%, shitje të tatueshme me shkallë 6%, TVSH e llogaritur shitje të tatueshme me 6%, shitje të tatueshme sipas regjimeve të agjentit të udhëtimit, TVSH e llogaritur sipas agjentit të udhëtimit). Duke vlerësuar riskun, në testim u morën rastet kur xhiroja sipas kasës rezultonte më e madhe se shitjet sipas deklaratës së TVSH-së dhe asaj të tatim fitimit sipas rastit të renditura nga diferenca më e madhe të më e vogla, duke përzgjedhur kampionin sipas Anekseve nr. 4 për vitin 2021 dhe nr. 5 për vitin 2022, ku u konstatuan detyrime tatimore sipas rasteve në vijim:

Konkretisht për **vitin 2021**, kanë rezultuar diferenca nga të cilat janë përzgjedhur për auditim vlerat më përfaqësuese si më poshtë:

Tabela nr. 7 “Diferencat e kasave për biznesin e madh viti 2021”

NIPT	Lloji	Të ardhurat Tatimore TTHF	Shitje CPCPC(kasa)	Kasa pa TVSH	Xhiro sipas FDP TVSH	TR sipas DTF	Diferenca kasa - TTFH	Diferenca e padeklaruar për efekt TVSH	Diferenca me efekte neTF
LG	BM	17,868,487	85,336,500		25,953,127	8,084,640	67,468,013		59,383,373
MD	BM	49,787,640	49,685,335		49,685,335	-	-102,305		0
MR	BM	16,052,771	38,065,925	31,721,604	27,324,679	11,271,908	22,013,154		10,741,246
LL	BM	14,000,000	30,720,722	25,600,602	16,033,048	4,445,910	16,720,722		12,274,812
MQ	BM	20,320,661	27,597,646	22,998,038	22,998,110	2,677,408	7,276,985		4,599,577
MA	BM	16,391,828	16,391,828		16,391,828	-	0		0
MD	BM	12,509,667	24,328,084	20,273,403	24,498,400	11,988,737	11,818,417		0
LK	BM	10,784,964	14,175,276	11,812,730	16,872,065	6,087,101	3,390,312		0
LP	BM	18,114,091	66,202,102	55,168,418	18,114,091	-	48,088,011	29,973,920	48,088,011
Diferenca ne total								29,973,920	135,087,019

Burimi i të dhënave: DRT Vlorë; Punoi: KLSH

Efektet financiar:

-TVSH për tu paguar detyrim 29,973,920* 20% = 5,994,784 lekë

Gjobë 100% TVSH = **5,994,784** për shitje të padeklaruar në deklaratën e fdp.

Për sa më sipër, diferenca ndërmjet kasës dhe deklaratës së TVSH ka sjellë të ardhura të munguara për TVSH në 1 raste për vitin 2021 në shumën **11,989,568** lekë nga të cilat 50% janë gjoba.

-Tatim fitimi për tu paguar detyrim 135,087,019 * 15% = 20,263,052 lekë.

Gjobë 100% Tatim fitimi=**20,263,052** lekë për mos plotësim deklarate të tatim fitimit pavarësisht kalimit të pragut të xhiros prej 14,000,000 lekësh për vitin përkatës.

Për sa më sipër, diferenca ndërmejt kasës dhe deklaratës së tatimit të thjeshtuar, ndërkohë që duhet të kishte plotësuar të plotë deklaratën e tatimit mbi fitimin për shkak të kalimit të xhiros

prej 14 milion lekë, përfshin detyrim për tatim fitimin në shumën **40,526,104 lekë** nga të cilat 50% janë gjobë.

-Për vitin 2022, nga i njejt kryqëzim i të dhënave rezultojnë diferenca, ku janë përzgjedhur për auditim rastet me vlera më të larta si më poshtë:

Tabela nr. 7 “Diferencat e kasave për biznesin e madh viti 2022”

NIPT	Lloji	Të ardhurat Tatimore	Shitje CPCMC(kasa)	Kasa pa TVSH	Xhiro sipas FDP TVSH	TR sipas DTF	Diferenca kase fdp tvsh	Diferenca Kasa TFTH	Diferenca kase TF	Diferenca per per efekt TF
MJ	BM	-	137,665,403	114,721,169	125,472,274	114,721,175	12,193,129	137,665,403	0	0
LN	BM	13,740,714	39,660,057	33,050,048	33,050,047	19,309,333	6,610,010	25,919,343	2,290,120	2,290,120
MI	BM	-	19,948,293	16,623,578	34,977,185	-	15,028,892	19,948,293	16,623,578	16,623,578
MT	BM	-	18,779,342	-	16,531,049	-	2,248,293	18,779,342	15,649,452	15,649,452
LM	BM	18,575,990	19,334,920	16,112,433	654,643	654,643	18,680,277	758,930	-22,201	-22,201
MD	BM	8,000,000	60,714,179	50,595,149	50,697,185	42,697,186	10,016,994	52,714,179	1,231,297	1,231,297
MC	BM	12,534,044	37,148,410	30,957,008	26,019,686	19,157,856	11,128,724	24,614,366	1,354,116	1,354,116
ME	BM	13,427,185	25,666,554	21,388,795	21,388,795	7,961,610	4,277,759	12,239,369	2,237,864	2,237,864
MT	BM	17,572,240	17,572,240	14,643,533	-	-	17,572,240	0	0	0
LK	BM	13,381,028	22,341,270	18,617,725	19,969,884	6,588,856	2,371,386	8,960,242	878,012	878,012
MR	BM	15,365,795	15,365,795	12,804,829	-	-	15,365,795	0	0	0
MU	BM	15,080,950	17,943,796	14,953,163	6,963,345	2,599,115	10,980,451	2,862,846	-213,410	-213,410
ME	BM	12,276,113	18,243,676	15,203,063	15,291,603	3,015,490	2,952,073	5,967,563	1,957,479	1,957,479
MD	BM	13,994,177	29,938,943	24,949,119	15,944,766	15,944,766	13,994,177	15,944,766	-2,657,461	-2,657,461
MR	BM	10,464,176	17,545,698	14,621,415	15,071,196	4,607,020	2,474,502	7,081,522	1,294,248	1,294,248
Diferenca ne total										40,623,093

Burimi i të dhënave: DRT Vlorë; Punoi: KLSH

Efekti financiar:

Tatim fitimi për tu paguar detyrim $40,623,093 * 15\% = 6,093,463$ lekë

Gjobë 100% Tatim fitimi=**6,093,463** lekë për mos plotësim deklarate të tatim fitimit pavarësisht kalimit të pragut të xhiros prej 14,000,000 lekësh për vitin përkatës.

Për sa më sipër, diferenca ndërmejt kasës dhe deklaratës së tatimit të thjeshtuar, ndërkohë që duhet të kishte plotësuar të plotë deklaratën e tatimit mbi fitimin për shkak të kalimit të xhiros prej 14 milion lekë, përfshin detyrim për tatim fitimin në shumën **12,186,927** lekë nga të cilat 50% janë gjobë.

4.3. Subjekte që rezultojnë debitorë në TF

a-Nisur nga deklarata e TF 2020 si dhe të dhënave të përpunuara, nga informacioni vënë në dispozicion grupit të auditimit, rezultojnë debitorë në mos likuidimin e TF të vetdeklaruar si në vijim:

Tabela nr.8 “Subjekte që rezultojnë debitorë në TF 2020”

(Në Lekë)

Subjekti 2020	Detyrimi Principal	Interesa	Gjoha	Detyrimi Total
Aktiv	24,403,680	524,722	2,542,708	27,471,110
Kërkesë për Çregjistrim	49,367	10,287	124,055	183,709
Pasiv	1,671,575	0	1,094,542	2,766,117
Total	26,124,622	535,009	3,761,305	30,420,936

Shënim: Burimi i të dhënave: DRT Vlorë; Punoi: KLSH

Për sa më sipër konstatohen subjekte, të cilët kanë kryer deklarimin e TF për vitin 2020 dhe nuk kanë kryer pagesën e këtij detyrimi në vlerën 30,420,936 lekë (sipas zërave përbërës), vlerë e cila duhet të ishte e arkëtuar brenda 31.12.2021.

b-Nisur nga deklarata e TF për vitin 2021 si dhe të dhënave të përpunuara, nga informacioni vënë në dispozicion grupit të auditimit, rezultojnë debitorë në mos likuidimin e TF të vetdeklaruar si në vijim:

Tabela nr.9- “Subjekte që rezultojnë debitorë në TF 2021”

(Në Lekë)

Subjekti 2021	Detyrimi Principal	Interesa	Gjoha	Detyrimi Total
Aktiv	32,857,796	650,472	5,478,102	38,986,370
Kërkesë për Çregjistrim	25,000	881	110,333	136,214
Pasiv	1,453,104	0	1,088,336	2,541,440
Total	34,335,900	651,353	6,676,771	41,664,024

Shënim: Burimi i të dhënave: DRT Vlorë; Punoi: KLSH

Për sa më sipër konstatohen subjekte, të cilët kanë kryer deklarimin e TF për vitin 2021 dhe nuk kanë kryer pagesën e këtij detyrimi në vlerën 41,664,024 lekë (sipas zërave përbërës), vlerë e cila duhet të ishte e arkëtuar brenda 31.12.2022.

c-Nisur nga deklarata e TF për vitin 2022 si dhe të dhënave të përpunuara, nga informacioni vënë në dispozicion grupit të auditimit, rezultojnë debitorë në mos likuidimin e TF të vetdeklaruar si në vijim:

Tabela nr.10- “Subjekte që rezultojnë debitorë në TF 2022”

(Në Lekë)

Subjekti 2022	Detyrimi Principal	Interesa	Gjoha	Detyrimi Total
Aktiv	84,267,506	2,716,973	8,676,023	95,660,502
Kërkesë për Çregjistrim	0	0	24,500	24,500
Pasiv	1,149,048	0	510,845	1,659,893
Total	85,416,554	2,716,973	9,211,368	97,344,895

Burimi i të dhënave: DRT Vlorë; Punoi: KLSH

Për sa më sipër konstatohen subjekte, të cilët kanë kryer deklarimin e TF për vitin 2022 dhe nuk kanë kryer pagesën e këtij detyrimi në vlerën 97,344,895 lekë (sipas zërave përbërës), vlerë e cila duhet të ishte e arkëtuar brenda 31.03.2022.

Për periudhën objekt auditimi rezulton detyrim i pa mbledhur nga DRT Vlorë në bashkëpunim me Drejtorin e Mbledhjes së Borxhit, Rajoni Jugor.

5- Tatimpaguesit me tepricë kreditore të TVSH

Përgjatë periudhës objekt auditimit është konstatuar rritje e tepricës kreditore të TVSH nga viti në vit dhe në numër tatimpaguesish e paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.11- “Teprica kreditore e TVSH-së 2021-2023”

Viti	2021	2,022	2,023
Vlera e tepricës së TVSH kreditore	708,485,919	1,039,466,438	2,119,974,572
Nurmi i subjekteve	1721	1997	2630

Burimi i të dhënave: DRT Vlorë; Punoi: KLSH

Nga databaza e tepricave kreditore të TVSH-së u përzgjedhën subjektet (Top 50) me tepricën më të lartë kreditore për periudhën tatimore deri në Dhjetor 2023 dhe krahasimi edhe për vitet e tjera nën auditim, të detajuar në Tabelën-“Lista (Top 50) subjekteve me tepricë kreditore të TVSH-së 2021-2023”, në seksionin Anekse.

Pavarësisht se konstatohet një rritje si pasojë e rritjes në aktivitetin e hotelierisë dhe rritjen e tepricës kreditore si pasojë e rolit të investitorit të aseteve për të cilat kreditohet TVSH, nga ana tjetër konstatohet rritje të tepricës edhe në sektorë të tjerë që përfshijnë tregti apo prodhim. Për sa më sipër, konstatohet se për periudhën e auditimit, kemi subjekte me tepricë kreditore kryesisht në rritje me aktivitet tregti dhe prodhim të cilat rrisin riskun e evazionit nëpërmjet mosdeklarimit

të shitjeve. Këto subjekte mbajnë peshën më të madhe dhe teprica kreditore e tyre është rritur ndjeshëm nga 01.01.2021 deri më 31.12.2023. Fakti që teprica kreditore nuk ndryshon apo ka pësuar rritje, nga ana e Inspektorit përkatës për këtë periudhë nuk është kërkuar informacion, analizuar apo propozuar për kontroll, kjo tregon veprime dhe mos veprime që ndikojnë në uljen e performancës në lidhje me deklaratimet tatimore të tatimpaguesit. Për këta subjekte nuk është kryer verifikimi në vend nëpërmjet kombinimit me sektorin e zbatimit/DVT nëse kanë gjendje malli apo aktive në vendndodhjet e deklaruara të biznesit.

5.1-Teprica kreditore e Tatim Fitimit

Nga të dhënat e marra lidhur me ecurinë e tepricës kreditore të Tatim Fitimit rezulton se në DRT Vlorë, teprica kreditore e tatim fitimit për vitet 2021 është në shumën 259,005,247 lekë për 1089 tatimpagues dhe për vitin 2022 është në shumën 290,282,090 lekë për 1198 tatimpagues. Kostatohet një rritje në rreth 31 milion lekë në tepricën kreditore të tatim fitimit dhe një rritje me rreth 100 tatimpagues të rinj që kanë akumuluar tepricë kreditore të TVSH. Lista me 30 subjektet më përfaqësuese në vlerë për vitin 2021 dhe 2022 në tepricën e lartë kreditore të tatim fitimit të akumuluar paraqitet në aneksin nr. 6 “Teprica kreditore e tatim fitimit per vitet 2021 dhe 2022 per 30 subjektet me te medha ne vlere te renditura”. **Për sa më sipër konstatohet një monitorim i dobët për këto biznese, veçanërisht për kategorinë Biznes i madh, i cilësuar me risk të lartë.**

6- Këstet e Tatim Fitimit në ulje

Grupi i auditimit testoi qarkullimin e subjekteve që kanë paraqitur kërkesë për ulje të kësteve të tatim fitimit ku rezultoi si në vijim:

Tabela nr.13 “Kërkesat për uljen e këstit të T.F”

Nr.	Nipti	Subjekti	Periudha e pranimit	Kesti Fillestar	Kesti Rivlersuar	Diferenca
1	LK	A	2023/09-2023/12	1186005	0	(1186005)
2	LO	M	2023/09-2023/12	983575	0	(983575)
3	MB	A	2023/09-2023/12	271613	0	(271613)
4	MF	Ë	2023/09-2023/12	45923	0	(45923)
5	LO	A	2023/09-2023/12	409283	0	(409283)
6	MV	V	2023/09-2023/12	226895	0	(226895)
7	JT	L	2023/09-2023/12	613705	0	(613705)
8	LO	M	2023/09-2023/12	128661	0	(128661)
9	JG	H	2023/09-2023/12	136839	0	(136839)
10	LC	2	2023/09-2023/12	349544	0	(349544)
11	LA	A	2023/09-2023/12	50364	0	(50364)
12	LK	S	2023/09-2023/12	100186	0	(100186)
13	LN	H	2023/09-2023/12	378533	0	(378533)
14	MF	C	2023/09-2023/12	51383	0	(51383)
15	KJ	K	2023/09-2023/12	164586	0	(164586)

Burimi i të dhënave: DRT Vlorë; Punoi: KLSH

Nga auditimi i vlerësimit të kërkesave të subjekteve në lidhje me uljen e kësteve të tatim fitimit të cilat kanë vlerat më të mëdha të kërkuara rezultojnë 15 subjekte, nga trajtimi i të cilave është miratuar ulja sipas kërkesave referuar përcaktimeve të Aktit Normativ Nr. 2, datë 07.06.2023 për disa shtesa në Ligjin Nr. 29/2023 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” neni 69 “Dispozita kalimtare”, pika 4 “Përfshimisht parashikimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, tatimpaguesit, eksportues të mallrave në regjimin e përpunimit aktiv, të cilët në vitin 2022 kanë eksportuar jo më pak se 70% të vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet, nuk paguajnë këstet që parapaguhet në muajt qershor, shtator dhe dhjetor të

vitit 2023” dhe në zbatim të e-mailit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatmeve, Tiranë datë 16/08/2023 për zbatimin e ketij akti.

7- Pagesa me vonesë e kësteve të tatimit mbi fitimin dhe efektet e penaliteteve

Nga auditimi u konstatuan tatimpagues që nuk kanë paguar këstet e Tatim Fitimit bazuar në Ligjin 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në R.SH” i ndryshuar, Neni 114/1 - “Mospagimi në afat i kësteve paraprake të tatim mbi fitimin, i ndryshuar me Ligj Nr. 112/2016, datë 03.11.2016, dënohet me gjobë në masën 10 për qind të shumës së këstit për t’u paguar.

-Kjo problematikë është konstatuar në 96 tatimpagues për vitin 2021 të cilët mund të kenë pasur më shumë se një vonesë në këstet e vitit me një efekt total në vonesë të detyrimit tatimor në shumën 61,952,134 lekë, trajtuar hollësisht **Aneksi 7-“Kestet e tatim fitimit të paguara me vonesë, vendosja e penaliteteve, viti 2021”**. Nga verifikimet dhe sqarimet e dhëna nga inspektorët, njoftim vlerësimet bashkëngjitur observacioneve, rezulton se nga 25 raste të konstatuara në akt konstatimi, vetëm në 7 raste me efekt totale në vonesë të detyrimit tatimor në shumën **6,110,477 lekë** nuk është vendosur penalti në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në R.SH” i ndryshuar, Neni 114/1 - “Mospagimi në afat i kësteve paraprake të tatim mbi fitimin, i ndryshuar, për pasojë efekti financiar është në vlerën totale **611,477 lekë (6,110,477 *10%)**.

-Kjo problematikë është konstatuar në 66 tatimpagues për vitin 2022 të cilët mund të kenë pasur më shumë se një vonesë në këstet e vitit me një efekt totale në vonesë të detyrimit tatimor në shumën 30,335,717 lekë, trajtuar hollësisht **Aneksi 8-“Kestet e tatim fitimit të paguara me vonesë, vendosja e penaliteteve, viti 2021”**. Nga verifikimet dhe sqarimet e dhëna nga inspektorët dhe të dhënat e gjeneruara nga sistemi C@ts, njoftim vlerësimet, bashkëngjitur observacioneve, rezulton se janë vendosur gjoba në të gjitha rastet evidentuara me vonesa në pagesën e tatim fitimit.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore si më poshtë:

- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.92/2014 datë 24.07.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr.5, datë 30.01.2006 për “Tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar;
- Udhëzimin nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë;
- Rregulloren e Funkionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin nr.192, datë 12.08.2020;
- Neni 60 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimi”;
- Neni 61 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Përgjegjësitë të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimi”;
- Neni 57 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Drejtoritë të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në Drejtoritë e tjera Rajonale”;
- Neni 4 “Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore”;
- Manuali i Kontrollit Tatimor nga Zyra dhe Monitorimi.

Për mangësitë e konstatuara ngarkohen me përgjegjësi, rast pas rasti, sipas subjekteve për kontroll, punonjësit si më poshtë:

- 1- z. R K, znj. D F, znj. AR, zj. L K, znj. K K, z. O Sh, z. I R, z. M B, z. A H, z. B K, z. A M, në detyrën e inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit pranë Drejtorisë Rajonale Tatime Vlorë.
- 2- z. S B, në detyrën e Përgjegjësit të Sektorit të Kontrollit Tatimor nga Zyra dhe Monitorimit pranë Drejtorisë Rajonale Tatime Vlorë.
- 3- z. B P, në detyrën e Drejtorit të Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatime Vlorë.
- 4- z. S K, në cilësinë e ish-Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatime Vlorë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2991/25 prot, datë 10.07.2024 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", administruar në KLSH me nr. 1111/37 prot, datë 15.07.2024, nga Z. S B me detyrë Përgjegjës i Sektorit Kontrollit nga Zyra pranë DRT Vlorë, Znj. D F me detyrë Inspektor e Kontrollit nga Zyra pranë DRT Vlorë, Z. R K me detyrë Inspektor i Kontrollit nga Zyra pranë DRT Vlorë, Z. B K me detyrë Inspektor i Kontrollit nga Zyra pranë DRT Vlorë, Znj. A R me detyrë Inspektor i Kontrollit nga Zyra pranë DRT Vlorë, Z. I R me detyrë Inspektor i Kontrollit nga Zyra pranë DRT Vlorë, Z. O S, me detyrë Inspektor i Kontrollit nga Zyra pranë DRT Vlorë, Z. A M me detyrë Inspektor i Kontrollit nga Zyra pranë DRT Vlorë, Znj. M B me detyrë Inspektor i Kontrollit nga Zyra pranë DRT Vlorë, Znj. L. K. me detyrë Inspektor i Kontrollit nga Zyra pranë DRT Vlorë, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Referuar pikës II “Ndarja e NIPT – ve sipas inspektorëve” :

Sipas grupit të auditimit, rasti i ndarjes së nipt – ve, me e – mail dhe jo me shkresë, është bërë në kundërshtim me përcaktimet e Manualit për Kontrollin Tatimor nga Zyra dhe Monitorimit po ju sqarojmë se:

Për periudhën Nëntor-Dhjetor 2022, në sektorin e kontrollit nga zyra dhe monitorimit, me shkresë nr. 16019/5 datë 11/11/2022 nga Drejtoria e Përgjithsme e Tatimeve (DPT), u transferua në këtë sektor inspektorja znj. M B. Për shkak të periudhës së shkurtër 2- mujore, nga riorganizimi dhe shpërndarja e re e nipt - ve që bëhet në muajin janar të vitit pasardhës, dhe për shkak të emergjencave të punës është dërguar e – mail nga Drejtori i Kontrollit Operacional për shpërndarjen e nipt-ve për inspektorët M B dhe A Rj.

Referuar pikës 4.1 “Diferencat e kasave për biznesin e vogël me TVSH ” dhe 4.2 “Diferencat e kasave për biznesin e madh ”:

Diferencat sipas kasës dhe të ardhurave në deklaratën e TFTH për secilin vit dhe sipas subjekteve në tabelën nr. 6 dhe diferencat e kasave për biznesin e madh sipas tabelës nr. 7, janë shpjeguar në sqarimet dhe komentet e dhëna nga secili inspektor për nipt-et përkatës nën administrim. Për këtë arsye efekti financiar i llogaritur nuk qëndron.

Referuar pikës 4.3 “Subjekte që rezultojnë debitorë në TF”:

Subjekte që rezultojnë debitorë në TF për vitin 2020-2021-2022, është detyrë funksionale e Drejtorisë së Mbledhjes së Borxhit, Rajoni Jugor dhe nuk është detyrë e Kontrollit nga Zyra.

Referuar pikës 5 “Tatimpagues me tepricë kreditorë të TVSH-së”:

Teprica kreditorë e TVSH-së, për subjektet e përzgjedhura në tabelën nr.12 për periudhën krahasimore 2021-2022-2023, konstatohet në rritje si pasojë e rritjes së investimeve në aktivitetin e hotelierisë, ndërtimit dhe fillimit të aktivitetit tregëtar. Për këtë arsye po ju sqarojmë se të gjithë subjektet e rinj, që janë regjistruar sipas viteve përkatëse për ushtrimin e aktivitetit ekonomik, kanë rritje të tepricës kreditorë për arsye të investimit. Ndërsa për subjektet e tjera është kërkuar informacion dhe janë ushtruar kontrole të thelluar ku është analizuar dhe teprica kreditorë sipas programit të njoftimit për kontroll. Për secilin subjekt të tabelës nr.12 është dhënë sqarim në “Komente dhe Sqarime” për “Grupin e Auditimit të KLSH - së” nga secili inspektor për niptet që ka nën administrim sipas vitit përkatës.

Referuar pikës 6 “Këstet e tatim fitimit në ulje”:

Zerimi i kësteve të tatim fitimit për subjektet fason është bërë në zbatim të Aktit Normativ Nr. 2, datë 07/06/2023 për disa shtesa në Ligjin Nr. 29/2023 “ Për Tatimin mbi të Ardhurat ” neni 69 “Dispozita kalimtare ”, pika 4 “ Përjashtimisht parashikimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, tatimpaguesit, eksportues të mallrave në regjimin e përpunimit aktiv, të cilët në vitin 2022 kanë eksportuar jo më pak se 70% të vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet, nuk paguajnë këstet që parapaguhen në muajt qershor, shtator dhe dhjetor të vitit 2023” dhe në zbatim të e-mailit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Tiranë datë 16/08/2023 për zbatimin e ketij akti.

Referuar pikës 7 “Pagesa me vonesë e kësteve të tatimit mbi fitimin dhe efektet e penaliteteve”:

Sipas grupit të auditimit, në 25 raste, trajtuar në Aneks 7 “Këstet e tatim fitimit të paguara me vonesë, vendosja e penaliteteve vitit 2021” dhe në 12 raste, trajtuar në Aneks 8 “Këstet e tatim fitimit të paguara me vonesë, vendosja e penaliteteve vitit 2022”, rezulton se nga Grupit i Auditimit të KLSH-së janë marrë në konsideratë shpejgimet e dhëna në “Sqarime dhe komente” të paraqitura tek “Qëndrimi i Grupit të Auditimit”.

Sqarime dhe komente nga inspektori R K

Në përgjigje të Projekt Raport Auditimit, po ju sqarojmë si më poshtë:

Përsa u përket kësteve të tatim-fitimit në ulje, faqe 9 e Akt-konstatimit, për tatimpaguesit nën administrim: “2” me nipt-LC dhe “A” me nipt-LA, ulja e kësteve nuk është kryer nga kërkesa e tatimpaguesit, por bazuar te Akti Normativ Nr.2, datë 07/06/2023 “Për disa shtesa në Ligjin Nr.29/2023 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, neni 69 “Dispozita kalimtare”, pika 4, ku citohet:

4. Përjashtimisht parashikimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, tatimpaguesit, eksportues të mallrave në regjimin e përpunimit aktiv, të cilët në vitin 2022 kanë eksportuar jo më pak se 70% të vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet, nuk paguajnë këstet që parapaguhen në muajt qershor, shtator dhe dhjetor të vitit 2023.

Po ashtu, në zbatim të e-mailit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Tiranë për zbatimin e ketij Akti Normativ janë hequr (zeruar) këstet e tatim fitimit për muajt Shtator, Tetor, Nëntor dhe Dhjetor, për arsye se tatimpaguesit ushtrojnë aktivitet eksportues të mallrave në regjimin e përpunimit aktiv.

Si rrjedhojë, ky pretendim është sqaruar.

Te aneksi Nr.2, faqe 13 “Diferencat e kasave për biznesin e madh viti 2021”, ju sqaroj se tatimaguesin “L Z” me nipt-LL nuk e kam pasur në administrim.

Si rrjedhojë, ky pretendim është sqaruar.

Te aneksi Nr.4, faqe 15 “Diferencat e BM kasë, TVSH, tatim-fitimi për vitin 2021”, ju sqaroj se për tatimaguesin “V” me nipt-LE situata është e tillë, që gjatë vitit ka kaluar me përgjegjësinë tatim-fitimi. Diferenca nuk ka. Deklaruar situatë tvsh (fdp) të ardhura në vlerën 10.944.853 lekë. Shumatorja e të ardhurave të deklaratës së tatim fitimit të thjeshtuar plus të ardhurave të deklaratës së tatim fitimit janë fiks 10.944.853 lekë. Pra, pa diferenca.

Për tatimaguesin “S” me nipt-LV situata është e tillë, që gjatë vitit ka kaluar me përgjegjësinë tatim-fitimi dhe tvsh. Diferenca nuk ka. Nga verifikimet tona, nuk rezultojnë diferenca.

Për tatimaguesin “Xh” me nipt-LI situata është e tillë, që gjatë vitit ka kaluar me përgjegjësinë tatim-fitimi. Deklaruar situatë tvsh (fdp) të ardhura në vlerën 13.424.129 lekë. Shumatorja e të ardhurave të deklaratës së tatim fitimit të thjeshtuar plus të ardhurave të deklaratës së tatim fitimit janë 13.423.350 lekë. Pra, me diferencë 13.424.129 lekë - 13.423.350 = 779 lekë.

Përsa i përket shmangies, për diferenca nën vlerën 5.000 lekë vlerë e tatueshme, me detyrim tvsh-je nën 1.000 lekë, në bazë të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në RSH”, neni 68, pika 8, ku citohet:

8. Shuma e detyrimit tatimor e detyrueshme për t’u paguar ose shuma e tepricës së kredisë, me vlerë deri në 1 000 (një mijë) lekë, vlerësohet si detyrim ose kredi me vlerë zero dhe për shuma të tilla nuk bëhet vlerësim tatimor nga administrata tatimore. (Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.), nuk bëhet vlerësim tatimor.

Si rrjedhojë, ky pretendim është sqaruar.

Te aneksi Nr.5, faqe 15 “Diferencat e BM kasë, TVSH, tatim-fitimi për vitin 2022”, ju sqaroj se kam qenë me leje lindje për periudhën e verifikimit të bilanceve.

Te aneksi Nr.6, faqe 16, ju sqaroj se nuk kam nipt në administrim te lista juaj.

Te aneksi Nr.7, faqe 18 “Këstet e tatim fitimit të paguara me vonesë, vendosja e penaliteteve viti 2021”, ju sqaroj se për 4 (katër) tatimpagues për të cilët ju pretendoni se nuk janë penalizuar dhe keni vendosur përkrah emrin tim, po ju sqaroj se nuk i kam pasur unë në administrim. Kjo është lehtësisht e verifikueshme.

Te aneksi Nr.8, faqe 19 “Këstet e tatim fitimit të paguara me vonesë, vendosja e penaliteteve viti 2022”, ju sqaroj se për 6 (gjashtë) tatimpagues për të cilët ju pretendoni se nuk janë penalizuar dhe keni vendosur përkrah emrin tim, po ju sqaroj se nuk i kam pasur unë në administrim. Kjo është lehtësisht e verifikueshme, sepse duhet të ndani periudhat kur janë shpërndarë niptet në administrim.

Observacion nga inspektoria D F

Në vijim te Projekt Raportit te Auditimit mbi auditimin e ushtruar ne Drejtorine Rajonale Tatimore Vlore, ne baze te programit te auditimit financiar nr 1111/1 prot bej me dije se Nipte ne administrim per periudhen e auditimit sipas urdherave perkates jane si vijon:

Urdheri nr 1874 prot date 16.04.2021 nipte ne administrim LS-LB.

Urdheri nr 30 prot date 06.01.2022 Nipte ne administrim L0,L1,L2,L3

Urdheri nr 641prot date 01.02.2023 nipte ne administrim L6, L7

Ne tabelen nr 6 per diferencat e kasave biznesi i vogel 2021 dhe 2022

Per nipte ne administrim periudhen 2022 e percaktuara sipas urdherit nr 641prot date 01.02.2023 nipte ne administrim L6,L7

Viti	NIPT	Të ardhurat Tatimore	Shitje CPCM(kasa)	Xhiro sipas FDP TVSH	TR sipas DTF	Diferenca per tvsh	Diferenca per tatim fitim
2022	LM	5,760,215	5,760,215	0	0		

Sqaroj se tatimpaguesi ka deklaruar shitje vetem faturat me poshte janar mai 2022 ,eshte ndryshuar pergjegjisia e tvsh qershor 2022, prej ku subjekti nuk rezulton me deklarues(printscreen bashkelidhur).

Ka ndryshuar pergjegjesi tatimore tvsh me vone dhe ka qene mosdeklaruaes, pra nuk ka diferenca.

Ne tabelen nr 7 per diferencat e kasave biznesi i madh

per niptet e cituara ne kete tabele nuk kam nipte ne administrim per periudhat e percaktuara.

Lidhur me tablen nr 7 per diferencat e kasave per biznesin e madh viti 2022 sipas Urdheritnr 641prot date 01.02.2023 me nipte ne administrim L6,L7

NIPT	Type	Të ardhurat Tatimore	Shitje CPCM(kasa)	kasa pa tvsh	Xhiro sipas FDP TVSH	TR sipas DTF	Diferenca kase fdp tvsh	Diferenca kase tatim fitimi	Diferenca per tatim fitim
LK	BM	13,381,028	22,341,270	18,617,725	19,969,884	6,588,856	2,371,386	15,752,414	4,383,484

Per periudhen 2022 kemi ndryshim pergjegjiesie nga tatim fitimi thjeshtuar ne Tatim fitimi dhe konkretisht ne 27.09.2022 prandaj subjekti ka dy deklarata

Xhiro e deklaruar ne TFTH13.381.028(deklarata bashkelidhur)

Xhiro e deklaruar ne TF.....6.588.856(deklarata bashkelidhur)

Totali19.969.884

Xhiro e deklaruar ne FDP.....19.969.884(situatë bashkelidhur)

Diferenca0

Xhiro totale nga kasa **ne vlere te tatueshme** rezulton 19.971.591

Diferenca1.707

Subjekti aplikon shitje 6%, 20% xhiro permbledhese e kases sipas normes tvsh eshte si vijon:

Xhiro total kase22341275

- Tvsh kase 2.369.684 (TVSH 20%.....1.708.998+Tvsh 6%.....660.686)

Vlera e tatueshme nga kasa 19.971.591 (printimin e kases me fatura analitike per periudhen total 2022 bashkelidhur)

Per sa me larte diferenca per Kas Fdp dhe balance periudhe 2022 jane ne vleren 1.707 leke ne vlere te tatueshe(vlera te pa perfishme per efekte)

- Lidhur me tabelen nr 12 per subjektet me teprice kreditore rezultojne te kontrolluar,nga sektori I kontrollit per investim dhe exportues
- Lidhur me tabelen 13 per kestet e tatim fitimit ne ulje per vitin 2023 sipas nipteve administrim te urdherit nr 641 prot date 01.02.2023 per tatimpaguesit :

M me Nipt LO

A me Nipt LO

S me Nipt LK

H me Nipt LN

eshte mbajtur akt konstatimi nr 5449 date 28.08.2023 ne vijim te emailit ardhur nga Dpt date 16.08.2023 per Aktin normativ Nr. 2, datë 7.6.2023, Për disa shtesa në ligjin Nr. 29/2023, “Për Tatimin mbi të Ardhurat” përcaktohet se: “Tatimpaguesit, eksportues të mallrave në regjimin e përpunimit aktiv, të cilët në vitin 2022 kanë eksportuar jo më pak se 70% të vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet, nuk paguajnë këstet që parapaguhen në muajt qershor, shtator dhe dhjetor të vitit 2023. (bashkelidhur akti dhe emaili)

Observacion nga inspektori B K

Në vijim te Projekt Raportit te Auditimit te lena nga audituesit e KLSH-se, ju paraqes sqarimet dhe kundërshtimet e mia per sa vijon.

Lidhur me Akt Konstatimin Nr.7986/3 date 26.04.2024:

Ne faqen 4 tabela nr.6 “Diferencat e kasave biznesi i vogel me TVSH 2021-2022”, sqaroj se ne kete tabele nuk eshte asnje nga niptet e mia ne ndjekje per kete periudhe.

Ne faqen 5 tabela nr.7 “Diferencat e kasave biznesi i madh viti 2021”, sqaroj se ne kete tabele nuk eshte asnje nga niptet e mia ne ndjekje per kete periudhe.

Ne faqen 6 tabela nr.7 “Diferencat e kasave biznesi i madh viti 2022”, sqaroj se ne kete tabele nuk eshte asnje nga niptet e mia ne ndjekje per kete periudhe.

Ne faqen 8 tabela nr.12 “Lista e subjekteve me teprice kreditore te TVSH 2021-2023”, sqaroj se ne kete tabele tatimpaguesit ne ndjekje si me poshte te cilet rezultojne me ritje te teprices kreditore te TVSH-se, kryesisht jane kontrolluar nga sektori i kontrollit ne vend sipas Njoftimeve dhe programeve perkatese.

- a. U me nipt KA kontrolluar nga kontrolli ne vend me Njoftim per kontroll Nr.9002 Prot nxjerre nga DRT Vlore Dhjetor 2022.
- b. Q me nipt KF ka teprice TVSH-je te mbartur nga viti 2014 dhe per vitin 2021-2023 nuk ka krijuar teprice kreditore te TVSH-se.
- c. A me nipt KC eshte kontrolluar nga kontrolli ne vend me Njoftim per kontroll Nr.3890 Prot nxjerre nga DRT Vlore Maj 2023.
- d. FFH me nipt KV eshte kontrolluar nga kontrolli ne vend me Njoftim per kontroll Nr.3192 Prot nxjerre nga DRT Vlore Maj 2023.
- e. P me nipt KS eshte teprice e akumuluar nder vite nga investimi ne ndertimin e objektit Hotel te cilen tatimpaguesi deri me sot nuk e ka kerkuar rimbursimin e TVSH-se per kete objekt. Eshte verifikuar dhe leja e ndertimit.
- f. G me nipt KF eshte teprice e akumuluar nder vite nga investimi ne ndertimin e objektit Hotel te cilen tatimpaguesi deri me sot nuk e ka kerkuar rimbursimin e TVSH-se per kete objekt. Eshte verifikuar dhe leja e ndertimit.
- g. S me nipt KM eshte kontrolluar nga kontrolli ne vend me Njoftim per kontroll Nr.2465 Prot nxjerre nga DRT Vlore Prill 2023.
- h. A me nipt KF eshte kontrolluar nga kontrolli ne vend me Njoftim per kontroll Nr.7194 Prot nxjerre nga DRT Vlore 2022.

- i. I me nipt KI është tepricë e akumuluar ndër vite nga investimi në ndërtimin e objektit Hotel të cilin tatimpaguesi deri me sot nuk e ka kërkuar rimbursimin e TVSH-se për këtë objekt. Është verifikuar dhe leja e ndërtimit.

Në faqen 9 pika 5.1 “Teprica kreditore në TF” (aneksi 6), sqarohet se tatimpaguesit në ndjekje si me poshtë të cilët rezultojnë me ritje të tepricës kreditore të TF, janë kontrolluar kryesisht nga sektori I kontrollit në vend sipas Njoftimeve dhe programeve perkatese, por njëkohësisht janë monitoruar nga sektori i kontrollit nga zyra dhe ka rezultuar se **tepricat e TF vijne si pasoje pagesave me teper të kesteve të tatim fitimit** ku në mbylljen e bilanceve të viteve perkatese ka rezultuar se këta tatimpagues kanë paguar me teper gjatë vitit keestet e tatim fitimit në krahasim me rezultatin vjetor.

Në faqen 9 tabela nr.13 “Kërkesat për uljen e kestit të TF”, sqarohet se në këto tabele **nuk është asnjë nga niptet e mia në ndjekje për këto periudhe.**

Në faqen 10 pika 7 aneksi 7 “Pagesat me vonese të kesteve të TF”, ju shpreheni se për niptet të cilat kam pasur në ngarkim u është vendosur gjobe për mos pagimin në afat të kesteve të TF.

Observacion nga inspektoria A R

Në vijim të Projekt Raportit të Auditimit mbi auditimin e ushtruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë, në bazë të programit të auditimit financiar nr 1111/1 prot, datë 26/12/2023, i mbajtur më datë 26/04/2024.

Bazuar në pikën 4.1 “Diferenca e kasave për biznesin e vogël me TVSH”, sipas tabelës nr. 6

Në lidhje me mosveprimin për sistemin dhe saktësimin e këtyre diferencave sipas kasës dhe të ardhurave në deklaratën e TTHF – së, ju sqarohet se:

Për tatimpaguesin “C” me Nipt LO, që është nën administrimin tim, diferenca që rezulton midis të ardhurave tatimore të deklaruara në deklaratën e tatimit të thjeshtuar të fitimit dhe të ardhurave nga shitje të fiskalizuara (CPCM) nuk ka efekte tatimore pasi tatimpaguesi është nën fashën 14.000.000 lekë për mbajtjen e tatim fitimit dhe nuk ka përgjegjësi tatimore “ Tatim Fitimi ”. Për diferencën midis deklaratimit të FDP – ve mujore dhe të ardhurave nga shitje të fiskalizuara (CPCM) prej 1.006.926 lekë, tatimpaguesi në sistemin c@ts është me statusin: “Kërkesë për Çregjistrim ” dhe në zbatim të manualit të kontrollit nga zyra, tatimpaguesit të cilët kanë aplikuar për çregjistrim, do të trajtohen në momentin kur: kërkesa vjen 1.) me shkresë nga QKB – ja, 2.) nga sektori i regjistrimit ose 3.) me kërkesë me çështje/shkresë të tatimpaguesit. Në këtë moment tatimpaguesi ka bërë vetsistemim të situatës financiare për tvsh- në dhe deklaratës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2022. Sipas deklaratës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin të ardhurat e deklaruara nga tatimpaguesi janë në vlerën 1.650.265 lekë dhe sipas situatës financiare, për deklarimin e t.v.sh – së, për vitin 2022 paraqiten në vlerë të tatueshme me 20 % = 1.375.223 lekë dhe t.v.sh 20 % në vlerë 275.045 lekë, në total në vlerën 1.650.268 lekë. Për këtë arsye efekti financiar i llogaritur nuk qëndron, pasi nuk ka diferenca. (Bashkangjitur Situata financiare FDP në total për vitin 2022 dhe deklarata e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2022).

Në lidhje me Tabelën nr. 7 “Diferencat e kasave për biznesin e madh viti 2022”

Në lidhje me diferencat nga kryqëzimi i të dhënave po ju sqarohjmë se:

Për tatimpaguesit “ A ” me NIPT LM diferenca midis deklaratës së tatim fitimit dhe shitjeve të fiskalizuara (CPCM) rezulton se tatimpaguesi ka kaluar me përgjegjësi tatimore “ Tatim fitimi ” më datë 26/08/2022 sipas e-mailit të ardhur nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Vlorë datë 09/08/2022 në zbatim të kërkesës për ndryshim përgjegjësie nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve , Tiranë të ardhur me e-mail më datë 08/08/2022 me objekt “ Ndryshim përgjegjësie ” (printim e-maili bashkangjitur informacionit) ku si fillim është kërkuar të bëhet verifikimi i të dhënave për tatimpaguesit që rezultojnë me shtypje gabim, xhiro reale pa gabime dhe më pas të bëhen ndryshimet e përgjegjësi tatimore. Për këtë arsye tatimpaguesit i është ndryshuar përgjegjësia pas verifikimit të informacionit të ardhur nga DPT-ja. Për periudhën Janar 2022– 26/08/2022 tatimpaguesi ka pasur përgjegjësinë “Tatim i thjeshtuar mbi Fitimin” dhe të ardhurat e realizuara për këtë periudhë janë deklaruar në Deklaratën e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin 2022 për vlerën 18.575.990 lekë ndërsa për periudhën Shtator – Dhjetor 2022, të ardhurat e realizuara janë deklaruar në Deklaratën e Tatim Fitimit 2022 për vlerën 654.643 lekë.

Tatimpaguesi në këtë periudhë është rregjistruar edhe për përgjegjësinë “ Tatim mbi Vlerën e Shtuar ” dhe diferenca midis “ Shitjeve të fiskalizuara (CPCM) ” dhe “ Deklaratës së Tatim fitimit 2022+Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin 2022 ”për vlerën 104.287 lekë (19.334.920 lekë – 18.575.990 lekë -654.643 lekë) vjen si rezultat i Tvsh – së së llogaritur, pasi shitjet nga fiskalizimi janë llogaritur së bashku me t.v.sh- në ndërsa në deklaratën e tatim fitimit ato janë pa t.v.sh. Për këto arsye nuk ka diferenca për të cilën të llogariten efekte financiare.

Në lidhje me pikën 5 -Tatimpaguesit me tepricë kreditore të TVSH – së ju bëj me dije se:

Për vitin 2021, tatimpaguesit nën administrimin tim, me NIPT me M1 kanë qenë në fazë investimi pasi janë subjekte të reja të cilët nuk kanë filluar me ushtrimin e aktivitetit dhe realizimin e të ardhurave por me investim dhe shpenzime (subjekte të rregjistruara në vitin 2021) dhe L6 është tatimpagues në fushën e teknologjisë dhe informacionit. Për këtë arsye konstatohet rritje e tepricës kreditore si pasojë e rolit të investitorit në asete.

Për vitin 2022 – 2023, për tatimpaguesit nën administrimin tim me NIPT L8-L9, është kërkuar informacion dhe është ushtruar kontroll në disa raste për tatimpaguesit me kërkesë për rimbursim t.v.sh-je. Nga kërkesa për informacion nëpërmjet komunikimit me telefon për tatimpaguesin "O " me NIPT LB, nga tatimpaguesi është kthyer përgjigje se është në fazë investimi (Ndërtim magazine/sere për kultivimin e perimeve).

Për tatimpaguesin "I" me NIPT LF po ju sqarojmë se tatimpaguesi ka marrë leje ndërtimi me nr. 826 për komplekse me funksion hotelerie për këtë arsye tatimpaguesi rezulton me tepricë kreditore për asye të investimit.

Në lidhje me tatimpaguesin "H" me NIPT LT po ju sqarojmë se është ushtruar kontroll dhe analizuar situata e tepricës kreditore në raport – kontrollin me nr. 1839 Prot datë 23/03/2023 dhe raport – kontrolli me nr. 1622 Prot datë 28/02/2024.

Në lidhje me tatimpaguesin "Q" me NIPT LB po ju sqarojmë se tatimpaguesi ka si aktivitet “Hotele dhe struktura të ngajshme” për këtë arsye rritja e tepricës kreditore vjen di rezultat I investimit të kryer nga tatimpaguesi në fushën e hotelerisë.

Në lidhje me tatimpaguesin "A" me NIPT LK po ju sqarojmë se për tatimpaguesin është ushtruar kontroll dhe analizuar situata e tepricës kreditore në raport – kontrollin me nr. 5452 Prot datë 19/12/2023.

Në lidhje me pikën 6 – Këstet e Tatim Fitimit në ulje nga tabela me nr.13 “ Kërkesat për uljen e këstit të T.F ”, për tatimpaguesin “A” me NIPT LK, nën administrimin tim, është mbajtur akt – konstatimi me nr. 5257 Prot, datë 14/08/2023 (akt – konstatimi bashkangjitur informacionit), në zbatim të Aktit Normativ Nr. 2 datë 07/06/2023 për disa shtesa në Ligjin Nr. 29/2023 “ Për Tatimin mbi të Ardhurat ” neni 69 “Dispozita kalimtare ” pika 4 “ Përfshirë parashikimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, tatimpaguesit, eksportues të mallrave në regjimin e përpunimit aktiv, të cilët në vitin 2022 kanë eksportuar jo më pak se 70% të vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet, nuk paguajnë këstet që parapaguhen në muajt qershor, shtator dhe dhjetor të vitit 2023” dhe në zbatim të e-mailit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Tiranë datë 16/08/2023 për zbatimin e këtij akti. (printim i e-mailit bashkangjitur informacionit).

Observacion nga inspektoria M. B.

Nisur nga materiali i derguar ne Projekt Raport, lidhur me niptet qe kam ne administrim (J6,J7,J8,J9,M2), ne te cilin e gjej veten të përmendur ne faqet :

Faqja 6 (Tabela nr 7 “Diferencat e kasave per biznesin e madh viti 2022“)

Faqja 8 (Tabela nr.12 “ lista e subjekteve me teprice kreditore 2021-2023“)

Faqja 9 (Tabela nr.13 “Kerkesat per uljen e kestit te T.F)

po ju paraqes sqarimet perkatese sipas rastit si me poshte:

Ne faqen 6, Diferencat e kasave per biznesin e madhë viti 2022“ subjektet që kam pas ne administrim jane sipas tabelës nr. 7 bashkëngjitur osbervacionit.

Per subjektin me nipt ME kemi te dhenat si me poshte

Te ardhurat T.F. 2022 = 7,961,610 lek

Te ardhurat T.F.Thjeshtuar 2022 = 13,427,185 lek

Te ardhura total 2022 = 21.388.795 lek

Shitje te tatueshme nga sit e tvsh 2022 = 21,388,795 lek

Shitje nga Kasa CPCM per 2022 = 25.666.554 lek (21.388.795 + 4.277.759)

Sic shihet nuk ka diferenca , pasi vlera prej 4.277.759 eshte vlera e tvsh –se se shitjeve te tatueshme te deklaruar nga subjekti ne situaten financiare.

E paraqitur ne tabelen situata eshte si me poshte

Nr	(A) NIPT	Type	(C) Të ardhurat Tatimore Total TF+TFTH (G+H)	(D) Shitje CPCM (kasa)	(E) kasa pa tvsh	(F) Xhiro sipas FDP TVSH	(G) TR sipas DTF	(H) TR sipas TFTH	Diferenca kase fdp tvsh (E - F)	Diferenca kase tatim fitimi (E-C)	Diferenca per tatim fitim	Diferenca per tvsh
1	ME	BM	21,388,795	25,666,554	21,388,795	21,388,795	7,961,610	13,427,185	0	0	0	0

Per subjektin me nipt MC kemi te dhenat si me poshte:

Subjekti eshte regjistruar per tvsh dhe t.fitimi me date 21.07.2022

Te ardhurat T.F. 2022 = 26,848,086 lek

Te ardhurat T.F.Thjeshtuar 2022 = 7,992,617 lek

Te ardhura total 2022 = 34.840.703 lek

Shitje te tatueshme nga sit e tvsh 2022 = 26,019,686 lek nga te cilat 19,157,856 shitje te tatueshme + 6,861,830 shitje pa tvsh

Diferenca (tf+tfth)-fdp tvsh= 34.840.703 - 19.157.856 = 15.682.470 te cilat jane shitjet jasht formularit te tvsh-se per periudhen para se te regjistrohej ne tvsh

Shitje nga kasa CPCM per 2022 = 37.148.410 lek te cilat perbehen nga

Periudha Prill-Korrik (periudha pa tvsh) shitje pa tvsh = 15.928.457 lek

Periudha Gusht – Dhjetor 2022:

Periudha	2208	2209	2210	2211	2212	Total
pa tvsh	1320620	11390	0	0	0	1332010
shitje 20%	3798777	1226157	696169	367132	430666	6518901
tvsh 20%	759755.4	245231	139233.8	73426.4	86133.2	1303780
shtije 6%	7884028	3421309	37359	22640	16980	11382316
tvsh 6%	473041.68	205279	2241.54	1358.4	1018.8	682939
Total shitje pa tvsh periudha 2208-2212						19233227
Total tvsh periudha 2208-2212						1986719

Pra nga CPCM shitje pa tvsh gjithsej per 2022 jane 15.928.457(shitje pa tvsh)+ 19.233.227(shitje te tatueshme)= 35.161.684 lek dhe tvsh 1.986.719 le

Subjektin e kam vleresuar nga zyra per tvsh duke i hequr te drejten e shitjeve me 6%, dhe si rezultat i vleresimit i eshte rritur tvsh-ja per tu paguar keshtu qe tvsh e shitjeve nga 1.986.719 lek qe ishte nga kasa, eshte 3,831,570 ne situaten e tvsh-se, keshtu qe jo vetem nuk ka diference ne ulje te detyrimit por eshte rritur detyrimi me 93%

Per subjektin me nipt M26617202T kemi te dhenat si me poshte:

Subjekti eshte regjistruar per tvsh dhe t.fitimi me date 19.10.2022

Te ardhurat T.F.Thjeshtuar 2022 = 17,572,240 lek

Te ardhurat nga kasa CPCM 2022 jane si me poshte:

PERIUDHA	SHITJE PA TVSH
2205	0
2206	0
2207	5924010
2208	11447980
2209	200250
2210	0
2211	0
2212	0
TOTAL	17572240

Subjekti është stacion plazhi dhe të ardhurat e deklaruara edhe nga kasa janë për periudhën që subjekti ka qenë për përgjegjësi tatimore T.F dhe TVSH. Në këto kushte nuk kishte si të deklaronte të ardhura në situatën financiare të tvsh.

Pra për subjektin nuk ka diferencë as FDP e TVSH me kasën dhe as FDP e TVSH me TF

E paraqitur në tabelë situata është si më poshtë

Nr	(A) NIPT	Type	(C) Të ardhurat Tatimore Total TF+TFTH (G+H)	(D) Shitje CPCM(kasa)	(E) kasa pa tvsh	(F) Xhiro sipas FDP TVSH	(G) TR sipas DTF	(H) TR sipas TFTH	Diferenca kase tvsh (E - F)	Diferenca kase tatim fitimi (E-C)	Diferenca për tatim fitim	Diferenca për tvsh
3	M26617202T	BM	17,572,240	17,572,240	14,643,533	-	-	17,572,240	0	0	0	0

Për subjektin me nipt MU kemi të dhenat si më poshtë:

Subjekti është aktivizuar për Tvsh dhe Tatim Fitimin në datë 26.08.2022 dhe në datë 21.09.2022 ka kaluar në pasiv për tu riaktivizuar në vitin 2023/04

Të ardhurat T.F. 2022 = 2,599,115 lek

Të ardhurat T.F.Thjeshtuar 2022 = 15,080,950 lek

Të ardhura total 2022 = 17.680.065 lek

Shitje pa tvsh nga sit e tvsh 2022 = 6,963,345 lek

Diferenca prej 10.716.720 lek janë të ardhura të deklaruara për periudhën që subjekti nuk ka qenë aktiv për tvsh pra për periudhën 2201-2208

Të ardhurat e deklaruara në kase (CPCM) janë si më poshtë

PERIUDHA	SHITJE PA TVSH
2204	0
2205	501322
2206	4250700
2207	5964698
2208	5045770
2209	1856225
TOTAL	17618715

Sic shihet edhe nga historiku i veprimeve subjekti ka qenë aktiv vetëm për periudhën 2204-2209

Pra për subjektin nuk ka diferencë deklarimi me pak as FDP e TVSH me kasën dhe as FDP e TVSH me TF

E shprehur në tabelë situata paraqitet si më poshtë

Nr	(A) NIPT	Type	(C) Të ardhurat Tatimore Total TF+TFTH (G+H)	(D) Shitje CPCM(kasa)	(E) kasa pa tvsh	(F) Xhiro sipas FDP TVSH	(G) TR sipas DTF	(H) TR sipas TFTH	Diferenca kase fdp tvsh (E - (F+N))	Diferenca kase tatim fitimi (E-C)	Diferenca për tatim fitim	Diferenca për tvsh	(N) xhiro për periudhën jashtë tvsh
4	MU	BM	17680065	17943796	17618715	6963345	2599115	15080950	-61350	-61350	-12270	-9202	10716720

Për subjektin me nipt MD kemi të dhenat si më poshtë:

Tatimpaguesi ka aktivitet Klinikë stomatologjike dhe shitjet janë të përjashtuara nga tvsh. Tatimpaguesi është aktivizuar për tvsh-në në datë 24.11.2022 dhe tatim fitimin në datë 19.10.2022

Të ardhurat T.F. 2022 = 15.944.766 lek

Të ardhurat T.F.Thjeshtuar 2022 = 13.994.177 lek

Të ardhura total 2022 = 29.938.943 lek

Shitje pa tvsh nga sit e tvsh 2022 = 15,944,766 lek

Diferenca është 13.994.177 dhe janë të ardhurat të deklaruara në tatim fitim të thjeshtuar pa u zbritur tvsh sepse subjekti është i përjashtuar nga tvsh për periudhën që subjekti nuk ka qenë as i regjistruar për tvsh

Të ardhurat nga kasa CPCM janë 29.938.943 të ndara sipas muajve si më poshtë

PERIUDHA	SHITJE PA TVSH
2205	0
2206	0
2207	1591690
2208	0
2209	6773137

2210	5629350
2211	4910230
2212	11034536
TOTAL	29938943

Ne keto kushte per subjektin nuk ka diferenca as FDP e TVSH me kasen dhe as FDP e TVSH me TF
Situata paraqitet si ne tabelen me poshte:

Nr	(A) NIPT	Type	(C) Të ardhurat Tatimore Total TF+TFTH (G+H)	(D) Shitje CPCM(kasa)	(E)kasa pa tvsh	(F) Xhiro sipas FDP TVSH	(G) TR sipas DTF	(H) TR sipas D TFTH	Diferenca kase fdp tvsh (E - (F+N))	Diferenca kase tatim fitimi (E-C)	Diferenca per tatim fitim	Diferenca per tvsh	(N) xhiro per periudhen jasht tvsh
5	M26629204D	BM	29938943	29938943	29938943	15944766	15944766	13994177	0	0	0	0	13994177

Per subjektin me nipt MD kemi te dhenat si me poshte

Subjekti eshte aktivizuar per Tvsh ne 28.06.2022 dhe Tatim Fitimin ne date 26.08.2022

Te ardhurat T.F. 2022 = 42,697,186 lek.

Te ardhurat T.F.Thjeshtuar 2022 = 8.000.000 lek

Te ardhura total 2022 = 50.697.186 lek

Shitje pa tvsh nga sit e tvsh 2022 = 50,697,185 lek nga te cilat 50.084.911shitje te tatueshme dhe 612.274 shitje te perjashtuara

Diferenca t.f+tfth 2022 me fdp te tvsh nuk ka

Shitjet total nga kasa jane 60714179 , nga ku kemi

Shitje te perjashtuara= 612.274

shitjet e tatueshme = 50.084.920

tvsh = 10.016.984

Shitje total pa tvsh sipas CPCM =50.697.194

Pra nuk rezultojne diferenca ndermjet kases dhe deklarimeve si ne tvsh edhe ne tatim fitimi

Situata paraqitet si ne tabelen me poshte

Nr	(A) NIPT	Type	(C) Të ardhurat Tatimore Total TF+TFTH (G+H)	(D) Shitje CPCM(kasa)	(E)kasa pa tvsh	(F) Xhiro sipas FDP TVSH	(G) TR sipas DTF	(H) TR sipas D TFTH	Diferenca kase fdp tvsh (E - (F+N))	Diferenca kase tatim fitimi (E-C)	Diferenca per tatim fitim	Diferenca per tvsh	(N) xhiro per periudhen jasht tvsh
6	MD	BM	50697186	60714179	50697174	50697185	42697186	8000000	-11	-12	-1.8	-2.2	0

Per subjektin me nipt MR kemi te dhenat si me poshte

Subjekti eshte aktivizuar per Tvsh dhe Tatim Fitimin ne date 19.10.2022 dhe ne date 10.11.2022 subjekti ka kaluar ne statusin pasiv

Te ardhurat T.F. 2022 = 0 lek

Te ardhurat T.F.Thjeshtuar 2022 = 15,365,795 lek

Te ardhura total 2022 = 15,365,795 lek

Shitje pa tvsh nga sit e tvsh 2022 jane zero duke qene se pas dates se aktivizimit te pergjegjesise se tvsh-se tatimpagesi nuk ka ushtruar aktivitetet

Shitjet nga kasa (CPCM) te detajuara sipas muajve jane si me poshte

PERIUDHA	SHITJE PA TVSH
2207	5051695
2208	9245260
2209	1068840
2210	0
2211	0
TOTAL	15365795

Sic shihet tatimpaguesi nuk ka diferenca ne deklarim as per tvsh as per tatim fitimin ne raport me shitjet e realizuara ne kase

Situata paraqitet si ne tabelen me poshte:

Nr	(A) NIPT	Type	(C) Të ardhurat Tatimore Total TF+TFTH (G+H)	(D) Shitje CPCM(kasa)	(E)kasa pa tvsh	(F) Xhiro sipas FDP TVSH	(G) TR sipas DTF	(H) TR sipas TFTH	Diferenca kase fdp tvsh (E - (F+N))	Diferenca kase tatim fitimi (E-C)	Diferenca per tatim fitim	Diferenca per tvsh	(N) xhiro per periudhen jasht tvsh
7	MR	BM	15,365,795	15,365,795	15,365,795	0	0	15365795	0	0	0	0	15,365,795

Per subjektin me nipt ME kemi te dhenat si me poshte

Subjekti eshte aktivizuar per Tvsh qe ne momentin e regjistrimit dhe Tatim Fitimin ne date 23.11.2022

Te ardhurat T.F. 2022 = 3,015,490 lek

Te ardhurat T.F.Thjeshtuar 2022 = 12,276,113 lek

Te ardhura total 2022 = 15.291.603 leke

Shitje pa tvsh nga sit e tvsh 2022 jane 15,291,603=335.025 (shitje te perjashtuara) + 329.775(shitje pa tvsh) + 14,626,803 (shitje te tatueshme).

Pra diference TF –TVSH nuk ka

Te ardhurat nga shitjet total me kase (CPCM) jane 18,243,676 lek nga te cilat 335.025+329.775=664800 jane shitje pa tvsh dhe 14.063.101 jane shitje te tatueshme dhe 3.515.775 eshte tvsh

Sic shihet edhe ne raport me te ardhurat e deklaruar ne kase(CPCM) nuk ka diferenca as nga tatim fitimi as nga TVSH.

Situata paraqitet si ne tabelen me poshte:

Nr	(A) NIPT	Type	(C) Të ardhurat Tatimore Total TF+TFTH (G+H)	(D) Shitje CPCM(kasa)	(E)kasa pa tvsh	(F) Xhiro sipas FDP TVSH	(G) TR sipas DTF	(H) TR sipas TFTH	Diferenca kase fdp tvsh (E - (F+N))	Diferenca kase tatim fitimi (E-C)	Diferenca per tatim fitim	Diferenca per tvsh
8	ME	BM	15291603	18,243,676	15,291,603	15291603	3015490	12276113	0	0	0	0

Ne faqen 8 Tab nr12 subjektet me teprice kreditore te tvsh 2021-2023 sqarimet per subjektet qe kam ne administrim janë marrë në konsideratë.

Ne faqen 9 Tab nr13 Subjektet për ulje të këstit të T.F, sqarimet per subjektet qe kam ne administrim jane marrë në konsideratë.

Shpresoj qe informacioni dhe sqarimet e vendosura nga ana ime te sherbejne per nje qartesim te situates se tatimpaguesve te permendur ne materialin tuaj.

Observacion nga inspektori O Sh

Referuar trajtimit në Projekt Raport, në përfundim të analizës së të igjitha rasteve për subjektet nën administrimin tim i përmbahem sqrimeve të dhëna më pare gjatë kontakte me grupin e auditimit dhe theksoj se bëhet fjalë për t.v.sh- në e cila nuk është e zhveshur nga vlera totale (CPCM) dhe disa nga rastet janë deklarim i dyfishtë për subjekte që kanë ndryshuar përgjegjësi tatimore në mes të periudhës.

Çdo rast është dërguar me sqarim në tabelat më parë.

Observacion nga inspektori AM

Ne lidhje me sa trajtohet ne akt-konstatimin nr 2, protokolluar ne DRT Vlore me nr 7968/3 prot date 26.04.2024 Aneksi 5, ju sqarojme se

1.Subjekti V me NIPT MJ, ka deklaruar sakte ne te ardhurat e DTF per vitin 2022, vleren e tatueshme 114721175 leke e cila eshte vlera e tatueshme pa Tvsh, me Tvsh ne vleren 22.944.235 leke.

2.Subjekti SAF me nipt MI, eshte subjekt ne faze investimi Hoteleri per shfrytezim te vete. Per keto subjektet deklarim ne FDP mujore vlerat e autofaturave te situacioneve ne shitje, per keto nuk perbejne te ardhura per efekt fiskal ne bilancin e periudhes. Bashkelidhur bilanc 2022.

Observacion nga inspektori I R

I mbajtur sot nga inspektori i kontrollit z. I R, në lidhje me Projekt Raport Auditimin, mbi auditimin e ushtruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë, në bazë programit të auditimit financiar nr. 1111/1 Prot, datë 26/12/2023, i mbajtur më datë 26/04/2024.

Bazuar në pikën 4.1 “Diferenca e kasave për biznesin e vogël me TVSH”, sipas tabelës nr. 6

në lidhje me mosveprimin për sistemimin dhe saktësimin e këtyre diferencave sipas kasës dhe të ardhurave në deklaratën e TTHF- së, ju sqaroj se:

Për tatimpaguesin “C” me Nipt MN, sqaroj se me urdherin Nr 88 datë 19.05.2023 protokolluar në DRT Vlorë Nr 22.05.2023 datë 22.05.2023 jam komanduar në Sektorin e Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit dhe me date 10.08.2023 jam njoftuar me email (bashkangjitur) ku me jane ngarkuar niptet me M0 për ndjekje. Subjekti ka deklaruar në muajin Shkurt 2023 deklaratën e Tatim te Thjeshtuar te Fitimit pra sic shihet per vitin 2022 subjekti nuk ka qene ne ndjekje nga ana ime, dhe në baze të verifikimeve në sistemin C@ts ky subjekt ka kaluar në statusin pasiv më date 26.03.2023.

Në lidhje me Tabelën nr. 7 “Diferencat e kasave për biznesin e madh viti 2022”

Në lidhje me diferencat nga kryqëzimi i të dhënave po ju sqarojmë se:

Për tatimpaguesit “I” me NIPT MR diferenca midis deklaratës së tatim fitimit dhe shitjeve të fiskalizuara (CPCM)rezulton se tatimpaguesi ka kaluar me përgjegjësi tatimore “Tatim fitimi” më datë 29/09/2022, dhe subjekti ka bërë 2 deklarata Tatim i Thjeshtuar mbi Fitimin, Tatim fitimi.

Për periudhën Janar 2022-29/09/2022 tatimpaguesi ka pasur përgjegjësinë “Tatim i thjeshtuar mbi Fitimin” dhe të ardhurat e realizuara për këtë periudhë janë deklaruar në Deklaratën e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin 2022 për vlerën 10.464.176 lekë ndërsa për periudhën Tetor – Dhjetor 2022, të ardhurat e realizuara janë deklaruar në Deklaratën e Tatim Fitimit 2022 për vlerën 4.607.020 lekë. Pra subjekti ka deklaruar një xhiro totale prej 15.071.196 lekë pa tvsh nga keto 2.693.250 shitje te perjashtuara, 12.370.154 shitje me 20%, 7.792 shitje me 6% sipas Situates Financiare te TVSH duke shtuar edhe 20% tvsh del vlera prej 2.474.031 dhe vlera totale është 17.545.227. Pra nuk ka diferenca.

Në lidhje me Tabelën nr. 12 “Lista (Top 50) subjekte me teprice kreditore te TVSH 2021-2023 ju sqaroj si më poshtë :

1.G Nipt MF po ju sqarojmë se tatimpaguesi ka si aktivitet “Hotele dhe struktura të ngajshme” për këtë arsye rritja e tepricës kreditore vjen si rezultat i investimit të kryer nga tatimpaguesi në fushën e hotelerisë.

2.A Nipt MS po ju sqarojmë se tatimpaguesi ka qenë në fazë investimi Bar-Restorant-Piceri-Plazh-Pishine-Lounge tek ish Kompleksi K. lagjia Uji I Ftohte.

3.C Nipt KD po ju sqarojmë se është ushtruar kontroll dhe analizuar situata e tepricës kreditore me program– kontrollin me nr. 5428/2 Prot datë 28/08/2023.

4.T Nipt MC në bazë të verifikimeve në sitemin c@ts ky subject deklaroi me 0 nga viti 2022 deri 2024 teprica kreditore vjen nga periudha 2020-2021 të cilat nuk janë periudha të ndjekura nga ana ime.

Sqarime në lidhje me anekset:

Aneksi nr 1. “Diferencat e kasave për biznesin e vogel viti 2021-2022”.

Për tatimpaguesin “C” me Nipt MN, sqaroj se me urdherin Nr 88 datë 19.05.2023 protokolluar në DRT Vlorë Nr 22.05.2023 datë 22.05.2023 jam komanduar në Sektorin e Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit dhe me date 10.08.2023 jam njoftuar me email (bashkangjitur) ku me jane ngarkuar niptet me M0 për ndjekje. Subjekti ka deklaruar në muajin Shkurt 2023 deklaratën e Tatim te Thjeshtuar te Fitimit pra sic shihet per vitin 2022 subjekti nuk ka qene ne ndjekje nga ana ime, dhe në baze të verifikimeve në sistemin c@ts ky subjekt ka kaluar në statusin pasiv më date 26.03.2023.

Aneksi nr 2. “Diferencat e kasave për biznesin e madh viti 2021”.

Nuk kam subjekte në monitorim.

Aneksi nr 3: “Diferencat e kasave për biznesin e madh viti 2022”

V Nipt MJ nuk është në ndjekje nga ana ime.

E Nipt MT nuk është në ndjekje nga ana ime.

Aneksi nr 4: “Diferencat e BM kasa ,tvsh ,tatim fitimi viti 2021”

Nuk kam subjekte në monitorim.

Aneksi nr 5: “Diferencat e BM kasa, TVSH, tatim fitimi viti 2022”

Për tatimpaguesit “I” me NIPT MR diferenca midis deklaratës së tatim fitimit dhe shitjeve të fiskalizuara (CPCM) rezulton se tatimpaguesi ka kaluar me përgjegjësi tatimore “Tatim fitimi” më datë 29/09/2022, dhe subjekti ka bërë 2 deklarata Tatim i Thjeshtuar mbi Fitimin, Tatim fitimi.

Për periudhën Janar 2022-29/09/2022 tatimpaguesi ka pasur përgjegjësinë “Tatim i thjeshtuar mbi Fitimin” dhe të ardhurat e realizuara për këtë periudhë janë deklaruar në Deklaratën e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin 2022 për vlerën 10.464.176 lekë ndërsa për periudhën Tetor – Dhjetor 2022, të ardhurat e realizuara janë deklaruar në Deklaratën e Tatim Fitimit 2022 për vlerën 4.607.020 lekë. Pra subjekti ka deklaruar një xhiro totale prej 15.071.196 lekë pa tvsh nga keto 2.693.250 shitje te perjashtuara, 12.370.154 shitje me 20%, 7.792 shitje me 6% sipas Situates Financiare te TVSH duke shtuar edhe 20% tvsh del vlera prej 2.474.031 dhe vlera totale është 17.545.227. Pra nuk ka diferenca.

Aneksi nr 6 : “Teprica kreditore e tatim fitimit për vitet 2021 dhe 2022 për 30 subjektet më të mëdha në vlerë të renditura”.

1.E KD teprice kreditore e mbartur nga vitet 2016-2017 periudha qe nuk jane ndjekur nga ana ime.

2.D MT teprice kreditore e mbartur nga vitI 2020 periudhë qe nuk është ndjekur nga ana ime.

Aneksi nr 7: “Këstet e tatim fitimit të paguara me vonesë, vendosja e penaliteteve viti 2021”

Nuk kam subjekte në monitorim.

Aneksi nr 8: “Këstet e tatim fitimit të paguara me vonesë, vendosja e penaliteteve viti 2022”

Nuk kam subjekte në monitorim.

Aneksi nr 9: “Lista (Top 50) subjekte me teprice kreditore te TVSH 2021-2023”.

1.G Nipt MF po ju sqarojmë se tatimpaguesi ka si aktivitet “Hotele dhe struktura të ngjajshme” për këtë arsye rritja e tepricës kreditore vjen si rezultat i investimit të kryer nga tatimpaguesi në fushën e hotelerisë.

2.A Nipt MS po ju sqarojmë se tatimpaguesi ka qenë në fazë investimi Bar-Restorant-Piceri-Plazh-Pishine-Lounge tek ish Kompleksi K. lagjia Uji i Ftohte.

3.C Nipt KD po ju sqarojmë se është ushtruar kontroll dhe analizuar situata e tepricës kreditore me program– kontrollin me nr. 5428/2 Prot datë 28/08/2023.

4.T Nipt MC në bazë të verifikimeve në sitemin c@ts ky subject deklaroi me 0 nga viti 2022 deri 2024 teprica kreditore vjen nga periudha 2020-2021 të cilat nuk janë periudha të ndjekura nga ana ime.

1.A LK nuk e kam subjekt në monitorim.

2.S KM nuk e kam subjekt në monitorim.

3.M 2015 LO nuk e kam subjekt në monitorim.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Në lidhje me pretendimet tuaja për tatimpaguesin “C” me Nipt LO, osbervacioni juaj nuk do të merret në konsideratë pasi nga ana Inspektorit të Kontrollit nga zyra, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore Neni 68, pika 5 e Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, pasi nuk ka bërë verifikimin e deklaratës në kohë duke lejuar subjektin të shmangë detyrimet tatimore (TVSH), e për pasojë mosvendosjen e gjobës në vlerën 100 % te detyrimeve tatimore të papaguara, të cilat përbëjnë ardhura të cilat i kanë munguar buxhetit të shtetit.

Në lidhje me pretendimet e tjera të paraqitura në observacion janë të njëjta më ato të paraqitura për akt-konstatimet (të trajtuara hollësisht në pjesën takuese në Projekt Raport), nuk janë paraqitur argumente apo dokumente shitesë, për pasojë nuk merren në konsideratë.

III.2.3-Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë së Shërbimeve të Tatimpaguesve. Asistenca dhe shërbimi ndaj tatimpaguesve. Regjistrimi i tatimpaguesve.

Për auditimin e periudhës 2021-2023, u shqyrtua informacioni dhe dokumentacioni:

-Ndarja e detyrave të punonjësve;

-Klasifikimi i subjekteve (aktiv/pasiv/të regjistruar/të ç’regjistruar/të pezulluar etj) për periudhën objekt auditimi;

-Vërtetimet që janë lëshuar për subjektet në lidhje me detyrimet, si dhe çdo dokumentacion i cilësuar i nevojshëm për punimin e materialit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm konstatohet se:

Drejtorja e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve në DRT Vlorë (DSHT këtu e më poshtë), është e organizuar dhe funksionon në zbatim të “Rregullores së funksionimit të Drejtorive Tatimore Rajonale”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 192, datë 12.08.2020. DSHT sipas Manualit të Shërbimit për Tatimpaguesit dhe Individit ka si objektiva / parime /detyra kryesore:

-Parimin për zbatimin e njëjtë dhe efektiv të legjislacionit për të gjithë tatimpaguesit;

-Vetëvlerësimi dhe vetëdeklarimi i detyrimit tatimor nga ana e tatimpaguesit;

-Nxitjen e respektimit vullnetar të legjislacionit tatimor, nëpërmjet informimit, edukimit dhe publikimit të akteve nënligjore;

-Hartimi i strategjive dhe marrja e masave për pakësimin e risqeve që vijnë nga mosrespektimi i legjislacionit tatimor;

-Nxitja e veprimtarive elektronike, sidomos të deklarimit dhe të pagesës elektronike të detyrimit tatimor.

- Shërbimin ndaj tatimpaguesit, vizita si dhe informimin e tyre për ndryshimet në legjislacionin tatimor.

Struktura e DSHT në DRT Vlorë, për periudhën 01.01.2021-25.05.2023, ka funksionuar me Urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”. Ndërsa, për periudhën 26.05.2023-31.12.2023, ka funksionuar me Urdhrin nr. 69, datë 26.05.2023, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”. Edhe pas miratimit të Urdhri nr. 69, struktura organizative e DRT Vlorë nuk ka pësuar ndryshime organizative. DSHT ka të miratuar në strukturë 14 punonjës: 1 drejtor drejtorie, 2 përgjegjës sektori dhe 11 specialistë, të paraqitur në tabelën nr. 1:

Tabela nr. 1 Struktura e DSHT, në periudhën 2021-2023

Drejtorja e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve	Punonjës, miratuar me Urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020	Punonjës fakt më datë 31.12.2021	Punonjës fakt më datë 31.12.2022	Punonjës fakt më datë 01.01.2023	Punonjës, miratuar me Urdhrin nr. 69, datë 26.05.2023	Punonjës fakt më datë 31.12.2023
Drejtor Drejtorie	1	0	0	0	1	0
Spektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve	10	9	8	9	10	8
Përgjegjës Sektori	1	1	1	1	1	0
Specialistë	9	8	7	8	9	8
Spektori i Regjistrimit	3	3	3	3	3	3
Përgjegjës Sektori	1	1	1	1	1	1
Specialistë	2	2	2	2	2	2
Totali	14	12	11	12	14	11

Burimi: DRT Vlorë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Nga auditimi u konstatua se:

-Drejtorja e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve ka funksionuar pa drejtor gjatë periudhës 2021-2023.

-Në Sektorin e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve në fund të vitit 2021, rezulton vakant 1 pozicion

specialisti. Në fund të vitit 2022, paraqiten vakant 2 pozicione specialisti. Si dhe nga muaji Shtator 2023, është vakant pozicioni i Përgjegjës të Sektorit dhe 1 pozicioni specialisti.

Për sa më sipër, mosplotësimi i pozicionit vakant të Drejtorit të Drejtorisë për një kohë kaq të gjatë dhe i Përgjegjës të Sektorit të Shërbimit ndaj Tatimpaguesve është shoqëruar me risk në mirëfunksionimin e punës, e trajtuar nga ana grupit të auditimit, më poshtë.

a) Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve.

Shërbimi dhe asistenca në këtë Sektor është dhënë kryesisht nëpërmjet email-it zyrtar dhe telefonit, me kontakte të drejtpërdrejta me tatimpaguesit në ambientet e Drejtorisë së Shërbimit, janë bërë sqarime verbale apo shpërndarje së broshurave informuese mbi mënyrën e deklarimit, përpilimit të librave të shitblerjes etj., si dhe janë dhënë sqarime të nevojshme në lidhje me paqartësitë e tatimpaguesve rreth situatave të tyre financiare në sistemin tatimor.

Nga auditimi, përmes intervistës me specialistë të sektorit, u konstatua se ndarja e detyrave të punës, ka funksionuar me komunikim të drejtpërdrejtë sipas situatave dhe nevojave të krijuara në punën e përditshme dhe në vazhdimësi.

Në lidhje me planet e punës, analizat mujore e vjetore, realizimin e tyre, si dhe raportet mbi performancën e Sektorit të Shërbimit ndaj Tatimpaguesve të mbajtur në periudhën 2021-2023, nuk na u vendos asnjë dokument në dispozicion. Nga takimi i kryer nga grupi i auditimit të KLSH më datë 25.01.2024, me ish Përgjegjës të Sektorit z. D. D., i dorëhequr nga DRT Vlorë në shtator 2023, na komunikoi se planet e punës, raportet e analizat mbi performancën e Sektorit, ishin përcjellë në struktura përgjegjëse në DPT përmes email-it zyrtar të tij, i cili tani nuk është më i aksesueshëm. Dokumentet nuk rezultojnë të ishin të protokolluara në Zyrën e Protokollit të DRT Vlorë, duke mos lënë asnjë gjurmë auditimi të performancës së këtij Sektori në vitet 2021-2023. Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar. Me nenin 14 e 15, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar. Me nenin 12, "*Përgjegjësitë dhe detyrat e përgjegjës të Sektorit/Zyrës së Asistencës & Shërbimit të Tatimpaguesve në DRT*" të Rregullores së Funkcionimit të Administratës Rajonale Tatimore, miratuar me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, të Ministrit të MFE. Me nenin 15, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "*Për arkivat*", i ndryshuar, si dhe Normat tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.

b) Sektori i Regjistrimit

Nga auditimi u konstatua se, me shkresat nr. 7794 prot., datë 01.11.2021, nr. 117 prot., datë 10.01.2022, nr. 83 prot., datë 09.01.2023, janë miratuar ndarjet e detyrave funksionale për inspektorët e Sektorit të Regjistrimit.

Për periudhën 2021-2022, planet e punës ishin të miratuara në plane mujore, ndërsa plani i punës për vitin 2023, ishte miratuar me shkresën nr. 445 prot., datë 23.01.2023, në të cilin ishin përcaktuar, përshkrimet e detyrave, specialistët e ngarkuar në përgjegjësi si afatet kohore. Planet ishin të firmosura nga Përgjegjësi i Sektorit dhe të miratuara nga Drejtori Rajonal.

Ky Sektor ka zhvilluar analizat vjetore për vitet 2021-2023. Nga auditimi i dokumentacionit përkatës u konstatua se janë miratuar nga Përgjegjësi i Sektorit dhe Drejtori Rajonal:

- Me shkresën nr. 631 prot., datë 12.01.2022, *Analiza vjetore e vitit 2021*;
- Me shkresën nr. 444 prot., datë 23.01.2023, *Analiza vjetore e vitit 2022*;
- Me shkresën nr. 592 prot., datë 12.01.2024, *Analiza vjetore e vitit 2023*.

Nga analiza e veprimtarisë së këtij Sektori për vitet 2021-2023, u konstatua si në vijim:
Subjekte me status aktiv dhe regjistrimet e reja.

Tabela nr. 2 Subjekte me status aktiv në vitin 2021

Subjekte sipas llojit të biznesit	Subjekte Aktiv më datë 31.01.2021	Regjistrime të reja	Subjekte Aktiv më datë 31.12.2021
BV	3118	875	4765
BV+TVSH	345	117	511
BM	1345	19	1290
Ente	60		78
OJF	44		40
Fermer	1477		2199
Total	6389	1011	8883

Burimi: Sektori i Regjistrimit të DSHT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Nga të dhënat e mësipërme u konstatua se, gjatë vitit janë kryer 1011 regjistrime të subjekteve të reja ose 15.8% më shumë se në fund të muajit janar 2021. Në fund të vitit kanë rezultuar 8883 subjekte aktive.

Tabela nr. 3 Subjekte me status aktiv në vitin 2022

Subjekte sipas llojit të biznesit	Subjekte Aktiv më datë 31.01.2022	Regjistrime të reja	Subjekte Aktiv më datë 31.12.2022
BV	3500	981	4995
BV+TVSH	398	100	546
BM	1456	16	1435
Ente	60		74
OJF	48		41
Fermer	2176		3029
Total	7638	1097	10120

Burimi: Sektori i Regjistrimit të DSHT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Nga auditimi u konstatua se, diferenca në zbritje e subjekteve aktiv në datën 30.12.2021, me ato të datës 31.01.2022, vjen si rezultat i procesimit vjetor që u bëhet subjekteve të cilat janë me deklaram 0 (zero) ose padeklaruar, për 12 periudha duke i kaluar me status pasiv. Ky është proces automatik i cili kryhet një herë në vit, në muajin janar, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Gjithashtu për periudhën 2021-2023, përveç regjistrimeve të reja, janë edhe subjekte të cilët kanë qenë me status pasiv dhe janë aktivizuar.

Për sa më sipër, gjatë vitit 2022 janë regjistruar 1097 subjekte të reja dhe më 31.12.2022, kanë rezultuar gjithsej 10120 subjekte aktive ose 14.4%, më shumë se më 31.12.2021.

Tabela nr. 4 Subjekte me status aktiv në vitin 2023

Subjekte sipas llojit të biznesit	Subjekte Aktiv më datë 31.01.2023	Regjistrime të reja	Subjekte Aktiv më datë 31.12.2023
BV	4926	865	5224
BV+TVSH	529	64	541
BM	1494	30	1594
Ente	72		72
OJF	42		34
Fermer	3048		3881
Total	10111	959	11346

Burimi: Sektori i Regjistrimit të DSHT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Nga auditimi u konstatua se më 31.01.2023 kanë qenë 10111 subjekte aktive. Gjatë vitit janë regjistruar 959 subjekte të reja ose 9.5% më shumë se në fillim të vitit. Më 31.12.2023, kanë rezultuar 11346 subjekte aktive.

Nga analiza e të dhënave të mësipërme për periudhën 2021-2023, konstatohet se rritjen më të madhe të subjekteve aktive e ka BV, në të cilin, më 31.01.2021 rezultonin 3118 dhe më 31.12.2023 ishin 5224 aktivë, ose 59.6% më shumë. Ndjekur më pas nga Fermerët, të cilët më 31.01.2021 rezultonin 1477 subjekte aktive dhe më 31.12.2023 me 3881, ose 38% më shumë.

Ndryshimi i përgjegjësive tatimore në sistem.

Nga auditimi i data- base të vënë në dispozicion nga përgjegjësi i sektorit, u konstatua se ishte ndjekur si proces edhe ndryshimi i përgjegjësive tatimore bazuar në kërkesat e ardhura nga subjekti, por edhe nga kërkesat e inspektorëve. Nga kryqëzimi i të dhënave rezultoi se ndryshimet janë kryer brenda afateve. Analiza është kryer për subjektet që zënë peshën më të madhe. Subjektet për ndryshim të përgjegjësive tatimore paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 5 Ndryshimi i përgjegjësive në vitin 2021

Subjekte sipas llojit të biznesit	Subjekte Aktiv më datë 01.01.2021	Ndryshimi	Lloji i ndryshimit
BV	3118	353	TVSH
BV+TVSH	345	152	TF
BM	1345		
Ente	60		
OJF	44		
Fermer	1477		
Total	6389	505	

Burimi: Sektori i Regjistrimit të DSHT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Sa më sipër rezultoi se gjatë vitit 2021, rezultuan 505 ndryshime përgjegjësish, nga të cilët 152 subjekte kanë kaluar me Tatim Fitimi dhe 353 prej tyre, me TVSH.

Tabela nr. 6 Ndryshimi i përgjegjësive në vitin 2022

Subjekte sipas llojit të biznesit	Subjekte Aktiv më datë 01.01.2022	Ndryshimi	Lloji i ndryshimit
BV	3500	241	TVSH
BV+TVSH	398	216	TF
BM	1456		
Ente	60		
OJF	48		
Fermer	2176		
Total	7638	457	

Burimi: Sektori i Regjistrimit të DSHT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Gjatë vitit 2022, rezultuan 457 ndryshime përgjegjësish, nga të cilët 216 subjekte kanë kaluar me Tatim Fitimi dhe 241 prej tyre, me TVSH.

Tabela nr. 7 Ndryshimi i përgjegjësive në vitin 2023

Subjekte sipas llojit të biznesit	Subjekte Aktiv më datë 01.01.2023	Ndryshimi	Lloji i ndryshimit
BV	4053	136	TVSH
BV+TVSH	463	209	TF
BM	1546		
Ente	60		
OJF	55		
Fermer	3011		
Total	9188	345	

Burimi: Sektori i Regjistrimit të DSHT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Gjatë vitit 2023, rezultuan 345 ndryshime përgjegjësish, nga të cilët 209 subjekte kanë kaluar me Tatim Fitimi dhe 136 prej tyre, me TVSH.

Në tabelën më poshtë është detajuar ndarja e kërkesës për ndryshim përgjegjësie, kërkesë e bërë nga subjekti dhe kërkesë e bërë nga inspektori.

Tabela nr. 8 Kërkesa për ndryshim përgjegjësie

Kërkesë për ndryshim	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2022
Kërkesë nga inspektori	0	2	59
Kërkesë nga subjekti	86	33	77
Total	86	35	136

Burimi: Sektori i Regjistrimit të DSHT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Nga auditimi u konstatua se, për subjektet që kanë ndryshuar përgjegjësi tatimore, nga ana e Sektorit të Regjistrimit ishin kryer njoftimet nëpërmjet shkresave zyrtare për datën dhe mënyrën e deklaramit, si edhe nëpërmjet e-filing, për çështjet e hapura e të dërguara në e-albania.

Subjekte të cilët kanë aplikuar për çregjistrim.

Tabela nr. 9 Aplikim për çregjistrim në vitin 2021

Aplikimpër ç'regjistrim	Subjekte Aktiv më datë 01.01.2021	Aplikim për ç'regjistrim	Ç'regjistruar
BV	3118	471	51
BV+TVSH	345	25	8
BM	1345	26	1
Ente	60	0	0
OJF	44	0	0
Fermer	1477	0	2
Total	6389	522	62

Burimi: Sektori i Regjistrimit të DSHT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Në lidhje me çregjistrimet e subjekteve, gjatë vitit 2021 kishin aplikuar për çregjistrim, 522 subjekte dhe ishin çregjistruar 62 prej tyre. Numrin më të lartë të aplikimeve për çregjistrim e zinin BV me 471 aplikime.

Tabela nr. 10 Aplikim për çregjistrim në vitin 2022

Aplikimpër ç'regjistrim	Subjekte Aktiv më datë 01.01.2022	Aplikim për ç'regjistrim	Ç'regjistruar
BV	3500	312	81
BV+TVSH	398	28	16
BM	1456	17	2
Ente	60	0	0
OJF	48	0	0
Fermer	2176	0	10
Total	7638	357	109

Burimi: Sektori i Regjistrimit të DSHT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Gjatë vitit 2022, kishin aplikuar për çregjistrim, 357 subjekte dhe ishin çregjistruar 109 prej tyre. Numrin më të lartë të aplikimeve për çregjistrim edhe në këtë vit, e zinin BV me 312 aplikime.

Tabela nr. 11 Aplikim për ç'regjistrim në vitin 2023

Aplikimpër ç'regjistrim	Subjekte Aktiv më datë 01.01.2023	Aplikim për ç'regjistrim	Ç'regjistruar
BV	4053	254	92
BV+TVSH	463	16	22
BM	1546	19	6
Ente	60	0	0
OJF	55	0	0
Fermer	3011	0	3
Total	9188	289	123

Burimi: Sektori i Regjistrimit të DSHT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Në vitin 2023 kishin aplikuar për çregjistrim, 289 subjekte dhe ishin çregjistruar 123 prej tyre. Numrin më të lartë të aplikimeve për çregjistrim edhe në këtë vit, e zënë BV me 312 aplikime.

Për sa më sipër, subjektet të cilat janë me statusin “Kërkesë për çregjistrim” por nuk janë çregjistruar, nga shqyrtimi i dokumentave rezultojnë se janë subjekte të cilat kanë deklarata të padorëzuara ose subjekte me detyrime të papaguara, veprime të cilat kanë penguar DRT Vlorë në çregjistrimin e subjektit brenda afatit. Sektori i Regjistrimit në DRT Vlorë, pas konstatimit të problematikave u ka dërguar subjekteve shkresën “Njoftim i situatës financiare”, shoqëruar me udhëzimet përkatëse për vazhdimin e procedurës së çregjistrimit.

Subjekte të cilët kanë aplikuar për status pasiv dhe riaktivizime.

Tabela nr. 12 Aplikim për status pasiv e riaktivizim

Viti	Status pasiv	Riaktivizime
2021	1094	611
2022	1094	611
2023	723	721

Burimi: Sektori i Regjistrimit të DSHT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Regjistrimi i NIPT-it nga Fermerë dhe Ente/OJF

Në regjimin online në e-albania, të regjistromeve të NIPT-ve të reja, përfshihen edhe të gjithë fermerët, Entet/OJF. Konstatohet numri në rritje nga viti 2021 në 2023, me 177 NIPT-e të reja të regjistruara, i cili paraqitet në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 13 Regjistrimi i NIPT-ve

Viti	Fermerë	Ente/OJF
2021	676	6
2022	824	8
2023	853	7

Burimi: Sektori i Regjistrimit të DSHT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Për sa më sipër, regjistrimi i Fermerëve dhe Ente/OJF nuk japin efekte të drejtëpërdrejta në të ardhura tatimore, por regjistrimi i tyre si subjekt, reflektohet te subjektet e tjera në deklarimet tatimore që pasqyrojnë, kur kryhen blerje nga Fermerët e Ente/OJF.

Transferimet e subjekteve nga DRT Vlorë, në DRT të tjera dhe anasjelltas.

Nga auditimi u konstatua se, Sektori i Regjistrimit dispononte korenspondencat me DRT e tjera për subjektet e transferuara si dhe kishin kryer njoftimet për Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në vazhdim të procedurave të mëtejshme.

- Në vitin 2021, ishin transferuar nga DRT Vlorë për në DRT të tjera, 31 subjekte. Si dhe nga DRT të tjera për në DRT Vlorë, 27 subjekte;
- Në vitin 2022, ishin transferuar nga DRT Vlorë për në DRT të tjera, 39 subjekte, si dhe anasjelltas 58 subjekte;
- Në vitin 2023, rezultuan të transferuara nga DRT Vlorë për në DRT të tjera, 28 subjekte. Si dhe nga DRT të tjera për në DRT Vlorë, 30 të tilla.

Subjekte me “Kërkesë për çregjistrim”, në proces Përthithje dhe Likuidimi.

Subjektet të cilët bëjnë kërkesë për të kaluar në proces përthithje dhe likuidimi, fillimisht depozitojnë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) dokumentat e mëposhtëm:

1. *Vendimin e Asamblesë së Ortakëve;*
2. *Projektin e Marrëveshjes së përbashkët me shoqërinë përthithëse;*
3. *Pasqyrën Financiare të periudhës ushtrimore;*

Për subjektet në proces likuidimi dorëzojnë edhe

1. *Bilancin e likuidimit.*

Më pas kjo çështje shfaqet në sistemin tatimor.

Nga auditimi u konstatua se, Sektori i Regjistrimit i kishte dërguar informacione me shkresë zyrtare Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit për subjekte që ishin në proces përthithje e likuidimi, për vazhdimin më tej të procedurave nga ana e tyre. Numri i subjekteve sipas viteve të dhëna më poshtë:

Tabela nr. 13 Kërkesë për çregjistrim

Viti	Proces përthithje	Proces likuidimi
2021	2	5
2022	3	5
2023	0	5

Burimi: Sektori i Regjistrimit të DSHT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DRT Vlorë vazhdon me procedurat për kontroll të thelluar pasi subjekti ka depozituar dokumentat e mësipërm. Për miratimin e likuidimit përfundimtar subjekti duhet të plotësojë kushtet sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, si dhe nenit 21 “Transferimi i veprimtarisë ekonomike”, të Udhëzimit nr. 6, datë 30.01.2015, “Për TVSH-në”, i ndryshuar.

Aplikimi i kërkesave për vërtetime, lëshuar nga Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve, DRT Vlorë.

Nga Grupi i auditimit janë marrë me përzgjedhje rastësore praktika aplikimi të kërkesave për vërtetime të lëshuar nga Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve të DSHT, në lidhje me zbatimin e procedurave dhe afateve, nga ku rezultoi se për vitin 2021, ishin 6 raste në vonesa nga 1-10 ditë në lëshimin e vërtetimit, për vitin 2022 ishin 5 raste në vonesë nga 1-7 ditë në lëshimin e vërtetimit dhe për vitin 2023, rezultuan 2 raste në vonesë nga 1-7 ditë, të lëshimit të vërtetimit. Këto vërtetime janë lëshuar jashtë afateve të përcaktuara në Manualin e Shërbimit për Tatimpaguesit dhe Individit, kapitulli III.

Për sa më sipër, arrihet në konkluzionin se,

- *Drejtoria e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve ka funksionuar pa drejtor gjatë periudhës 2021-2023;*
- *Nga muaji shtator 2023, paraqitej vakant pozicioni i Përgjegjës të Sektorit Shërbimit ndaj Tatimpaguesve;*
- *Nga Përgjegjësi i Sektorit Shërbimit ndaj Tatimpaguesve nuk ishin kryer ndarja e detyrave periodike të specialistëve;*
- *Nga Përgjegjësi i Sektorit Shërbimit ndaj Tatimpaguesve nuk ishin kryer planet e punës, analizat mujore e vjetore, realizimi i tyre, si dhe raportet vjetore mbi performancën e Sektorit të Shërbimit ndaj Tatimpaguesve në periudhën 2021-2023;*
- *Nga auditimi rezultuan se, për vitin 2021, ishin 6 raste në vonesa nga 1-10 ditë në lëshimin e vërtetimit, për vitin 2022 ishin 5 raste në vonesë nga 1-7 ditë në lëshimin e vërtetimit dhe për vitin 2023, rezultuan 2 raste në vonesë nga 1-7 ditë, të lëshimit të vërtetimit.*

Parregullsitë e konstatuara nuk janë në përputhje me përcaktimet ligjore e nënljore të bëra në:

- Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Me nenin 14 e 15, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Me nenin 12, “Përgjegjësitë dhe detyrat e përgjegjësit të Sektorit/Zyrës së Asistencës & Shërbimit të Tatimpaguesve në DRT” të Rregullores së Funkcionimit të Administratës Rajonale Tatimore, miratuar me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, të Ministrit të MFE;
- Me nenin 15, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, i ndryshuar, si dhe Normat tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.

- Kapitulli III, Manuali i Shërbimit për Tatimpaguesit dhe Individit.

Personat që mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre:

- z. D, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit ndaj Tatimpaguesit, në Drejtorinë e Shërbimit ndaj Tatimpaguesit, DRT Vlorë, për periudhën janar 2021 -19 shtator 2023;
- z. S K, me detyrë Drejtor Rajonal të DRT Vlorë, për periudhën janar 2021-nëntor 2023.

Për sa më sipër, është mbajtur Akt konstatimi nr. 4, prot.,7986/6, datë 26.04.2024.

Për sa është trajtuar në Projekt raportin e auditimit nr. prot.,1111/28 datë 13.06.2024, nga subjekti i audituar DRT Vlorë, janë paraqitur observacionet me shkresën nr. 2991/25 prot., datë 10.07.2024, protokolluar në KLSH me nr. 1111/37, datë 15.07.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Unë D, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Asistencës dhe Shërbimit ndaj Tatimpaguesi deri në datën 19.09.2023, sqaroj se, gjatë periudhës 2021-2023, Drejtoria e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve në DRT Vlorë, nuk ka pasur organikë të kompletuar. Gjatë gjithë periudhës ka munguar drejtori i shërbimit. Në këto kushte nuk ishte e mundur të ndiqej linja hierarkike për lëvizjen e e dokumentacionit shkresor. Si rrjedhojë u përdor si metodë për organizimin dhe mbarëvajtjen e punës përdorimi i email-it zyrtar si mjet më eficient për ndarjen dhe zbatimin e detyrave.

- Për sa i përket shkresave të cilësuar si jashtë afateve ligjore për evadimin e tyre, theksojmë se në tërësi 13 rastet e përmendura në materialin tuaj nuk janë shkresa të cilat i nënshtrohen regjimit 1 ditor të evadimit, pasi nuk janë me protokoll të brendshëm të sektorit, por janë me protokoll dalës nga zyra e Protokoll/Arkivës, këto lloj shkresash e kanë afatin e evadimit 10 ditë pune, sipas manualit të funksionimit të Shërbimit ndaj Tatimpaguesit.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Për sa më sipër, nga subjekti i audituar nuk janë sjellë dokumente të rinj justifikues për të kundërshtuar konstatimet e grupit të auditimit në projekt raportin e auditimit, prandaj observacioni nuk merret në konsideratë.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua mosrealizim i planit të të ardhurave sipas zërave kryesore; mungesa e kryerjes së analizave periodike mbi progresin e realizimit të të ardhurave sipas fushave kryesore; vonesa dhe mangësi në përcjelljen e planeve të të ardhurave për Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë për vitin 2021 megjithëse të ardhurat tatimore bruto paraqiten me nivel realizimi në masën 103% në krahasim me planin e të ardhurave, ka një mosrealizim të zërave kryesore. Të ardhurat tatimore gjithsej (arkëtim) rezultojnë me mosrealizim në vlerën 115,623 mijë lekë, të ardhurat tatimore gjithsej (neto) me mos realizim në vlerën 195,808 mijë lekë, si dhe me mos realizim rezultojnë edhe zëri i tatimit mbi vlerën e shtuar (bruto) në vlerën 109,545 mijë lekë, tatimi mbi fitimin në vlerën 25,360 mijë lekë, të ardhurat nga taksa nacionale në vlerën 26,536 mijë lekë. Nga DRT Vlorë ka rezultuar se nuk është kryer asnjë analizë për arsyet që kanë ndikuar në mosrealizimin e këtyre zërave në të ardhurat tatimore. Për vitin 2022, të ardhurat tatimore total (bruto) rezultojnë me realizim në masën 105%, ndërkohë të ardhurat nga taksa nacionale dhe rimbursimi i kryer paraqiten me mosrealizim në vlerën 10,090 mijë lekë dhe 99,643 mijë lekë respektivisht për të cilat nuk është kryer një analizë mbi arsyet që mund të kenë ndikuar në mosrealizim. Për vitin 2023, të ardhurat tatimore total (bruto) rezultojnë me nivel realizimi në masën 100%, megjithëse është konstatuar mosrealizim në të ardhurat e të taksave nacionale në vlerën 22,496 mijë lekë, tatim i vlerës shtuar 411,526 mijë lekë, të ardhurat tatimore gjithsej (neto) 377,522 mijë lekë, kontributet e sigurimeve gjithsej 82,578 mijë lekë si dhe të ardhurat tatimore total (neto) 460,100 mijë lekë ku rezulton se nuk është asnjë analizë nga ana e DRT Vlorë për arsyet që kanë ndikuar në mos realizimin e këtyre zërave kryesor të të ardhurave.

Gjithashtu, nga auditimi konstatohet se ka vonesa në dërgimin e planit të të ardhurave, si dhe DRT Vlorë nuk disponon të gjitha shkresat me ndryshimet e planit të të ardhurave përgjatë periudhës së audituar pasi referuar të dhënave në shkresat përcjellëse nga DPT drejtuar DRT Vlorë rezulton se ka patur ndryshime të planit të të ardhurave me Akteve Normative. Për vitin 2023, konstatohet se plani i përcjellë nga DPT është hartuar duke e planifikuar realizimin e të ardhurave në nivel mujor dhe jo për të gjithë vitin, sikundër është vepruar në vitet paraardhëse 2021 dhe 2022. Si rrjedhojë, për vitin 2023 janë vendosur në dispozicion vetëm shkresat për miratimin e planit në nivel muaji ku konstatohet se mungon shkresa përcjellëse e planit të të ardhurave për muajin janar 2023 si dhe nga ana e DRT Vlorë nuk disponoheshin informacione mbi këtë vendimmarrje. Rezulton se plani i të ardhurave nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve përcillet për zbatim në DRT Vlorë dhe nuk ka projekt plane, analiza mbi parashikimin e arkëtimeve, apo raporte të kryera nga Sektori i Analizës dhe Statistikës dhe Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqet 14-33 të Raportit të Auditimit).

1.1-Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masa për dërgimin të planit vjetor drejt Drejtorive Rajonale Tatimore dhe brenda afateve në mënyrë që të ndërmerren veprimet operacionale në kohë për mbledhjen e të ardhurave. Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë, të kryejë analiza mbi faktorët që ndikojnë në realizimin ose mosrealizimin të të ardhurave tatimore sipas zërave dhe t'i përcjell këto të dhëna në mënyrë të dokumentuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, me qëllim hartimin e programeve sa më të drejtë dhe reale, si dhe të kryhen analiza periodike mbi progresin e realizimit të të ardhurave, me qëllim që të evidentohen përgjegjësitë e zbatimit të detyrave të strukturave përkatëse.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të Kontrollit në Vend për vitet 2021-2023, konstatohen mostrajtime të detajuara të pikave të programeve të kontrollit të miratuara; mos hedhje dhe vonesë në kohë të hedhjes së dokumenteve në sistemin C@ts, për kontrollet tatimore, mangësi në hartimin e bilancit material; si dhe në lidhje me inventarizimin e

dokumentacionit zyrtar (fizik) të praktikës, konstatohet mungesë dokumentacioni shoqërues të Raportit Përfundimtar të Kontrollit, për kontrollet tatimore si më poshtë:

- Tatimpaguesi “H” SHPK:

Nuk është bërë analizë e detajuar e blerjeve të përjashtuara, si dhe të blerjeve të investimeve nga furnitorë me shkallë tatimore 20 %, për të vërtetuar nëse këto blerje i shërbejnë subjektit në aktivitetin e tij.

Programi i kontrollit nuk është hedhur në sistemin C@ts; Formulari nr. 3, i hedhur në sistemin C@ts nuk ka nënshkrimin e inspektorit të kontrollit; Raporti nuk ka të bashkëngjitur si pjesë përbërëse të tij “*Formularin-pyetësor i vetëdeklarimit para kontrollit*” që i vihet në dispozicion tatimpaguesit së bashku me njoftimin për kontroll dhe plotësohet prej tij në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, neni 81/f, brenda 30 ditëve para fillimit të kontrollit në vend, të përcaktuar në njoftimin për kontroll, sipas formatit të miratuar (shtojca 1) me Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar.

- Tatimpaguesi “F” SHPK:

Blerjet brenda vendit me shkallë 20%, për periudhën mars-dhjetor 2018, me vlerë 221,640,407 lekë, si dhe për periudhën janar - dhjetor 2019, me vlerë 320,843,262 lekë, nuk janë analizuar se çfarë përfaqësojnë këto blerje dhe nëse i shërbejnë natyrës së aktivitetit që kryen tatimpaguesi.

Autorizimi për kontroll tatimor, njoftimi i kontrollit, programi i kontrollit, vetë deklarimi për konfliktin e interesit, si dhe procesverbalet e plotësuara më datë 17.05.2021, ditën e fillimit të punës në subjekt, janë pasqyruar në sistemin C@ts më datë 23.07.2021, *veprime në kundërshtim me Manualin e Kontrollit, pika 2.2 “Pasqyrimi i veprimeve të kontrollit në programin informatik të tatimeve C@ts”*.

Tatimpaguesi “H P” SHPK:

-Nga auditimi i dy raporteve të kontrollit tatimor për periudhën tatimore shkurt 2020 - janar 2022, si dhe shkurt 2022 - qershor 2023, në drejtim të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, nisur nga natyra e aktivitetit të tregtisë me pakicë të karburantit, e cila zhvillohet çdo ditë të javës, nga e hëna në të diel, nga ana e inspektorit të kontrollit nuk është bërë analizë për pagën e “*shitësve në pikat e karburanteve*”, ku sipas përcaktimeve të neni 87, të “*Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, duhet që pagesa orare të jetë minimalisht 25% më e lartë se pagesa minimale orare, gjithashtu për çdo punë të kryer nga ora 19.00-22.00, jep të drejtën e shtesës mbi pagë jo më pak se 20%, sipas përcaktimeve të nenit 81 të “*Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar.

-Raporti nuk ka të bashkëngjitur si pjesë përbërëse të tij “*Formulari-pyetësor i vetëdeklarimit para kontrollit*”, veprim në kundërshtim me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6.

-Në 5 raste nga auditimi i raportit të kontrollit të ushtruar në tatimpaguesit “S”, “F”, “T” SHPK, “A”, “T”, kanë rezultuar mangësi në realizimin e bilancit material, pasi nuk është përcaktuar se si është përzgjedhur kampioni për realizimin e bilancit material, nuk ka të dhëna se nga është marrë gjendja fizike që përkon me datën e fillimit të periudhës së kontrollit, nuk ka të dhëna për sasi të hyrje dhe dalje për çdo artikull gjatë periudhës objekt kontrolli, fakt që e bën të pamundur nxjerrjen e konkluzionit për saktësinë dhe vërtetësinë e bilancit material të deklaruar nga tatimpaguesi.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 80, “*Kontrolli tatimor*” të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, nenin 59 “*Përgjegjësitë dhe detyrat e inspektorit të sektorit të kontrollit në vend*”, të “*Rregullores së funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore*”, i ndryshuar, miratuar nga Ministri i MFE me

Urdhri nr. 192, datë 12.08.2020, Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.5, Kapitulli VIII, pika 8 dhe Programeve të kontrollit të miratura në DRT Vlorë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë të marrë masa që për çdo kontroll tatimor në vend, të zbatohen me përpikmëri dhe në mënyrë të detajuar të gjitha pikat e Programit të kontrollit tatimor të miratuar, duke dhënë një situatë të qartë financiare të veprimtarisë së tatimpaguesve.

2.2 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë të marrë masa që të zbatohen procedurat dhe afatet e përcaktuara ligjore në lidhje me inventarizimin e dokumentacionit zyrtar (fizik) të praktikës së kontrollit tatimor tek tatimpaguesit; pasqyrimin në kohë të akteve të kontrollit (autorizime, program kontrolli, akt konstatime etj) në sistemin informatik tatimor; të vë në dispozicion të tatimpaguesit “Formularin-pyetësor i vetëdeklarimit para kontrollit” së bashku me njoftimin për kontroll.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të Kontrollit në Vend për vitet 2021-2023, në lidhje me përzgjedhjen e tatimpaguesve që do të kontrollohen, konstatohet se në vitin 2021, nga 79 kontrolle të planifikuara, 12 kontrolle janë propozuar nga DRT apo 15% e totalit, në vitin 2022 nga 142 kontrolle të planifikuara, 25 kontrolle janë propozuar nga DRT apo 17.6 % e totalit, në vitin 2023 nga 155 kontrolle të planifikuara, 17 kontrolle janë propozuar nga DRT apo 10.9 % e totalit. Sa më sipër nuk janë respektuar kriteret e përcaktuara në Manualin e Kontrollin Tatimor në Vend, ku 30% e tatimpaguesve që do të përfshihen në planin e kontrollit të çdo muaji, seleksionohen bazuar në propozimet e dërguara nga çdo DRT në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor në DPT dhe 70% e tatimpaguesve që do të përfshihen në planin e kontrolleve të çdo muaji seleksionohen në bazë të analizës së riskut nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut në DPT, çka mund të sjellë pasoja në aftësinë zbuluese të kontrolleve tatimore.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

3.2 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë në bashkëpunim me DPT të marrë masa në vijimësi për respektimin e kriterëve për përzgjedhjen e tatimpaguesve që do të kontrollohen me qëllim rritjen e aftësisë zbuluese të kontrolleve tatimore.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, gjatë zhvillimit të aktivitetit të tyre, shoqëritë “E” SHPK, “K”, “K.” SHPK, “T” SHPK, në periudha të ndryshme kohore kanë kryer transaksione huamarrje dhe huadhënie me ortakun (kreditime dhe debitime nga llogaria e ortakut), për llogari të shoqërive përkatëse, me qëllim mbarëvajtjen normale të aktivitetit tregtar të shoqërive, sipas përshkrimeve në raportet e kontrolleve të inspektorëve tatimor. Nga ana e inspektorit nuk është bërë informacioni RAD (Raportim i Aktivitetit të Dyshimtë) në lidhje me shumat e parave të cilat kanë kaluar si hua ortaku ndaj shoqërisë, veprime këto jo në përputhje me dispozitat e ligjit Nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit” i ndryshuar, neni 18.1 si dhe UMF Nr.16, datë 16.2.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, neni 5, pika 1 dhe 2. Këto pagesa nuk konfirmohen me saktësi në raportet e kontrollit tatimor, si pagesa të kryera nëpërmjet sistemit bankar dhe të pasqyruara me prova në aktet e mbajtura nga inspektorët e kontrollit.

-Në lidhje me transaksionet kur ortaku i jep shoqërisë hua ose e anasjelltas, pa aplikuar interesa, grupi i audituesve gjykon se kemi të bëjmë me veprime të cilat janë pa thelb ekonomik dhe jo në

përputhje me parimin e vlerës së tregut. Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e pikave b, c, dh të nenit 71, germat a, b, c, ç të nenit 71/2 dhe germa ç, të nenit 72, të Ligjit Nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 24 datë 02.09.2008, i ndryshuar, për të cilat duhet të ishte kryer vlerësim alternativ i situatës financiare së shpenzimeve të interesit të pa llogaritura në PASH, si ri karakterizim të ardhurash duke sjellë si pasojë detyrime tatimore. Referuar kuadrit legjislativ tatimor, rezulton se ortaku dhe shoqëria me përgjegjësi të kufizuara janë entitete të ndryshme dhe me personalitet juridik të ndarë, sipas përcaktimeve në Ligjin Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Sipas legjislacionit tatimor si shoqëria dhe ortaku konsiderohen si “Palë të lidhura”, meqenëse ortaku ka ndikim në vendimmarrjen e shoqërisë për shkak të zotërimit të kuotave/aksioneve të saj sipas përcaktimeve në Ligjin Nr. 42/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe Udhëzimin Nr. 16, datë 18.6.2014 “Për transferimin e çmimit”, gjë që sjell se çdo marrëdhënie apo transaksion midis tyre duhet t’u përmbahet kushteve dhe parimeve të tregut (Arm’s Length). Megjithëse nuk ka të përcaktuar saktë dhe qartë mënyrën e procedimit në legjislacionin tatimor të fushës së llogaritjes së interesave dhe detyrimeve tatimore të rillogaritura në rastet e huadhënies nga llogaria e ortakut drejt llogarisë së shoqërisë ose e anasjelltas, referuar Kodit Civil i miratuar me Ligjin Nr. 7850 datë 29.07.1994, i ndryshuar, nenet 1050-1055, Kreu XIX “Huaja”, cilësohet se huamarrësi duhet t’i paguajë huadhënësit një interes në rastet kur ekziston një marrëveshjeve ndërmjet palëve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të hartojnë një metodologji të qartë dhe të saktë nënligjore, ose një manual udhëzues për analizimin e llogarisë së ortakut, kur konstatohen se jepen hua ose shuma nga llogaria e ortakut në favor të llogarisë së shoqërisë, ku ata janë ortakë ose anasjelltas, apo nga individë të tjerë, për mënyrën e kryerjes së pagesës nëpërmjet sistemit bankar apo cash si dhe për raste kur këto hua jepen pa interes, nisur edhe nga përcaktimet ligjore që parashikon Kodi Civil.

Menjëherë dhe brenda vitit 2024

4.2 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë pasi të ketë analizuar situatën e kontrollit të kryer në subjektet “E” SHPK, “K”, “K.” SHPK, “T” SHPK, referuar gjetjeve nga auditimi i KLSH-së, të marrë masat e nevojshme që në bashkëpunim me Administratën Tatimore, të identifikojë burimin e detyrimeve që kanë shoqëritë dhe transaksionet e kryera midis palëve, duke bërë informacioni RAD (Raportim i Aktivitetit të Dyshimtë) në lidhje me shumatat e parave të cilat kanë kaluar si hua ortakut ndaj shoqërisë.

Menjëherë dhe brenda vitit 2024

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raportit të kontrollit të ushtruar në “T” SHPK, me NIPT KO, u konstatua se:

Nga kontrolli i deklarimeve të subjektit në sistemin C@ts për TVSH, dhe verifikimi për pagesat e tatim fitimit 2021, rezulton se subjekti ende nuk ka gjeneruar të ardhura apo dhe shpenzime referuar Pasqyrës së të Ardhurave dhe Shpenzimeve të vitit 2021. Nga Akt-Ekspertimit nr. 14 prot, datë 18.10.2022, hartuar nga Shoqëria “T” SHPK, deri në datë 23.09.2022, realizimi i punimeve për ndërtimin e 2 objekteve (vilave) është në vlerën 48,210,072 lekë me TVSH, dhe objekti konsiderohet i përfunduar, ndërkohë që për periudhën objekt kontrolli nga pala

investitore “I” SHPK nuk është deklaruar asnjë blerje në sistemin C@ts, gjithashtu për llogari të palës investitore “I” SHPK nuk është lëshuar asnjë faturë shitje situacion punimesh nga subjekti i ndërtimit “Gj” SHPK. Sa më sipër konstatohet se moslëshimi faturave si nga shitësi dhe mospranimi faturave nga blerësi për ti regjistruar në librat e blerjes për efekt të deklarimit të formularëve të tatimit mbi vlerën e shtuar, gjatë periudhës objekt kontrolli, bie në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit Nr. 6, datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, Neni 20 - “Punimet e ndërtimit, kryerja e procesit të ndërtimit, si dhe të mirëmbajtjes”.

- Me shkresën nr. 6303/10 prot, datë 14.12.2022, dërgimi informacioni, Drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve/Drejtorisë së Hetimit Tatimor, nga DRT Vlorë në vijim të problematikave të konstatuara nga kontrolli në vend, ku ka rezultuar se deri në momentin e kontrollit për ndërtimin e objektit në fjalë nuk është prerë asnjë situacion dhe asnjë faturë tatimore, materiali është kaluar për procedurë të mëtejshme në DPT me qëllim verifikimin e deklarimeve të subjektit ndërtues “Gj” SHPK me NIPT JH.

- Me shkresën nr. 6303/11 prot, datë 14.12.2022, dërgimi informacioni, Drejtuar Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, nga DRT Vlorë në vijim të problematikave të konstatuara nga kontrolli në vend, materiali është kaluar për procedurë të mëtejshme në DTM me qëllim verifikimin e deklarimeve të subjektit ndërtues “Gj” SHPK me NIPT JH.

- DRT Vlorë nuk administron shkresë kthim përgjigje nga DPT dhe DTM, në lidhje me ecurinë e mëtejshme të kësaj praktike.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

5.1-Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë në bashkëpunim me DPT, në vijim të problematikave të konstatuara nga kontrolli në vend, të ndjekë ecurinë e praktikës, dërguar për procedim të mëtejshme në DPT, me qëllim verifikimin dhe analizimin e deklarimeve të subjektit ndërtues “Gj” SHPK me NIPT JH.

Brenda vitit 2024

6. Gjetje nga auditimi: Në 4 raste nga auditimi i raportit të kontrollit të ushtruar në tatimpaguesit “S”, “F”, “R”, “A”, për zbatimin e kërkesave të ligjit Nr. 9136, datë 11.02.2003 “Për mbledhjen e detyrueshme të kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore”, kanë rezultuar problematikat si më poshtë:

-Nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor nuk janë analizuar kontratat individuale të punës midis shoqërisë dhe punonjësve, në lidhje me përputhshmërinë e tyre me përcaktimet e dispozitave të Kodit të Punës në R.SH.

- Nuk janë analizuar regjistrat që duhet të mbajë tatimpaguesi sipas përcaktimeve të nenit 15 “Mbajtja e regjistrimeve” të Ligjit Nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Nuk ka një analizë të llogaritjes së pagës dhe elementëve përbërës të saj sipas përcaktimeve të dispozitave të nenit 119, të Kreut XI të Kodit të Punës në R.SH.

- Janë konstatuar parregullsi në llogaritjen e ditëve dhe orëve të punës dhe pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore.

-Gjithashtu referuar natyrës së aktivitetit që ushtrojnë tatimpaguesit si tregti me pakice e shumice e karburantit, farmaci, hoteleri dhe orareve të ushtrimit të aktivitet gjatë një ditë 24 orë, si dhe gjatë ditëve të pushimit e shtunë dhe e diel, konstatohet se nuk është bërë një analizë për deklarimin e pagave reale me qëllim llogaritjen dhe pagesën detyrimeve për kontributet e

sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Ndërkohë në lidhje me konstatimin për llogaritjen e shtesës mbi pagë, në mungesë të të dhënave për regjistrat që duhet të mbajë tatimpaguesi, për efekt të llogaritjes së ditëve dhe orëve të punës për pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe referuar natyrës së aktivitetit që ushtron ky tatimpagues, grupi i audituesve gjykon se janë arsye themelore për të kryer rivlerësimin e pagave, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, për punonjësit me paga të deklaruara jo konform përcaktimeve të legjislacionit, në lidhje me këtë tatimpagues i cili ka plotësuar deklarata tatimore që përmbajnë të dhëna të pasakta ose të falsifikuara dhe nuk mban dhe ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve, veprime të cilat janë në kundërshtim me germën b, c të nenit 71, germa a e nenit 72, pika 3, neni 119 e Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.24 date 02.09.2008, i ndryshuar.

Theksojmë se fenomeni i mosdeklarimit të pagave reale shoqërohet me pasoja sociale për të punësuarit, ndikimin në zhvillimin ekonomik të vendit si dhe pasoja të drejtpërdrejta në skemën e pensioneve, duke sjellë uljen e ndjeshme të nivelit të pensionit në raport me pagën mesatare që ka vendi.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

6.1-Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror të Punës të marrë masat në vijimësi për monitorimin e subjekteve, të cilat referuar natyrës së aktivitetit që ushtrojnë si farmaci, karburant, hoteleri etj., si dhe orareve të ushtrimit të aktivitetit gjatë një dite pune si dhe gjatë ditëve të pushimit e shtunë dhe e dielë, mbartin risk për deklarimin e pagave reale me qëllim llogaritjen dhe pagesën detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Në 3 raste nga auditimi i raporteve të kontrollit të ushtruar në tatimpaguesin “S” me NIPT KM, kanë rezultuar mangësi si më poshtë:

a- Nuk është bërë analiza e kartës teknologjike për të rakorduar sasinë e prodhuar për produktet Bitum natyral, Bitum i pastruar bllok, Bitum i fraksionuar, Bitum RAW (natyral), Qymyr nga karriera, si dhe sasinë në dalje për prodhim bitumi dhe/ose djegie, gjithashtu nuk administrohen të dhëna për sasinë në shitje dhe në blerje të produkteve por vetëm në vlera, çka e bën të paqartë metodologjinë e kontrollit të aplikuar në këtë rast nga inspektori i kontrollit.

b- Karta teknologjike e paraqitur, nuk është e miratuar nga organet shtetërore përkatëse, veprim në kundërshtim me përcaktimet e bëra në VKM nr. 434, datë 20.05.2015 “Për përcaktimin e normativave për humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë prodhimit, magazinimit, transportimit etj... të njohura për qëllime fiskale”, neni 4, 7, 8 dhe 9.

c- Bilanci material është bërë për periudhën 01.01.2020 - 31.07.2021, ndërkohë që kërkesa për rimbursimin e TVSH sipas njoftimit për kontroll dhe programit të kontrollit është për periudhën Janar 2020 - Maj 2021. Sa sipër rezulton se janë 2 muaj Qershor - Korrik 2021 për të cilat është bërë kontrolli i bilancit material por që nuk është përcaktuar në program kontrolli, në kundërshtim me përcaktimet e Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1, germa a, ku citohet “Njoftimi i kontrollit tatimor përmban periudhën ose periudhat tatimore, për të cilat kryhet kontrolli tatimor”.

ç- Nuk është analizuar çfarë përfaqësojnë “*autofaturime punime zbulimit sipas 3 mujoreve*”, nuk ka të dhëna si kanë dalë këto vlera, zërat e punimeve që janë kryer, çfarë dokumentacioni shoqërues dhe justifikues është kontrolluar nga Inspektori për të saktësuar vlerën e këtyre punimeve, mungon analiza për situacionet në lidhje me hyrjet dhe sasinë e situacionuar në dalje, nuk ka të dhëna nëse kanë qenë objekt kontrolli nga institucione të tjera kompetente si AKBN etj, dhe a janë administruar këto raporte kontrolli nga Inspektori.

Nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor nuk rezulton të jetë kryer një kontroll i këtyre situacioneve në mënyrë analitike se çfarë kanë pasur të përfshirë, në elementët e materialeve të para, kostos së punës direkteve dhe shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit (ku përfshihen material indirekte, puna indirekte dhe shpenzime të tjera), për të gjykuar me komponentët e secilit situacion dhe krahasimin me blerjet e tatueshme.

Nga ana tjetër, nga inspektori tatimor, konstatohet se nuk është kryer një analizë në lidhje me plotësimin e kushteve për klasifikimin e këtyre operacioneve të realizuara nga tatimpaguesi si investime apo jo referuar kërkesave të legjislacionit fiskal dhe standarteve të raportimit financiar. Mungesa e analizës dhe trajtimi i gabuar nuk janë në përputhje me kërkesat e ligjit për kontabilitetin dhe standardeve në zbatim të tij, konkretisht SKK 5 “*Aktivitet afatgjata materiale dhe jomateriale*”.

d- Nuk rezulton të jetë kryer një analizë në lidhje me licencat e kërimit apo zbulimit të tatimpaguesit dhe klasifikimi i tyre si shpenzime kërkimore të cilat nuk plotësojnë kushtet për njohjen si aktiv (investim) apo shpenzime zhvillimi (të cilat kapitalizohen në aktiv të pasqyrave fiannciare dhe plotësojnë kushtet për njohjen si investim). Për më tepër, referuar dipozitave të Udhëzimit nr. 6, datë 30.01.2015 “*Për tatimin mbi vlerën e shtuar*”, situacionet, referohen të përdoren në fushën e punimeve të ndërtimit, sipas përcaktimeve të nenit 20 “*Punimet e ndërtimit*”, ndërkohë që tatimpaguesi nuk është i licencuar për punime ndërtimore dhe ushtron veprimtarinë sipas objektit të tij në fushën e nxjerrjes së mineraleve.

e- Mungon analiza e kostos së mallrave të raportuara nga tatimpaguesi, në lidhje me komponentët e kostos së paraqitur në raport kontrolli referuar kostos së materialeve të para si dhe procesit të prodhimit.

f- Nga ana e inspektorit tatimor nuk është shkëmbyer informacion apo të jenë marrë konfirmime nga AKBN në lidhje me treguesit e inventarit të raportuar të nxjerrë apo investimet e realizuara përgjatë periudhës objekt kontrolli, por janë marrë të mirëqena deklaratimet e tatimpaguesit. Në këtë mënyrë nuk është arritur siguri në lidhje me sasinë e nxjerra/përpunuara dhe shitura drejt palëve të treta apo investimet e pretenduara me anë të vetëfaturimeve, të cilat vazhdimisht kanë krijuar një tepricë kreditore të TVSH-së.

g- Nuk është bërë analiza për blerjet e tatueshme në lidhje me kredinë apo leasing, për vitin 2020 në vlerën 2,698,139 lekë dhe periudhën Janar - Korrik 2021 në vlerën 1,540,486 lekë, çfarë përfaqësojnë këto blerje.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

7.1-Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë për tatimpaguesin “S” me NIPT KM, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “*Ri kontrolli tatimor*” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi kontrollin e ushtruar në tatimpaguesin “V” me NIPT KE në raportin e kontrollit janë evidentuar mangësi dhe parregullsi në dokumentacionin mbi të cilin është kredituar TVSH:

-Mungon në dosjen e kontrollit nënshkrimi i deklaratës së konfliktit të interesit. Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, ka lidhur kontratë shërbimi me inxhinier ndërtimi, A. K. i cili ka kryer akt konstatimin teknik në datë 10.05.2021 është njëkohësisht edhe drejtues teknik i kompanisë E. SHPK, projektuese e projekt-arkitekture për Hotelin në kompleksin M, me drejtues ligjor A.

-Sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se në leje ndërtimit nr. 406, datë 29.06.2017 të miratuar për ndryshim funksioni nga Banim në Hotel është miratuar vetëm për objektin H and jo për objektin H1, për të cilën subjektit ndërtues i është rimbursuar TVSH referuar Akt Konstatimit Teknik në datë 10.05.2021.

- Rezultojnë ndryshime në planimetritë e sheshit të ndërtimit sipas dokumentacionit në dosjen e kontrollit, ka mospërputhje të sipërfaqes së ndërtimit, me një diferencë 33 m², nga 5250 m² është ndryshuar në 5283 m², si dhe ka ndryshuar kati numri i kateve nëntokë, nga 1 kat në planimetrinë fillestare në 2 kate nën tokë. Në projektin-arkitekturorë objekti “Hotel 4 kat me një kat pjesërisht nën tokë” rezulton se është 1 kat pjesërisht nën tokë ndërkohë në leje ndërtimi me ndryshim funksioni, nr. 406, datë 29.08.2017.

-Rezultojnë mospërputhje dhe ndryshime nga leja fillestare e ndërtimit në lejet e trajtuara më vonë të cilat nuk janë analizuar në Akt Konstatimit Teknik në datë 10.05.2021 dhe Raport Kontrolli.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë/Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të administrojë në rrugë zyrtare informacion dhe dokumentacion justifikues në lidhje me mangësitë dhe parregullsitë e konstatuara në procedurën e kontrollit tatimor, konform përcaktimeve ligjore në fuqi.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi kontrollin e ushtruar në tatimpaguesin “M” me NIPT KE janë konstatuar mangësi të cilat përfshijnë:

a- Periudha e kontrolluar në raport kontrolli për vitin 2021, përfshin muajt Janar – Gusht 2021, ndërkohë që referuar programi të kontrollit periudha e kontrollit është deri në Shkurt 2021, sipas kërkesës për rimbursimin e TVSH së tatimpaguesit, duke mos përputhur analizën e kryer në raport kontrolli me kërkesën e tatimpaguesit, në kundërshtim me përcaktimet e manualit të kontrollit tatimor dhe duke certifikuar për rimbursim në mënyrë të padrejtë tepricën kreditore të TVSH-së së miratuar.

b- Kontrolli në këtë tatimpagues është kryer në vijim të kërkesës së tatimpaguesit nr. Prot, 21178 date 24.11.2021 në Drejtorinë Përgjithshme të Tatimeve, ku ka bërë kërkesën për rimbursim. Përgjatë periudhës së kontrolluar subjekti ka një pjesë të aktivitetit të përqendruar në eksporte si dhe gjendja e tepricës kreditore të tvsh ka ardhur edhe nga akumulimi i gjendjes së inventarit në rritje në mbyllje të periudhës në krahasim me çeljen e periudhës së kontrolluar. Gjithashtu, komponenti tjetër nga është akumuluar teprica kreditore e TVSH-së vjen si rrjedhojë e deklaramit të punimeve për nxjerrjen e mineralit si investime në formën e autofaturimeve duke i deklaruar në blerje dhe në shitje si autongarkesë në rubrikën e TVSH-së. Këto autofatura të hartuara nga ana e tatimpaguesit nuk rezultojnë të jenë të detajuara në raportin e kontrollit tatimor. Sipas shpjegimit të inspektorit tatimor ato përfshijnë situacione për punime të realizuara për nxjerrjen e mineralit, “për zbulime në karrierë”, të cilat janë trajtuar si investime.

c- Nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor nuk rezulton të jetë kryer një kontroll i këtyre situacioneve në mënyrë analitike se çfarë kanë pasur të përfshirë, në elementët e materialeve të para, kostos së punës direkteve dhe shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit (ku përfshihen material indirekte, puna indirekte dhe shpenzime të tjera), për të gjykuar me komponentët e secilit situacion dhe krahasimin me blerjet e tatueshme.

Nga ana tjetër, nga inspektori tatimor, konstatohet se nuk është kryer një analizë në lidhje me plotësimin e kushteve për klasifikimin e këtyre operacioneve të realizuara nga tatimpaguesi si investime apo jo referuar, kërkesave të legjislacionit fiskal dhe standarteve të raportimit financiar. Mungesa e analizës dhe trajtimi i gabuar nuk janë në përputhje me përkesat ligjit për kontabilitetin dhe standarteve në zbatim të tij, konkretisht SKK 5 *“Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale”*.

Kjo pasi nga ana në raport kontrolli nuk është detajuar lloji i investimit për punime në karrierë dhe nëse këto punime do të kontribuojnë në sjelljen e përfitimeve të ardhshme ekonomike në mënyrë që të plotësohen kushtet për njohjen e tyre si aktiv në kontroll të njësisë ekonomike.

ç- Nuk rezulton të jetë kryer një analizë në lidhje me lishencat e kërkimit apo zbulimit të tatimpaguesit dhe klasifikimi i tyre si shpenzime kërkimore të cilat nuk plotësojnë kushtet për njohjen si aktiv (investim) apo shpenzime zhvillimi (të cilat kapitalizohen në aktiv të pasqyrave fiannciare dhe plotësojnë kushtet për njohjen si investim). Për më tepër, referuar dipozitive të Udhëzimit nr. 6, datë 30.01.2015 *“Për tatimin mbi vlerën e shtuar”*, situacionet, referohen të përdoren në fushën e punimeve të ndërtimit, sipas përcaktimeve të nenit 20 *“Punimet e ndërtimit”*, ndërkohë që tatimpaguesi nuk është i licenuar për punime ndërtimore dhe ushtron veprimtarinë sipas objektit të tij në fushën e nxjerrjes së mineraleve. Për rrjedhojë, trajtimi i autofaturimeve me anë të situacioneve, për operacionet e paraqitura të nxjerrjes së mineralit paraqitet i gabuar sipas kuadrit të raportimit financiar dhe atij fiskal. Grupit të auditimit, këto situacione nuk iu vendosën në dispozicion në mënyrë që të gjykohet në lidhje me komponentët e përfshirë në të, si përfshirja e kostos së punës në situacion dhe shpenzimet e tjera të përgjithshme të prodhimit.

d- Nga problematikat e evidentuara në raportin e kontrollit përfshihen gjithashtu mungesa e analizimit të kostos së mallrave të raportuara nga tatimpaguesi, e cila rezulton të jetë marrë e mirëqenë nga ana e inspektorit tatimor, pasi nuk rezulton të jetë kryer një analizë në lidhje me komponentët e kostos së paraqitur në raport kontrolli referuar kostos së materialeve të para si dhe procesi të prodhimit. Mungesa e analizës dhe trajtimi i gabuar nuk janë në përputhje me kërkesat ligjit për kontabilitetin dhe standardeve në zbatim të tij, konkretisht SKK 4 *“Inventarët”*.

-Për tatimpaguesin “M”, NIPT KE, për periudhën e kontrollit shtator 2021- qershor 2023, janë evidentuar mangësi në rakordimin e të dhënave për periudhën shtator-dhjetor 2021, në blerjet brenda vendit sipas FDP janë më shumë, në vlerën 18,109,523 lekë ndërkohë referuar tabelës *“Blerje nga furnitorë vendas me TVSH 20%”* të analizuar sipas natyrës dhe furnitorëve nga inspektori i kontrollit paraqiten në shumën 18,702,663 lekë, pra me një diferencë në vlerën 593,140 lekë.

e- Referuar të dhënave në raportin e kontrollit, Tatimpaguesi, “M” NIPT KE, ushtron aktivitetin në nxjerrjen dhe përpunimin e mineralit të bitumit në zonën e Selenicës dhe rezulton të jetë palë e lidhur me tatimpaguesin tjetër të përzgjedhur për kontroll, Selenicë Bitumi me NIPT KM, pasi kontrollohen nga të njëjtët persona të ngarkuar me qeverisjen e këtyre subjekteve. Kjo rezulton edhe nga marrëdhëniet e analizuara në shitje dhe në blerje ndërmjet tyre. Nga auditimi konstatohet se, një analizë mbi transaksionet e kontrolluara ndërmjet palëve të lidhura sipas përcaktimeve të ligjit për tatimin mbi të ardhurat nuk rezulton të jetë realizuar nga inspektori

tatimor në raportin e kontrollit tatimor. Nuk janë vendosur në dispozicion, situacione për punime në karrierë nga tatimpaguesi “S”.

f- Inspektori i kontrollit, në raportin përfundimtar të kontrollit, nuk ka analizuar se çfarë përfaqësojnë autofaturat, si është arritur në këto vlera, zërat e punimeve të kryera, cilit dokumentacion justifikues dhe shoqërues i është referuar inspektori apo ka kontrolluar për të saktësuar vlerën e punimeve të këtyre punimeve, nuk ka të dhëna nëse subjekti ka qënë objekt kontrolli nga inspektori si AKBN, dhe nëse inspektori i kontrollit i ka administruar këto raporte. Nuk rezultojnë të jenë detajuar në raportin e kontrollit, autofaturat e hartuara nga tatimpaguesi, nuk është analizuar nga inspektori se për çfarë është përdorur vetëfaturim që ka rritur TVSH e kreditueshme nga blerjet me 2,236,926 lekë për periudhën Shtator - Dhjetor 2021 dhe 1,805,679 lekë për periudhën Janar - Dhjetor 2022.

Nuk rezulton të jetë kryer analizë nga inspektori për “Blerje të investimeve vendase me TVSH 20 %”, nga subjekti “B” me NIPT LA, në vlerë të tatueshme 11,772,500 lekë dhe TVSH e zbritshme në vlerën 2,354,500 lekë, për periudhën Janar - Dhjetor 2022, për të cilat tatimpaguesi ka deklaruar blerje të investimeve vendase për punime në karriere. Këto në kundërshtim me nenin 80, “Kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, me nenin 59 “Përgjegjësitë dhe detyrat e inspektorit të sektorit të kontrollit në vend”, të “Rregullores së funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore”, i ndryshuar, miratuar nga Ministri i MFE me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, Programit të kontrollit nr. 2465/2 prot, datë 26.04.2023, si dhe me Manualin e Kontrollit Tatimor. Nuk u vendosën në dispozicion situacionet në mënyrë që të gjykohej në lidhje me komponentët e përfshirë në të, si përfshirja e kostos së punës në situacion.

g- Nga analiza e bilancit material për periudhën janar-dhjetor 2022, në vlerë konstatohet se gjendja fillestare dhe hyrjet ka sasi të pamjaftueshme për të shitur mallra, gjë që dëshmon në mosvërtetësinë e sasisë së deklaruar si të nxjerrë të mineralit për aq kohë që vërtetohet shitje qymyri mbi sasi të gjendje dhe të blera, si në sasi dhe si në vlerë duke ju referuar bilancit material.

-Në bilancin material të periudhës Janar - Qershor 2023, nuk rakordojnë sasi të mineralit, qymyr bituminoz të gjendjes fillestare dhe hyrjet me gjendjen në fund të periudhës së kaluar, Janar - Dhjetor 2022, si dhe nuk është bërë bilanci material për B, ndërkohë që në fund të periudhës së vitit të kaluar ka gjendje në mbyllje të mineralit. Nuk është analizuar nga inspektori i kontrollit, mos përfshirja në bilancin material e mineralit, B.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

9.1-Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë për tatimpaguesin Mineral Bitumen me NIPT KE, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i DRT Vlorë, u konstatua se Sektori i Kontrollit dhe Monitorimit nga Zyra, nuk ka përmbushur detyrimin për monitorimin e bizneseve me rritje te teprikes kreditore nga viti 2021 në vitin 2023, në kundërshtim me përcaktimet e “Rregulloren e funksionimit të administratës rajonale tatimore” miratuar me Urdhër nr. 192, datë 12.08.2020, Manualin për Kontrollin Tatimor.

Gjatë periudhës 2021-2023, pavarësisht se konstatohet një rritje si pasojë e rritjes në aktivitetin e hotelierisë dhe rritjen e tepricës kreditore si pasojë e rolit të investitorit të aseteve për të cilat kreditohet TVSH, nga ana tjetër konstatohet rritje të tepricës edhe në sektorë të tjerë që përfshijnë tregti apo prodhim. Për sa më sipër, konstatohet se për periudhën e auditimit, kemi subjekte me tepricë kreditore kryesisht në rritje me aktivitet tregti dhe prodhim të cilat risin riskun e evazionit nëpërmjet mosdeklarimit të shitjeve. Këto subjekte mbajnë peshën më të madhe dhe teprica kreditore e tyre është rritur ndjeshëm nga 01.01.2021 deri në me 31.12.2023. Fakti që teprica kreditore nuk ndryshon apo ka pësuar rritje, nga ana e Inspektorit përkatës për këtë periudhë nuk është kërkuar informacion, analizuar apo propozuar për kontroll, kjo tregon veprime dhe mos veprime që ndikojnë në uljen e performancës në lidhje me deklaratimet tatimore të tatimpaguesit. Për këta subjekte nuk është kryer verifikimi në vend nëpërmjet kombinimit me sektorin e zbatimit/DVT nëse kanë gjendje malli apo aktive në vendndodhjet e deklaruara të biznesit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqet 173-192 të Raportit të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: DRT Vlorë, nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra, të marrë masa menjëherë për monitorimin e tatimpaguesve me rritje të vazhdueshme të tepricës kreditore, kryesisht në rritje me aktivitet tregti dhe prodhim të cilat risin riskun e evazionit nëpërmjet mosdeklarimit të shitjeve, duke kërkuar informacion, analizuar apo propozuar për kontroll, verifikimi në vend nëpërmjet kombinimit me sektorin e zbatimit/DVT nëse kanë gjendje malli apo aktive në vendndodhjet e deklaruara të biznesit.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi organizimin e strukturës në DRT Vlorë mbi emërimet, transferimet dhe largimet nga puna, kanë rezultuar mangësi si më poshtë:

a-Në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, për periudhën 2021-2023, u konstatuan transferime të përhershme dhe të përkohshme, brenda drejtorisë por edhe jashtë saj. Disa punonjës janë transferuar përkohësisht edhe jashtë profilit të tyre të punës. Këto lëvizje kanë sjell risk në mirëfunksionimin e punës dhe në performancën e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor. Në Sektorin e Kontrollit në Vend rezulton se gjatë vitit 2023, është larguar nga puna 1 punonjës dhe është komanduar një punonjëse tjetër në atë pozicion, sipas Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, i cili në të njëjtën kohë është i emëruar dhe Specialisti i Zyrës së Burimeve Njerëzore, në DRT Vlorë.

Gjithashtu gjatë vitit 2023 ka pasur një vend vakant, pozicioni Inspektor i dytë dhe për këtë pozicion është komanduar një punonjëse tjetër sipas Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, i cili në të njëjtën kohë është i emëruar dhe Inspektori i dytë i Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, në DRT Vlorë, fakt cili ka ndikuar dhe në performancën e këtij sektori apo mbingarkesën e inspektorëve të tjerë në këtë Sektor në realizimin e kontrolleve në terren dhe mbartjen e kontrolleve në vitet pasardhëse.

b- Në Drejtorinë e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve u konstatua se për periudhën objekt auditimi 2021-2023, pozicioni i drejtorit ka qenë vakant, i shoqëruar me risk në mirëfunksionimin e punës.

-Në kuadër të procesit të dixhitalizimit dhe rritjes së numrit të shërbimeve të ofruara online nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania, struktura e Sektorit të Shërbimit ndaj Tatimpaguesve e përbërë nga 10 punonjës (1 përgjegjës + 9 specialistë), në raport me numrin dhe llojin e shërbimeve të ofruara dhe efektivitetin e këtij sektori, duhet të rishikohet.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-192 të Raportit të Auditimit).

11.1 Rekomandimi: Titullari i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrin masa për ndërprerjen e komandimeve të përkohshme për pozicionet vakante, si dhe plotësimin e tyre me vendime emërimi sipas profilit përkatës.

Menjëherë e në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i përputhshmërisë ligjore, të veprimtarisë së Drejtorisë së Shërbimit ndaj Tatimpaguesve u konstatua se:

-Nuk janë miratuar e protokolluar planet e punës, analizat mujore e vjetore, realizimi i tyre, si dhe çdo raport tjetër mbi performancën e Sektorit duke mos lënë asnjë gjurmë auditimi të veprimtarisë së Sektorit të Shërbimit ndaj Tatimpaguesit për periudhën 2021-2023. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Me nenin 14 e 15, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Me nenin 12, “Përgjegjësitë dhe detyrat e përgjegjësit të Sektorit/Zyrës së Asistencës & Shërbimit të Tatimpaguesve në DRT”, të Rregullores së Funkcionimit të Administratës Rajonale Tatimore, miratuar me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, të Ministrit të MFE. Me nenin 15, të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, i ndryshuar, si dhe Normat tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.

-Për vitin 2021, janë konstatuar 6 raste në vonesa nga 1-10 ditë në lëshimin e vërtetimit, për vitin 2022 ishin 5 raste në vonesë nga 1-7 ditë në lëshimin e vërtetimit dhe për vitin 2023, rezultuan 2 raste në vonesë nga 1-7 ditë, të lëshimit të vërtetimit. Këto vërtetime janë lëshuar jashtë afateve të përcaktuara në Manualin e Shërbimit për Tatimpaguesit dhe Individit, kapitulli III.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.3, faqet 192-200 të Projekt Raportit).

12.1 Rekomandimi: Drejtori i DRT Vlorë të marrë masa të menjëhershme për monitorimin e punës në Drejtorinë e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve si dhe respektimin e procedurave për administrimin e dokumentacionit dhe evidentimin e të dhënave statistikore të gjeneruara nga kjo drejtori sipas përcaktimeve të Manualit të Drejtorisë e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve.

Menjëherë e në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në dosjen e kontrollit për tatimpaguesin “D”, me NIPT KV, rezulton se ka aplikuar shkallën e reduktuar të TVSH 6%, jo në përputhje me kushtet, kriteret dhe procedurat në VKM Nr. 953, datë 29.12.2014, “Për dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Subjekti ka aplikuar shkallën e zbritshme të TVSH-së me 6% që në vitin 2017, në mungesë të dokumentacionit justifikues, si certifikata e përdorimit, sipas të dhënave në QKB subjekti nuk ka objekt veprimtari hotel apo resort, si dhe subjekti nuk ushtron vetëm veprimtari ekonomike në fushën e strukturave akomoduese, për të cilën tatimpaguesi duhet të jetë i regjistruar si person i tatueshëm më vete, për qëllime të veprimtarisë në fushën e strukturave akomoduese. Nga auditimi mbi këtë praktikë konstatohet se megjithëse ndryshimet ligjore kanë dhënë mundësinë tatimpaguesve që të aplikojnë shkallën e reduktuar të TVSH-së për shërbimet e akomodimit në struktura akomoduese që në vitin 2016, procesi i pajisjes me certifikata kategorizimi në bashkëpunim me MTM ka filluar vetëm pas vitit 2019. Për këtë arsye, kuadri rregullator, përveç ligjit për TVSH-në dhe VKM në zbatim të tij, ka qenë jo i plotë për administrimin e procesit dhe aplikimin e shkallës së reduktuar të TVSH-së, duke krijuar kushtet për aplikim të standartit të dyfishtë në trajtimin e tatimpaguesve. Për rrjedhojë, trajtimi i këtij rasti dhe të tjerëve të ngjashëm kërkon një qëndrim administrativ të unifikuar mbi ligjshmërinë e aplikimit të shkallës së reduktuar për këtë periudhë kohore.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

13.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “*Ri kontrolli tatimor*” të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar dhe në të njëjtën kohë të kërkojë interpretimin në DPT mbi ligjshmërinë e aplikimit të shkallës së reduktuar të TVSH-së për këtë tatimpagues dhe raste të tjera nga kontrolli nga zyra, për periudhën para vitit 2020, me qëllim unifikimin e qëndrimit.

Menjëherë e në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi kontrollin e ushtruar në tatimpaguesin “A” me NIPT KE janë konstatuar se nuk janë respektuar përcaktimet e bëra nenin 55 të UMF nr.6 datë 30.01.2015 për kreditimin e karburantit si blerje e tatueshme me TVSH. Duke qenë se tatimpaguesi ushtron veprimtarinë e sigurimit sipas objektit të veprimtarisë, klasifikohet në grupin “V. Të tjera (veprimtari të tjera jo të listuara) deri në 2% për shërbimet e sigurimit dhe një pjesë e aktivitetit i atribuohet shitjeve për ofrimin e shërbimit të transportit të vlerave monetare. *Udhëzimi i TVSH-së nuk shprehet specifikisht për trajtimin e kreditimit të karburantit për rastin e shoqërive të transportit të vlerave monetare si një kategori e veçantë e transportit, por megjithatë, kjo nuk pasqyron të drejtën për ta klasifikuar këtë aktivitet si transport mallrash. Elementi kryesor i vlerës së tatueshme të kostove të furnizimit për shërbimet e transportit të vlerave monetare përfshin koston e punës direkte të përbërë nga punonjësit e armatosur gjatë transportit të vlerave monetare. Ky shërbim dhe norma e kreditimit të karburantit si sektor i veçantë nuk janë të përfshira në udhëzimin nr.6, datë 30.01.2015, të ndryshuar, duke lejuar trajtimin në raport kontrolli dhe shpjegimet e subjektit të audituar si kategoria e “transport mallrash”. Në këto kushte, konstatohet se trajtimi në këtë kategori nuk rezulton të jetë i arsyetuar me analogji, sepse transporti i vlerave monetare si operacion ka elementë më përfaqësues të koston punën direkte dhe jo karburantit, krahasuar me transportin e mallrave.*

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

14.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria Rajonale Vlorë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të merren masa për trajtimin e unifikuar të kreditimit të TVSH-së për blerjet e karburantit nga tatimpaguesit që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e transportit të vlerave monetare duke nxjerrë qëndrim të unifikuar administrativ.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se, zhvilluesi “T” me NIPT MR, i ka kryer punimet me Vendimin nr. 561, datë 27.07.2021, “*Për miratimin e deklaratës për kryerje punimesh*”, nënshkruar elektronikisht nga Drejtori i Drejtorisë së Urbanistikës dhe Kontrolluesi, por pa nënshkrimin dhe vulën e Kryetarit të Bashkisë Vlorë, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 5, pika 1.3/b, “*Autoritetet përgjegjëse*”, të ligjit nr. 107/2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, pikën nr. 4, të nenit 99, dhe 109 “*Kërkesat e formës së aktit administrativ të shkruar në letër ose elektronik*” të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, nenin 4 “*Vlefshmëria ligjore e nënshkrimeve elektronike*” të ligjit nr. 9880, datë 25.2.2008 “*Për nënshkrimin elektronik*”, si dhe neni 7 dhe 8 i VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar. Nga ana e DRT Vlorë, për blerjet e kryera në vlerën e tatueshme 33,845,497 lekë, është kryer rimbursimi i TVSH, në shumën 6,769,099 lekë, pa saktësuar më

parë vërtetësinë e deklaratës paraprake të lëshuar nga Bashkia Vlorë, dokument mbi bazën e të cilit janë kryer punimet për objektin “*Ndarje e ambienteve të brendshme*”. Inspektori i kontrollit nuk ka kryer verifikimet përkatëse sipas legjislacionit tatimor si dhe mungon korrespondenca me institucionet vendore. Gjithashtu nuk është trajtuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, si rast përgjithësues për vlefshmërinë e kreditimit të tvsh-së në ndërtim kur aktit administrativ të dalë nga organi publik (deklaratë apo leje) i mungon nënshkrimi i personit të autorizuar si një kompetencë për vlefshmërinë e tij. Detyrimet tatimore në rast të pavlefshmërisë së aktit të lejimit të punimeve nga tatimpaguesi së bashku me penalitetin përkatës përllogariten në vlerën 8,123,019 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

15.1 Rekomandimi: DRT Vlorë për tatimpaguesin “T” me NIPT MR, referuar parregullsive në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për ri kontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “*Ri kontrolli tatimor*” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, si dhe interpretimin e rastit të konstatuar me parregullsi në vlefshmërinë e aktit të miratimit të punimeve për qëllime të kreditimit të tvsh-së në ndërtim.

Menjëherë

B. TË ARDHURA TË MUNGUARA NË BUXHETIN E SHTETIT

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i DRT Vlorë u konstatua se Sektori i Kontrollit dhe Monitorimit nga Zyra, nuk ka përmbushur detyrimin për saktësimin e qarkullimit sipas kasës dhe të ardhurave të deklaruara në deklaratat e TTFH dhe TF për tatimpaguesit, nëpërmjet kontrollit tatimor apo vlerësimit nga zyra, në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, “*Për procedurat tatimore në RSH*”, neni 71, konkretisht:

a) Për bizneset e vogla me TVSH u kryqëzua qarkullimi sipas kasës së saktësuar nga gabimet dhe të ardhurat në deklaratën e TTFH, ku u konstatua se për 4 subjekte në vitin 2021 dhe 2022 ka sjellë një efekt total të ardhura të munguara për TVSH gjithsej 4,292,068 lekë, nga të cilat 50% janë vlerat e gjobave dhe për 1 tatimpagues të ardhura të munguara për TF në shumë 1,323,209 lekë nga të cilat 50% janë vlerat e gjobave. Total detyrim që përbën të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit është në shumën 5,615,277 lekë.

b) Për BM u kryqëzua qarkullimi sipas kasës dhe shitjet sipas deklaratës, ku u konstatuan se, për vitin 2021, është 1 subjekt me qarkullim sipas kasës më të lartë se sa deklaratat në FDP për efekte të TVSH-së në vlerën 29,973,920 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 11,989,568 lekë nga të cilat 50% janë gjoba dhe 5 subjekte me qarkullim sipas kasës më të lartë se sa deklaratat në FDP për efekte të TF në vlerën 135,087,019 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 40,526,104 lekë nga të cilat 50% janë gjobë.

c) Për BM u kryqëzua qarkullimi sipas kasës dhe shitjet sipas deklaratës për TVSH dhe TF, ku u konstatuan se, për vitin 2022 janë 9 subjekte me qarkullim sipas kasës më të lartë se sa deklaratat në FDP për efekte të TF në vlerën 40,623,093 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 12,186,927 lekë, nga të cilat 50% janë gjobë.

Nga sa më sipër, vlerësohen paraprakisht të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit gjithsej në shumën 70,317,876 lekë, nga të cilat 35,158,938 lekë detyrime tatimore dhe 35,158,938 lekë gjobë tatimore.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.3, faqet 173-192 të Raportit të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, Sektori i Kontrollit nga Zyra të kryejë verifikimet përkatëse për vlerësimin dhe rivlerësimin në përmbushje të detyrimit për saktësimin e qarkullimit vjetor sipas kasës dhe të ardhurave të deklaruara në deklaratat përkatëse nga tatim paguesit, me qëllim arkëtimin e të ardhurave tatimore të evidentuara paraprakisht si të munguara në buxhetin e shtetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i DRT Vlorë, u konstatua se Sektori i Kontrollit dhe Monitorimit nga Zyra, nuk ka përmbushur detyrimin për bizneset që nuk kanë paguar kështet e Tatim Fitimit sipas afatit të përcaktuar në dispozitat ligjore.

Janë konstatuar 7 raste në vlerën 6,110,477 lekë, për të cilat nuk është vendosur gjoba TF në masën 10 % të saj në vlerën 611,477 lekë ($6,110,477 * 10\%$), sipas kërkesave të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në R.SH” i ndryshuar, neni 114/1.

Nga sa më sipër, konstatohen të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit të vlerësuara gjithsej në shumën **611,477 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.3, faqet 173-192 të Raportit të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, Sektori i Kontrollit nga Zyra, të marrë menjëherë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor, të vendos penalitetet përkatëse, me qëllim arkëtimin e të ardhurave tatimore të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej **611,477 lekë** gjobë për mospagimin në afat të kësteve të tatimit mbi fitimin.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raportit të kontrollit të ushtruar në “E” SHPK me NIPT KO, u konstatua se:

- Në lidhje me zërin qira ambjenti janë verifikuar librat e blerjes për vitin 2019 dhe 2020, ku sipas faturave të blerjeve të deklaruara nga subjekti kundrejt shitësit “T” me NIPT KH, për vitin 2019 rezulton në total vlera 3,980,611 lekë ndërkohë në bilancin e vitit 2019 ky zë është deklaruar në vlerën 7,308,889 lekë, pra ka një diferencë *3,328,187 lekë*, ndërkohë për vitin 2020 rezulton në total vlera 3,459,839 lekë ndërkohë në bilancin e vitit 2020 ky zë është deklaruar në vlerën 7,479,996 lekë, pra ka një diferencë *4,020,158 lekë*, diferenca për të cilat nuk është bërë analizë dhe shpjegime nga Inspektori i Kontrollit në Raport Kontrolli.

Sa më sipër subjekti ka deklaruar shpenzime të paargumentuara 3,328,187 lekë për vitin 2019, dhe 4,020,158 lekë për vitin 2020, në total 7,348,345 lekë, për të cilat nga inspektori i kontrollit nuk u vu në dispozicion dokumentacion shtesë që argumenton këto shpenzime, për rrjedhojë shpenzimet e zbritshme janë mbivlerësuar në shumën 3,328,187 lekë për vitin 2019, dhe 4,020,158 lekë për vitin 2020, në total 7,348,345 lekë dhe fitimi i tatueshëm është ulur në po të njëjtën shumë. Në zbatim të përcaktimeve të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 68 “Vlerësimi tatimor” pika 4 dhe 5/b, subjektit i linden detyrime për TF në vlerën 2,204,503 lekë, nga të cilat 50 % gjobë.

- Nga kontrolli në librat e shitjes për periudhën objekt kontrolli, në lidhje me shitjet e deklaruara nga subjekti për ndërtimin e 2 objekteve: 1- A - *Objekt individual banimi* 2 *Kat+ 1 kat nëntokë*

Tragjas, Vlorë; 2-L -Objekt individual banimi 1 Kat+1 kat nëntokë Lagja Lirim, Vlorë, janë konstatuar diferenca ndërmjet shitjeve të deklaruara sipas librave të shitjes dhe situacioneve progresive është 531,940 lekë, ndërkohë duke marrë në konsideratë shpenzimet plotësuese dhe fitimin e shoqërisë në masën maksimale 10% apo 365,110 lekë ($10\% * 3,651,100$), vlera totale e situacioneve duke përfshirë shtrukturat dhe TVSH është 4,746,320 lekë, si rrjedhim diferenca llogaritet në vlerën 1,627,160 lekë, vlerë kjo e cila përbën shitje pa deklaruar, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 124, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mos lëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i mos lëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore”.

Nga ana e Inspektorit nuk është bërë rivlerësimi i të ardhurave në bazë të përcaktimeve të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 68 “Vlerësimi tatimor” pika 4 dhe 5/b, duke llogaritur detyrimet për TVSH në vlerën 650,864 lekë, nga të cilat nga të cilat 50 % gjobë dhe për TF në vlerën 488,148 lekë, nga të cilat nga të cilat 50 % gjobë.

Për tatimpaguesin “E” SHPK., ka rezultuar detyrim në vlerën totale **3,343,515 lekë** (nga të cilat 1,346,325 lekë detyrim për TF, 325,432 lekë detyrim për TVSH detyrim tatim fitimi + 1,671,757 lekë gjobë).

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë për tatimpaguesin “E” SHPK, me NIPT KO, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit të munguar në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën **3,343,515 lekë**.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në 4 raste nga auditimi i dosjeve mbi kontrollin e ushtruar në tatimpaguesin “H” SHPK me NIPT LT, janë konstatuar mangësi si më poshtë:

a) -Për periudhën 2018-2020

- Nga auditimi konstatohet se detyrimet tatimore nuk janë përlllogaritur saktë nga ana e inspektorit tatimor për kreditimin e gabuar të TVSH -së për ndërtimin në rolin e investitorit, pasi i atribuohen një pjese të ndërtimit dhe nuk përputhen me analizën sipas aktit të inspektimit të inxhinierit të ndërtimit për realizimin e punimeve, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 20 të Udhëzimit nr. 6, datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, i ndryshuar. Në raport kontrolli janë njohur detyrime vetëm për 18,503,670 lekë, ndërkohë që duhet të ishin nxjerrë njoftim vlerësime në shumën 29,968,744 lekë, për pasojë diferenca prej 11,465,074 lekë përbën kreditim të padrejtë të TVSH-së. Mbi këtë detyrim aplikohet gjoba për deklaratë të pasaktë në shumën 2,476,456 lekë dhe në total detyrimi në shumën 13,941,530 lekë.

b) -Program Kontrolli nr. 5633/2 prot, datë 29.06.2022, periudha tatimore nga 05/2020-04/2022 -Kreditimi i TVSH për karburantin Korrik - Dhjetor 2020

Sipas deklarimeve të subjektit qarkullimi për këtë periudhë është në vlerën 67,726,646 lekë, shitjet kryesisht përfaqësojnë shitjen e materialeve të ndërtimit te shoqëria “H SHPK”, gjithashtu shoqëria ka realizuar të ardhura dhe nga shërbimi bar-restorant. Shitjet e deklaruara nga subjekti lidhen me veprimtarinë ekonomike tregti dhe sipas përcaktimeve të Ligjit 92/2014, datë

24.07.2014 “Për TVSH-në” i ndryshuar, kreu IX, seksioni 3, neni 74/a/ii, Udhëzim Nr. 6, Datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 55-Kufizime të zbritjes së TVSH për disa furnizime, për tregtin normative e zbritjes së TVSH-së është 3 % e qarkullimit 2,031,799 lekë (3% *67,726,646 lekë), për pasojë për vlerën e tatueshme 5,609,057 lekë (7,640,856 -2,031,799), nuk i njihet e drejta e kreditimit të TVSH-së në vlerën 1,121,811 lekë.

Për sa më sipër dhe në zbatim të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 68 “Vlerësimi tatimor” pika 4 dhe 5/b dhe nenit 115, subjektit i lindin detyrime për TVSH 1,121,811 lekë, nga të cilat 224,362, penalitet 20%.

-Kreditimi karburantit Janar - Dhjetor 2021

Sipas deklarimeve të subjektit qarkullimi për këtë periudhë është në vlerën 97,489,781 lekë, shitjet kryesisht përfaqësojnë shitjen e materialeve të ndërtimit te shoqëria “H SHPK”, gjithashtu shoqëria ka realizuar të ardhura dhe nga shërbimi bar-restorant. Shitjet e deklaruara nga subjekti lidhen me veprimtarinë ekonomike tregti dhe sipas përcaktimeve ligjore, për tregtin normativa e zbritjes së TVSH-së është 3 % e qarkullimit 2,924,693 lekë (3% *97,489,781 lekë), për pasojë për vlerën e tatueshme 686,231 lekë (3,610,924 -2,924,693), nuk i njihet e drejta e kreditimit të TVSH-së në vlerën 137,246 lekë. Për sa më sipër subjektit i lindin detyrime për TVSH 164,695 lekë, nga të cilat 27,449 penalitet 20%.

-Shoqëria “H Group” SHPK, ka kryer punime ndërtimi (operacion, transaksion, furnizim) dhe këto të fundit nuk janë kryer në përputhje me legjislacionin e fushës dhe legjislacionin fiskal duke përdorur lejen e ndërtimit të shoqërisë “H” SHPK me NIPT JI, në kundërshtim me kërkesat ligjore të fushës së ndërtimit dhe ato fiskale, VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të territorit“, Neni 2, pika 8, neni 13, pika 1, 2 dhe 3, neni 14, pika 1. Për pasojë tatimapaguesit “H Group” SHPK nuk i njihet TVSH-ja e zbritshme për ndërtimin e hotelit. Për sa më sipër dhe në zbatim të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 68 “Vlerësimi tatimor” pika 4 dhe 5/b dhe nenit 115, subjektit i lindin detyrime për TVSH në vlerën 26,110,175 lekë, nga të cilat 4,355,029 penalitet 20%.

c)- *Program kontrolli nr. 8188/2 prot., datë 01.11.2022, për periudhën Gusht 2020 - Gusht 2022*
Nga auditimi u konstatua se Leja zhvillimore nr.1, datë 04.02.2015, me afat deri në 20.09.2018, për ndërtimin e objektit Strukturë shërbimi “Kompleks hotelerie 4 kate me 1 kat parkim nëntokë (3 objekte)” në Nisi, Radhimë, lëshuar nga Bashkia Orikum, është në emrin e subjektit “H” SHPK me NIPT JI, ndërkohë subjekti “H Group” SHPK me NIPT LT, nuk disponon leje ndërtimi. Të dy shtyrjet e afateve të lejes nr. 1146, datë 24.10.2018 dhe nr. 188, datë 17.03.2021, janë bërë në emrin e subjektit “H” SHPK me NIPT JI. Sa më sipër, tatimpaguesit nuk i kreditohet TVSH, blerje për ndërtimin e objektit, në vlerën totale të tatueshme 8,082,890 lekë dhe TVSH 1,616,578 lekë, për pasojë subjektit i lindin detyrimet në shumën 1,616,578 lekë për TVSH 20% dhe 323,316 lekë penalitet për deklarim të pasaktë, në total detyrimi është 1,939,894 lekë, sipas përcaktimeve të pikës nr. 3, të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

ç)- *Program Kontrolli nr. 1839/2 prot, datë 23.03.2023,*

- Raporti i ekspertimit teknik nuk është kryer për të gjithë objektet për të cilën është rimbursuar TVSH.

- Vlera e situacioneve progresive për ndërtimin e hotelit në Radhimë, Vlorë, në raportin e kontrollit nuk rakordon me vlerën e situacioneve në raportin e ekspertimi teknik dhe me

situacionin analitik të shoqërisë H Group SHPK, vendosur në dispozicion nga inspektori i kontrollit si dhe në raportin e kontrollit është konstatuar se në situacion punimesh për Hotelin në Radhimë, Vlorë është lëshuar nga H Group, por subjekti që ka lejen e ndërtimit është subjekti H SHPK.

-Shoqëria “H Group” SHPK, ka kryer punime ndërtimi (situacione Hoteli Orikum) dhe këto të fundit nuk janë kryer në përputhje me legjislacionin e fushës dhe legjislacionin fiskal duke përdorur lejen e ndërtimit të shoqërisë “H” SHPK me NIPT JI, në kundërshtim me kërkesat ligjore të fushës së ndërtimit dhe ato fiskale, VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të territorit“, Neni 2, pika 8, neni 13, pika 1, 2 dhe 3, neni 14, pika 1. Për pasojë tatimpaguesit “H Group” SHPK nuk i njihet TVSH-ja e zbritshme për situacionet e ndërtimit të hotelit.

-Referuar raportit përfundimtar të kontrollit, rezulton se tatimpaguesit H Group, i është kredituar TVSH edhe për objektin polifunksional në Lungomare, në mungesë të raportit të ekspertimit të inxhinieres së ndërtimit, për të cilën inxhinierë e ndërtimit nuk ka qenë në dijeni për rimbursimin e TVSH të objektit në Lungomare.

-Subjekti ka kryer veprimtari si bar restorant, shërbime akomodimi, nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se tatimpaguesi ka raportuar shitje sipas natyrës për shërbimin e bar restorantit dhe nuk rezulton të ketë në pronësi ambjente apo të ketë blerje të deklaruara për qeradhënie për ushtrimin e aktivitetit dhe kjo analizë nuk është kryer në raportin e kontrollit tatimor, si dhe nuk është vendosur në dispozicion certifikata e përdorimit për objektin në të cilën po zhvillohet veprimtaria si bar restorant, shërbime akomodimi që tregon se objekti është ndërtuar në përputhje me projektin dhe kushtet teknike në fuqi, që tregon se objekti ka kaluar të gjitha inspektimet dhe testet e nevojshme për të siguruar që është i sigurt dhe në përputhje me standardet dhe rregulloret përkatëse për të ushtruar aktivitetin. Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se objekti vijon të jetë në proces ndërtimi.

-Vlera jo e zbritshme për TVSH si rezultat i konstatimeve, është 13,986,852 lekë, penalteti për TVSH për 2,797,370 lekë, totali i detyrimit për tatimpaguesin H. Group, NIPT LT detyrimi për tvsh është 13,986,852 lekë, mbi këtë detyrim aplikohet penalteti për deklaratë të pasaktë dhe në total detyrimi është 16,784,222 lekë.

Në përfundim për tatimpaguesin “H” SHPK., ka rezultuar detyrim në vlerën totale **60,306,689 lekë** nga të cilat 20% janë gjobë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

4.1-Rekomandim: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë për tatimpaguesin “H Group” SHPK, NIPT LT, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit të munguar në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën prej **60,306,689 lekë**.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në 4 raste nga auditimi mbi kontrollin e ushtruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë janë konstatuar mangësi mbi shitjet e tatueshme me shkallë të reduktuar të TVSH-së me 6%, nga tatimpaguesit që ushtrojnë veprimtari në aktivitetin e hotelierisë, konkretisht si më poshtë:

a)- Tatimpaguesi, “E” SHPK, me NIPT LJ, periudha tatimore 03/2021-07/2021.

Nga analiza e blerejve dhe shitjeve të deklaruar nga subjekti rezulton se për periudhën Mars-Korrik 2021, ka deklaruar shitje me shkallë të tatueshme 6 % vlerën 14,638,347 lekë me TVSH. -Subjektit ka aplikuar pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për pajisjen me certifikatën e kategorizimit si strukturë akomoduese, aplikim me nr. 4147 prot, datë 15.06.2020, administruar në DRT Vlorë me nr. 3037 prot, datë 26.05.2023, ndërkohë çertifikata e kategorizimit është lëshuar në datë 10.08.2023.

Referuar përcaktimeve të Ligjit 92/2014, datë 24.07.2014 “Për TVSH-në” i ndryshuar, Neni 49, pika 3, VKM Nr. 953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”, Neni 11/1 si dhe Urdhër të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr.41, datë 18.02.2020 “Për një ndryshim në Urdhrin nr. 267, datë 24.07.2019 “Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese”, ka shtyrë afatin e aplikimit për marrjen e certifikatës së kategorizimit të strukturave akomoduese duke përcaktuar datën 31.03.2020 si afatin përfundimtar për aplikim.

Sa sipër tatimpaguesi “E” SHPK, për periudhën 03.2021-07.2021 nuk plotëson kushtet për aplikimin shkallës së reduktuar TVSH-së 6 % dhe në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 68 “Vlerësimi tatimor” pika 4 dhe 5/b, Neni 115, pika 3, subjektit i linden detyrime për TVSH 20% në shumën **2,049,368 lekë**, nga të cilat **341,561 lekë** penalitet 20%.

b)- Tatimpaguesi, “E” SHPK, me NIPT LJ, periudha tatimore 08/2021-08/2022, për ushtrimin e veprimtarisë si strukturë akomoduese, kategoria *Hotel* është pajisur me Certifikatë Kategorizimi nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) në datë 10.08.2023, Nr. Regj. 1544/2023, duke tejkaluar afatin e përcaktuar në Urdhër Nr. 41 datë 18.02.2020 “Për një ndryshim në Urdhrin Nr. 267, datë 24.07.2019, “Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese”, i ndryshuar ku përcakton se, “...të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari si strukturë akomoduese se afati i aplikimit për marrjen e certifikatës së kategorizimit është deri në datë 31.03.2020”. Rezulton se janë aplikuar shitjet me shkallë 6% jo në përputhje me përcaktimet ligjore dhe në mungesë të dokumentacionit për përcaktuar për periudhën e kontrollit. Në raportin përfundimtar të kontrollit, në analizimin e kontrollit të shitjeve të tatueshme inspektori ka paraqitur në mënyrë të përmbledhur shitjet për periudhën Gusht-Dhjetor 2021 dhe ka ndarë shitjet të tatueshme me shkallë 6% nga shitjet e tatueshme me shkallë 20%, por nuk është detajuar nëse në shitjet e tatueshme me shkallë 6% janë aplikuar vetëm për strukturën akomoduese *Hotel*, pasi subjekti vepron edhe në aktivitetin bar-restorant. Si rrjedhojë, totali i detyrimit për TVSH për tatimpaguesin “E” SHPK vlerësohet në shumën **11,450,612 lekë**.

c)- Tatimpaguesi “H” SHPK, me NIPT KO, nga analiza e kontrollit të shitjeve të tatueshme, u konstatua se, inspektori ka paraqitur në mënyrë të përmbledhur shitjet e tatueshme me shkallë 20% në vlerën 127,241,176 lekë, si dhe shitjet e tatueshme me shkallë 6% në vlerën 46,290,094 lekë. Por, nuk ka detajuar nëse shitjet e tatueshme me shkallë 6% janë aplikuar vetëm për strukturën akomoduese *Hotel*, pasi subjekti vepron edhe në aktivitete si: agjenci turistike, bar-restorant, akomodim në çadra plazhi, shezllona, referuar përcaktimeve të ligjit 92/2014, datë 24.07.2014 “Për TVSH-në” i ndryshuar, neni 49, pika 3. Vendimit nr. 953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”, neni 11/1. Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 68 “Vlerësimi tatimor” pika 4 dhe 5/b, si dhe neni 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”,

pika 3, për mosplotësim të saktë të deklaratës tatimore nga ana e tatimpaguesit, i linden detyrimet totale në shumën 7,776,736 lekë. Inspektori i kontrollit nuk ka kryer verifikimet e subjektit sipas legjislacionit tatimor dhe manualit të kontrollit, ku efekti financiar i shmangur me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit është në vlerën **8,899,342 lekë**.

ç)- Tatimpaguesi, “P” SHPK me NIPT MF, nga verifikimi në sistemin C@ts konstatohet se tatimpaguesi ka marrë certifikatën e kategorizimit në datë 24.03.2023 për strukturë akomoduese “hotel”. Për periudhën e kontrolluar shtator-nëntor 2022 shitjet e deklaruara me 6% janë shumën 5,097,557 lekë dhe TVSH është 305,854 lekë. Mbi këto shitje duhet të ishte deklaruar TVSH 20% ose në shumën 1,019,511 lekë dhe për rrjedhojë detyrimi për TVSH vlerësohet në shumën 713,657 lekë, për diferencën në normën e TVSH së aplikuar. Gjoha për deklarim të pasaktë për tatimin mbi vlerën e shtuar vlerësohet në shumën 154,150 lekë.

Në total detyrimi tatimor për TVSH për këtë tatimpagues paraqitet në shumën **867,807 lekë**.

Si përfundim, detyrimi tatimor gjithsej prej 23,267,129 lekë i evidentuar paraprakisht sipas subjekteve është: “E” SHPK me NIPT LJ detyrime për **13,499,980 lekë**; “H” SHPK me NIPT KO detyrime për **8,899,342 lekë**; P me NIPT MF detyrime për **867,807 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, referuar mangësive dhe parregullsive të konstatuara, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të marrë masa të menjëhershme për vlerësimin e detyrimeve tatimore të munguara, duke kryer vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse, për arkëtimin e vlerës totale **23,267,129 lekë** të cilat përbëjnë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit, të përfituar padrejtësisht nga aplikimi i gabuar i shkallës së reduktuar të TVSH 6%, nga tatimpaguesit që ushtrojnë veprimtari në fushën e strukturave akomoduese, konkretisht: “E” SHPK, me NIPT LJ detyrime për **13,499,980 lekë**; “H” SHPK, me NIPT KO detyrime për **8,899,342 lekë**, P, me NIPT MF, detyrime për **867,807 lekë**.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raportit të kontrollit të ushtruar në tatimpaguesin “I” SHPK, me NIPT MR, u konstatua se:

- Sipas Raport Ekspertimit Teknik situacionet progresive për ndërtimin e hotelit për periudhën Korrik-Gusht 2021, janë në vlerën 78,052,008 lekë pa strukturat, fitimin dhe TVSH. Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit në librat e blerjes për të njëjtën periudhë, rezulton se janë bërë blerje situacione punimesh nga subjekti ndërtues “T” SHPK me NIPT KC, në vlerën 146,378,470 lekë me TVSH.

Nga kryqëzimi i të dhënave rezulton se subjekti investitor “I” SHPK, ka deklaruar blerje situacione punimesh ndërtimi nga subjekti ndërtues “T” SHPK, për periudhën korrik-shtator 2021, në vlerë të tatueshme 121,982,058 lekë, ndërkohë që nga Raport Ekspertimi sipas inxhinierit vlera faktike e volumit të punimeve të kryera për periudhën korrik-shtator 2021 është 78,052,008 lekë.

Duke marrë në konsideratë shpenzimet plotësuese dhe fitimin e shoqërisë në masën maksimale 10% apo 7,805,200 lekë (10% * 78,052,008), vlera totale e situacioneve duke përfshirë strukturat, pa TVSH, është 85,857,208 lekë, si rrjedhim diferenca ndërmjet blerje situacione punimesh ndërtimi të deklaruara nga subjekti dhe vlerës faktike të volumit të punimeve të kryera në Raport Ekspertimi sipas inxhinierit është **36,124,850 lekë** (121,982,058 lekë- 85,857,208 lekë).

Sa sipër konstatohet se është mbivlerësuar zëri “Investime brenda vendit me TVSH 20%”, në vlerën **36,124,850 lekë**, duke rritur në mënyrë të padrejtë tepricën kreditore të TVSH-së në

vlerën 7,224,970 lekë (36,124,850 lekë*20%), për periudhën korrik-shtator 2021. Në zbatim të përcaktimeve të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 68 “Vlerësimi tatimor” pika 4 dhe 5/b dhe nenit 124, subjektit i linden detyrime për TVSH **14,449,940 lekë**, nga të cilat 50 % janë penalitet.

-Në përfundim për tatimpaguesin “I” SHPK., ka rezultuar detyrim në vlerën totale **14,449,940 lekë** (nga të cilat 7,224,970 lekë detyrim për TVSH detyrim tatim fitimi + 7,224,970 gjobë).

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

6.1-Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë për tatimpaguesin “I” SHPK me NIPT MR, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit të munguar në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën **14,449,940 lekë**.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raportit të kontrollit të ushtruar në tatimpaguesin “T” me NIPT KË, kanë rezultuar mangësi si më poshtë:

- Nga analiza e bilancit material për vitin 2016 të paraqitur nga vetë inspektori i kontrollit, për 10 artikuj, duke e kryqëzuar me të dhënat e inventarit të deklaruar nga subjekti në sistemin C@ts, kanë rezultuar diferenca në disa artikuj. Referuar përcaktimeve të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 68 pika 4 dhe 5/b, neni 124, Ligji Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 97, 101 dhe Udhëzimin Nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, pika 57.1, subjektit i linden detyrimet në total **1,121,088 lekë**, nga të cilat detyrimi për TVSH 320,311 lekë, detyrimi për TF 240,233 lekë dhe 560,544 lekë penalitet.

-Nga analiza e blerjeve të realizuara nga subjekti për periudhën objekt kontrolli në zërin “Blerje të investimeve vendase me 20%” është deklaruar “Blerje punime riparimi”, në vlerën 1,608,887 lekë. Nga ana inspektorit të kontrollit nuk është analizuar se çfarë investimesh janë bërë, çfarë përfaqësojnë këto punime, nëse janë punime ndërtimi dhe nëse është pajisur me leje ndërtimi për këto punime/deklaratë paraprake punimesh, i shërbejnë ose jo natyrës së aktivitetit që kryen tatimpaguesi. Sa sipër subjekti ka deklaruar blerje investime vendase me TVSH 20% në vlerën totale 1,608,887 lekë, për të cilat nga administrohet dokumentacion shtesë (*fatura tatimore, situacione, preventiv punimesh etj*) që argumenton se këto investime i shërbejnë natyrës së aktivitetit që kryen tatimpaguesi si dhe mungon leja e ndërtimit për kryerjen e punimeve (*Deklarata paraprake punimesh*) sipas përcaktimeve të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të territorit“, Neni 7. Në zbatim të përcaktimeve të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 68 “Vlerësimi tatimor” pika 4 dhe 5/b, neni 115, subjektit i linden detyrime për TVSH **643,554 lekë** nga të cilat 100 % penalitet.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

7.1-Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë për tatimpaguesin “T” me NIPT KË, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit të munguar në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën **1,764,642 lekë**.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raportit të kontrollit të ushtruar në tatimpaguesin “K.” SHPK, NIPT KU, kanë rezultuar mangësi si më poshtë:

-Nga analiza e blerjeve të deklaruara nga subjekti në zërin “*Blerje brenda vendit me TVSH 20%*” dhe “*Blerjet e Investimeve brenda vendit me TVSH 20%*”, janë deklaruar si blerje të realizuara në funksion të aktivitetit të subjektit, punime ndërtimi dhe blerje situacione ndërtimi/vetëfaturime, në vlerën e tatueshme 15,148,401 dhe TVSH në vlerën 3,029,680. Nga inspektori i kontrollit nuk është bërë analiza në raport kontrolli se për cilën godinë janë kryer punimet e ndërtimit, ndërkohë për situacionet/vetëfaturimet të deklaruara në zërin “*Blerjet e Investimeve brenda vendit me TVSH 20%*”, në Raport Kontrolli citohet se këto punime janë kryer për objektin Resort Turistik Hotel, ndërkohë që Hoteli që përkon me Seksionin “E” është pajisur me certifikatë përdorimi nr. 594, datë 19.10.2020, miratuar nga Bashkia Vlorë, për pasojë situacionet/vetëfaturimet për punimet e ndërtimit të deklaruara nga subjekti nuk i shërbejnë veprimtarisë së tatueshme dhe nuk do ti njihet e drejta e zbritshmërisë së TVSH-së.

Në zbatim të përcaktimeve të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 68 “Vleresimi tatimor” pika 4 dhe 5/b dhe neni 115, pika 3 subjektit i linden detyrim për TVSH në vlerën **3,635,616 lekë** nga të cilat 605,936 lekë janë penalitet.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

8.1-Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë për tatimpaguesin “K.” SHPK, NIPT KU, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të neni 85 “Ri kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit të munguar në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën **3,635,616 lekë**.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raportit të kontrollit të ushtruar në tatimpaguesin “T”, NIPT KN, kanë rezultuar mangësi si më poshtë:

- Subjekti është pajisur me leje ndërtimi Nr.1701, datë 15.01.2020 e cila ndryshon subjektin zhvillues nga “G” e cila ishte pajisur me leje ndërtimi Nr.339, datë 16.01.2018 nga Bashkia Kavajë në subjektin “T” si subjekt zhvillues. Nga raporti identifikohet se subjekti ka kryer “Blerje te investimit brenda vendit” (autofature) për ndërtimin e një strukture shërbimi pajisur me lejen e ndërtimit të sipërcituar.

Nga auditimi konstatohet se Autofatura me nr.30, datë 31.12.2019 e shoqërisë “T.” Shpk me vlerë të tatueshme 4,400,000 lekë dhe TVSH 880,000 lekë për blerje investime brënda vendit për ndërtimin e strukturës së sipërcituar nuk i lejohet të zbresë TVSH për blerjet e kryera pasi konsiderohet punime të kryera në shkelje të lejes përkatëse (*Për periudhën Dhjetor 2019 subjekti nuk ka qënë i pajisur me leje ndërtimi*). Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me neni 69, pika 1 e Ligjit 92/2014, datë 24.07.2014 i ndryshuar si dhe neni 20 pika 8/d të UMF Nr.6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Fakt ky i paidentifikuar nga Raporti i Kontrollit. Për sa konstatohet më sipër subjektit duhet ti linden detyrimet si vijon detyrim për TVSH 20% në vlerën **880,000 lekë** (*4,400,000 lekë* 20%*), gjobë për TVSH 21.6% në vlerën **190,080 lekë, total detyrimi 1,070,080 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

9.1-Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë për tatimpaguesin “T”, NIPT KN, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit të munguar në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën **1,070,080 lekë**.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raportit të kontrollit të ushtruar në tatimpaguesin “D”, NIPT JS, kanë rezultuar mangësi si më poshtë:

- Subjekti është pajisur me leje ndërtimi nr. 2/32 date 28.09.2011, me shtyrje leje dy here sipas Vendimit nr. 289, datë 24.05.2019 dhe Vendimit nr. 186, datë 24.04.2020.

Nga raporti identifikohet se subjekti ka kryer Blerje të investimit brenda vendit (autofature) për ndërtimin e një strukture shërbimi pajisur me lejen e ndërtimit të sipërcituar.

Nga auditimi konstatohet se Autofatura me nr.363 e datës 31.01.2019 e shoqërisë “D.” Shpk me vlerë të tatueshme 700,567 lekë dhe me TVSH 140,113 lekë, autofatura me nr. 370 dhe nr. 371 e datës 28.02.2019, përkatësisht me vlerë të tatueshme 2,670,018 lekë dhe 4,796,881 lekë dhe me TVSH 534,004 lekë dhe 959,376 lekë, autofatura me nr.377 dhe nr. 378 e datës 31.03.2019 me vlerë të tatueshme 2,242,198 lekë dhe 8,893,229 lekë dhe me tvsh 448,440 lekë dhe 1,778,646 lekë, autofatura me nr.388 dhe nr. 389 e datës 30.04.2019 me vlerë të tatueshme 1,396,894 lekë dhe 4,157,814 lekë dhe me TVSH 279,379 lekë dhe 831,563 lekë për blerje investime brenda vendit për ndërtimin e strukturës së sipërcituar nuk i lejohet të zbresë TVSH për blerjet e kryera pasi konsiderohen punime të kryera në shkelje të lejes përkatëse (Për periudhën Janar-Prill 2019 subjekti nuk ka qënë i pajisur me leje ndërtimi). Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenit 69 pika 1 e Ligjit 92/2014 dt.24.07.2014 i ndryshuar si dhe nenit 20 pika 8/d të UMF Nr.6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Fakt ky i paidentifikuar nga Raporti i Kontrollit. Për sa konstatohet më sipër subjektit duhet ti lindin detyrimet si vijon detyrim për TVSH 20% në vlerën **4,971,521 lekë (24,857,601lekë* 20%)**, gjobë për TVSH 21.6% në vlerën **1,073,849 lekë, total detyrimi 6,045,370 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

10.1-Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë për tatimpaguesin “D”, NIPT JS, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit të munguar në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën **6,045,370 lekë**.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raportit të kontrollit të ushtruar në tatimpaguesin “Ç”, KT, kanë rezultuar mangësi si më poshtë:

- Analiza e konsumit të karburantit nuk është llogaritur sipas nenit 74, pika 1 , shkronja a/ii e ligjit 92/2014 “Për TVSH-në” i ndryshuar, për përcaktimin e normativave të zbritjes së TVSH-se të perdorur sipas veprimtarive dhe UMF Nr.6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 55, pika I/d me kushtin që gazoili i blerë të përdoret vetëm për nevoja të veprimtarisë ekonomike të tatueshme, e drejta për të zbritur TVSH-

në ushtrohet deri në normativen 25 % të peshës specifike që blerjet për gazoil zënë në raport me qarkullimin e tatueshëm, të kryer në kuadër të veprimtarisë ekonomike.

Nga mos kryerja e analizës lidhur me veprimet financiare të sipërpermendura ka sjell diferenca të cilat në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

-Shitje të tatueshme për peridhen Gusht 2020 - Dhjetor 2021 janë në total 50,789,368 lekë, nga të cilat punimeve të kryera referuar situacioneve dhe raportit të inxhinierit ka kryer punime gërmime në shumën 25,775,502 lekë, kreditimi i lejuar nga inspektori është në shumën 32% ose në vlerën 8,248,160 leke, kreditimi i lejuar për punimet e kryera duhet të ishte 6,443,875 leke. Diferenca në vlerë të tatueshme është në shumën 1,804,285 lekë (8,248,160 leke-6,443,875 lekë).

-Diferenca 50,789,368 leke - 25,775,502 lekë = 25,013,866 lekë e cila nga ana e inspektorit është llogaritur normativa e konsumit të karburantit me 32 % janë punime ndërtim banesash dhe objektsh të ndryshme ku normative e lejuar e konsumit të karburantit është 8% dhe jo 32% që subjektit i është llogaritur nga ana e inspektorit, kreditimi i lejuar nga inspektori është në shumën 32% ose në vlerën 8,004,437 leke, kreditimi i lejuar për punimet e kryera duhet të ishte 2,001,109 lekë (8%). Diferenca në vlerë të tatueshme është (8,004,437 leke- 2,001,109 lekë) = 6,003,328 leke. Për sa konstatohet më sipër subjektit duhet ti lindin detyrimet si vijon detyrim për TVSH 20% në vlerën **1,561,523 lekë** (7,807,613 lekë* 20%), gjobë për TVSH 21.6% në vlerën **337,289 lekë, total detyrimi 1,898,811 lekë.**

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

11.1-Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë për tatimpaguesin “Ç”, KT, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit të munguar në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën **1,898,811 lekë.**

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raportit të kontrollit të ushtruar në tatimpaguesin “T” SHPK me NIPT LS, u konstatua se, në Pasqyrën e Aktiveve Afatshkurtra, periudha paraardhëse për viti 2020, në zërin «Inventar», «Mallra për rishitje», vlera 4,000,000 lekë i përket sasisë 1000 copë aparate/dekoder, sipas inventarit në fund të vitit 2020, ndërsa në periudhën raportuese për viti 2021, ky zë paraqitet në vlerën 17,929,727 lekë.

-Sipas interpretimit të inspektorit, kjo rritje në vlerë, ka ardhur pasi subjekti ka mbajtur në të njëjtin zë «Mallra për rishitje», Aparatet/dekoder tokësor së bashku me Shërbimin e transmetimit kabllor, veprime këto në kundërshtim me nenin 15, “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve” i ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

-Subjekti ka deklaruar në sistemin C@ts, inventar në fund të vitit 2021, 700 dekodera me vlerë totale 2,800,000 lekë. Ndërsa sipas bilancit material të kryer në Raportin përfundimtar të kontrollit, sasia e aparateve/dekoder, paraqitet 152 copë. Për sa më sipër, konstatohet diferencë në aparate/dekoder në sasinë 548 copë në vlerën 2,192,000 lekë. Që pasojnë me detyrim ndaj subjektit “T” SHPK në masën 20% për TVSH ose 438,400 lekë, penalitet në masën 100% ose 438,400 lekë, detyrim për tatim fitimi në masën 15% ose 328,800 lekë dhe penalitet në masën 100% ose 328,800 lekë, në total **1,534,400 lekë.**

Inspektori i kontrollit nuk ka kryer verifikimet e subjektit sipas legjislacionit tatimor ku efekti financiar i shmangur është me efekt në të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit. Veprim ky

në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 124 “Moslëshimi i faturës tatimore”.
(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

12.1 Rekomandimi: DRT Vlorë për tatimpaguesin “T” SHPK me NIPT LS, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit të munguar në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën prej **1,534,400 lekë**.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raportit të kontrollit të ushtruar në “H P” SHPK me NIPT KH, për periudhë tatimore Shkurt 2020-Janar 2022 u konstatua se, subjekti ka kryer “Blerje të investimeve nga furnitorët vendas me shkallë 20%” në vlerën 5,545,040 lekë dhe TVSH 1,109,008 lekë. Nga kontrolli që i’u bë blerjeve për kreditimin e TVSH, tatimpaguesi ka kryer blerje për investime punimesh në vlerën e tatueshme 3,724,941 lekë dhe TVSH 744,988 lekë, por nuk është pajisur me “Deklaratë paraprake për kryerje punimesh”. Nga ana e inspektorit nuk janë kryer verifikimet e subjektit sipas legjislacionit tatimor, ku efekti financiar i shmangur me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit është në vlerën **893,986 lekë**. Veprime këto në kundërshtim me nenin 39, pika 1, i ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, si dhe neni 7, të VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

13.1 Rekomandimi: DRT Vlorë për tatimpaguesin “H P” SHPK me NIPT KH, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit të munguar në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën **893,986 lekë**.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raportit të kontrollit të ushtruar në “H P” SHPK me NIPT KH, për periudhë tatimore Shkurt 2022-Qershor 2023 u konstatua se, nga kryqëzimi i faturave të blerjeve me FDP mujore në sistemin C@ts, rezultojnë blerje për investime në subjektin “S” me NIPT KQ të cilat janë pajisje duralumini, si dhe në subjektin “A” me NIPT KF, aktiviteti i të cilit është “shitje inerte e beton”. Këto blerje paraqiten në vlerën e tatueshme 3,338,080 lekë dhe me TVSH 667,616 lekë. Nga auditimi rezulton se subjekti për punimet e kryera nuk është pajisur me Deklaratë paraprake për kryerje punimesh, në kundërshtim me nenin 7, “Punime që kryhen me deklaratë paraprake punimesh”, i VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”. Nga ana e inspektorit nuk janë kryer verifikimet e subjektit sipas legjislacionit, ku diferenca e përmenduar sjell efekte financiare në të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit, në vlerën **801,139 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

14.1-Rekomandimi: DRT Vlorë për tatimpaguesin “H P” SHPK me NIPT KH, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në

Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit të munguar në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën **801,139 lekë**.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raportit të kontrollit të ushtruar në “S” SHA, NIPT KM u konstatua se:

- Nuk është bërë analizë për blerjet e tatueshme në lidhje me kredinë apo leasing, për periudhën Qershor-Dhjetor 2021, në vlerën 1,455,093 lekë, për vitin 2022 në vlerën 2,540,763 lekë, si dhe periudhën Janar- Shkurt 2023 në vlerën 419,656 lekë, se çfarë përfaqësojnë këto blerje.

- Gjithashtu, nuk ka analizë për “Blerje të investimeve vendase me TVSH 20 %”, nga subjekti “B” me NIPT LA, në vlerë të tatueshme 9,774,500 lekë dhe TVSH e zbritshme në vlerën 1,954,900 lekë, periudha Janar - Dhjetor 2022, për të cilat tatimpaguesi ka deklaruar blerje të punimeve për sistemim karriere, vegla pune dhe materiale ndihmëse.

- Nga auditimi rezulton se tatimpaguesi “S. B.”, të gjitha AAM i ka njohur me kosto, në të cilat janë përfshirë kostoja e blerjes dhe kosto të tjera të drejtpërdrejta që lidhen me aktivin. Nga analiza e Pasqyrave Financiare të periudhës ushtrimore 2021, u konstatua se në Pasqyrën e Amortizimit të AAM, zëri “Ndërtesa” paraqitet në vlerën 361,645,355.56 lekë. Ndërsa në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në periudhën raportuese paraqitet në vlerën 454,052,579.19 lekë.

Kjo vlerë është raportuar edhe në analizën e inspektorit në Raportin Përfundimtar të Kontrollit.

Për sa më sipër, kemi vlerë të shtuar të aktivit, me 92,407,223.63 lekë. Inspektori tatimor nuk ka kryer verifikimet e subjektit sipas legjislacionit, ku diferenca e përmenduar sjell efekte financiare në të ardhura të mungura në buxhetin e shtetit. Veprime këto në kundërshtim me nenin 80, “Kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, me nenin 59 “Përgjegjësitë dhe detyrat e inspektorit të sektorit të kontrollit në vend”, të “Rregullores së funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore”, i ndryshuar, miratuar nga Ministri i MFE me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, Programit të kontrollit nr. 2465/2 prot, datë 26.04.2023, si dhe me Manualin e Kontrollit Tatimor.

Për veprimet e mësipërme, në lidhje me vlerën e mbiverësuar prej 92,407,223.63 lekë të aktivit “Ndërtesa”, në bazë të ligjit nr. 9920 datë 18.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 115 “Plotësimi i pasaktë i deklaratës tatimore”, subjektit “S”, i lind detyrimi për tatim fitimin në masën 15% ose në vlerën 13,861,084 lekë dhe penalteti për tatim fitimin në masën 21.9% ose në vlerën 3,035,577 lekë, në **total detyrimi 16,896,661 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

15.1-Rekomandimi: DRT Vlorë për tatimpaguesin “S” SHA, NIPT KM, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit të munguar në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën **16,896,661 lekë**.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi kontrollin e ushtruar në tatimpaguesin “M” me NIPT KE janë konstatuar mangësi të cilat përfshijnë:

- Referuar Pasqyrave Financiare dhe bilancit material për periudhën shtator-dhjetor 2021 në raportin e kontrollit rezultojnë diferenca në vlerën 4,842,559 lekë. Për rrjedhojë, vlera totale e detyrimit për diferencën e konstatuar është **1,162,214 lekë**.

- Në analizën e normativave të zbritjes së TVSH-së për gazoilin, inspektori i kontrollit, të normativën e karburantit e ka 33% në raport kontrolli ndërkohë në koherencë edhe me raportin e mëparshëm tatimor për të njëjtën subjekt që e ka licensuar si gjermim/shpim si aktivitet, me normativën e karburantit me 25% jo në përputhje me Udhëzim nr. 6, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 55, “Kufizime të zbritjes së TVSH për disa furnizime”, normativat e përdorimit të gazoilit sipas veprimtarisë, deri më 33% është normativa që aplikohet për prodhim materiale inerte, ndërkohë për veprimtarinë gjermime/shpime është deri më 25%. Totali i detyrimit bazuar në rivlerësimin e kryer nga grupi i auditimit është **798,961 lekë**.

-Rezulton se nuk është kryer rakordimi i FDP-ve të TVSH, me tatim fitimin dhe me pasqyrat financiare nga ana e inspektorit për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2022. Mos kryerja e rakordimit, sipas Ligj Nr. 9920, datë 19.05.2009, për “Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 71, e drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi. Bazuar në blerje nga furnitorë vendas me 20%, të analizuar nga inspektori vlera totale e detyrimit është **3,573,203 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

16.1-Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë për tatimpaguesin “M”, NIPT KE, bazuar në mangësitë dhe parregullsitë e evidentuara në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të paraqesë propozimet përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit të munguar në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën **5,534,378 lekë**.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Në 2 raste nga auditimi i raport kontrollove për tatimpaguesit “H” SHPK, NIPT LT dhe P, NIPT J, rezultoi se nuk janë respektuar kufizimet e së drejtës së zbritjes së shpenzimeve për autoveturat dhe shërbimet në lidhje me to:

-Nga auditimi mbi blerjet e tatueshme të raportuara nga tatimpaguesi “H” SHPK, në kryqëzim me analizën e bërë për tatim fitimin në vitin 2019, konstatohet se janë blerë mjete transporti me vlerën 10,987,500 lekë sipas shtesës së aktiveve afatgjata të pashitura dhe mjete transporti në shumën 6,453,083 lekë të cilat janë shitur në 2019, në pasqyrat financiare të dorëzuara në C@TS për vitin 2019 e cila përbëhet nga autovetura. Këto blerje paraqiten në shumën 10,315,583 lekë sipas librit të blerjeve me tvsh 2,063,117, për të cilën është kredituar tvsh në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën c të nenit 74 të ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Për këto arsye linden detyrimet e në shumën 2,063,117 lekë për tvsh dhe gjobë për deklarim të pasaktë në shumën 445,633 lekë, në total detyrime në shumën **2,508,750 lekë**.

-Sipas raportit përfundimtar të kontrollit, për tatimpaguesin “P”, NIPT J, rezulton se nuk është kryer një analizë mbi mjetet e klasifikuara si autovetura në formatit për pasuri të luajtshme të ngarkuara në sistemin C@TS, që nuk janë ATP (automjet i transportit të përzier) si dhe çfarë funksioni kanë për subjektin. Si rrjedhojë, detyrimi për tatimpaguesin, është në shumën totale **319,011 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

17.1 Rekomandimi: Drejtoria Tatimore Rajonale Vlorë, të marrë masa menjëherë dhe në vijim, të respektohen përcaktimet ligjore lidhur me kufizimet e së drejtës së zbritjes së TVSH-së për të siguruar konformitetin me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të ligjit nr.

9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit të munguar në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën prej **2,827,761 lekë**.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Në **4 raste** nga auditimi i raport kontrollove për tatimpaguesit S, NIPT L77324203N, A, NIPT KE dhe K, NIPT LL, V me Nipt LT rezultoi mangësi si më poshtë:

a) Nga auditimi mbi kontrollin e ushtruar në tatimpaguesin “S” me NIPT LN janë konstatuar mangësi të cilat përfshijnë:

- Për periudhën objekt kontrolli, nga shqyrtimi i librave të blerjes së tatimpaguesit konstatohet se janë deklaruar situacionet e ndërtimit në shitje dhe në blerje për periudhën Janar – Mars 2023 në shumën 9,954,504 lekë me tvsh në shumën 1,990,900 lekë. Nga auditimi janë konstatuar **punime në shkelje të lejes së ndërtimit pasi ka përfunduar afati i lejes** sipas Vendimit nr. 581 datë 24.09.2019 të Bashkisë Vlorë ku është miratuar kërkesa për shtyrjen e afatit të përfundimit të lejes fillestare deri në datën 24.12.2020. Gjithashtu nga auditimi konstatohet se për periudhën objekt vlerësimi të detyrimeve, Janar - Mars 2023, në listëpagesat e tatimpaguesit nuk ka të paraqitur inxhinier zbatimi të punimeve të ndërtimit në mënyrë që situacionet të jenë të hartuara dhe miratuara nga profesionistët e licensuar përkatës për vërtetësinë e punimeve të ndërtimit për të cilat është pretenduar teprica kreditore e tvsh-së. Nga këto punime në kudërshtim me afatin e lejes së ndërtimit sipas përcaktimeve të nenit 20 të Udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, **lindin detyrime në shumën 1,990,900 lekë për tvsh dhe 430,034 lekë gjobë për deklarim të pasaktë, në total detyrime në shumën 2,420,934 lekë.**

b)- Nga auditimi mbi kontrollin e ushtruar në tatimpaguesin “A” me NIPT KE janë konstatuar mangësi të cilat përfshijnë:

-Në blerjet brenda vendit, nuk është kryer analiza e kreditimit të tvsh për karburantin në raport me qarkullimin e realizuar duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e blerjeve referuar llojit të aktivitetit të tatimpaguesit referohet drejt kësaj natyre për ofrimin e shërbimit të sigurimit. Nga librat e blerjeve dhe informacionit të vendosur në dipozicion nga inspektorit taimtor për kartelën e blerjes së karburantit konstatohet se tatimpaguesi për vitin 2022 ka kryer blerje për karburant në shumën 19,471,731 lekë. Në raport me qarkullimin e realizuar gjatë vitit 2022 prej 181,585,388 lekë gjatë vitit 2022 konstatohet se nuk janë respektuar përcaktimet e bëra nenin 55 të UMF nr.6 datë 30.01.2015 ku përcaktohet që “Me kushtin që gazoili i blerë të përdoret vetëm për nevoja të veprimtarisë ekonomike të tatueshme, e drejta për të zbritur TVSH-në ushtrohet deri në normativat e përcaktuara më poshtë sipas veprimtarive. Shpenzimet faktike për gazoilin për çdo veprimtari ekonomike duhet të justifikohen me volumin e punës së kryer, rrugët e realizuara nga mjeti/et, normativat e konsumit të gazoilit për rrugë ose proces të kryer, etj. Në çdo rast, këto shpenzime duhet të jenë të kryera realisht dhe të justifikuara sipas veprimeve të realizuara për nevoja të veprimtarisë ekonomike, të provuara me dokumentacionin përkatës, por jo më shumë se normativat e përcaktuara në këtë udhëzim.” Duke qenë se tatimpaguesi ushtron veprimtarinë e sigurimit sipas objektit të veprimtarisë, klasifikohet në grupin “V. Të tjera (veprimtari të tjera jo të listuara) deri në 2%. Kreditimi përtej normativave të nenit 55 të UMF nr.6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” rezulton në detyrim në vlerën totale **3,852,294 lekë** (nga të cilat **3,168,005 lekë detyrim për TVSH dhe 684,289 lekë gjobë**.

c) Nga auditimi mbi kontrollin e ushtruar në tatimpaguesin “KA” me NIPT LL janë konstatuar mangësi të cilat përfshijnë:

-Nga auditimi në lidhje me rakordimin e shpenzimeve sipas pasqyrës së performancës me blerjet e deklaruara në formularin e deklarimit dhe pagesës së TVSH-së konstatohet se nuk është kryer nga ana e inspektorit tatimor në raportin e kontrolli tatimor. Nga kryerja e këtyre e këtyre krahasimeve duke marrë në konsideratë edhe efektin e diferencave ndërmjet gjendjes së inventarit kanë rezultuar diferencat në shumën 1,401,131 lekë. Për rrjedhojë, rezulton të jenë mbivlerësuar shpenzimet e periudhës pasi janë më të mëdha se ato të deklaruara në libra për 1,401,131 lekë që pasojnë në një detyrim për tatim fitimi në masën 15% ose 210,167 lekë dhe gjobë në masën 100% në masën 210,167 lekë në total **420,334 lekë**.

d- Nga auditimi mbi kontrollin e ushtruar në tatimpaguesin “V” me Nipt LT janë konstatuar mangësi të cilat përfshijnë:

- Nga auditimi konstatohet se nuk është kryer një analizë në lidhje me inventarin e përpunuar nga tatimpaguesi si dhe arsyen e mos dokumentimit të qarkullimit të këtij inventari të ky tatimpagues për aq kohë sa është në ruajtje. Këto mangësi, rezultojnë që të kenë ndikuar edhe në mos kryerjen e analizës për të ardhurat e realizuara nga tatimpaguesi në lidhje me natyrën e faturimit të tyre, për kg apo orë pune. Gjithashtu sipas informacionit të vendosur në dispozicion në lidhje me këto mangësi për dokumentimin e qarkullimit të inventarit referuar objektit të aktivitetit, konstatohet se ai është kryer duke përdorur faturë shoqërimi. Kjo praktikë konstatohet e gabuar duke qenë se ajo përdoret për lëvizjet ndërmjet vendndodhjeve të të njejtit tatimpagues, ndërkohë që në këtë rast duhet të ishte përdorur faturë shitje. Për rrjedhojë nga ana e inspektorit tatimor duhet të ishte kryer analiza e qarkullimit të inventarit.

- Nga auditimi mbi blerjet e investimit të raportuara nga tatimpaguesi dhe të pasqyruara në raport kontroll konstatohen punime ndërtimi për mirëmbajtjen e godinave në vlerën 4,129,550 lekë dhe tvsh në shumën 825,910 lekë të cilat nuk janë trajtuar në raport kontrolli që të jenë pajisur me lejen përkatëse të ndërtimit për kryerjen e tyre si dhe faktit që të jenë kryer në formën e autofaturimit sipas paraqitjes në raport kontrolli dhe deklarimeve në cats. Tatimpaguesi referuar objektit të veprimtarisë nuk rezulton të jetë i licensuar për kryerjen e veprimeve ndërtimore dhe nuk rezulton të ketë të punësuar punonjës të specializuar për kryerjen e këtyre punimeve të specializuara në lsitëpagesat e raportuara për periudhën objekt kontrolli. Për rrjedhojë, blerjet për të cilat është lejuar kreditimi i tvsh për këto punime rezultojnë të jenë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 20 të Udhëzimit nr. 6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Detyrimet që lindin për TVSH janë në shumën 825,910 lekë dhe gjobë për deklarim të pasaktë në shumën 178,396 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

18.1 Rekomandimi: Drejtoria Tatimore Rajonale Vlorë, të marrë masa menjëherë dhe në vijim, të respektohen përcaktimet ligjore lidhur me kufizimet e së drejtës së zbritjes së TVSH-së për të siguruar konformitetin me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimit të munguar në buxhetin e shtetit dhe ato që rezultojnë pas informacioneve shtesë në rikontroll të cilat nuk janë pasqyruar në raportet e kontrollit si mungesa e bilancit material, mungesa e analizës së kartës teknologjike, mungesa e analizës së kostos së prodhimit, mungesa e analizës së kriterëve për vetëfaturim në rastin e investimeve apo shpenzimeve të periudhës, etj, evidentuar paraprakisht sipas tatimpaguesve “S” me NIPT LN në vlerën **2,420,934 lekë**, “A” me NIPT KE në vlerën **3,852,294 lekë**, “K” me NIPT LL në vlerën **420,334 lekë** dhe “V” me Nipt LT në vlerën **1,004,306 lekë**.

Menjëherë

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raportit të kontrollit të ushtruar në “F” SHPK me NIPT LK, u konstatua se, në bilancin material të kryer për artikujt (nafta, benzina dhe gaz i lëngshëm), për periudhën janar – dhjetor 2019, rezultuan diferenca në llogaritje të gazit të lëngshëm në magazinën e subjektit, me adresë “Lagjja 24 Maji“. Në fund të periudhës, më datë 31.12.2018, kjo magazinë ka pasur gjëndje sasinë prej 4,193.75 litër, e jo 1,515,21 litra siç është paraqitur nga inspektori i kontrollit. Nga ana e inspektorit nuk janë kryer verifikimet e subjektit sipas legjislacionit, ku diferenca e përmenduar sjell efekte financiare. Veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, neni 124 “*Moslëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i moslëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore*”, diferencë për të cilën subjektit i lind detyrimi total në vlerën **132,104 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

20.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të administrojë në rrugë zyrtare informacion dhe dokumentacion justifikues nga tatimpaguesi “F” SHPK me NIPT LK, në lidhje me mangësitë dhe parregullsitë e konstatuara në auditimin e procedurës së kontrollit tatimor, dhe të marrë masa konform përcaktimeve ligjore në fuqi për arkëtimin e detyrimit në vlerën **132,104 lekë**.

Menjëherë

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raportit të kontrollit të ushtruar në “S” SHPK, me NIPT LN u konstatua se fatura nr. 326073154, datë 07.03.2020, blerje me TVSH 35,839 lekë, nga furnitori “S”, është deklaruar në muajin Maj 2021, për të cilën tatimpaguesi “S” ka kërkuar kreditimin e TVSH, në kundërshtim me nenin 76, të ligjit nr. 92/2014 “*Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar. Me neni 54, pika nr. 3, të Udhëzimit nr. 6, datë 30.01.2015, “*Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar. Inspektori i kontrollit nuk ka kryer verifikimet e subjektit sipas legjislacionit dhe në kundërshtim me nenin 80, “Kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, me nenin 59 “*Përgjegjësitë dhe detyrat e inspektorit të sektorit të kontrollit në vend*”, të “*Rregullores së funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore*”, i ndryshuar, miratuar nga Ministri i MFE me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, me Programin e kontrollit, si dhe me Manualin e Kontrollit Tatimor, ku diferenca e përmenduar sjell efekte financiar të shmangur në vlerën **43,007 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

21.1 Rekomandimi: DRT Vlorë nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të administrojë në rrugë zyrtare informacion dhe dokumentacion justifikues nga tatimpaguesi “S” SHPK, me NIPT LN, në lidhje me mangësitë dhe parregullsitë e konstatuara në procedurën e kontrollit tatimor, dhe të marrë masa konform përcaktimeve ligjore në fuqi për arkëtimin e detyrimit në vlerën **43,007 lekë**.

Menjëherë

22. Gjetje nga auditimi: Në 4 raste nga auditimi i raportit të kontrollit të ushtruar në tatimpaguesit “S”, “F”, R “A”, për zbatimin e kërkesave të ligjit Nr. 9136, datë 11.02.2003 “*Për mbledhjen e detyrueshme të kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore*”, kanë rezultuar problematikat si më poshtë:

-Nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor nuk janë analizuar kontratat individuale të punës midis shoqërisë dhe punonjësve, në lidhje me përputhshmërinë e tyre me përcaktimet e dispozitave të Kodit të Punës në R.SH.

- Nuk janë analizuar regjistrat që duhet të mbajë tatimpaguesi sipas përcaktimeve të nenit 15 “Mbajtja e regjistrimeve” të Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Nuk ka një analizë të llogaritjes së pagës dhe elementëve përbërës të saj sipas përcaktimeve të dispozitave të nenit 119 të të Kreut XI të Kodit të Punës në R.SH.

- Janë konstatuar parregullsi në llogaritjen e ditëve dhe orëve të punës dhe pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore.

-Gjithashtu referuar natyrës së aktivitetit që ushtrojnë tatimpaguesit si tregti me pakice e shumice e karburantit, farmaci, hoteleri dhe orareve të ushtrimit të aktivitet gjatë një ditë 24 orë, si dhe gjatë ditëve të pushimi e shtunë dhe e djelë, konstatohet se nuk është bërë një analizë për deklarimin e pagave reale me qëllim llogaritjen dhe pagesën detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Ndërkohë në lidhje me konstatimin për llogaritjen e shtesës mbi pagë, në mungesë të të dhënave për regjistrat që duhet të mbajë tatimpaguesi, për efekt të llogaritjes së ditëve dhe orëve të punës për pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe referuar natyrës së aktivitetit që ushtron ky tatimpagues, grupi i audituesve gjykon se janë arsye themelore për të kryer rivlerësimin e pagave, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, për punonjësit me paga të deklaruara jo konform përcaktimeve të legjislationit, në lidhje me këtë tatimpagues i cili ka plotësuar deklarata tatimore që përmbajnë të dhëna të pasakta ose të falsifikuara dhe nuk mban dhe ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve, veprime të cilat janë në kundërshtim me *germën b, c të nenit 71, germa a e nenit 72, pika 3, neni 119 e Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.24 date 02.09.2008, i ndryshuar*, për pasojë subjekteve i linden detyrim si vijon:

- Tatimpaguesi “S” 2017, në vlerën totale 289,034 lekë, nga të cilat 144,517 gjobë.

- Tatimpaguesi “F”, në vlerën totale 75,132 lekë, nga të cilat 37,566 gjobë.

- Tatimpaguesi “A”, në vlerën totale 96,346 lekë, nga të cilat 48,173 gjobë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

22.1-Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë/Sektori i Kontrollit nga Zyra të marrë masat e duhura administrative konform legjislationit tatimor, për vlerësimin e detyrimeve tatimore të munguara, duke kryer vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse për llogaritjen detyrimeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, me qëllim arkëtimin e të ardhurave tatimore të evidentuara paraprakisht të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën gjithsej prej **460,512 lekë**, nga të cilat 50% gjobë, sipas tatimpaguesve “S, në vlerën **289,034 lekë**, “F”, në vlerën **75,132 lekë**, “A”, në vlerën **96,346 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Në 1 rast nga auditimi i raportit të kontrollit të ushtruar në tatimpaguesit “S”, nga analiza e blerjeve për periudhën Janar-Shtator 2022, konstatohet se shoqëria ka kryer blerje të materialeve të ndërtimit “pllaka”, por nuk provohet që këto materiale të jenë përdorur për mirëmbajtjen e aktiveve të shoqërisë nga të cilat gjenerohen të ardhura të tatueshme apo të jenë tregtuar. Ligji 92/2014 “Per TVSH-ne” i ndryshuar, kreu IX, seksioni I,

përcakton lindjen dhe aplikimin e të drejtës së zbritjes së TVSH-së, ku konkretisht në nenin 69, pika 1 sanksionohet se: “Personi i tatueshëm gëzon të drejtën që të zbresë nga TVSH-ja e llogaritur për transaksionet e tatueshme shumë e mëposhtme të TVSH-së, në masën që furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të marra përdoren nga personi i tatueshëm në funksion të këtyre transaksioneve të tatueshme”. Në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 68 “Vlerësimi tatimor” pika 4 dhe 5/b dhe neni 115, subjektit i lindin detyrimet për mosnjohjen e TVSH-së së zbritshme për materialet e ndërtimit në vlerë të tatueshme 121,325 lekë dhe TVSH të zbritshme 24,261 lekë. Konkretisht detyrim për TVSH 29,113 lekë, nga të cilat penalitet 4,852 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

23.1-Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë/Spektori i Kontrollit nga Zyra të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor, për vlerësimin e detyrimeve tatimore të munguara, duke kryer vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse, me qëllim arkëtimin e të ardhurave tatimore të evidentuara paraprakisht të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën gjithsej prej **29,113 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i raportit të kontrollit të ushtruar në tatimpaguesin “K” NIPT KS, kanë rezultuar mangësi si më poshtë:

-Nga inspektori i kontrollit nuk është analizuar nëse është miratuar nga organet drejtuese tarifa e studimit për çdo program studimi, por është nxjerrë një vlerë mesatare për çdo vit si raport i numrit të përgjithshëm të studentëve me pagesat e kryera, gjithashtu është analizuar numri i studenteve bazuar vetëm tek të dhënat e vëna në dispozicion nga subjekti, duke mos kryqëzuar të dhënat e paraqitura nga subjekti me të dhënat zyrtare të raportuara çdo vit në MAS, si detyrim ligjor që ka çdo institucion i Arsimit të Lartë në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit Nr. 5, datë 19.2.2018 “Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për Raportim të Institucioneve të Arsimit të Lartë”, i ndryshuar, pika 1, 2, germa a, b, pika 4/A, pika 4/B, Pika 5.

Sa sipër mungesa e të dhënave zyrtare për tarifën e miratuara dhe numrin e studentëve, paraqet pasiguri për vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave financiare të raportuara nga subjekti.

-Nga analiza e pasqyrave financiare për vitin 2018, rezulton se subjekti ka deklaruar në zërin “Shpenzime të tjera shfrytëzimi”, shpenzime për qira në vlerën 563,433 lekë, të cilat në mungesë të dokumentacionit që vërteton njohjen e këtyre shpenzimeve janë shpenzime të panjohura për efekte fiskale, për pasojë nuk do të njihen si shpenzim i zbritshëm. Referuar përcaktimeve të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, neni 21, Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni nr 115, subjektit i lindin detyrimet për TF në shumën 103,022 lekë, nga të cilat 18,508 lekë penalitet.

-Nga analiza e shpenzimeve të deklaruara nga subjekti për vitin 2018 dhe 2021 rezulton se subjekti ka deklaruar në zërin “Shpenzime të tjera shfrytëzimi”, shpenzime të tjera në vlerën 1,717,923 lekë për vitin 2018 dhe 7,500,000 lekë për vitin 2021, të cilat nuk janë analizuar nga inspektori i kontrollit, se çfarë përfaqësojnë këto shpenzime dhe nëse janë në funksion të veprimtarisë ekonomike të subjektit dhe pse në vlera të konsiderueshme. Shpenzimet më sipër në mungesë të dokumentacionit justifikues, fatura tatimore, situacione etj, që vërteton njohjen e këtyre shpenzimeve, klasifikohen si shpenzime të panjohura për efekte fiskale, dhe në referencë të përcaktimeve të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Per Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar,

neni 21, Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni nr 115, mund të sjellin efekte tatimore si detyrim për TF dhe penalitet. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2.1, faqet 33-173 të Raportit të Auditimit).

24.1-Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë për tatimpaguesin “K” NIPT KS, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit tatimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të bëjë propozimet përkatëse në DPT për rikontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e detyrimeve tatimore në shumën **103,022 lekë** dhe vlerësimin e detyrimeve të tjera të mundshme për zërin “Shpenzime të tjera shfrytëzimi”.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 58-“Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" si dhe në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” i rekomandohet Titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, vlerësimi i problematikave dhe shkeljeve të përshkuara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi dhe dhënie masash disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet në shërbimin civil”, për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara.

D. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit për të cilët janë rekomanduar masa disiplinore, Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT